Pas marrjes së vendimit për hartimin e PZHK-së për komunën e Deçanit, puna e Drejtorisë Urbanizmit dhe Mbrojtje Mjedisi është përqendruar ne mobilizimin e brendshëm të stafit komunal në sigurimin e të dhënave të cilat kërkohen sipas U.A. të MMPH Nr. 11/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin dhe zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

16.03.2018 – Mbahet takimi i parë me grupin punues për ndarjen e detyrave për plotësimin e shtojcave të U.A. të MMPH Nr. 11/2015.

Bartës i procesit te hartimit është Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje te Mjedisit. Ndërsa drejtoritë tjera do te angazhohen ne proces duke kontribuar me profesionist, te dhëna dhe informatat te cilat janë te nevojshme për hartimin e PZHK-se.

18.05.2018 – Mbahet takimi i dytë me grupin punues për pre progresin e sigurimit të dhënave. Në këtë takim vërehet mundësi e grumbullimit të dhënave për plotësimin e shtojcave si dhe mungesa bashkëpunimit nga hisedarët e ndryshëm e me theks të veçantë nga kompanitë publike si dhe operatorët privat qe operojnë në Komunën e Deçanit.

Ne këtë takim, është shqyrtuar rëndësia e dokumenteve strategjike sektoriale si dhe gjendja e tyre ne zbatim dhe nevoja e hartimit te dokumenteve tjera sektoriale. Te gjitha strategjitë, si burim dhe drejtim te hartimit do ta kanë PZHK-në ndërsa deri ne miratimin e këtij dokumenti, mund te ofrohen te dhënat dhe informatat tjera shtesë të dokumenteve sektoriale të cilat mund te aprovohen para miratimit të PZHK-së.

21.06.2018 – Mbahet takimi i parë me Ekipin Komunal për Planifikim me synim të hartimit të pjesë së profilit të Komunës Deçanit duke u bazuar në gjendjen faktike.

Ne këtë takim, është arritur që të plotësohet shumica e pjesës së profilit, mirëpo janë të qarta mungesa e te dhënave nga ndërmarrjet publike, kompanitë e telekomit si dhe agjencitë ne nivelin rajonal.

22.06.2018 – Mbahet takimi i parë me Ekipin Komunal për Menaxhimin e Mjedisit i cili është i fokusuar vetëm ne procesin e menaxhimit të mbrojtjes së mjedisit.

Ne këtë takim sigurohen të gjitha te dhënat dhe informatat e nevojshme për mjedisin duke u bazuar ne dokumentet sektoriale e te cilat kane te bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave etj.

10.10.2018 – Mbahet takimi me grupet tematike punuese për hartimin dhe plotësimin e profilit të komunës dhe mundësinë e plotësimit të shtojcave të U.A. të MMPH Nr. 11/2015. Grupet tematike të formuara trajtojnë çështjet e mjedisit, ekonomisë, infrastrukturës, turizmit, bujqësisë, financat dhe vendbanimet. Në këtë takim kanë marr pjesë edhe Ekipi Komunal për Planifikim dhe Ekipi Komunal për Menaxhimin e Mjedisit.

14.12.2018 – Mbahet takimi me te gjitha grupet punuese për prezantimin e draft profilit të komunës. Gjithashtu fillon edhe konsultimi me banorët e vendbanimeve.

Prezantimi ne përgjithësi është pranuar si i kompletuar me disa te dhëna shtesë të cilat kanë të bëjnë me pjesën historike të Deçanit dhe është rekomanduar që të merren të dhënat nga profesorët e degës se historisë dhe gjeografisë. Po ashtu, janë kërkuar ma shumë sqarime për rolin e kufijve të parkut Kombëtare “Bjeshkët e Nëmura” si dhe Manastirin e Deçanit.

03.03.2019 – Organizohet punëtoria për ndarjen e detyrave për vlerësimin e gjendjes ekzistuese. Gjatë takimit është potencuar nevoja e grumbullimit të dhënave të nevojshme të parapara me shtojcat e U.A. të MMPH Nr. 11/2015.

Grupet punuese gjatë punëtorisë kanë siguruar disa të dhëna shtese te cilat e kanë plotësuar vlerësimin e gjendjes ekzistuese mirëpo edhe pjesën e profilit. Te dhënat kanë të bëjnë me pjesën e edukimit,

infrastrukturën e transportit dhe atë teknike. Po ashtu, janë plotësuar edhe tabelat ne shtojca me te dhëna dhe njëkohësisht janë marr detyrat shtese për plotësimin e tyre. Ne vazhdim janë hartuar SËOT analizat dhe janë identifikuar sfidat dhe masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

21.05.2019 – Mbahet takimi me grupet punuese, Ekipi Komunal për Planifikim dhe Ekipi Komunal për Menaxhimin e Mjedisit për përfundimin e vlerësimit të gjendjes ekzistuese.

Finalizimi i gjendjes ekzistuese e ka hap procesin e fillimit te punës me skenarë. Skenarët e zhvilluar kanë has sfida për shkak të mungesa të dhënave për kufirin e Bjeshkëve të Nëmura si dhe kufizimet që rrjedhin nga projekt plani i "Bjeshkëve te Nëmura".

02.06.2019 – Mbahet punëtoria e përgjithshme për konceptin e zhvillimit hapësinore, vizionin, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet.

Grupet punuese kanë punuar në drejtimin e hartimit ë skenarëve të cilat janë bazuar ne gjendjen ekzistuese, përvojën e zbatimit te planit paraprak mirëpo edhe mundësit e zhvillimit ne te ardhmen. Sfida t dhe kontradiktat e ideve ishin te pranishme, sidomos ne fushën e ndërtimit ne pjesën perëndimore – Bjeshkët e Nëmura, infrastrukturën rrugore gjegjeshit të autostradës së Dukagjinit (roli dhe statusi i tij), drejtimet zhvillimit ne turizëm, fondi i pronës komunale, si dhe sfidat të cilat kanë të bëjnë në mes të qytetit të Deçanit dhe fshatrat ne kufi me zonën urbane të cilat për shkak të zgjerimit janë bashkuar me Deçanin (këtu bëhet fjalë për Isniqin, Carabreg dhe Qestë. Për Qesten është hartuar PRrU dhe kushte dhe kriteret e ndërtimit janë të caktuara, mirëpo sfiduese mbetet zgjerimi i kufirit të ndërtimit gjegjësisht boshllëqet e mbetura ne mes te Deçanit me Isniqin dhe Carabregun në jug të cilat për një periudhë kohore 5 vjeçare (sipas trendit te rritjes së qytetit dhe fshatrave) do të lidhen me Deçanit dhe sot ë shërbejnë si para lagje të zonën urbane.

15.10.2019 – Mbahet punëtoria për diskutimin e draft Planit Zhvillimor Komunal me synim të prezantimit të versionit përfundimtar të zhvillimit të ardhshëm 8 vjeçare.

Dokumenti mbështetët nga të pranishmit mirëpo kërkohet plotësimi me disa elemente zhvillimore të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, turizmin dhe bujqësinë. Po ashtu propozohet rritja ë shërbimeve sociale me theks të veçantë të shëndetësisë dhe edukimit ndërsa interes të veçantë nxiti shpërndarja e rrjeti të ujësjellësit në mënyrë të kompletuar me kanalizimit. Gjithashtu, mbrojtja e mjedisit nxiti interes që të caktohen masat me synim të mbrojtës së flotës, faunës por edhe të lumenjve. Përkundër faktit të prishjes së shtretërve të lumenjve nga gërmimet e pakontrolluara, pjesëmarrësit kanë kërkuar nga hartuesit që të caktohen zonat ne të cilat lejohet gërmimi ne mënyrë të kontrolluar duke mos e shkatërruar rrjedhjen ujore por edhe botën nënujore. Korridori ekonomik gjegjësisht rruga Pejë – Gjakovë është kërkuar që të zhvillohet dhe mos të kërkohen zonat e reja të biznesit apo zona ekonomike të cilat mund të shkaktojnë ndotje të tokës. Si temë tjetër (kryesisht nga sektori i ndërtimit) është kërkuar që të caktohen zonat e ndërtimit të mesëm dhe të lartë, të cilat do i ndihmojnë ndërtuesit dhe plotësojnë buxhetin e komunës nga të hyrat e taksave. Po ashtu, kërkesa në rritje për banim, do ju mundëson që të ofrojnë strehim me çmim të përballueshëm në qoftë se plani i qartëson të gjitha kushtet dhe kriteret e ndërtimit si dhe në qoftë së ofrohen të gjitha shërbimet e infrastrukturës teknike, transportit dhe sociale.

13.12.2019 – Merret pëlqimi nga të gjithë hisedarët, grupet e interesit, grupet punuese dhe Ekipi Komunal për Planifikim dhe Ekipi Komunal për Menaxhimin e Mjedisit për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme për projekt PZHK-në.

Kjo është rrjedhojë e takimit – prezantimit të draft PZHK-së me datë 15.10.2019 dhe marr parasysh të gjitha rekomandimet e hisedarëve.

26.02.2020 – Mbahet mbledhja e II-të e rregullt e Komiteti për Politikë dhe Financa ku si pikë e diskutimit ishte projekt PZHK e Komunës Deçanit dhe aktivizimi i të gjitha partive politike, udhëheqësve të lagjeve, fshatrave për fillimin e konsultimeve publike.

Draft projekti në përgjithësi ka marr mbështetje për përmbajtjes dhe drejtimet e zhvillimit, mirëpo çështjet e ngritura në këto drejtime ishin me rritjen e investimeve në rrjetin e infrastrukturës së trafikut, infrastrukturën teknike (me theks ujësjellës dhe kanalizimi, lëvizja deri te shkollat dhe rritja e kapaciteteve edukative që nxënësit mos të përdorin dy turne. Po ashtu është kërkuar rritja e infrastrukturës së sportit si dhe rekreacionit. Në fushën e turizmit është kërkuar që të shikohen mundësitë e ndërtimit në parkun Kombëtarë Bjeshkët e Nëmura. Në ketë takim është shfrytëzuar edhe momenti për të shpjeguar kompetencat rreth ndërtimeve ën Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nëmura" dhe roli i Institutit për Planifikim Hapësinorë në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

02.03.2020 – Mbahet takimi i II-të i rregullt e Kuvendit, Komuna e Deçanit ku prezantohet procesi i hartimit te PZHK-së dhe aktivizimin e gjithmbarshëm dhe gjithëpërfshirës në fillimin e diskutimit të dokumentit.

Periudha e pandemisë COVID19 e ka bllokuar procesin e hartimit të projekt PZHK-së.

01.06.2020 - Mbahet takimi i radhës i Këshillit të Drejtorëve për gjendjen ekzistuese të periudhës së

COVID19 dhe procesin e vazhdimit të PZHK-së dhe komentimi i projekt -PZHK së propozuar.

Ne ketë takim është vendosur që të krijohet platforma online dhe të vazhdohet me punën për hartimin e PZHK-së.

01.06.2020 - Drejtoria për BPZHR organizoi diskutim publik për ,,Planin Zhvillimorë Komunal'' për tematikën e bujqësisë.

Ne këtë takim është kërkuar që të projekt PZHK të shikohen mundësitë e rritjes së sistemi të ujitjes, të parandalohen gërmimet ne burimet e ujërave, të ndërtohet rrjeti i kanalizimit me qenë se deri tani janë duke u përdorur gropa septike. Gjithashtu janë kërkuar hartimi i politikave për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe ndihmat me grante. Kërkesat ishin edhe në lidhje me ofrimin e vendeve për shitjen e produkteve bujqësore si dhe te mbrohen ne të ardhmen tokat e tyre nga vërshimet, zjarret dhe reshjet. Përdorimi i pesticideve në mënyrë të pakontrolluar ishte një nga temat e bisedës, mirëpo që nuk i takon këtij niveli të planit. Trajnimi në fushën e bujqësisë dhe praktikat e mira dhe bashkëkohore për bujqësinë ishin një nga kërkesat e pjesëmarrësve pas prezantimit. Gjithashtu, pajisja me leje të ndërtimit është konsideruar si shumë burokratike për zonat rurale.

04.06.2020 - Drejtoria për Arsim në Komunën e Deçan, organizoi diskutim publik lidhur më ,,Planin Zhvillimor Komunal me tematikën e bujqësisë.

06.06.2020 - Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Deçan, organizojnë diskutim publik lidhur me ,,Planin Zhvillimor Komunal'' me tematikën e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe mirëqenien speciale dhe shëndetësi.

Në ketë takim është kërkuar të rritet numri i aktiviteteve sportit në lagje por edhe ma shumë. Zona e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nëmura" është konsideruar si potencial për aktivitete sportive dhe rekreative. Në kërkesë është parashtruar mundësia e përdorimit të palestrave të sportit në kuadër të shkollave (si të hapura ashtu edhe të mbyllura). Stadiumi i qytetit do të ishte potencial i zhvillimit të futbollit ndërsa ndërtimi i palestrave për sportet e mbyllura nëpër disa fshatra ku do të kryheshin shërbime pa pagesë, do të promovonte shumë sportin.

Rinia ka nevojë për shumë aktivitete, dhe është kërkuar që në kuadër të planeve sektorialë të hartohen politikat për aktivizimin e rinisë në aktivitete të ndryshme. Gjithashtu, mungesa e buxhetit nuk po ofron mundësi që rinia të merr pjesë në projekte te ndryshme. Zhvillimi ekonomik dhe rritja e punësimit do ta ndihmon mjaft rininë e komunës Deçanit që të mos migron në komunat ma të zhvilluara apo edhe në shtetet tjera.

Për mirëqenien sociale është kërkuar që të ndërtohen shtëpi të komunitetit me theks te veçantë në fshatra ku banoret e atyre zonave mund të socializohen. Ndërsa kërkesat për banim me çmime të përballueshëm ishte mjaft i lartë me qenë se nevoja për banim është ne rritje, e sidomos çifteve të reja. Në ketë drejtim është kërkuar që komuna të mendon të ndërton ndërtesa të banimit me qera të ulët mirëpo edhe partneriteti PPP nuk është përjashtuar.

Socializimi dhe aktivizimi i gruas ishte kërkesa tjetër që duhet të përfshihet dhe trajtohet në ketë plan. Mungesa e hapësirave dedikuar gruas është evidente ne jo vetëm në Deçan mirëpo edhe në shumë komuna tjera andaj është propozuar që në këtë drejtim të punohet dhe të aktivizohen organizatat lokale të cilat do të bashkëpunojnë me këto institucione dhe të promovojnë vetëdijesimit, rruajtjen e traditave – zakoneve dhe aftësimin e gruas për punë.

23.10.2020 – Mbahet takimi me grupet punuese dhe Ekipin Komunal për Planifikim dhe Ekipin Komunal për Menaxhim të Mjedisit për integrimin e propozimeve dhe komenteve nga takimet me grupet e ndryshme të interesit në fushën e bujqësisë, arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, rinisë dhe sportit.

Ne këto takime, dokumenti i PZHK-së ka marr formën e vet përfundimtare. Duhet të cekët se si përfundim, shërbimet sociale, infrastruktura e trafikut dhe ajo teknike, pastaj sektori i ndërtimit, mbrojtja e mjedisit dhe mbi te gjitha zhvillimi ekonomik ishin çështjet të cilat në aspektin shoqëror kanë dominuar më se shumti. Shqetësimi kryesor mbetej roli i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nëmura" në zhvillimin e qëndrueshëm të Deçanit mirëpo edhe statusi i pa qartë i Manastirit të Deçanit, i cili konsiderohet si aset i trashëgimisë për Komunën e Deçanit, mirëpo edhe si rrezik për zhvillim të turizmit si rrjedhojë e mosbashkëpunimin.

21.11.2022 – Merret vendimi për hartimin e VSM-së se projekt PZHK-së

Hartimi i VSM-së ka nxit në pah disa rekomandimet ë cilat kanë ndikuar në përmbajtjen e projekt PZHK-së. Këto rekomandime kanë ndikuar ne disa pika të planifikuara nga projekt PZHK dhe me sukses janë krijuar sinergjitë duke i mënjanuar kontradiktat.

21.03.2021 – Komuna e Deçanit pajiset me pëlqimin e VSM-së për PZHK-ne.

Gjatë një periudhe kohore, DUMM ne Komunën Deçanit e rinis procedurën për kompletimin e shtojcave duke i marr parasysh se shume te dhëna janë vjetruar, disa nga ato duhej te harmonizoheshin me gjendjen reale dhe rifillon punën pothuajse nga fillimi për ti plotësuar te gjitha kërkesat te dala nga korniza ligjore.

06.11.2022- Komuna e Deçanit duke u bazuar ne vërejtjet e dala nga MMPHI për plotësim te dokumentit para marrjes s e pëlqimit për dalje ne shqyrtim publik, organizon takimin e hapur me qytetar për prezantimin e tre skenarëve për zhvillimin e ardhshëm të komunës. Skenarët kane qëndruar te ekspozuara ne DUMM ndërsa hapja e prezantimit te skenarëve është bere nga Kryetari.



Figura 3. Momente nga prezantimi i skenarëve për zhvillim: mobilizimi dhe aktivizimi ne nivel komunal, prezantimi i skenarëve te shoqëria civile, prezantimi te qytetaret.



Figura 4. Prezantimi i skenarëve ne vendbanime

1.2 Përmbledhje e shkurtër e PZHK-së.

1.2.1 Pozita, karakteristikat gjeografike, reliefi dhe gjeologjia

Komuna e Deçanit, ndodhet në perëndim nga kryeqyteti i Prishtinës ne distancë 88 km vij ajrore, në Rrafshin e Dukagjinit rrëzë Bjeshkëve të Nemuna në koordinatat 42°32'00"N dhe 20°17'00"E. Ka pozitë të mirë gjeografike në rrugën magjistrale Pejë – Gjakovë – Prizren që e lidhë pjesën veriore dhe jugore të Dukagjinit. Vija ajrore me Detin Adriatik është 90 km, ndërsa përmes Pejës lidhet me hekurudhën që e lidh Dukagjinin me Fushë Kosovën. Ne pjesën perëndimore kufizohet me Republikën e Shqipërinë nëpërmes qafës së Morinës dhe ofron mundësitë mira të lidhjes me vendbanimet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Në veri perëndim kufizohet me Malin e Zi ndërsa në verilindje kufizohet me Komunën e Pejës. Në lindje pjesërisht kufizohet me Komunën e Gjakovës ndërsa në jug dhe jug perëndim kufizohet me Komunën e Junikut.

1.2.2 Klima

Komuna e Deçanit, ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane. Gjatë vitit në Deçan, ka 1945 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit, karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7°C dhe 22.7°C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C. Në klimë ndikon shumë afërsia "Bjeshkëve të Nemuna" dhe rrymat e tjera të ajrit, që në viset e ulëta karakterizohet më vera të nxehta dhe të thata dhe më dimra relativisht të ftohtë dhe më lagështi.

1.2.3 Temperatura

Temperatura e ajrit në qytetin e Deçanit, që gjendet në lartësinë mbidetare prej 600 m temperaturat mesatare vjetore nuk lëshohen nën 0º C. Muaj më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare mujore 0.2º C. e muaj më i nxehtë është korriku me temperaturë të mesme mujore prej 21.7º C.

1.2.4 Demografia - Zhvillimi Demografik

Numri i popullsisë në qytetin e Deçanit, qe nga viti 1948 deri në vitin 2011, ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 22179 banorë. Pra, në bazë të kësaj rritje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare (1948 – 2011), rezulton se mesatarisht popullsia ne komunën e Deçanit ka shënuar rritje me 352 banorë në vit. Por nëse marrim dhe krahasojmë të dhënat statistikore të vlerësimit të popullsisë të prezantuara nga ASK në vitin 2011 - 2021, kjo e dhënë ndryshon dhe rritja mesatare vjetore e popullsisë është 247 banorë në vit. Në qytetin e Deçanit, mesatarisht familjet i kanë 6.3 anëtar, ndërsa mesatarja e anëtareve të familjes në komunën e Deçanit, është 6.8 anëtar sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011. Komuna e Deçanit karakterizohet me diversitet etnik të popullsisë. Sipas regjistrimit të vitit 2011 kjo komunë dominohet nga komuniteti shqiptarë, egjiptian, boshnjak, ashkali, rom, serb, goran, të tjerë, nuk janë deklaruar dhe nuk ka të dhëna. Bazuar në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Deçanit, është rreth 144 banorë në 1 km², që është nën mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

1.2.5 Shkalla e Papunësisë

Vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2021, është 20.7% (101,161 persona të moshës 15-64 vjeç) dhe llogaritet të jetë më e larta në rajon. Mirëpo, krahasuar me vitin 2020 ka një rrënje prej 5.2%. Në këtë mes, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat me 25% se sa për meshkujt me 19%.

1.2.6 Shkalla e Punësimit

Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për vitin 2021, është 31.10%1, apo 383,304 persona. Punësimi me i lartë është të meshkujt (45.9%), ndërsa punësimi të femrat është 16.5%. Femrat janë të punësuara, kryesisht në këto sektorë: arsim, kujdes shëndetësor dhe tregti, me 51.8 % të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët: ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit, me 41.8%.

1.2.7 Ambienti i biznesit - ndërmarrjeve

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Deçan, në bashkëpunim me nivelin qendror kanë krijuar një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit ndërmarrës në komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, NVM-së regjistrohen përmes Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve me shumë pak procedura. Disa prej zhvillimeve të rëndësishme në ketë drejtim që ka krijuar kushte komuna e Deçanit, për ushtrimin e veprimtarive ndërmarrëse është investimi në infrastrukturë rrugor i cili investim ka hapur rrugë ndërmarrjeve për investime edhe në zhvillimin ekonomik lokal në fushën e turizmit, që është një nga potencialet e mëdha të zhvillimit.

1.2.8 Numri dhe struktura e ndërmarrjeve në Komunën e Deçanit

Është inkurajues fakti që numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat ka shënuar rritje ndër vite, duke u bazuar në statistikën që mirët gjatë aplikimit të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet sipas llojit SH.P.K kanë mesatarisht numrin e të punësuarve 3-7, ndërsa ndërmarrjet Individuale 1-3 të punësuar. Në vitet e fundit ka pasur rritje në ndërmarrjeve duke filluar nga ndërmarrjet individualë që kanë qenë kryesisht Start UP (fillestar), të cilat kanë gjetur mbështetje dhe disa prej tyre janë përfituese të grandeve nga niveli qendror dhe një numër i caktuar tyre nga donacione të ndryshme. Regjistrimi i ndërmarrjeve ne komunën e Deçanit vit pas viti po rritet dhe duhet të theksohet se gjatë vitit 2022 janë regjistruar 106 ndërmarrje të reja ndërsa sa i përket shuarjeve të ndërmarrjeve më së shumti ka pas në vitin 2019 me 37 të tilla. Viti 2020 mund të konsiderohet si viti kur ka pas më së shumti ndërmarrje të regjistruara nga kalkulimi "në mes të regjistrimit dhe shuarjes së ndërmarrjes" me 80 ndërmarrje ndërsa viti 2019 mund të konsiderohet me më pak të regjistruara nga kalkulimi "në mes të regjistrimit dhe shuarjes së ndërmarrjes" me 61 ndërmarrje të regjistruara. Sa i përket pronësisë shumica e ndërmarrjeve janë pronë private. Vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve janë publiko – private dhe komunale.

1.2.9 Sipërfaqet bujqësore dhe kualiteti i tyre

Komuna e Deçanit, disponon me 12,028 ha tokë bujqësore (sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore/sipërfaqe, tokë e punueshme/arë, kopshte, livadhe dhe tokë bujqësore e pa përdorur) që përfshinë 60% të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Deçanit, (293,94 km2). Ndër to më se shumti ka tokë të mirë të klasës I,II dhe III (60%) ndërsa ma së paku tokë të varfër respektivisht klasa V,VI (15%). Tokë të mesme të kualitetit IV ka 25%. Sa i përket bonitetit të tokës më se shumti ka të klasës 6 me 12094 Ha, pastaj klasa 4 me 6501 Ha, klasa 8 me 3204 Ha e kështu me radhë.

1.2.10 Kultivimi i kulturave bujqësore

Në Komunën e Deçanit, nga sipërfaqja e tërësishme bujqësore prej 12,028.6 ha, kulturat kryesore bujqësore që kultivohen në këtë Komunë janë: misri, gruri, perimet, pemët, patatja etj. ndërsa dominon më së shumti kultura e misrit dhe perimekultura. Prodhimi vjetor i kulturave bujqësore sipas viteve (2017-2019) është si vijon: kulturat bujqësore, sipërfaqet e mbjella, rendimenti për ha dhe prodhimi vjetor.

1.2.11 Prodhimtaria blegtorale

Sipërfaqet e konsiderueshme të kullosave dhe livadheve janë potencial i rëndësishëm i Komunës së Deçanit, për zhvillimin e blegtorisë e cila në veçanti shtrihet në pjesën rurale. Në Komunën e Deçanit, dominojnë

[1] Anketa e Fuqisë Punëtore 2021, ASK

kullosat natyrale me 1,873 ha.

1.2.12 Pylltaria

Pyjet e Komunës së Deçanit, janë thesari më i çmuar i vendit duke ju falënderuar relievit, klimës dhe hidrografisë i bënë ato me të çmuara dhe me atraktive. Sipërfaqet pyjore në komunën e Deçanit, janë si vijon: sipërfaqja e përgjithshme 16,786.1 ha. Nga sipërfaqja e përgjithshme Komunës së Deçanit, pyjet bëjnë pjesë rreth 36 % të sipërfaqes, rritja vjetore është 92,691 m3, kualiteti i masës drunore është i nivelit të lartë ku 70 %, është dru teknik i cili përdoret për përpunimin e mëtutjeshëm në industrinë e drurit. Trashëgimia natyrore dhe kulturore

1.2.13 Trashëgimia natyrore

Komuna e Deçanit, është e njohur me trashëgimi natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është e vendosur nën mbrojtje sipas normave ligjore mjedisore. Deçani disponon "Bjeshkët e Nemuna" që janë Park Nacional, paraqet një prej vlerave më të rëndësishme natyrore. Bukuritë natyrore dhe vlerat e këtij territori e posaçërisht "Gryka e Deçanit", kanë vend të rëndësishëm në vlerat, peizazhit dhe bukurive natyrore specifike me florë dhe faunë. Vlerë të mëdha këtij territori i shtonë edhe "Gryka e Deçanit" më "Kanjonin e Lumëbardhit" të Deçanit, si dhe "Gryka e Lloqanit" me "Lumëbardhin e Lloqanit", vlera që krijojnë mundësi të jashtëzakonshme për vizita dhe ekskursione nga turistët vendas dhe të huaj.

1.2.14 Trashëgimia kulturore

Qyteti i Deçanit, karakterizohet me monumente të gjitha kategorive ku përfshihen: komplekse, shtëpi tradicionale, kulla, xhami, kisha, mulli etj. Territori i Deçanit, është i pasur me monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Vendet më interes të madhe janë: lokalitet arkeologjike parahistorike në; Belle, Pleqe, Vranoc të Vogël, Gllogjan, Strellc i Epërm, Rastavicë, Irzniq, dhe Baballoq, kullat, monumentet e krishterë dhe islam, si dhe mullinjtë. Vendet me rëndësi arkeologjike janë: Llukë e Epërm, Lëbushë, Kisha Selishtave, Rrazhga, Qelia, Shpella e Madhe, Balleja, Kozhnjerit, Carrabregut, Kisha në kodër të Lumëbardhit etj. Në komunën e Deçanit kemi një numër të madh të kullave - të komplekseve të kullave në disa fshatra tjera siç janë kompleksi i kullave në: Isniq, Drenoc, si dhe një numër i kullave në fshatrat e Deçanit. Ndër kullat më të njohura janë: Kulla e Osdautajve, Kuklecve në kompleksin kullave në Isniq, kulla e Demukajve dhe Mushkolajve në Deçan, Kulla e Mazrekajve dhe Binakajve në Kompleksin e Kullave në Drenoc, Kulla e Ramë Shabanit në Prapaqan, Kulla e Ali (Demë) Gecit në Llukë të Ulët, Kompleksi i Qelisë. Infrastruktura teknike

1.2.15 Ujësjellësi

Sistemi i furnizimit me ujë në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga K.R.U " Hidrodrini" SH.A kurse furnizimi për qytetin dhe fshatrat e Komunës së Deçanit, bëhet nga këto burime:

1. Bjeshka e Strellcit përfshihen 6 burime;
2. Gryka e Deçanit përfshihen 5 burime;
3. Gryka e Deçani - Gypi i CDF-përfshinë 3 burime;
4. Bjeshka e Lloqanit përfshihen 3 burime;
5. Gjipsi i Vokshit përfshinë 4 burime;
6. Burimi i Vokshit - Lugi i Zallit përfshinë 5 burime.

Qyteti i Deçanit i ka 37 fshatra, 35 fshatra mbulohen me rrjetin e ujësjellësit me furnizim 100 % ujë të pijes, ndërsa fshatrat Belle dhe Pleqe furnizohen nga burimet natyrore për shkak të konfiguracionit të terrenit-malor. Rrjeti shpërndarës është i ndarë në rrjetin primar dhe sekondar, të përberë nga 9 tubacione me gjatësi të përgjithshme prej: 118,520 m. Sipas regjistrimit të fundit i viti 2011, në Komunën e Deçanit, janë 40019 banorë, të cilët kane qasje në sistemin e ujësjellësit 99.9%, ndërsa numri i konsumatorëve në Komunën e Deçanit, është: amvisëri 6011, komerciale (biznese) 414 dhe Institucione 47.

1.2.16 Kanalizimi

Kanalizimi përfshinë rrjetin e Qytetit të Deçanit, me 6 fshatra dhe 27 fshatrave të tjera ku parashihet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit. Ky rrjet është shtrirë përgjatë sistemit të ujësjellësit dhe kryesisht përgjatë rrugëve të vendbanimeve përkatëse në një thellësi që nuk pengon komunikacionin e deri tek vendi i impiantit që gjendet në fshatin Lumbardhë.

1.2.17 Rrjeti i kanalizimit - ujërat e zeza

Në Komunën e Deçanit, sistemi i kanalizimit ka filluar të ndërtohet që nga viti 2007, dhe ende vazhdon shtrirja e rrjetit ku do të filloj ndërtimi edhe për 18 fshatra nga ana jugore dhe 6 fshatra nga ana veriore, gjithsej nga 38 vendbanime që i ka Komuna e Deçanit, të përfunduara me rrjetin e kanalizimit për ujërat e zeza janë 12 vendbanime. Rrjeti i kanalizimit që ka filluar nga viti 2007, mbulohet Qyteti i Deçanit, me gjashtë fshatra: Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Llukë e Epërm, Llukë e Ultë dhe Lumbardhë. Ky rrjet është me gjatësi prej 59,062.36 m, gjithashtu rrjet të kanalizimit kanë edhe këto fshatra: Rastavicë me gjatësi prej 752 m , Pobergjë me gjatësi 1,533 m, fshati Sllup me gjatësi 3,225 m, Drenoc dhe Lloqan.

1.2.18 Rrjeti i kanalizimit atmosferik

Në Qytetin e Deçanit, ekziston një sistem i mirë për largimin e ujërave atmosferike në kuptimin e një sistemi të dizajnuar dhe të ndërtuar sipas normave ndërtimore. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është i orientuar në drejtim të Lumëbardhit, ujërat atmosferike derdhen pa trajtim adekuat. Vetëm qendra e Deçanit, ka rrjetë për ujërat atmosferike më gjatësi 1500 m.

1.2.19 Ujitja

Për ujitje në territorin e Komunës, shfrytëzohen disa burime natyrore: lumenjtë dhe puse (bunarë). Duke qenë se nuk ka një sistem të rregulluar të ujitjes sipas të dhënave sipërfaqet dhe sasitë e nevojshme për ujë nuk mund të verifikohet me saktësi, por supozohet se janë diku rreth 80 % e sipërfaqes së tokës bujqësore që mbulohet me ujitje. Komuna e Deçanit, ka një infrastrukturë të mirë për ujitjen e tokës bujqësore ku deri me tani kanale të betonuara janë gjithsej 61,110 m, por në të ardhmen për zhvillimin dhe rritjen e prodhimtarisë bujqësore investimet e Komunës do të përqendrohen në ndërtimin e infrastrukturës bujqësore.

1.2.20 Sistemi për ujitjen e tokave bujqësore

Sistemi i ujitjes në Komunën e Deçanit, administrohet nga Kompania Rajonale e Ujitjes (KRU) “Drini i Bardhë”. Gjatësia e sistemit të ujitjes aktual është: 61.110 m, ndërsa gjendja fizike e rrjetit është e mire. Në infrastrukturën e ujitjes janë ndërtuar 8 penda, ose prita të ujit-furnizues për furnizim të kanaleve të ujitjes. Një pjesë e sistemit të ujitjes është tradicional, “Ujitje me Përmbytje”, që bëhet përmes kanaleve të hapura dhe përfaqëson mënyrën e ujitjes me shpenzime maksimale të ujit. Kjo paraqet problem, në veçanti gjatë muajve korrik-gusht kur sasia e ujit është e pamjaftueshme në mungesë të reshurave dhe temperaturave të larta. Për krijimin e kushteve të mira për ujitjen e tokave bujqësore, komuna ka studimin e fizibilitetit për ndërtimin e tri pendave akumuluese në kanjonin e lumit Lumbardhë të Lloqanit.

1.2.21 Energjia elektrike

Furnizimi i Kosovës, me energji elektrike bëhet nga dy burime primare: dy termocentralet me ndezje të thëngjillit “Kosova A” dhe “Kosova B” në rajonin e Prishtinës, dhe importeve përgjatë rrjetit 400 kv dhe 220 kv në termocentralin “Kosova B”, përgjatë rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv.

Gjendja e rrjetit për furnizim me energji elektrike për momentin është e mirë, ku me ndihmën e donatorëve dhe investimeve Komunale është bërë riparimi i një pjese të madhe të këtij rrjeti duke përshirë tensionin e ulët dhe tensionin e lartë. Komuna e Deçanit, ka shtrirje me furnizim të energjisë elektrike edhe nga hidrocentrali i Kozhnjerit, i cili e bënë furnizim me 8 mg ku zbrazja bëhet në NS Deçan 110/35/10 kv. Rrjeti primar është në gjendje të rregullt dhe funksional i tensionit të ulët në: Qyteti i Deçanit, (ndërtesat përgjatë rrugës kryesore furnizohen me rrjet nëntokësor), Lëbushë, Dubovik, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm,

Pozhar, Kodrali dhe Drenoc. Ndërsa pjesërisht janë: Strellci i Epërm, Strellc i Ulët dhe Isniqi.

1.2.22 Sektori i ndriçimit publik të rrugëve

Gjatësia e gjithë rrjetit të ndriçimit publik sipas PKVEE është raportuar të jetë 17,350 m, ndriçimi i rrugëve publike sipas këtij plani është siguruar për 20 rrugë-seksione në Komunën e Deçanit. Ndriçimi publik në Komunën e Deçanit, përfshinë 1,183 ndriçues. Nga kjo në total është 90% janë raportuar të jenë të teknologjisë LED dhe 10 % llamba të tipit HID halide.

1.2.23 Telekomunikacioni

Në territorin e Komunës së Deçanit, veprojnë disa operatorë si: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO, të cilat ofrojnë telefoni fikse dhe mobile, kurse kompani të tjera si: Kujtesa, Adea Computers, Art Motion, Një Art, PTK etj. veprojnë si kompani që ofrojnë shërbime në televizion kabllor dhe internet brenda zonës urbane dhe zonat rurale. Në rastet të shumta, linjat tele-komunikuese përdorin rrjetin ajror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraprak. Megjithatë, gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Deçanit, është relativisht e mirë. Posta Telekomi Kosovës (PTK) ofron shërbime postare, që mbulojnë gjithë territorin e Komunës dhe është e vetmja kompani e cila e ka piken e vet zyrtare të operimit në këtë komunë. Operatorët tjerë privat funksionojnë vetëm nëpërmes distributorëve.

1.2.24 Ngrohja

Komuna e Deçanit, nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Ekonomitë familjare për ngrohje përdorin: drurin, peletin, briketin, karburantet ose energjia elektrike për ngrohje. Nuk ekzistojnë të dhënat se me çka ngrohet çdo njësi banimi apo biznesi me qenë se ato ndryshojnë nga viti në vit. Mirëpo, është me se e sigurt se për ngrohje më se shumti përdoret druri dhe energjia elektrike. Ka tendenca që ne vitet e fundit, energjia elektrike të ketë rritje në krahasim me përdorimin e druri me qenë se tani në treg po ofrohen teknologji kursyese për ngrohje mirëpo edhe subvencionimet nga niveli qëndro po e nxisin përdorimin e teknologjisë e cila është kursyese e energjisë. Deçani bazuar në pasurit e pyjeve ku nga pastrimi i tyre mund të realizoj ngrohjen nga biomasa.

1.2.25 Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Deçanit, ka krijuar një sistem komunal për menaxhim të mbeturinave dhe plotësimin me mjetet përcjellëse për shtrirjen e plotë të shërbimit për mbledhjen (grumbullim) të mbeturinave në gjithë territorin e Komunës. Shtrirja e menaxhimit të mbeturinave në gjithë Komunën, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh. A. e cila ofron shërbime rreth mbledhjes (grumbullimit) të mbeturinave dhe ndarjes në bazë në ekonomitë familjare. Trajtimi i mbeturinave përfshin: riciklimin, ripërdorimin, reduktimin dhe kompostimin e mbeturinave e deri në transportimin e tyre në deponinë regjionale. Ne komunën e Deçanit menaxhohen mbeturinat e veçanta.

1.2.26 Infrastruktura e transportit rrugor dhe transporti

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e Komunës se Deçanit, bëhet përmes transportit rrugor ndërsa hekurudhor nuk është i pranishëm. Komuna e Deçanit, posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat tjera dhe shtetet fqinje.

Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si vijon: a) transportin e rregullt të udhëtarëve; b) transportin e lirë të udhëtarëve; c) transportin taksi të udhëtarëve dhe d) transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është: 63 km, kurse rrugë lokale janë me gjatësi prej 300.24 km. Nga gjithsejtë 405 km rrugë, 362.60 km janë të asfaltuara dhe 42.40 km të pa asfaltuara.

1.2.27 Transporti rrugor

Komuna e Deçanit, ka një infrastrukturë rrugore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme biznesore. Rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve lokale, rajonale dhe nacionale. Në kuptim të trafikut, rruga nacionale R-107, e cila e përshkon territorin e komunës në drejtimin veri-perëndim, që lidhet me vendkalimin kufitar me Malin e Zi dhe gjatësia e kësaj rruge është: 28 km, administrohet nga niveli qendror dhe rruga rajonale R-108, që lidhë komunat Pejë - Deçan - Gjakovë. Në përmirësimin të infrastrukturë rrugore, Komuna e Deçanit, ka asfaltuar pjesët dërmuese të rrugëve duke afruar cilësi të mirë për transport në zonën urbane dhe rurale. Ajo çka duhet të ndryshoj në të mirën e mbrojtjes së mjedisit dhe të aktivizohet transporti publik, pasi që në bazë të dhënave në komunën e Deçanit 75-80 %, e transportit kryhet më automjete private.

1.2.28 Ndotja nga komunikacioni

Transporti rrugor është një nga burimet më të mëdha të ndotjes, duke kontribuar në cilësi të dobët të ajrit, zhurmës dhe ndryshimet klimatike. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve bëhet me mjete të ndryshme të cilat ndotin mjedisin duke ndikuar në ndotje të ajrit nga transporti. Ndotësit e ajrit nga transporti përfshijnë oksidin e azotit, grimcat, monoksidin e karbonit dhe hidrokarbure. Të gjithë kanë një ndikim të dëmshëm në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimësisë në nivel lokal.

1.2.29 Transporti ndër-urban

Transporti ndër-urban i udhëtarëve ka për shërbim një mini-stacion të autobusëve si dhe disa vend parkingje për taksi. Linjat e autobusëve që qarkullojnë dhe shërbejnë për qytetarët e Deçanit, janë kryesisht ato të linjave transite Pejë-Gjakovë- Prizren dhe disa linja Deçan-Pejë-Prishtinë, ku shërbimi i udhëtarëve bëhet në mini stacione të cilat me përfundim e Qendrës se Qytetit, do të ndryshohen këto mini stacione.

1.2.30 Vend-parkingjet

Në Komunën e Deçanit, përfshihen 4 parkingje, prej cilave dy parkingje publike (hapësira në komunë dhe hapësira të objekti i postës) dy parkingje tjera janë: përballë objektit të banimit kolektiv "Gogaj" në Rrugën "Jashar Salihu" dhe tjetri në rrugën "Sali Çeku", këto 4-parkingje kanë hapësirë prej 280 vend parkingje. E domosdoshme në komunën e Deçanit, të planifikohen, të shtohet numri i parkingjeve për të akomoduar automjetet në vend-parkingje sipas standardeve dhe parkingjet të qendrat biznesit.

1.2.31 Shëndetësia

Infrastruktura e institucioneve shëndetësore, shërbimet shëndetësore në komunën e Deçanit, ofrohen në nivel të kujdesit primar shëndetësorë në këto njësi:

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Deçan,
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq,
- 7 Ambulantë të Mjekësisë Familjare (AMF) në Lumbardhë, Prapaqan, Gramaqel, Pobergjë (Polana), ndërsa tri prej AMF në: fshatin Ratish i Ulët, Prilep dhe Maznik, nuk janë në funksion.

Të angazhuar në ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësorë në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 120 punëtor.

Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) mbështetet në konceptin e mjekësisë familjare dhe përfshin kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike. Shërbimet ofrohen në institucione shëndetësore publike dhe private. Rrjeti publik i KPSH-së, përbëhet nga gjithsej 11 institucione, nga të cilat Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, dhe njësitë e saj përbërëse: 3 Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 7 Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF), Qendra kryesore e vaksinimit në QKMF, dhe Njësia e Urgjencës në objekt të veçantë në kuadër të QKMF-së-Deçan. Në kuadër të QKMF-së funksionon edhe Qendra Informuese (SISH).

QKMF - ndodhet në Qytetin e Deçanit dhe në të ofrohen shërbimet specialistike si dhe ato dentare dhe emergjente për tërë popullatën e Komunës së Deçanit. Kjo qendër mbulon me shërbime të patronazhit (mobil) për gjithë qytetaret.

QMF - të ndodhen në: Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq. Në këto qendra ofrojnë shërbime mjekë të specializuar kurse mungojnë shërbimet si: Stomatologjike, Laboratorike dhe kontrollet Gjinekologjike.

AMF - të ndodhen në këto vendbanime: Prapaqan, Lumbardh, Gramaqel, Pobergjë (Polana) dhe tri të tjera nuk janë funksionale, e ato janë: Prilep, Ratish i Ulët dhe Maznik.

1.2.32 Përkujdesja Sociale

Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), në komunën e Deçanit, funksionon Qendra për Punë Sociale, e cila zbaton programin e masave për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Qendra për Punë Sociale (QPS), bën vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e përfituesve të asistencës sociale, dhe atyre që plotësojnë kushtet për strehim të përkohshëm. Në vitin 2017, në Komunën e Deçanit, kanë qenë të përfshira në asistencë sociale 331 familje me 1249 persona, përderisa në vazhdimësi kërkesat për asistencë sociale dhe për banim social janë më të mëdha se mundësitë buxhetore të Komunës. Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimi si shfrytëzues më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe njëkohësisht është komponent e rëndësishme e zhvillimit social - ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor.

1.2.33 Infrastruktura e institucioneve arsimore

Arsimi në Komunën e Deçanit, është i organizuar në nivel të: arsimit parashkollor/para fillor ku paraqet nivelin 01 dhe 02 sipas përshtatjes në përkufizimet e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (SNKA). Nivelin 01: paraqet zhvillimin e hershëm dhe edukimin e fëmijës nga mosha 0 deri 3 vjeç. Arsimi parashkollor-para fillor në këtë nivel përfshihen: çerdhet për fëmijë 1-2 vjeçar, kopshtet (për fëmijë 3-4 vjeçar) dhe klasa e parë për fëmijë 5-6 vjeçar. Në komunën e Deçanit, niveli i arsimit parashkollor zhvillohet në një çerdhe, e cila gjendet në afërsi të Qendrës së Qytetit, kopshti i fëmijëve "Fatosat", me kapacitetit 120 vende, duke i përfshirë grup moshat nga 6 muaj deri në 6 vjeç. Niveli 02: Arsimi para fillor përfshin moshat 3 deri 6 vjeç.

1.2.34 Infrastruktura e institucioneve administrative publike

Ndërtesat e Shërbimeve administrative dhe publike në komunë, janë përqendruar në perimetrin rreth Qendrës së Qytetit të Deçanit. Shpërndarja hapësinore dhe qasja në institucionet publike e nivelit komunal është e mirë në të gjitha ndërtesat.

1.2.35 Kultura

Jeta kulturore në Komunën e Deçanit, është e pasur me një numër të madh të aktiviteteve dhe natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore dhe sportive. Të gjitha këto aktivitete kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në ndërtesa të kulturës. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli të cilën banorët e Komunës së Deçanit, e kanë dëshmuar me evenimentet e ndryshme kulturore dhe tradicionale. Zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë. Në teatrin që mban emrin e aktorit të njohur Teatrit "Skënder Tafa" kanë dalë shumë herë shfaqje e drama, që kanë bërë jehonë të madhe edhe në nivel vendi.

Në Komunën e Deçanit, veprojnë këto grupe artistike: Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve i Deçanit, Shoqëria kulturo-artistike "Jusuf Gërvalla", grupi i rapsodëve "Dervish Shaqa".

Komuna me financim të përbashkët me nivel qendror ka ndarë një vlere të mjeteve financiare në mënyrë që të krijoj kushte për aktivitete rinore ku është duke u ndërtuar Qendra Rinore, Kolonia e Artistëve, Qendra e Trashëgimisë Kulturore dhe Fshati Turistik (Podi i Gështenjave) Deçan, më sipërfaqe prej: 580 m2 P+1K. Në Komunën e Deçanit, manifestimet me të rëndësishme janë festat, evenimentet tradicionale, trashëgimia jo materiale, aktivitetet sportive, festivalet folklorike dhe dekoratat.

1.2.36 Sporti

Sporti është njëri ndër lëmit më të preferuara nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Të rinjtë e Komunës së Deçanit, aktivitetet e tyre sportive i realizojnë në Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit me 4000 m2 dhe 1500, ulëse dhe në fushat e mbuluara sportive. Në shumicën e shkollave të Komunës, kanë hapësira për aktivitete sportive ku në oborret e disave nga shkollat përveç fëmijëve hapësirat sportive shfrytëzohen edhe

nga komuniteti dhe klubet sportive. Ekzistojnë 20 fusha të vogla sportive dhe 5 palestra, dhe gjenden në: SHFMU " Lidhja e Prizrenit" Deçan, SHFMU " Bajram Curri" Strellc i Epërm, SHFMU " Isa Boletini" Isniq, SHFMU " Rexhep Kadrijaj" Rastavicë dhe SHFMU "Sylë Alaj" Drenoc.

1.2.37 Hapësirat publike dhe të gjelbra

Hapësirat publike dhe të gjelbra përdoren për rekreacion aktiv dhe pasiv, ndërkohë që efektet e tyre të shumëfishta (shëndetësore, kulturore etj.) përmirësojnë cilësinë e jetës. Për të qenë në dispozicion të banorëve, hapësirat publike dhe zonat e gjelbra duhet të jenë të integruara mirë dhe të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjitha hapësirat e pjesës urbane dhe rurale.

1.2.38 Ndërtesat e religjionit dhe varrezat

Popullsia e Komunës së Deçanit, sa i përket religjionit është e ndarë në tri besime kryesore: Mysliman, Katolik dhe Ortodoks. Pjesa me e madhe e popullsisë i takon besimit Mysliman, përderisa një numër i vogël i popullsisë i takojnë besimit Katolik dhe Ortodoks, konsiderohet se rreth 96% e popullsisë në komunën e Deçanit, i takojnë besimit Mysliman, 3% i takojnë besimit Katolik dhe 1% besimit Ortodoks. Ndërtesat e kulteve fetare janë të shpërndara në gjithë territorin e Komunës së Deçanit. Numri total i xhamive është 20, Manastiri i Deçanit, si kult fetar ortodoks i mbrojtur nga UNESCO (Trashëgimi Botërore), Kisha Katolike në fshatin Papiq dhe dy Teqe janë në fshatin Korali dhe Baballoq.

1.2.39 Varrezat

Varrezat, janë prezentë në Qytetin e Deçanit dhe në fshatrat e Komunës. Të gjitha varrezat janë të popullatës së besimit: Mysliman, Katolik dhe Ortodoks. Në disa fshatra hasen varreza të shpërndara në më shumë se një hapësirë të ndryshme dhe janë në prona publike, infrastruktura rrugore deri të varrezat ekziston ndërsa sa i përket ndërtesave përcjellëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit në disa vende janë prezentë, por që në shumicën e vendeve mungojnë.

1.2.40 Mjedisi

Mjedisi në Komunën e Deçanit, gjendja është dukshëm e mirë duke përfshirë administrimin e mbeturinave, pastrimin e deponive ilegale, ndërtimin e kanalizimit për ujërat e zeza në pjesën rurale si dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese- shesheve dhe parqeve. Shqetësim mjedisor është: humbja e tokës bujqësore, mungesa e shtrirjes dhe trajtimi i ujerave të zeza-(impiantet).Veprimtaritë të cilat kanë ndikim në komponentët e mjedis janë: dy-gurthyes, dhjetë-përpunimit të drurit (sharra), dy-seperacione, dhe tri-betonjerka.

1.2.41 Ndotja e Ajrit

Ajri është element i rëndësishëm i mjedisit dhe domosdoshmëri për jetën. Ndotja e tij nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo artificiale (burime antropogjenë), përbën shkakun kryesor të përkeqësimit të cilësisë së tij, shkakton sëmundje dhe degradimin e elementeve tjera të mjedisit..

1.2.42 Ndotja e ujërave

Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në Komunën e Deçanit, i ekspozohen ndotjes nga shkarkimet e ndryshme qoftë nga bizneset dhe ekonomitë familjare. Përdorimi i ujit nga bizneset dhe amvisëritë pa u trajtuar shkarkohen në shtratin e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit.

1.2.43 Degradimi i tokës

Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar nga veprimtaritë e ndryshme të cilat kanë ndikuar në degradim, humbje të tokës bujqësore. Ndotja e tokës prish ekuilibrin e lëndëve ushqyese që përmban toka. Lëndët e ngurta artificiale akumulohen në tokë dhe ndryshojnë veçoritë e saj fizike. Mbetjet kimike përzihen me bimët e kultivuara në tokë dhe ndikojnë negativisht në veçoritë biologjike të këtyre bimëve. Në komunën e Deçanit, një prej shqetësimeve për humbjen e fondit të tokës bujqësore janë ndërtimet në tokën bujqësore ku është identifikuar sipërfaqja prej 200.75 ha tokë ndërtimore nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, prandaj çdo veprim që prish veçoritë dhe cilësitë natyrore të kësaj hapësire jetike emërtohet degradim (ndotje e tokës).

1.2.44 Zhurma

Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme në nivel të përgjithshëm. Komuna e Deçanit, nuk ka Plan të Veprimit dhe Hartë për Zonat me Nivel të Zhurmës si dhe aparaturë përkatëse për matjen e nivelit të zhurmës, me të cilat obligohet sipas Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma Nr.02/L-102. Këto dokumente duhet të identifikojnë zonat e zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimin e masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma si dhe përdorimin e materialit akustik gjatë ndërtimit të ndërtesave, po ashtu edhe përgjatë rrugëve të bëhet mbjellja e drurëve-brezi i gjelbër.

1.2.45 Fatkeqësitë natyrore

Në Komunën e Deçanit, fatkeqësitë natyrore përbejnë rrezik për jetën e njeriut, ambientin, ndërtesat e trashëgimisë kulturore gjithashtu rrezik potencial përbejnë edhe këto dukuri: vërshimet, tërmetet, zjarret e pa kontrolluara dhe aksidentet e shkaktuara nga transportimi i mallrave të rrezikshëm (karburantet). Për këtë arsye masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat, Komuna e Deçanit, ka të miratuar dokumentin për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Territorin e Komunës së Deçanit i cili shërben si udhëzues për identifikimin e rrezikshmërisë dhe planifikimin e masave parandaluese.

1.2.46 Tërmetet

Territori i Kosovës, karakterizohet me lëkundje të forta nga tërmetet, vatrat e të cilëve mund të jenë sipas sizmologëve jashtë territorit të Kosovës respektivisht në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi por edhe jashtë këtyre shteteve. Lëkundjet lokale autoktone dhe seizmicitetit që janë aktive në shtetet fqinje dëshmojnë për renditjen e Kosovës, në radhën e territoreve me aktivitet të lartë sizmik. Ky aktivitet mund të diktohet në mënyrë direkt dhe indirekte edhe në territorin e komunës Deçanit.

1.2.47 Vërshimet

Vërshimet janë fatkeqësi elementare që kërkojnë vëmendje të veçantë. Vërshimet janë dukuri që shfaqen në zonat e caktuara që janë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe shkaktojnë dëme materiale. Vërshimet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të menaxhohen. Uji që mblidhet nga reshjet dhe shkrirja e borës mund të gjendet përgjatë rrjedhës se lirë sipërfaqësore, dhe në këtë rast është e rëndësishme që t'i krijohen kushtet për rrjedhje të lirë dhe papengesa-kanalizimi atmosferik, kanalet e ujitjes dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të lumenjve. Komuna e Deçanit, me vite ballafaqohet me problemin e vërshimeve si në vendbanime ashtu edhe në tokën bujqësore.

1.2.48 Thatësira

Thatësira mund të llogaritet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë stinës së verës, zakonisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë të larta dhe reshjet janë të rralla.

1.2.49 Erërat

Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngrohta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët. Erërat ndikojnë në komoditetin e ambientit të njeriut, në temperaturat fiziologjike të njeriut. Shpejtësi me të madhe mesatare e erërave në Komunën e Deçanit, janë ato veriore dhe jug-perëndimore. Të gjitha erërat kanë drejtime dhe shpejtësi mesatare 3-4 m/s. Shpejtësia maksimale është deri 18,9 m/s.

1.2.50 Fatkeqësitë tekniko - teknologjike

Sipas të dhënave zyrtare në Komunën e Deçanit, bizneset individuale në Deçan, janë të ndërtuara 16 pompa të karburanteve dhe 5 pompa me butan gaz. Kapacitet e deponive të këtyre karburanteve nuk kalojnë më tepër së 30 m^3. Bartja-transportimi i karburanteve bëhet përmes magjistrales Pejë-Gjakovë, rrugëve rajonale Llukë-Deçan, si dhe rrugëve tjera të fshatrave. Rreziku është edhe gjatë transportit ku mund të shkaktohet edhe shfaqja e zjarrit dhe shpërthimeve të ndryshme. Sipas shënimeve që posedon Komuna, nuk ka pasur ndonjë rast të shpërthimit të auto-cisternave apo ndezjes se tyre. Në komunën e Deçanit, janë të identifikuara dy vende për grumbullim të hekurishteve dhe automjeteve të vjetra.

1.2.51 Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Në Komunën e Deçanit, vazhdimisht ka pasur raste të shpërthimeve të zjarrit në pjesët e bjeshkëve, zonave të pyllëzuara si dhe në disa raste edhe disa ndërtesa individuale dhe zjarre fushore. Dëmet materiale nuk janë të vogla por nëse përfshihen edhe zjarret në pyje përfshinë një kosto shumë të madhe. Zjarret që janë paraqitur në male/bjeshkë dhe fusha dyshohet që janë shkaktuar nga pakujdesia e faktorit njeri.

1.2.52 Erozioni

Erozioni është një faktor shumë i rëndësishëm për trajtim sepse kërcënon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën si dhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është e pranishme në pjesën malore/bjeshkë në forma dhe intensitete të ndryshme. Në shfaqjen e kësaj dukurie në shumicën e rasteve ka ndikuar faktori njeri, si rezultat i shfrytëzimit joracional të tokës bujqësorë, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, por edhe për shkak të shfrytëzimit të pakontrolluar të aluvioneve përgjatë lumenjve. Më së shumti është shfaqur si pasojë e degradimit të pyjeve, pjerrtësisë së terrenit, e cila ka ardhë si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes përgjatë brigjeve dhe shtretërve të lumenjve, mungesës së pendëve mbrojtëse dhe dëmtimit të masës mbrojtëse vegjetacionit.

1.2.53 Rrëshqitja e tokës, ngricat, stuhitë dhe ortekët e borës

Në komunën e Deçanit, nuk ka të dhëna për rrëshqitje të tokës të cilat duhet cekur me theks të posaçëm se pjesa malore/bjeshkëve. Ndërsa sa i përket ngricave, stuhive dhe ortekëve te borës ku mund të pëson popullata apo te shkaktohen dëme materiale atakohen zonat malore/bjeshkët. Në pjesën malore/bjeshkë rreziku nga rrëshqitja e tokës, stuhitë dhe ortekët e borës, këto hapësira popullata i shfrytëzon me tepër gjatë sezonit veror, prandaj deri sa nuk kemi banim të përhershëm në ato zona, rreziku është shumë i vogël.

1.2.54 Asetet e trashëgimisë kulturore

Në Komunën e Deçanit, trashëgimia materiale është krijuar në mes të qytetërimeve antike, e cila trashëgon një thesar të pasur kulturor dhe është pjesë e trashëgimisë kulturore e identifikuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme-Arkeologjike me nënkategoritë përkatëse. Kjo trashëgimi e pasur, gjendet në çdo pjesë të Komunës së Deçani, duke u identifikuar me burime arkeologjike-fshati Belle, arke tonikë-kullat, në monumente fetare, monumente natyrore dhe Lista e Kuqe e florës dhe faunës. Trashëgimi kulturore, konsiderohen të gjitha ndërtesat të cilat në një formë apo një tjetër përcjellin pasqyrën e zhvillimit dhe ndërtimit nga kohëra të ndryshme e deri në ditët e sotme. Këto vlera të trashëgimisë kulturore, që posedon Komuna e Deçanit, është një ndër elementet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit bazuar në "Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027" trashëgimia definohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Tabela në vijim përfshin numrin e ndërtesave të trashëgimisë kulturore sipas kategorive (nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme) nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

1.2.55 Resurset natyrore dhe biodiversitetit

Pozita gjeografike, faktori gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima kanë ndikuar, që ky territor të ketë një diversitet të pasur biologjik me bimë barishtore shumëvjeçare (hemikriptofita), rreth 70 % dhe bimë drunore dhe shkurret fanerofita rreth 7 %. Biodiversitetit përfshinë shumëllojshmërinë brenda dhe midis llojeve, si dhe shumëllojshmërinë ekosistemeve. Sipas hulumtimeve të bëra janë përshkruar 795 lloje të bimëve të ndryshme, endemike subendemike, që u përkasin elementeve endemike të ndryshme, gjithashtu edhe një numër i madh i llojeve relikte. Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me lloje të shumta të bimëve mjekuese (boronica, linsuri, kamomili dhe çajreve të tjera natyrore etj.).

1.2.56 Flora

Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare florën në Komunën e Deçanit, e përbejnë: algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor, që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në Komunën e Deçanit, bimët

vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegjetacion i cili ka ndikim direkt në klimën, ajrin, ujin dhe tokën.

1.2.57 Fauna

Llojet më të rëndësishme të faunës të cilat gjenden në Librin e Kuq e ku kanë habitat edhe në territorin e Komunës së Deçanit, janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), shqarthi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: fëllëza e gurëve (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër (*Columba oenas*), korbi (*Corvus corax*), qyqja (*Cuculus canorus*), qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj.

1.2.58 Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna

Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" paraqet një regjion gjeografik me bukuri të rrallë, me pasuri të madhe të elementeve të peizazhit si: bjeshkë të larta të zhveshura me dëborë në maja, pyje mbresëlënës me lloje të ndryshme ku me bukuri dominojnë pishat e larta, lugina magjepsëse e gryka të thella mahnitëse, kullosa e livadhe me lule të gjitha ngjyrave, burime e rrjedha të shumta ujore që formojnë përroska e lumenj, shpella të bukura dhe liqene përrallore në bjeshkët e larta.

1.2.59 Zhvillimi i turizmit ndërkufitar shtigjet-Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike

Një fushë, që duhet kushtuar rendësi, është edhe bashkëpunimi ndërkufitar në aspektin ekonomik i cili konsiston në turizmin malor, ecjen nëpër shtigjet malore që lidhin Kosovë, Shqipëri dhe Malin e Zi. Në Bjeshkët e Deçanit, kalojnë shtegu Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike.

Shtegu turistik "Majat e Maleve Ballkanike" është i gjatë 197 km, që krijon një rreth të mbyllur në të tri shtetet, Shqipëri (Theth), Mali i Zi (Plavë) dhe Kosovë (Bjeshkët e Deçanit). Vizita mund të filloj nga cilido shtet. Këto shtigje mund të kalohen për 10-13 ditë. Përveç aktiviteteve si ecje nëpër male (hiking), çiklizmit, skijimi, lundrimi me kajak, rafting etj. ku turistet mund të përjetojnë edhe jetesën tradicionale si dhe të shijojnë kuzhinën e Bjeshkëve të Deçanit, po ashtu duhet krijuar mundësi për ndërtimin e kapaciteteve për infrastrukturë turistike.

1.2.60 Turizmi

Në Komunën e Deçanit, turizmi është një perspektivë kryesore, që paraqet një shtyllë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik lokal. Komuna e Deçanit, shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore dhe trashëgimisë kulturore. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peizazhet, grykat, flora dhe fauna janë vlera dhe potencial për zhvillimin ekonomik lokal me theks të veçantë turizmin. Deçani ka mundësi të mira për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit:

- Turizmi malorë,
- Turizmi rekreativ-sportiv,
- Turizmi verorë dhe dimëror,
- Speleoturizmi (shpellave),
- Turizmi rural,
- Turizmi edukativ arsimor,
- Turizmi kurativ (shëndetësore).

1.2.61 Prioritetet për zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit

Komuna e Deçanit, ka dëshmuar përkushtimin e saj për zhvillimin e turizmit dhe ka ndërmarrë hapa të domosdoshëm për infrastrukturën turistike, e cila përshin dimensione sociale, kulturore dhe mjedisore përtej zhvillimit fizik dhe marketingut, turizmi për Komunën e Deçanit, posedon potencial të theksuar për të ndikuar në rritjen e qëndrueshme për t'u pozicionuar si vend turistik, strategjik për t'i përmbushur pritjet gjithnjë në rritje për një treg të qëndrueshëm të turizmit, me orientim nga natyra dhe kultura. Kjo pjesë karakterizohet me produkte unike, atraktive dhe shëndetësore me potencial rekreativë për ekonominë lokale ku mund të zhvillohet me sukses turizmi duke u bazuar në kushte të favorshme natyrore-klimatike.

1.2.62 Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë

Territori i Komunës së Deçanit, shtrihet në një sipërfaqe prej: 293,948,468.50 m^2, më 37 fshatra (zona kadastrale), sipas regjistrimit të fundit janë 5,887 ekonomi familjare dhe 40,019 banor rezident. Komuna e Deçanit, gjendet në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, regjionin e Dukagjinit, me një lartësi prej 473 m pika me e ulët lartësi mbi detare në fshatin Maznik dhe 2565 m, lartësi Maja e Gjeravicës në Bjeshkët e Nemuna. Kufizohet me bjeshkët e Plavës dhe Gucisë në veri, në jug më fushën e Gjakovës, në perëndim me luginën e rrjedhës së epërme të Erenikut dhe në lindje më fushën e Pejës. Territori i Komunës së Deçanit, shtrihet përgjatë rrugës (longitudinale) Gjakovë-Pejë, në vijim të relacionit që lidhë bazën e Egjeut me atë të Adriatikut. Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë nga se përmes kësaj metodologjie shihen qartë karakteristikat e sistemit popullatës se hapësirës së caktuar si dhe mënyra e organizimit të jetës në vendbanimet e kësaj hapësire. Njëherë, vendbanimi më i madh nënkupton organizimin më të lehtë të jetës, nga se investimet në të janë më të arsyeshme dhe rentabile. Kurse vendbanimi më i vogël zakonisht është më vështirë të pajiset me infrastrukturë elementare, që është aq e nevojshme për jetën e banorëve të atij vendbanimi.

1.2.63 Administrimi territorial

Deçani si qendër kryesore, i organizuar në: zonë urbane dhe zonë rurale. Nga aspekti i shërbimeve administrative të territorit të komunës parashihet kjo formë organizative:

- Deçani, qendër administrative komunale-Qendër kryesore administrative dhe politike për gjithë Komunën do të jetë vet Qyteti i Deçanit. Në këtë qendër urbane do të funksionoi administrata komunale, strukturat udhëheqëse dhe politike, shërbimet kryesore komunale etj.
- Themelimi i tri zyrave të vendit në: Strellc i Epërm , Drenoc (Polana), ofrojnë shërbimet për qytetarë ndërsa Zyra e Gjendjes Civile në fshatin Irzniq, nuk është në funksion kurse shërbimet për këtë rajon ofrohen në objektin e Komunës së Deçanit.

1.2.64 Zona urbane

Për nga funksionaliteti, Qyteti i Deçanit, është urë lidhëse për të gjitha vendbanimet. Për me tepër, Qyteti i Deçanit, shërben si qendër administrative, arsimore dhe kulturore e Komunës duke akomoduar shumicën nga institucionet administrative si: Komuna, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF, Posta, Policia, Stacioni i Autobusëve (jo funksional-kontest pronësor), si dhe institucionet arsimore dhe kulturore.

1.2.65 Zona rurale

Vendbanimet rurale janë gjithsej 37-të dhe janë të shpërndara për rreth vendbanimit kryesor - Qytetit të Deçanit, dhe të gjitha karakterizohen me infrastrukturë bazike, si rrugë lidhëse, infrastrukturë shoqërore dhe teknike.

1.2.66 Vendbanimet sipas llojit dhe lartësisë mbidetare

Nga aspekti i tipologjisë, Komuna e Deçanit, ka gjithsej 1 vendbanim të tipit të dendur (Qyteti i Deçanit) të ndarë në lagje urbane, 3 vendbanime të tipit të shpërndarë (Isniq, Strellc i Ultë dhe Strellc i Epërm); dhe kryesisht mbesin vendbanime të tipit të grumbulluar vendbanimet si: Carrabreg Ultë, Carrabreg i Epërm, Drenoc, Dubovik, Gramaqel, Baballoq Irzniq, Lëbushë, Llukë e Epërme, Prilep, Rastavicë, Beleg, Gllogjan, Kodrali, Lumbardh, Llukë e Ultë, Prapaqan, Ratish i Ulët, Shaptej, Dashinoc, Dubravë, Lloqan, Maznik, Pozhar, Prokolluk, Ratish i Epërm, Papiq, Vranoc i Vogël , karakterizohen me shtrirje të rrafshet ndërsa Voksh, Sllup, Hulaj dhe Pobergjë kanë shtrije në rrafsh-kodër si dhe Belle, Pleqe kanë shtrirje malore.

1.2.67 Vendbanimet Joformale

Komuna e Deçanit, ka identifikuar 5 vendbanime joformale në Planin Zhvillimor Komunal PZHK. Të gjitha vendbanimet joformale të identifikuara, gjenden në zonat rurale, përkatësisht janë: Bohriqe, Papiq Lagjja e Dëshmorëve, Ledina dhe Jasiq i Ri, këto vende janë kryesisht në pjesët periferike të fshatrave siç janë: Strellc i Ulët, Papiq, Baballoq, Carrabreg i Ulët dhe Jasiq i Ri.

1.2.68 Pronësia e fondit të banimit

Më shumë se 90% e banesave janë private, ndërsa ndërtesa me banim social është 1 objekt. Sa i përket ndërtesave të banimit në bashkëpronësi, një pjesë e tyre janë të ndërtuara në vitet e mëhershme dhe disa pas luftës që janë me koncesion në mes të kompanive ndërtimore dhe komunës.

1.2.69 Ndërtesat ilegale të banimit

Ka mjaft shtëpi të cilat janë ndërtuar pa leje në tokë të parceluar të klasit 1-4 pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit të cilat i nënshtrohen Ligjit Nr. 06/L-024 Për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Bazuar në regjistrin e ndërtimeve pa leje në Komunën e Deçanit, ku në të gjitha vendbanimet e Komunës se Deçanit janë: 6137 ndërtime pa leje në zonën e I a; 5742 ndërtime pa leje në zonën e I b; dhe 8 ndërtime pa leje në zonën e II ku në total janë: 11,887

1.2.70 Buxheti komunal

Buxheti i Komunës së Deçanit, përbëhet nga të hyrat vetanake dhe grantet qeveritare. Në bazë të analizës së Buxhetit të Komunës për periudhën 5 vjeçare 2016-2022, vërehet një rritje e vazhdueshme e buxhetit ku prej vitit 2016/2017 - 12% dhe vitet tjera mesatarisht 5 % në vit dhe rritje të përgjithshme afërsisht 20% (Ministria e Financave të Kosovës).

1.2.71 Korniza e zhvillimit hapësinore

Slogani: *Deçani mjedis me kualitet të lartë jetese*

Deklarata e Vizionit: *Vend i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Qytet me potencial të pashtershëm për turizëm, portë lidhëse me dy shtetet fqinje Shqipërinë dhe Malin e Zi. Një ndër komunat me sipërfaqen më të gjerë pyjore, vend i begatuar me rrjedhat ujore dhe kanionet atraktive. Hapësirë me kushtet e favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, mjedis i qëndrueshëm për agro-industri dhe biznes-me synimin që të avancohet në mjedis ekologjik me bioproduktet - brende të kësaj komune .*

1.2.72 Qëllimet

Qëllimi 1 - Inventarizimi dhe masat mbrojtëse të hapësirave me vlerat e trashëgimisë
Objektivat:
Qëllimi 2 - Ruajtja e trashëgimisë materiale të paluajtshme kulturore
Objektivat:
Qëllimi 3 - Krijimi i një ambienti të pastër pa ndotje dhe siguri ndaj rreziqeve natyror
Objektivat:
Qëllimi 4 - Zhvillimi i zonave me potenciale turistike
Qëllimi 5 - Nxitja e zhvillimit të bujqësisë
Qëllimi 6 - Nxitja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)
Qëllimi 7 - Zhvillimi i resurseve njerëzore
Qëllimi 8 - Nxitja dhe favorizimi i veprimtarive shërbyese
Qëllimi 9 - Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm
Qëllimi 10 - Rritja e kapacitetit dhe shtrirja e rrjetit të infrastrukturës
Qëllimi 12 – Arsimi cilësor në të gjitha nivelet
Qëllimi 13 - Ofrimin i shërbimeve shëndetësore në çdo kohë
Qëllimi 14 - Shërbime administrative efikase
Qëllimi 15 - Kujdesi i shtuar për memorialët dhe varrezat në Komunën e Deçanit
Qëllimi 16 - Rritja e kapaciteteve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes
Qëllimi 17 - Zhvillimi kompakt i vendbanimeve, shfrytëzimi racional i tokës
Qëllimi 18 - Plotësimi i kapaciteteve për institucione publike

1.2.73 Elementët e konceptit hapësinor

Siç u vërejt ma lartë, koncepti përfundimtar i zhvillimit hapësinor është i bazuar në një sistem të elementëve të ndërlidhura dhe të integruara hapësinore i cili koncept arrihet përmes përfshirjes së hisedarëve

të ndryshëm për planifikim të qëndrueshëm, i cili shërben si platformë bazike për kushtet zhvillimore për revidimin e PZHK-së dhe hartimin e Hartës Zonale Komunale të Komunës së Deçanit.

Në të gjithë skenarët e me theks të veçantë në skenarin e baraspeshuar, janë krijuar nyjat ku do të zhvillohen aktivitetet siç janë banimi, puna, edukimi dhe rekreacioni. Nyjat lidhen me korridoret respektivisht infrastruktura rrugore të cilat mund të kenë intensitet të lartë të zhvillimit tek nyjat.

Rendësi iu është jep dendësimi mirëpo edhe plotësimit të cilat i dendësojnë dhe i mbushin hapësirat si mënyrë për të arritur integrimin hapësinorë. Dendësia është bërë me synim të ofrimit të mundësive për ndërtim, kontrollimin e zgjerimit të qytetit kundrejt tokave bujqësore, kontrollimin e migrimit lokal, zhvillimin ekonomik, zbatimin e konceptit të qytetit kompakt dhe uljen e shpenzimeve në investimet kapitale ne infrastrukturë teknike, trafikut dhe sociale dhe orientimi i buxhetit në prioritete tjera strategjike.

Mbrojtja është planifikuar ne drejtimin perëndimore gjegjësisht ne Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" si dhe në mbrojtjen e tokës bujqësore me synim të rritjes së kontrolluar të vendbanimeve rurale drejt tokave kualitative bujqësore. Mbrojtja tjetër është aplikuar edhe në hapësirat përgjatë lumenjve duke i respektuat distancat e caktuara për ndërtim (në zonën urbane dhe disa rurale) ndërsa në pjesën rurale mbrojtja nga erozioni dhe eksploatimet. Koncepti i mbrojtjes është aplikuar edhe te ndërtesat me vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me synim të promovimit dhe zhvillimit ne të ardhmen në kontekstin e turizmit. Ne zonën urbane është zbatuar mbajtja dhe vënia nën kontroll te ndërtimit me synim të aplikimit të kufijve urbanë fizik ndërsa janë caktuar edhe masat mbrojtëse të resurseve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

Krahas mbrojtjes, janë caktuar drejtimet e zhvillimit të zonave respektivisht të rritjes së zonës me synim të rritjes së intensitetit të zonave ekzistuese dhe plotësimin e zonave ku është e përshtatshme zhvillimit. Duke synuar që të zhvillohet koncepti i qytetit kompakt dhe jo i zgjeruar, janë propozuar drejtimet e zhvillimit të sektorit të:

- Ndërtimit – duke i caktuar zonat ne të cilat mund të ndërtohet me etazhitete të ndryshme duke filluar nga etazhiteti individual deri të ai shumë banesor – kolektiv. Në sektorin e ndërtimit është ofruar mundësia e cila për shumë vite e ndihmon Komunën e Deçanit mirëpo edhe investitorët që ti orientojnë investimet e veta duke i plotësuar nevojat e banimit, kërkesat e banimit në të ardhmen dhe kontrolluar migrimin.
- Ekonomik – duke i caktuar zonat me mundësi të zhvillimit të bizneseve të llojeve të ndryshme duke mos i cenuar zonat me resurse natyrore. Zhvillimi i ekonomik i përfshinë NVM, bujqësinë, blegtorinë dhe turizmin me shërbimet tjera.
- Turizmi – duke e kombinuar pjesën malore, kodrinore dhe atë rurale. Zona urbane do të shërben si por hyrëse në fushën e turizmit duke ofruar shërbimet e nevojshme të informimit, akomodimit dhe shërbimeve tjera rekreative. Në pjesën malore gjegjësisht në parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" çdo zhvillim turistik do të behët në harmoni me Planin Hapësinorë Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"
- Bujqësia – duke e përfshirë sa ma shumë zonën rurale cila ka potencial të tokës kualitative dhe të përshtatshëm për bujqësi. Zhvillimi i bujqësisë është një nga shtyllat kryesore të Komunës Deçanit për zhvillimin e ardhshëm. Në pjesën perëndimore zhvillimi bujqësisë do të jetë në harmoni të plotë me Planin Hapësinore Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".
- Blegtoria – duke ofruar mundësitë e zhvillimit të sektorit blegtoral i cili në vitet e fundit ka trend pozitiv dhe kthimi në traditat e zhvillimit të sektorit blegtoral.
- Shërbimet – janë cak i Komunës Deçanit e cila do ti ndihmon në të ardhmen banorët e vet, vizitorët dhe investitorët potencial. Për ketë është më se e nevojshme ndërtimi i infrastrukturës gjegjësisht me ndërtimin e ndërtesës së re moderne të Komunës Deçanit, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, ofrimin e shërbimeve të mira në menaxhimin e mbeturinave, furnizimi i qëndrueshëm me ujësjellës, ujitje dhe energji si dhe shpërndarja e rrjetit të internetit.

Skenari përfundimtarë është rezultat i lidhjes së strukturës se gjelbër (mjedisit), strukturës së kaltër (lumenjve), me zonën e ndërtuar (zonën urbane dhe fshatrat) dhe strukturat tjera fizike (infrastruktura e trafikut dhe ajo teknike) të cilat së bashku përbëjnë kornizën e dëshiruar të zhvillimit hapësinor të komunës. Lidhja funksionale e elementëve të këtij sistemi, bazohet në intensitetin e lëvizjes dhe bashkëveprimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, duke krijuar kështu një hierarki nyjash (qendra të aktiviteteve) dhe rrjetesh (korridoret / lidhjet ndërmjet nyjave) të niveleve të ndryshme. Elementët hapësinore trajtohen në bazë të një qasje të shtresëzimit, ku elementë të ndryshëm ndërtohen mbi njëri-tjetrin bazuar në marrëdhëniet reciproke ndërmjet tyre si:

- Korridoret që përshkruajnë Deçanin (R107 dhe R108) si dhe mundësi e ndërtimit të auto udhës së Dukagjinit. Këto korridore pastaj degëzohen në rrugë lokale duke ofruar qasje të lehtë në të gjitha vendbanimet. Lidhja këtyre korridoreve me shtete fqinje duke i fuqizuar sektorët zhvillimore por edhe duke ruajtur traditat dhe zakonet me shtetet fqinje.
- Bjeshkët e Nemuna, pasuri e kësaj komune e cila është e trajtuar me ligj dhe ofron zhvillim në mënyrë të kontrolluar.
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore si veçanti dhe pasuri e kësaj komune do ketë ndikim në zhvillimin ne të ardhmen ne veçanti ne sektorin e turizmit.
- Zona e pasur për bujqësi dhe blegtori.
- Qendra urbane - Qyteti i Deçanit si porta kryesore e menaxhimit të zhvillimit të qëndrueshëm në shumë sektor
- Atraksionet dhe rekreacionet.
- Rregullimi i lumenjve dhe akumulimi.
- Mbrojtja dhe zhvillimi.

1.2.74 Tërësitë hapësinore funksionale

Tërësia hapësinore e Komunës së Deçanit është e ndarë ne tre zona të cilat kanë karakteristika të ndryshme zhvillimore, e ato janë:

- Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët": zona e Bjeshkëve të Nemuna brenda territorit të Deçanit, hapësirë në anën perëndimore të Komunës, pjesë e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".
- Tërësia "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore": është zonë kodrinore malore dhe me pjesën urbane - Qyteti i Deçanit, i vendosur në mes të tërësisë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" dhe tërësisë "bujqësia", me pozitë qendrore në komunë. Në ketë tërësi ndodhet edhe Zona e Veçantë e Mbrojtur rreth Manastirit të Deçanit.
- Tërësia "Bujqësia": zona bujqësore, rrafshi aluvial i Lumëbardhit të Deçanit dhe atij të Lloqanit, pellgjet në të dy anët përreth tyre dhe rrafshet pjellore të gërshetuara në tërë zonën rurale

Komuna e Deçanit është ndër të paktat Komuna të cilat brenda territorit të sajë e kanë të mbrojtura dy zona respektivisht zonën e Parkut Kombëtarë për "Bjeshkët e Nemuna" e cila kontrollon 54.41%të territorit Komunal dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur rreth Manastirit të Deçanit e cila e kontrollon 2.69 % të territorit Komunal të Komunës Deçanit.

1.2.75 Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët"

Kjo tërësi trajtohet në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", gjegjësisht i përfshinë të gjitha projeksionet mbrojtëse, zhvillimore, qëllimet, objektivat dhe aktivitete dedikuar Komunës së Deçanit.

1.2.76 Tërësia "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore"

Hapësirat kodrinore malore-pellgjet e dy lumenjve, është kryesisht zonë e zhvillimit që karakterizohet me kusht të volitshme për ndërtim dhe zhvillim. Menaxhohet nga autoritetet e nivelit qendror dhe atij lokal. Tërësia e dytë ndahet në këto nën zona:

Zona e vendbanimeve - dy zona vendbanimesh: Pleqe dhe Belle, fshati Shkëlzen Haradinaj, zhvillim i kontrolluar në bashkëpunim me të gjithë akteret relevant.
Zona e zhvillimit - hapësira jashtë zonës urbane, turizmi sporti, rekreacioni.
Zona e pyjeve privatë (zhvillim i kontrolluar) - Në këtë zonë janë caktuar hapësira me interes zhvillimi por gjithnjë duke respektuar ruajtjen e mjedisit. Të gjitha ndërtimet janë listuar në zona ku do të rregullohen sipas planeve rregulluese të hollësishme, duke respektuar kriteret dhe normat për investimet në hapësirat e Parkut Kombëtar.
Zona e Veçantë e Mbrojtur - Kjo zonë përfshinë hapësirën rreth Manastirit të Deçanit, e cila mbulon një sipërfaqe prej: 790.7 ha. Në këtë zonë sipërfaqe e konsiderueshme është në pronësi shtetërore, pastaj pjesa tjetër ju takon pronarëve privat. Kjo zonë ka një peizazh mahnitës dhe është pjesa hyrëse për Bjeshkët e Deçanit. Sipas Ligjit Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, dispozitat e këtij ligji e pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Për ligjin në fjalë nuk është bërë një hulumtim dhe studim paraprak për vlerat dhe potencialin qe posedon kjo zonë.
Zona urbane - Tërësinë urbane në të cilat ekzistojnë zona rurale toka bujqësore të cilat i përfshijnë hapësirat e fshatrave dhe është e shpërndarë në të gjithë hapësirën fushore dhe kodrinore me sipërfaqe 11,836.8 ha. Tërësinë urbane respektivisht zona e qytetit të Deçanit dhe shtrihet në sipërfaqe prej 729.75 ha.

Në kuadër të zonës së qytetit, ekzistojnë tre zona të cilat janë të ndara në 5 njësi te reja.

1.2.77 Tërësia e tretë: Zona rurale e Komunës Deçanit

Kjo zonë e përfshinë të gjithë territorin lindor të rrafshët të Komunës së Deçanit. E njohur si zonë kualitative bujqësore, këto planifikohet të zhvillohet bujqësia dhe blegtoria. Në ketë zonë kalojnë edhe dy lumenjtë respektivisht lumi i Lumëbardhit të Deçanit dhe ai i Lloqanit. Rrafshinat përreth këtyre lumenjve (aluvial) janë pellgje mjaft kualitative dhe pjellore andaj kjo zonë i ka të gjitha predispozitat që të zhvillohet bujqësia në mënyrë intensive. Përndryshe, pas tërësisë së parë respektivisht Grykës së Deçanit, zona rurale e Komunës Deçanit e zënë 40.26% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Komunës.

1.2.78 Zhvillimi ekonomik

Komuna e Deçanit, ka një bazë mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Në këtë Komunë ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomik, filluar nga veprimtaritë primare ekonomike, ato sekondare dhe shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Gjithashtu, kjo Komunë ka bazë të mirë edhe për veprimtari të lehta industriale, kurse bukuritë natyrore dhe trashëgimia materiale dhe jo-materiale ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit. Komuna e Deçanit, do të ofroj shërbime edhe më efikase duke ngritur kapacitetet human në fushën e turizmit. Tërë planifikimi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Komunës, do të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore dhe kulturore dhe në avancimin e resurseve humane. Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave që vijnë për t'i shfrytëzuar ato resurse. Hapësira e Komunës së Deçanit, ka dallime të theksuara sa i përket strukturave ekonomike, sociale dhe natyrore. Bazuar në këto dallime, edhe propozimi i zhvillimit ekonomik do të këtë një diversitet të pasur, që ofron kjo Komunë janë: zonat rurale për zhvillimin e turizmit, zonat historike, zonat arkeologjike, zona e Bjeshkëve të Deçanit, dhe trashëgimia jo-materiale, evenimentet tradicionale.

1.2.79 Zhvillimi i turizmit

Zonat me potencial turistik përveç pjesës se rrafshët në zonën urbane dhe rurale, potenciali me vlera zhvillimore është përqendruar në pjesën e Bjeshkëve të Deçanit. Komuna e Deçanit, kryesisht është e pasur me pyje dhe kullosa dhe fondin e tokës bujqësore, sipas Ministrisë së Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, toka bujqësore kategorizohet në 11 njësi bujqësore të parcelave. Peizazhet natyrore në gjithë territorin janë mjaft atraktive për rekreacion dhe turizëm. Mund të thuhet se pyjet, kullosat, uji, liqenet, mineralet, peizazhet janë resurset natyrore më të rëndësishme të zonës së Bjeshkëve të Deçanit. Për të zhvilluar turizmin në mënyrë të qëndrueshme, duhet pasur parasysh parimet kryesore të zhvillimit siç janë: shfrytëzimi i resurseve për nevoja momentale dhe ruajtja e tyre për nevojat e gjeneratave të ardhshme. *Turizmi do të*

trajtohet në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", gjegjësisht i përfshinë të gjitha projeksionet mbrojtëse, zhvillimore, qëllimet, objektivat dhe aktivitete dedikuar Komunës së Deçanit. Komuna e Deçanit, krahasuar me potencialet që i ka ende nuk ka arrit të krijon ofertën e saj të kompletuar për turizëm. Nevojitet mjaft kohë dhe angazhim që kjo oferte të zhvillohet andaj, duhet me doemos të rritet numri i akomodimeve dhe të zhvillohet infrastruktura turistike në përgjithësi. Për këtë është me se e nevojshme të hartohen politikat afat mesme për zhvillim siç janë:

- Ngritja e kapaciteteve humane në fushën e turizmit.
- Ndërtimi i shtëpisë së Shoqatës së Bjeshkatarëve "Shkëlzen Haradinaj" (vazhdim i projektit).
- - ndërtimi i Mullirit Tradicional në parkun Kombëtarë duke u bazuar ne Planin Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".
- Krijimi dhe ndërtimi i fshatit turistik "Laku i kryqes".
- Ndërtimi i rezidencës turistike Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.
- Ndërtimi i Qendrës së grumbullimit, përpunimit të frutave dhe bimëve mjekuese me kompleks gastronomik.
- Ndërtimi i tri pendave akumuluese të ujti ne Grykën e Lloqanit.
- Ndërtimi i qendrës për rruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e produkteve të gështenjës afër fshatin Strellc i Epërm (ne brezin e gështenjës që shtrihet ne kuadër të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".

1.2.80 Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë

Për zhvillimin e bujqësisë duhet të rishikohet - plotësohet strategjia dhe plani për zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Deçanit, duhet të planifikoj politika lehtësuese, për subvencionimin e këtij sektori. Në ketë aspekt Komuna e Deçanit, duhet të ndërmarrë këto objektiva për zhvillimin e bujqësisë duke ndihmuar bujqit në: grupimi i parcelave bujqësore, aplikimi i masave agroteknike, ngritja e kapaciteteve të magazinimit dhe përpunimit të produkteve, ngritja e fermave dhe serave (përpunim qumështi, mishi dhe perimeve të freskëta) të favorizoj me investime rritjen e sipërfaqeve me pemëtari, bletari, kultivimin e bimëve mjekuese dhe rritjen e fondit të gjedheve dhe shpezëve, gjithashtu të mbështetet edhe ngritja e qendrës se grumbullimit dhe përpunimit të frutave malore, frigoriferëve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, organizmin e fermerëve në organizata bujqësore të prodhimeve bujqësore. Objektivi për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, nënkupton menaxhim të resurseve natyrore dhe siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore, sipërfaqet e pyjeve, rritjen e kapaciteteve të rendimenteve, duke siguruar që rrjeti ekzistues i kanaleve të ujitjes të betonohet dhe zgjerohet me aplikim e sistemit të avancuar të ujitjes. Kullosat dhe livadhet janë potencial ku duhet të mbështetet zhvillimi i blegtorisë, lavërtarisë, pemëtarisë, perimtarisë dhe agro industrisë. Gjithashtu për të siguruar ujitjen në mënyrë të qëndrueshme është e nevojshme që të ndërtohen tre akumulues.

Zhvillimi i bujqësisë intensive do të jetë në pjesën lindore gjegjësisht në tërësinë e tretë "Zona rurale e Komunës Deçanit". Në ketë pjesë do të zhvillohet lavërtaria, perimtaria, pemëtaria dhe gjedhtaria. Duke e marr parasysh sipërfaqen e madhe të tokës kualitative në ketë tërësi, është e nevojshme që të shtrihet rrjeti i ujitjes, të trajnohen sa ma shumë pronarët e tokave për aplikim në projektet apo grante te ndryshme bujqësore, mbështetja në ngritjen e fermave të reja, shpërndarja e fidanëve të ndryshme të pemëtarisë dhe brendimi i produkteve të Komunës Deçanit. Në përgjithësi ne ketë tërësi do të ketë prodhime parësore gjegjësisht bujqësi duke përfshirë prodhime bujqësore komerciale, infrastrukturë bujqësore dhe prodhim bujqësor për konsum vetjak.

Bujqësia mund të zhvillohet edhe në hapësirat fushore dhe kodrinore të tërësisë "Zona Urbane dhe Trashëgimia kulturore". Në ketë pjesë mund të zhvillohet sektori pemëtarisë, gjedhtaria, bletaria dhe kultivimi i llojeve te ndryshme te florës, bimëve shëruese etj. Duke i marr parasysh se në ketë tërësi ka ende familje të cilët i kultivojnë rendimentet e ndryshe bujqësore, andaj rekomandohet që të ngiten fermat e reja të vogla, përpunimi i qumështi dhe nënprodukteve tjera të qumështit, mishit, fruta farore, fruta të imta dhe bimë mjekuese.. Në ketë tërësi, mbështetet edhe mbrojta dhe zhvillimi i gështenjës andaj, është e rëndësishme që

kjo kulturë të mbrohet dhe të zhvillohet me tutje deri në brendimin e tij. Për shkak të pozitës së favorshme në mes të dy tërësive, propozohet që në ketë pjesë të ndërtohen edhe qendra me frigorifer të ndryshëm të cilët do e ndihmojnë ruajtjen e rendimenteve të ndryshme e me theks të veçantë të frutave të imta. Sa i përket florës, rekomandohet që të kultivohen lulet të cilat e ndihmojnë bletarinë, siç janë: lavandula, luledielli, lulet e egra, marigoldët etj. Në ketë pjesë do të zhvillohet prodhimi parësor e cila përfshinë prodhim bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore dhe për prodhim bujqësor për konsum vetjak.

Në pjesën perëndimore gjegjësisht në tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" do të zhvillohet sektori i bujqësisë në harmoni me Planin Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".

Bletaria - Komuna e Deçanit, ka mjaft sipërfaqe tokësore në të cilën rritën dhe zhvillohen një numër i konsiderueshëm i bimëve nektaruese (nektarmbajtëse), që janë burim kryesor i ushqimit të bletëve. Bimët nektaruese që shfrytëzohen për kullotjen e bletës sipas shtrirjes së tyre ndahen si: bimë natyrore dhe bimët e ndryshme bujqësore të kultivuara.
Gjithashtu vlen të përmendet ndikimi i faktorit njeri, i cili më punën e tij në ngritjen dhe rregullimin e kopshteve dhe kultivimin kulturave të tjera bujqësore ndikojnë shumë në përmirësimin e kullosave për bletët. Natyra e Komunës së Deçanit, ofron kushte mjaft të mira për të nxjerrë sa më herët bletët në kullosë para fillimit të pranverës gjejnë kullosa të bollshme në natyrë si: Bagren (Akacia-Robinia pseudacacia L.), Blirit (Tilia sp.L), Gështenjës (castane sativa) etj.
Përpos bimëve drunore të cilat gjenden të përhapura në vendin tonë, kemi edhe shumë lloje të bimëve barishtore. Këto bimë barishtore janë të përhapura nëpër livadhet e ultësirave, livadhet kodrinore, livadhet malore dhe kullosat. Në të gjitha këto livadhe rritën shumë bimë që janë të njohura për prodhimin e nektarit dhe të pjalmit (polenit) me cilësi shumë të mirë e këtu vlen të përmenden:
Zymbyli i livadheve (C. Caerylea), që lulëzon nga fundi i qershorit dhe gjatë tërë korrikut, Manaferra (Ribes rubrum), Tërfili i livadheve (Trifolium Pratënse L.), Sherbela e livadheve (Silvia verticilata L.), Trumza (Satureia subspicata Vis.) Luleverdha (C. Palustris) që është pranishëm në livadhet kodrinore dhe në Bjeshkët e Deçanit. Këto kushtet të favorshme që ofron natyra bëjnë të mundur zhvillimin e bletarisë. Për të zhvilluar ketë sektor është e nevojshme që ti ofrohen kushtet sa ma të favorshme për bletët. Në përgjithësi, bletët tërhiqen nga lulet që janë të pasura me nektar dhe polen, kanë ngjyra të ndezura dhe janë të lehta për t'u qasur. Mbjellja e një shumëllojshmërie të këtyre luleve mund të ndihmojë në tërheqjen dhe mbështetjen e popullatave të bletëve. Për të mbështetur ketë sektor është e nevojshme që të krijohet bashkëpunim në mes të Komunës Deçanit me OJQ-të siç janë:

- Trajnime për bletarët e ri.
- Ngritja e parkut të bletarisë dhe shtimi i numrit të shoqërive të bletëve.
- Subvencionimi i bletareve me pajisje dhe koshere.
- Mbështetja e sektorit të zhvillimit të lulishteve ku me theks të veçantë do të mbështetët gjinia femërore në zhvillimin e këtyre bizneseve.

Blegtoria – Komuna e Deçanit njihet tradicionalisht për zhvillimin e blegtorisë. Ajo karakterizohet me fond të pasur e të konsiderueshëm të livadheve e kullosave. Janë të llogaritura 1,873 ha sipërfaqe për kullosa çka e mundëson zhvillimi e kësaj veprimtarie. Gjithashtu me politikat e qëndrueshme afat shkurtër dhe afat mesëm të zhvillimit të blegtorisë ne të ardhmen do të mundësohet edhe zhvillimi i blegtorisë në pjesën rurale. Ekziston tradita dhe përkushtimi i banorëve për ta zhvilluar këtë veprimtari, sepse ofron shumë përfitime, duke përfshirë:

- Ushqimi - blegtoria është një burim ushqimi për konsum njerëzor.
- Të ardhurat - blegtoria mund të jetë një burim të ardhurash për fermerët dhe prodhuesit.
- Plehrat - plehrat e bagëtive mund të përdoren si pleh për të përmirësuar pjellorinë e tokës dhe rendimentet e të korrave.
- Veshje - blegtoria siguron lesh dhe lëkurë që mund të përdoret për të bërë veshje dhe produkte të tjera.
- Rëndësia kulturore - në shumë kultura, blegtoria është një pjesë e rëndësishme e zakoneve dhe

ceremonive tradicionale.

- Punësimi - blegtoria dhe industritë e ngjashme ofrojnë mundësi punësimi për miliona njerëz në mbarë botën.
- Burimet gjenetike - racat e bagëtive dhe burimet e tyre gjenetike janë të rëndësishme për sigurinë ushqimore në të ardhmen dhe për mbarështimin e racave të reja, të përmirësuara të kafshëve.

Të gjitha përfitimet e lartë përmendura lidhen direkt me mundësinë e rritjes së numrit të punësuarve ne Komunën e Deçanit e cila ka ndikim të drejt për drejt në zhvillimin ekonomik. Andaj është më se e nevojshme që të behet lidhshmëria e politikave blegtorale, me strategjinë lokale për zhvillim ekonomik dhe të identifikohen hapat konkrete të mbështetjes së këtij sektori. Duke i bashkërenditur të gjitha këto veprime, fillojnë të hapen mundësitë e reja zhvillimore siç janë:

- Tregu për mish, qumësht, djathë, vezë dhe produkte të tjera të qumështit që janë burime të rëndësishme të proteinave dhe lëndëve ushqyese në dietat njerëzore.
- Grumbullimi dhe deponimi leshit dhe lëkurës të cilat kanë treg për shitje si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj.

Zhvillimi i blegtorisë lejohet të zhvillohet në mënyrë intensive në tërësinë "Zona rurale e Komunës Deçanit", ndërsa te tërësia "Zona urbane dhe trashëgimia kulturore" do të jetë ma pak e zhvilluar dhe në mënyrë të kontrolluar. Në pjesën urbane të kësaj tërësie ku ka ndërtime të mëdha, nuk lejohet zhvillimi i blegtorisë intensive përpos pjesës kodrinore. Në tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" lejohet zhvillimi i blegtorisë vetëm sipas Planit Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".

1.2.81 Pylltaria si aktivitet ekonomik

Në Komunën e Deçanit, ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme me pyje. Zhvillimi i pyjeve në Komunën e Deçanit do të ketë një mori përfitime mjedisore dhe ekonomike. Pjesa ma e madhe e pyjeve në Komunën e Deçanit ndodhen në anën perëndimore të saj. Ky masivitet i pyjeve i ndihmon Komunës se Deçanit që të ketë ajër ma cilësor me qenë se absorbojnë dioksidin e karbonit nga atmosfera dhe e ndihmojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike. Andaj, kërkohet që në kuadër të zhvillimit të politikave sektoriale, Komuna e Deçanit se bashku me nivelin qendror të hartojnë një plan për shfrytëzim dhe mbrojtje të pyjeve.

Mbrojtja dhe menaxhimi efikas i pyjeve ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e mjedisit të shëndosh dhe ta ndihmon biodiversitetin respektivisht speciet e ndryshme bimore dhe shtazore. Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e rrjedhës së ujit në pellgje ujëmbledhëse, duke ndihmuar në parandalimin e erozionit, rregullimin e temperaturave të përrenjve dhe ruajtjen e cilësisë së ujit. Gjithashtu me shfrytëzimin e tyre racional mund të zhvillohet industria e drurit, biomasës dhe artizanalëve tjera të cilat mund të përdorën ne sektorin e ndërtimit, prodhimin e letrës etj.

Komuna e Deçanit, duke pasur parasysh fondin e pyjeve mund të shfrytëzohet masën drunore të dëmtuar për biomase (ngrohje). Me menaxhimin e mirë të pyjeve ofrohen mundësitë e mira për punësim e që kanë të bëjnë me prerjet dhe përpunimin e drurit ndërsa në aspektin kulturorë dhe shpirtëror, pyjet luaj rol të rëndësishëm për shumë njerëz duke shërbyer si vend i rëndësishëm për ceremoni të ndryshme, kampingje, meditime dhe lidhjen me natyrën.

Pyjet janë të shtrira kryesisht në tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" dhe për mbrojtjen e tyre janë të nevojshme të ndermirën disa masa që kanë të bëjnë me:

- Zhvillimin dhe forcimin e kornizës ligjore dhe politikat lokale. Në këtë drejtime është e nevojshme që të ketë bashkërendim dhe mbështetje edhe nga niveli qendror dhe të hartohen mekanizmat për parandalimin e dëmtimit të pyjeve. Me shpalljen e Parkut Kombëtarë" Bjeshkët e Nemuna" është më se e nevojshme që të mbrohet biodiversiteti dhe ekosistemet.
- Kontrollimi i gjuetisë dhe parandalimi i gjuetisë së egër e cila ka ndikim në zhvillimin e pyjeve.
- Parandalimi i qasjes së paautorizuar dhe nxjerrjen e burimeve në mënyrë të pakontrolluar.
- Gjithë përfshirja e banorëve dhe pronarëve të tokave në zonat pyjore për të marr njohuritë rreth

traditave dhe praktikat e mbrojtjes së pyjeve. Gjithashtu është e nevojshme edhe ngritja e vetëdijesimit të banoreve dhe vizitorëve për mbrojtjen e pyjeve.

- Monitorimi dhe mbikëqyrja e pyjeve nga personat përgjegjës mirëpo edhe nga grupet vullnetare, banorët etj. Për ketë është e nevojshme që të zhvillohet sektori i monitorimit të pyjeve duke siguruar foto satelitore, pajimin me dron, shpërndarja e sensoreve të ndryshëm monitorues dhe fotografik të cilat sjellin imazhe në kohë reale rreth dukurive negative.
- Ripyllëzimi dhe pyllëzimi të zonave të nevojshme nëpërmes aktiviteteve të ndryshme me synim të mbrojtës së pyjeve. Rekomandohet që të behët ripyllëzimi dhe pyllëzimi me llojet e njëjta të druve me synim të mos prishjes së balancës së ekosistemit.
- Menaxhim i zjarreve me synim të parandalimit të zjarreve në pjesët pyjore.
- Prerjet e kontrolluara duke i minimizuar ndikimet negative mjedisore dhe sigurojnë regjenerimin e zonave të prera.
- Rritja e bashkëpunimit nder komunal dhe ndërkufitar, me organizatat lokale, nacionalë dhe ndërkombëtarë, OJQ-të me synim të parandalimit të shpyllëzimit.
- Zhvillimi i hulumtimeve të ndryshme pyjore me synim të promovimit të Komunës së Deçanit në sektorin e biologjisë dhe mjedisit ën përgjithësi.
- Stimulimi nëpërmes shpërndarjes së donacioneve të ndryshme komunale për OJQ-të për parandalimin e shpyllëzimit.

Në mënyrë të kontrolluar, prodhimi do të jetë parësore dedikuar pyjeve gjegjësisht pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, rotacion të mesëm, të gjatë dhe pylltari e bazuar ne mbulesë të vazhdueshme. Këto do të kanë ndikim në prodhimin dytësor me industri të lendes së parë, për prodhime drurit dhe produkteve me bazë të drurit.

1.2.82 Zhvillimi i industrisë së lehtë dhe i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme NVM-ve

Strategjia e krijimit të një ambienti tërheqës në Komunën e Deçanit bazohet në favorizimin e artizanaleve, ndërmarrjeve të vogla , në veçanti atyre me zhvillimin e argo-industrisë dhe agro-turizmit. NVM-të tashmë do të kanë një orientim investues, pasi fillimisht do të parashihen lehtësime në infrastrukturën përcjellëse, pastaj sigurimi i një lokacioni si parku i biznesit i cili është planifikuar në hapësirat e fshatit Drenoc, me sipërfaqe 20 ha. Vend ky si nyje qarkulluese dhe i përshtatshëm për të gjitha kategoritë që kërkojnë trajtim të veçantë dhe kritere në ruajtjen e mjedisit.

Koncepti i zhvillimit ekonomik të NVM-së për ushtrimin e veprimtarisë së tyre Komuna e Deçanit, ka planifikuar zonën për ushtrimin e veprimtarisë se industrisë se lehtë, agro-turizëm dhe shtrirjen e veprimtarive të NVM-së në sektor të ndryshëm.

NVM për prodhim parësor gjegjësisht për bujqësi janë të planifikuara ne tërësinë “Zonat rurale të Komunës Deçanit”. Në ketë sektor janë planifikuar prodhime bujqësore komerciale, dhe me infrastrukturë bujqësore.

Veprimtaritë ekonomike duke përfshirë prodhim parësor: me zhvillimin e prodhimtareve bujqësore komerciale, infrastrukturë bujqësore dhe pylltari.

Veprimtaritë ekonomik duke përfshirë prodhime dytësore: industri e lëndës së parë që kanë të bëjnë me prodhim të drurit, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i energjisë ripërtritshme.

Veprimtaritë ekonomike duke përfshirë prodhim tretësor me shërbim tregtar: Shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, Shërbim i patundshmërisë, Shërbim i akomodimit dhe ushqimit, Shërbim financiar dhe i sigurimit, shërbim administrativ dhe mbështetës.

Në Komunën e Deçanit jeton popullatë e re dhe fuqia punëtore nuk mungon. Mirëpo, duhet qe sa ma parë të hartohen politikat sektoriale të cilat do e ndihmojnë zhvillimin e NVM dhe rritjen e punësimit ndërsa në anën tjetër do e ndihmon demografinë në aspektin e uljes së migrimit.

Në varësi të rritjes së kërkesave dhe nevojës për zgjerim, propozohet që korridori i cili i lidh nyjat respektivisht rruga e cila e lidhë Deçanin me Gjakovën të zgjerohet në drejtimin jugor me aktivitete të ndryshme ekonomike. Në ketë mënyrë, zhvillimi ekonomik bëhet përgjatë këtij korridori, në tokat kryesisht të kontaminuar nga gazrat, pluhuri dhe mbetjet e gomave duke i mbrojtur tokat pjellore dhe kualitative nga zhvillimi i pakontrolluar.

1.2.83 Ujësjellësi

Sistemi i ujësjellësit në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga njësia operative K.R.U "Hidrodrini" Sh.A Pejë. Bazuar në rëndësinë e ujësjellësit dhe ndikimin e tij në kualitetin e jetës dhe mirëqenien e popullatës si dhe në zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës, gjatë hartimit të PZHK-së, duhet gjithsesi të harmonizohen planet dhe projektet planifikuese për investimet kapitale në infrastrukturën e furnizimit me ujë ku nevojat imediatë janë për përmirësimin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit në pjesën urbane dhe rurale aty ku ka nevojë duke përfshirë edhe zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe gjetjen e humbjeve Teknike dhe administrative si dhe identifikimin dhe eliminimin e lidhjeve ilegale. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës, për:

- Ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime,
- Zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbime të furnizimit me ujësjellës të cilat janë fshati Belle dhe Pleqe dhe Shkelzen Haradinaj.

Projektet e planifikuara për fazën afatmesme në periudhën 2021-2023 dhe afatgjatë 2022-2030 për infrastrukturën Teknike të planifikimit janë këto projekte:

- Funksionalizimi i klorinatorëve në Komunën e Deçanit.
- Rehabilitimi në disa pjesë të ujësjellësit në qendër të qytetit me vlerë 50,000.00 €.
- Pajimi i rajonit të Vokshit me ujëmatës.
- Sistemi i rezervarit në Hulaj të rehabilitohet me ujëmatës.
- Marrja në menaxhim të rrjetit të kanalizimit të ujerave të zeza në tërë territorin e Komunës së Deçanit.
- Ndërtimi dhe shtrirja e ujësjellësit në Bjeshkët e Deçanit.
- Hulumtimi dhe analizimi i mundësisë së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.

1.2.84 Sistemi i kanalizimit

Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit, ka shënuar një zhvillim të theksuar viteve të fundit. Në bazë të shënimeve të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe aktualisht sistemi i kanalizimit i ujërave të zeza është i shtrirë në një gjatësi të përgjithshme prej: 64,572.36 m. Në rrjetin e kanalizimit përshihen: Qyteti i Deçanit, fshatrat: Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Llukë e Epërm, Llukë e Ulët, Lumbardhë, Rastavicë, Pobergjë, Drenoci dhe Sllup, ku të gjitha ujërat e zeza trajtohen pjesërisht dhe duhet të ndërtohen impiante sipas standardeve për trajtimin e ujërave të zeza, për të evituar ndotjen e cila paraqet kërcenim serioz për shëndetin e popullatës dhe mjedisin në tërësi është e domosdoshme edhe realizmi sa me i shpejt i planifikimit për ndërtimin e kanalizimit në 18 fshatra tjera të cilat janë pa sistem të kanalizimit duke përfshirë edhe ndërtimin e impianteve. Ndërtimi i kanalizimit dhe impianteve në këto vendbanime: Strellc i Ulët - Bohriqe, Dubovik - Lagjja Gërvallaj - kufi me fshatin Kryshec dhe Papiq kjo me vlerë afërsisht 13 milion (trembëdhjetë milion €) ku trajtimi i ujërave të zeza do të bëhet sipas normave dhe standardeve mjedisore.

1.2.85 Kanalizimi atmosferik

Deri me tani rrjet të kanalizimit për ujërat atmosferike është i shtrirë vetëm në zonën urbane dhe atë në pjesën qendrore të qytetit me gjatësi prej 6.5 km, me kapacitet Ø 200mm - Ø 500mm, me puset të vendosura

në largësi nga 25-30 m, përgjatë rrugës kryesore të qytetit, shkarkimi i tyre bëhet në lokacione të ndryshme në kanalet e hapura.

Shtrirja e rrjetit të ujërave atmosferike në të ardhmen parashihet edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferike në pjesën e vjetër të qytetit e ashtu quajtura (rruga e vjetër) me gjatësi prej 3 km. Kanalizimi i ujërave atmosferik është trajtuar më rastin e ndërtimit të rrugës së qendrës më gjatësi prej 6 km. Ky rrjet parashihet të ndërtohet edhe në këto qendra të vendbanimeve në zonat rurale si: Strellc i Epërm, Isniq, Carrabreg i Epërm, Irzniq dhe Drenoc ku do të jetë me gjatësi prej 12 km, por është e domosdoshme të bëhet edhe trajtimi i tyre dhe pastaj shkarkimi në kanalet e hapura apo në rrjedhat e lumenjve.

1.2.86 Ujitja

Sistemi i rrjetit të ujitjes parashihet të mbuloj tërë tokat bujqësore në Komunën e Deçanit. Deri më tani është investuar në rrjetin e ujitjes dhe planifikohet të vazhdohet në këtë drejtim edhe në të ardhmen. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e tyre ka kosto të lartë mirëpo Komuna e Deçanit planifikon që në kuadër të politikave zhvillimore për bujqësinë të planifikon edhe aplikimin në grante dhe projekte të ndryshme të nivelit qendror dhe organizatave të ndryshme. Në të gjithë Sistemin ekzistues pritën të realizohen projekte për ndërtimin e kanaleve të ujitës, me ç 'rast parashihet ndërtimi i 32 kanaleve me gjatësi rreth 51.49 km. Me të gjithë këtë gjatësi, Komuna e Deçanit e mbulon të gjithë zonën rurale me Sistemin e ujitjes.

Në kuadër të zhvillimit të Sistemi të ujitjes njëkohësisht janë planifikuar të ndërtohen tre penda akumuluese në Gryken e Lloqanit. Ndërtimi i këtyre pendave do ta lehtësoj mjaft sektorin e bujqësisë e sidomos në periudhat thatësire. Një veprim i tillë është mjaft i rëndësishëm sepse:

- E ndihmon Komunën e Deçanit në furnizimin me ujë. Uji i grumbulluar në lumenjtë do i ndihmon njerëzit por edhe kafshët dhe mund të përdorët për ujitje, prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe proceset e ndryshme agro industriale.
- E ndihmon ekosistemin dhe mund të janë pika ndalesa për shumë habitate të faunës e me theks të veçantë të llojeve të rrezikuara.
- Luan rol të rëndësishëm ne menaxhimin e përmbytjeve sepse Komuna e Deçanit në vitet e fundit ka qenë zonë e rrezikuar nga përmbytjet të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin Komunal mirëpo edhe të buxheti i ekonomive familjare. Akumuluesit ne këto raste shërbejnë si rezervuar natyror dhe mund të mbajnë sasi të ujit gjatë reshjeve të shiut dhe i parandalojnë përmbytjet. Në rastet e reshjeve të dendura, akumuluesit e ndalojnë për një periudhë kohore ku faktori njeri i merr të gjitha masat për shpëtimin e jetës, pronës bagëtisë, teknikës, pajisjeve etj.
- Përpos sektorit të bujqësisë pikat akumuluese luajnë rrol të rëndësishëm edhe në aspektin e rekreacionit dhe mund të janë pika atraktive për turizëm si shëtitje me kanoe, kamping, not, peshkim etj. Vlejnë të cekët se këto akumulues mund të nxisin edhe zhvillimin e sporteve të ndryshme ujore.

I vetmi ndikim negativ i akumuluesve është prishja e jetës nënujore respektivisht gjallesave nën ujë të cilave habitati i lëvizjes ju ndryshon mirëpo në përgjithësi, akumulimi i ujit luan një rol kritik në ruajtjen e jetës dhe ruajtjen e shëndetit të ekosistemeve të planetit tonë.

1.2.87 Furnizimi me energji elektrike

Rrjeti elektrik në Komunën e Deçanit, furnizohet nga dy nën stacione: rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv, në një pjesë të rrjetit është investuar në përmirësimin dhe furnizimin me energji elektrike, kurse pjesa tjetër e Qytetit të Deçanit, duhet të behën investime në përmirësim e rrjetit ekzistues në pjesën urbane të pa përfshirë dhe pjesën rurale me qëllim për të rritur cilësinë dhe sigurinë e furnizimit si dhe për të reduktuar humbjet Teknike në zonat e caktuara të territorit të Komunës.

Komuna e Deçanit, së bashku me KEDS-in, duhet të përmirësoj gjendjen ekzistuese të rrjetit elektrik në pjesën rurale në ato vendbanime, ku rrjeti është i dobët, duhet të bëhen projekte për ndërrimin e rrjetit ekzistues (vjetruar), po ashtu duhet të përfshihen edhe kalimi nga rrjeti shpërndarës ajror në rrjetin

shpërndarës kabllor si dhe zëvendësimin e linjave ajrore me kabllo nëntokësor, duhet të merret parasysh edhe ndërrimi i stabilimenteve ekzistuese (vjetruara). Deri me tani është shpërndarë rrjeti i energjisë elektrike në Bjeshkën e Deçanit (Bjeshka e Madhe) me gjatësi 5 km, në vlerë: 195,000.00 €. Shpërndarja e rrjetit elektrik parashihet, që të bëhet në të gjitha e Bjeshkët e Deçanit, me qëllim të përmirësimit të kushteve për mirëqenie të qytetarëve dhe zhvillimin e turizmit.

1.2.88 Menaxhimi i mbeturinave

Deçani qytet ekologjik është prioritet i Komunës, ku menaxhimi i mbeturinave në nivel të Komunës është përmirësuar dukshëm krahasuar me gjendjen e mëhershme, në këtë drejtim Komuna ka parashtruar qëllimin dhe objektivat specifike që janë pjesë integrale e menaxhimit të qëndrueshëm si: grumbullimi i mbeturinave derë më derë, duke përfshire aktivitete si: selektimin, riciklimin, kompostimin, ambalazhimin etj. Administrimi i mbeturinave në territorin e Komunës behët sipas Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2022 - 2030. Qëllimi i këtij plani është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për territorin a administruar nga Komuna, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore mjedisore dhe kornizën planifikuese strategjike.

Mirëmbajtja aktualisht zbatohet në mënyrë të kënaqshme dhe synohet që të arrihen objektivat e planifikimit siç janë:

- Sigurimin e kamionëve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave.
- Sigurimin e kontejnerëve publik dhe individual për grumbullimin e mbeturinave.
- Sigurimin e kontejnerëve dhe infrastrukturës përcjellëse për ndarje dhe riciklim.
- Sigurimin e enëve kompostuese dhe
- Investimet në deponinë e materialeve inertë.

Komuna se bashku me OJQ-të, ka dizajnuar kampanjën për vetëdijesim. Kampanja nënkupton logo dhe moto e Komunës, që do të përdorë për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për reformën në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Kampanja do të fokusohet në fushat në vijim:

Zgjerimi i shërbimeve - çdo zgjerim i shërbimit për çdo vendbanim do t'i paraprijë me takime publike me banorë. Në të njëjtën kohë Komuna, do të organizojë ligjërata për shkollat fillore dhe të mesme për të ngritur vetëdijen e nxënësve rreth procesi të menaxhimit të mbeturinave dhe efektet pozitive dhe negative të mbeturinave.

Ndarja në burim në shkolla dhe institucione - Komuna do të organizojë takime dhe ligjërata me nxënësit e shkollave, mësimdhënësit, dhe punonjësit e institucioneve publike për të shpjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave dhe përfitimet nga ky proces, do të publikojë broshura ku do të shpjegohet në mënyrë të qartë procesi i ndarjes së mbeturinave.

Ndarja në burim në amvisëri - Komuna do të organizojë takime lagje për lagje duke ju shpjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave në burim dhe përfitimet nga ky proces, do të publikojë broshura të cilat do të shpjegojnë qartë këtë proces si dhe kohën e operimit për mbledhjen e mbeturinave.

Ishujt ekologjik - lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme koha për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme, Komuna do të informojë qytetarët për ishujt ekologjik, lokacionin për mbeturinat e vëllimshme dhe kohën për mbledhjen e këtyre mbeturinave përmes broshurave dhe takimeve me qytetarë. Komuna, ka caktuar lokacion për mbeturinat ndërtimore dhe të demolimit në fshatin Lëbushë.

1.2.89 Telekomunikacioni

Kapitulli i telekomunikacionit e përfshinë telefoninë fikse, telefoninë mobile dhe shërbimet e internetit. Duke e marr a parasysh zhvillimin teknologjik dhe të komunikimit, Komuna e Deçanit është e gatshme që ti

përshtatet ndryshimeve teknologjike ne 8 vitet e ardhshme edhe të ofrojë kushte sa ma të mira të komunikimit të cilat nuk janë të parapara në projekt PZHK-në.

1.2.90 Telefonia Fikse

Rrjeti i telefonisë fikse në Komunën e Deçanit, është i lidhur nëpërmjet fibrat optik. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së në Deçan, e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik, po ashtu PTK-ë bënë edhe shërbimin postar. Nga gjithsej 38 vendbanime, që ka Komuna e Deçanit, prej të cilave 36 mbulohen nga operatori ekonomik Vala, kurse shërbimet tjera postare i mbulon Telekomi i Kosovës.

1.2.91 Telefonia Mobile

Komuna e Deçanit, është e mbuluar mjaftë mirë me telefoni mobile. Të gjitha vendbanimet kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ish Ministria e Infrastrukturës tani Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Të dy operatorët mobil Vala dhe Ipko, i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të Komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatori mobil Vala është 11 antena, ndërsa nga operatori mobil Ipko është 8 antena.

1.2.92 Shërbimet e Internetit

Shërbime të internetit ofrohen nga disa operator të cilët e mbulojnë pjesën ma të madhe të territorit të komunë së Deçanit siç janë: Vala, Ipko, Artmotion, Kujtesa, Adea Computer, Tel Kos dhe Një arti. Pjesa ma e madhe e territorit të Komunës është e mbuluar me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore - bjeshkët dhe dy vendbanimet fshati Belle dhe Pleqe. Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me operatorin ekonomik Vala, në të ardhmen parashihet që ky operator të bëjë vendosjen e antenave dhe shtrirjen e rrjetit në Bjeshkët e Deçanit. Projektet e planifikuara ndërmjet Komunës dhe operatorit ekonomik Vala, që do të bëhen gjatë viteve në vijim janë:

- Mbulimi me rrjet të telekomunikacionit me fibër optik përgjatë rrugës nacionale Deçan-Plavë, dhe mbulimin me rrjet mobil të zonave turistike në Komunën e Deçanit.

Me realizimin e projekteve të sipër përmendura, Komuna e Deçanit e forcon komunikimin, krijon qasje ma të mire ne informacion, e promovon turizmin, ofron mundësi të edukimit online dhe e forcon lidhjen sociale ne ketë zonë.

1.2.93 Infrastruktura e transportit dhe transportit

Infrastruktura e transportit dhe transporti ka ndikim esencial për zhvillimin e çdo sektori në territorin e Komunës Deçanit. Politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore ne Komunën e Deçanit do të jenë të karakterit lidhës ne mes të dy apo ma shumë vendbanime mirëpo duke e marr parasysh edhe aspektin social dhe ekonomik e që nënkupton ofrimin e kushteve të sigurisë për ecje dhe çiklizëm, gjelbërimi i tyre dhe harmonizimi i tyre me politikat sektoriale e sidomos me sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turistik. Duke i marr parasysh të gjitha këto propozime, ne të ardhmen Komuna e Deçanit do të udhëheqë politikat e lëvizjen me prioritet të:

Këmbësorit - duke ofruar sa ma shumë lëvizje aktive kundrejt lëvizjes pasive. Për ketë synohet që të krijohen sa ma shumë hapësira për ecje respektivisht trotuare, hapësira publike, korridore të gjelbra si dhe rritja e sigurisë ne trafik. Rrjeti i hapësirave publike do ti nënshtrohet një analize të hulumtimi në nivel të zhvillimit të politikave sektoriale e cilat do të ketë rritje të dukshme të lëvizjes aktive.

Çiklistit – duke iu mundësuar sa ma shumë shtigje për çiklizëm brenda zonës urbane, lidhjes me vendbanimet tjera respektivisht me fshatrat, si dhe krijimin e shtigjeve të cilat do të jetë atraktive, turistike dhe ekstreme (në zonat malore). Të gjitha këto do të janë të lidhura me normat dhe politikat e lëvizjes shtëpi – punë - shtëpi, shtëpi – shkollë - shtëpi, shtëpi – blerje – shtëpi.

Transportit publik – do të ofrohet brenda zonës urbane dhe lidha e saj me vendbanimet tjera respektivisht me fshatrat. Është e rëndësishme që të ofrohen politikat e qarta të cilat e promovojnë përdorimin e transportit publik dhe mënjanimin e përdorimit të automjetit. Andaj, organizimi i transportit publik do të ndikon pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit, në buxhetin e familjes si dhe ne zhvillimin ekonomik të Komunës. Për zonën perëndimore respektivisht zonën malore propozohet të organizohet transporti i llojit "shuttle -bus" i cili do të bëjë transportin në mënyrë të kontrolluar në vende të ndryshme brenda kësaj zone. Kjo do të ketë kontribut pozitiv në zhvillimin e turizmit dhe transportimin e vizitorëve të ndryshëm si dhe do të mbroj mjedisin nga gazrat e automjeteve dhe do të ruaj biodiversitetin. Rekomandohet që "shuttle-bus" të jetë ekonomik dhe të subvencionohet nga Komuna e Deçanit. Komuna e Deçanit i posedon të gjitha mundësitë e zhvillimit të transportit të integruar multimodal. Andaj, është e rëndësishme që pas projekt PZHK-së të Komunës së Deçanit, të fillohet me procesin e hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban.

Parkimit – ofrim i parkingjeve për të gjitha hapësirat e banuara, ekonomike dhe administrative. Parkingjet për vizitorë propozohen të organizohen sa ma larg qendrës së qytetit me synim ofrim të transportit publik për lëvizje ne pjesët tjera urbane. Të gjitha parkingjet do të përmbajnë në vetë parkingjet për personat me nevoja të veçanta dhe pikat e furnizimit me rrymë. Gjithashtu, zonat e banuara do ti nënshtrohen një regjenerimi urban që të mund të organizohen parkingjet për banorë mirëpo edhe hapësirat publike e këndet e lojërave.

Automjetit - prioriteti i fundit i cili do ti nënshtrohet restrikcioneve të ndryshme siç është anashkalimi i qendrës së qytetit, ulja e shpejtësisë, kufizime në rrugë njëanësore etj.

Bashkëpunimi me akteret relevant për rritjen e sigurisë në trafik është më se i domosdoshëm. Roli i Policisë së Kosovës është i rëndësishëm ne hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë në trafik. Identifikimi i saktë i pikave të zeza ku ndodhin më se shumti aksidentet duhet të analizohen dhe të ofrohen zgjidhjet më të mira për rritjen e sigurisë. Në këtë drejtim pritët kontributi edhe banorëve të Komunës së Deçanit, OJQ-ve si dhe organizatave të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare. Kjo nënkupton përmirësimin e udhëkryqeve, vendkalimeve të këmbësorëve etj., mirëpo edhe zbatimin e masave të mbrojtjes si anësoret, shtyllat lëvizëse, ndriçues të ndryshëm etj.

1.2.94 Infrastruktura e transportit

Pozita gjeografike e Komunës së Deçanit, në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme rajonale dhe nacionale, si dhe rrjeti rrugor lokal mundëson komunikim të mirë dhe mjaft efikas në transportin e njerëzve dhe mallrave gjithashtu duke ndërlidhe Qytetin e Deçanit, me të gjitha vendbanimet po ashtu edhe më shtetet fqinje. Komuna e Deçanit, ka shtrirje të rrugëve në të gjitha kategoritë me gjatësi prej:

- 405 km rrugë lokale ku 345 km janë të asfaltuara, 60 km të pa asfaltuara,
- 28 km rrugë nacionale
- 41.5 km rrugë regjionale.

Komuna e Deçanit, karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Në Komunën e Deçanit, ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale, regjionale, lokale të pa kategorizuara.

Për çështjen e sigurisë në trafik, jo të gjitha kategoritë e sipër përmendura i plotësojnë kushtet. Është më se e nevojshme që të fillohet me hartimin e strategjisë për rritjen e sigurisë ne trafik dhe të merren hapa konkrete me qenë se Komuna e Deçanit është e orientuar drejt zhvillimit të turizmit si në zonat urbane e rurale ashtu edhe në ato malore. Po ashtu promovimi i zhvillimit të lëvizjes aktive nuk mund ti arrin qëllimet e saj të plota nëse nuk ofrohen kushtet e lëvizjes së sigurt, andaj pas projekt PZHK-së është e nevojshme që të ndërmerren këto hapa:

- Identifikimi dhe kategorizimi i të gjitha hapësirave publike në zonën urbane dhe rurale. Për kategorizim do të merren për bazë praktikat dhe udhëzimet e mira ndërkombëtare dhe ato lokale

- Krijimi i rrjetëzimit të hapësirave publike në mes veti duke i identifikuar projektet – investimet kapitale të cilat do e mundësojnë jetësimin e këtij rrjeti.
- Identifikimi i të gjitha pikave më të frekuentuara për ecje dhe çiklizëm dhe hartimi i politikave për rritjen e sigurisë (me theks të veçant ne afërsi të shkollave).
- Lidhja e zonës urbane me zonën rurale nëpërmes lëvizjes aktive duke i identifikuar "korridoret e gjelbra" sipas prioriteteve (p.sh. korridoret e prioritetit të parë, dytë, tretë et.).
- Lidhja e politikave të lëvizjes aktive me politikat sektoriale të zhvillimit të turizmit (si ai urban, rural dhe malor) duke i forcuar sinergjitë dhe larguar kontradiktat.
- Zbatimi i projekteve për fazë – fazë me synim të rritje së sigurisë në trafik për promovimin e lëvizjes aktive dhe zhvillimin e turizmit.

1.2.95 Transporti publik

Transporti ndër urban planifikohet të bëhet me autobusë dhe minibusë, nga operatorët privatë kurse me vendbanimet e Komunës, transporti vazhdohet me minibus. Në tërë territorin e Komunës së Deçanit, pika ndaluese për automjetet e transportit publik janë gjithsej 72, kurse pika ndaluese të pajisura me shenjëzim për automjetet e transportit publik lokal janë 70, ndërsa numri i automjeteve motorike të regjistruar si taksi - kombibus janë 13. Stacioni i autobusëve mbetët për diskutim me që objekti ekzistues është në kontest pronësor me rregullimin e çështjes së stacionit të autobusëve, Komuna e Deçanit i ka të gjitha mundësitë që të fillon me hartimin e politikave për transport multimodal. Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim nga operatorët privat me linjat ne zonat e ndryshme urbane, rurale dhe ndërkufitare. Gjithashtu është planifikohet që në pjesën perëndimore të aktivizohet "shuttle-bus" i cili është mjet transportues ekologjik dhe do të jetë në dispozicion të vizitorëve të për ketë zonë. Ky projekt do të hartohet dhe menaxhohet nga Komuna e Deçanit.

1.2.96 Transporti i pa motorizuar - këmbësor dhe biçikleta

Rrjeti i shtigjeve për këmbësor, biçikleta dhe hapësira publike do t'i kushtohet një planifikim i detajuar sipas modelit multimodal (avancim i transportit) dhe ndërlidhjes përmes hapësirave publike, parqeve dhe shtigjeve po ashtu i kushtohet rendësi edhe lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara. Komuna e Deçanit në planifikimin 8 vjeçar parasheh këto investime:

- Përfundimi i Shëtitores përgjatë Lumit të Lumëbardhit nga Ura e Demës deri tek burimi i ujit të thartë Gushavci. Tani vetëm e trasuar pjesërisht dhe gjendët në punim e sipër. Shteg ky që mundëson qarkullimin edhe të këmbësorëve edhe të mjeteve të pa motorizuara.
- Shtegu për ecje dhe çiklizëm nga qendra e qytetit, drejtë dy shkollave të mesme deri afër ish bletarisë dhe kryqëzimi i saj në dy drejtime: djathtas drejt Lumit Lumëbardhi i Deçanit dhe majtas në drejtim të manastirit dhe vazhdimi pastaj për në Podin e Gështenjave.
- Shtegu për ecje dhe çiklizëm nga Podi i Gështenjave drejtë grykës së Lloqanit, e degëzuar me Vendbanimin Hulaj në anën jugore për të vazhduar drejt Lakut të Kryqes si zonë malore dhe zbritja rrëze bjeshke deri të Gushavci.
- Parashihen shtigje të reja dhe shtigje të zgjeruara nga tri drejtimet e qytetit për në parkun e qytetit i planifikuar tek ish shtëpizat e ish. "Napredakut" (tani pronë Komunale) , me një sipërfaqe prej 12 ha dhe me ambient për të gjitha disiplinat rekreative. Në afërsi të parkut janë edhe qendra rinore dhe objekti i trashëgimisë kulturore.

1.2.97 Parkimi

Në përgjithësi në Komunën e Deçanit, parkimi është problem që paraqitet në pjesën urbane, konkretisht në qendër të qytetit ku dihet se nuk ka një hapësirë të definuar, që i plotëson kushtet dhe kriteret për parkim publik ku kjo gjendje është si pasojë e mungesës se pronave Komunale. Hapësirat ekzistuese, që shërbejnë si parkime janë në prona privatë dhe ndërtesave të shumë banesore dhe qendrave tregtare - bizneseve. Komuna e Deçanit, parasheh që në të ardhmen të ofron pikat e parkimit nëpër disa zona të caktuara. Pjesa ma e fokusuar është rruga regjionale Pejë - Deçan- Gjakovë ku planifikohet të behën disa investime për parking. Opsionet janë të ndryshme duke filluar nga:

- Parkimi paralel ne rrugë në mënyrë lineare dhe të organizuar duke u bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare e cila bazohet në raportit një pemë – dy parkingje – një pemë.
- Krijimi i vend parkingjeve të reja të shpërndara ne të gjithë zonën urbane afër pikave të rëndësishme siç janë ndërtesa Komunale, QMF-të, Stacioni Policorë etj.
- Hartimi i politikave të parkingjeve nëpërmes Partneritetit Publiko Privat.
- Ndërtimin e një garazhe publike me dy etazhe në qendër të Qytetit ku parashihet zgjidhja e problemit të parkimit publik. Ky propozim lidhet edhe me politiken e transportit publik e cila mund të jetë falas për transport në pikat e ndryshme të zonës urbane dhe rurale.
- Paketat inovative dhe tërheqëse për lëvizje në mënyrë të lehtë dhe të rregullt mund të zhvillohen nëpërmes zbatimin të politikave të lëvizshmërisë siç janë konceptet "parko dhe ec", "parko dhe çiklo" apo "parko dhe përdor transport publik". Të gjitha këto mund të rregullohen me hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban për Komunën e Deçanit.

Duke i zbatuar veprimet e sipër përmendura atëherë Komuna e Deçanit:

- E rritë nivelin e sigurisë sepse duke i siguruar vend parkingjet në zonat e caktuara dhe duke i larguar ato nga rrugët, do të ketë ndikim pozitiv në uljen e aksidenteve në rrugë si dhe t'ju lehtëson lëvizjen e automjeteve të ndryshme të urgjencës siç janë ndihma e parë, zjarrfikëset, policia etj. Gjithashtu, ndotja nga lëvizja e automjeteve në zonat e ndryshme urbane do të ulët dukshëm.
- Do të baraspeshon nevojën – kërkesën për parking në raport me numrin e vend parkingjeve. Me këto veprime caktohet edhe intensiteti i numrit të vend parkingjeve. Ky veprim e mbështet dhe e forcon metodat e ndryshme alternative të lëvizjes.
- Ofrimi i lehtë i qasjes për të gjitha kategoritë e shoqërisë – me theks të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik - duke ju ofruar parkingjet e mjaftueshme bizneseve të ndryshëm e me theks të veçantë tregjeve të hapura ku do të bëhet plasim i produkteve të ndryshme lokale.
- Fuqizimin e transportit multimodal – duke krijuar transport të qëndrueshëm duke krijuar modalitetet të lëvizjes me transport publik, çiklizëm, ecje, etj. dhe duke e dekurajuar lëvizjen vetëm në automjet duke e ndihmuar zhvillimin e politikave të lëvizjes aktive.

1.2.98 Infrastruktura publike

Zhvillimi i Sistemit të infrastrukturës publike i referohet mirëqenies së qytetarëve përmes ngritjes së nivelit të shërbimeve dhe qasjes më të lehtë në ndërtesave publike. Në këtë aspekt, parimet themelore të zhvillimit të ardhshëm të këtij sektori janë:

- Përmirësimi i shërbimeve në të gjitha vendbanimet dhe shtrirja e balancuar e shërbimeve në tërë territorin e Komunës;
- Përmirësimi i shërbimeve në fushën e përkujdesjes së: fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara .

Në periudhën e zbatimit të planit, duhet të monitorohet zhvillimi hapësinor dhe demografik i secilit vendbanim dhe struktura e moshës së popullatës, dhe në përputhje me këtë dhe funksionet e tyre themelore, të sigurohen shërbimet e nevojshme publike. Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuatë. Në PZHK-ë, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- Vendbanime;
- Rekreacion;
- Toka bujqësore;
- Korridore të gjelbërimit;
- Kullosa dhe livadhe;
- Pyje;

- Pyllëzim;
- Gurëthyes;
- Rrjedha të ujit.

1.2.99 Institucionet arsimore

Në përgjithësi, qasja në arsim fillor dhe të mesëm në Komunën e Deçanit, është e mirë. Në zhvillimin e ardhshëm të infrastrukturës arsimore synohet sigurimi i ndërtesave të nevojshme të edukimit parashkollor me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel të arsimimit, parashihet ndërtimi i tri çerdheve. Projektet e planifikuara për infrastrukturën arsimore janë:

- SHMU " Lidhja e Prizrenit" Deçan: Ndërtimi i fushave të futbollit të vogël, basketbollit dhe trotuareve me ndërtesa përcjellëse, asfaltimi dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 120 m dhe gjerësi 5 m dhe hapësira për 50 parkingje.
- SHFMU - " Dëshmorët e Baballoqit" – Baballoq: Ndërtimi i aneksit.
- SHFMU - "Dëshmorët e Vokshit"- Pobergjë: Ndërtimi i aneksit.
- SHFMU -"Kuvendi i Verrave të Llukës"- Llukë e Epërme: Para masa dhe parallogaritja për sanitare fushore dhe rregullimi i shtegut me kubëza deri tek sanitaret.
- Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri " në Deçan: Punimi i kanalizimit për kyçje në kanalizimin e ujërave të zeza të objektit të shkollës vlera.
- SHFMU "Sylejman Vokshi" Prilep: Ndërtesa e re e shkollës.
- SHFMU "Jusuf Gërvalla"- Prapaqan: Ndërtimi i Sallës së Sportit, Rregullimi i hyrjes kryesore dhe oborrit të shkollës me kubëza.
- SHFMU – "Ardhmëria" Beleg. Ndërtimi i objektit të ri të shkollës.
- SHFMU "Maxhun Çekaj" Irzniq: Renovimi i tërësishëm i objektit të shkollës (molerim, demontim dhe montim të dyerve, sanitaret e brendshme, rrethojat e shkallëve etj.)
- SHFMU "Lan Selimi" Llukë e ulët (paralele e ndarë): Rrethojë e objektit të shkollës.
- SHMT "Tafil Kasumaj" – Deçan: Salla e Sportit – ndërtesa e re, renovimi i kulmit të shkollës, zgjerimi i objektit të shkollës.
- SHFMU- "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë: Rrethimi i shkollës, Trotuari për nxënës.
- SHFMU - "Faik Konica"- Ratishë: Trotuari, Kubëzimi i oborrit.

1.2.100 Institucionet shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Zhvillimi i kujdesit shëndetësor do të bazohet në përmirësimin e cilësisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat Shëndetësore në zonat rurale. Ofrimi i shërbimeve cilësore do të sigurohet përmes rritjes së numrit të personelit shëndetësor, në veçanti të mjekëve familjarë. Gjithashtu përmirësimi i kujdesit shëndetësor do të mundësohet duke pajisur të gjitha institucionet shëndetësore me pajisje të reja dhe moderne mjekësore dhe furnizim të rregullt me inventar, shërbime laboratorike dhe specialistike. Rinovimi dhe funksionalizimi i disa AMF, zhvillimi i kujdesit shëndetësor parashihet të jetë edhe në Bjeshkët e Deçanit, vendbanimin Belle, Pleqe dhe Bjeshkën e Belegut i cili shërbim do të bëhet në përputhje edhe me zhvillimin e sektorit të turizmit në këto zona. Në një periudhë afatgjate, është planifikuar edhe ndërtimi i inseneratorit në fshatin Irzniq.

Në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për rastet sociale, është planifikuar sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ndërtimi i ndërtesave për strehim të familjeve me nevoja sociale.

Planifikimi i Komunës së Deçanit, për ndërtimin e ndërtesave për banim social është paraparë ndërtimi i dy ndërtesave. Në bazë të linjave buxhetore Komunale është planifikuar të ndërtohen këto ndërtesa për banim social në Rr. "Manastirit", në afërsi të ndërtesës së objektit social ekzistues.

Në sigurimin e përkujdesjes për të moshuarit, pa përkujdesje planifikohet ndërtimi i objektit për akomodim dhe kujdes për këtë kategori. Planifikimi i projekteve për institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale janë:

- Ndërtimi i inseneratorit në fshatin Irzniq.
- Ndërtimi i dy ndërtesave për banim social.
- Ndërtimi i objektit për të moshuarit Deçan.
- Aplikimi i energjisë efiçiente, QKMF në Deçan.
- Renovimi i AMF-së në Lumbardh.
- Blerja e një automjeti të ri për implementimin e programit për nënën dhe fëmijën, shërbim i patronazhit.
- Ndërtimi i garazheve për automjetet e QKMF-së.
- Blerja dhe digjitalizimi i RTG në QMF Strellc.
- Blerja e softuerit për distribuimin e imazheve të RTG-ve (grafive).
- Blerje e aparaturës bashkëkohore për laboratorë.
- Blerja e automjeteve të reja.
- Ashensori në QKMF-së.

1.2.101 Administrata publike

Komuna e Deçanit, ka planifikuar ndërtimin e objektit të ri të komunës ku do të vendosen këto institucione: Administrata Komunale, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Deçan, Qendra për Pune Social - QPS dhe Qendra për Regjistrim të Dokumenteve - QRD dhe Regjistrimin e Automjeteve - QRA, të cilat aktualisht funksionojnë në disa ndërtesa të veçanta.

Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet avancimi i Sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, për funksionim me efikas në administratën e institucioneve të cekura me lartë, është planifikuar ndërtimi i objekti që do të ndërtohet brenda periudhës kohore 2023-2031, në lokacionin e quajtur ish objekti i Drinit të Bardhë në Deçan, me etazhitet të lartë, me vlerë investive afërsisht rreth 3 milion €. Planifikimi për administratën publike për vitet 2023-2031 është:

- Ndërtimi i objektit të ri;
- Avancimi i Sistemit elektronik, për informimin e qytetarëve.
- Decentralizimi i administratës - funksionalizimi i shërbimeve administrative me qendrat sekondare.
- *Shërbime administrative dhe qasje e lehtë për të gjithë qytetarët në një vend (One Stop Shop-aplikimi online për shërbime të administratës publike e cila formë rritë efikasitetin e shërbimit në administratë dhe lehtëson marrjen e shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset);*
- Funksionalizimi i nën qendrës për shërbime publike në fshatin Irzniq;
- Planifikimi i parkingjeve nëntokësore në qendrën e qytetit - hapësirë kjo tani e bartur në pronësinë e Komunës dhe në shërbim për objektin administrativë dhe qytetarët.

1.2.102 Hapësirat publike

Hapësira e përgjithshme publike në territorin e Komunës së Deçanit, është 6.41 ha, nga territori prej 293 km². Me përfundimin e punëve të planifikuara për ndërtimin e qendrës së qytetit, hapësirave gjelbëruese me shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta përgjatë Lumëbardhit, shëtitorja përgjatë rrugës së Manastirit, Podi i Gështenjave, rruga nga Ura e Demës deri të "Uji i Thartë (Gushavcit), rruga e vjetër në Deçan, sipërfaqja e gjelbëruar për kokë banori do të rritët dukshëm. Mirëpo, pas miratimit të projekt PZHK-së, Komuna e Deçanit duhet të harton sa ma parë dokumentin strategjik sektorial për hapësirat publike dhe të tenton sa ma parë që të benë lidhjen e hapësirave publike të cilat to të krijojnë një rrjetë urbane, të lidhura në mes veti. Vlejnë të cekën se me ketë veprim fuqizohet lëvizja aktive, zbatohen politikat e qëndrueshme të lëvizshmërisë si dhe promovohet turizmi urbane si pikë lidhje në mes të atij malor dhe rural. Mirëpo, rregullimi i hapësirave publike nuk do të jetë e fokusuar vetëm në zonën urbane, të njëjta veprime pritën të ndërmerren edhe ne zonën

rurale si dhe në zonën malore respektivisht të qendrat e vendbanimeve në këtë rajon duke u bazuar në ligjin në fuqi për ketë rajon. Andaj me këto veprime Komuna e Deçanit do synon në:

- Ndërveprimi social – ku njerëzit që të ndër veprojnë me njëri-tjetrin, gjë që mund të ndihmojë në ndërtimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve shoqërore dhe të rrisë kohezionin e komunitetit.
- Të rrisë aktivitetin fizik – me ndërtimin e parqeve dhe kënde të lojëra me synim të përmirësimit të shëndetit fizik dhe mirëqenies.
- Qasja me të lehtë në natyrë - e cila ofron përfitime shëndetësore, mendore dhe emocionale si reduktimi i stresit dhe promovimi i relaksimit.
- Shprehja kulturore, tradicionale dhe historike – me ofrimin e historive dhe traditave të ndryshëm. Zhvillimin e kulturës dhe artit nëpërmes instilacioneve të ndryshme të artit publik.
- Rritjen ekonomike – duke u transferuar në tregje ndërsa sheshi i qytetit mund të shërbejnë si qendra të aktivitetit ekonomik dhe të stimulojnë zhvillimin ekonomik lokal.
- Angazhimi qytetar – duke shpreh mendimet dhe bindjet e tyre në tubime (pjesëmarrje demokratike).

1.2.103 Menaxhimi i varrezave

Komuna e Deçanit, ka ndërmarre hapa konkret në rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, kurse në zonën rurale varrezat janë të shpërndara sipas lagjeve, të cilat mirëmbahen nga familjet. Në të ardhmen Komuna e Deçanit, planifikon që menaxhimin e varrezave të bëjë nga një ndërmarrje publike lokale. Aktualisht është e rezervuar hapësira për varrezat e qytetit dhe ka filluar jetësimi i kësaj hapësira, për të cilën ekziston plani detal. Mbetët të investohet në finalizimin e projektit. Është projektuar në sipërfaqen prej 10 ha dhe është sistemuar si kompleks me të gjitha veprimtaritë përcjellëse: Ceremonitë fetare për tri konfesionet, përpunimi i varreve, mirëmbajtja dhe shërbimet e transportit.

1.2.104 Destinimet dhe përmasat

Komuna e Deçanit, shtrirjen e vendbanimeve në gjithë territorin e saj mund të përshkruhet si model i dy tipave si: vendbanime të koncentruar përgjatë rrugës kryesore në qendër të qytetit dhe rreth tij, kurse në zonën rurale zhvillimi i vendbanimit është kryesisht i shpërqendruar, një tip të tillë të vendbanimit e kemi edhe në periferi të qendrës urbane.

Plani synon të adresojë këtë çështje duke rekomanduar zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke filluar nga zona urbane e deri tek vendbanimet në zonën rurale. Investimet publike në përpjesëtim me rritjen e popullsisë synojnë të ofrojnë shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi, që janë element shumë me rendësi. Çdo vendbanim duhet të zhvillohet duke u bazuar në potencialin për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofroj shërbime duke marrë parasysh rritjen e popullsisë sipas të dhënave të vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2011 deri 2018, del se në Komunën e Deçanit, për çdo vit kemi shtim natyrore të popullsisë prej 225 banorë. Në fund të vitit 2021, Komuna e Deçanit, kishte 42753 banorë. Si rezultat përllogaritja e rritjes se popullsisë për vitin 2031, popullata e Komunës së Deçanit, do të jetë rreth 45199 banorë vendbanimet në vijim do të zhvillohen sipas funksioneve, Qyteti qendër Komunale dhe vendbanimet si nën qendra: Strellc i Epërm, Irzniq, Isniq, Drenoc, Gramaqel dhe shtrirja e vendbanimeve në Bjeshkët e Deçanit-Pleqe dhe Belle.

1.2.105 Orientimi i zhvillimeve në të ardhmen

Planifikimi i akomodimit, zhvillimit në të ardhmen bazohet sipas kërkesave për zhvillim duke pasur në konsideratë rritjen e popullsisë dhe ekonomisë, ku ky zhvillim përkthehet në sipërfaqe të tokës, që duhet të planifikohet për të akomoduar kërkesat për zhvillim.

Planifikimi parasheh respektim të normave strikte, kufizimit të vendbanimeve me kufirin urban të caktuar, në gjithë territorin e Komunës së Deçanit, sa i përket në aspektin e pozicionit shpërndarës të vendbanimeve, pjesa dërmuese e sipërfaqeve ndërtimore të fshatrave: Isniq, Llukë e Epërme, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, një pjesë e Lloqanit, i takojnë zonës urbane me caktimin e kufirit urban prej 729.75 ha, këto trajtohen

dhe plotësohen sipas kritereve urbanistike të caktuara si zonë urbane. Sipas tipit të vendbanimeve të përqendruara në qytet dhe vendbanimet e shpërndara rurale duke u bazuar edhe në rritjen e popullsisë aktuale të banimit (njësi/banim/ha) në zonën urbane dhe rurale, ku kërkesat për tokë për të akomoduar zhvillimin në 8 vitet e ardhshme për zonë urbane janë afërsisht 50 ha tokë në vendin e quajtur Podi i Gështenjave, kurse në zonën rurale janë afërsisht 120 ha, ku i bie të jetë gjashtë njësi banimi në ha. Përllogaritja e tokës së nevojshme për akomodim të zhvillimit të ardhshëm për banim dhe ekonomi.

Synimi i planit është që zhvillimi të kontrollohet në mënyrë të balancuar dhe kompakt, duke përfshirë të gjitha zonat kadastrale me kufi ndërtimor. Për këtë arsye, dendësia mesatare e banimit në zonën urbane do të rritët nga 23 njësi banimi në hektarë në 55 njësi banimi në hektarë.

Në zonën rurale, zhvillimet do të përqendrohen në qendra të vendbanimeve nëpërmes kufijve për zhvillim. Dendësia mesatare e banimit do të rritët nga 4 njësi banimi për hektarë deri në 12 njësi banimi për hektarë, varësisht nga funksioni i vendbanimit. Kjo do të mundësojë zhvillim më të përqendruar dhe kompakt në të gjitha vendbanimet e Komunës.

Tabela më poshtë paraqet dendësitë e parashikuara për zonën e parë, dytë dhe tretë të qytetit po ashtu edhe në zonat rurale. Alokimi i saktë i dendësive të banimit për çdo pjesë të zonës urbane dhe rurale do të përcaktohet saktësisht në Hartën Zonale të Komunës (HZK). Rrjedhimisht, pas përcaktimit të dendësive për zonë urbane dhe rurale do të përllogaritët saktë sasia e tokës e nevojshme për të mbështetë zhvillimin e ardhshëm, duke u bazuar në tipologjinë e ndërtimit.

1.2.106 Vendbanimet joformale – planifikimi

Në Komunën e Deçanit janë gjithsejtë të identifikuara 8 vendbanime joformale të cila planifikohen ti nënshtrohen procesit të formalizmit. Ky proces do te jetë proces afat gjatë mirëpo në varësi të zhvillimit të kornizës ligjore për trajtimin e vendbanimeve joformale edhe proceseve gjyqësore. Të gjitha vendbanimet joformale i kanë shërbimet sociale, publike, transportit dhe teknike. Problem të këto vendbanime janë çështja pronësore – toka mirëpo edhe shfrytëzimi i ndërtesave siç është rasti i Baballoqit 1 dhe Baballoqit 2 të cilat janë ndërtuar ne pronën komunale me synim të procesit të kolonizimit të këtyre zonave me refugjatet serb nga Kroacia dhe Bosnja në kuadër të programeve “Ju Program” dhe “Solidariteti”. Në përgjithësi janë identifikuar 247 ndërtesa të llojit të banimit individual, dhe 64.81 ha. Në të jetojnë 247 familje dhe përafërsisht 1137 banorë.

1.2.107 Ndërtimet pa leje

Angazhimi ne vitet në vijim është qenë bashkëpunim edhe me banorët të parandalohen ndërtimet pa leje ndërtimore ndërsa të gjitha ndërtimet pa leje të identifikuara ti nënshtrohen trajtimit në bazë të Ligjit nr.08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit N6.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Procesi i trajtimit të ndërtimeve sipas projekt PZHK-së do të ndryshon vetëm në rast se ndryshon korniza ligjore për trajtimin e tyre.

1.2.108 Banimi

Komuna e Deçanit, duke marr për bazë zhvillimin si prioritet ka kërkesat me të mëdha për ndërtesat e banimit kolektiv. Aktualisht janë rreth 21 ndërtesa të karakterit kolektiv në zonën e qytetit duke i përfshirë edhe ato që janë në ndërtim e sipër, me kapacitetin prej 750 njësi banimi. Duhet të theksohet se këto janë të përqendruara përreth qendrës së qytetit, që patjetër është paraparë të përfshihet zgjerimi i qytetit në pjesën perëndimore-pjesa e re e qytetit.

Komuna e Deçanit, do të bëjë përpjekje që ta ruaj çmimin aktual i cili është i përballueshëm për një numër të banorëve por jo për të gjithë, prandaj do të vazhdohet me një strategji lokale fillimisht përmes partneritetit publiko-privat që të ofroj kushte në zbutjen e kostos së banesave dhe po ashtu të siguroj mundësinë për ndërtimin e dy ndërtesa të banimin social në afërsi të ndërtesat ekzistues. Planifikimet tjera për ndërtim do të jenë edhe në zonën e dytë dhe nën zonat tjera urbane.

Tërësia "Zona rurale e Komunës Deçanit" - është zonë e cila do të zhvillohet duke akomoduar veprimtari bujqësore dhe banim. Shfrytëzimet e tokës bujqësore janë të lejuara në këtë zonë: bujqësi, industri e prodhimeve

1.2.109 Shfrytëzimi i tokës – Planifikimi

Mjedisi karakterizohet me diversitet të formave të shumta natyrore si dhe me ndikime të ndryshme të faktorit njeri. Në bazë të veçorive fiziko-natyrore dhe atyre humane Komuna e Deçanit, është e ndarë në tri tërësi natyrore ku përfshihen edhe aktivitetet tjera shoqëroro-ekonomike. Ndarje hapësinore e planifikuar sipas ndarjes fiziko-natyrore dhe atyre humane ndahet në:

- Tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët"
- Tërësinë "Urbane dhe trashëgimia kulturore"
- Tërësinë "Zona rurale e Komunës Deçanit"

Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" : *Kjo pjesë trajtohet ne harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*
Tërësia "Urbane dhe trashëgimia kulturore": *një pjesë e kësaj tërësie trajtohet ne harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*
Tërësinë "Urbane dhe trashëgimia kulturore": pjesa urbane përfshin një sipërfaqe prej 729.75 ha, është bartëse kryesore e zhvillimit administrativ social dhe ekonomik bazuar në interesimin dhe kërkesat e vazhdueshme për zhvillim, në ketë zonë duhet, që hapësirat të jenë të balancuara në gjithë kufirin urbanë. Zona urbane si tërësi ndahet në dy zona: banim, shërbimet administrative dhe shërbime të tjera ekonomike, sociale, parqe dhe hapësira publike.
Zona urbane ndahet në 5 njësi urbane: Njësia qendrore, njësia lindore, njësia jugore, njësia perëndimore dhe njësia veriore.

Njësia qendrore: Është pjesa ma vitale e qytetit të Deçanit e cila ka ndikim ne drejtimin dhe zhvillimin e tërë pjesës perëndimore dhe lindore. Ne kuadër të shfrytëzimit , në pjesën qendrore ekzistojnë numër i madh i NVM, banimi, infrastruktura administrative, arsimore dhe shëndetësore. Kjo zonë në pjesën veriore kufizohet me Lumëbardhin e Deçanit, në pjesën lindore me një pjese të fshatit Llukë e Epërme dhe me një pjesë të Carrabregut të Epërm duke ndjekur rrugët ekzistuese. Ne pjesën jugore me vendbanimin Carrabreg duke e kaluar Carrabregun e Epërm ne drejtimin perëndimor, paralelë me rrugën regjionale R107 në drejtimin verior drejt qendrës se qytetit dhe duke kaluar ne rrugën e Manastirit lidhet më pikën e fillimit. Kërkesat dhe tendencat e zhvillimit të njësisë qendër janë mjaft të larta, si në zhvillimin e NVM, ndërtimet e larta me destinime afariste dhe banesore, qendra biznesi, markete, parkingjet, hapësira publike të gjelbëruara etj. Deri me tani, rruga R107 shërben si arteria kryesore ekonomike me tendencë të zgjatjes ne drejtimin jugor deri të vendbanimi Baballoq në të dy anët e rrugës. E njëjta ka tendencë, duke u bazuar në kërkesat e investitorëve potencial, që të zhvillohet edhe në drejtimin verior – drejt vendbanimit Lybeniq. Kjo vijë afariste brenda njësisë qendër njihet si Korridori ekonomik i Deçanit. Nevojat për banim ne ketë njësi janë të larta dhe propozohet zbatimi i konceptit "qytet kompakt" me zgjerim të kontrolluar ku në rast të zhvillimit të turizmit apo nevojave tjera ekonomike, biznesore dhe kërkesave të investitorëve të respektohet ligji dhe të gjitha normativat teknike për planifikimin hapësinorë për këtë pjesë të qytetit.

Njësia lindore: Është pjesë e cila e paraqet edhe kufirin lindor të qytetit të Deçanit, ajo në perëndim kufizohet me zonën qendër ndërsa në pjesën veriore me zonën veriore. Njësia lindore ka shfrytëzim të kombinuar në mes të banimit individual dhe afarizmit. Tendencat për ndërtim në ketë zonë nuk janë të mëdha mirëpo kjo zonë konsiderohet si potencial ne të ardhmen për zhvillim me synim të zbatimit të konceptit qytet kompakt. Deri në atë periudhë, në ketë zonë lejohet ndërtimi me destinim banimin si dhe zhvillimin e bizneseve – turizmit dhe nevojave tjera ekonomike duke respektuar ligjin dhe normat teknike të planifikimit hapësinorë. Me synim të largimit të automjeteve nga pjesa e njësisë qendër, propozohet që në ketë pjesë të hartohen politikat e qarta të lëvizjes dhe qarkullimit të automjeteve, duke i marr parasysh edhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të nivelit qendror.

Të pjesa e lumit Lumëbardhi i Deçanit, distanca e Vijës ndërtimore nga trupat ujorë të jetë në largësi prej 15 m nga pika e skajshme e anës së jashtme të shtratit të ujërave të mëdha në zonat urbane dhe ku shtrati i ujërrjedhjës është i rregulluar dhe krejt në harmoni me Ligjin për ujërat dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. II neni 3. Inkurajohet që për synim të zhvillimit të turizmit urban dhe rural por edhe atij malor, kjo pjesë të zhvillohet me afarizëm të llojit gastronomi dhe hoteleri me etazhitet sipas normave dhe në harmoni me ligjin.

Njësia jugore: Është pjesë që përfaqëson pjesën jugore të vendbanimit të Deçanit e cila kufizohet ne verilindje me njësinë lindore, ne anën veriore me njësisë qendrore dhe në pjesën veriperëndimore më njësinë perëndimore. Kjo njësi është e dedikuar për banim të ulët me etazhitet sipas normave dhe në harmoni me ligjin. Në ketë njësi lejohet edhe zhvillimi i biznese të cilat mund të janë të kombinuara më banimin individual apo të veprojnë si njësi në vetë. Me synim të largimit të automjeteve nga pjesa e njësisë qendër, propozohet që në ketë pjesë të hartohen politikat e qarta të lëvizjes dhe qarkullimit të automjeteve, duke i marr parasysh edhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të nivelit qendror. Rëndësi e veçantë duhet ti jepet vazhdimësisë së Korridorit Ekonomik të Deçanit e cila e lidhë njësinë qendër nëpërmes njësisë jugore me vendbanimin Baballoq dhe me tutje deri ne kufi me Komunën e Gjakovës. Kjo nënkupton që ky Korridor Ekonomik i Deçanit, mund të ketë kombinime ne zhvillim në mes të afarizmit, gastronomisë, hotelerisë banimit, industrisë, me synim të mbrojtjes së tokës bujqësore dhe kualitative.

Njësia veriore – Është pjesë që e prezanton pjesën ma atraktive në aspektin mjedisor – lumi Lumëbardhi i Deçanit dhe ujë mineral, sportive – stadiumi dhe palestra, kulturore – një pjesë e Zonës së Veçantë të Mbrojtur dhe Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Në ketë njësi, planifikohet të zhvillohet banimi individual me etazhitet të lejuar sipas ligjit dhe normave teknike, të kombinuara me afarizëm të integruar në ndërtesa ose si njësi të veçanta. Kjo njësi karakterizohet edhe me Korridorin Ekonomik të Deçanit i cili zhvillohet ne drejtimin e Pejës. Të pjesa e lumit Lumëbardhi i Deçanit, ndërtimi i ndërtesave individuale nuk lejohet të jetë nën kriteret e parapara me Ligjin për Ujërat dhe Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë njëjtë sipas kritereve sikurse tek njësia lindore. Inkurajohet që për synim të zhvillimit të turizmit urban dhe rural por edhe atij malor, kjo pjesë të zhvillohet me afarizëm të llojit gastronomi dhe hoteleri dhe krejt në harmoni me Ligjin dhe normat teknike kurse *pjesa e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur, trajtohen me Ligjet ne fuqi.*

Njësia perëndimore (Qesta): Kufizohet me njësinë qendër, njësinë veriore dhe njësinë jugore dhe njëkohësisht e definon kufirin lindor të qytetit të Deçanit. Një pjesë e kësaj njësie është trajtuar me Plan Rregullues Urban "Qesta" dhe në ketë zonë kalon porta e grykës së Lloqanit dhe porta e Grykës së Deçanit. Gjithashtu është në zhvillim Qendra Rinore, Kolonia e Artistëve, Qendra e Trashëgimisë Kulturore, pishina e mbyllur me ndërtesa përcjellëse, Fshati Turistik (Podi i Gështenjave) Deçan, shtigje të biçikletave, shëtitore, shtigje për ecje – hiking etj. si dhe Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan. Andaj, edhe zhvillimi i ardhshëm i dedikohet planit të përmendur mirëpo duke e marr parasysh edhe propozimin e ri të rrugës R107 nga niveli qendror. Edhe në ketë njësi planifikohet ndërtimit individual duke respektuar ligjin në fuqi dhe normat teknike si dhe duke i marr parasysh edhe potencialet e zhvillimit me afarizëm të llojit të integruar në ndërtesa apo të veçuara për gastronomi, afarizëm, hoteleri në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit të qëndrueshëm.

1.2.110 Prioritetet strategjike

Turizmi

- Formalizmi i vendbanimeve në Bjeshkët e Deçanit si vende me vlera turistike duke u bazuar ne kornizën ligjore.
- Hartimi i Planeve të Hollësishme Rregulluese për shtatë zonat e rrëze bjeshke – brenda zonës urbane si potenciale për ndërtim të kontrolluar dhe zhvillim
- Planifikimi dhe ndërtimi i kontrolluar në të gjitha pikat e identifikuara si potenciale turistike të bjeshkëve
- Promovimi i turizmit – Ndërtimi i një qendre informative dhe jetësimi i projekteve për zhvillim

Infrastruktura

- Ndërtimi i Autostradës së Dukagjinit e cila kalon nëpër Deçan
- Përfundimi i infrastrukturës rrugore në të gjitha punimet e filluara në Grykën e Deçanit
- Ndërtimi i rrugës transit (unazore-lindje perëndim) në Zonën e Qytetit
- Ndërtimet dhe masat mbrojtëse anti erozive në Shtratin e Lumëbardhit të Deçanit dhe të Lloqanit
- Sigurimi i transportit publik në të gjitha pikat frekuentuese e po ashtu edhe për Zonën Belle e Pleqe
- Sigurimi i transportit publik në të gjitha pikat frekuentuese e po ashtu edhe për Zonën Belle e Pleqe
- Ndërtimi i pendave akumuluese në Lumëbardhin e Lloqanit dhe të Deçanit
- Shpërndarja e rrjetit të ujësjellësit dhe mirëmbajtja e tij në të gjitha vendbanimet e Komunës së Deçanit
- Ndërtimi i fabrike për trajtimin e ujërave të zeza në afërsi të Lumëbardhit të Deçanit
- Vazhdimi i kanalizimit për pjesën e mbetur të zonës urbane dhe fshatrave
- Përfundimi i Elektrifikimit i të gjitha hapësirave ku ka filluar punimi posaçërisht furnizimi me energji në Zonën e Grykës.

Bujqësia

- Përcaktimi i tokave bujqësore për kultivimin e bio-produkteve në Komunën e Deçanit
- Ndërtimi i tregut të kafshëve në hapësirën Komunale në Strellcin e Epërm
- Planifikimi i pikave grumbulluese për artikujt nga agrikultura dhe bimët mjekuese në: Fshatin Irzniq , Drenoc , Strellc, Deçan - Qestë.
- Rivitalizimi dhe mbrojtja e brezit të gështenjave dhe brezit të pishave në hapësirat e rrëze bjeshkëve
- Pastrimi dhe Rivitalizimi i pyjeve në Zonën Urbane
- Planifikimi i tregjeve mobile në Zonën e Qytetit
- Përcaktimi i tokave bujqësore për kultivimin e bio-produkteve në Komunën e Deçanit
- Ndërtimi i tregut të kafshëve në hapësirën Komunale në Strellcin e Epërm.

Arsimi

- Ndërtimi i shkollave në Komunën e Deçanit

Trashëgimia kulturore

- Investimet në trashëgimi – Ndërtimi i Memorialit të Qytetit dhe Restaurimi i Kullave si vlera të trashëgimisë kulturore
- Eksplorimi i plotë dhe formalizmi i hapësirave në Qeli dhe Belle

Ruajtja e Mjedisit

- Ndërtimi i gjashtë impianteve për pastrimin ujërave të zeza - me prioritet ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Fshatin Lumbardhë

Parku i qytetit

- Planifikimi dhe ndërtimi i parkut të Qytetit buzë Rrugës së Manastirit mbi shkollat e mesme deri në zonën e Podit të Gështenjave – Hapësirat e ish Kampit
- Ndërtimi i qendrave për grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe demolomi i tyre

Zhvillimi socio – ekonomik

- Planifikimi dhe ndërtimi i Parkut të Biznesit në hapësirat në Fshatin Dranoc
- Ndërtimi i Qendrës Rinore në afërsinë e Shtëpisë së Komunitetit
- Ndërtimi i dy çerdheve në zonën urbane

1.3 Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal

Projekt PZHK përfshinë gjithë territorin e Komunës së Deçanit - zonën urbane, zonën rurale dhe malore. Ky plan përcakton caqet për tetë (8) vitet e ardhshme duke përfshirë zhvillimin hapësinor-mjedisor, social dhe ekonomik.

Qëllimet e PZHK-së janë:

- Krijimi i një organizimi më racional territorial të përdorimit të tokës dhe lidhjeve ndërmjet tyre, për të balancuar kërkesat për zhvillim me nevojën për të mbrojtur mjedisin dhe për të arritur objektivat sociale dhe ekonomike.
- Të ofrojë vizionin të qartë me qëllimet dhe objektivat për zhvillimin e ardhshëm hapësinor Komunal dhe të përcaktojë programet, politikat e zhvillimit dhe aktivitetet afat shkurtër, afatmesëm dhe afat gjatë për realizimin e qëllimeve dhe arritjen e vizionit të dëshiruara.
- Të forcon pjesëmarrjen dhe gjithë përfshirjen ne vendimmarrje gjatë hartimit dhe zbatimit të PZHK-së duke e rrit ndjenjën e pronësisë ne proceset dhe forcimin e besimit në mes të komitetit dhe institucioneve lokale.
- Të promovoj promovojë resurse natyrore dhe kulturore, mirëqenien dhe kualitetin e jetesës së banoreve, zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm në Komunën e Deçanit.

Për ti arritur këto qëllime, duhet paraprakisht të miratohet PZHK e që nënkupton që të përcjellët procesi i hartimit të këtij dokumenti hapësinorë sipas Ligjit Nr. 04/L-174 dhe udhëzimeve administrative te dala nga ky ligj dhe të merren pëlqimi nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe të miratohet nga Kuvendi Komunal. Përfitimet e Komunës së Deçanit nga PZHK janë në aspektin:

Ekonomik – duke krijuar stabilitet dhe besim për investime, nëpërmes identifikimit të tokave të përshtatshme për zhvillime ekonomike ne zonën urbane dhe rurale dhe të lidhura mirë me transportin rrugor; promovimin e mjedisit të pastër me zhvillim ekonomik miqësor ndaj mjedisit; ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore dhe plotësimin e nevojave të banorëve; dhe marrja e vendimeve ma efikase dhe bashkëkohore.

Social - marrja parasysh e nevojave të banorëve në zhvillimin e politikave lokale; përmirësimi i qasjes dhe lëvizjes së lirë; ofrimi ndërtesave shoqërore dhe shërbyese ne vendet ku ka nevojë; zhvillimi zonave të braktisura me synim të rritjes së cilësisë së jetesës të banorëve, krijimin e mjediseve të këndshme, të shëndetshme dhe të sigurta.

Mjedisor – promovimi i regjenerimit dhe përdorimit të duhur të tokës, ndërtesave dhe infrastrukturës; promovimi i përdorimit të tokës së përdorur “ngjyrë kafe” më parë, minimizimin e ndërhyrjes në tokën e “ngjyrë të gjelbër”, zhvillimin akseve “ngjyre hiri”; ruajtjen e aseteve të rëndësishme mjedisore, kulturore, historike dhe trashëgimore; adresimin e rreziqeve mjedisore (përmbytjet, ndotja e ajrit etj.); mbrojtjen e zonave për rekreacion dhe trashëgimi natyrore; promovimi e politikave të lëvizshmërisë pro mjedisore; dhe promovimi i efiçiencës së energjisë në paraqitjen dhe projektimin e zhvillimit.

1.4 Korniza strategjike

PZHK nuk mund të jetë apo të funksionon si një dokument i vetëm apo i ndarë nga dokumentet tjera strategjike, sektoriale, politikave zhvillimore apo projekteve. Përkundrazi, si dokument shumë disiplinor, ajo krijon lidhshmërinë dhe balancimin në mes të strategjive të niveleve të ndryshme qofshin ato lokal, rajonal,

qendror apo ndërkufitar. Gjithashtu, ajo i merr parasysh edhe dokumentet e të kaluarës nëpërmjet të cilave janë zhvilluar strategji dhe projekte të ndryshme. Duhet të cekët se gjate periudhës se hartimit të projekt PZHK-së, në nivelin qendror kanë qenë në proces hartimi i disa dokumenteve strategjike te cilat kanë ndikim të drejt për drejt në drejtimet zhvillimore të Komunës Deçanit. Ne ketë rast, duhet te ceken:

- Plani Hapësinorë i Kosovës 2010 – 2020+ (PHK), i cili është ende në fuqi mirëpo nga MMPHI gjegjësisht nga Instituti për Planifikim Hapësinorë (IPH) kanë filluar me procesin e hartimit të dokumentit të ri si dhe në vazhdim të HZK -së.
- Projekt - Plani hapësinor i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (PHPKBN) i miratuar dhe në fuqi për trajtimin e Zonës së veçantë të Parkut kombëtar "Bjeshkët e Nëmura" e cila e përfshinë gjysmën e territorit perëndimorë të Komunës së Deçanit.

Sipas U.A. Nr.11/2015, Neni 6 pika 1.5 për informatat për kornizën strategjike të marra parasysh gjatë hartimit të projekt PZHK-së, behët kategorizimi strategjive në:

- Strategjitë sektoriale, afatshkurta, afat mesme dhe afat gjata në nivel lokal dhe qendror.
- Strategjitë prej planeve të mëparshme Komunale.
- Strategjitë rajonale ose strategjitë e Komunave fqinje dhe
- Udhëzime, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit siç janë planifikuar në Planin Hapësinorë të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës.

Strategjitë sektoriale, afatshkurta, afat mesme dhe afat gjata në nivel lokal dhe qendror - të identifikuara gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së janë:

1. Strategjitë prej planeve të mëparshme Komunale - të identifikuara gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së janë:
    - Plani Zhvillimor Komunal i hartuar në vitin 2009 (aprovuar më 27. 03. 2009).
    - Planit Zhvillimor Urban i hartuar në vitin 2009 (aprovuar më 27. 03. 2009).
    - Plani Rregullues Urban Deçan – Zona e parë e qytetit 2011 (aprovuar më 30. 06. 2011).
    - Plani Rregullues Urban i Qestes (aprovuar më 30. 06. 2011).
    - Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim 2015 - 2019 (SKIK) - Qëllimi i kësaj strategjie është krijimi i mënyrave efektive për Komunikim, krijimi i Komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike, krijimi i mjedisit të përshtatshëm nga pushteti lokal dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve.
    - Plani Komunal i veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) 2019 -2021.
    - Plani për Zhvillim Ekonomik Lokal (PZHEL) për vitin 2020.
    - Plani Lokal për Mbrojtjen e Mjedisit (PLMM) 2020 - 2023.
    - Plani për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme 2021 - është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimit të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare
    - Plani lokal për menaxhimin e integruar te mbeturinave (PLMIM) 2021 – 2025 - Qëllimi i këtij plani është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivelin lokal duke harmonizuar interesat e të gjithë artereve publik të cilët ky shërbim I ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe më të qëndrueshëm ku do të krahasohen dhe të vlerësohen te gjitha opsionet e mundshme duke ofruar impiantet e përshtatshme për trajtimin e mbeturinave sipas llojeve
    - Plani lokal i veprimit në mjedis (PLVM) 2022 – 2027 - Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Deçanit është që të identifikoj problemet mjedisore, të përcaktojë prioritetet në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për

problemet prioritare mjedisore, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse.

- Plani Komunal për menaxhimin të mbeturinave (PKMM) 2023 – 2027 - është dokument planifikimi që e mundëson zhvillimin e integruar të Menaxhimit te Mbeturinave. Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave do të kontribuoj në menaxhimin me efecientë të mbeturinave në territorin e Komunës, në zbatimin të politikave në pajtim më Strategjinë e Integruar për menaxhimin e mbeturinave në nivel nacional.
- Draft Plani i Veprimit Komunal për Energjinë dhe Klimën (PVKEK) 2023 – 2030 - Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) është dhënia e kontributit domethënës për zvogëlimin e CO2 të emetuar në nivel Komunal përmes masave te EE, BRE dhe promovimit qe kontribuon edhe në nivel vendi, edhe ne arritjen e caqeve të efiçiencës së energjisë dhe burimeve te ripërtritshme të energjisë.
- Plani lokal për Menaxhimin e Mbeturinave Inerte nga Ndërtimi dhe Demolimi (PKMMIND) është dokument planifikimi i cili e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal duke i kontribuar zbatimit të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare.
- Plani objektet e vjetra te cilat paraqesin rrezik për qytetaret nga shembja ne territorin e Komunës Deçanit - Në këtë plan është bërë vlerësimi i ndërtesave të cilat paraqesin rrezik shembje ne të gjithë territorin e Komunës Deçanit, gjithashtu është bërë vlerësimi I shkallës së rrezikshmërisë se tyre si dhe masat të cilat duhet të merën për zvogëlimin e rrezikut, reagimin, rimëkëmbjen, dhe evitimin e pasojave nga këto ndërtesa me qellim te mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit.
- Plani - Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në territorin e Komunës së Deçanit si dhe gjendja e urave në tërësi.
- Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ne territorin e Komunës Deçanit - Me këtë Vlerësim identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në Komunën e Deçanit, si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre. Gjithashtu, me këtë vlerësim identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin e rreziqeve, reagimin , rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë dhe katastrofat me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri.
- Zhvillimi socio-ekonomik i Komunës Deçanit – paraqet të dhënat socio - ekonomike të Komunës së Deçanit deri në vitin 2019.

2. Strategjitë rajonale dhe strategjitë e Komunave fqinje – të identifikuara gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së janë:
    - Strategjia për zhvillim rajonal (SZHR) 2020 - 2030 – Vizioni i kësaj strategjie është zhvillimi i balancuar dhe i qëndrueshëm rajonal, me rritje të kohezionit socio-ekonomik e territorial, të bazuar në praktikat më të mira të BE-së dhe në specifika zhvillimore lokale në Republikën e Kosovës. Për të arritur ketë strategji, janë identifikuar disa qëllime strategjike të cilat kanë të bëjnë me koordinimi i politikave për zhvillim rajonal, zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale, shfrytëzimi i resurseve natyrore, kulturore dhe humane në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.
    - Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë – vizioni i kësaj strategjie është të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis, në të njëjtën kohë gjersa shtohen mundësitë për biznes dhe punësim dhe tranzicion drejt një ekonomie qarkore të harmonizuar me normat dhe standardet evropiane. Për të arritur ketë vizion, janë

identifikuar disa qëllime strategjike siç janë zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave, profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave, forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit, Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore.

- Strategjia e zhvillimit rajonal 2010 – 2013 për Kosovën perëndimore - Eured – RDA West - është strategji e fokusuar në vizionin e përbashkët të Komunave perëndimore të Kosovës duke u bazuar në pozitën e tyre gjeografike, potencialet natyrore me synim të zhvillimit të ardhshëm të qëndrueshëm pa e kompromentuar dhe degraduar për gjeneratat e ardhshme. Vizioni e konsideron pjesën perëndimore të Kosovës si një rajon i përshtatshëm për të jetuar dhe vizituar me potenciale te mjaftueshme për punësim dhe klimë të mirë për investime. Ky vizion arrihet nëpërmes disa qëllimeve siç janë:
    - Zhvillimit të kontrolluar ne zonat malore, zonat për zhvillim siç është (korridori Istog - Gjakovë), dhe në zhvillimin e zonave rurale – bujqësore.
    - Zhvillimi i transportit rajonal dhe
    - Rritja e kualitetit të jetesës për banorët e këtij rajoni.

  Qëllimet e lartë përmendura mund të arritën nëpërmes veprimeve konkrete të cilat janë të orientuara në zhvillimin e agro – bizneseve, prodhimtari bazuar ne resurset vendore dhe përpunim, turizëm dedikuar mbrojtjes mjedisit si dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu, rendësi i është dhënë edhe shfrytëzimit të gjitha lidhjeve ndërshtetërore respektivisht pikave kufitare me synim të zhvillimit të korridoreve brenda rajonit dhe lidhjes-qasjes së lehtë me vendet fqinje siç janë Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia. Andaj është e rëndësishme që edhe në projekt PZHK-në të merren parasysh prioritetet strategjike të dala nga ky dokument e të cilat kanë të bëjnë me Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, Krijimin e mirëqenies dhe punësimit dhe Krijimin e fuqisë punëtore të aftë për punësim.
- Strategjia rajonale për promovim të investimeve në rajonin perëndimor të Kosovës - Eured – RDA West – e cila ka të bëjë me promovimin e mundësive investive në rajoni perëndim duke krijuar paraprakisht klimë të mirë të investimit. Promovimi i mundësive të investimeve i përfshinë, kapacitetet njerëzore, burimet natyrore duke mbrojtur mjedisin, trashëgiminë e kulturën, zhvillimin e zonave ekonomike pastaj me prioritet janë zhvillimi i sektorit te bujqësisë, turizmit, teknologjia informative, shërbimet e biznesit dhe financiare. Për të arritur promovimin sa ma të mirë të zonës perëndimore synohet themeli mekanizmave të cilat bëjnë promovimin e këtij rajoni, mbështetja nga institucionet lokale (dhe qendrorë) ne fushën e edukimit dhe aftësimit profesional dhe brendimi i këtij rajoni i bazuar ne produkte, shërbime dhe kualitet të jetesës.
- Strategjia rajonale për transport në rajonin perëndimor të Kosovës – Eured – RDA Ëest – është strategji e cila ka për synim përmirësimin dhe zhvillimin e transportit (të njerëzve dhe mallrave) e cila nuk ndikon negativisht ne kualitetin e jetesës së banorëve dhe e zhvillon sektorin e biznesit ne mënyrë të qëndrueshme. Me vizionin e kësaj strategjie synohet zhvillimi i transportit të integruar, efikas dhe të qëndrueshëm. Për të plotësuar synime duhet të ofrohet transport publik që qëndrueshëm, zhvillimi i rrjetit të mallrave, rritja e sigurisë rrugore, zhvillimi i politikave të qëndrueshme të lëvizshmërisë dhe përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve të transportit.
- Strategjia rajonale e zhvillimit te turizmit ne rajonin perëndimor të Kosovës – Eured -RDA West – Gjetjet e kësaj Strategjie Rajonale të Turizmit për rajonin ekonomik perëndimor të Kosovës* sugjerojnë se zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të turizmit duhet të bazohet në burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, të cilat paraqesin një avantazh konkurrues të këtij rajoni. Resurset natyrore përfshijnë terrenet malore që mbulojnë Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna të themeluar nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor të vitit

2012, parkun rajonal të kanioneve të Mirushës dhe lokacione të tjera përgjatë luginave të rajonit. Dokumenti strategjik sugjeron se ekzistojnë kushtet e duhura për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dimëror dhe veror, duke ofruar atraksione turistike si aktivitete të ndryshme sportive dhe rekreative, shërbime shëndetësore dhe kurative, si dhe duke promovuar eko-turizmin dhe agroturizmin. Strategjia synon të krijojë kushte për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, që do të promovonte Kosovën perëndimore si destinacion turistik dhe do të përmirësonte imazhin e përgjithshëm të vendit si një vend i sigurt dhe tërheqës. Qëllimi është gjithashtu të jepet një kontribut për kohezionin social dhe ekuilibrin e zhvillimit në rajon dhe në aspektin ndërkufitar.

- Strategjia Rajonale për Turizëm – Plani i Veprimit - synon realizimin sa më të suksesshëm të objektivave strategjike për të mbështetur zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin ekonomik në rajon. Plani i zbatimit përforcon objektivat e strategjisë rajonale për turizëm duke u bazuar në burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore për të krijuar një përparësi konkurruese në rajon dhe më gjerë. Tutje, ky plan zbatimi parasheh modelet e zhvillimit të turizmit më një infrastrukturë të përmirësuar, shërbime më cilësore dhe marketing më të zhvilluar dhe më shumë aktivitete në promovimin e destinacionit
- Plani regjional i trashëgimisë 2012 - 2015 – është plan në të cilin ndërlidhen mënyra të ndryshme se si trashëgimia prek pjesë të ndryshme të jetesë sonë dhe i shndërron ato në një strategji funksionale për të ardhmen. Ky plan i ka veprimet e bashkërenduara mes të gjitha palëve përmes aktivizimit të grupeve lokale, palëve me interes dhe Komuniteteve për t'u angazhuar drejtpërdrejtë në trashëgimi, dhe për t'i përdorur mjetet teknike qofshin ato shoqërore, ashtu edhe ekonomike për të siguruar mbrojtjen e saj. Qëllim tjetër i këtij plani nuk është vetëm bartja e trashëgimisë tek gjeneratat e ardhshme, por edhe e mjeteve me anë të së cilave do të mund të vazhdohet mbrojtja dhe mirëmbajtja e tyre. Përmes Planit të trashëgimisë për Kosovën perëndimore eksplorohen mënyrat për të ndërmjetësuar mes nivelit lokal dhe atij global.
- Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "BJESHKËT E NEMUNA".
- Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020 - 2028 – i cili e ngrit çështjen e rrugës Istog – Pejë - Deçan – Gjakovë – Prizren me synim të lidhjes me Shqipërinë. Në anën tjetër qasjen me Malin e Zi edhe nëpërmes zhvillimit të politikave të turizmit respektivisht me zhvillimin e zonës EST nëpërmes kompleksit turistik "Borea" e cila lidhet me bjeshkët e Deçanit dhe dalje në Malin e Zi. Gjithashtu, në ketë drejtim me synim të zhvillimit rajonal rendësi i është dhënë edhe bashkëpunimit në mes të Pejës, Deçanit dhe Junikut për turizmin e qëndrueshëm, ku është themeluar edhe Organizata për Menaxhim të Destinacionit – Perëndim (OMD- Perëndim). Komuna e Pejës, deri më tani i konsideron banorët e Deçanit si një nga vizitorët më të rregullt të zonave turistike në Pejë. Duke e marr parasysh që Peja është qendër administrative ne ketë qytet ndodhet edhe Kujdesi dytësor shëndetësor e cila shfrytëzohet edhe nga banorët e Deçanit. Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, citohet se zona perëndimore e Kosovës derdhjet e ujërave i bëjnë ne lumenjtë në të cilën ceket edhe Lumëbardhi i Deçanit, duke e theksuar se për mbrojtën e tyre nevojitet veprimi i përbashkët i Komunave. Në kundërt të projekteve konkrete ceken:
    - Ndërlidhja me bjeshkët e Deçanit me qasje në bjeshkët e Malit të zi dhe Shqipërisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar si dhe zhvillim të agroturizmit.
    - Ridefinimi i rrugëve transit Pejë - Vitomiricë, Pejë – Deçan
- Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2017 - 2025 – ne të cilën bashkëpunimi rajonal respektivisht me Komunën e Deçanit shihet vetëm në zhvillimin e infrastrukturës rrugore ne nivel rajonal të cilat janë rrjedhojë e strategjive te nivelit qendrorë.
- Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011 – 2023 – është propozuar që të ndërtohet hekurudha që lidhë Komunat Pejë – Deçan – Junik – Gjakovë. Përmendet edhe shfrytëzimi

i QKMF-së nga disa fshatra të Komunës se Deçanit të cilat janë në kufi me Komunën e Junikut. Rendësi i është dhënë edhe lidhjes rrugore me Komunën e Deçanit, respektivisht me fshatin Voksh (rrugë regjionale), si dhe krijimi i akseve të reja të cilat kalojnë ne territorin e Deçanit mirëpo i shkurtojnë distancat e Komunës Junikut me Deçanin dhe Gjakovën. Në fushën e zhvillimit turistik, Komuna e Junikut parasheh që të harmonizohen politikat e zhvillimit të turizmit me Komunën e Deçanit me theks te veçantë te pjesa e Bjeshkës së Belegut. Komuna e Junikut i len të hapura të gjitha bashkëpunimet rajonale ndër Komunale dhe ndër kufitare dhe ketë e konsideron si mundësi e mirë.

- Resurset Natyrore në Rajonin Perëndimor të Kosovës - Qëllimi i kësaj strategjie është identifikimi i të gjitha resurseve natyrore që i ofron rajoni perëndimor i Kosovës të cilat mund ta ndihmojnë zhvillimin rajonal në sektorët e turizmit ndër Komunal dhe ndërkufitar.

3. Udhëzime, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit siç janë planifikuar në Planin Hapësinorë të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës - të identifikuara gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së janë:
    - Plani Hapësinorë i Kosovës 2010 – 2020+ - Në Planin Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020 + (PHK) Komuna e Deçanit së bashku me Komunën e Rahovecit, Malishevës dhe Komunën e Gjakovës si qendër më e madhe Komunale bëjnë pjesë në "Urat e Kosovës" respektivisht "Hapësira e Verdhë" e cila karakterizohet me shërbime tregtare e turistike, agro-industriale dhe industri e lehtë. Komuna dominuese ne ketë pjesë është Komuna e Gjakovës andaj njihet edhe si rajoni i Gjakovës dhe planifikohet ne të ardhmen lidhja ndërkufitare me Shqipërinë duke e forcuar bashkëpunimin ne mes Rrafshit të Dukagjinit me pjesën veriore të Shqipërisë me qasje në bregdetin shqiptarë. Kjo lidhje gjegjësisht korridor, e forcon zhvillimin ekonomik ne mes të këtyre dy vendeve, e ringjallë kulturën, traditat dhe zakonet e te kaluarës si dhe i ofron Kosovës dalje të drejt për drejt në portin e Shëngjinit.

    Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura të cilat janë të identifikuara ne Komunën e Deçanit si pjesë e "Hapësirës së Verdhë" në PHK janë:

    - Maja e Ropsit, Deçan – rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut.
    - Kozhnjeri, Deçan – rezervat shtazor i llojit të dhisë së egër.
    - Malet e Prilepit, Deçan – rezervat bimor me përbërje të panjës malore.
    - Bliri në Isniq, Deçan – monument natyror me karakter botanik.
    - Bliri në Strellc të Epërm, Deçan - monument natyror me karakter botanik.
    - Trungjet e Blirit në Isniq, Deçan – Monumente natyrore me vlera të rralla botanike.
    - Pishat e Deçanit, Deçan – Përbërja e pastër e pishës së zezë.

    Si Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM) ne Komunën e Deçanit sipas PHK-së është:

    - Manastiri i Deçanit, Deçan.

    Sikurse në dokumentin e PZHK-së, njëjtë edhe në PHK janë të definuar deklaratat e vizionit të rajoneve të Kosovës të përcjella me qëllimet e përgjithshme, me analizën e përparësive, mundësive dhe mangësitë, konflikteve dhe sinergjive si dhe zonat me interes të veçantë. Për rajonin e Gjakovës ku përfshihet edhe Komuna e Deçanit, deklarata e vizionit është:

    Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.




Figura 5. Pjesë nga Plani Hapësinorë i Kosovës 2010 – 2020 +

Qëllimet e përgjithshme janë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, nder urbanë me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Sa i përket konflikteve të identifikuara në skenarin e zhvillimit të "Hapësirës së Verdhë" janë shtrirja e vendbanimeve në tokën bujqësore, zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve, dhe zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore. Ndërsa, sinergjitë e identifikuara në skenarin e zhvillimit të "Hapësirës së Verdhë" janë zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore. Zonat hapësinore me interes te veçantë për Kosovën në "Hapësirën e Verdhë" janë:

- Aeroporti i Gjakovës,
- Kanioni i Drinit të Bardhë me Urën e Fshejtë,
- Parku rajonal i Mirushës,
- Miniera e kromit në Devë,
- Liqeni akumulues - Radoniqi
- Manastiri i Deçanit,
- Çarshia e Madhe - Gjakovë,
- Kullat e Dukagjinit,
- Kalimet kufitare (Prush e Morinë).

Në Komunën e Deçanit, ndodhet edhe Manastiri i Deçanit i cili do të trajtohet me Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Sipas këtij ligjit, respektivisht Neni 2 *"Zonë e Veçantë e Mbrojtur" do të jetë një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik. Zona e Veçantë e Mbrojtur e Manastirit të Deçanit është e identifikuar edhe në hartën e PHK-së.*




Figura 6. Kufiri i Zonës së Veçantë të Mbrojtur

Trajtimi i Zonës së Veçant të Mbrojtur është nën përgjegjësinë e MMPHI-së respektivisht IPH.

4. Dokumentet tjera ndërkombëtare të cilat kanë ndikim në rritjen e kualitetit të jetesës dhe mirëqenies se banorëve, siç janë:

- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 2030[2]
- Agjenda Urbane e BE-së[3]
- Instrumentet për ndihmën e para anëtarësimit (IPA) Programi CBC 2014 - 2020 Mali i Zi – Kosovë (IPA) - është dokument ndërkufitar i cili mbulon një gamë të gjerë temash që janë analizuar dhe që konsiderohen të jenë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të zonës së programit, duke filluar nga ekonomia rajonale, papunësia, bujqësia, turizmi, arsimi, shëndetësia, kultura dhe natyra, shoqëria civile, me infrastrukturën, kuadrin ligjor dhe mjedisin. Këto lëndë janë studiuar dhe analizuar tërësisht duke përdorur metodologjinë e analizës Politike, Ekonomike, Sociale, Teknologjike, Ligjore dhe Mjedisore (PESTLM). Si rezultat i gjetjeve të mësipërme dhe në konsultim të ngushtë me të gjitha palët e interesuara janë përzgjedhur tre prioritete tematike për Programin CBC 2014 - 2020 Mali i Zi-Kosovë, me objektivat specifike të mëposhtme:
- Promovimi i punësimit, lëvizshmërisë së punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit: përmirësimi i qasjes në tregun e punës dhe inkurajimi i grupeve të cenueshme shoqërore për të marrë pjesë në shoqëri
- Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut: përmirësimi i mjedisit, menaxhimit të mbetjeve (uji dhe të ngurta) dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe zvogëloni erozionin e tokës dhe promovoni ruajtjen e tokës.

[2] Home - United Nations Sustainable Development
[3] Urban Agenda for the EU | Futurium (europa.eu)

2 PROFILI KOMUNAL

Profili Komunal paraqet përmbledhjen e informatave te përgjithshme mbi gjendjen aktuale gjeografike, fizike, sociale dhe ekonomike. Ajo e prezanton pozitën e Komunës së Deçanit, rëndësinë ne çështjet specifike te Komunës brenda kontekstit të Kosovës, benë krahasim të gjendjes lokale me sektorët e ndryshëm të nivelit qendror dhe me normat teknike, ofron informata ne rëndësishme në lidhje me udhëzimet dhe detyrimet që rrjedhin nga dokumentet e miratuara ne nivel lokal dhe qendror.

2.1 Historia e Zhvillimit

Deçani apo ndryshe siç është quajtur dikur Ulëza, shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës. Të dhënat historike flasin për Deçanin që nga koha e antikitetit ku gjurmët arkeologjike dëshmojnë së në këtë pjesë ka ekzistuar procesi i organizuar i jetës. Gjithashtu dëshmitë tregojnë se ne ketë zonë kanë jetuar fiset ilire të njohur si Dardanet. Gjurmët autoktone ne territorin e Deçanit janë etnografike, kulturore, historike, toponimike, topografike, arkeologjike dhe antropologjike. Këtë e dëshmojnë edhe dokumentet arkivore Austriake dhe Turke. Edhe sot e kësaj dite, në Komunën e Deçanit më rrethinë ekzistojnë gjurmët e mbi shtatë (7) kishave katolike Ilire dhe toponimeve tjera siç është Veku i Kaurreshës, pastaj gjurmët e Tumave Ilire, materialet dekorative nga stolitë deri tek stelat, e dëshmitë tjera.

Shënimet e para të shkruara, në të cilat përmendët Deçani janë në Kristobulën e vitit 1330. Në vitin 1330, pjesë e Deçanit me rrethinë ishin 40 fshatra me 2432 shtëpi. Kopja e Kristobulës së Deçanit është gjetur në shekullin XIX, e cila padrejtësisht ende ruhet në Arkivin e Serbisë. Objekt i rëndësishëm monumental dhe fetar është Manastiri i Deçanit, ky manastir është vepër që ruan elemente të stilit të ndërtimit perëndimor (Shqiptaro-Dalmate). Në arkitrarin e portalit jugor të narteksit gjendet një mbishkrim i gdhendur i arkitektit shqiptar dom Vita Kuçi. Është ruajtur e dhëna se dom Vita Kuçi me 30 gurskalitës ndërtoi Manastirin e Deçanit. Ky manastir është ndërtuar në themelet e një kishe të vjetër Ilire (paleokristiane).

Në kohën e sundimit osman, kjo trevë ishte në kuadër të Sanxhakut të Dukagjinit me qendër në Pejë. Treva e Deçanit, sikurse edhe e tërë Kosovës, ishte nën sundimin Osman. Mirëpo, kjo pjesë i bëri përherë qëndresa atij sundimi, duke organizuar forma të ndryshme të rezistencës, sidomos gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Vlen të përmendim këtu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878, Lidhjen e Pejës, pastaj Kuvendi i Parive i mbajtur në Isniq në prill 1910, i mbajtur në Kullën e Osdautaj, ky Kuvend ka një rëndësi të veçantë ngase aty u unifikuan krerët e Parive, duke bërë Lidhjen e Besës, e cila ishte shumë e rëndësishme, për rrethanat e kohës dhe organizimin e kryengritjes së vitit 1910. Kështu, jehona e Kuvendit të Parisë dhe Lidhjes së Besës të Verrat e Llukës, shumë shpejt u përhap në mbarë Vilajetin e Kosovës, dha kontribut shumë të madh edhe në Kryengritjen e vitit 1912, si rezultat i saj u shpall Pavarësia e Shqipërisë.

Më fillimin e luftës së Parë Botërore, kah fundi i vitit 1915, në këto treva u vendos pushteti dhe administrata Austro-Hungareze, e cila zgjati deri në vitin 1918. Më ri-pushtimin e kësaj treve nga pushteti Serbo-Malazias në vitin 1918, u vendos organizimi territorial, sikurse në viset tjera të pushtuara. Deçani në atë kohë ishte në kuadër të Rrethit të Pejës dhe Rrethit të Gjakovës.

Me ndryshimet administrative, territoriale, në vitin 1929, treva e Komunës së Deçanit, ishte në kuadër të Banovinës së Zetës. Në kohën e Luftës së Dytë Botërore, treva e Deçanit ishte në kuadër të zonës nën administrimin Italian deri në vitin 1943, e pas kapitullimit Italian ishte nën sundimin Gjerman.

Në fund të vitit 1959, suprimohen rrethet dhe forcohet sistemi Komunal. Komuna e Deçanit, formohet si Komunë në veti, e cila deri në vitin 1963, quhet Këshilli Popullor i Komunës, ndërsa prej vitit 1963, me ndryshimet kushtetuese quhet Kuvendi i Komunës së Deçanit. Më 1974 Kosova fitoi

elementin konstituiv në Federatën Jugosllave.

Në vitin 1989, u bë suprimimi i organeve të Kuvendit të Komunës së Deçanit. U vendos administrata e dhunshme Serbe. Mirëpo, në anën tjetër popullata Shqiptare u organizua dhe formoi organet paralele. Edhe Deçani, funksionoi si organ paralel në kuadër të Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të luftës së armatosur me pushtetin serb që ndodhi në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe 1999, Deçani me rrethinë doli nga lufta i shkatërruar pothuajse 99 %. Përpos dëmtimeve materiale, duhet të veçohen edhe viktimat lufta për liri ku ranë dëshmorë 270, martirë të vrarë 124, zhdukur 73, invalid të UÇK-së 400 dhe veteranë të UÇK-së 3800.

Kosova u vu nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, u bë organizimi dhe vendosja e organeve Komunale. Komuna e Deçanit, si njësi territoriale-administrative në pajtim me dispozitat e Rregullores për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 2000/45 e UNMIK-ut dhe Rregullores Nr. 2007/30 dy vite (2007-2009) pas këtyre akteve nënligjore, Kuvendi i Kosovës shpallë Pavarësinë e Kosovës me 17 shkurt 2008. Pas Pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës aprovon organizimin e Komunave në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

2.2 Gjendja ekzistuese e Komunës

2.2.1 Pozita gjeografike e Komunës Deçanit

Komuna e Deçanit, ndodhet në perëndim nga kryeqyteti i Prishtinës ne distancë 88 km vij ajrore, në Rrafshin e Dukagjinit rrëzë Bjeshkëve të Nemuna në koordinatat 42°32'00"N dhe 20°17'00"E. Ka pozitë të mirë gjeografike në rrugën magjistrale Pejë – Gjakovë – Prizren që e lidhë pjesën veriore dhe jugore të Dukagjinit. Vija ajrore me Detin Adriatik është 90 km, ndërsa përmes Pejës lidhet me hekurudhën që e lidh Dukagjinin me Fushë Kosovën. Në pjesën perëndimore kufizohet me Republikën e Shqipërinë nëpërmes qafës së Morinës dhe ofron mundësitë mira të lidhjes me vendbanimet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Në veri perëndim kufizohet me Malin e Zi ndërsa në verilindje kufizohet me Komunën e Pejës. Në lindje pjesërisht kufizohet me Komunën e Gjakovës ndërsa në jug dhe jug perëndim kufizohet me Komunën e Junikut. Nga Peja është larg 15 km, nga Gjakova 21 km, nga Prizreni 58 km, dhe nga Prishtina 94 km.




Figura 7 Pozita e komunës Deçanit ne Kosovë

Komuna e Deçanit, shtrihet në një sipërfaqe prej 293,94 km² e ndarë në qytetin e Deçanit, lagjet urbane dhe fshatrat. Deçani është qendër administrative, politike, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore ndërsa territori i Komunës i përfshinë (përpos qytetit të Deçanit) edhe 37 vendbanime tjera - fshatra: Baballoq, Beleg, Belle, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm, Dashinoc, Drenoc, Dubovik, Dubravë, Shaptej, Gllogjan, Gramaqel, Hulaj, Irzniq, Isniq, , Kodrali, Lëbushë, Lloqan, Llukë e Epërme, Llukë e Ulët, Lumbardh, Maznik, Vranoc i Vogël, Papiq, Pleqe, Pobergjë, Pozhar,

Prapaqan, Prilep, Prokolluk, Rastavicë, Ratishë i Epërm, Ratishë i Ulët, Sllup, Strellc i Epërm, Strellc i Ulët dhe Voksh.


Sipërfaqja e Komunës Deçanit e përben 2.69 % të sipërfaqes së përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe renditet si Komuna e 20-ta për nga madhësia e territorit Komunal.

Renditja e komunave sipas madhësisë se territorit komunal					
Renditja	18	19	20	21	22
Komuna	Klinë	Malishevë	Deçan	Rahovec	Drenas
Sipërfaqja km²	309	306	293	276	275
% ne raport me sipërfaqen e përgjithshme te Kosovës	2.83	2.81	2.69	2.53	2.52


Tabela 3. Renditja e Komunave sipas madhësisë së territorit komunal

Lartësia mbidetare lëvizë nga me e ulëta në fshatin Maznik 412 m dhe me e larta që përfshinë masivin e Bjeshkëve të Nemuna, Majën e Gjeravicës me 2656 m lartësi mbidetare. Në sajë të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit, ndahet në dy pjesë:


- Në ultësirë që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit
- Në lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare).



Harta 1. Reliefi



Harta 2. Përbërja gjeologjike




Harta 3. Llojet e tokave (përbërja pedologjike)

2.3 Demografia

Demografia është studimi statistikor i popullatave njerëzore dhe është pjesë e rëndësishme e projekt PZHK-së sepse e shqyrton madhësinë, strukturën dhe lëvizjet e popullatës në hapësirë dhe kohë. Për të pas një pasqyre të qartë të demografisë ne Komunën e Deçanit duhet të merret parasysh e kaluara respektivisht nga historia e këtij vendi, zhvillimi ekonomik ne të kaluarën, antropologjia, aspekti social dhe fusha të tjera. Demografia është e dobishme për qeveritë si një mjet për të analizuar dhe parashikuar tendencat sociale, kulturore dhe ekonomike që lidhen me popullsinë. Ekzistojnë tre variabile kryesore të cilat kontribuojnë në ndryshimin e popullsisë e ato janë lindshmëria, vdekshmëria dhe migrimi. Për regjistrimin e popullsisë ne Kosovë përgjegjës është Agjencinë e Statistikave të Kosovës – ASK, agjenci e cila është e specializuar edhe për vlerësimin e popullsisë së Komunave në baza vjetore. Në Kosovë regjistrimi zyrtar i popullsisë është bërë në vitin 1948, 1953, 1961, 1971 dhe 1981. Regjistrimin e vitit 1991 shqiptarët e kanë bojkotuar si përgjigje ndaj masave të dhunshme të pushtetit serb dhe të dhënat e prezantuara nga Regjistrimi nga Enti Federativ i Statistikës në Beograd për ketë vit janë supozime. Regjistrimi i vitit 2001 nuk është realizuar sepse në ketë vit Kosova sapo ishte çliruar nga lufta dyvjeçare dhe kushtet për regjistrimin e popullsisë nuk ishin të favorshme. Regjistrimi zyrtarë i radhës i banorëve rezident që jetojnë në Kosovë është ai i vitit 2011 i kryer nga ASK dhe mund të konsiderohet jo i plotë sepse pakicat serbe e kanë bojkotuar ketë regjistrim.

Madhësia e familjeve në Komunën e Deçanit nga viti 1948 ka pas trend të rritjes deri në vitin 1981, kurse të dhënat e vitit 1991 nuk mund të konsiderohen si të sakta sepse në ketë vit regjistrimi i popullsisë është bojkotuar nga shqiptarët. Regjistrimi i vitit 2011 tregon rrënje të madhësisë së familjes ndërsa nga ky vit e deri në vitin 2023, madhësia e familjes mund të bazohet vetëm në të dhënat në nivel nacional.



Harta 4. Komuna e Deçanit dhe madhësia e vendbanimeve sipas numrit të banorëve

Madhësia mesatare e ekonomive familjare ne Komunën e Deçanit								
1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2012	2013
7.6	7.8	7.7	8.4	8.8	8.5	6.8	5.87	5.68
2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
5.62	5.71	5.50	5.21	4.90	4.98	4.92	4.85	4.85

Tabela 4. Madhësia mesatare e ekonomive familjare në Komunën e Deçanit


Vërejtje: *Madhësia mesatare e ekonomive familjare ne Komunën e Deçanit janë nga viti 1948 deri te viti 2011. Nga viti 2012 e deri te viti 2022 të dhënat për madhësinë e ekonomisë familjare janë ne nivel nacional sepse te dhënat e sakta për nivel Komunal nuk janë bërë publike. Po ashtu mungojnë edhe të dhënat e ekonomive familjare për Komunën e Deçanit të ndara në zonën urbane dhe zonën rurale. Të dhënat e madhësisë së ekonomisë familjare janë marr nga VSRK nga viti 2014 deri 2023 e të cilat janë bazuar në Anketat e Fuqisë Punëtore – AFP.*

Viti	Ekonomitë familjare		Popullsia		Madhësia e familjes (numri i anëtarëve në Ekonomi Familjare)	
	Komuna	Qyteti (vendbanimi Deçan)	Komuna	Qyteti (vendbanimi Deçan)	Komuna	Qyteti (vendbanimi Deçan)
1948[4]	2355	188	17840	1205	7.6	6.4
1953	2447	226	19223	1339	7.8	5.9
1961	2882	327	25552	1829	7.7	5.6
1971	3281	431	31335	2585	8.4	6.0
1981	4014	519	35577	3280	8.8	6.3
1991[5]	5049	721	42898	4440	8.5	6.1
2011[6]	5887	602	40019	3803	6.8	6.3
2020[7]	-	-	42480		4.92[8]	-
2021[9]	-	-	42490		4.85[10]	-


Tabela 5. Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë në periudhat 1948 – 2011 për Komunën e Deçanit

Në tabelën e sipërme prezantohen të dhënat në nivel të Komunës dhe zonës urbane për numrin e ekonomive familjare, popullsinë dhe numrin mesatarë të anëtarëve në ekonomitë familjare për të gjitha periudhat e regjistrimit nga viti 1948 deri në vitin 2011, si dhe të dhënat nga Vjetari Statistikor të Republikës së Kosovës (VSRK) për vitin 2020 dhe 2021. VSRK i vitit 2023 nuk i përfshinë të dhënat e vitit 2022[11]. Numri i popullsisë në qytetin e Deçanit, qe nga viti 1948 deri në vitin 2011, ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 22179 banorë. Pra, në bazë të kësaj rritje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare (1948 – 2011), rezulton se mesatarisht popullsia ne Komunën e Deçanit ka shënuar rritje me 352 banorë në vit. Por nëse i marrim dhe krahasojmë të dhënat statistikore të vlerësimit të popullsisë të prezantuara nga ASK në vitin 2011 - 2021, kjo e dhënë ndryshon dhe rritja mesatare vjetore e popullsisë është 247 banorë në vit.

[4] Regjistrimi nga Enti Krahinor i Statistikave të Kosovës
[5] Regjistrimi nga Enti Federativ i Statistikës në Beograd
[6] Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) 2011
[7] Vjetari Statistikor i Republikës se Kosovës (ASK) 2021
[8] Mesatarja ne nivel të Republikës Kosovës – Vjetari statistikor 2021
[9] Vjetari Statistikor i Republikës se Kosovës (ASK) 2023
[10] Mesatarja ne nivel të Republikës Kosovës – Vjetari statistikor 2021
[11] Vjetari Statistikor i Republikës Kosovës 2023 (faqe 49) Untitled-1 (rks-gov.net)



Grafiku 1. Populllsia e Komunës së Deçanit gjatë viteve: 1948 – 2011 dhe vlerësimet nga viti 2012 – 2021



Harta 5. Dendësia e popullatës

Viti	Numri i banorëve	Rritja e natyrale	Rritja natyrale në %	Rritja nga viti 1948	Rritja nga viti 1948 ne %
1948	17840	-	-	-	-
1953	19223	1383	7,75	1383	7,75
1961	22230	3007	15,64	4390	24,61
1971	27478	5248	23,61	9639	54,03
1981	35577	8099	29,47	17737	99,42
1999	42898	7321	20,58	25058	140,46
2011	40019	-2879	-6,71	22179	124,32
2012	40614	598	1,49	22774	127,66
2013	40549	-65	-0,16	22709	127,29
2014	40847	298	0,73	23007	128,96
2015	41173	326	0,80	23333	130,79
2016	41480	307	0,75	23640	132,51
2017	41808	328	0,79	23968	134,35
2018	42070	262	0,63	24230	135,82
2019	42244	174	0,41	24404	136,79
2020	42480	236	0,56	24640	138,12
2021	42490	10	0,02	24650	138,17

Tabela 6. Rritja natyrale e popullsisë nga viti 1948 – 2021[12]

Sipas të dhënave rritja e popullsisë në Komunën e Deçanit nga regjistrimi i viti 1948 deri të regjistrimi i vitit 2011 është 124 % ose me një mesatare prej 13% rritje për çdo regjistrim zyrtarë, ndërsa nëse merren parasysh edhe vlerësimet e rritjes së popullsisë deri ne vitin 2021 atëherë rritja e popullsisë është 138 % me një rritje mesatare prej 6 % në çdo regjistrim.

	Demografia numri I popullsisë sipas vendbanimeve, 2011	Popullsia
1	Baballoq	1598
2	Beleg	826
3	Belle	8
4	Carrabreg i Epërm	1446
5	Carrabreg i Ulët	2059
6	Dashinoc	299
7	Deçan	3793
8	Drenoc	1046
9	Dubovik	1060
10	Dubravë	278
11	Gllogjan	984
12	Gramaqel	1097
13	Hulaj	158
14	Irzniq	1739
15	Isniq	3871
16	Kodrali	808
17	Lëbushë	1145
18	Lumbardh	717
19	Lloqan	499
20	Llukë e Epërme	1451
21	Llukë e Ulët	506
22	Maznik	447
23	Papiq	174
24	Pobergjë	1314
25	Pozhar	424
26	Prapaqan	740
27	Prokolluk	288
28	Prilep	2165
29	Rastavicë	1238

[12] Nga viti 2012 deri ne vitin 2021 te dhënat janë te bazuara ne vlerësimin e popullsisë nga Vjetari Statistikor i Republikës se Kosovës 2023

30	Ratish i Epërm	210
31	Ratish i Ulët	560
32	Sllup	338
33	Strellc i Epërm	3347
34	Strellc i Ulët	2114
35	Shaptej	591
36	Voksh	570
37	Vranoc i Vogël	111
	Gjithsej në Komunë	40,019
	Gjithsej në Kosovë	1.739.825


Tabela 7. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve në vitin 2011

2.3.1 Familja dhe karakteristikat e saj


Në qytetin e Deçanit, mesatarisht familjet i kanë nga 6.3 anëtarë, ndërsa mesatarja e anëtarëve të familjes në Komunën e Deçanit, është 6.8 anëtar sipas Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011.

Viti	Ekonomitë Familjare		Popullsia			Pjesëmarrja e qytetit në Komunë %	
	Urban	Rural	Komuna	Qyteti vendbanimi	Vendbanimet rurale	Ekonomitë Familjare	Popullsia
1948	2355		17840	1205	16635	8.0	6.7
1953	2447		19223	1339	17884	9.2	7.0
1961	2882		22230	1829	20401	11.3	8.2
1971	3281		31335	2585	28750	13.1	9.4
1981	4014		35577	3280	32297	12.9	9.2
1991	5049		42898	4440	38458	14.2	10.3
2011	602	5285	40019	3803	36216	10.2	9.5


Tabela 8. Numri i ekonomive familjare dhe pjesëmarrja e qytetit në Komunë nga viti 1948 – 2011



Grafiku 2. Ekonomitë familjare në zonën urbane dhe rurale



Grafiku 3. Ekonomitë familjare urbane dhe rurale në përqindje



Grafiku 4. Numri i popullsisë në zonën urbane dhe rurale

Sipas Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011, në Komunën e Deçanit më se shumti ka familje mbi 10 anëtarshe (17%) mirëpo edhe familje 5 anëtaresh (17%) dhe të përcjella nga familjet 6 anëtaresh (16%) dhe prej 7 anëtaresh (11%).

Numri i anëtareve në ekonomi familjare sipas regjistrimit të vitit 2011										
Anëtarët	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10+
Komuna e Deçanit	142	302	351	637	1001	983	699	445	310	1017
	2%	6%	7%	10%	17%	16%	11%	7%	6%	17%
Nivel nacional	8556	19051	24514	46966	57720	48523	32158	19064	11606	28932


Tabela 9. Numri i anëtarëve në ekonomi familjare sipas regjistrimit të vitit 2011

Ekonomitë familjare ne Komunën e Deçanit dhe ne nivel nacional						
	Urban	%	Rural	%	Gjithsejtë	%
Komuna e Deçanit	602	0.4	5285	3.12	5887	1.98
Nivel nacional	128131		168959		297090	

Tabela 10. Përqindja e ekonomive familjare në Komunën e Deçanit (urban dhe rural) në raport me nivelin nacional

2.3.2 Struktura e popullsisë sipas grup - moshave dhe gjinisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Struktura e përgjithshme e popullsisë sipas gjinisë është e pothuajse e baraspeshuar: meshkuj 20,125 dhe femra 19,894.



Grafiku 5. Struktura e popullsisë sipas grup moshës dhe gjinisë

Grafiku prezanton të dhënat për strukturën e popullsisë sipas grup - moshave prej 0 - 4 vjeç deri në moshën 80 e më tepër vjeç duke u bazuar në regjistrimin e vitit 2011. Nga grafiku shihet që grup - mosha 15 – 19 vjeç dominon me numër të popullsisë në krahasim me grup - moshat tjera.


Struktura e popullsisë sipas gjinisë është meshkuj 50.3 % dhe femra 49.7%, ku pas analizës së të dhënave, del se në grup - moshat 30 – 49 dhe 50 e më shumë vjeçare dominon gjinia femërore që do të thotë se në Komunën e Deçanit, jetëgjatësia e femrave është më e lartë se jetëgjatësia e meshkujve. Mosha e re 1 - 14 vjeç merr pjesë me 26.2 % në popullsinë e Deçanit, ndërsa grup - moshat 15 - 64, që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjesë me 66.4 % dhe është pjesa më dominuese e popullatës. Mosha 65 vjeç e më tepër kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 7.4 % të popullsisë së përgjithshme.

Përbërja e popullsisë sipas grupeve te moshës dhe gjinisë															
Grupi1			Grupi 2			Grupi 3			Grupi 4			Grupi 5			
0 - 4 vjeç			5 - 14 vjeç			15 – 19 vjeç			20 - 64 vjeç			≥ 65 vjeç			
M	F	Σ1	M	F	Σ2	M	F	Σ3	M	F	Σ4	M	F	Σ5	
1747	1616	3363	3696	3412	7108	2174	2007	4181	11647	10752	22399	1543	1425	2968	
8.4%			17.8%			10.4%			56%			7.4%			

Tabela 11. Përbërja e popullsisë sipas grupeve te moshës dhe gjinisë


2.3.1 Shkollimi dhe aktiviteti i popullsisë

Si kriter i vlerësimi të shkollimit të popullsisë në Komunën e Deçani është marr mosha 6 deri 29 vjeç sipas vlerësimit të ASK-së. Bazuar në këto të dhëna, Komuna e Deçanit duhet të harton politika të qëndrueshme sa i përket edukimit ku shkollimin e vijojnë më se shumti nxënësit e shkollës fillore të nivelit 1-5, pastaj ka një ulje të dukshme nga niveli 6-9. Kjo ulje reflektohet edhe në shkollimin e mesëm të lartë të nivelit 10-13 për të vazhduar me gati 50% ma pak vazhdimin e studimeve në Kolegje / Universitete. Një numër shumë i vogël kanë vazhduar studimet pas Universitare / Kolegje për të përfunduar me një numër tejet të vogël të nivelit të doktoratës. Shqetësuese mbetet fakti se nga hulumtimi rezulton se numri ma i madh i moshës 6 deri 29 nuk e vijojnë shkollimin.



Grafiku 6. Popullsia 6 deri 29 vjeç që vijon shkollimin sipas nivelit të vitit 2011

Komuna e Deçanit hynë në kategorinë e Komunave të cilat kanë përqindje të kënaqshme të popullatës aktive për punë. Të dhënat tregojnë se 66.4 % e popullatës nga mosha 15-65 vjeç janë të aftë për punë e që paraqet tregues të mirë për investitorë sa i përket fuqisë punëtore. Këto të dhëna janë të bazuara në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë në vitin 2011. Regjistrimi i ri do të tregon gjendjen e re dhe do te ndikon ne hartimin e politikave të qëndrueshme sektoriale për punësim.



Grafiku 7. Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit 2011[13]

2.3.2 Popullsia në Komunën e Deçanit sipas etnisë

Komuna e Deçanit karakterizohet me diversitet etnik të popullsisë ku sipas regjistrimit të vitit 2011 kjo Komunë dominohet nga komuniteti shqiptarë, egjiptian, boshnjak, ashkali, rom, serb, goran, kurse të tjerë, nuk janë deklaruar dhe nuk ka të dhëna.

[13] Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011 ASK

Përkatësia etnike										
	Shqiptarë	Egjiptian	Boshnjak	Ashkali	Rom	Serb	Goran	Te tjerë	Nuk janë deklaruar	Nuk ka te dhëna
Meshkuj	19823	204	30	21	19	0	1	3	0	0
%	50	52	50	50	57	0	100	16	0	0
Femra	19579	189	30	21	14	3	0	16	2	0
%	50	48	50	50	43	100	0	84	100	0
Gjithsejtë	39402	393	60	42	33	3	1	19	2	64
%	98	0.9	0.06	0.05	0.03	0.001	0.001	0.01	0.001	0.06

Tabela 12. Përkatësia etnike

Krahasimi i përbërjes etnike në mes të Komunës se Deçanit dhe Kosovës tregojnë disa dallime sa i përket përbërjes etnike. Në të dy rastet etnia shqiptare dominon ndërsa ne nivel nacional etnia boshnjake është e dyta ndërsa të Komuna e Deçanit ajo është e treta. Etnia serbe ne nivel nacional është e treta, ndërsa ne Komunën e Deçanit ajo është e gjashta. Ne Komunën e Deçanit etnia egjiptian është e dyta ndërsa në nivel nacional ajo është e pesta, gjithnjë duke ju referuar regjistrimit zyrtarë të popullsisë ne vitin 2011. Pjesa ma e madhe e etnisë egjiptian janë në Baballoq dhe Gramaqel ndërsa ajo boshnjake ne Prapaqan dhe Dubovik etj. Te dhënat e ASK-së tregojnë se në të gjitha vendbanimet e Komunës Deçanit, etnia shqiptare është shumicë.

Përkatësia etnike ne Komunën e Deçanit dhe ne nivel nacional										
	Shqiptarë	Egjiptian	Boshnjak	Ashkali	Rom	Serb	Goran	Te tjerë	Nuk janë deklaruar	Nuk ka te dhëna
Gjithsejtë Në Komunën e Deçanit	39402	393	60	42	33	3	1	19	2	64
Gjithsejtë ne nivel nacional	1616869	11524	27533	15436	8824	25532	10265	5104	0	0

Tabela 13. Përkatësia etnike në Komunën e Deçanit dhe në nivel nacional

2.3.3 Religjioni i popullatës

Komuna e Deçanit si shumica e Komunave në Kosovë është Komunë me shumicë të besimit islam, pastaj nga ai katolik dhe ortodoks. Një numër i vogël është pa besim mirëpo ekziston edhe një numër i banorëve pa të dhëna për besimin e tyre.

Përbërja e popullatës sipas besimit ne Komunën e Deçanit dhe ne nivel nacional							
	Islam	Katolik	Ortodoks	Te tjera	Pa besim	Nuk ka te dhëna	Gjithsejtë
Komuna e Deçanit	39343	408	11	21	2	234	40019
	98.8%	1%	0.02%	0.04%	0.002%	0.5%	100%
Nivel Nacional	1,663,412	38,438	25,837	1,188	1,242	2,495	1,739,825
	95%	3%	1.6%	0.03%	0.03%	0.14%	100%

Tabela 14. Përbërja e popullatës sipas besimit ne Komunën e Deçanit dhe ne nivel nacional

2.3.4 Dendësia e popullsisë

Bazuar në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në Komunën e Deçanit, është 100 – 150 banorë ne 1 km², (rreth 144 banorë në 1 km²), që është nën mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe

dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Regjistrimi zyrtar i popullsisë i vitit 2011 respektivisht 01. Prill – 31. Dhjetor 2011 është pikënisje e çdo vlerësimi duke e përfshirë edhe lindjet dhe vdekjet. Të dhënat e përditësuar dhe të publikuara nga ASK për lindjet dhe vdekjet janë analizuar për të pas figurë të qartë të trendit të rritjes së popullsisë. Këto të dhëna tregojnë se në Komunën e Deçanit trendi i lindjeve është ma i lartë se i vdekjeve.

Viti	Lindje	Gjinia		Vdekje	Gjinia		Shtimi natyror
		Meshkuj (%)	Femra (%)		Meshkuj (%)	Femra (%)	
2022	535	51	49	224	48	52	311
2021	554	47	53	279	56	44	275
2020	514	50	50	253	59	41	261
2019	452	52	48	183	44	56	269
2018	532	51	49	195	50	50	337
2017	570	49	51	174	63	37	396
2016	620	47	53	152	53	47	468
2015	707	47	53	138	59	41	569
2014	639	52	48	153	59	41	486
2013	496	55	45	156	54	46	340
2012	600	51	49	151	56	44	449
2011	562	50	50	113	61	39	449

Tabela 15. Lindjet dhe vdekjet sipas gjinisë nga viti 2011[14]

Sipas tabelës së sipërme shihet se nataliteti më i lartë në Komunën e Deçanit ka qenë në vitin 2015 me 707 lindje ndërsa mortaliteti më i lartë është shënuar ne vitin 2021 me 279 vdekje. Shtimi natyror ma i madh është shënuar ne vitin 2015 me 569 banorë ndërsa ai më i vogli është i vitit 2020 me 261 banorë e cila korrespondon me periudhën e pandemisë COVID19. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e sipërme, nga viti 2011 deri te vlerësimi ne vitin 2022 ka pas një mesatare prej 565 lindje ne vit (gjinia 50 % meshkuj dhe 50 % femra) dhe mesatarisht 181 vdekje në vit (gjinia 56 % meshkuj dhe 44 % femra) ose me rritje natyrale prej 384 banorë. Nëse llogarisim këto dy të dhëna me numrin e përgjithshëm të popullsisë ne vitin 2011 atëherë mund të përfundojmë se për periudhën 2011 - 2022 lindshmëria ne Komunën e Deçanit është 17% ndërsa vdekshmëria 5.42%. Nga këto nxjerrim se shtimi natyror në Komunën e Deçanit është 11.50 % duke mos i marr parasysh lëvizjet e migrimit. Ky shtim prej 11.50% i ndarë nga viti 2011 deri 2022 tregon se shtimi natyror për çdo vit është me një mesatare prej 1.04 %.

Sa i përket lindjeve dhe vdekjeve në Komunën e Deçanit në raport me nivelin nacional, ajo luan rol te vogël në krahasim me Komunat e mëdha fqinje siç janë Komuna e Pejës dhe e Gjakovës apo Komunat tjera siç janë Komuna e Prishtinës, Ferizajt apo Prizrenit. Të dhënat tregojnë se nga viti 2019 deri 2021 Komuna e Deçanit kishte ndikim me mesatare prej 0.18 % ne numrin e lindjeve dhe 0.17 % në numrin vdekjeve.

Demografia, lëvizjet natyrore sipas vendbanimeve								
Vendbanimet	Lindjet dhe vdekjet							
	Viti i vlerësimit 2022		Viti i vlerësimit 2021		Viti i vlerësimit 2020		Viti i vlerësimit 2019	
	Lindjet	Vdekjet	Lindjet	Vdekjet	Lindjet	Vdekjet	Lindjet	Vdekjet
Gjithsej ne Komunë	535	224	554	279	514	253	452	183
Gjithsej ne Kosovë	31420	11378	29236	14845	27709	14457	25795	10501
	17%	0.19%	0.18%	0.18%	0.18%	0.17%	0.17%	0.17%

Tabela 16. Demografia, lëvizjet natyrore sipas vendbanimeve

[14] Të dhënat e siguruara nga Agjencinë e Statistikave të Kosovës

Në përgjithësi rezulton që Komuna e Deçanit në 63 vitet e fundit, ka pas rritje konstante të numrit të popullsisë për 22,179 banorë (nga 17,840 në vitin 1948 në 40019 në vitin 2011).

Regjistrimet zyrtare të popullsisë të viteve 1971,1981,1991 dhe 2011, si dhe vlerësimet nga viti 2012 deri 2021, janë përdorur për të vlerësuar rritjen e popullsisë në Komunën e Deçanit, si dhe për kalkulimin e popullsisë së përafërt për vitin 2031. Dihet që një numër i caktuar i banorëve të Deçanit jeton në migrim dhe në vitet e fundit, migrimi ka qenë një faktor i rëndësishëm i cili ka ndikuar ne numrin e popullsisë.

2.3.5 Migrimi

Shpesh mendohet se migrimi është një fenomen i kohëve të fundit por megjithatë migrimi ka qenë një tipar që nga koha e ekzistencës njerëzore për shekuj me radhë. Migrimi gjithmonë ka qenë individual apo në grupe dhe synimet kanë qenë pothuajse të njëjta siç janë: për të fituar lirinë nga lufta dhe konfliktet e ndryshme, për ti shpëtuar urisë dhe varfërisë, jo tolerancës fetare, shtypjes politike, për rritjen e cilësisë së jetës nëpërmes gjetjes së mundësive të reja ekonomike dhe punësimi, për tregti dhe udhëtime në vende tjera të botës.[15]

Çdo kontinent në botë i ka disa vende tërheqëse për migrim si rezultat i synimeve të cekura ma lartë. Evropa gjithmonë ka qenë e synuar për migrim nga vendet tjera që janë jashtë këtij kontinenti mirëpo migrimet ekzistojnë edhe brenda vet Evropës, ku 1.9 milion është numri imigrantëve të cilët kanë hyrë ne Evropë vetëm në vitin 2020. Në vitin 2021 numri i emigrantëve është 23.7 milion ne krahasim me 447.2 milion sa është numri i përgjithshëm i popullsisë ne Evropë. Shtetet e synuara janë Gjermania, Franca, Spanja, Italia, Zvicra, Holanda, Austria, Belgjika e kështu me radhë.[16]

Kosova historikisht njihet si vend me migrim të lartë ku synimet e migrimit kanë qenë të ndara në periudha të ndryshme. Si vend i cili ka qenë i ndikuar mjaft nga luftërat përkundër migrimit të lartë, numri i popullsisë ne Kosovë gjithmonë ka pas rritje. Në shekullin e fundit, migrimi në Kosovë ka qenë i ndikuar nga dhuna dhe persekutimi i vazhdueshëm nga okupuesit. Pas Luftës së Dytë Botërore ka ekzistuar edhe një trend i ri i migrimit ndërkombëtarë – ai për një jetë më të mirë dhe të sigurt.

Persona të cilët jetojnë jashtë Kosovës sipas Komunës së lindjes, gjinisë dhe vendit të qëndrimit aktual, 2014					
	Meshkuj	%	Femra	%	Gjithsejtë
Gjermani	2321	58	1690	42	4011
Zvicër	1683	55	1398	45	3081
Te tjera	410	56	324	44	734
Austri	401	58	289	42	690
Amerikë	279	62	170	38	449
Suedi	192	53	169	47	361
Belgjikë	159	59	109	41	268
Francë	128	58	92	42	220
Itali	54	57	40	43	94
Angli	34	64	19	36	53
Slloveni	16	59	11	41	27
Gjithsejtë	5677	58	4311	42	9988

Tabela 17. Persona të cilët jetojnë jashtë Kosovës sipas Komunës së lindjes, gjinisë dhe vendit të qëndrimit aktual, 2014

Ne vitet e ’90 të shekullit të kaluar, ky trend ka qenë deri diku i nevojshëm për shkak të rritjes së varfërisë dhe nevojës për sigurimin e ekzistencë mirëpo edhe për shkak të shumë luftërave të zhvilluara në rajon dhe dhunës së ushtruar ne Kosovë ne përgjithësi. Pas vitit 1999 Kosova vazhdon të jetë ne hartën e shteteve me migrim ma të lartë, gjegjësisht mendohet se çdo e katërta familje në

[15] “Migrimi dhe kultura” - Robin Cohen (1995)
[16] “Statistikat e migracionit dhe popullsisë migrante” - EUROSTAT

Kosovë e kanë një anëtarë të tyre në migrim.[17] Ky trend i migrimi ka vazhduar ne nivele alarmante. Përkundër statistikave, qëllimi i emigrantëve ishte stabilizimi ekonomik individual mirëpo edhe ndihma ekonomike e familjes së mbetur në Kosovë. Këto të ardhura, kanë ndikuar mjaft në mirëqenien e familjeve ne Kosovë por edhe ndikim pozitiv në ekonominë kosovare ne përgjithësi. Ky trend i ndihmesës nga migrimi ka qenë evident edhe në të kaluarën, të tanishmen mirëpo me shumë bindje, kjo do të jetë edhe në të ardhmen.
Sipas ASK gjegjësisht *"Persona të cilët jetojnë jashtë Kosove sipas Komunës së lindjes, gjinisë dhe vendit të qëndrimit aktual, 2014"* migrimet nga Komuna e Deçanit me se shumti kanë qenë në Gjermani te pasuara nga Zvicra, dhe më se paku në Slloveni.

Siç u cekë ma lartë, nëpër të gjitha këto faza ka kaluar edhe Komuna e Deçanit ku si Komunë, Deçani njihet si vend e cili ka mjaft popullatë të migruar ne vendet e ndryshme të Evropës. Shtetet më mikpritëse dhe të synuara janë Gjermania dhe Zvicra, mirëpo duke mos mbet shumë prapa as shtetet tjera siç janë Belgjika, Suedia, Italia, Franca, Austria etj. Migrimi nga Deçani është evident edhe përtej oqeanit respektivisht në SHBA dhe Kanada. Pozitive është se ndihmat financiare nga mërgimi në Komunën e Deçanit asnjëherë nuk janë ndalur dhe ato kanë qenë konstante dhe mjaft domethënëse për ekonominë lokale. Një tipar tjetër me rëndësi është se mërgimtaret apo siç njihen edhe si diaspora, e ndjejnë për obligim që periudhën e pushimeve verore dhe dimërore ti kalojnë në vendlindje. Sipas të dhënave të ASK-së përkundër shtimit natyral të popullsisë ne Komunën e Deçanit, ndikim ne ngadalësimin e trendit të rritjes së popullsisë ka luajtur edhe migrimi ndërkombëtar por edhe ai kombëtarë. Arsyet e migrimit nga Komuna e Deçanit sipas ASK janë:

Personat te cilët jetojnë jashtë Kosovës dhe arsyeja e largimit (2014)						
Punësim	Studim	Familjare	Lufta 98/99	Te tjera	Nuk ka te dhëna	Gjithsejtë
3299	86	4696	930	572	405	9988
33%	1%	47%	9%	5%	4%	100%

Tabela 18. Personat te cilët jetojnë jashtë Kosovës dhe arsyeja e largimit (2014)

Migrimi kombëtar në Komunën e Deçanit janë për arsye punësimi me 5 %, arsimi 5 %, familjare 50 %, luftës 10 % dhe për tjera 30 %.

Viti	Migrimi ndërkombëtarë			Migrimi kombëtarë			Bilanci i përgjithshëm i migrimit
	Imigrimi[18]	Migrimi[19]	Bilanci I migrimit ndërkombëtarë	Imigrimi	Migrimi	Bilanci I migrimit kombëtarë	
2021	59	289	-230	108	143	-35	-265
2020	27	23	4	91	120	-29	-25
2019	32	83	-51	134	178	-44	-95
2018	34	67	-33	132	174	-42	-75
2017	29	53	-24	135	179	-44	-68
2016	307	426	-119	130	172	-42	-161
2015	247	453	-206	121	158	-37	-243
2014	127	276	-149	128	167	-39	-188
2013	0	0	-336	0	0	-39	-375
2012	0	0	0	0	0	0	-124
2011	0	0	-47	0	0	-29	-76
Gjithsejtë			-1191	Gjithsejtë		-380	-1571

Tabela 19. Bilanci i përgjithshëm i migrimit (ndërkombëtarë dhe kombëtarë)[20]

Sipas tabelës së sipërme, viti 2013 konsiderohet si vit me migrimin ma të lartë ne Komunën e

[17] "Migrimi dhe Zhvillimi Ekonomik në Kosovë" – Banka Botërore (Raport Nr. 60590 – XK),
[18] "Imigrimi - veprimi i ardhjes për të jetuar përgjithmonë në një vend të huaj" – Oxford language,
[19] "Migrimi - akti i largimit nga vendi i vet për t'u vendosur përgjithmonë në një tjetër; duke lëvizur jashtë vendit" – Oxford language,
[20] Regjistrimit I popullsisë ne vitin 2011 dhe vlerësimi I popullsisë ne 2012 -2021

Deçanit, ndërsa ai më i ultë është viti 2020. Bilanci i përgjithshëm i migrimit sipas publikimeve nga ASK-ja është 1571 banorë ose e përafërt me numrin e banorëve të fshatit Baballoq, Carrabreg i Epërm, Llukë e Epërme apo Pobergjë.

Nëse i marrim parasysh bilancet në raport më numrin e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 e deri në vlerësimin e vitit 2021 atëherë mund të konstatojmë se migrimi ndërkombëtar është 2.97 % ndërsa ai kombëtarë është 0.94 % ose në total 3.92 %. Kjo në baza vjetore tregon se migrimi ndërkombëtarë është 0.27 % ndërsa migrimi kombëtarë është 0.08 % ose bilanci i përgjithshëm është 0.35 %.

Duke iu referuar të dhënave të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migrimit mund të përfundojmë se shtimi natyror në Komunën e Deçanit gjatë periudhës 2011 – 2021 është 6.83 % ose 0.62 % për çdo vit ndërsa nëse e paragjykojmë për vitin 2022 atëherë shtimi do të jetë 6.94 % ose 0.62 % për çdo vit.

2.3.6 Burimet kryesore të jetesës

Burimet kryesore te jetesës ne Komunën e Deçanit janë kryesisht nga puna, mbështetjet e ndryshme dhe remitancat. Burimet e bazuar nga puna dhe mbështetjet tjera janë te gjeturat nga ASK ndërsa sa i përket remitancave ato nuk janë te njohura edhe pse Komuna e Deçanit ka numër te madh te mërgimtarëve.

Rastet sociale për vitin 2022 ne Komunën e Deçanit janë 315 familje.

Demografia, burimet kryesore të jetesës, sipas numrit të banoreve			
Vendbanimet	Punë	Mbështetje	Remitancat
	Popullsia	Popullsia	Popullsia
Gjithsej ne Komunë	2848	1296	
Gjithsej ne Kosovë	390281	922464	92317

Tabela 20. Burimet kryesore të jetesës, sipas numrit të banoreve

2.4 Veçoritë mjedisore

2.4.1 Pedologjia, gjeologjia dhe toka

Rrafshi i Dukagjinit, është krijuar në periudhën gjeografike - neogjen. Nga lëvizjet tektonike krijohet një liqe që përfshinë tërë Rrafshin e Dukagjinit. Nga mesi i periudhës së Laçerit, niveli i ujit të liqenit fillon të ulët dhe më vonë, fillon të tërhiqet përmes luginës së Drinit të Bardhë.

Zona kadastrale e Komunës Deçanit ndodhet ne zonën gjeologjike – tektonike te Bjeshkëve te Nemuna, kurse pjesa lindore në zonën e Mirditës (Ofiolitike). Këtu mund te gjejmë shkëmbinjtë e moshave të ndryshme nga ma të rinjtë që ndodhen në pjesën fushore e në disa pjesë të Bjeshkëve të Nemuna deri te ata më të vjetër të cilët i ndërtojnë Bjeshkët e Nemuna. Në krijimin e relievit të zonës kadastrale të Deçanit, përveç tektonikës, rol të rëndësishëm kanë pasur proceset gjeologjike, në veçanti ato fluvioglaciale. Zona urbane është vendosur në sendimente fluvioglaciale dhe liqenore, të cilat kanë mbetur nga liqeni neogjen i Dukagjinit dhe proceset lumë – akullnajore në pleistocen dhe më vonë ku sendimentet dallohen për nga sortimi jo i mirë. Në pjesën perëndimore të zonës kadastrale , e cila shtrihet në Bjeshkët e Nemuna hasen shkëmbinjtë e vjetër të moshës paleozoike, siç janë metagranitet, mermerët dhe rreshpet epidot-kloritike, ndërsa në afërsi të zonës urbane hasën filitet e ranorët e moshës triasike.

Qyteti i Deçanit ndahet në kontaktin morfologjik ndërmjet fushëgropës së Dukagjinit dhe maleve të larta të Bjeshkëve të Nemuna, në të djathtë të Lumëbardhit të Deçanit. Disniveli i madh hipsometrik ndërmjet fushëgropës dhe maleve të larta ka ndikuar në krijimin e grykës së thellë ë të ngushtë të Lumëbardhit, por edhe më gjerë.

Si rezultat i kushteve të ndryshme natyrore, në territorin e zonës kadastrale të Deçanit hasen dy formacione tokësore me bonitet të ndryshëm. Në pjesën fushore hasen toka kualitative, ndërsa llojet e veçanta janë aluvionale dhe tokat e kuqërremta – kafe. Në pjesët e larta malore tokat janë jocilësore si litosoli dhe rankeri, që janë toka të cektë si rezultat i shpëlarjes dhe i proceseve erozive. Territori i larmishëm me disnivel të madh hipsometrik dhe kushtet e llojllojshme klimatike kanë ndikuar në paraqitjen e diversitetit vegjetativ, që ndryshon krahas rritjes së lartësisë mbidetare. Derisa në pjesët e poshtme sipërfaqja është e mbuluar me bimësi të kultivuar, në pjesët më të larta shtrihet vegjetacioni i shkurreve kalimtare, pyjet gjetherënëse, pyjet e përziera, halorët dhe në fund kullosat dhe majat e zhveshura[21].

Përbërja pedologjike - Sipas përbërjes pedologjike, tokat në territorin e Komunës së Deçanit janë të përfaqësuar si në vijim:

- Tokë pseudoglej - 9066,44 ha
- Tokë e kuqërremtë - 5590 ha
- Tokë aluviale - 5305.82 ha
- Tokë ranker - 5170 ha
- Tokë e murrmë në shtresat kompakte - 2160.2 ha
- Tokë e kuqe - 678.79 ha
- Tokë deluviale - 636.81 ha
- Tokë e livadheve - 632.58 ha
- Tokë litosole - 156.38 ha

Gjeologjia - Sa i përket përbërjes gjeologjike, territori i Komunës së Deçanit në masë të madhe është i ndërtuar nga gurët ranor, filit, rreshpe klorite, konglomerat, çert dhe gurë gëlqeror 5082.73 ha, sendimente liqenore dhe lumore 4215.46 ha, shkëmbinj metagranitikë (shkëmbinjtë kataklastikë skistozë) - 3196.01 ha, tarracë lumore - 3115.68 ha, ortoskist (epidot, aktinolit dhe shist klorit) - 2717.83 ha etj.

Përbërja gjeologjike	Sip/ha	Përbërja gjeologjike	Sip/ha
Aluvium	2868	Metadiabaza	117
Fushë gurore	311	Metagabro	3
Deluvium	98	Shkëmbinj metagranitikë (shkëmbinjtë kataklastikë skistozë)	3196
Diabazë, spilit, basalt	19	Ortoskist (Epidot, aktinolit dhe shist klorit)	2718
Sendimenti glacial (morenë)	718	Proluvium	894
Granit	35	Gëlqere e kuqe dolomit cefalopod	190
Sendimenti liqenor dhe lumor	4215	Tarracë lumore	3116
Gëlqeror, dolomit	446	Rërë, argjilë, zhavorr, pjesërisht tufit linjit	583
Gëlqeror, dolomit, brecia	429	Gur ranor, filit, reshpe klorite, konglomerat, çert, gur gëlqeror	5083
Sendimenti limno -glacial	537	Serpentinit	152
Mermer, gëlqere e rikristalizuar	1171	Seri sedimentarësh vullkanike	47

Tabela 21. Përbërja gjeologjike e Komunës Deçanit

2.4.2 Mineralet

Materialet ndërtimore, ku një sasi e shkëmbinjve të fortë silikat në Komunën e Deçanit ekzistojnë në pjesën e Bjeshkëve të Deçanit që kanë mundësi të përdoren në ndërtimtari. Deri më tani, shkëmbinjtë e fortë silikatë janë hulumtuar dhe shfrytëzuar rrallë dhe për shkak të cilësisë së tyre të lartë ata mund të bëhen burim i rëndësishëm i mineraleve ndërtimore në të ardhmen. Shfrytëzimi kryesor i mundshëm i shkëmbinjve të fortë silikatë, si lëndë e parë ndërtimore, është prodhimi i agregateve si dhe perspektiva e shfrytëzimit si gurë dekorativë dhe dimensional. Vendburimet e shkëmbinjve të fortë silikatë me vlera të larta gjenden kryesisht në pjesët veriore, verilindore dhe

[21] Vendbanimet e Kosovës – tabloja fizike – hapësinore, demografike dhe funksionale Vëllimi I Qendrat urbane. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

lindore të Deçanit. Në bazë të rezultateve të Planit të Guroreve të Kosovës (PGK), rekomandohet intensifikimi i hulumtimeve gjeologjike për shkëmbinjtë e fortë karbonatikë. Janë hulumtuar dhe verifikuar rezerva të konsiderueshme të gëlqerorëve, të cilët përdoren si materiale gjeologjike në ndërtimtari dhe industri. Mermeri dhe gëlqerorët e mermerizuar gjenden kryesisht në sasie konsiderueshme në Komunën tonë dhe përdoren si gurë dekorativë. Paraqitjet e mermerit në Komunën tonë paraqiten në formë mermerit brekçiozë në pjesën e Uzbilit në Grykën e Deçanit, i cili mund të përdoret si gurë dekorativë dhe dimensional. Në Komunën e Deçanit janë të pranishme vetëm tri paraqitje të dolomitëve dhe analizat e pakta të hulumtuara kanë dhënë vlera të MgO (Oksidi i Magnezit) deri në 16 %. Kështu, ata janë të klasifikuar si gëlqerorë dolomitikë. Dolomitët si të tilla gjenden në Grykën e Deçanit , Grykën e Lloqanit dhe Bjeshkët e Deçanit. Vendburimet e travertinit janë të kufizuara në burimin e ujit mineral afër apo Gushavcit, i cili ka cilësi të mira kurative – shëndetësore.

Rëra dhe zhavorri në Komunën e Deçanit ka përbërje minerale dhe kokrrizore të përshtatshme, gjë që është e përshtatshme si lëndë e parë për prodhimin e betonit. Rezervat e rërës dhe zhavorrit në Komunën e Deçanit janë të koncentruar në shtretërit e lumenjve të Lumëbardhit të Deçanit dhe Lloqanit, dhe për shkak të aktiviteteve të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit, ka pjesë të peizazhit të këtyre lumenjve që janë dëmtuar ku vlerësohet që resurse totale të rërës dhe zhavorrit janë rreth 3310 m3. Bazuar në faktin se ndikimet mjedisore gjatë procesit të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit janë të dukshme dhe qasja e kufizuar për shkak të destinimeve të tjera të tokës ku shtrihen këto vendburime, kjo veprimtari rezulton të jetë e pa - perspektivë dhe duhet bërë zëvendësimi i operimeve të tilla në favor të shfrytëzimit të shkëmbinjve të fortë silikatë dhe karbonatikë. Megjithatë, meqenëse shtresimet dhe depozitimet e rërës dhe zhavorreve në shtretërit e lumenjve janë të ripërtritshme (prurjet vjetore të lumenjve), çështja e lejimit të shfrytëzimit të kufizuar duhet të shtrohet pas një elaborimi më të detajuar, profesional nga institucionet relevante.

Gurët dekorativë dhe dimensional të mermerit në Komunën e Deçanit deri më tani nuk janë bërë hulumtimet edhe ato hulumtime që janë bërë janë hulumtime të pakta dhe kërkohen hulumtime e kërkime gjeologjike të tjera. Gjeo-databaza e Kosovës (GDK) përmban të dhëna për mbi 116 lokacione të gurëve dimensional dhe dekorativë ku përshtatshmëria për gurë dekorativë dhe dimensional ende nuk është hulumtuar. Nuk ekzistojnë të dhëna mbi blloqet e përshtatshme për shfrytëzim dhe sasinë e tyre dhe për humbjet gjatë shfrytëzimit ku nevojiten hulumtime të hollësishme teknike dhe petrografike, si dhe zgjerimi i bazës së të dhënave mbi rezervat / resurset.

2.4.3 Karakteristikat hidrografisë

Lumëbardhi i Deçanit - Më gjatësi 40,5 km që buron në Bjeshkën e Roshkodolit në vendin e quajtur, Tëdel i Lumëbardhit në lartësi mbi detare 2130 m. Pellgu i tij përshkon fshatrat: Deçan, Isniq, Llukë e Epërme dhe Llukë e Ulët, Lumbardh, Prapaqan, Papiq dhe Broliq, fushat e të cilave fshatra i ujit, si dhe furnizon me ujë liqenin akumulues të Radoniqit. Shtrati Lumëbardhit duhet të rregullohet në tërësi nga Manastiri i Deçanit e deri në fshatin Lumbardh me gjerësi prej 50 m në të dy anët e lumit ku rregullimi në të dy anët e tij do të merrte funksionin e shëtitores.

Lumëbardhi i Lloqanit - Më gjatësi 23,7 km që buron nga shpatijet e Kurvallës, Dervish-Komit dhe të Stanishtës së Zogut në lartësi mbi detare 2100 m. Pellgu i Lloqanit përshkon fshatrat Hulaj, Lloqan, Carrabreg i Epërm, Prilep, Rastavicë, Baballoq dhe Gramaqel. Ky lumë përveç që ujit fushat e këtyre fshatrave, uji i tij përdoret për ujitje të fushave edhe të shumë fshatrave të tjera si: Pobergjë, Voksh, Sllup, Drenoc etj. ku shtrati dhe brigjet e lumit janë pjesërisht të rregulluara.

Në lumenjtë që përshkojnë territorin Komunës sonë, në ta ekzistojnë kushte shumë të volitshme për kultivimin dhe rritjen e peshkut dhe ndërtimin restoranteve dhe hoteleve që do të kishte efekt shumë pozitiv socio-ekonomik dhe turistik. Potenciali ujor i “Bjeshkëve të Nemuna”, në masë të madhe është i grumbulluar nëpër rezervuare, prej nga distribuohet si ujë i pijshëm nëpër ujësjellës të vendbanimeve dhe shfrytëzohet nga qytetarët për pije kurse pjesën tjetër popullata e shfrytëzon për ujitje të sipërfaqeve bujqësore. Mirëpo, shtretërit e lumenjve janë të parregulluar që periodikisht

vërshojnë tokat bujqësore dhe dëmtojnë mbulesën vegjetative. Pellgjet e tyre janë të ekspozuara proceseve erozive dhe vërshuese. Territorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshëm i prrojeve dhe proçkave si: Përroi Durakut i Strellcit, Përroi i Behovcit, Përroi e Vokshit, Përroi i Gllogjanit, Përroi i Lëbushës dhe Përroi i Ratishit. Në lartësinë e bjeshkëve ekziston një numër madh i liqeneve me origjinë glaciale të njohur në gjuhën popullore si "sytë e maleve". Këta liqe janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike për Komunën tonë. Liqejt natyror që gjenden në masivin e "Bjeshkëve të Nemuna" paraqesin habitat për interes të veçantë për zhvillimin e turizmit, por nuk janë aq shumë të hulumtuar.

Burimet minerale - Burimet minerale dhe termale ndeshen në katër lokalitete të Rrafshit të Dukagjinit, ku një nga këto burime më i njohuri është ai i Ujit të thartë afër Manastirit të Deçanit. Për shkaqe të shpalljes së asaj pjese si zonë të rëndësisë së posaçme, në të cilin gjendet burimi, ajo pjesë ka mbetur pa një infrastrukturë të rregulluar turistike, si dhe nuk ka qenë i mundur shfrytëzimi komercial i këtij burimi. Gjendja e tanishme e burimit nuk ofron kushte për eksploatimin tij, si dhe për vizitorët. Në të ardhmen, mendohet rregullimi i infrastrukturës për këtë burim, si dhe mundësia e hapjes së ndonjë reparti për mbushjen e shisheve më ujë në afërsi të burimit, duke i ditur edhe cilësitë e tij të ndryshme shëndetësore.

2.4.4 Lartësia mbidetare

Bjeshkët e Nemuna apo Alpet Shqiptare, shtrihen në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit, që i takon nga sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtarë, me përfshirje-sipërfaqe prej 16,786 ha apo 27 % nga territori i Bjeshkëve të Nemuna i takon Komunës së Deçanit. Lartësitë e Bjeshkëve të Nemuna, pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpine të tjera. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të Siujdhesës Ballkanike, me ç 'rast shkëmbinjtë formojnë pamje impozante. Nga masivi i Bjeshkëve të Nemuna, mund të veçojmë këto maja më të larta me lartësi mbi detare siç janë Maja e Gjeravicës 2656 m, Maja e Marjashit 2533m, Maja e Rupes 2501 m, Maja e Qenit 2406 m, Maja e Strellcit 2377 m.

2.4.5 Kushtet klimatike

2.4.5 Klima


Komuna e Deçanit, ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane ku gjatë vitit në Deçan, ka 1945 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit, karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7°C dhe 22.7°C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C. Në klimë ndikon shumë afërsia "Bjeshkëve të Nemuna" dhe rrymat e tjera të ajrit, që në viset e ulëta karakterizohet më vera të nxehta dhe të thata dhe më dimra relativisht të ftohtë dhe më lagështi.

2.4.5 Diellosja

Ditët me diell zgjasin rreth 44% prej ditëve të mundshme të vitit që është një vlerë e lartë. Mesatarisht numri i ditëve me diell është mbi 9 orë në Deçan, që është 92 ditë gjatë vitit, e mbi 2000 m lartësi mbi detare ka 115 ditë.

Lokalitetet	Mesatarja e ditëve me diell në orë gjatë vitit
Deçani - vendbanimet nën 700 m lartësi mbidetare	1945
Tereni në 1000 m lartësia mbidetare	2019
Tereni në 1500 m lartësia mbidetare	2121
Tereni në 2000 m lartësia mbidetare	2148

Tabela 22. Lokalitetet me mesataren e ditëve me diell




8. Ditët me diell, me re, vranësira dhe reshje

2.4.5 Temperatura


Temperatura e ajrit në qytetin e Deçanit, që gjendet në lartësinë mbidetare prej 600 m temperaturat mesatare vjetore nuk lëshohen nën 0º C. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare mujore 0.2º C kurse muajt më i nxehtë është korriku me temperaturë të mesme mujore prej 21.7º C.

Lokalitetet	Temperatura mesatare vjetore	Ndryshimi vjetor i temperaturës
Deçani- vendbanimet nën 700 m l.m.d.	11,1º C.	21,1º C
Tereni në 1000 m lartësinë mbidetare	9,3	20,1
Tereni në 1200 m lartësinë mbidetare	8,5	19,5
Tereni në 1500 m lartësinë mbidetare	7,4	18,6
Tereni në 2000 m lartësinë mbidetare	5,0	17,1

Tabela 23. Temperaturat mesatare vjetore



Grafiku 9. Temperaturat ditore gjatë një viti




Grafiku 10. Temperaturat mesatare vjetore, tendencat dhe anomalitë

2.4.5 Reshjet

Reshjet, sasia mesatare vjetore e reshjeve në territorin e Komunës së Deçanit, lëvizë prej 900-1500 ml / m² ku mesatarisht gjatë vitit ka 126 ditë me të reshura. Më së paku të reshura ka gjatë muajt korrik, gusht dhe shtator 6 - 8 ditë mesatarisht me sasi deri në 70 ml / m². Sasia më e madhe është gjatë gjysmës së ftohtë të vitit ku sasia e të reshurave arrin deri 1500 ml / m² në ditë. Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Në viset e ulëta është 724.6 lit / m², në viset malore të Bjeshkëve të Nemuna, sasitë mesatare të reshurave arrijnë më tepër se 1,300 lit / m². Në këtë rajon vranësirat mesatare vjetore janë 58 %, gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 60,5 (16,6 %) në vit, ndërsa e ditëve të vrerta 119,3 ditë (32,6 %). Zgjatja mesatare vjetore e zënies së diellit për shkak të ndikimeve orografike është më e vogël se sa mesatarja për Kosovën dhe është 1.972 orë nga e cila në korrik 293,6 orë ose 72,1 % diell në vit.

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
101	102	74	66	57	48	45	34	60	104	114	103	908


Tabela 24. Sasia e të reshurave mujore dhe vjetore në ml/m²



Grafiku 11. Temperaturat mesatare vjetore dhe reshjet

2.4.5 Bora

Mbulimi me borë në territorin e Komunës së Deçanit, ka kohëzgjatje të ndryshme të qëndrueshmërisë varësisht nga reliefi dhe lartësia mbidetare. Qëndrueshmëria ma e madhe e borës është në lartësi mbi 2000 m. Gjatë dimrit trashësia e borës në viset kodrinore - malore arrin deri më 50 cm, kurse në viset më të larta (bjeshkë) ajo është mbi 1m, kurse në lartësitë e mëdha malore (alpine) qëndron gjatë tërë vitit. Andaj, kushtet e këtilla klimatike mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve rekreative sportive (skijimin) gjatë sezonit të dimrit.




Grafiku 12. Ditët e thata dhe ditët me borë

2.4.5 Erërat

Era, frekuencën më të madhe e ka gjatësia / 398° 0`/00``/, ndërsa nga erërat ato perëndimore /P/ dhe jugperëndimore /JP/ me 122° 0`/00``/ dhe 113° 0`/00``/, ndërsa më të rrallat janë ato lindore /L/ me 55° 0`/00``/. Shpejtësia mesatare e erës gjatë vitit është 16 m/sek., ndërsa ajo maksimale arrin deri më 26,5 m/sek. dhe më së shpeshti era fryn nga veriu dhe veriperëndimi.


Elementet kryesore klimatike që i përkasin Komunës sonë janë: moti i kthjelltë, lartësia e lartë mbidetare e kompleksit të bjeshkëve, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit, reshjet atmosferike (dëborë) të bollshme, të ujërave në sasi të mjaftueshme.



Grafiku 13. Shpejtësia maksimale dhe minimale e erës gjatë periudhës vjetore

2.4.5 Lagështia

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2 %, në të cilën rast rritja është dukshëm më e madhe prej verës (muaji Maj – Shtator) kah dimri për 17,5 %, se sa zvogëlimi prej dimrit në drejtim të verës ku niveli i "rehatisë" se lagështisë është e bazuar në pikën e vesës. Ndryshe nga temperaturat në Deçan të cilat gjatë ditës janë të larta ndërsa gjatë natës më të ulëta, pika e vesës së lagështisë ndryshon ma ngadalë që do të thotë se lagështia e ditës është pothuajse e njëjtë edhe gjatë natës.




Grafiku 14. Muajt me nivelin me të lartë të lagështisë dhe zona e komforit

2.4.6 Resurset natyrore dhe biodiversiteti

Pozita gjeografike, faktori gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima kanë ndikuar që ky territor të ketë një diversitet të pasur biologjik më bimë barishtore shumëvjeçare (hemikriptofita), rreth 70% dhe bimë drunore dhe shkurret fanerofita rreth 7%. Biodiversiteti përfshinë shumëllojshmërinë brenda dhe midis llojeve, si dhe shumëllojshmërinë ekosistemeve. Sipas

hulumtimeve të bëra janë përshkruar 795 lloje të bimëve të ndryshme, endemike subendemike, që u përkasin elementeve endemike të ndryshme, gjithashtu edhe një numër i madh i llojeve relikte. Po ashtu, ky rajon është i pasur edhe me lloje të shumta të bimëve mjekuese (boronica, linsuri, kamomili dhe çajeve të tjera natyrore etj.).

Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, janë ofruar të dhëna për mbrojtjen e natyrës, identifikimin e zonave të rrezikuara, të dhëna objektive për llojet e rrezikuara me standarde globale, motivimin e njerëzve që përmes aktiviteteve të ndryshme të mbrojnë natyrën, të dhëna për llojet e rrezikuara, shkallën e rrezikshmërisë, faktorët që rrezikojnë speciet dhe habitatet, një bazë të dhënash për të monitoruar gjendjen e llojeve të rrezikuara. Numri i taksoneve të përfshira në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës sipas Raunkierit, janë paraqitur në figurë. Figura tregon se dominojnë Hemikriptofitet me 155 taksone, pastaj Gjeofitet me 32 dhe Kamefitet me 27. Në numër më të vogël janë Fanerofitet me 19 taksone dhe më së paku Terofitet me vetëm 4 taksone.



Grafiku 15. Taksonet e përhapjes të bimëve sipas ndarjes se Raunkierit (format jetësore sipas Raunkierit)

Gjatë hulumtimeve intensive të kryera në terren grupi punues ka konstatuar edhe disa lloje të reja për Florën e Kosovës, në përgjithësi por në raste të caktuara dhe më gjerë për florën e Evropës Juglindore, ku kemi konstatuar 9 taksone bimore të reja për Florën e Kosovës.

Këto taksone janë: *Crocus flavus, Quercus robur* subsp. *pedunculiflora*, *Cyanus lingulatus, Juniperus sabina, Ranunculus degenii, Viola herzogii, Pulsatilla alpina, Minuartia baldaccii* subsp. *baldaci* dhe *Gypsophila spergulifolia.*

Nr.	Familja/lloji	Lulëzimi /familja	Rio topi	Përhapja në Deçan	Bimë endemike	Zbulimi	Gjendja
DIPSACACEAE							
1.	Cephalaria pastricensis Dorfl. et Hayek. 1921. (Cefalaria e Pashtrikut)	VI – VII / VIII	Në vende me bar, shkurre, pyje të zonës malore dhe subalpike.	Pashtrik, Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Lumëbardhit, Zhleb).	Deçan	Dorfler, I., Hayek, A. (1921), nga materiali i mbledhur në Pashtrik dhe Alpet Shqiptare.	Populacione të rrezikuara (Duhet të jenë nën mbrojtje të ligjit)
FABACEA							
1.	Astragalus fialae Degen 1900. (Arithja e Fialit)	VII / VIII	Në shkëmbinj të zonës alpike	Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Lumëbardhit).	Deçan	Degen, A. (1900), nga materiali i mbledhur në Alpet Shqiptare.	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj).

LAMIACEAE							
1.	Thymus rochlenae Vel. 1903. (Listra e Rohlenes)	VI / VII	Në kullosa, livadhe të zonës malor dhe subalpike	Rrethinat e Deçanit	Deçan	Velenovsky, J. (1903).	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
SAXIFRAGACEAE							
1.	Ëulfenia blecicii Lak. 1971. *(Vulfenia e Bleçiqit)* (Në Kosovë janë të përhapura dy nënlloje të këtij lloji: Ë. blecicii subsp. blecicii dhe Ë. blecicii subsp. rohlenae, të cilat janë të përhapura në Alpet Shqiptare)	VI – VIII / VIII	Në vende me bar, pyje e shkurre të zonës subalpike	Alpet Shqiptare	Deçan	Lakusič, R. (1971)	

Tabela 25. Bimët endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën të cilat janë të përhapura edhe në Alpet Shqiptare – Komuna e Deçanit[22]

2.4.6 Flora

Pjesa perëndimore e Kosovës njihet si zonë e pasur me llojllojshmëri të florës. Në këtë pjesë gjenden hapësirat të cilat karakterizohen me lloje të radha të bimëve. Në Komunën e Deçanit disa nga këto hapësira (gjithsejtë 19 monumente natyrore[23]) janë venë edhe në mbrojtje si monumente natyrore dhe një nga to është kompleksi i trungjeve të pishës së zezë (pinus nigra), si zonë e mbrojtur i rëndësisë së pishës pyjore. Kjo hapësirë është mbjellë në pjesën e parë të shek. XIX-të, më sipërfaqe prej 15 ha, vlen të theksohet se nga fshati Strellc i Epërm deri tek fshati Voksh shtrihet brezi i gështenjës më sipërfaqe prej 900 ha. Ndër bimët e njohura në rajonin e Deçanit me karakter endemik janë: Sempervivum kosaninii Praeger 1930. (Burgulli i Koshaninit), Cephalaria pastricensis Dorfl. et Hayek. 1921. (Cefalaria e Pashtrikut), Astragalus fialae Degen 1900. (Arithja e Fialit), Trifolium ëettsteinii Dorf. et Hayek 1921. (Tërfili i Vetshtajnit), Thymus albanus H. Braun 1892. (Listra shqiptare), Thymus rochlenae Vel. 1903. (Listra e Rohlenes), Lilium albanicum Griseb. 1845. (Zambaku shqiptar), Aconitum pentheri Hauek 1916. (Akoniti i Rusolisë), Rubus ipecensis rech. 1935. (Manaferra e Pejës), Saxifrage scardica Griseb. 1843. (Iriqëza e Sharrit), Ëulfenia blecicii Lak. 1971. (Vulfenia e Bleçiqit) (Në Kosovë janë të përhapura dy nënlloje të këtij lloji: Ë. blecicii subsp. blecicii dhe Ë. blecicii subsp. rohlenae, të cilat janë të përhapura në Alpet Shqiptare). Sipas botimit të Prof. Dr. Asc. Fadil Millaku[24] zona ma e pasur me florë dhe faunë në "Bjeshkët e Nemuna" janë ne Komunën e Deçanit me 797 lloje të bimëve vaskulare ku 128 nga ato konsiderohen me karakter endemik. Pozita e mirë gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, klima dhe reliefi i mirë kanë ndikuar që të zhvillohen diversiteti biologjik i bimëve barishtore shumëvjeçare (hemikriptofita), rreth 70% e bimëve drunore dhe rreth 7% të shkurreve fanerofita.

Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare[25], florën në Komunën e Deçanit, e përbejnë: algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor, që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në Komunën e Deçanit, bimët vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegjetacion i cili ka ndikim direkt në klimën, ajrin, ujin dhe tokën.

[22] Bimët Endemike të florës vaskulare karakteristike për Deçanin.
[23] Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Referencë Nr. 317/IKMN
[24] "Flora subalpike dhe alpike e alpeve Shqiptare" 1999
[25] Libri i Kuq i bimëve vaskulare i Republikës së Kosovës.

Përhapja e shtrirjes i florës vaskulare të pranishme në territorin e Komunës së Deçanit, të cilat janë pjesë e Librit të Kuq veçohen këto bime: *Dinathus scardicus*, *Crocus scardicus*, *Draba korabensis, Potentilla montonegrina, Selaginella selaginoides, Pedicularis oederi, Silene ëaldsteinii, Salix herbacea*, *Lilium albanicum, Ranunculus incomparabilis, Pinguicula balcanica, Allysum scardicum, Anemone narcissiflora, Draba doerfleri* etj. Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat (vendbanim) të dhive të egra dhe shqiponjës së maleve (*Aquila crysaetos*), ndërsa pyjet dhe kullosat në pjesët e ulët të zonës shfrytëzohen nga ariu i murrmë dhe kaprojtë, gjithashtu duhet të veçohen edhe këto rezervate si: Panja e heldrahit *(Acer heldreichii),* Arneni *(Pinus peuce),* Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer pseudoplatanus*), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiacae*), Mështekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea) etj.*

Bashkësia e hormoqit *(Picetum excelsae),* Bashkësia e hormoqit dhe arnenit *(Piceo-Pinetum peucis)* dhe Bashkësia e arnenit *(Pinetum peucis).* Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Saxifraga stellaris, Valeriana tripteris, Malva moschata, Cirsium candelabrum, Tanacetum vulgare, Salix eleagnos, Lilium martagon,Centaurea ipecensis, Verbascum baldacii, etj.*

2.4.6 Fauna

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës, fauna në Komunën e Deçanit përbëhet prej 8 lloje të peshqve, 13 lloje ujë tokësorë, 10 lloje rrëshqitës, 148 lloje shpendë (sipas disa të dhënave më të reja 175 lloje, ndërsa mendohet të ketë mbi 200 lloje), 37 lloje gjitarë dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera. Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në Parkun Kombëtar "Bjeshkëve të Nemuna" janë: rrëqebulli (Lynx lynx), ariu i murrmë (Ursus arctos), kaprolli (Capreolus capreolus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos), fajkoi thonj bardhë (Falco naummani), pulegra (Tetrao urogallus) etj.[26]

Llojet më të rëndësishme të faunës të cilat gjenden në Librin e Kuq[27] e ku kanë habitat edhe në territorin e Komunës së Deçanit, janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), shqarthi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: fëllëza e gurëve (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër (*Columba oenas*), korbi (*Corvus corax*), qyqja (*Cuculus canorus*), qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj.

Nga hulumtimet e kryera, posaçërisht me vendosjen e kamerave kurth (monitoruese), në zonat malore në Gryken e Deçanit, tek Kozhnjeri është konstatuar prania e shumëllojshme e faunës, në veçanti të gjitarëve siç janë ariu i murrmë, ujku, dhelpra, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, shqarthi i bardhë, shqarthi i artë, lepuri, ketri, vjedulla, gjeri i lajthive etj. Sa i përket prania e shpendëve vlejnë të ceket se në Bjeshkën e Belegut, Prilepit, Babalioqit dhe në Bjeshkën e Deçanit, janë të pranishme shqiponja e artë, shqiponja minj ngrënëse, skifteri malor, skifteri i përhimet, huti i madh, huti pyjor, pula e pyjeve, shkurtëza, thëllëza e gurit, etj. Në bazë të gjurmëve të gjetura në terren është verifikuar edhe prania e rrëqebullit ballkanik (Lynx lynx balcanicus), i cili e ka ndryshuar habitatin nga pjesa e Rugovës dhe është vërejt edhe në bjeshkët e Deçanit. Habitati i kësaj kafshe të rrallë është e rrezikuar nga zhdukja, dhe është pjesë e Listës së Kuqe të Kafshëve[28].

2.5 Ekonomia dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme – NVM

Deri në vitin 1999 Komuna e Deçanit ka pas disa ndërmarrje shoqërore të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre duke u bazuar në potencialet që kjo Komunë i ka ofruar dhe duke e punësuar një

[26] Biodiversiteti I Kosovës – Mr.Sc Qenan Maxhuni
[27] Libri i Kuq i bimëve vaskulare i Republikës së Kosovës.
[28] Raporti për Gjendjen e Natyrës 2015-2017 MMPHI.

numër të madh të popullatës së Deçanit. Këto ndërmarrje pas vitit 1999 nuk i kanë mbijetuar ndryshimeve kohore dhe menaxhuese, në fakt disa prej tyre janë shkatërruar gjatë luftës ne Kosovë ndërsa të tjerat janë privatizuar. Ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë funksionuar në Komunën e Deçanit ishin:

1. Ndërmarrja pyjore "Gjeravica",
2. Fabrika e mobileve "Shipadi",
3. Fabrika për bronzim dhe prodhim të rrjetave metalike "Metaliku",
4. Fabrika për prodhimin e teheve për prodhim të drurit dhe metalit "Jugofreudi",
5. Fabrika e auto pjesëve "Zastava",
6. Fabrika për prodhimin e pompave më piston "NIN",
7. Ndërmarrja e përpunimit të drurit "Parketarja",
8. Fabrika për prodhimin e pllakave izoluese nga materiali i stiropori i veshur më lëvozhga druri te betonuar "Teroliti",
9. Ndërmarrja ndërtimore "Bistrica",
10. Ndërmarrja tregtare "Gërmaja",
11. Hidrocentrali "Kozhnjeri",
12. Fabrika e Mjaltit "Apiko",
13. Fabrika e konfeksionit të tekstilit në Junik (atëherë Juniku ka qenë pjesë e Komunës Deçanit).

Komuna e Deçanit, ka një potencial mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Pozita e saj gjeografike ndodhur në mes të trekëndëshit Kosovë, Mal i Zi dhe Shqipëri (nëpërmes Komunës Junikut) por edhe në mes të Komunës Pejës, Gjakovës, Juniku ofrojnë potenciale ekonomike. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin ekonomik ndërsa në anën tjetër zona malore është potencial i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Po ashtu në ketë Komunë zhvillohen mjaft ndërmarrjeve individuale, tregti, industrinë e lehtë, gjithashtu resurset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin ekonomik lokal. Komuna e Deçanit, në të ardhmen ka për qëllim të ofroj shërbime bashkëkohore dhe efikase dhe të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore në avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale njerëzore. Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset natyrore dhe kulturore në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave të ardhshme që t'i shfrytëzojnë këto resurse.

Në Komunën e Deçanit, aktivitetin e tyre e ushtrojnë 2254 ndërmarrje, dhe në bazë të kritereve mbi vlerësimin e madhësisë së ndërmarrjeve dhe numri i të punësuarve, pjesa dërmuese e tyre i takon ndërmarrjeve individuale me aktivitet prodhues, tregtar, ndërtimor dhe shërbyese.

Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre	
Ndërmarrje individuale	694
Kompani e huaj	1
Kooperativa bujqësore	0
Ndërmarrje publike	1
Ndërmarrje Komunale	1
Ndërmarrjen shoqërore	0
Ndërmarrje tjera nën juridiksionin e AKP-së	1
Ortakëri e përgjithshme	21
Shoqëri aksionare	5
Shoqëri me përgjithësi të kufizuara	283
Gjithsejtë	2254

Tabela 26. Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre[29]

[29] ARBK-Zyra për Regjistrim të Bizneseve Deçan 31.12.2020

2.5.1 Bruto prodhimi vendor

Ndikimi ekonomik i Komunës Deçanit ne ekonominë nacionale është i vogël dhe sipas publikimeve te raporteve te ASK-së BPV i Komunës Deçanit për vitin 2011 ishte 101 milion € ne krahasim me 4.55 miliard € ne nivel nacional. Sipas para llogaritjeve, Komuna e Deçanit ka kontribuar me 2.2 % ne BPV të Kosovës gjatë vitit 2011. Ne vitet ne vijim BPV ka pas rritje ne masë 5 – 6% nga viti paraprak ndërsa sipas raporteve te prezantuara nga ASK në vitin 2018, Komuna e Deçanit e kishte BPV 211 milion €. Kjo e dhënë është inkurajuese mirëpo nëse krahasohet me rritjen në nivel nacional atëherë BPV ka rritje prej 0.1% ose 2.3% të BDV-së nacionale. Rritja e BDV-së nga viti 2011 deri në vitin 2018 ne Komunën e Deçanit është 109% kurse të dhënat pas vitit 2018 nuk janë bërë publike.


Bruto Prodhimit Vendor (BPV) (€), 2011 - 2022								
	BPV (€)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti			
	2011	2012	2013	2018	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2018	2011 - 2018
Komuna Deçan	101 mil.	107 mil.	133 mil.	211 mil.	5.90%	5.60%	86.70%	109.00%
Kosova	4.55 bil.	4.79 bil.	5.07 bil.	8.95 bil.	5.27%	5.80%	76.00%	96.00%

Tabela 27. Bruto Prodhimit Vendor (BPV) (€), 2011 – 2022

2.5.2 Punësimi

Shkalla e Papunësisë, vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2022, është 12.6% (58 081 persona të moshës 15-64 vjeç) dhe llogaritet të jetë më e larta në rajon. Mirëpo, krahasuar me vitin 2021 ka një rrënje prej 8.1% ku në këtë mes, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat me 16.5% se sa për meshkujt me 11%.


Komuna e Deçanit nuk është e vetmja Komunë e cila përballet me sfida të papunësisë. Duke qenë në mes të dy Komunave të mëdha siç janë Komuna e Pejës dhe ajo e Gjakovës, dikur Komuna e Deçanit kishte prosperitet ekonomik mirëpo pas vitit 1999 ky aspekt u venit për shkak të ndryshimeve të trendëve ekonomike duke u shkatërruar dhe privatizuar ndërmarrjet shoqërore, zhvillimi i politikave ekonomike jo te balancuara nga niveli qendror për të gjithë rajonin perëndimor të Kosovës dhe mungesa e fondit të pronës Komunale në Komunën e Deçanit për hartimin e programeve të qëndrueshme zhvillimore dhe joshëse për investitorët. Të dhënat e papunësisë janë të publikuara vetëm në nivel të Kosovës ndërsa në nivel Komunal ato mungojnë. Mirëpo nëse i referohemi trendëve të papunësisë në nivel të Kosovës për vitin 2022 e që është 12.6% dhe nëse këtë përqindje e ndajmë ne barazh ne të gjitha Komunat atëherë të dhënat e supozuara të papunësisë ne Komunën e Deçanit për popullsi aktive (66.4% e banorëve është 15 - 64 vjeç) për vitin 2021 është 28213 banorë nga e cila 12.6% (papunësia në nivel të Kosovës) është 3555 banorë të papunë.



Grafiku 16. Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas gjinisë për vitin 2020 deri 2022

Bazuar në të dhënat nga Agjencia e Punësimit të Kosovës (APK), numri më i lartë i punëkërkuesve të regjistruar në Komunën e Deçanit, është në vitin 2018 dhe ishte 1986. Sipas po të njëjtës agjenci, nga viti 2020 deri 2023 (në proces të hartimit të këtij dokumenti), numri i punë kërkuesve është 725 (365 punë kërkues aktiv dhe 360 punë kërkues pasiv). Megjithatë, ky numër mendohet të jetë më i lartë për faktin se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të papunë nuk paraqiten në Entin për Punësim.

Shkalla e Punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për vitin 2022, është 33.80 %[30], apo 403813 persona. Punësimi me i lartë është të meshkujt 49.4% në moshë pune, ndërsa punësimi të femrat është 18.4% në moshë pune. Femrat janë të punësuara, kryesisht në këta sektorë: arsim, kujdes shëndetësor dhe tregti, me 51.2 % të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët: ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit, me 42.3%.



Grafiku 17. Totali i të punësuarve në Kosovë sipas gjinisë për vitin 2020, 2021 dhe 2022

Numri i të punësuarve sipas pronësisë sipas te dhënave te grumbulluara gjatë viteve 2011 deri në vitin 2022 janë në rritje si në sektorin publik shoqëror po ashtu edhe ne sektorin publik.
Niveli i varfërisë, një prej parametrave thelbësor për mirëqenien e një vendi është shkalla e punësimit. Niveli i lartë i papunësisë në vend është një prej katalizatorëve kryesor të zgjerimit të varfërisë në vend. Bazuar në Konsumi i Përgjithshëm ne Kosovë 2017[31], konsumi mesatar vjetor për familje është vetëm 7,803 €. Nga kjo vlerë, rreth 70 % qind shpenzohet për ushqim dhe banim, dhe vetëm 3% e mesatares së konsumit vjetor për ekonomi familjare i takon kategorisë së shpenzimeve për shëndetësi, ndërsa që vlera e shpenzimeve për aktivitete tjera sociale mbetet tejet e ulët. Duke u bazuar në statistikat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2019, në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 311 (ose 1213 persona), në vitin 2020 gjithsejtë 316 (ose 1264 persona), në vitin 2021

[30] Anketa e Fuqisë Punëtore 2022, ASK
[31] Anketa e Buxhetit Familjar 2017, ASK

gjithsejtë 325 (ose 1300 persona) ndërsa në vitin 2022 gjithsejtë 316 (ose 1232 persona) ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale. Këto, shifra paraqesin rreth 3% deri 4% të gjithë popullsisë së vlerësuar në Deçan në vitet 2019 - 2021. Në të njëjtën kohë, bazuar në Statistikat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përfitues nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës janë 633 familje në vitin 2020, 628 familje në vitin 2021, dhe 619 familje në vitin 2022.

2.5.3 Bizneset dhe strukturat e tyre

Në vitet e fundit qeverisja lokale në Deçan, në bashkëpunim me nivelin qendror kanë krijuar një sërë masash reformuese me qëllim të përmirësimit të ambientit ndërmarrës në Komunë. Si rrjedhojë e këtyre reformave, NVM-së regjistrohen përmes Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve me shumë pak procedura. Disa prej zhvillimeve të rëndësishme në ketë drejtim që ka krijuar kushte Komuna e Deçanit, për ushtrimin e veprimtarive ndërmarrëse është investimi në infrastrukturën rrugore, i cili investim ka hapur rrugë ndërmarrjeve për investime edhe në zhvillimin ekonomik lokal në fushën e turizmit, që është një nga potencialet e mëdha të zhvillimit.

2.5.3 Numri dhe struktura e ndërmarrjeve në Komunën e Deçanit

Raporti i më poshtëm tregon një shkallë ngritje të numrit për regjistrim e Bizneseve në Komunën e Deçanit. Në vitet e fundit ka pasur rritje në regjistrimin e ndërmarrjeve e cila është pasqyruar si në tabelë:

2022				2021				2020				2019			
TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
28	24	30	24	34	18	14	16	22	24	22	31	22	32	13	31
106				82				99				98			

Tabela 28. Regjistrimi i ndërmarrjeve ne vitet 2019 - 2022[32]

2022				2021				2020				2019			
TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
9	5	7	10	8	0	7	4	5	0	4	11	13	10	11	3
31				19				19				37			

Tabela 29. Shuarja e ndërmarrjeve ne vitin 2019 - 2022[33]

2022				2021				2020				2019			
TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
19	19	23	14	26	18	7	12	17	24	18	20	9	22	2	28
75				63				80				61			

Tabela 30. Diferenca ne mes te regjistrimit dhe shuarjes së ndërmarrjeve gjatë vitit 2019 - 2022

Është inkurajues fakti që numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat ka shënuar rritje ndër vite, duke u bazuar në statistikën që mirët gjatë aplikimit të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet sipas llojit SH.P.K kanë mesatarisht numrin e të punësuarve 3-7, ndërsa ndërmarrjet Individuale 1-3 të punësuar. Në vitet e fundit ka pasur rritje në ndërmarrjeve duke filluar nga ndërmarrjet individualë që kanë qenë kryesisht Start UP (fillestar), të cilat kanë gjetur mbështetje dhe disa prej tyre janë përfituese të grandeve nga niveli qendror dhe një numër i caktuar tyre nga donacione të ndryshme.

[32] Ndërmarrjet e regjistruara sipas komuna, viti, periudha dhe Kodi/Seksionet e aktiviteteve ekonomike 2021, ASK

[33] Numri i ndërmarrjeve të shuara sipas komunave dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike sipas komuna, tremujoret dhe variabla 2019 -2021, ASK

Ndërmarrjet ekonomike, sipas pronësisë, 2011 - 2022				
Pronësia	Ndërmarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Private	0	0	1966	1295
Publike - Komunale	0	0	0	1
Publiko (Komunale) - Private	0	0	0	0
Publike - Shoqërore	0	0	0	0
Publiko (Shoqërore) - Private	0	0	0	0
Gjithsejtë	0	0	1966	1296

Tabela 31. Ndërmarrjet ekonomike, sipas pronësisë, 2011- 2022

Regjistrimi i ndërmarrjeve ne Komunën e Deçanit vit pas viti po rritet dhe duhet të theksohet se gjatë vitit 2022 janë regjistruar 106 ndërmarrje të reja ndërsa sa i përket shuarjeve të ndërmarrjeve më së shumti ka pas në vitin 2019 me 37 të tilla. Viti 2020 mund të konsiderohet si viti kur ka pas më së shumti ndërmarrje të regjistruara nga kalkulimi "në mes të regjistrimit dhe shuarjes së ndërmarrjes" me 80 ndërmarrje ndërsa viti 2019 mund të konsiderohet me më pak të regjistruara nga kalkulimi "në mes të regjistrimit dhe shuarjes së ndërmarrjes" me 61 ndërmarrje të regjistruara. Sa i përket pronësisë, shumica e ndërmarrjeve janë pronë private dhe vetëm një ndërmarrje ekonomike është Komunale.

Të dhënat tregojnë se punësimi sipas pronësisë është ma i madh në atë privat në krahasim me atë publike - komunale gjegjësisht publike - shoqërore. Në sektorin privat këto rritje janë të dukshme ndërsa në sektorin publike - komunal dhe atë publike - shoqërore kjo rritje është ma e ngadaltë dhe e kontrolluar me kornizë ligjore (kufizime ne punësim).

Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë, 2011 - 2022				
Pronësia	Te punësuar (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Private	0	0	1841	2294
Publike - Komunale	0	0	0	52
Publiko (Komunale) - Private	0	0	0	0
Publike - Shoqërore	829	836	858	872
Publiko (Shoqërore) - Private	0	0	0	0
Gjithsejtë	829	836	2699	3218

Tabela 32. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas pronësisë, 2011 - 2022

Shtrirja e ndërmarrjeve ekonomike si dhe numri i të punësuarve është dukshëm ma i lartë në vendbanimet rurale se sa në vendbanimin urban. Ne te dy rastet nga viti 2013 deri në vitin 2022 ka rritje të punësuarve ne masën 30% në zonën urbanë gjegjësisht 35% në atë rurale.

Ndërmarrjet ekonomike, sipas vendbanimeve, 2011 - 2022				
Vendbanimet	Ndërmarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Baballoq	0	0	28	14
Beleg	0	0	15	17
Belle	0	0	1	3
Carrabreg i Epërm	0	0	245	145
Carrabreg i Ulët	0	0	281	155
Dashinoc	0	0	8	12
Deçan	0	0	458	318
Drenoc	0	0	15	8
Dubovik	0	0	17	14
Dubravë	0	0	18	6
Gllogjan	0	0	11	12
Gramaqel	0	0	41	27
Hulaj	0	0	4	2

Irzniq	0	0	69	51
Isniq	0	0	104	57
Kodrali	0	0	17	8
Lëbushë	0	0	84	52
Lumbardhë	0	0	8	14
Lloqan	0	0	4	9
Llukë e Epërme	0	0	27	11
Llukë e Ulët	0	0	14	10
Maznik	0	0	3	7
Papiq	0	0	1	1
Pobergjë	0	0	9	15
Pozhar	0	0	12	17
Prapaqan	0	0	4	11
Prokolluk	0	0	2	5
Prilep	0	0	139	69
Rastavicë	0	0	53	47
Ratish i Epërm	0	0	5	8
Ratish i Ulët	0	0	5	6
Sllup	0	0	2	7
Strellc i Epërm	0	0	107	81
Strellc i Ulët	0	0	98	53
Shaptej	0	0	54	12
Voksh	0	0	2	6
Vranoc i Vogël	0	0	1	6
Gjithsejtë	0	0	1966	1296

Tabela 33. Ndërmarrjet ekonomike, sipas vendbanimeve, 2011 - 2022

Duke e marr parasysh se shumica e popullatës ne Komunën e Deçanit jetojnë ne zonën rurale dhe merren me bujqësi, shumë nga ata kanë krijuar ndërmarrjet bujqësore të tyre. Ne vitin 2013 Komuna e Deçanit numëronte 25 ndërmarrje të tilla me pronësi private ndërsa ne vitin 2018 ishin 12 të tilla. Kjo tregon se puna në bujqësi gradualisht ka filluar ta humb interesimin dhe kjo tkurrje e ndërmarrjeve në ketë sektor është një alarm i marrjes së masave urgjente për mbështetjen e këtyre politikave. Përpos tkurrjes së ndërmarrjeve bujqësore private, në Komunën e Deçanit në vitin 2013 janë regjistruar gjithsejtë 3936[34] ferma familjare, kurse fuqia punëtore në bujqësi ne Komunën e Deçanit ishte 13407 persona[35]

	Ndërmarrjet e regjistruara ne Komunën e Deçanit	2019	2020	2021	2022
a	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	2	6	5	10
b	Xehetari dhe gurëthyes	0	0	0	0
c	Prodhim	13	9	11	9
d	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	0	0	1	2
e	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	4	2	1	1
f	Ndërtimtari	10	12	16	17
g	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	22	19	19	22
h	Transport dhe ruajtje	6	5	0	1
i	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	16	19	10	12
j	Informacion dhe Komunikim	3	7	1	5
k	Aktivitete financiare dhe sigurimit	0	1	0	0
l	Aktivitete të patundshmërisë	1	1	1	1
m	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	7	6	10	7
n	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	5	2	2	8
o	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detyrueshëm	0	0	0	0
p	Arsim	1	1	0	1

[34] Regjistrimi I bujqësisë 2014, ASK
[35] Fuqia punëtore në bujqësi sipas regjioneve dhe komunave 2014, ASK

q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	0	1	3	4
r	Art, zbavitje dhe rekreacion	1	0	0	6
s	Aktivitete të shërbimeve tjera	7	8	2	0
Gjithsejtë		98	99	82	106

Tabela 34 Ndërmarrjet e regjistruara ne Komunën e Deçanit[36]

Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas sektorëve ekonomik, 2011 - 2022	2011	2012	2013	2022
A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	0	0	389	413
B - Xeheroret dhe gurëthyesit	0	0	95	0
C - Industria përpunuese	0	0	136	43
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionin	0	0	0	15
E - Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	0	0	0	7
F - Ndërtimtaria	0	0	625	700
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	0	0	0	698
H - Transporti dhe magazinimi	0	0	87	6
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	0	0	308	284
J - Informimi dhe Komunikimi	0	0	0	16
K - Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	0	0	0	0
L - Aktivitetet e patundshmërive	0	0	0	3
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	0	0	0	17
N - Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	0	0	58	23
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	0	0	19	0
P - Arsimi	0	0	56	3
Q - Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	0	0	0	39
R - Arte, argëtimi dhe rekreimi	0	0	0	18
S - Aktivitetet tjera shërbyese	0	0	68	9
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra te padiferencuara - dhe shërbime - aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	0	0	0	0
U - Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0	0	0	0
Gjithsejtë	0	0	1841	2294

Tabela 35. Ndërmarrjet ekonomike, punësimi sipas sektorëve ekonomik, 2011 – 2022

	Ndërmarrjet e shuara ne Komunën e Deçanit	2019	2020	2021	2022
a	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	1	2	0	1
b	Xehetari dhe gurëthyes	0	2	0	1
c	Prodhim	4	0	3	3
d	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	1	0	0	
e	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	2	0	0	0
f	Ndërtimtari	3	1	1	4
g	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14	11	7	2
h	Transport dhe ruajtje	6	0	0	0
i	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	3	0	2	3
j	Informacion dhe Komunikim	0	0	1	0
k	Aktivitete financiare dhe sigurimit	0	0	0	0
l	Aktivitete të patundshmërisë	0	0	0	0
m	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1	1	1	1
n	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	0	1	0	0
o	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detyrueshëm	0	0	0	0
p	Arsim	0	0	0	0
q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1	0	0	1
r	Art, zbavitje dhe rekreacion	0	1	1	1
s	Aktivitete të shërbimeve tjera	1	0	1	3
	Nuk ka të dhëna nga ARBK	0	0	2	11
Gjithsejtë		37	19	19	31

Tabela 36 Ndërmarrjet e shuara ne Komunën e Deçanit[37]

[36] Numri i ndërmarrjeve të reja dhe të regjistruara, sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike, ASK

Komuna e Deçanit nuk posedon zona të caktuara të dedikuara për industri, biznes apo zona te lira ekonomike siç janë park apo zonë industriale, inkubator apo park biznesi, park teknologjik apo zonë te lirë. Ne Komunën e Deçanit ekzistojnë dy zona komerciale me pronësi private dhe publike e që kanë të bëjnë kryesisht me tregun privat dhe tregun e gjelbër i llojit publiko - komunal. Të dy tregjet ndodhen në zonën urbane të qytetit dhe shtrihen ne sipërfaqe 1 ha (Tregu i qytetit) dhe 0.3 ha (tregu i gjelbër) në një total prej 1.3 ha.

Zonat komerciale, sipas pronësisë, 2011 - 2022				
Pronësia	Ndërmarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Private - Tregu i qytetit	1	1	1	1
Publike - Komunale - Tregu i gjelbër	0	0	0	1
Publiko (Komunale)- Private	0	0	0	0
Publike - Shoqërore	0	0	0	0
Publiko (Shoqërore) - Private	0	0	0	0
Gjithsejtë	1	1	1	2

Tabela 37. Zonat komerciale, sipas pronësisë, 2011 – 2022

2.5.4 Turizmi

Duke vlerësuar potencialet natyrore dhe trashëgimisë kulturore e arkitekturore me të cilat disponon Komuna e Deçanit, mundësia e zhvillimit të turizmit si një sektor i rëndësishëm ekonomik, paraqet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të Komunës. I kufizuar me vargmalet në pjesën veriore, perëndimorë dhe jugore, kufizimi me dy shtete, lumenj dhe burime minerale, Komuna e Deçanit posedon potenciale te mëdha ne zhvillimit të turizmit malor, rekreativ, sportiv, eksplorues, shëndetësor, agro turizmit (rural) dhe turizmi kulturor. Deri me tani ne Komunën e Deçanit janë të identifikuara tre lloje të turizmit:

- Turizmin transit, pra si pikë kalimi për në vendet tjera në Kosovë apo nga Kosova në shtetet fqinje,
- Turizëm vikendi duke ofruar oferta për qëndrim gjatë vikendit.
- Turizëm qëndrimi i cili përfshinë pika qëndrimi turistik shumë ditorë si ne zonat urbane dhe rurale.

Në të kaluarën Komuna e Deçanit ka qenë e njohur edhe për pushimoren dedikuar fëmijëve në vendin e njohur si “Pishat e Deçanit”. Rrugëtimi i kësaj pushimore drejt përmirësimit të kushteve dhe kapaciteteve ishte i ngadaltë dhe i vështirë. U zgjerua me kapacitete dhe ndërtesa mirëpo pas përfundimit të luftës në Kosovë ne vitin 1999 këto ndërtesa u përdorën nga trupat e KFOR-it.

Turizmi ne Komunën e Deçanit nuk është i zhvilluar në nivelin e duhur përkundër potencialeve që i posedon të kombinuara në mes të trashëgimisë natyrore, kulturore, arkitekturore dhe arkeologjike. Turizmi malorë ne Komunën e Deçanit është ma i parapëlqyeri ndërsa i përcjellë me atë rural (me shumë kulla dhe tradita) dhe ma pak ai urban.

Me 13. Dhjetor 2012 vargmalet e Bjeshkëve te Nëmura shpallen “Park Kombëtar” dhe miratohet Ligji Nr. 04/L – 086 “Ligji për parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna ”. Duke ju referuar neneve të këtij ligji gjegjësisht Neni 3. Regjimet e Mbrojtjes, të gjitha propozimet për zhvillimin e kësaj zone duhet të janë në përputhje me regjimet mbrojtëse të zonës parë, dytë, tretë dhe katërt. *Andaj gjatë hartimit të projekt PZHK-së, të gjitha veprimet për zhvillimin e zonës turistike në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna ” janë marr në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”.*

Për lehtësim të orientimit drejt zonave turistike dhe pikave të interesit, deri me tani është realizuar edhe sinjalizimi i shtigjeve për alpinizëm dhe biçikleta. Është hapur edhe Qendra për

[37] Numri i ndërmarrjeve të shuara sipas komunave dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike, ASK

Informim Turistik në Deçan, e cila ofron material promovues dhe informues për Bjeshkët e Deçanit, siç janë: Fshati i Pleqes, Fshati historik Belle, Bjeshka e Strellcit, Bjeshka e Kurvallës - Lloqanit, Bjeshka e Prilepit, Bjeshka e Milishevcit, Bjeshka e Roshkodolit, Bjeshka e Madhe - Deçanit, Bjeshka e Budoshit, Bjeshka e Lumëbardhit, Bjeshka e Irzniqit, Bjeshka e Zllonopojës, Bjeshka e Baballoqit, Bjeshka e Pllaqicës, Bjeshka e Carrabregut - Koria, Bjeshka e Jedovës dhe Bjeshkët e Belegut. Ne të gjitha bjeshkët e lartpërmendura interesimi nga vizitorët është gjithnjë e në rritje ndërsa në dimër ato po zgjojnë interes për sportet dimërore. Deri me tani ne Komunën e Deçanit janë te identifikuara tre zona turistike nga te cilat dy janë private dhe një publiko - shoqërore.

Zonat turistike, sipas pronësisë, 2011 - 2022				
Pronësia	Ndërmarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Private	2	2	2	2
Publike - Komunale	0	0	0	0
Publiko (Komunale) - Private	0	0	0	0
Publike - Shoqërore	0	1	1	1
Publiko (Shoqërore) - Private	0	0	0	0
Gjithsej	2	3	3	3

Tabela 38. Zonat turistike, sipas pronësisë, 2011 - 2022

Shtrirja sipërfaqësore është më e madhe në zonën rurale me gjithsejtë 28741 ha ndërsa në atë urbanë 99.18 ha. Kapacitet akomoduese janë me te larta ne zonën rurale në krahasim me atë urbane ndërsa të dhënat nga Qendra Informuese Turistike në Komunën e Deçanit tregojnë se nga viti 2011 deri në vitin 2022 ne të dy zonat ka rritje kapaciteteve akomoduese. Ne zonën urbane nga viti 2011 kur ishin 643 akomodime, në vitin 2022 kemi rritje në 1147 akomodime kurse ne zonën rurale nga 1673 akomodime në vitin 2011, kemi rritje në 5356 akomodime ne vitin 2022.

Zonat turistike, sipas njësisë kadastrale, 2011 - 2022				
Njësia kadastrale	Zona turistike (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Njësia kadastrale A - Zona Urbane	1	1	1	1
Njësia kadastrale B - Zona Rurale	1	2	2	2
Gjithsej	2	3	3	3

Tabela 39. Zonat turistike, sipas njësisë kadastrale, 2011 – 2022

Zonat turistike, shtrirja sipërfaqësore, 2011 - 2022				
Kodi	Sipërfaqja (ha)			
	2011	2012	2013	2022
Njësia kadastrale A, Zona turistike 01	99.18	99.18	99.18	99.18
Njësia kadastrale A, Zona turistike 02	0	0	0	0
Njësia kadastrale B, Zona turistike 01	16765	16765	16765	16765
Njësia kadastrale B, Zona turistike 02	11976	11976	11976	11976
Gjithsej	28840.18	28840.18	28840.18	28840.18

Tabela 40. Zonat turistike, shtrirja sipërfaqësore, 2011 - 2022

Zonat turistike, kapacitetet akomoduese, 2011 - 2022				
Kodi	Kapacitetet akomoduese (nr.)			
	2011	2012	2013	2022
Njësia kadastrale A, Zona turistike 01	643	687	758	1147
Njësia kadastrale A, Zona turistike 02	0	0	0	0
Njësia kadastrale B, Zona turistike 01	1352	1352	1542	4658
Njësia kadastrale B, Zona turistike 02	321	304	411	698
Gjithsej	2316	2343	2711	6503

Tabela 41. Zonat turistike, kapacitetet akomoduese, 2011 – 2022

Komuna e Deçanit nuk gëzon strategji të qëndrueshme të zhvillimit turistik andaj zona urbane karakterizohet me mikpritjen, gastronominë tradicionale, festivale te ndryshme dhe mullinj të vjetër. Në zonën urbane janë 2 hotele dhe 18 restorante me 37 dhoma dhe me 78 shtretër si dhe 6 vila me 42 shtretër. Gastronomia ofron 292 tavolina verore dhe 338 tavolina ne hapësira te mbyllura (gjithsejtë 630 tavolina me 2520 karrige)[38]. Është në përfundim kompleksi i Qendrës Rinore shumë funksionale në Podin e Gështenjës ku në kuadër të kompleksi janë; Ndërtesa e Qendrës Rinore, Pishina e mbuluar, Restoranti më ushqime tradicionale, 24 bujtina për akomodim dhe Kolonia e Artistëve.

Në zonën rurale, Komuna e Deçanit posedon shumë shtëpi karakteristike të kësaj zone – kulla të cilat kanë vlera të mëdha arkitekturore ku përpos arkitekturës këto kulla mbajnë tregime, histori dhe traditat e veta sikurse Kulla e Zymer Himës tani që është muze etnografik i Qytetit.

Ekziston një numër mjaft i madh i kullave të Komunën e Deçanit e që për fat të keq shumë nga ato janë rrënuar në luftën e fundit në Kosovë mirëpo disa nga ato kanë shpëtuar e një numër i tyre edhe rindërtuar dhe të shpjeguar në pjesën trashëgimisë kulturore. Gjithashtu edhe disa zona arkeologjike dhe supozime për zona te reja arkeologjike paraqesin potencial për zhvillimin e Deçanit në aspektin e turizmit. Deçani ka mundësi të mira për zhvillimin të degëve te ndryshme te turizmit edhe pse tani ekzistojnë mjaft zhvillime komunale, ndër komunale dhe ndërshtetërore.

Deri me tani llojet e turizmit te cilat ofrohen nga Komuna e Deçanit janë:

Turizmi malorë - Deçani ka vende atraktive turistike, që shfrytëzohen nga vizitoret për ekskursione, për sport, rekreacion, pushim, kulturë, për arsim e edukim. Me turizmin malor nënkuptojmë lëvizjen e njerëzve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore. Të gjitha Bjeshkët e Deçanit, kanë terrene shumë të mira për zhvillimin e turizmit malor, të cilat ofrojnë mundësi reale për ecje dhe biçikleta e që këtu duhet të ceken zhvillimi i aktiviteteve "Via Dinarica" dhe "Peaks of Balkan" (Majat e Maleve Ballkanike). *Zhvillimi i ardhshëm i turizmit malor do te jetë ne përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.*

Turizmi rekreativ dhe sportiv - Bjeshkët e Deçanit, posedojnë burime natyrore rekreative me terrene sportive për zhvillimin e turizmit rekreativ dhe sportiv. Turizmi rekreativ është lëvizja e njerëzve në kohën e tyre të lirë për të kaluar kohën në terrene atraktive ku burimet rekreative janë të pranishme në të gjitha Bjeshkët e Deçanit.




Figura 8. Projekti i Qendrës Turistike Bjeshka e Belegut

[38] Qendra për informim turistik, komuna e Deçanit

Në vitin 1978, është hartuar plani i fizibilitetit ekonomik nga "Instituti për zhvillim ekonomik" i Zagrebit, Bjeshka e Belegut-Qendër Turistike e Skitarisë. Bjeshka e Belegut, ofron kushte të mira për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit por duhet të veçohet potenciali për zhvillimin e turizmit dimëror, pasi trashësia e borës arrin 3-5 m, në lartësinë 2200 m, me gjatësi shtigjesh 1-5 km. Vetë ekspozicioni i këtyre terreneve, veri-perëndim, veri-lindje dhe jug-lindje, ofrojnë kushtet të favorshme për skitari, nga muaji dhjetor deri në muajin maj. Pranvera dhe vjeshta i japin një koloritet të jashtëzakonshëm kësaj natyre, ku i gjithë territori merr spektrin e ngjyrave të llojllojshme vjeshtore.

Bjeshka Belegut - paraqet një produkt turistikë të rëndësishme jo vetëm për zhvillim lokal, por dhe për Kosovën në përgjithësi ku duhet në të ardhmen të investohet në infrastrukturën turistike në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.

Turizmi veror dhe dimëror - Ky lloj i turizmit është mjaft i përhapur në Bjeshkët e Deçanit, duke u bazuar në burimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske, terrenet e përshtatshme për infrastrukturë turistike. Lokacionet që ofrojnë kushte për turizmin veror dhe dimëror dhe që kanë vlera turistike janë të gjitha në Bjeshkët e Deçanit. Si produkt turistik është edhe shtegu i hekurt "Via Ferrata", i cili është një atraksion i veçantë turistik për ecje dhe ngjitje, që ndodhet përgjatë Grykës së Deçanit të Kërshi i Qelisë, 4 km larg qendrës së qytetit pastaj Shtëpia Bjeshkatare Alpine "Shkëlzen Haradinaj" te Bjeshka e Belegut më largësi 18 km nga qyteti, fshati turistik në Belle dhe fshatin Pleqe. *Turizmi veror dhe dimëror ne te ardhmen në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" do te zhvillohet në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.*

Speleoturizmi (shpellave) - Për opinionin e gjerë nuk janë të njohura bukuritë natyrore të Shpellës së Bojkut dhe Shpella në fshatin Belle, në të cilën shihen gjurmët e njerëzimit, që kanë qenë aty brenda po ashtu nën shpellë ka edhe liqe dhe burime të tjera ende të pa hulumtuara dhe studiuara, të cilat janë pasuri për vendin. *Te gjitha zhvillimet e Speleoturizmit në pjesën e parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" do te zhvillohet në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.*

Turizmi rural dhe kulturor - Në shumë zona rurale të Komunës së Deçanit, ka monumente kulturore me potencial arkitektonik – kullat, po ashtu duke përfshi edhe kulturën materiale - shpirtërore ku ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra tradicionale, këngë, veshje e ushqime tradicionale, që ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e turizmit rural. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Për këto vlera shquhen këto fshatra, të cilat janë: Pleqe, Belle, Hulaj, Voksh, Drenoc, Gllogjan, Isniq, Dubovik, Strellc i Epërm. *Turizmi rural i cili zhvillohet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna " do zhvillohen në të ardhmen në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë*.

Turizmi edukativ arsimor - Ekosistemet dhe habitatet malore, prania e llojeve të rralla të florës dhe faunës, shpellat e pa hulumtuara, kanionet e lumenjve, burimet dhe rrjedhat e shumta ujore, kanë nxit interesim për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme edukative – arsimore dhe shkencore në gjithë territorin e Komunës së Deçanit. *Turizmi edukativ arsimor i cili zhvillohet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna " do zhvillohen në të ardhmen në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.*

Turizmi kurativ (shëndetësor) – ne vitet e fundit është zhvilluar mjaft ne te gjithë Komunën e Deçanit e me theks te veçantë në zonën malore. Prezenca e llojllojshmërisë se florës ka ndikuar ne rritjen e interesimit për ti vizituar këto zona dhe grumbulluar bimë te ndryshme për shërim. Mirëpo, përkundër

nevojave për grumbullimin e bimëve shëruese, është e rëndësishme që ky lloj i grumbullimit te kontrollohet dhe menaxhohet ma mire sepse mund te ketë ndikim ne zhdukjen e llojeve te caktuara bimore dhe ndikim ne faunën e kësaj zone.
Në kuadër të turizmit kurativ, Komuna e Deçanit posedon burimin e ujit mineral i njohur si destinacion turistik kurativ (shëndetësor) i veçantë "Uji i thartë" (Gushavci). Kjo pike turistike me ujë mineral ofron veti shëruese – kurimi për disa sëmundje ngjitëse, sëmundjeve te lëkurës, sëmundjeve te eshtrave etj. Ky është një burim ne masivin gëlqeror i llojit karstik dhe buron nga qarjet dhe plasaritjet e tokës dhe një pjese ne aluvionet e lumit. Sasia e rrjedhjes është Q=16 l/s, 180 m dhe derdhet ne një basen te ndërtuar nga banoret i cili nuk i plotëson kushtet teknike dhe higjienike, andaj duhet te behën investimet e duhura për përdorimin e këtij uji. Gjithashtu, për zhvillimin e këtij projekti është e nevojshme që të arrihet marrëveshje edhe me Manastirin e Deçanit. *Turizmi shëndetësor i cili zhvillohet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna " do zhvillohen në të ardhmen në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.*

Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" - paraqet një regjion gjeografik me bukuri të rrallë, me pasuri të madhe të elementeve të peizazhit si: bjeshkë të larta të zhveshura me dëborë në maja, pyje mbresëlënëse me lloje të ndryshme ku me bukuri dominojnë pishat e larta, lugina magjepsëse e gryka të thella mahnitëse, kullosa e livadhe me lule të gjitha ngjyrave, burime e rrjedha të shumta ujore që formojnë përroska e lumenj, shpella të bukura dhe liqene përrallore në bjeshkët e larta. Bjeshkët e Nemuna e përbejnë 26% të sipërfaqes se Komunës Deçanit. Kjo zonë deri me tani është përdor si vend atraktiv natyror për turizëm veror dhe dimëror. Në dimër si vendet ma tërheqëse janë Bjeshkët e Belegut, Bjeshka e Carrabregut, Bjeshka e Deçanit, Kurvallës, Dervish Komi kurse gjatë verës janë përdor mjaft për ecje malore (hiking) dhe çiklizëm. *Me 13. Dhjetor.2012 Bjeshkët e Nemuna janë shpallur Park Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna " të cilat trajtohen me Ligjin nr./L- 086, dhe të gjitha veprimet ne të ardhmen ne ketë pjesë të Komunës se Deçanit do të trajtohen në harmoni të plotë me ligjin e sipërpërmendur dhe me Planin Hapësinorë Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"*

Turizmit ndërkufitar shtigjet (Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike) - është një fushë e cila ka ndikuar ne promovimin e Komunës së Deçanit dhe në rritjen e zhvillimit ekonomik për vendbanimet buzë kufijve ne mes të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ku lloj i turizmit përpos zhvillimit ekonomik të vendbanimeve buzë kufijve, ai po ashtu ka arrit që ti ruaj traditat, zakonet dhe lidhjet e kamotshme të këtyre viseve. Ecja malore ose ndryshe hiking dhe çiklizmi malor janë disiplinat të cilat janë zhvilluar më se shumti në dekadën e fundit ne ketë rajon. Në ketë drejtim janë zhvilluar projekte madhore siç janë shtegu Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike.
Via Dinarica - promovon turizmin e përgjegjshëm në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Shtegu, i cili shtrihet rreth 2,000 kilometra, është një korridor kulturor dhe lidhë vendet dhe Komunitetet përgjatë Alpeve Dinarike dhe Vargmalit të Sharrit, duke vënë në pah peizazhin e rajonit dhe traditat e tij të ndryshme. Ky është një shteg i cili lidh Sllovenínë, Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë, Kosovën (nëpërmes Deçanit, Pejës, Istogut dhe Zubin Potokut) me Maqedoninë.
Shtegu turistik "Majat e Maleve Ballkanike" - është i gjatë 197 km, që krijon një rreth të mbyllur në të tri shtetet, Shqipëri (Theth), Mali i Zi (Plavë) dhe Kosovë (Bjeshkët e Deçanit), vizita mund të filloj nga cilido shtet ku këto shtigje mund të kalohen për 10 -13 ditë.
Bashkëpunimi ndërkufitar mes tri shteteve Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi në sektorin e turizmit është i madh, pasi që ketë e mundëson pozita gjeografike. Lidhjet tjera te vendbanimeve ne mes te tre shteteve bëhen edhe me shtigje tjera siç janë: shtegu - Lugu i Shkodrës që lidhë Roshkodolin me Shkodrën dhe shtegu i tre kufirit qe lidhë Plavën (Malin e Zi), Shkodrën (Shqipërinë),Roshkodolin, dhe Bjeshkën e Belegut. *Turizmi ndërkufitar i cili zhvillohet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna "*

do zhvillohen në të ardhmen në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna " dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.

.





Figura 9. Harta informuese e shtegut për ecje ndërkufitare – Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi




Harta 6. Zhvillimi ekonomik dhe turizmi

Qendra Turistike Informuese - e cila gjendet vetëm 500 m, nga qendra e Deçanit, në rrugën e Manastirit të Deçanit është pikë orientuese e turisteve që vizitojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Komunës së Deçanit. Kjo zyre ofron edhe materiale të ndryshme si broshura dhe udhëzues të ndryshëm që turistët ta kenë më të lehtë qasjen në trashëgimin kulturore dhe natyrore të Komunë së Deçanit, mundësinë e shfrytëzimit, akomodimit dhe ushqimit në lokalitete të ndryshme që i përkasin kësaj zone. Puna në këtë zyrë organizohet dhe drejtohet prej zyrtarëve Komunal përgjegjës, të cilët kryejnë punë në bazë të programit të tyre vjetor si: zhvillimin e politikave të turizmit të qëndrueshëm, hulumtimet e produkteve turistike, përpunimin e të dhënave të nevojshme për turizëm, hartimin e projekteve për zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit, përgatitjen e materialeve promovuese, si dhe promovimin e Bjeshkëve të Deçanit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Qendra Turistike Informuese, bënë edhe shpërndarjen e informatave për turistët si dhe shërbehen ata me harta, broshura, fletushka me fotografi të ndryshme, fletushka me informacione për florën dhe faunën, broshura të shtigjeve për ecje malore, udhërrëfyes për ndërtesat e trashëgimisë kulturore dhe gastronominë.

2.5.5 Bujqësia

Komuna e Deçanit, është Komunë ku pjesa dërmuese e popullsisë jeton në zonat rurale ku në zonat rurale jetojnë rreth 74.19% e popullsisë së tërësishme të Komunës së Deçanit. Bujqësia është veprimtari kyçe në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të Komunës së Deçanit. Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë dhe prodhimin e rendimenteve të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkatari. Komuna e Deçanit, ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë, gjithashtu ka fond të konsiderueshëm edhe të tokës bujqësore.



Harta 7. Shfrytëzimi i tokës

Në zhvillimin e bujqësisë kontribuojnë edhe ekspertët dhe teknikët e bujqësisë, ku në këtë Komunë janë mbi 45 agronom të diplomuar dhe afër 200 teknik të bujqësisë të cilët ndihmojnë me këshilla profesionale dhe punë të drejtpërdrejtë. Ne vitin 2023 janë identifikuar 10 ndërmarrje bujqësore dhe 361 ferma familjare që krahasuar me vitin 2013 kur ne këtë Komune ishin 25 ndërmarrje private bujqësore, ne vitin 2023 ekzistojnë vetëm 10 të tilla.

Fermat familjare, sipas vendbanimeve, 2011- 2023				
Vendbanimet	Ndërmarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2023
Baballoq	/	/	/	14
Beleg	/	/	/	12
Belle	/	/	/	/
Carrabreg i Epërm	/	/	/	3
Carrabreg i Ulët	/	/	/	7
Dashinoc	/	/	/	11
Deçan	/	/	/	16
Drenoc	/	/	/	4
Dubovik	/	/	/	17
Dubravë	/	/	/	3
Gllogjan	/	/	/	11
Gramaqel	/	/	/	5
Hulaj	/	/	/	3
Irzniq	/	/	/	26
Isniq	/	/	/	47
Kodrali	/	/	/	5
Lëbushë	/	/	/	3
Lumbardh	/	/	/	12
Lloqan	/	/	/	1
Llukë e Epërme	/	/	/	8
Llukë e Ulët	/	/	/	3
Maznik	/	/	/	11
Papiq	/	/	/	1
Pobergjë	/	/	/	14
Pozhar	/	/	/	5
Prapaqan	/	/	/	13
Prokolluk	/	/	/	6
Prilep	/	/	/	12
Rastavicë	/	/	/	2
Ratish i Epërm	/	/	/	10
Ratish i Ulët	/	/	/	10
Sllup	/	/	/	2
Strellc i Epërm	/	/	/	34
Strellc i Ulët	/	/	/	14
Shaptej	/	/	/	8
Voksh	/	/	/	2
Vranoc i Vogël	/	/	/	6
Pleqe	/	/	/	0
Gjithsejtë	0	0	0	361

Tabela 42. Fermat familjare, sipas vendbanimeve, 2011- 2023


2.5.6 Sipërfaqet bujqësore dhe kualiteti i tyre

Territori i Komunës Deçanit karakterizohet me pjesën malore dhe e pasur me flore dhe faune si dhe me pjesën e rrafshët e cila karakterizohet me toke kualitative dhe produktive të tokës bujqësore /sipërfaqe, tokë e punueshme/ arë, kopshte, livadhe dhe tokë bujqësore e pa përdorur e që përfshinë 60% të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Deçanit prej (293,94 km^2).

Ndër to më se shumti ka tokë të mirë të klasës I, II dhe III me (60%) sipërfaqe ndërsa ma së paku tokë të varfër respektivisht klasa V, VI me (15%) sipërfaqe. Tokë të mesme të kualitetit IV ka 25% të sipërfaqes kurse sa i përket bonitetit të tokës më se shumti ka të klasës 6 me 12094 ha, pastaj klasa 4 me 6501 ha, klasa 8 me 3204 ha dhe kështu me radhë.


Lloji i tokës									
	Tokë e mirë			Tokë e mesme			Tokë e varfër		
Klasa	I, II, III			IV			V, VI		
Sipërfaqja ne %	60%			25%			15%		
Klasa e bonitetit									
	1	2	3	4	5	6	7	8	Gjithsejtë
Sipërfaqe ha	3380	2205	1549	6501	118	12094	1246	3204	29397
%	11.5	7.5	5.3	19.1	0.4	41.1	4.2	10.9	100

Tabela 43 Lloji i tokës dhe klasa e bonitetit



Harta 8. Boniteti i tokës

Në vitin 2023 janë identifikuar 13447 ha tokë bujqësore ku pjesa ma e madhe e tokës bujqësore është private, gjegjësisht 13247 ha, ndërsa pronë shoqërore janë 200 ha.



Harta 9. Toka bujqësore

2.5.7 Kultivimi i kulturave bujqësore

Në Komunën e Deçanit, nga sipërfaqja e tërësishme bujqësore prej 18098.44 ha rreth 55 % janë tokë e kultivuar bujqësore, 5% janë tokë bujqësore jo e kultivuar dhe 40% janë livadhe dhe kullota.

Toka bujqësore, sipas kategorive te shfrytëzimit dhe shtrirjes hapësinore, 2011- 2023				
Kategoritë	Sipërfaqja (ha)			
	2011	2012	2013	2023
Tokë bujqësore e kultivuar	/	/	/	10043.88
Tokë bujqësore jo e kultivuar	/	/	/	1051.39
Livadhe dhe kullota	/	/	/	7003.17
Gjithsej	0	0	0	18098.44

Tabela 44. Toka bujqësore, sipas kategorive te shfrytëzimit dhe shtrirjes hapësinore, 2011- 2023

Përdorimi i mekanizmave - bujqësor në Komunën e Deçanit është i ndryshëm. Te gjitha janë private por ka edhe një numër të cilat janë donacione nga niveli Komunal dhe organizatat e ndryshme. Ne përgjithësi këto mekanizma kanë trend në rritje mirëpo numri i traktorëve nga viti 2011 deri ne vitin 2023 ka një trend te rrënjës ne masë 9.82%.

Prodhimtaria bujqësore e drithërave – është kultura që ka luhatje dhe prodhim në bazë te produkteve te caktuara. Të kultura e grurit nga viti 2011 deri ne vitin 2023 ka pas luhatje ne rendimente dhe kultivim mirëpo ne vitet e fundit ky trend ka rritje të rendimentit gjithashtu kanë kultivim dhe rritje të rendimentit të gjitha kulturat e lavërtarisë. Sipërfaqet më misër, po ashtu kanë rritje të dukshme dhe kryesisht vërehet rritje e sipërfaqeve të kultivuara me misër të hibrideve të ndryshme dhe ulje e sipërfaqeve të kultivuara me misër autokton. Gjendja e njëjtë është edhe me thekër ndërsa sipas të dhënave, tërshëra dhe elbi ne vitin 2023 nuk kanë zgjuar interes për tu kultivuar.

Drithërat, llojet dhe prodhimtaria, 2011 - 2023								
	Prodhimi (t / ha)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011 - 2012	2012 - 2023	2013 - 2023	2011 - 2023
Gruri	3.76	3.35	3.85	3.75	-10.90	11.94	-2.597403	-0.265957
Misër	3.4	2.77	3.78	3.95	-18.53	42.60	4.4973545	16.176471
Thekër	2.4	2.4	2.92	3.8	0.00	58.33	30.136986	58.333333
Tërshëra	2.46	2.14	2.89	0	-13.01	-100.00	-100	-100
Elb	3.09	3.18	3.24	0	2.91	-100.00	-100	-100
Gjithsejtë	15.11	13.84	16.68	11.5	-39.53	-87.13	-167.96	-125.76

Tabela 45. Drithërat, llojet dhe prodhimtaria, 2011 – 2023

Prodhimtaria bujqësore e perimeve - për çdo vit janë në shtim e sipër në sipërfaqe tek fermerët. Bimët foragjere kanë gjithashtu rritje në sipërfaqe, ndërsa livadhet natyrale po zvogëlohen duke u rritur livadhet artificiale. Speci, qepa, lakra dhe shalqiri janë produkte vendore të cilat prodhohen ne masë të madhe ne ketë Komunë ndërsa domatja ka pasur rrënje krahasuar nga viti 2011, mirëpo trendi në vitet e fundit për prodhimin e domates është në rritje.

Perimet, llojet dhe prodhimtaria, 2011- 2023								
	Prodhimi (t / ha)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2023	2011 - 2023
Speci	32.18	16.09	19.79	41.08	-50	22.996	107.580	27.657
Domatja	63.4	20.28	18.2	32.1	-68.01262	-10.256	76.374	-49.369
Qepë	12.68	9.76	14.44	18.84	-23.02839	47.951	30.471	48.580
Lakër	27.49	16.59	25.76	30.03	-39.65078	55.274	16.576	9.240
Shalqinj	22.56	20.16	21.33	28.36	-10.6383	5.804	32.958	25.709
Gjithsej	158.31	82.88	99.52	150.41	-191.33	121.77	263.96	61.82

Tabela 46. Perimet, llojet dhe prodhimtaria, 2011- 2023

Prodhimtaria bujqësore e pemëtarisë – kanë gjetur treg të mjaftueshëm ne produktet e caktuara siç është kultivimi i mollës, dardhës dhe arrave që janë ne rritje dhe karakterizohen si produkte mjaft kualitative vendore me theks te veçantë “Arrat e Deçanit” ndërsa gjendja e prodhimit te dredhëzave dhe kumbullës ne vitet e fundit është karakterizuar me rrënje te prodhimit.

Pemët, llojet dhe prodhimtaria, 2011 - 2023								
	Prodhimi (t / ha)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011- 2012	2012 - 2013	2013 - 2023	2011 - 2023
Mollë	7.55	4.71	8.29	15.01	-37.616	76.01	81.06	98.81
Dardhë	7.09	4.79	7.59	7.31	-32.440	58.46	-3.69	3.10
Kumbulla	6.54	12.47	13.26	5.84	90.673	6.34	-55.96	-10.70
Dredhëz	6	5.29	3.14	5.62	-11.833	-40.64	78.98	-6.33
Arrë	4.94	4.1	5.3	5.6	-17.004	29.27	5.66	13.36
Gjithsej	32.12	31.36	37.58	39.38	-8.221	129.42	106.06	98.23

Tabela 47. Pemët, llojet dhe prodhimtaria, 2011 – 2023

Prodhimtaria bujqësore e foragjereve – ne përgjithësi ka pas trend te rritjes ne vitin 2023 ne krahasim me vitin 2011 kur prodhimi i përgjithshëm ishte 34.14 ton. Te dhënat për prodhimin e foragjereve tregojnë rritje te dukshme për 7.03 ton ne krahasim me vitin 2011, mirëpo disa kultura e sidomos jonxhet kanë pas trendë negative të prodhimit ndërsa ne anën tjetër tërfili, misëri, arra kanë trend të mirë të rritjes nga viti të vit.

Foragjeret, llojet dhe prodhimtaria, 2011- 2023								
	Prodhimi (t / ha)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2014	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2023	2011 - 2023
Jonxhe	9.86	3.51	3.93	4.29	-64.402	11.966	9.16	-56.491
Terfili	3.1	2.94	3.92	3.59	-5.161	33.333	-8.418	15.806

Përzierje	3.39	2.44	2.95	3.35	-28.024	20.902	13.559	-1.18
Misër	15.01	11.15	19.11	18.3	-25.716	71.39	-4.239	21.919
Arre	2.78	2.31	2.65	3.53	-16.906	14.719	33.208	26.978
Gjithsejtë	34.14	22.35	32.56	33.06	-140.21	152.31	43.27	7.03

Tabela 48. Foragjeret, llojet dhe prodhimtaria, 2011- 2023

2.5.8 Prodhimtaria blegtorale

Prodhimi i qumështit - në Komunën e Deçanit, ekzistojnë dy pika grumbulluese për qumështin, ndërsa nuk ka pikë grumbulluese dhe përpunuese të prodhimeve bujqësore, kështu që fermerët janë të detyruar që tepricën e prodhimeve të tyre ta tregtojnë në tregjet tjera të Kosovës. Prodhimi i qumështit te lopës dhe deles ne vitet e fundit ka rrënje ndërsa qumështi i dhisë ka rritje mirëpo ne përgjithësi prodhimi i qumështit në sektorin e blegtorisë ne Komunën e Deçanit ka rrënje të madhe.

Qumështi, llojet dhe prodhimtaria, 2011 - 2023								
	Prodhimi (l)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011 2012	2012 2013	2013 2023	2011 2023
Qumësht lope	10200000	9600000	9900000	1329528	-5.88	3.125	-86.57	-86.97
Qumësht dele	1022670	990660	956010	786720	-3.13	-3.497668	-17.71	-23.07
Qumësht dhie	55200	71940	71280	62124	30.33	-0.917431	-12.85	12.54
Lloji 4	/	/	/	/	/	/	/	/
Lloji 5	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsejtë	11277870	10662600	10927290	2178372	21.31	-1.29	-117.12	-97.49

Tabela 49. Qumështi, llojet dhe prodhimtaria, 2011 – 2023

Prodhimi i mishit - Në zonat rurale infrastruktura bujqësore kërkon investime për ngritjen e kapaciteteve për prodhime bujqësore. Sipërfaqet e konsiderueshme të kullosave dhe livadheve janë potencial i rëndësishëm i Komunës së Deçanit, për zhvillimin e blegtorisë e cila në veçanti shtrihet në pjesën rurale. Nga prodhimet blegtorale përpos qumështit, rëndësi është edhe prodhimi i mishit. Edhe sektori i prodhimit te mishit ka pësuar luhatje nga viti në vit ku krahasuar me vitin 2011 prodhimi i mishit në vitin 2023 ka trend të rrënjës për 32.14 % të mishit të deles ose me prodhim 19 ton, dhe 3.33% ose me prodhim 696 ton të mishit të gjedhit, e në total 35.48% prodhim ma pak se në vitin 2011.

Gjedhet - nga viti 2011 deri ne vitin 2023 ka një rritje te ndjeshme në përgjithësi mirëpo sa i përket llojeve ku duhet të cekët se nga 3400 krerë lope në vitin 2011 ka rrënje në 2397 krerë ne vitin 2023. Sa i përket mëshqerrave këtu dallohet një trend i rritjes gjegjësisht nga 600 krerë vitin 2011 në 882 në vitin 2023.

Delet – nga viti 2011 deri ne vitin 2023 karakterizohet me rrënje te numrit te krerëve sa i përket deleve mbarështimi kur në vitin 2011 ishin 3099 ndërsa në vitin 2397. Gjendja e njëjtë është edhe me qengja kur në vitin 2011 ishin 4022 krerë ndërsa në vitin 2023 gjithsejtë 790 krerë. Trendi i deleve ne vitin 2023 në krahasim me vitin 2011 është në rrënje të madhe.

Dhitë – kanë një trend ma pozitiv sa i përket koncentrimit të tyre ne Komunën e Deçanit. Cjapi ka rritje nga 32 sa i shin në vitin 2011 në 53 të tilla sa janë në vitin 2023. Ndërsa gjendja e dhive ka trend negativ gjegjësisht nga 184 të tilla sa ishin në vitin 2011 ndërsa sipas të dhënave në vitin 2023 janë gjithsejtë 172 të tilla. Mirëpo trendi i dhive ne përgjithësi mund të konsiderohet si trend me rritje pozitive.

Derrat – kanë trend në rrënje në vitin 2023 në krahasim me vitin 2011 ndërsa sa i përket dosave, aty ka një rritje të vogël. Duke e marr parasysh përkatësinë e shumicës së popullsisë ne Komunën e Deçanit, rritja e derrave nuk konsiderohet si prioritet.

Shpezët – sipas të dhënave të ASK-së dhe Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka pas rritje te ndjeshme nga te cilat numri i gjelave në vitin 2011 ka qenë 1032 ndërsa në vitin 2023 ishte 1104 me një rritje prej 6.98%. Edhe numri i pulave ka pas rritje të ndjeshme nga viti 2011

sa ishin 10124 në 11425 në vitin 2013 me rritje prej 1.95% ose me një rritje të përgjithshme të shpendëve me 8.92%.

2.5.9 Pyjet

Pyjet e Komunës së Deçanit, janë thesari i çmuar i vendit duke ju falënderuar relievit, klimës dhe hidrografisë që i bënë ato dhe me atraktive. Në përgjithësi janë 15281 ha pyje nga te cilat 37% ose 5711 ha tokë pyjore private ndërsa 63% janë tokë pyjore shoqërore ose 9570 ha. Për nga kategoria janë tokë pyjore e shfrytëzuar për qëllime komerciale e cila nga viti 2011 sa ishte 582 ha në vitin 2023 ka pas rritje ne 5711 ha. Tokë pyjore e mbrojtur në vitin 2011 nuk ishte fare mirëpo pas shpalljes se Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna ", sipërfaqja e tokës pyjore të mbrojtur është rritur në 16765 ha ose në total 22476 ha.

Toka pyjore, sipas kategorive te shfrytëzimit dhe shtrirjes hapësinore, 2011 - 2023				
Kategoritë	Sipërfaqja (ha)			
	2011	2012	2013	2023
Tokë pyjore e shfrytëzuar për qëllime komerciale	582	790	860.13	5711
Tokë pyjore e mbrojtur	0	16765	16765	16765
Gjithsej	582	17555	17625.13	22476

Tabela 50. Toka pyjore, sipas kategorive te shfrytëzimit dhe shtrirjes hapësinore, 2011 – 2023

Nga sipërfaqja totale e tokës pyjore ne Komunën e Deçanit, tokë pyjore halore janë 8489,9 ha kurse tokë pyjore gjethe - rënëse 6946,6 ha. Pyjet shtrihen në lartësi të larta mbidetare, pika më e lartë është Gjeravica 2656 m , ndërsa pika më e ulët mbidetare është në Podin e Gështenjave

Ato janë burim kryesorë për prodhimin e biomasës tokësore dhe furnizuesi kryesorë me oksigjen, ku ruajnë tokën nga erozioni, erërat etj. Pjesa më e madhe e pyjeve të Komunës së Deçanit, është në pronësi publike, në viset e ulëta dominojnë pyjet e dushkut të cilat dita ditës po degradohen në mënyra të ndryshme, ndërsa në viset malore me të larta janë pyjet e pastra të ahut dhe halorëve (pishave) të ndryshme. Pyjet e Deçanit, janë jashtëzakonisht atraktive dhe ideale për vizitë turistike dhe për një pushim malorë. Pyjet e Komunës së Deçanit, kanë ndikim të madh në natyre nëpërmjet procesit të fotosintezës, fletët dhe halat e drurëve CO_2 (dyoksidi i karbonit) atmosferik konvertohet në karbon të ngurtë të depozituara në biomasë. Biomasa pyjore për prodhimin e energjisë përfshin drutë e zjarrit, mbetjet që rezultojnë nga procesi i shfrytëzimit (maja, degë, lëvore) dhe mbetjet e procesit të përpunimit industrial të drurit si tallash, ashkla etj. Harmonizimi i kërkesës dhe ofertës për dru zjarri dhe lëndë punimi ka qenë dhe mbetet një sfidë për ekonominë pyjore ndër vite. Vlen të theksohet se Pyjet në Komunën e Deçanit janë teje mase të pasuruara me Gështenjë apo ''Pema e Bukës'' siç njihet në këtë anë. Në bazë të dhënave vetëm në Komunën e Deçanit janë rreth 900 ha me Gështenjë, 80% e tyre në pronë shtetërore dhe 20% pronë private. Gështenja përpos vlerave të saja ushqyese mund të gjejë vend edhe në shumë prodhime industriale, e që për Komunën e Deçanit është edhe pasuri por edhe mundësi për zhvillim.

2.6 Infrastruktura teknike

Komuna e Deçanit në dekadën e fundit ka bërë mjaft investime kapitale ne infrastrukturën teknike me synim të rritjes së kualitetit te jetesës dhe mirëqenien e banoreve. Gjithashtu, nëpërmes investimeve ne infrastrukturën teknike, qeverisja lokale e Komunës se Deçanit ka për qellim që të ofroj oferta të mira për vizitoret dhe investitorët ekzistues me potencial në të ardhmen.

2.6.1 Ujësjellësi

Sistemi i furnizimit me ujë në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga K.R.U " Hidrodrini" SH.A Pejë - Njësia shërbyese Deçan, kurse furnizimi për qytetin dhe fshatrat e Komunës së Deçanit janë të gjitha burime nëntokësore si më poshtë:

7. Bjeshka e Strellcit përfshinë 6 burime
8. Gryka e Deçanit përfshinë 5 burime
9. Gryka e Deçanit - Gypi i CDF-së - përfshinë 3 burime
10. Bjeshka e Lloqanit përfshinë 3 burime
11. Burimi Gjipsi i Vokshit dhe Lugu i Zallit përfshinë 5 burime
12. Burimi Hulaj përfshinë 1 burim
13. Burimi Isniqit përfshinë 2 burime

Qyteti i Deçanit i ka 37 fshatra, ku 35 fshatra mbulohen me rrjetin e ujësjellësit me furnizim 99 % me ujë të pijes, ndërsa fshatrat Belle dhe Pleqe furnizohen nga burimet natyrore për shkak të konfiguracionit të terrenit malor. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Komunën e Deçanit, janë 40019 banorë, të cilët kanë qasje në sistemin e ujësjellësit 99.9%, ku numri i konsumatorëve në Komunën e Deçanit ishte 6472, nga amvisëria 6011, klient komerciale 414 dhe klient institucional 47[39]. Ne vitin 2023 të dhënat tregojnë për shtimin e numrit të konsumatorëve gjegjësisht të lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit për 18 konsumatorë të ri ose 6946 konsumator nga të cilët 6490 janë amvisëri, 407 klient komercial dhe 49 klient publik[40].


Sipas K.R.U "Hidrodrini" Pejë – Njësia shërbyese Deçan, gjatë një vitit shpenzohen 1110010 m³ për amvisëri ose me një mesatare prej 0.46 m³ në ditë; për klient komercial 85719 m³ ose me një mesatare prej 4.79 m³ ; dhe 59827 m³ në vit për klient publik ose mesatarisht 0.4 m³ në ditë. Totali i konsumit të ujit të pijshëm ne Komunën e Deçanit është 1,255,556 m³.

Rrjeti shpërndarës është i ndarë në rrjetin primar dhe sekondar, të përberë nga 13 tubacione (5 tubacion primare dhe 8 sekondare) me gjatësi të përgjithshme prej 68 km primare dhe 111.6 sekondare e që në total kemi 179.6 km tubacione. Vjetërsia e tubacioneve te rrjetit primarë është mesatarisht 27.5 vjet ndërsa vjetërsia e tubacioneve të rrjetit sekondarë është mesatarisht 29 vjet.

Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, rrjeti primar- seksionet, materiali dhe presioni nominal i tubacioneve, 2023				
Kodi referues	Tubacioni 01			
	Seksioni (Ø XX) mm	Materiali (XX)	Presioni nom. SN (bar)	Gjatësia (km)
Burimi Deçan 1, Deçan, Dubovik, Krushec, Papiq dhe Prapaqan	125	PE		16,708
Burimi Deçan 2, Deçan, Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Beleg dhe Lumbardh	125	PE		17,008
Burimi Isniq, Isniq	125	AC		5,075
Burimi Kurvallës dhe Hasan Aga, Dranoc, Irzniq, Prilep dhe Rastavicë	125	HDPE		25,945
Burimi Rakita dhe Gurrat e bardha, Strellc i Epërm	125	PVC		4,160

Tabela 51. Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, rrjeti primar- seksionet, materiali dhe presioni nominal i tubacioneve, 2023

[39] K.R.U "Hidrodrini" Sh.a – Njësia operative Deçan.
[40] K.R.U."Hidrodrini" Sh.a – Njësia operative Deçan.



Harta 10. Rrjeti dhe qasja ne ujësjellës

Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, rrjeti sekondar - seksionet, materiali dhe presioni nominal i tubacioneve, 2023								
Kodi referues	Tubacioni 01				Tubacioni 02			
	Seksioni (Ø XX) mm	Materiali (XX)	Presioni nom. SN (bar)	Gjatësia (km)	Seksioni (Ø XX) mm	Materiali (XX)	Presioni nom. SN (bar)	Gjatësia (km)
Burimi Deçan 1, Deçan, Dubovik, Krushec, Papiq dhe Prapaqan	50 - 125	PE		12,593				
Burimi Deçan 2, Deçan, Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ultë, Beleg dhe Lumbardh	50 - 125	CI		0,360	50 - 125	PE		32,100
Burimi Isniq, Isniq	50 - 125	PE		3,480	50 - 125	AC		2,621
Burimi Kurvallës dhe Hasan Aga, Dranoc, Irzniq, Prilep dhe Rastavicë	50 - 125	HDPE		41,032				7,131
Burimi Rakita dhe Gurrat e bardha, Strellc i Epërm	50 - 125	PVC		12,516	50 - 125	PE		

Tabela 52. Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, rrjeti sekondar - seksionet, materiali dhe presioni nominal i tubacioneve, 2023

Burimet e ujit te pijshëm janë nga 7 pika me gjithsejtë 25 burime ku Burimi Gryka e Deçanit e me 5 burime furnizon me më se shumti me ujë të pijshëm me gjithsejtë kapacitet prej 66.44 L/s, ndërsa burimi Gjipsi i Vokshi dhe Lugu i Zallit me 5 burime furnizojnë më se paku me ujë të pijshëm me kapacitet prej 27 l/s. Ne përgjithësi, në Komunën e Deçanit furnizohen me ujë të pijshëm 99 % e banorëve në 24 h dhe atë me një sasi prej 305.44 l/s.

Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, kapacitetet e burimeve, 2023		
Kodi referues	Sipërfaqësore	Nëntokësore (l / s)
Burimi, Bjeshka e Strellcit, 6 burime		40.00
Burimi, Gryka e Deçanit, 5 burime		66.44
Burimi, Gryka e Deçanit - Gypi i CDF - së 3 burime		42.00
Burimi, Bjeshka e Lloqanit, 3 burime		48.00
Burimi, Gjipsi i Vokshit dhe Lugu i zallit, 5 burime		27.00
Burimi,Hulaj,1 burim		37.00
Burimi, Isniqi, 2 burime		45.00

Tabela 53. Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, kapacitetet e burimeve, 2023

Sa i përket kapaciteteve konservuese gjegjësisht vëllimit të rezervuarëve, Komuna e Deçanit posedon 4817.68 m³, e ndarë në 8 njësi nga e cila Rezervuari i Drenocit është me kapacitet 760 m³ dhe konsiderohet si rezervuari ma i madh ne Komunën e Deçanit. Vjetërsia mesatare e strukturës se kapaciteteve konservuese konsiderohet të jetë 19.3 vjet e që është tregues se të gjitha investimet teknike te dedikuara ujit të pijshëm janë realizuar pas vitit 1999.

Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, kapacitetet konservuesë - rezervuarët, 2023	
Kodi referues	Kapacitetet konservuesë max. (m³)
Rezervuari i Cop - it	743.00
Rezervuari i NCA - së	508.68
Rezervuari i Isniqit	710.00
Rezervuari i Dranocit	760.00
Rezervuari i CDF - it	608.00
Rezervuari i Strellcit	628.00
Rezervuari i Hulaj	460.00
Rezervuari i Vokshit	400.00

Tabela 54. Infrastruktura e rrjetit te ujësjellësit, kapacitetet konservuesë - rezervuarët, 2023

Nr.	Mënyra e furnizimit							
	Vendbanimet	Sistemi	Menaxhimi	Burimi	Numri i banorëve	Numri i furnizimit	Furnizimi me %	Orët e furnizimit
1.	Deçan	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	3803	3803	100%	24 h
2.	Baballoq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1598	1598	100%	24 h
3.	Beleg	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	826	826	100%	24 h
4.	Belle	x	x	x	8	8	x	x
5.	Carrabreg i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	1446	1446	100%	24 h
6.	Carrabreg i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	2059	2059	100%	24 h
7.	Dashinoc	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	299	299	100%	24 h
8.	Drenoc	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4	1046	1046	100%	24 h
9.	Dubovik	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1060	1060	100%	24 h
10.	Dubravë	✓	Ujësjellësi	1.2.3	278	278	100%	24 h
11.	Gllogjan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	984	984	100%	24 h
12.	Gramaqel	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1097	1097	100%	24 h
13.	Hulaj	✓	Ujësjellësi	1.2.3	158	158	100%	24 h
14.	Irzniq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1739	1739	100%	24 h
15.	Isniq	✓	Ujësjellësi	1.2	3860	3860	100%	24 h
16.	Kodrali	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	808	808	100%	24 h
17.	Lëbushë	✓	Komunitet	1.2	1145	1145	100%	24 h
18.	Lumbardh	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	717	717	100%	24 h
19.	Lloqan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	499	499	100%	24 h
20.	Llukë e Epërme	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	1451	1451	100%	24 h
21.	Llukë e Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	506	506	100%	24 h
22.	Maznik	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	447	447	100%	24 h
23.	Papiq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	174	174	100%	24 h
24.	Pobergjë	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4	1314	1314	100%	24 h

25.	Pozhar	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	424	424	100%	24 h
26.	Prapaqan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	740	740	100%	24 h
27.	Prokolluk	✓	Ujësjellësi	1.2.3	288	288	100%	24 h
28.	Prilep	✓	Ujësjellësi	1.2.3	2165	2165	100%	24 h
29.	Pleqe	x		x	11	11	x	x
30.	Rastavicë	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1238	1238	100%	24 h
31.	Ratish i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3	210	210	100%	24 h
32.	Ratish i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3	560	560	100%	24 h
33.	Sllup	✓	Ujësjellësi	1.2.3	338	338	100%	24 h
34.	Strellc i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	3347	3347	100%	24 h
35.	Strellc i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	2114	2114	100%	24 h
36.	Shaptej	✓	Ujësjellësi	1.2.3	591	591	100%	24 h
37.	Voksh	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	570	570	100%	24 h
38.	Vranoc i Vogël	✓	Ujësjellësi	1.2.3	101	101	100%	24 h

Tabela 55. Mënyra e furnizimit

2.6.2 Rrjeti i kanalizimit fekal - ujërat e zeza

Në Komunën e Deçanit, sistemi i kanalizimit ka filluar të ndërtohet që nga viti 2007, dhe ende vazhdon shtrirja e rrjetit deri në kompletimin e tij final. Menaxhimi i rrjeti të ujërave të zeza bëhet nga K.R.U "Hidrodrini" Pejë – Njësia operative Deçan.


Gjatësia e përgjithshme e rrjetit te kanalizimit fekal është 64 572,36 m si dhe derdhja bëhet në 8 gropa septike kolektive në lokacione të ndryshme. Kjo gjatësi e shtrirjes së këtij rrjeti të kanalizimit mbulon një sipërfaqe prej 321 ha të vendbanimeve në Komunën e Deçanit të shpërndara ne 15 lokalitete dhe me sipërfaqe te ndryshme. Sipërfaqja ma e madhe e shtirjes së mbulueshmërise me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza është Deçani me 78.9 ha ndërsa ajo ma e vogla me sipërfaqe Sllupi me 10 ha. Gjerësia e zonës mbrojtëse shkon nga 3m deri në 15m ndërsa vjetërsia mesatare e te gjithë gropave septike kolektive është 16.8 vjet.

Rrjeti primar i kanalizimit fekal ka një gjatësi të përgjithshme prej 44841.72 km të dixhitalizuar, me material PVC SN8 me profile prej Ø 200 deri te Ø 1000, kurse është duke u vazhduar edhe në dixhitalizimin e pjesës së mbetur nga kompania menaxhuese.

Rrjeti sekondar i kanalizimit fekal ka gjatësi të përgjithshme prej 11340.48 km, me material PVC SN8 me profile prej Ø 200 deri te Ø 350.

Rrjeti primar dhe kanalizimit i kanalizimit fekal dhe gjatësia								
	Ø 200	Ø 250	Ø 315	Ø 400	Ø 500	Ø 630	Ø 800	Ø 1000
Rrjeti primarë gjatësia km	550.02	15917.69	7206.96	3610.42	3533.88	2613.4	947.1	1938.35
Rrjeti sekondarë gjatësia km	3,563.95	6,609.97	3,563.95	-	-	-	-	-

Tabela 56. Rrjeti primar dhe kanalizimit i kanalizimit fekal dhe gjatësia



Harta 11. Rrjeti i kanalizimit - qasja ne rrjetin e kanalizimit

2.6.3 Rrjeti i kanalizimit atmosferik

Në Komunën e Deçanit, ekziston rrjeti o kanalizimit për largimin e ujërave atmosferik i cili derdhet në drejtim të lumit të Lumëbardhit dhe i cili nuk ka trajtim. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit te kanalizimit atmosferik është 6500 metra ose 6.5 km, me material PVC SN78 me diametër - Ø 500 ndërsa vjetërsia e rrjetit atmosferik shkon nga 3 deri 13 vjet.

2.6.4 Ujitja

Për ujitje në territorin e Komunës, shfrytëzohen disa burime natyrore siç janë lumenjtë dhe puset (bunarët). Duke qenë se nuk ka një sistem të rregulluar të ujitjes sipas të dhënave sipërfaqet dhe sasitë e nevojshme për ujë nuk mund të verifikohet me saktësi, por supozohet se janë diku rreth 80 % e sipërfaqes së tokës bujqësore që mbulohet me ujitje. Komuna e Deçanit, ka një infrastrukturë të mirë për ujitjen e tokës bujqësore ku deri me tani kanale të betonuara janë gjithsej 61,110 m, por në të ardhmen për zhvillimin dhe rritjen e prodhimtarisë bujqësore investimet e Komunës do të përqendrohen në ndërtimin e infrastrukturës bujqësore.

Kanalet		Gjatësia	Viti i ndërtimit	Sipërfaqja projektuese e ujitjes	Gjendja	Investitorët donatorët
		L = m’		F = (ha)		
1	Kanali kryesor	5110	1936	550	Mirë	
2	Kanali Maznikut	5100	1936	350	E keqe	
3	Kanali i Ratishit	3400	1936	180	E keqe	
4	Kanali i Dashinocit	3900	1936	280	E keqe	
5	Kanali i Hulajve	1100	1936	280	E keqe	
6	Kanali i Luge Bunarit	5000	1936	440	E keqe	
7	Kanali i Dranocit	5000	2017 / 18	350	Mirë	MZHE-ja
8	Kanali Deçan – Carrabreg	6000	2013 / 14	500	Mirë	MZHE-ja
9	Vija e Gështenjës	2500	2017	450	Mirë	MZHE-ja
10	Kanali I Isniqit	5000	2014 /15	450	Mirë	MZHE-ja
11	Kanali I Prapaqanit	5000	2010	400	Mirë	MBPZHR
12	Kanali I Belegut	3000	2009	260	Mirë	MBPZHR
13	Kanalet ne Strellc	5500	2014	300	Mirë	MZHE-ja
14	Kanali Gushavcit	2500	2008/09	150	Mirë	CDF
15	Kanali Hulaj – Pobergjë	3000	2011	120	Mirë	MZHE-ja
	Gjithsejtë	61110	-	5000	-	-

Tabela 57 Infrastruktura ujore – kanalet e betonuara[41]

Komuna e Deçanit, duke u bazuar në projekt Planin Zhvillimor Komunal, ka identifikuar domosdoshmërinë për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në zonat rurale, ku janë identifikuar të gjitha kanalet e ujitjes që duhet të ndërtohen. Ndërtimi i kanaleve, do të ujitë rreth 4302 ha tokë punuese, ku rreth 60% e kësaj sipërfaqe është e mbjellë me perime dhe pemishte intensive. Andaj është e një rëndësie të veçantë ndërtimi i këtyre kanaleve për rritjen e rendimenteve te të gjitha kulturave bujqësore. Në Komunën e Deçanit në ndërtim janë 32 kanale me gjatësi rreth 51.2 km si dhe 3 penda ujitëse që planifikohen të ndërtohen në të ardhmen në Lumëbardhin e Lloqanit.


2.6.5 Sistemi për ujitjen e tokave bujqësore

Sistemi i ujitjes në Komunën e Deçanit, administrohet nga Kompania Rajonale e Ujitjes (KRU) “Drini i Bardhë” Pejë. Gjatësia e sistemit të ujitjes aktual është prej 61.110 m, ndërsa gjendja fizike e rrjetit është e mire.

Në infrastrukturën e ujitjes janë ndërtuar 8 penda, ose prita të ujit-furnizues për furnizim të kanaleve të ujitjes. Një pjesë e sistemit të ujitjes është tradicional, “Ujitje me Përmbytje”, që bëhet përmes kanaleve të hapura dhe përfaqëson mënyrën e ujitjes me shpenzime maksimale të ujit. Kjo paraqet problem, në veçanti gjatë muajve korrik - gusht kur sasia e ujit është e pamjaftueshme në mungesë të reshurave dhe temperaturave të larta. Për krijimin e kushteve të mira për ujitjen e tokave bujqësore, Komuna ka studimin e fizibilitetit për ndërtimin e tri pendave akumuluese në kanjonin e lumit të Lumëbardhit të Lloqanit.

Problem paraqet edhe ndërrimi i destinimit të tokës nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore, si pasojë e ndërtimeve të pakontrolluara në zonën rurale, e cila ka ndikuar në zvogëlimin e fondit të tokës bujqësore po ashtu ka ndikuar negativisht edhe në sistemin e ujitjes. Një pjesë e sipërfaqeve të tokës bujqësore ujiten përmes sistemit të thjeshtë (vija) të pa betonuar afërsisht prej 30 %, me kanale prej dheut ku furnizimi me ujë bëhet përmes burimeve natyrore.

[41] K.R.U Drini i Bardhë



Harta 12. Sistemi i ujitjes dhe drenazhimit

2.6.6 Energjia elektrike


Furnizimi i Kosovës, me energji elektrike bëhet nga dy burime primare: dy termocentralet me ndezje të thëngjillit "Kosova A" dhe "Kosova B" në rajonin e Prishtinës, dhe importeve përgjatë rrjetit 400 kv dhe 220 kv në termocentralin "Kosova B", përgjatë rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv.

Gjendja e rrjetit për furnizim me energji elektrike për momentin është e mirë, ku me ndihmën e donatorëve dhe investimeve Komunale është bërë riparimi i një pjese të madhe të këtij rrjeti duke përshirë tensionin e ulët dhe tensionin e lartë. Komuna e Deçanit, ka shtrirje me furnizim të energjisë elektrike edhe nga hidrocentrali i Kozhnjerit, i cili e bënë furnizim me 8 Mgv ku zbrazja bëhet në NS Deçan 110/35/10 kv.

Rrjeti primar është në gjendje të rregullt dhe funksional ku me tensionin e ulët furnizohen: Qyteti i Deçanit, (ndërtesat përgjatë rrugës kryesore furnizohen me rrjet nëntokësor), fshatrat Lëbushë, Dubovik, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm, Pozhar, Kodrali dhe Drenoc, ndërsa pjesërisht edhe fshatrat Strellci i Epërm, Strellc i Ulët dhe Isniqi.

Ne Komunën e Deçanit janë 16.02 km Linja 35 kV dhe 108.77 km - Linja 10 kV të tensionit të mesëm të linjës ajrore ndërsa linja të tensionit të mesëm tokësor janë 3.18 km – Linjë 35kV dhe 31 km të Linjës 10 kV.

Numri i transformatorëve 35 / 10 kV janë gjithsejtë 2 copë ndërsa 10/0.4 kV janë 169 copë.



Harta 13. Rrjeti elektrik




Figura 10. Furnizimi me Energji Elektrike në Komunën e Deçanit nga NS Deçan




Figura 11. Furnizimi me Energji Elektrike në Komunën e Deçanit nga NS Isniq

2.6.7 Sektori i ndriçimit publik të rrugëve

Gjatësia e gjithë rrjetit të ndriçimit publik sipas PKVEE në qytetin e Deçanit dhe në fshatra deri më tani është raportuar të jetë 96 km, e që projekti është duke vazhduar edhe për të gjitha fshatrat e mbetura në Komunën e Deçanit. Ndriçimi publik në Komunën e Deçanit, është duke u kryer më ndriçues të teknologjisë LED dhe një pjesë e vogël e tyre llamba të tipit HID halide[42].

2.6.8 Telekomunikacioni

Në territorin e Komunës së Deçanit, veprojnë disa operatorë si: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO, të cilat ofrojnë telefoni fikse dhe mobile, kurse kompani të tjera si: Kujtesa, Adea Computers, Art Motion, Një Art, PTK etj. veprojnë si kompani që ofrojnë shërbime në televizion kabllor dhe internet brenda zonës urbane dhe zonat rurale. Në rastet të shumta, linjat tele komunikuese përdorin rrjetin ajror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraprak. Megjithatë, gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Deçanit, është relativisht e mirë. Posta Telekomi Kosovës (PTK) ofron shërbime postare, që mbulojnë gjithë territorin e Komunës dhe është e vetmja kompani e cila e ka piken e vet zyrtare të operimit në ketë Komunë. Njësia shërbyese në Deçan i ka 9 njësi të shpërndara në njësisë shpërndarëse Carrabreg, Lloqan, Isniq, Prilep, Strellc dhe 4 të tilla janë në njësinë shërbyese Deçan.

Operatorët tjerë privat funksionojnë vetëm nëpërmes distributorëve dhe sipas të dhënave të Telekomit të Kosovës operatori Vala i ka 20000 klient privat, 1200 klient publik dhe 700 klient komercial, ndërsa operatori IPKO nuk ka ofruar të dhëna për klientët e tyre në Komunën e Deçanit.

Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti primar është e ndarë në atë mbitokësore dhe nëntokësore. Mbi tokësore janë 151.36 km ndërsa nëntokësore janë 43.78 km të cilat i takojnë Telekomit të Kosovës dhe janë të ndara në njësi shërbyese të Isniqit (11.75 km), njësisë shërbyese të Strellcit (20 km) dhe njësisë shërbyese të Deçanit (12.03 km).
Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti sekondar sipas operatoreve, 151.69 km i takojnë Telekomit të Kosovës të ndarë ne disa vendbanime.

Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti sekondar, sipas vendbanimeve		
Kodi referues	Përçuesi 01 Gjatësia (km)	Përçuesi 02 Gjatësia (km)
Strellc		39,43
Isniq		39,45
Gllogjan, Dubravë, Hereq, Jasiq i Ri, Baballoq, Gramaqel dhe Shaptej, Projekt i vitit 2019		49,3
Prilep		6,48
Skivjan		5,91
Carrabreg i Ulët		0,40
Carrabreg - Ledina		0,35
Podi i Gështenjave		0,83
Lloqan		0,60
Beleg		1,86
Llukë e Epërme & Ulët		7,35

Tabela 58. Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti sekondar, sipas vendbanimeve

[42] Plani Komunal i Veprimit për Efiçencën e Energjisë-2022-2024 (PKVEE)

Të dhënat e ofruara nga Telekomi i Kosovës tregojnë se janë gjithsejtë 195.8 km nyje optike të ndara në primare me gjatësi prej 43.8 km (nëntokësore) dhe sekondare në gjatësi prej 152 km (mbitokësore) kurse rrejti terciar i Telekomit te Kosovës është në gjatësi prej 21 km.

Telefonia fikse është ne ulje vit pas viti dhe sipas te dhënave te Telekomit te Kosovës, në vitin 2023 ne Komunën e Deçanit janë 1450 klient amvisërie, 30 klient publik dhe 100 klient komercial.

2.6.9 Ngrohja

Komuna e Deçanit nuk ka Plan për Energji termike si dhe nuk ka sistem të energjisë ngrohëse – ngrohtore andaj ekonomitë familjare për ngrohje përdorin: drurin, peletin, briketin, karburantet ose energjia elektrike. Nuk ekzistojnë të dhënat se me çka ngrohet çdo njësi banimi apo biznesi me qenë se ato ndryshojnë nga viti në vit. Mirëpo, është me se e sigurt se për ngrohje më se shumti përdoret druri dhe energjia elektrike. Ka tendenca që ne vitet e fundit, energjia elektrike të ketë rritje në krahasim me përdorimin e drurit me qenë se tani në treg po ofrohen teknologji kursyese për ngrohje mirëpo edhe subvencionimet nga niveli qendror po e nxisin përdorimin e teknologjisë e cila është kursyese e energjisë. Komuna e Deçanit është mjaft e pasur me pyje dhe nga mirëmbajtja e tyre e rregull dhe mund te siguron ne të ardhmen ngrohje nga biomasa.

2.6.10 Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Deçanit, ka krijuar një sistem Komunal për menaxhim të mbeturinave dhe plotësimin me mjetet përcjellëse për shtrirjen e plotë të shërbimit për mbledhjen (grumbullim) të mbeturinave në gjithë territorin e Komunës. Shtrirja e menaxhimit të mbeturinave në gjithë Komunën, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh. A. e cila ofron shërbime rreth mbledhjes (grumbullimit) të mbeturinave dhe ndarjes në bazë në ekonomitë familjare në 38 vendbanimet e Komunës së Deçanit. Trajtimi i mbeturinave përfshin: riciklimin, ripërdorimin, reduktimin dhe kompostimin e mbeturinave e deri në transportimin e tyre në deponinë regjionale. NPL "Higjiena" Sh. A, mbështetët nga GIZ-i Gjerman në kuadër të projektit "Shërbimet të Qëndrueshme Komunale", siç janë përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-060 Për Mbeturina. Kjo ndërmarrje e bënë mbledhjen (grumbullimin) e mbeturinave duke afruar shërbimin "Derë me derë" për ekonomitë familjare në zonën e qytetit të Deçanit, dhe mbulon në mbledhjen e mbeturinave zonën urbane të qytetit duke u shtrirë edhe në mbledhjen e mbeturinave edhe në 35 fshatra të Komunës. Dy vendbanime siç janë: fshati Belle dhe Pleqe, sipas konfiguracionit malor ofrohet shërbim sipas Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave në Komunën e Deçanit.

Në Komunën e Deçanit, janë të përfshira: 7681 ekonomi familjare, 584 biznese aktive dhe 22 klient publik dhe klient me kontratë, ku mbulimi me shërbim është 100 % në gjithë territorin e Komunës[43].

Grumbullimi i mbeturinave në Komunën e Deçanit, bëhet përmes sistemit "Derë më derë" (kontejnerëve 120 l dhe qese plastike), kontejnerëve të përbashkët (1.1m^3) si dhe kontejnerëve me kontratë (1.1 m^3). Shërbimi "Derë më derë" kryhet nëpërmes kontejnerëve 120 l dhe qese plastike dhe i njëjti bëhet duke ofruar shërbim për qytetin dhe të gjitha fshatrat. Ndërsa shërbimi me kontejnerë të përbashkët (në pjesën e qendrës së qytetit) dhe me kontratë kryhet nëpërmes kontejnerëve 1.1m³.

Ne Komunën e Deçanit ndodhet njësia deponuese e cila ka sipërfaqe prej 4 ha dhe më zonë mbrojtëse prej 100 m. Ndërsa njësia transferuese është në Sverkë (Komuna e Klinës) me sipërfaqe prej 140 ha dhe zonë mbrojtëse 800 m.

[43] Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2018-2022

Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit, 2023				
Kategoria	Rrjeti i shërbimit			
	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i kontejnerëve (nr.)	Vëllimi i kontejnerëve (m^3)	Distanca mesatare ndërmjet kontejnerëve (m)
Baballoq	15	352	120 l	43
Beleg	6	190	120 l	31.6
Carrabreg i Epërm	4	345	120 l	11.6
Carrabreg i Ultë	6	297	120 l	20
Dashinoc	20	51	120 l	392
Deçan	6	1467	120 l	4
Drenoc	9	230	120 l	39
Dubovik	8	185	120 l	43
Dubravë	20	52	120 l	384
Shaptej	14	92	120 l	152
Gllogjan	17	211	120 l	80
Gramaqel	19	252	120 l	75
Irzniq	13	314	120 l	41.4
Prokolluk	11	59	120 l	186
Isniq	5	794	120 l	6.3
Kodrali	9	150	120 l	60
Lëbushë	6	180	120 l	33
Lloqan	5	117	120 l	42
Hulaj	2	30	120 l	67
Llukë e Epërme	4	227	120 l	18
Llukë e Ulët	7	93	120 l	75
Lumbardh	9	151	120 l	60
Maznik	19	76	120 l	250
Vranoc i Vogël	25	18	120 l	1388
Papiq	23	20	120 l	1150
Pobergjë	9	255	120 l	35
Pozhar	8	106	120 l	75
Prapaqan	10	154	120 l	65
Prilep	5	340	120 l	15
Rastavicë	10	200	120 l	50
Ratish i Epërm	16	69	120 l	231
Ratish i Ulët	18	43	120 l	418
Sllup	8	56	120 l	14
Strellc i Epërm	8	589	120 l	14
Strellc i Ulët	11	455	120 l	24
Voksh	12	140	120 l	74
Jasiq i Ri	21	3	120 l	80
Pleqe	0	0	0	0
Belle	0	0	0	0
Gjithsejtë	418	8363	0	5746.9

Tabela 59. Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit, 2023


2.6.11 Ofrimi i shërbimit

NPL "Higjiena" SH. A, bënë grumbullimin e mbeturinave më këtë frekuencë të shërbimeve: në qytet shërbimi ofrohet çdo ditë nga ora: 08:00 - 16:00^h, kurse gjatë sezonit të verës kur sasia e mbeturinave rritet për shkak të ardhjes së qytetarëve nga diaspora shërbimi ofrohet edhe dy herë në ditë. Bizneset dhe institucionet me Kontrata të Veçanta shërbehen në bazë të orarit të kontratave dhe në bazë të pastrimit të kontejnerëve[44].

[44] Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2023-2027

Në fshatra në ekonomitë familjare shërbimi bëhet me kontejnerë prej 120 l dhe qese plastike, ndërsa në institucione dhe disa biznese shërbimi bëhet me kontejnerë 1.1 m^3 sipas kontrate.

Gjatë periudhës së prezantuar në tabelë në Komunën e Deçanit prodhohen 738557 ton mbeturina ku vetëm amvisëria dhe bizneset prodhojnë 56153 ton, institucionet publike 2155 ton ndërsa klientët me kontratë prodhojnë 1057 ton, dhe marrë në përgjithësi, brenda një viti, Komuna e Deçanit prodhon 797882 ton mbeturina.



Harta 14. Harta e shtrirjes dhe mbledhja së mbeturinave për ditë të javës[45]

2.6.12 Mbeturinat e veçanta

Mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit - Komuna e Deçanit, ka caktuar vendin për deponimin e mbeturinave të konstruktimit dhe demolimit në Rr. ”Luan Nimonaj” në Deçan ku mbeturinat inerte mund edhe të përdorën për mbushjen dhe rehabilitimin e gropave apo hendeqeve të ndryshme.

Mbeturinat nga bujqësia dhe industria e ushqimit - përfshijnë nus-prodhimet nga thertoret, eshtrat e kafshëve dhe kafshët e ngordhura, plehrat e kafshëve etj. Në industrinë e prodhimeve dhe përpunimit të qumështit, mishit, miellit, pijeve të ndryshme alkoolike dhe joalkoolike etj. gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre për përftimin e produkteve krijojnë mbeturina, por mbeturinat krijohen edhe gjatë dhe pas konsumimit të produktit ushqimor ose pas skadimit të afatit të përdorimit. Gjatë importit të produkteve ushqimore të cilat pas skadimit të afatit ose për shkak të ambalazhimit-skadimit një sasi e konsideruar e tyre bëhet mbeturinë, grumbullimin e tyre e bënë NPL “Higjiena” Sh. A Deçan.

[45] Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2023-2027

Mbeturinat nga produktet medicinale - janë mbeturina që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe ambientin. Grumbullimin e tyre e bënë Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare në Deçan, të cilat për asgjësimin e tyre dërgohen në incenerator në Qendrën Regjionale në Pejë. Në Komunë e Deçanit, dikur ka qenë vetëm një incenerator në fshatin Irzniq, i cili tani nuk është në funksion ku në të ardhmen duhet paraparë ndërtimi i një inceneratori sipas standardeve mjedisore që bënë djegien e mbeturinave medicinale.

Inceneratori - nënkupton objektin apo pajisjen stacionare të krijuar për t'u shfrytëzuar për djegien e mbeturinave të rrezikshme, me apo pa shfrytëzim të energjisë nga djegia e tyre, përfshirë instalimin për pirolizë, gazifikim apo procese tjera të trajtimeve termike të mbeturinave.

Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre - Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet kryesisht nga disa biznese private nga hekurishtet, autoservise, ku gjithsej në Komunë janë 2 hekurishte dhe 6 autoservise , të cilat mbeturinat i trajtojnë në dy mënyra: njëra është duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje, të cilat kryesisht shitën në vende të rajonit si dhe tjetra duke i ndarë pjesët e tyre për t'i ripërdorur.

Mbeturinat e gomës - Në Komunën e Deçanit, nuk ka biznese që merret më grumbullimin e gomave ose deponi për deponimin e tyre. Gomat e automjeteve nuk kategorizohen si mbeturinë e rrezikshme, por disa lloje specifike mund të kenë përbërës të tretshëm dhe të rrezikshëm që të trajtohen, ku duhet të caktohet një pikë grumbulluese në Komunën e Deçanit.

Mbeturinat elektrike dhe teknike - Pajisjet elektrike dhe teknike pas përdorimit të tyre shndërrohen në mbeturina, të cilat në mungesë të ripërdorimit dhe riciklimit paraqesin mjaft problem për mjedisin, për shkak se këto përmbajnë disa komponentë të rrezikshme. Nuk ka të dhëna për sasinë e krijuar, por dihet se sasia e tyre është në rritje të vazhdueshme duke pas parasysh importin e pajisjeve të reja dhe të përdorura ku duhet të caktohet një pikë grumbulluese në Komunën e Deçanit.

Mbeturina me vajrave - dhe vajrat e përdorura paraqesin ndotje të madhe të dheut dhe ujërave, për shkak se ato derdhen në çdo vend duke ndotur dheun (tokën) dhe ujin. Vajrat e përdorura pjesërisht grumbullohen për t'u ripërdorur ose djegur për përfitimin e energjisë së nxehtësisë dhe ende nuk ekziston ndonjë qendër për grumbullimin e tyre.

2.7 Infrastruktura e transportit rrugor dhe transporti

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e Komunës se Deçanit, bëhet përmes transportit rrugor ndërsa transporti hekurudhor dhe ajror nuk është i pranishëm. Komuna e Deçanit, posedon një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me Komunat dhe shtetet fqinje. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj si vijon:


a) transportin e rregullt të udhëtarëve;
b) transportin e lirë të udhëtarëve;
c) transportin taksi të udhëtarëve dhe
d) transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake[46].

Sipas U.A 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinorë - NTPH, pika 11. Infrastruktura e transportit rrugor, rrjeti rrugor ndahet në rrjetin kombëtar të infrastrukturës rrugore dhe në rrjetin lokal të infrastrukturës rrugore. Disa nga rrjetet e cekura në ketë U.A e përfshijë Komunën e Deçanit.

[46] Rregullore për Transportin të Urban dhe Urban Periferik të Udhëtarëve 2014

Infrastruktura e transportit rrugor sipas U.A 08/2017 - Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë		
Rrjeti kombëtar i infrastrukturës rrugore		
Auto udhët	Rrugët publike të ndërtuara dhe të destinuara vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të korsive me gjerësi së paku 3.50 m, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një korsi për ndalje emergjente në dy anët , me gjerësi së paku 2.50 m;	Jo / Vërejtje: Hyrjet dhe daljet në Komunën e Deçanit janë duke u ndërtuar me nga dy korsi të lëvizjes ne të dy anët mirëpo nuk mund të karakterizohet si auto udhë.
Rrugët nacionale	Rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e dy e më tepër qyteteve dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;	Jo/ Vërejtje: Rruga R-107 e cila lidhet me Malin e Zi i plotëson kriteret për rrugë nacionale sipas këtij U.A. mirëpo ajo ende figuron si rrugë rajonale.
Rrugët rajonale	Rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e qendrave me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve;	Po/ Vërejtje: Si rrugë rajonale është rruga R-107 dhe R-108.
Rrugë lidhëse	Rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e vendbanimeve me stacionet dhe terminalet hekurudhore, terminalet ajrore, parqet nacionale, dhe përmbajtje tjera të veçanta	Po
Rrjeti lokal i infrastrukturës rrugore		
Rrugët lokale	Rrugët që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regjionale	Po
	Rrugët brenda vendbanimeve rurale, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regjionale	Po
	Rrugët brenda vendbanimeve urbane apo qyteteve, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regjionale	Po

Tabela 60. Infrastruktura e transportit rrugor sipas U.A 08/2017 - Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë



Harta 15. Rrjeti rrugor

Ne Komunën e Deçanit kalojnë rrugët rajonale dhe rrugët lokale të asfaltuara dhe të paasfaltuara. Rrugët rajonale janë - R 107 dhe R 108, ku rruga rajonale R108 është rruga e cila e lidhë të gjithë rajonin e Dukagjinit nga veriu drejt jugut (nga Istogu drejt Prizrenit) dhe R107 është rruga e cila e lidhë kryeqytetin nëpërmes Komunës se Deçanit me piken kufitare me Malin e Zi drejt Plaves dhe Gucisë. Këto rrugë rajonale janë me brez rrugor, prej 7 metra gjerësie, me shirit për vozitje 3.5 deri 4 metra, të shoqëruara me shiritat për ndalje që janë 3 metra dhe gjerësinë e brezit mbrojtës 6 metra kurse gjerësia e përgjithshme e rrugës rajonale është 22 metra.

Rrugët lokale të asfaltuara - janë me brez rrugor me gjerësi prej 5 dhe 6 metra, me shirit për vozitje 2.5 deri 3 metra, të shoqëruara me shiritat për ndalje që janë 3 metra dhe gjerësinë e brezit mbrojtës 1 metër, me gjerësi të përgjithshme të rrugës prej 8 metra.

Rrugët lokale të paasfaltuara - janë me brez rrugor me gjerësi 5 dhe 6 metra, me shirit për vozitje 2.5 deri 3 metra, të shoqëruara me shiritat për ndalje që janë 3 metra dhe gjerësinë e brezit mbrojtës 1 metër, me gjerësi të përgjithshme të rrugës prej 8 metra.

Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është: 62.2 km, kurse rrugë lokale janë me gjatësi prej 405 km nga të cilat 362.60 km janë të asfaltuara dhe 42.40 km të pa asfaltuara.

Rrugët e vendbanimeve - janë me gjerësi të përgjithshme prej 8 metra dhe shirita me gjerësi nga 2.5 – 3 metra dhe me trotuare ne varësi nga terreni me gjerësi nga 1 – 3 metra.

Rrugët urbane – janë rrugët e qytetit të Deçanit me gjatësi prej 39 km dhe janë të ndara në rrugë urbane primare me gjatësi prej 21 km dhe rrugë urbane sekondare 18 km, ku mbulesa e tyre është nga shtresa e asfaltit .

Rrugët lidhëse – janë rrugët publike të cilat bëjnë lidhjen e vendbanimeve me stacionet dhe terminalet hekurudhore, terminalet ajrore, parqet nacionale me përmbajtje tjera të veçanta ku gjatësia e rrugëve lidhëse ne Komunën e Deçanit është 15 km me mbulesë nga shtresa e asfaltit dhe 4 km nga shtresa me zhavorr.

Rrugët e pa karakterizuara – janë rrugë me gjerësi të përgjithshme me gjerësi 8 deri 10 metra me shirita gjerësi prej 2.5 – 3 metra dhe me gjatësi të përgjithshme me shtresë asfalt 120 km. Ndërsa me shtresë prej zhavorri 25 km.

Rrugë të emëruara - në Komunën e Deçanit, janë gjithsejtë 593 rrugë, ku nga ky numër 574 rrugë janë të emëruara dhe 19 rrugë janë të pa emëruara ose me kode.

Urat – ne rrugët rajonale, rrugët lokale të asfaltuara dhe rrugët lokale të paasfaltuara janë të profileve të ndryshme për nga gjerësia dhe gjatësia. Te rrugët rajonale janë me gjerësi 19 metra ndërsa gjatësia ma e madhe e urës është 43 metra. Te rrugët lokale të asfaltuara gjerësia është 4 deri 10 metra ndërsa gjatësia ma e madhe e urës është 10 metra. Te rrugët lokale të paasfaltuara gjerësia është 3.6 metra ndërsa gjatësia ma e madhe është 10 metra.

Tunele - Në Komunën e Deçanit nuk ka asnjë rrugë të çfarëdo kategorie me tunele.

	Gjatësia në km	Mbulesa
Rrugë rajonale	62.20	Asfalt
Rrugë lokale të asfaltuara	362.60	Asfalt
Rrugë lokale të paasfaltuara	42.40	Zhavorr / Rërë
Gjithsejtë	467.20	

Tabela 61 Kategoria e rrugëve, gjatësia dhe gjendja

Shpejtësia e lejuar - në rrugët e vendbanimit është 30 km/h deri në max. 60 km/h.

Në rrugët rajonale gjegjësisht në R107 në varësi të seksioneve rrugore, shpejtësia është nga 50 km/h deri në max. 80 km/h. Në rrugën R108 shpejtësia maksimale është 50 km/h me qenë se pjesa e saj ma e madhe është rrugë malore.

Stacionet për autobus - janë të shpërndarë në të gjithë rrjetin rrugorë në Komunën e Deçanit dhe atë në rrugët rajonale janë 8 stacione dhe 8 vend parkingje për autobus. Ne rrugët lokale janë 37 stacione të autobusëve dhe 37 vend parkingje për autobus. Ne rrugët urbane janë 2 stacione për

autobus dhe 2 vend parkingje kurse sa i përket stacioneve për taksi, ekziston një parking dhe vetëm një stacion për taksi.

Vend parkingjet - janë gjithsejtë 4 në lokacione të lidhura me rrugët urbane prej cilave dy parkingje publike (hapësira në Komunë dhe hapësira të objekti i postës), dy parkingje tjera janë përballë objektit të banimit kolektiv "Gogaj" në Rrugën "Jashar Salihu" dhe tjetri në rrugën "Sali Çeku". ku të gjitha kanë kapacitet prej 280 vende.

2.7.1 Transporti publik rrugor


Komuna e Deçanit, ka kompetencë të certifikojë automjetet me (8+1) ulëse për transport urban dhe urbane-periferik, ndërsa për transport të rregullt të udhëtarëve me autobusë brenda territorit të Komunës, mund të ushtrohet si: transport urban dhe urban - periferik, transport i veçantë i udhëtarëve dhe transport për nevoja vetanake. Kompanitë private të licencuara nga Ministria e Infrastrukturës Rrugore, ju ofrojnë shërbime qytetarëve për linjat urbane dhe linjat ndër-urbane, ndërsa nuk ofrohet shërbim nga stacioni i autobusëve i cili ekziston si objekt por nuk shfrytëzohet për shkak të kontestit pronësorë kurse shërbimi urban dhe urban - periferik realizohet nga kombi buset dhe taksitë private me (8+1) ulëse.

Ne Komunën e Deçanit operojnë linjat periferike të cilat e lidhin qytetin e Deçanit me vendbanimet tjera, linjat rajonale dhe linjat ndërkombëtare.

Linjat periferike janë gjithsejtë 3 të cilat e lidhin Deçanin me Vokshin, Deçanin me Gllogjanin dhe Deçanin me Prapaqanin. Lëvizjet janë çdo 300 minuta dhe operojnë 6 herë vajtje ardhje në ditë kurse në fundjavë ato operojnë vetëm 2 herë në ditë vajtje ardhje.

Linjat rajonale janë gjithsejtë 3 të tilla të cilat e lidhin Deçanin me Prishtinën, Deçanin me Pejën dhe Deçanin me Gjakovën. Me Pejën dhe Gjakovën ka lëvizje çdo 30 minuta ose 24 vajtje ardhje në ditë ndërsa me Prishtinën 24 lëvizje vajtje ardhje gjatë ditës kurse në vikend me Prishtinën lëvizin 12 vajtje ardhje ndërsa me Pejë dhe Gjakovën çdo 180 minuta.

Linjat ndërkombëtare janë të ndryshme dhe shpesh herë ndodhë se autobusët pikënisjen e kanë nga Deçani por shumica e rasteve janë kalimi transit nga qytetet tjera. Linjat ndërkombëtare janë sezonale dhe ndryshojnë dhe kryesisht janë linjat me Gjermaninë, Zvicrën, Austrinë, Italinë, Francën por edhe me Shqipërinë. Nuk ekzistojnë oraret e rregullta, sepse ato ndryshojnë sipas sezonit dhe numri i tyre shtohet apo ulet ne varësi te kërkesave.



Harta 16. Transporti publik

2.8 Infrastruktura publike dhe sociale

2.8.1 Infrastruktura e institucioneve administrative publike

Ndërtesat e institucioneve administrative dhe sigurisë publike në Komunë, janë përqendruar në perimetrin rreth qendrës së Qytetit të Deçanit. Shpërndarja hapësinore dhe qasja në institucionet publike të nivelit Komunal është e mirë dhe e lehtë mirëpo ekzistojnë disa mangësi siç është rasti i qasjes së lehtë dhe pa pengesa të personave me aftësi të kufizuara dhe mungesa e parkingjeve.

Ne grupin e institucionet administrative dhe te sigurisë publike bëjnë pjesë administrata lokale, bashkësia lokale, policia, zjarrfikësit dhe gjykata. Ne Komunën e Deçanit shpërndarja e institucioneve administrative dhe të sigurisë publike është ne Deçan, Strellc i Epërm dhe Dranoc – Polana. Sipas të dhënave zyrtare, institucionet administrative dhe të sigurisë publike në Komunën e Deçanit janë: Komuna, Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan, Shërbimi i Zjarrfikëseve, Stacioni Policor, Zyra e Gjendjes Civile 1 dhe Zyra e Gjendjes Civile 2.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Administratë në kuadër të Komunës së Deçanit, numri ma i madh i të punësuarve është ne Komunë me gjithsejtë 133 zyrtarë , në Gjykatën themelore janë 33 në Shërbimin e Zjarrfikësve janë 13, në Zyrën e Gjendjes Civile 1 ne Strellc të Epërm janë 2 dhe në Zyrën e Gjendjes Civile 2 në Dranoc – Polana është 1 zyrtarë kurse për shkaqe administrative Stacioni i Policisë nuk i ka ofruar të dhënat.

Zona e gravitimit gjegjësisht ofrimi i shërbimeve në të gjitha institucioneve administrative dhe të sigurisë publike është për 42490 banorë (sipas vlerësimit të popullsisë për vitin 2023) përpos Zyrës së Gjendjes Civile 1 në Strellc të Epërm që është për 5461 banorë dhe Zyrës së Gjendjes Civile 2 në Dranoc dhe Polana për 3587 banorë.

Vendbanimet	Institucioni	Viti i themelimit	Lagja / zona gravituese	Numri i banoreve
Deçan	Komuna	1963	Deçan	42490
Deçan	Gjykata themelorë Pejë - Dega Deçan	/	Deçan	42490
Deçan	Shërbimi i Zjarrfikëseve	2005	Deçan	42490
Deçan	Stacioni i policisë	/	Deçan	42490
Strellc i Epërm	Zyra e gjendjes civile 1	/	Strellc i Epërm dhe Strellc i Ultë	5461
Dranoc - Polana	Zyra e gjendjes civile 2	/	Dranoc - Pobergjë - Lloqan - Voksh	3587

Tabela 62. Institucionet administrative dhe sigurisë publike

Edhe në vendbanimin e Irzniqit ekziston Zyra e gjendjes Civile mirëpo ajo është jashtë funksioni dhe nuk ofron asnjë shërbim për banorët e atij vendbanimi.

Institucionet administrative dhe te sigurisë publike, kapacitetet hapësinor dhe infrastrukturore					
Institucioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Sipërfaqja e ndërtesës m²	Etazhiteti
Komuna		0.1049		3441.84	B + P+2
Gjykata themelorë Pejë - Dega Deçan	0.84618	0.04	0.4887	1200	P + 2
Shërbimi i zjarrfikëseve	0.32885	0.025	0.2938	750	P + 2
Stacioni i policisë	0.29522	0.045	0.639	1640	B + P +1+Nk
Zyra e gjendjes civile 1	0.13704	0.0215	0.1155	430	P + 1
Zyra e gjendjes civile 2	0.16771	0.015	0.1527	150	P + 0

Tabela 63. Institucionet administrative dhe te sigurisë publike, kapacitetet hapësinor dhe infrastrukturore

Në ndërtesën e Komunës së Deçanit janë 64 zyra me sipërfaqe prej 964.75 m, ndërsa në objektin e Zyrës se Gjendjes Civile 1 janë 4 zyre dhe në Zyrën e Gjendjes Civile 2 është 1 zyre. Në kuadër të menaxhimit të hapësirave të ndërtesave Komunale ekziston edhe salla audio vizuale me 240 m² sipërfaqe dhe 84 ulëse. Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Stacioni i Policisë kanë edhe ndërtesat ndihmëse me sipërfaqe 325 m² dhe 195 m² me etazhitet P+0.

Çdo institucion administrativ dhe i sigurisë publike kanë parkingjet e veta të cilat janë të dedikuara për zyrtarët Komunal por edhe për vizitorët.

Institucionet administrative dhe te sigurisë publike, kapacitetet infrastrukturore - vend parkingjet		
Institucionet	Vend parkingjet (nr.)	
	Për vizitor	Për zyrtar
Komuna	10	60
Gjykata themelorë Pejë - Dega Deçan	10	4
Shërbimi i zjarrfikëseve	10	10
Stacioni i policisë	0	15
Zyra e gjendjes civile 1	3	2
Zyra e gjendjes civile 2	2	1

Tabela 64. Institucionet administrative dhe te sigurisë publike, kapacitetet infrastrukturore - vend parkingjet

Të gjitha ndërtesat e institucioneve administrative dhe të sigurisë publike kanë hapësirat e gjelbra publike të cilat janë në kuadër të institucioneve. Komuna e Deçanit si institucion administrativ i ka 400 m² hapësirë publike ndërsa për objektet tjera janë të prezantuara në tabela.

2.8.2 Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit, si qendër administrative, politike, ekonomike, shëndetësore, arsimore, kulturore e paraparë me ligjet dhe aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës së Deçanit. Sipas këtij Statuti, Komuna është njësi themelore territoriale e Vetëqeverisjes Lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me ligjet në fuqi ku territori dhe kufijtë e Komunës, janë përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave.

Organet e Komunës janë: Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Nënkryetari.
Kuvendi i Komunës ka këto komitete të përhershme:

- Komitetin për Politikë dhe Financa;
- Komitetin për Komunitete
- Komitetin Konsultativ (për personat me aftësi të kufizuara)

Kuvendi i Komunës, mund të themeloj edhe Komitete jo obliguese të tjera siç janë:

- Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
- Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe Rural;
- Komitetin për Planifikim Urban;
- Komitetin për Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Komitetin për Shërbime Publike dhe
- Komitetin për Pronë.

Komuna, organizon takime publike periodike me qytetarë, së paku dy herë në vit ku në këto takime përfaqësuesit Komunal i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës Komunale. Takimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik kurse takime të tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

Komuna e Deçanit, ofron shërbime me të cilat pajisen qytetaret me të gjitha dokumentet e nevojshme, gjithashtu ofron edhe shërbime në mënyrë teknike.

Drejtoritë e Komunës së Deçanit, janë të organizuara në:

- Administratë e Përgjithshme,
- Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Buxhet dhe Financa,
- Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
- Arsim,
- Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike,
- Inspektim,
- Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Ekonomi dhe Zhvillim,
- Gjeodezi dhe Kadastër,
- Kulturë, Rini dhe Sporte,

Kryetari i Komunës emëron Drejtorët e drejtorive Komunale.

2.8.3 Infrastruktura e institucioneve arsimore

Arsimi në Komunën e Deçanit, është i organizuar në nivel të: arsimit parashkollor/para fillor ku paraqet nivelin 01 dhe 02 sipas përshtatjes në përkufizimet e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (SNKA). Nivelin 01: paraqet zhvillimin e hershëm dhe edukimin e fëmijës nga mosha 0 deri 3 vjeç ndërsa arsimi parashkollor- para fillor në këtë nivel përfshihen: çerdhet për fëmijë 1-2 vjeçar, kopshtet (për fëmijë 3-4 vjeçar) dhe klasa e parë për fëmijë 5-6 vjeçar.


Në Komunën e Deçanit, niveli i arsimit parashkollor zhvillohet në një çerdhe, e cila gjendet në afërsi të Qendrës së Qytetit, kopshti i fëmijëve “Fatosat”, me kapacitetit 120 vende, duke i përfshirë grup moshat nga 6 muaj deri në 6 vjeç. Niveli 02: Paraqet arsimin para fillor ku përfshihen moshat nga 3 deri 6 vjeç.

Arsimi i obliguar - Arsimi i obliguar paraqet nivelet një dhe dy sipas SNKA-së. Arsimi fillor klasifikohet si niveli 1 (klasat 1-5) dhe niveli 2, është arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9) ku arsimi i obliguar funksionon në 18 shkolla publike.

Niveli i arsimit fillor - Niveli i arsimit fillor zgjat 5 vjet, duke filluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1-5). Në këtë nivel regjistrohen fëmijët që mbushin moshën 6 vjeçare, ndërsa grup mosha e nxënësve në këtë nivel është nga 6 deri në 10 vjeç.

Niveli i arsimit, i mesëm i ulët - është nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (6-9) dhe përfshinë grup moshat e nxënësve nga 11 deri në 14 vjeç dhe funksionon në shkolla të mesme të ulëta publike.

Niveli i arsimit të mesëm të lartë - paraqet nivelin e tretë (3) sipas SNKA dhe funksionon në shkolla të mesme publike dhe nuk ka shkolla jo publike (të licencuara) në Komunë.



Harta 17. Institucionet arsimore

Në bazë të synimeve dhe përmbajtjes këto shkolla janë të organizuara në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Shkollat e Mesme të Larta (gjimnazet dhe shkollat profesionale) janë shkolla të profilizuara ku kemi Gjimnazin "Vëllezër Frashëri" në Deçan, që ndahet në këto drejtime:

- Shkencat natyrore dhe
- Shkencat shoqërore – gjuhësore.

Ndërsa shkolla e mesme profesionale "Tafil Kasumaj" në Deçan, ndahet në këto drejtime:

- Mjekësi,
- Teknikë,
- Mekatronikë,
- Makineri,
- Ekonomi dhe
- Hoteleri.

Numri i nxënësve para-fillor (5<6 vjeç)				
	Meshkuj	Femra	Gjithsejtë	Ndryshimi
2016 - 2017	255	228	483	-
2017– 2018	263	242	505	22
2018 - 2019	240	234	474	-31
2019 - 2020	262	222	484	10
2020 - 2021	230	209	439	-45
2021 - 2022	220	243	463	24
2022 - 2023	185	214	399	-64

Tabela 65 Numri i fëmijëve në arsimin para fillor ose nivelit 1[47]

Numri i nxënësve në arsimin fillor – mesëm të ultë				
	Meshkuj	Femra	Gjithsejtë	Ndryshimi
2016 - 2017	2198	2110	4308	-
2017 - 2018	2146	2050	4196	-112
2018 - 2019	2078	1971	4049	-147
2019 - 2020	1971	1905	3876	-173
2020 - 2021	1984	1813	3797	-79
2021 - 2022	1951	1755	3706	-91
2022 - 2023	1,858	1,729	3,587	-119

Tabela 66 Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ultë i nivelit 2[48]

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë				
	Meshkuj	Femra	Gjithsejtë	Ndryshimi
2016 - 2017	754	574	1328	-
2017 - 2018	719	566	1285	-43
2018 - 2019	694	517	1211	-74
2019 - 2020	633	502	1135	-76
2020 - 2021	556	507	1063	-72
2021 - 2022	551	492	1043	-20
2022 - 2023	519	463	982	-61

Tabela 67 Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ultë të nivelit 1 dhe 2[49]

Arsimi para universitar - për vitin shkollor 2021/2022, në sistemin e arsimit publik para universitar në Komunën e Deçanit, janë regjistruar gjithsej 5,299 nxënës kurse në vitin 2019/2020, ishin të regjistruar gjithsej 5,495 etj. Nëse i referohemi periudhës 2016 – 2022 shihet se numri i nxënësve është zvogëluar për 820 nxënës.[50]

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet				
	Meshkuj	Femra	Gjithsejtë	Ndryshimi
2016 - 2017	3207	2912	6119	-
2017 - 2018	3218	2858	5986	-133
2018 - 2019	3012	2722	5734	-252
2019 - 2020	2866	2629	5495	-239
2020 - 2021	2770	2529	5299	-196
2022 - 2023	2722	2490	5212	-87
2022 - 2023	2,562	2,406	4,968	-244

Tabela 68 Numri i nxënësve në të gjitha nivelet[51]

[47] MASHT dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016 - 2023
[48] MASHT dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016 - 2023
[49] MASHT dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016 - 2023
[50] MASHT dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016 - 2023
[51] MASHT dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016 - 2023

Niveli i shkollimit	Numri i institucioneve	Numri i përgjithshëm i fëmijëve, nxënësve të regjistruar
Edukimi parashkollor (0-5)	1 - institucion i licencuar	37
Edukimi para fillor (5-6)	18 - shkolla amë	399
Edukimi fillor (6-11)	18 - shkolla amë	2006
Edukimi i mesëm i ulët (11-15)	18 –shkolla amë	3587
Edukimi i mesëm i lart (15-18)	1 - shkollë gjimnaz 1 - shkollë e mesme teknike	982
Gjithsejtë		7011 nxënës

Tabela 69 Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i vijuesve sipas niveleve 2023[52]

Sqarim: numri i fëmijëve në kopshtin e fëmijëve" Fatosat "në Deçan nga 37 fëmijë nuk janë të përfshirë në MASH dhe ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020.

Mësimdhënësit sipas përkatësisë gjinore				
`	Meshkuj	Femra	Gjithsejtë	Ndryshimi
2016 - 2017	266	229	455	-
2017 -2018	206	266	432	-23
2018 - 2019	201	230	431	-1
2019 - 2020	195	236	431	0
2020 - 2021	198	233	431	0
2021 - 2022	156	258	414	-17
2022 -2023	154	253	407	-7

Tabela 70 Mësimdhënësit sipas përkatësisë gjinore

Nr.	Shkolla	Tipi i shkollës	Vendi	Hapësira m^2	Sipërfaqja (ha)	Stafi ne përgjithësi	Drejtorët	Zv. drejtorët	Sekretarët
1	"Vëllezërit Frashëri"	Gjimnaz	Deçan	3930	1.50	51	1	1	1
2	"Tafil Kasumaj"	SHMP	Deçan	2293	0.76	33	1		1
3	"Lidhja e Prizrenit"	SHFMU	Deçan	4885	3.20	64	1	1	1
4	"Isa Boletini"	SHFMU	Isniq	4050	1.03	36	1		1
5	"Bajram Curri"	SHFMU	Strellc i Epërm	2950	1.28	27	1		1
6	"Drita"	SHFMU	Gramaqel	1150	1.30	14	1		1
7	"Dëshmorët e Kombit"	SHFMU	Strellc i Ulët	1240	0.19	16	1		1
8	"Jusuf Gërvalla"	SHFMU	Prapaqan	4350	4.80	27	1		1
9	"Sylë Alaj"	SHFMU	Drenoc	770	4.20	19	1		
10	"Heronjtë e Dukagjinit"	SHFMU	Gllogjan	764	2.10	15	1		
11	"Lan Selimi"	SHFMU	Lumbardh	3914	2.04	26	1		
12	"Maxhun Çekaj"	SHFMU	Irzniq	2200	3.20	16	1		
13	"Sylejman Vokshi"	SHFMU	Prilep	820	0.42	13	1		1
14	"Dëshmorët e Vokshit"	SHFMU	Pobergjë	800	1.57	14	1		
15	"Ardhmëria"	SHFMU	Beleg	500	3.08	18	1		
16	"Faik Konica"	SHFMU	Ratish i Ulët	480	5.33	16	1		
17	"Esad Mekuli"	SHFMU	Maznik	700	0.35	16	1		
18	"K. i Verrave të Llukës"	SHFMU	Llukë e Epërm	450	1.85	13	1		
19	"Dëshmorët e Baballoqit"	SHFMU	Baballoq	800	0.42	14	1		
20	"Rexhep Kadrijaj"	SHFMU	Rastavicë	2700	2.30	15	1		
	Gjithsejtë			39746	40.83	463	20	2	9

Tabela 71 Shkollat në Komunën e Deçanit

[52] Plani Zhvillimore i Arsimit të Komunës së Deçanit 2018-2023

2.8.4 Shëndetësia

Bazuar në Ligji Nr. 04/l-125 për Shëndetësi por edhe në U.A. 18/2007 për normat teknike për planifikim, Kapitulli 4. pika 4. Infrastruktura e institucioneve shëndetësore, shërbimet shëndetësore në Komunën e Deçanit, ofrohen në nivel të kujdesit primar shëndetësorë në këto njësi:

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Deçan,
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq,
- 7 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) në Lumbardh, Prapaqan, Gramaçel, Pobergjë (Polana), ndërsa tri prej AMF në: fshatin Ratish i Ulët, Prilep dhe Lumbardh, nuk janë në funksion.

Të angazhuar në ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësorë në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 120 punëtor.

Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, regjistri sipas vendbanimeve				
Vendbanimet	Institucioni	Viti i themelimit	Lagja / zona gravituese	Numri i banoreve
Deçan	QKMF Adem Ukëhaxhaj	1950	Qyteti i Deçanit, Carrabregu i Ulët dhe i Epërm, Llukë e Ulët, Llukë e Epërme, Hulaj, Belle, Drenoc, Rastavicë, Pozhar dhe Beleg	15130
Strellc i Epërm	QMF	/	Strellc i Epërm dhe Strellc i Poshtëm	6636
Isniq	QMF	/	Isniq, Dubovik, Vranoc i vogël dhe Lëbushë	5032
Irzniq	QMF - Malë Zejnaj	/	Irzniq, Ratishë, Prekulluk, Gllogjan dhe Kodrali	4589
Gramaçel	AMF	/	Gramaçel, Baballoq, Shaptej, Dubravë	3564
Pobergjë	AMF	/	Voksh, Pobergjë, Lloqan dhe Sllup	2721
Prapaqan	AMF	/	Prapaqan dhe Papiq	914
Lumbardh	AMF	/	Nuk funksionon	1463
Prilep	AMF	/	Nuk funksionon	2445
Ratishë i Ulët	AMF	/	Nuk funksionon	632

Tabela 72 Institucionet e Kujdesit Shëndetësorë në Komunën e Deçanit[53]


Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH)[54], mbështetet në konceptin e mjekësisë familjare dhe përfshinë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike ku shërbimet ofrohen në institucione shëndetësore publike dhe private. Rrjeti publik i KPSH-së, përbëhet nga gjithsej 11 institucione, nga të cilat Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, dhe njësitë e saj përbërëse: 3 (tre) Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 7 (shtatë) Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF), Qendra kryesore e vaksinimit në QKMF, Njësia e Urgjencës në objekt të veçantë në kuadër të QKMF-së – Deçan si dhe Qendra Informuese (SISH).

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - ndodhet në Qytetin e Deçanit dhe në të ofrohen shërbimet specialistike ato dentare dhe emergjente për dhe e cila mbulon me shërbime të patronazhit (mobil) për gjithë popullatën e Komunës së Deçanit.

Numri i parkingjeve te QKMF në Deçan janë 10 për stafin dhe 15 për vizitorë.

[53] QKMF -Komuna e Deçanit

[54] Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësi dhe Ligji nr. 8/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-125



Harta 18. Institucionet shëndetësore

Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet profesionale								
Institucioni	Mjek te përgjithshëm (nr.)		Mjek ne specializim (nr.)		Mjek te specializuar (nr.)		Farmacist (nr.)	
QKMF Deçan	11		2		10		0	
Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet infrastrukturore - Ndërtesa ndihmëse / Përmbajtjet Përcjellëse								
QKMF Deçan	Ndërtesa ndihmëse A		Ndërtesa ndihmëse B		Ndërtesa ndihmëse C		Ndërtesa ndihmëse D	
	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)
	150.0 m^2	150.0 m^2	-	-	-	-	-	-

Tabela 73. Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet profesionale

QMF - të ndodhen në: Strellc i Epërm, Isniq dhe Irzniq dhe në këto qendra ofrohen shërbime me mjekë të specializuar kurse mungojnë shërbimet si: Stomatologjike, Laboratorike dhe kontrollet Gjinekologjike.

AMF - të ndodhen në këto vendbanime: Prapaqan, Gramaçel, Pobergjë (Polana) dhe tri të tjera që nuk janë funksionale, e ato janë në: Prilep, Ratish i Ulët dhe Lumbardh.

Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet hapësinore				
Institucionet		Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)
QKMF Deçan	Adem Ukëhaxhaj	0.4853	0.33698	0.19872
QMF - Strellc	QMF	0.0175	0.0175	0.0
QMF - Isniq	QMF	0.3809	0.0646	0.3763
QMF - Irzniq	QMF - Malë Zejnaj	0.1048	0.0192	0.0856
AMF - Gramaçel	AMF	0.0178	0.0178	0.0
AMF - Pobergjë	AMF - Dinë Cenaj	0.1738	0.0176	0.1538
AMF - Prapaqan	AMF	0.1147	0.0168	0.0979

AMF - Lumbardh	AMF	0.0493	0.0196	0.0297
AMF - Prilep	AMF	0.0552	0.0224	0.0328
AMF – Ratishë U	AMF	0.1633	0.0176	0.1457

Tabela 74. Institucionet shëndetësore te nivelit parësor, kapacitetet hapësinore

2.8.5 Përkujdesja Sociale

Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), në Komunën e Deçanit, funksionon Qendra për Punë Sociale, e cila zbaton programin e masave për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Qendra për Punë Sociale (QPS), bën vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e përfituesve të asistencës sociale, dhe atyre që plotësojnë kushtet për strehim të përkohshëm. Kjo qendër është në shërbim të gjithë banorëve të Komunës së Deçanit dhe sipas të dhënave në këtë qendër punojnë 7 zyrtarë të përgjithshëm dhe 3 zyrtarë të specializuar.


Përpos QPS-së ne Komunën e Deçanit ekzistojnë është disa qendra tjera të banimit dhe qëndrimit, siç janë:

- Qendra për banim social - më financim të përbashkët MMPHI dhe donacioni – SDC Zviceran me Komunën e Deçanit, është ndërtuar ndërtesa me qira jo profitabile në vitin 2003 - 2004, me 16 njësi banesore.
- QK (Qendra kolektive) - Lagja Baballoq me 14 ndërtesa të banimit.
- Qendra e Trajtimit Mendor në Pejë - Dega në Deçan, e cila qendër ofron shërbim ditor për personat me nevojë dhe gjendet afër Entit për Punësim dhe sipas të dhënave në këtë qendër punojnë 7 zyrtarë të përgjithshëm.
- Shtëpia e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore - kjo qendër ofron strehim dhe shërbim në nivel regjional për personat me nevoja mendore, e cila qendër gjendet në vendin e quajtur Podi i Gështenjave në Deçan dhe sipas të dhënave në këtë shtëpi punojnë 6 zyrtarë të përgjithshëm dhe 2 zyrtarë të specializuar.

Qendrës Kolektive në Lagjen Baballoq është ndërtuar në vitin 1992, ndërsa të gjitha qendrat dhe shtëpia për komunitete janë ndërtuar pas vitit 1999.

Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, kapacitetet infrastrukturore - ndërtesa kryesore				
Institucionet	Ndërtesa kryesore			
	Sipërfaqja (m²)	Etazhiteti (P)	Stacionari	Kapacitetet
			Sipërfaqja (m²)	Shtretër (nr.)
Qendra për punë sociale	1640	P + 2 +Nk	/	/
Qendra për punë banim social	920	P + 3	/	/
Qendra kolektive - Lagja në Baballoq 14 shtëpi x 10 ari - 75(m²) një shtëpi	1050	P + 0	/	/
Qendra e trajnimit mendor në Pejë - Dega Deçan	265	P + 0	/	/
Shtëpia e Komunitetit më aftësi të kufizuara mendore	330	P + 0	/	/

Tabela 75. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, kapacitetet infrastrukturore - ndërtesa kryesore



Harta 19. Hapësirat publike dhe sociale në Komunën e Deçanit

Të gjitha ndërtesat e paraqitura në tabele kanë të organizuar parkingjet për stafin dhe për vizitorët si dhe posedojnë hapësira publike të gjelbëruara.

Kërkesat për asistencë sociale dhe për banim social janë më të mëdha se mundësitë buxhetore të Komunës. Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimi si shfrytëzues më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe njëkohësisht është komponent e rëndësishme e zhvillimit social - ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor.

Nga viti në vit, ne Komunën e Deçanit shtohen dhe ulen kërkesat për personat me nevojë të natyrave të ndryshme ku sipas të dhënave vetëm gjatë vitit 2023 janë identifikuar 1002 raste të kërkesave për nevojë.

Sipas Programit për Banim Social 2017-2022, është paraparë planifikimi për ndërtimin e dy ndërtesave që do të shërbej për ndihmë familjeve që kanë nevojë për strehim. Deçani nuk ka shtëpi të pleqve, andaj duhet të planifikohet një qendër për pleqtë, gjithashtu edhe për rastet e dhunës në familje si dhe kujdesin e fëmijëve.

Qendra për Punë Sociale, është në koordinim me Qendrën Regjionale në Pejë.

Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, personat ne nevojë	
Personat ne nevoje - kategoritë #	Numri i banoreve
Fëmijë pa përkujdesje prindërore	0
Fëmijë me sjellje asociale Delikuent te mitur Persona me marrëdhënie te çrregulluara ne familje Persona te moshës se shtyrë Persona me sëmundje trupore ose aftësi te kufizuara fizike Persona me të aftësive të kufizuara mendore Persona me sëmundje mendore Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi Viktima te dhunës ne familje Viktima te trafikut te qenieve njerëzore Persona me varësi nga alkooli ose drogat Viktima të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu Kategori te tjera.	22
Delikuent te mitur	22
Persona me marrëdhënie te çrregulluara ne familje	22
Persona te moshës se shtyrë	10
Persona me sëmundje trupore ose aftësi te kufizuara fizike	0
Persona me të aftësive të kufizuara mendore	10
Persona me sëmundje mendore	560
Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi	1
Viktima te dhunës ne familje	10
Viktima te trafikut te qenieve njerëzore	0
Persona me varësi nga alkooli ose drogat	2
Viktima të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu	0
Kategori te tjera.	429

Tabela 76. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, personat ne nevojë

2.8.6 Institucionet kulturore dhe rinore

Në Komunën e Deçanit funksionojnë dy Shtëpi të Kulturës, njëra në Deçan dhe tjetra në Isniq si dhe një Muze në Deçan dhe një muze privat i njohur si "Etno-Kastrioti" në fshatin Isniq.

Shtëpia e Kulturës "Jusuf Gërvalla" – është hapësirë shumë funksionale me etazhitet B+P+1K+NK e ndërtuar në një sipërfaqe prej 2100 m² në bazë dhe sipërfaqe shfrytëzuese të gjitha etazhave prej 8500 m². Në ketë shtëpi të kulturës janë: Galeria e arteve – Ars Kultura, biblioteka (salla ekspozuese, sallat e leximit), salla audio-vizuale, hapësirë e siguruar për media-radio. Po ashtu një etazhë e objektit është vënë në dispozicion të shoqatave dhe klubeve të ndryshme kulturore-artistike të cilat veprojnë në Deçan, inkubatori i bizneseve, Qendra për Regjistrim të Bizneseve, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe KKZ.

Teatri i qytetit "Skënder Tafaj"- i cili gjendet në Pallatin e Kulturës në Deçan, i përmbushë nevojat për shfaqje si: drama, komedi, filma si dhe aktivitete tjera kulturore (muzikës). Biblioteka e Komunës, i plotëson kushtet por duhet të bëhet ndërhyrje në gjithë hapësirën për ofrimin e kushteve me të mira për lexuesit, duke përfshi si: inventarizimin e librave, pasurimin me tituj të rinj të librave të autorëve të vendit dhe të huaj.

Shtëpia Kulturës " Berit Backer" e cila gjendet në fshatin Isniq, e ka marre emrin e veprimtares e cila ka qenë një antropologe dhe aktiviste për të drejtat e njeriut e cila bashkë me fotografen Ann Christine Eek, në vitin 1976 bëri një udhëtim në Kosovë, për ta dokumentuar jetën rurale në fshatin Isniq. Gjatë qëndrimit të tyre 7 javor në Isniq, Backer e cila fliste rrjedhshëm Gjuhën Shqipe dhe e cila ishte e afërt me banoret vendas, zhvillojë intervista dhe studioj traditat Shqiptare duke përfshirë hierarkitë familjare dhe strukturën e tyre, ndërkohë që Eek, shkrepte fotografi të shumta të jetës

brenda dhe jashtë kullave të Isniqit-shtëpitë e ndërtuara nga guri, tipike në zonën e Dukagjinit në shenjë të respektit dhe afirmimit të kulturës jo vetëm në fshatin Isniq, por në përgjithësi të traditave tona Shqiptare ku u be promovimi i tyre në shumë vende të botës.

Kjo shtëpi e kulturës disa herë ka bërë ekspozita me fotografi të zonjës Eek, gjithashtu ka bërë edhe shfaqje të kulturës, traditës duke motivuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet kulturore në fshatin Isniq. Eposi i fshatit Isniq është unik për kulturën tonë.

Shtëpia e kulturës e ndërtuar me sipërfaqe të përgjithshme të bazës prej 600 m^2 me etazhitet P+0 në parcelën prej 0,3823 ha, si sipërfaqe të lirë dhe të gjelbëruar prej 0.3223 ha.

Muzeu Etnografik është i vendosur në Kullën e Zymer Himës në Deçan, ku janë të ekspozuara një numër i konsiderueshme i eksponateve të periudhave të ndryshme ku duhet ndërmarrë masa për ruajtjen e tyre nga mikroorganizmat, që kërkon konservimin dhe ruajtjen e objekteve në muze. Muzeu Etnografik ndodhet në një parcelë me sipërfaqe prej 117 m^2, me ndërtesë të etazhitetit P+2K me ndërtim me sipërfaqe në bazë prej 72 m^2 dhe me 45 m^2 sipërfaqe të lirë dhe të gjelbëruar.

Muzeu privat ”Etno-Kastrioti” i cili gjendet në fshatin Isniq ku janë të ekspozuara mbi 1100 eksponate, muze që ka rol të rëndësishëm për edukimin e brezit të ri, pasi aty pasqyrohet jeta dhe tradita Shqiptare.

Kulla Muze e “Jusuf Gërvalla” në Dubovik ku janë ekspozuara eksponatet personale të Heroit Jusuf Gërvalla.

2.8.7 Kultura

Jeta kulturore në Komunën e Deçanit, është e pasur me një numër të madh të aktiviteteve dhe natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore dhe sportive. Të gjitha këto aktivitete kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në ndërtesa të kulturës. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli të cilën banorët e Komunës së Deçanit, e kanë dëshmuar me evenimentet e ndryshme kulturore dhe tradicionale. Zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë.

Manifestimet e rëndësishme ne Komunën e Deçanit	
Festat më të rëndësishme	- Dita 24 marsit-Epopeja e Dukagjinit. - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Deçanit, 5-6 maj. - Dita e Çlirimit të qytetit të Deçanit, 16 qershor.
Evenimentet tradicionale	- Dita e Mjaltit në muajt qershor dhe korrik. - Dita e Qethjeve të deleve në muajin korrik. - Dita e Gështenjës në muajin tetor. - Dita e Rakisë të pjekur në muajin tetor ose nëntor. - Darka e Lamës në muajin nëntor. - Panairi Tradicional Veror.
Trashëgimia jo materiale	- Endja tradicionale në vek.
Aktivitete sportive	- Turniri memorial i futbollit ”Ruzhdi Ramosaj”. - Turniri memorial i shahut “Zeqë Hasi”.
Festivalet folklorike	- Festivali i këngës për fëmijë “Ardhmëria”. - Festivali “ Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”.
Dekoratat	- Shkëlzen Haradinaj. - Ismail Haradinaj. - Haki Povataj. - Zeqë Hasaj.

Tabela 77 Manifestimet e rëndësishme ne Komunën e Deçanit

Në teatrin që mban emrin e aktorit të njohur Teatrit “Skënder Tafaj” kanë dalë shumë herë shfaqje e drama, që kanë bërë jehonë të madhe edhe në nivel vendi ku shumë artistë, këngëtarë dhe figura politike kanë origjinë nga Deçani.

Në Komunën e Deçanit, veprojnë këto grupe artistike: Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve i Deçanit, Shoqëria kulturo-artistike “Jusuf Gërvalla”, grupi i rapsodëve “Dervish Shaqa”.

Komuna me financim të përbashkët me nivelin qendror ka ndarë një vlere të mjeteve financiare në mënyrë që të krijoj kushte për aktivitete rinore ku është ndërtuar Qendra Rinore, Kolonia e Artistëve, Qendra e Trashëgimisë Kulturore dhe Fshati Turistik (Podi i Gështenjave) Deçan, më sipërfaqe prej 580 m^2 dhe me etazhitet P+1K.

Në Komunën e Deçanit, manifestimet me të rëndësishme janë festat, evenimentet tradicionale, trashëgimia jo materiale, aktivitetet sportive, festivalet folklorike dhe dekoratat.

2.8.8 Sporti

Sporti është njëri ndër lëmit më të preferuara nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Të rinjtë e Komunës së Deçanit, aktivitetet e tyre sportive i realizojnë në Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit dhe në fushë lojë te mbyllur sportive.

Shumica e shkollave të Komunës, kanë hapësira për aktivitete sportive ku në oborret e disave nga shkollat përveç fëmijëve, hapësirat sportive shfrytëzohen edhe nga banorët dhe klubet sportive.

Palestra sportive në Komunën e Deçanit është ndërtuar në vitin 2013, në fshatin Isniq dhe ka një sipërfaqe prej 4422 $m^{2.}$, me gjithsejtë 1012 ulëse.

Stadiumi i qytetit "Ruzhdi Ramosaj" është me sipërfaqe prej 7000 m^2 dhe me 400 ulëse ku te dy këto institucione sportive profesionale janë të ndërtuara në një parcelë prej 3.8 ha.

Ne Isniq ndodhet edhe një fushë lojë e mbyllur e cila është ndërtuar ne vitin 2008 me sipërfaqe prej 1100 m^2 dhe në një parcelë prej 0,1898 ha.

Në Komunën e Deçanit, janë këto klube sportive:

- Klubi futbollit "Deçani"- Deçan,
- Klubi futbollit "Besa"- Irzniq,
- Klubi Hendbollit "Deçani" - meshkuj,
- Klubi Hendbollit "Deçani" - femrat,
- Klubi Hendbollit "Jusuf Gërvalla", Prapaqan - femrat,
- Klubi i Ping Pongut "Shqiponjat e Zeza" - Irzniq.

2.8.9 Hapësirat publike dhe të gjelbra

Komuna e Deçanit nuk karakterizohet me shumë hapësira publike. Ekzistojnë disa sheshe dhe parqe te cilat frekuentohen nga banorët dhe vizitorët mirëpo për zhvillimin e qytetit aktiv, duhet të hartohen politikat e qarta ku ekzistojnë gjithsejtë 3 parqe te njohura ne Deçan dhe 7 sheshe.

Parqet karakterizohen me llojllojshmëri të florës por edhe faunës ndërsa sheshet janë ma shumë si emërime se sa si hapësira të cilat janë të përshtatshme për frekuentim. Andaj është më se e nevojshme që të organizohen këto hapësira dhe të ri dizajnohen duke ju caktuar kufirin e qartë të tyre. Hapësirat publike dhe të gjelbra përdoren për rekreacion aktiv dhe pasiv, ndërkohë që efektet e tyre të shumëfishta (shëndetësore, kulturore etj.) përmirësojnë cilësinë e jetës. Për të qenë në dispozicion të banorëve, hapësirat publike dhe zonat e gjelbra duhet të jenë të integruara mirë dhe të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjitha hapësirat e pjesës urbane dhe rurale.

Hapësirat publike dhe të gjelbra në zonën urbane janë duke u zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme nga ndërtimet, po ashtu të njëjtat hapësira janë duke u rrezikuar nga presioni i ndërtimit. Në hapësirat ekzistuese qasja në ato është e mirë, për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet emergjente. Përdoruesit janë nga të gjitha grup-moshat, kurse mirëmbajtja e tyre bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale Higjiena për gjatë gjithë vitit.

Hapësirat publike (sheshet dhe parqet), regjistri sipas vendbanimeve					
Vendbanimet	Hapësira	Sipërfaqja m^2	Viti i themelimit	Lagja / zona gravituese	Numri i banoreve
Deçan	Park - Pishat e Deçanit	15,000	/	Deçan	8000 - 10000
Deçan	Park - Luan Haradinaj dhe Sali Çeku	400	/	Deçan	8000 - 10000
Deçan	Sheshi i Habsburgëve	4,000	/	Deçan	8000 - 10000
Deçan	Sheshi Mentor Tolaj	500	/	Deçan	8000 - 10000
Deçan	Shëtitorja në dy brigjet e Lumëbardhit	24,000	/	Deçan	8000 - 10000
Isniq	Sheshi Rrustem Bruqi	1,000	/	Isniq	8000
Isniq	Sheshi Isa Boletini	2,000	/	Isniq	8000
Strellc i Epërm	Sheshi Ismet Ukaj	1,500	/	Strellc i Epërm	3500
Irzniq	Sheshi Shqiponjat e zeza	3,000	/	Irzniq	2500
Pobergjë	Beqir Vokshi	2,000	/	Pobergjë	1500
Gjithsejtë		53,400			

Tabela 78. Hapësirat publike (sheshet dhe parqet), regjistri sipas vendbanimeve

2.8.10 Ndërtesat e religjionit

Popullsia e Komunës së Deçanit, sa i përket religjionit është e ndarë në tri besime kryesore dhe atë myslimane, katolike dhe ortodokse. Pjesa me e madhe e popullsisë i takon besimit mysliman, përderisa një numër i vogël i popullsisë i takojnë besimit katolik dhe ortodoks. Konsiderohet se rreth 96% e popullsisë në Komunën e Deçanit, i takojnë besimit mysliman, 3% i takojnë besimit katolik dhe 1% besimit ortodoks.

Ndërtesat e kulteve fetare janë të shpërndara në gjithë territorin e Komunës së Deçanit. Numri total i xhamive është 17, ortodokse është Manastiri i Deçanit i mbrojtur nga UNESCO (Trashëgimi Botërore), Kisha Katolike në fshatin Papiq dhe dy Teqe në fshatin Korali dhe Baballoq.

Vendbanimet	Institucioni	Viti i themelimit	Lagja / zona gravituese	Numri i banoreve të besimit
Deçan	Xhami	2012	Deçan	3512
Strellc i Epërm	Xhami	2013	Strellc i Epërm	2204
Prilep	Xhami	1686	Prilep	1244
Pobergjë	Xhami	1999	Pobergjë	984
Strellc i Ulët	Xhami	1881	Strellc i Ulët	1732
Lëbushë	Xhami	1793	Lëbushë	96
Isniq	Xhami	1630	Isniq	2884
Deçan	Xhami	1851	Deçan	3512
Carrabreg	Xhami	1816	Carrabreg i Epërm. dhe Ulët	2100
Drenoc	Xhami	1717	Dranoc	856
Voksh	Xhami	1998	Voksh	456
Pozhar	Xhami	1817	Pozhar dhe Kodrali	340
Llukë e Epërme	Xhami	1900	Llukë e Epërme	916
Beleg	Xhami	2015	Beleg	1670
Baballoq	Xhami	1868	Baballoq	792
Irzniq	Xhami	1816	Irzniq	1156
Maznik	Xhami	/	Maznik	548
Papiq	Kishë	2002	Papiq	80
Deçan	Manastir	/	Deçan	/

Tabela 79. Institucionet fetare

Në përgjithësi janë 16 hoxhë dhe një prift ndërsa të dhëna për shërbyesit në Manastirin e Deçanit nuk kemi.

Institucionet fetare, kapacitetet hapësinore				
Institucioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Lartësia (h)
Xhamia e Re Deçan	0.034	0.0216	0.0124	P+3
Xhamia Strellc i Epërm	0.028	0.018	0.0100	P+1
Xhamia Prilep	0.200	0.0198	0.1802	P+1
Xhamia Irzniq	0.070	0.0165	0.0535	P+1
Xhamia Pobergjë	0.030	0.013	0.0170	P+1
Xhamia Strellc i Ulët	0.018	0.018	0.0000	P+1
Xhamia Lëbushë	0.040	0.006	0.0340	P+1
Xhamia Isniq	0.030	0.0144	0.0156	P+1
Xhamia e vjetër e Deçanit	0.110	0.015	0.0950	P+1
Xhamia Carrabreg	0.080	0.0187	0.0163	P+1
Xhamia Drenoc	0.100	0.0135	0.0865	P+1
Xhamia Voksh	0.150	0.0154	0.1346	P+1
Xhamia Pozhar	0.150	0.02	0.1300	P+1
Xhamia Llukë e Epërm	0.006	0.006	0.0000	P+1
Xhamia Baballoq	0.120	0.0192	0.101	P+1
Xhamia Maznik	0.458	0.0170	0.441	P+1
Kisha Papiq	0.160	0.0119	0.1481	P+0
Manastiri në Deçan	/	/	/	P+0

Tabela 80. Institucionet fetare, kapacitetet hapësinore

2.8.11 Varrezat

Varrezat, janë prezentë në Qytetin e Deçanit dhe në fshatrat e Komunës të ndara në varreza të popullatës së besimit: Mysliman, Katolik dhe Ortodoks. Në disa fshatra hasen varreza të shpërndara në më shumë se një hapësirë të ndryshme dhe janë në prona publike, infrastruktura rrugore deri të varrezat ekziston ndërsa sa i përket ndërtesave përcjellëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit në disa vende janë prezentë, por që në shumicën e vendeve mungojnë.


Hapësirat publike- varrezat (islame, katolike, ortodokse, tjera), regjistri sipas vendbanimeve				
Vendbanimet	Lokacioni	Viti I themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banoreve te besimit
Vendbanimi 01	Deçan	/	"Haxhi Mushkolaj", "Metë Sylve", "Luan Nimanaj"	Besimi Islam 3512
Vendbanimi 02	Strellc i Epërm	/	3x "Tahir Zemaj".	Besimi Islam 2204
Vendbanimi 03	Prilep	/	"Gazmend dhe Blerim Lokaj"	Besimi Islam 1244
Vendbanimi 04	Pobergjë	/	"Arif Vokshi", "Hulaj"	Besimi Islam 984
Vendbanimi 05	Strellc i Ulët		"Rexhë Zeqaj".	Besimi Islam 1732
Vendbanimi 06	Lëbushë	/	3 x "Enver Haradinaj".	Besimi Islam 96
Vendbanimi 07	Isniq	/	"Ali Musaj", "Osdautaj"	Besimi Islam 2884
Vendbanimi 08	Carrabreg	/	"Muharrem Lataj", "Lavdim Likaj"	Besimi Islam 2100
Vendbanimi 09	Dranoc	/	"Enver Alaj"	Besimi Islam 856
Vendbanimi 10	Voksh	/	"Dëshmorë e Vokshit"	Besimi Islam 456
Vendbanimi 11	Pozhar	/	"Valiant Ferizi" , "Pozhar"	Besimi Islam 340
Vendbanimi 12	Llukë e Epërm	/	"Verrat e Llukës"	Besimi Islam 916
Vendbanimi 13	Beleg	/	2x "Sadri Vishaj".	Besimi Islam 728
Vendbanimi 14	Baballoq	/	"Shalaj"	Besimi Islam 792
Vendbanimi 15	Kodrali	/	Kodrali	Besimi islam 980
Vendbanimi 16	Lumbardh	/	"Avni Pergjegjaj"	Besimi Islam 564
Vendbanimi 17	Dashinoc	/	"Mujë Mehmeti"	Besimi Islam 204
Vendbanimi 18	Sllup	/	"Bilall Mazrekaj"	Besimi Islam 272

Vendbanimi 19	Gllogjan	/	2x "Shkelzen Haradinaj"	Besimi Islam 792
Vendbanimi 20	Rastavicë	/	"Arben Qerimaj", "Tahir Kadrijaj".	Besimi Islam 708
Vendbanimi 21	Shaptej	/	"Rifat Beqiraj".	Besimi Islam 336
Vendbanimi 22	Gramaqel	/	2x "Jagozi", 2x "18 prill 98", "Faik Jasiqi", "Gojanëve".	Besimi Islam 832
Vendbanimi 23	Dubovik	/	"Vëllezërit Gërvalla".	Besimi Islam 712
Vendbanimi 24	Ratish I Epërm	/	"Arifaj"	Besimi Islam 144
Vendbanimi 25	Irzniq	/	"Cen Bajram Daci", "Rexhep Dervishaj", 2x te lapidari.	Besimi Islam 1156

Tabela 81. Varrezat islame, katolike, ortodokse dhe të tjera

Hapësirat publike - varrezat, kapacitetet hapësinore			
Lokacioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)
Deçan	0.4025 ha	0.325 ha	0.10 ha
Strellc I Epërm	0.3222 ha	0.3 ha	0.0222 ha
Prilep	0.146 ha	0.1 ha	0.046 ha
Pobergjë	13.6668 ha	13 ha	0.6668 ha
Strellc I Ulët	0.5302 ha	0.5 ha	0.0302 ha
Lëbushë	0.2198 ha	0.2 ha	0.0198 ha
Isniq	2.0091 ha	1.8 ha	0.2091 ha
Carrabreg	2.4498 ha	2.0 ha	0.4498 ha
Dranoc	0.7022 ha	0.7 ha	0.0022 ha
Voksh	1.3 ha	1.0 ha	0.30 ha
Pozhar	0.9212 ha	0.9 ha	0.0212 ha
Llukë e Epërm	2.09 ha	2.0 ha	0.09 ha
Beleg	2.1412 ha	2.0 ha	0.1412 ha
Baballoq	4.3787 ha	3.0 ha	1.3787 ha
Kodrali	0.4 ha	0.3 ha	0.10 ha
Lumbardh	4.3857 ha	3.857 ha	1.0 ha
Dashinoc	0.7022 ha	0.5 ha	0.022 ha
Sllup	0.4443 ha	0.05 ha	0.40 ha
Gllogjan	0.9717 ha	0.9 ha	0.0717 ha
Rastavicë	1.4288 ha	1.0 ha	0.4288 ha
Shaptej	1.4784 ha	1.0 ha	0.4784 ha
Gramaqel	9.815 ha	7.0 ha	2.815 ha
Dubovik	0.2888 ha	0.2 ha	0.0888 ha
Ratish I Epërm	1.2276 ha	1.0 ha	0.2276 ha
Irzniq	1.5739 ha	1.0 ha	0.5739 ha
Gjithsejtë	55.9 ha	43.67 ha	12.23 ha

Tabela 82. Hapësirat publike- varrezat, kapacitetet hapësinore



Harta 20. Menaxhimi i varrezave

2.9 Mbrojtja e mjedisit

2.9.1 Mjedisi

Mjedisi në Komunën e Deçanit ka përmirësime ne vitet e fundit si rezultat i administrimit të mirë të mbeturinave, pastrimin e deponive ilegale, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në pjesën rurale si dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese - shesheve dhe parqeve. Krahas veprimeve konkrete për rruajtjen e mjedisit, ekzistojnë shqetësime për humbjen e tokës bujqësore, mungesa e shtrirjes dhe trajtimi i ujerave të zeza në të gjithë vendbanimet, përdorimi automjeteve të vjetra, djegia e tokës pas korrjes, ngrohja me djegie, prerja e pa kontrolluar e pyjeve etj.

Veprimtaritë të cilat kanë ndikim në ndotjen e mjedisit janë:

- Gurthyesit (gjithsejtë dy),
- Sharra të përpunimit të drurit (gjithsejtë dhjetë),
- Reparacione (gjithsejtë dy) dhe
- Betoniera (gjithsejtë tre).

2.9.2 Ndotja e Ajrit

Ajri është element i rëndësishëm i mjedisit dhe domosdoshmëri për jetën. Ndotja e tij nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo artificiale (burime antropogjenë), përbën shkakun kryesor të përkeqësimit të cilësisë së tij, shkakton sëmundje dhe degradimin e elementeve tjera të mjedisit.

Transporti është njëri ndër ndotësit kryesor të ajrit, ujit, dhe tokës. Deçani si lidhje kryesore ne mes te Pejës dhe Gjakovës, vazhdimisht është nën ndikimin e gazrave të ndryshme të prodhuara nga

mjetet motorike me djegie të brendshme – fosile. Vjetërsia e mjeteve motorike ndikon ne çlirimin e mjaft grimcave PM që përfshijnë lëndë mikroskopike të shpërndara në ajër dhe njihen aerosolë. PM10 përfshin grimca me diametër më të vogël se 10 µm, PM2. 5 ato më pak se 2.5 µm. Toksiciteti i këtyre grimcave është kryesisht për shkak të grimcave me diametër më të vogël se 10µm. Këto grimca pastaj shpërndahen ne drejtimet e ndryshme fale erërave dhe ndikojnë drejt për se drejti në ndotjen e tokës (me theks të veçantë atë kualitative bujqësore) dhe në burimet e ujit, lumenjtë dhe kanalet e ujitjes. Kjo ndotje pastaj në mënyrë zingjirore arrin deri te trupi i njeriut. Përpos transportit, ndotës tjerë të ajrit janë djegiet e ndryshme për prodhim por edhe ngrohja me biomasë siç janë djegia e drurit, plehrat e kafshëve, apo mbetjet e të korrurave si dhe përdorimin i thëngjillit. Të gjitha këto janë burime të ndotjes së ajrit ku çlirohen sasi të mëdha të si CO_2 (dyoksidi i karbonit), NOx (Dyoksidi i azotit), SO_2 (Dyoksidi i sulfurit), Pb (Plumbi), etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotje nga qarkullimi i automjeteve në Komunën e Deçanit, është përgjatë rrugës kryesore Deçan-Pejë dhe Deçan-Gjakovë andaj në ketë drejtim janë vendosur 4 (katër) stacione matëse të ndotësve të ajrit në këto lokacione:

- Në rruga R107 në lokacionin te InterEX,
- Në rruga R107 në lokacionin te Banana Split,
- Në sheshin Mentor Tolaj, dhe
- Në qendër të qytetit.

Ndotja e mjedisit ne Komune - Ajri, sipas ndotësve përkatës dhe lokacioneve matëse								
Substancat ndotëse SO2 (dyoksidi i sulfurit) SULFURIT), CO (monoksidi i karbonit), NO2 (dyoksidi i azotit), PM10 (grimcat e suspenduara), PM2.5 (grimcat e suspenduara)	Viti 2023				Trendët e rritjes / zvogëlimit			
	Qershor 2023	Korrik 2023	Gusht 2023	Shtator 2023	Q - K 2023	K - G 2023	G - SH 2023	K - SH 2023
Substanca ndotëse, Afër InterEX								
PM 2.5	7.89	13.04	18.1	12.29	65.27	38.57	-32.099	-5.75
PM 10	16.07	34.9	30.2	24.36	117.174	-13.46	-19.33	-30.20
NO2	5.1	9.37	9.73	9.18	83.725	3.84	-5.65	2.027
O3	25.3	13.5	10.2	25.02	-46.640	-24.44	1482.0	85.33
SO2	2.2	1.1	1.6	1.7	-50	45.45	6.25	54.54
CO	0.2	0.1	0.2	1.2	-50	100.00	500.00	1100.00
Substanca ndotëse, Sheshi Mentor Tolaj								
PM 2.5	7	10.9	12.7	13.06	55.714	16.51	2.83	24.77
PM 10	16.54	33.6	24	26.31	103.143	-28.57	9.625	-21.69
NO2	9.12	14.8	12.7	15.8	62.280	-14.189	24.409	6.756
O3	23.7	13.9	10.45	22.69	-41.350	-24.82	117.129	63.237
SO2	2.5	1.4	1.8	1.1	-44.00	28.571	-38.888	-21.428
CO	0.1	0.6	0.8	1.6	500.00	33.333	100.00	166.66
Substanca ndotëse, Qendra qytetit								
PM 2.5	9.54	7.35	12.8	15.7	-22.955	74.149	22.656	113.605
PM 10	19.57	26.7	21.7	32.07	36.433	-18.726	47.788	20.112
NO2	11.2	8.26	6.22	19.07	-26.25	-24.697	206.591	130.871
O3	16.72	19.9	22.18	28.5	19.019	11.457	28.494	43.216
SO2	2.7	1.6	1.9	2.1	-40.740	18.75	10.526	31.25
CO	0.3	0.3	0.6	2.0	0.00	100	233.333	566.667
Substanca ndotëse, Afër Banana Split								
PM 2.5	7.07	7.6	13.8	15.81	7.496	81.578	14.565	108.026
PM 10	16.51	24.8	24.6	32.6	50.211	-0.806	32.520	31.451
NO2	24	7.1	10.6	11.72	-70.416	49.295	10.566	65.070
O3	8.97	16.6	11.9	23.6	85.061	-28.313	98.319	42.168
SO2	2.8	1.8	1.4	2.2	-35.714	-22.222	57.142	22.222
CO	0.2	0.4	0.5	2.1	100.00	25	320	425

Tabela 83. Ndotja e mjedisit ne Komune - Ajri, sipas ndotësve përkatës dhe lokacioneve matëse

Të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) tregojnë se numri i vdekjeve nga cilësia e dobët e ajrit është duke u rritur nga viti duke shkaktuar sëmundje jo të transmetuese duke përfshirë goditje në tru, sëmundje ishemike të zemrës, sëmundje pulmonare obstruktive kronike dhe kancer të mushkërive. Andaj është më se e nevojshme që gjatë hartimit të masave për mbrojtjen e ajrit në Komunën e Deçanit të shihen të gjitha mundësitë e përdorimit të teknologjisë së pastër dhe pa ndotje siç janë energjinë diellore, helikat për prodhimin e energjisë nga ajri, energjinë elektrike në mënyrë të kontrolluar ne efecientë, biogazin, gazin e lëngshëm të naftës (LPG), gazin natyror dhe karburantet alkoolike.

2.9.3 Ndotja e ujërave

Ne Komunën e Deçanit nuk ka njësi matëse te cilët e monitorojnë rregullisht nivelin e ndotjes se ujërave te lumenjve, kanaleve, proçkave etj.

Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësore në Komunën e Deçanit, i ekspozohen ndotjes nga shkarkimet e ndryshme qoftë nga bizneset dhe ekonomitë familjare. Përdorimi i ujit nga bizneset dhe amvisëritë pa u trajtuar shkarkohen në shtratin e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit.

Ujërat e ndotura (zeza) përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, baktere dhe viruse patogjene, metale të rënda: Cd (kadmiumi), Hg (merkuri), Zn (zinku), Pb (plumbi), Cr (kromi) etj. si dhe materie tjera që prishin cilësinë e ujit ndikojnë në ndryshimin e parametrave fiziko-kimik dhe biologjikë të ujit.

Nga burimi i tyre Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumëbardhi i Lloqanit, janë të pastër dhe klasifikohen në kategorinë e parë për nga cilësia e ujit ngase janë larg vendbanimeve kur fillon rrjedhja e tyre të shtrihet nëpër vendbanime, hynë në kategorinë e dytë të cilësisë së ujërave pasi kalojnë nëpër vendbanime për shkak të shkarkimit të ujërave të ndotura (zeza) si dhe për shkak të hedhjes së mbeturinave të amvisërisë dhe inerte. Shkarkimi i ujërave të ndotura (zeza) në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumenjve.

2.9.4 Degradimi i tokës

Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar nga veprimtaritë e ndryshme të cilat kanë ndikuar në degradim, humbje të tokës bujqësore ku ndotja e tokës prish ekuilibrin e lëndëve ushqyese që përmban toka. Lëndët e ngurta artificiale akumulohen në tokë dhe ndryshojnë veçoritë e saj fizike. Mbetjet kimike përzihen me bimët e kultivuara në tokë dhe ndikojnë negativisht në veçoritë biologjike të këtyre bimëve.

Në Komunën e Deçanit, një prej shqetësimeve për humbjen e fondit të tokës bujqësore janë ndërtimet në tokën bujqësore ku është identifikuar sipërfaqja prej 200.75 ha tokë ndërtimore nga sipërfaqja e përgjithshme e Komunës, prandaj çdo veprim që prish veçoritë dhe cilësitë natyrore të kësaj hapësire jetike emërtohet degradim (ndotje e tokës). Shumica e faktorëve që krijojnë degradimin e tokës vijnë nga shkaqe të ndryshme nga faktori njeri, ku ndër më kryesoret janë:

- Ndotja e tokës nga mbeturinat e amvisërisë dhe mbeturinat inerte;
- Përdorimi pa kriter i prepareteve kimikë;
- Erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve.

Për t'i parandaluar këto dëme duhet që:

- Pesticidet dhe plehrat të përdoren në masën të caktuar;
- Ujërat e përdorur (ndotura) që përmbajnë lëndë të dëmshme duhet të trajtohen pastaj të shkarkohen në lumenjtë;
- Dhe më e rëndësishmja duhet rritur niveli i vetëdijes shoqërore mbi degradimin dhe ndotjen së tokës.

2.9.5 Zhurma

Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme në nivel të përgjithshëm. Komuna e Deçanit, nuk ka Plan të Veprimit dhe Hartë për Zonat me Nivel të Zhurmës si dhe aparaturë përkatëse për matjen e nivelit të zhurmës, me të cilat obligohet sipas Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma Nr.02/L-102.

Këto dokumente duhet të identifikojnë zonat e zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimin e masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma si dhe përdorimin e materialit akustik gjatë ndërtimit të ndërtesave, po ashtu edhe përgjatë rrugëve të bëhet mbjellja e drurëve-brezi i gjelbër.

Gjatë matjeve të shpejta me aplikacione te thjeshta telefonike, rezulton se ne pikun e ditës e gjithë rruga R107 është me nivel deri 25% ma shumë se norma e lejuar gjatë ditës. Niveli i zhurmës ne pjesën qendër është 76.80 decibel ose 16.80 decibel ma e lartë se norma e lejuar prej 60 decibelëve. Ne zonat e banuara niveli i zhurmës është nen kufirin e 60 decibelëve (rreth 42 decibel) ndërsa në mbrëmje (ne ora 20:00) rruga R107 është mbi kufirin e 50 decibelëve (54.20 decibel).

Mirëpo, për të pasur një gjendje reale të niveli të zhurmës, është e nevojshme që të vendosen matës në shumë pika të cilët e monitorojnë nivelin e zhurmës dhe të cilët në baza vjetore ofrojnë gjendjen reale gjatë periudhave te ndryshme ditore.

2.9.6 Fatkeqësitë natyrore

Në Komunën e Deçanit, fatkeqësitë natyrore përbejnë rrezik për jetën e njeriut, mjedisin, ndërtesat e trashëgimisë kulturore. Ato shfaqen në mënyra të ndryshme nëpërmjet vërshimeve, tërmeteve, zjarreve të pa kontrolluara, erërat e forta, erozionet, rrëshqitja e dheut etj. Për këtë arsye masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat, Komuna e Deçanit e ka të miratuar dokumentin për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Territorin e Komunës së Deçanit[55], i cili shërben si udhëzues për identifikimin e rrezikshmërisë dhe planifikimin e masave parandaluese.

2.9.7 Tërmetet

Territori i Kosovës, karakterizohet me lëkundje të forta nga tërmetet, vatrat e të cilëve mund të jenë sipas sizmologëve jashtë territorit të Kosovës respektivisht në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi por edhe jashtë këtyre shteteve.

Lëkundjet lokale autoktone dhe seizmicitetit që janë aktive në shtetet fqinje dëshmojnë për renditjen e Kosovës, në radhën e territoreve me aktivitet të lartë sizmik. Ky aktivitet mund të diktohet në mënyrë direkt dhe indirekte edhe në territorin e Komunës tonë.

Territori i Kosovës ka disa zona të fuqishme të burimeve sizmike, apo sizmogjene, siç janë:

- 1. Zona sizmogjene Prizren-Pejë magnitudë maksimale M=6.6 shkallë Rihter,
- 2. Zona sizmogjene Ferizaj-Viti-Gjilan me magnitudë maksimale M=6.1 shkallë Rihter,
- 3. Zona sizmogjene Kopaonik me magnitudë maksimale M=6.0 shkallë Rihter.

Disa nga tërmetet e fuqishme të regjistruara në Kosovë mirëpo që janë ndjerë edhe në Komunën e Deçanit janë:

- Tërmeti i Prizrenit në 16 qershor 1456[56],
- Tërmeti i Pejës me 11 nëntor 1662[57],

[55] Plani i vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit, viti i miratimit 2010.
[56] Sulstarova et al., 2005
[57] Sulstarova et al., 2005; Papazachos et al., 2000),

- Tërmeti i Ferizaj dhe Viti në 10 gusht 1921[58],
- Viti në 15 gusht 1921[59],
- Tërmeti i Gjilanit në 2 shtator 1921[60],
- Tërmeti i Kaçanikut dhe Viti në 3 tetor 1921[61],
- Tërmeti i Gjakovës 3 shtator 1922[62],
- Tërmeti i Prizrenit me 26 shtator 1945[63],
- Tërmeti i Klinës 5 shkurt 1947[64],
- Tërmeti i Kopaonik 18 maj 1980[65],
- Tërmeti i Gjilanit 24 prill 2002[66],
- Tërmeti i Istog 10 mars 2010[67],
- Tërmeti i Vushtrri 18. nëntor 2013[68].




Figura 12. Njësitë gjeotektonike të Ballkanit Qendror dhe në Kosovë

Ndërsa tërmetet e ndodhura ne shtetet fqinje mirëpo që janë ndjerë ne Komunën e Deçanit që nga viti 1900 e deri më sot janë: 5 tërmete mbi magnituden 6 shkallë Rihter, 52 dridhje në mes të magnitudes 5 dhe 6 shkallë Rihter , 554 dridhje në mes të magnitudes 4 dhe 5 shkallë Rihter.

Ndër këto me e fuqishmja mund të identifikohet tërmeti i Ishujve Kamenik (Bar, Mali i Zi) me magnitudë 6.9 e vitit 15. prill. 1979.

Duke i marrë për bazë shkallën e urbanizimit, karakteristikat e teknologjisë së ndërtimit si dhe mos respektimin aseizmik të ndërtimit të ndërtesave, mund të theksohet se Komuna jonë është e rrezikuar në ketë pikëpamje sizmike.


Në bazë të kësaj, mundësitë për shpëtim në raste të tërmeteve janë minimale por gjithashtu ekzistojnë parakushte të mira për përkujdesje shëndetësore të lënduarve. Është e pa mundur që të

[58] SO Skopje, D. Hadzievski
[59] SO Skopje, D. Hadzievski
[60] SO Skopje, D. Hadzievski
[61] SO Skopje, D. Hadzievski
[62] SO Skopje, D. Hadzievski
[63] SO Skopje, D. Hadzievski
[64] SO Skopje, D. Hadzievski
[65] Harvard University, 1980
[66] ISC, 2002; Elezaj, 2002
[67] SIK Sh.Mustafa, N.Hasi, 2010
[68] GSK, Sh, Mustafa, 2013


parandalohet një tërmet ose një dukuri tjetër sizmike, por është e mundur që të merren masat për të kufizuar efektet më negative që lidhen me cenimin e jetës dhe të pasurisë së qytetarëve. Duhet të ndërmerren masa adekuate për zvogëlimin e dëmeve në rastet të tilla si dhe të zbatohen standardet e ndërtimit të ndërtesat kolektive dhe private, rrugë, sistemit e furnizimit me ujë, energji elektrike, të cilat do të jenë shumë të rëndësishme për fazën e përballimit dhe të rimëkëmbjes nga një goditje eventuale sizmike. Edhe pse Komuna e Deçanit nuk është prek drejt për se drejti nga tërmeti, ajo duhet të harton programin e vet lokal për rastet e tërmeteve.

Tërmeti i Durrësit me 26 Nëntor 2019, ngriti në pah situatën reale të ndërtimeve, përgjegjësinë institucionale, rolin e një vendi mirëpo edhe përgjegjësinë e popullatës në rastet e tërmetit. Andaj është më se e rëndësishme që të fillohet sa ma parë dhe të veprohet në këto drejtime:

- Fazës para tërmetit – vlerësimi i situatës dhe marrja e të gjitha masave përgatitore para se të ndodh një tërmet me pasoja.
- Fazës gjatë tërmetit - menaxhimi i situatës e me theks të veçantë edukimi i banorëve në rast të tërmeteve me pasoja.
- Fazës pas tërmetit - ofrimi i kujdesit shëndetësor, sigurimi i ujit të pijshëm dhe ushqimit, kujdesi ndaj popullatës së cenuar me theks te veçantë të sëmurët, të moshuarit, shtatzënat, personat me aftësi të kufizuara dhe mënjanimi aksidenteve, incidenteve apo konflikteve.



Harta 21. Harta sizmike e Kosovës



Harta 22. Zonat sizmike


2.9.8 Vërshimet

Vërshimet janë fatkeqësi elementare që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe janë dukuri që shfaqen në zonat e caktuara që janë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe shkaktojnë dëme materiale. Vërshimet, mund të parashikohen nëpërmes përdorimit të teknologjisë së avancuar dhe të merren masat paraprake për parandalimin ose uljen e dëmeve ne jetë të njerëzve nëpërmes evakuimit. Sado qe mund te merren veprime konkrete për parandalimin e vërshimeve, duhet te ceket se vërshimet kurrë nuk mund të parandalohen në masën 100%. Atyre mund ti rezistohet për një periudhe apo kohë te caktuar mirëpo, është mjaft e vështirë që ato të parandalohen në tërësi andaj, përparësi është se ne këto raste mund të menaxhohen që të ketë sa ma pak dëme. Uji që mblidhet nga reshjet dhe shkrirja e borës mund të gjendet përgjatë rrjedhës se lirë sipërfaqësore, dhe në këtë rast është e rëndësishme që t'i krijohen kushtet për rrjedhje të lirë dhe papengesa. Ne pika te caktuara janë te nevojshme te ndërtohet kanalizimi atmosferik, kanalet e ujitjes dhe të behët mirëmbajtja e vazhdueshme e lumenjve.

Komuna e Deçanit, me vite ballafaqohet me problemin e vërshimeve si në vendbanime ashtu edhe në tokën bujqësore por nga viti në vit Komuna e Deçanit është përballë me vërshimet të cilat kanë përmbytur sipërfaqe të mëdha te tokës. Deri sa ne vitin 2011 ishin te vërshuar vetëm 1 ha, ne vitin 2012 rritja e përmbytjes nga vërshimet ka qene ne mase 33% gjegjeshit 1.5 Ha. Gjendja e përmbytjeve nga vërshimet ishte stabile deri ne vitin 2023, kur 7 ha tokë ne Komunën e Deçanit janë përmbytur si rrjedhojë e vërshimeve. Pas analizimit të vërshimeve të vitit 2023 është ardhur në përfundim se rrjedhja e ujit nga zonat malore drejt asaj fushore ne mënyrë të lirë ka shkaktuar përmbytje duke i cenuar zonat fushore siç janë: Strellc i Epërm - Behovci, që përshkon fshatrat Isniq dhe Dubovik, Isniq - përroi i Sijakut dhe Selishtave, Përroi i Ukaj në Deçan, Lugu Davel në Carrabreg i

Epërm, Lumëbardhi i Lloqanit që vërshon vendbanimet Baballoq dhe Jasiq i Ri, Përroi i Malit, që përshkon vendbanimet Prilep dhe Rastavicë. Ndikimi i vërshimeve është:

- Në shkaktimin e dëmeve ekonomike,
- Në cenimi i shëndetit të njerëzve,
- Ne rrezikimin e bagëtive,
- Ndotja e mjedisit,
- Dëmtimi i të gjitha rendimenteve bujqësore ku ka pas përmbytje.



Harta 23. Zonat e rrezikuara nga përmbytje


2.9.9 Thatësira

Thatësira mund të llogaritet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë stinës së verës, zakonisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë të larta dhe reshjet janë të rralla. Deri në hartimin e projekt PZHK-së nuk janë identifikuar zonat të cilat kanë thatësira të mëdha.

2.9.10 Erërat

Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngrohta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët. Erërat ndikojnë në komoditetin e ambientit të njeriut, në temperaturat

fiziologjike të njeriut. Shpejtësi me të madhe mesatare e erërave në Komunën e Deçanit, janë ato veriore dhe jug-perëndimore. Të gjitha erërat kanë drejtime dhe shpejtësi mesatare 3-4 m/s, kurse shpejtësia maksimale është deri 18,9 m/s.



Grafiku 18. Trëndafili i erërave

2.9.11 Fatkeqësitë tekniko – teknologjike

Sipas të dhënave zyrtare në Komunën e Deçanit, bizneset individuale në Deçan, janë të ndërtuara 16 pompa të karburanteve dhe 5 pompa me butan gaz. Kapacitet e deponive te këtyre karburanteve nuk kalojnë me tepër së 30 m³. Bartja-transportimi i karburanteve bëhet përmes magjistrales Pejë-Gjakovë, rrugëve rajonale Llukë - Deçan, si dhe rrugëve tjera të fshatrave.

Rreziku është edhe gjatë transportit mund të shkaktohet edhe shfaqja e zjarrit dhe shpërthimeve të ndryshme. Sipas shënimeve që posedon Komuna, nuk ka pasur ndonjë rast të shpërthimit të auto-cisternave apo ndezjes se tyre.

Në Komunën e Deçanit, janë të identifikuara dy vende për grumbullim të hekurishteve dhe automjeteve të vjetra.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, rajoni i Dukagjinit, respektivisht zona e Koshares përfshirë edhe Komunat fqinje siç janë Deçani, Juniku dhe Gjakova kanë qenë cak i sulmeve ajrore nga forcat e Aleancës Veri atlantike – NATO kundrejt atyre pushtuese serbe. Pas përfundimit të luftës, nga UNEP[69] është kryer vlerësim i mjedisit pas konfliktit në të gjithë territorin e Kosovës (5 -19 nëntor 2000) me theks te veçantë prezenca e uraniumit të varfëruar ne Kosovë. Në Komunën e Deçanit, janë identifikuar lokacione te cilat kanë rezultuar ma te ndotura nga mbetjet e luftës se fundit. Bëhet fjale për fshatin Irzniq dhe fshatin Vranoc në të cilat janë kryer testet e tokës, ujit dhe teste tjera (prodhime te ndryshme nga kafshët) kanë rezultuar te pa ndotura ndërsa mbetjet e gjetura kanë qenë brenda normave të lejuara ose pothuajse të pandjeshme dhe pa ndikim ne në mjedis dhe jetën në

[69] March.PDF (iaea.org)

përgjithësi. Mirëpo rekomandohet që në të ardhmen të vazhdohet me hulumtimet me synim të mbajtjes nën kontroll të gjendjes.

Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet), në Komunën e Deçanit, nuk ka të evidentuar ndonjë sipërfaqe apo deponim të mbeturinave, që mund të kategorizohet si zonë me ndotje të lartë.


2.9.12 Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Në Komunën e Deçanit, vazhdimisht ka pasur raste te shpërthimeve te zjarrit në pjesët e bjeshkëve, zonave të pyllëzuara si dhe në disa raste edhe disa ndërtesa individuale dhe zjarre fushore. Dëmet materiale nuk janë të vogla por nëse përfshihen edhe zjarret në pyje përfshinë një kosto shumë të madhe. Zjarret që janë paraqitur në male-bjeshkë dhe fusha dyshohet që janë shkaktuar nga pakujdesia e faktorit njeri.

Sipas te dhënave, zjarret e vitit 2011 kane shkaktuar dëme ne 57 ha ku situata e atëhershme ishte vetëm një paralajmërim për rreziqet ne vijim e qe ne vitin 2012 u përfshinë 252.3 ha nga zjarri. Viti 2012 identifikohet edhe si viti i cili ka pas me se shumti dëme nga zjarri te cilat i kanë përfshi zonat malore kurse në vitin 2023, zjarret kanë përfshi rreth 50 ha të sipërfaqeve kryesisht te zonës malore.

2.9.13 Erozioni

Erozioni është një faktor shumë i rëndësishëm për trajtim sepse kërcënon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën si dhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është e pranishme në pjesën malore-bjeshkë në forma dhe intensitete të ndryshme. Në shfaqjen e kësaj dukurie në shumicën e rasteve ka ndikuar faktori njeri, si rezultat i shfrytëzimit joracional të tokës bujqësorë, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, por edhe për shkak të shfrytëzimit të pakontrolluar të aluvioneve përgjatë lumenjve. Më së shumti është shfaqur si pasojë e degradimit të pyjeve, pjerrtësisë së terrenit, e cila ka arit si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes përgjatë brigjeve dhe shtretërve të lumenjve, mungesës së pendëve mbrojtëse dhe dëmtimit të masës mbrojtëse vegjetacionit. Erozioni nuk ka qenë shumë evident në këto dekadat e fundit përpos vitit 2023 kur janë evidentuar 3.5 ha tokë të afektuar nga erozioni. Ekzistojnë mjaft rezultate për shkaktimin e erozionit e cila lidhet me reshjet e dendura, vërshimet dhe përmbytjet që kanë ndodhë gjatë vitit 2023.



Harta 24. Erozionet


2.9.14 Rrëshqitja e tokës, ngricat, stuhitë dhe ortekët e borës

Sikurse rasti i erozionit, edhe rrëshqitja e dheut është paraqitë gjatë vitit 2023 në sipërfaqe prej 1.5 ha. Më herët nuk ka pas të dhëna për rrëshqitjen e dheut apo identifikimin e zonave ne Komunën e Deçanit te cilat janë të rrezikuara nga rrëshqitja e dheut andaj është më se e domosdoshme që krahas identifikimit të zonave potenciale për rrëshqitje të dheut, të identifikohen edhe shkaktarët e këtyre dukurive. Ndërsa sa i përket ngricave, stuhive dhe ortekëve te borës ku mund të pëson popullata apo te shkaktohen dëme materiale atakohen zonat malore-bjeshkët.

Në pjesën malore-bjeshkë rreziku nga rrëshqitja e tokës, stuhitë dhe ortekët e borës, kur këto hapësira popullata i shfrytëzon me tepër gjatë sezonit dimëror, prandaj deri sa nuk kemi banim të përhershëm në ato zona, rreziku është shumë i vogël.

Fatkeqësitë natyrore, sipas kategorive kryesore, 2011 - 2023									
Fatkeqësia	Sipërfaqja e afektuar (ha)					Trendët e rritjes / zvogëlimit			
	2011	2012	2017	2019	2023	2011 - 2012	2012 - 2017	2017 - 2019	2019 - 2023
Erozioni	0	0	0	0	3.5	0	0	0	0
Tërmetet	0	0	0	29394.00	0	0	0	0	0
Vërshimet	1	1.5	3	5	7	50	100	133.33	600
Rrëshqitjet	0	0	1	0	1.5	0	0	0	0
Zjarret pyjore	57	252.3	60	100	50	342.63	-320.5	66.66	-12.28

Tabela 84. Fatkeqësitë natyrore, sipas kategorive kryesore, 2011 - 2023



Harta 25. Plani i mbrojtjes nga rreziqet natyrore

2.10 Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

2.10.1 Asetet e trashëgimisë natyrore

Komuna e Deçanit, është e njohur me trashëgimi natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është nën mbrojtje ligjore. Disa nga zonat e mbrojtura të natyrës në territorin e Komunës së Deçanit, datojnë që nga vitet e '50 të shekullit të kaluar. Sipas listes se trashigimise natyrore ne Komunen e Deçanit egzstojne gjithesejt 27 zona te mbrojtura te cilat perbehen nga 3 rezervate natyrore, 1 park kombëtar, 1 zone e vecant e mbrojtur e natyres, 1 park i natyres, 19 monumente te natyres dhe 2 pejsazhe.

Parku Komebtar "Bjeshkët e Nemuna " e zenë 26% të sipërfaqes së Komunes së Deçanit ose 16765.45 ha dhe trajtohet me Planin Hapësinorë për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna ", kurse në përgjithësi, 17758.07 ha janë sipërfaqe me trashigimi natyrore ne Komunën e Deçanit.

Trashëgimia natyrore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore		
Kategoritë	Numri	Sipërfaqja (ha)
Rezervat i natyrës	3	186.92
Park kombëtar - PK Bjeshkët e Nemuna - 26.6% sipërfaqja për pjesën e Komunës së Deçanit	1	16765.45
Zone e veçantë e mbrojtur e natyrës	1	790.7
Park i natyrës	1	15
Monument i natyrës	19	0
Peizazh i mbrojtur	2	0
Monument i arkitekturës se parkut	0	0
Gjithsejtë	27	17758.07

Tabela 85. Trashëgimia natyrore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore

Rezervatet natyrore - ne Komunën e Deçanit janë Parku Kombetar Bjeshkët e Nemuna - Maja e Ropsit i shpallur ne mbrojtje ne vitin 1955; Parkut Kombetar Bjeshkët e Nemuna – Kozhnjeri i shpallur nën mbrojtje në vitin 1955, Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – Malet e Preilepit të shpallura nën mbrojtje në vitin 1963. Sipëfaqja e përgjithshme e rezervateve të natyrës ne Komunen e Decanit është 186.92 ha.

Rezervatet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Deçan - PK Bjeshkët e Nemuna, Maja e Ropsit	1955, nr. 277/55		25
Deçan - PK Bjeshkët e Nemuna, Kozhnjeri	1955, nr. 337/58		161
Deçan - PK Bjeshkët e Nemuna, Malet e Prilepit	1963,nr 05/6/9/63		0.92
Gjithsejtë			186.92

Tabela 86. Rezervatet e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Rezervati natyror Maja e Ropsit, me sipërfaqe 25 ha, është venë në mbtojtje në vitin 1955 me Nr.277/55 dhe ka rendesi botanike me llojet e ruajtura të molikës, bredhit, pishës, ahut etj.
Rezervati natyror Kozhnjeri me sipërfaqe 161 ha, është venë në mbrotje në vitin 1955 me Nr.337/58 dhe ka rendësi faunistike gjegjësisht është rezervat ku jeton dhia e egër (Rupicarpa rupicarpa).
Rezervati natyror malet e Prilepit me sipërfaqe 0.92 ha, është venë në mbrojtje në vitin 1963 me Nr 05/6/9/63 dhe ka rëndësi botanike me përbërje të pastër të panjës malore (Accer Heildreichii).
Zonat e Vecanta te Mbrojtura - në Komunën e Decanit janë të rregulluara me Ligjin Zonat e Vecanta te Mbrojtura - Ligji nr. 03/L-039 e cila siguron Mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, e që në këtë rast është Manastiri i Decanit i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 800 ha, dhe Zona e Vecant e Mbrojtur Pishat e Decanit e shpallur nen mbrojtje në vitin 1968 dhe ka sipërfaqe prej 15 ha.

Zone e veçantë e mbrojtur e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore			
Njësia kadastrale	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Deçan, Zona e veçantë e mbrojtur	Ligji nr. 03/L-039		800
Deçan, Pishat e Deçanit	1968		15
Gjithsejtë			815

Tabela 87. Zone e veçantë e mbrojtur e natyrës, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Monumentet natyrore - në Komunën e Deçanit, kanë karakter: botanik, hidrologjik, gjeomorfologjisë po ashtu duke i përfshirë edhe peizazhet e ndryshme natyrore, që gjenden në gjithë territorin e Komunës, dhe konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Instituti për Mbrojtjen e Natyrës (Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit) ka bërë hulumtimin dhe evidentimin e vlerave të reja të natyrës. Përveq vlerave të natyrës të mbrojtura paraprakisht, gjatë procesit të evidentimit të vlerave natyrore në territorin e Komunës së Deçanit, janë identifikuar edhe 19 vlera të reja, disa prej të cilave për shkak të vlerave unike janë të mbrojtura në mënyrë institucionale.

- Isniq – Bliri (1968)
- Isniq - Trungjet e Blirit (1968)
- Llukë e Ulët - Gleni i Llukës
- Kodrali - Trungu i Blirit
- Kodrali – Trungu bungëbutes
- Strellc i ulët – Trungu i Blirit

- Strellc i epërm – Trungu i Blirit
- Decan – Burimi i ujit mineral
- Decan – Trungu i Blirit
- Maznik – Trungu i Dudhkut
- Dashinoc – Trungu i Dushkut
- Ratishë e ulët – Trungu i Mrizit (bungut)
- Ratishë e epërm - Trungu i Dushkut
- Ratishë i epërm – Komleksi i trungjeve
- Shaptei – Kompleksi i trungjeve të dushkut
- Gramaqel – Kompleki i trungjeve – Varrezat e Jagozit.
- Carrabreg i Epërm – Trungu i Dushkut
- Drenoc – Trungjet e blirit dhe treungu u pishës
- Rastavicë – Trungu i Dushkut.

Gjithsejtë	**40,019**	**42,490**	**43,000**	**43,516**	**44,038**	**44,567**	**45,102**	**45,643**	**46,191**	**46,745**	**47,306**	**47,874**

Tabela 114. Projeksionet e popullsisë rezidente, jo rezidente dhe mërgimtarëve deri në vitin 2031 në Komunën e Deçanit sipas vendbanimeve

Komuna e Deçanit karakterizohet me popullsi të re dhe është sfiduese që rinisë së Deçanit ti sigurohet punësimi. Për momentin përpos vendeve të punës që ofrohen ne NVM, rinia nga Deçani vende pune sigurojnë edhe në Pejë dhe Gjakovë sepse distanca me këto dy qytete është e vogël. Kjo mundëson qe rinia ti shfrytëzon këto dy qytete për punësim dhe mos të migrojnë. Tendencat për lëvizjen e popullsisë e sidomos atyre me kapacitete profesionale është evidente.

Migrimi jashtë Kosovës nga Komuna e Deçanit vazhdon me trendët sikurse ka qene në vitet e kaluara, mirëpo edhe kthimi i mërgimtarëve kryesisht në moshë të shtyrë është rritur ne vitet e fundit. Politikat e ndihmës sociale janë problematike si rezultat i buxhetit të ulët, ndërsa investimet kapitale për përmirësimin e cilësisë së jetesës për banorë nuk ka munguar kundrejt buxhetit të vogël Komunal. Sektori i bujqësisë është mjaft i favorshëm për zhvillim, mirëpo ne vitet e fundit jo vetëm ne Deçan por edhe në Komunat tjera të Kosovës, puna në bujqësi nuk është e parapëlqyer nga të rinjtë.

Rekomandohet që të hartohen politikat e qëndrueshme ekonomike që të ofrojnë të rinjve dhe popullsisë ne përgjithësi sa ma shume aktivitete, programe sociale, ekonomike dhe kulturore ne te ardhmen. Të ju mundësohet qifteve të reja banimi me çmim të përballueshëm dhe të favorizohen nëpërmes programeve që të gjejnë punësim.

Analiza SWOT - Demografia	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Popullatë ekonomikisht aktive, - Rritja standarde e popullatës, - Popullatë e arsimuar mirë me numër të studentëve gjithnjë e në rritje. - Familja mesatare përbëhet nga 5 anëtarë. - Përbërja gjinore përafërsisht e barabartë.	- Migrimi i popullsisë (kryesisht të rinjtë) në shtetet tjera, - Migrimi i popullsisë lokale për punësim dhe arsim në vende të tjera brenda Kosovës.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Zhvillimi i programeve të ndryshme socio-ekonomike për të gjitha grupet e moshave, - Planifikimi hapësinor dhe krijimi i vendbanimeve të reja, - Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik me theks të posaçëm në turizëm, ndërmarrjet e vogla, prodhimtari, bujqësi e që do të kenë një ndikim pozitiv në demografinë. - Mbështetje e jashtme financiare (nga mërgimtaret)	- Humbja e fuqisë të aftë për punë – popullsisë aktive (migrimi i të rinjve në vende të tjera), - Humbja e kapaciteteve profesionalë për punë (kryesisht të rinjtë), - Zhvillimi ekonomik i paqëndrueshëm ka një ndikim në demografi, - Mbështetja financiare respektivisht varësia nga jashtë (mërgimtarët),

Tabela 115. SWOT analiza për demografi

3.3 Ekonomia

Vlerësimi i gjendjes së ekonomisë është thelbësor për disa arsye, pasi ofron informacion të vlefshëm për politikë bërësit dhe orientimin e politikave lokale drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Andaj, është e rëndësishme që pas vlerësimit të caktohen – formulohen politikat lokale ekonomike me synim te krijimit të stabilitetit ekonomik si dhe rritjen e saj ne vitet ne vijim. Nëpërmes hartimit të politikave lokale ekonomike, ofrohen strategji te qëndrueshme për bizneset me synim të krijimit të besimit të investitorët e cila rezulton me rritjen e numrit të punësuarve. Rritja e investimeve nga sektori i biznesit, gjenerimi i te ardhurave, rritja e numrit të punësuarve do të ndikon ne rritjen e buxhetit lokal te cilat kthehen ne investime kapitale për rritjen e mirëqenies dhe kualitetit te jetesës për banorë. Gjithashtu, vlerësimi i gjendjes ekonomike, është paralajmërues për rreziqet e mundshme ne sferën e ekonomisë.

3.3.1 Ekonomitë familjare, punësimi dhe papunësia

Ne regjistrimin e vitit 2011 ne Komunën e Deçanit kanë rezultuar gjithsejtë 5918 ekonomi familjare, me mesatare 6.8 anëtarë për një familje. Sipas vlerësimeve të viti 2020 numri i anëtarëve për një familje ishte 4.92 anëtarë ndërsa në vitin 2021 ky numër ka ra ne 4.85 anëtarë për familje. Madhësia e familjeve për nga numri i anëtareve është i ndryshëm, duke filluar nga 1 anëtarë për familje e deri te 10 anëtarë për familje. Bazuar ne këto të dhëna, më se shumti ne Komunën e Deçanit ka familje me 10 anëtarë (1017 ekonomi familjare), pastaj me 5 anëtarë (1001 ekonomi familjare), me 6 anëtarë (983 ekonomi familjare) etj. Numri i madh i anëtarëve për familje tregon se ne Komunën e Deçanit ende vazhdon tradita e te jetuarit ne bashkësi edhe pse numri i ekonomive familjare me 1 deri ne 4 anëtare është në rritje e që tregon se gradualisht kanë filluar familjet me mëdha të ndahen nga bashkësia familjare dhe te jetojnë të ndara. Ky është një tregues se ne Komunën e Deçanit janë të nevojshme shtimi i njësive të reja të banimit pa marr parasysh kërkesat për banim nga mërgimtarët.

Numri i anëtareve për ekonomi familjare										
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10+
Gjithsejtë në Komunë	142	302	351	637	1001	983	699	445	310	1017

Tabela 116. Numri i anëtareve për ekonomi familjare

Të dhënat për numrin e anëtarëve të familjes për vitin 2022 dhe 2023 nuk janë publikuar nga ASK, andaj si referim për projeksionet e ekonomive familjare për vitin 2031 merren te dhënat zyrtare te vitit 2021, gjegjësisht 4.85 anëtarë për familje. Sipas vlerësimit të numrit të popullsisë në vitin 2021 në Komunën e Deçanit janë gjithsejtë 42460 banorë ose 8636 ekonomi familjare me mesatare 4.92 anëtarë për familje.

Projeksionet e ekonomive familjare ne vendbanimet e Komunës Deçanit												
Vendbanimi	2011	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Baballoq	235	350	354	358	363	367	371	376	380	385	389	394
Beleg	121	181	183	185	187	190	192	194	197	199	201	204
Belle	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Carrabreg i Epërm	213	317	320	324	328	332	336	340	344	348	352	357
Carrabreg i Ulët	303	451	456	462	467	473	478	484	490	496	502	508
Dashinoc	44	65	66	67	68	69	69	70	71	72	73	74
Deçan	558	830	840	850	861	871	881	892	903	914	925	936
Drenoc	154	229	232	235	237	240	243	246	249	252	255	258
Dubovik	156	232	235	238	241	243	246	249	252	255	258	261
Dubravë	41	61	62	62	63	64	65	65	66	67	68	69
Gllogjan	145	215	218	221	223	226	229	231	234	237	240	243
Gramaçel	161	240	243	246	249	252	255	258	261	264	267	271
Hulaj	23	35	35	35	36	36	37	37	38	38	39	39
Irzniq	256	381	385	390	395	399	404	409	414	419	424	429
Isniq	569	847	858	868	878	889	900	910	921	932	944	955
Kodrali	119	177	179	181	183	186	188	190	192	195	197	199
Lëbushë	168	251	254	257	260	263	266	269	273	276	279	282
Lumbardh	105	157	159	161	163	165	167	169	171	173	175	177
Lloqan	73	109	111	112	113	115	116	117	119	120	122	123
Llukë e Epërme	213	318	321	325	329	333	337	341	345	349	354	358
Llukë e Ulët	74	111	112	113	115	116	118	119	120	122	123	125
Maznik	66	98	99	100	101	103	104	105	106	108	109	110
Papiq	26	38	39	39	39	40	40	41	41	42	42	43
Pobergjë	193	288	291	295	298	302	305	309	313	316	320	324
Pozhar	62	93	94	95	96	97	99	100	101	102	103	105
Prapaqan	109	162	164	166	168	170	172	174	176	178	180	183
Prokolluk	42	63	63	64	65	66	67	67	68	69	70	71
Prilep	318	474	480	485	491	497	503	509	515	521	528	534
Rastavicë	182	271	274	278	281	284	288	291	295	298	302	305
Ratish i Epërm	31	46	47	47	48	48	49	49	50	51	51	52
Ratish i Ulët	82	123	124	126	127	129	130	132	133	135	136	138
Sllup	50	74	75	76	77	78	79	79	80	81	82	83
Strellc i Epërm	492	733	742	750	759	769	778	787	797	806	816	826
Strellc i Ulët	311	463	468	474	480	485	491	497	503	509	515	521
Shaptej	87	129	131	133	134	136	137	139	141	142	144	146
Voksh	84	125	126	128	129	131	132	134	136	137	139	141
Vranoc i Vogël	16	24	25	25	25	25	26	26	26	27	27	27
Gjithsejtë në Komunë	**5,885**	**8,761**	**8,866**	**8,972**	**9,080**	**9,189**	**9,299**	**9,411**	**9,524**	**9,638**	**9,754**	**9,871**

Tabela 117. Projeksionet e ekonomive familjare ne vendbanimet e Komunës Deçanit

Numri i ekonomive familjare është ma i madh në zonat rurale se në zonën urbane ku në përgjithësi ne zonën urbane janë 9% ndërsa në ato rurale 91 % e ekonomive familjare.

Numri ekonomive familjare në vendbanimin urban dhe në vendbanimet rurale – ekzistuese dhe projeksione												
	2011	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Urban	558	830	840	850	861	871	881	892	903	914	925	936
Përqindje %	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9
Rural	5,327	7,931	8,026	8,122	8,219	8,318	8,418	8,519	8,621	8,725	8,829	8,935
Përqindje %	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91

Tabela 118. Numri ekonomive familjare në vendbanimin urban dhe në vendbanimet rurale – ekzistuese dhe projeksione

Vendbanimet	Populsia 2011	Ekonomik familjare	Populsia 2023	Ekonomitë familjare	Projeksioni 2031	Ekonomi familjare	Rritja e populsisë në bazë të projeksionit 2023-2031	Rritja në bazë të projeksionit te ekonomive familjare 2023-2031
Baballoq	1598	235	1738	358	1912	394	174	36
Beleg	826	121	898	185	988	204	90	19
Belle	8	1	9	2	10	2	1	0
Carrabreg i Epërm	1446	213	1572	324	1730	357	157	32
Carrabreg i Ulët	2059	303	2239	462	2463	508	224	46
Dashinoc	299	44	325	67	358	74	33	7
Deçan	3803	594	4125	850	4538	936	413	85
Drenoc	1046	154	1137	235	1251	258	114	23
Dubovik	1060	156	1153	238	1268	261	115	24
Dubravë	278	41	302	62	333	69	30	6
Gllogjan	984	145	1070	221	1177	243	107	22
Gramaqel	1097	161	1193	246	1312	271	119	25
Hulaj	158	23	172	35	189	39	17	4
Isniq	3871	569	1891	390	2080	429	189	39
Irzniq	1739	256	4209	868	4631	955	421	87
Kodrali	808	119	879	181	967	199	88	18
Lëbushë	1145	168	1245	257	1370	282	125	26
Lumbardh	717	105	780	161	858	177	78	16
Lloqan	499	73	543	112	597	123	54	11
Llukë e Epërme	1451	213	1578	325	1736	358	158	33
Llukë e Ulët	506	74	550	113	605	125	55	11
Maznik	447	66	486	100	535	110	49	10
Papiq	174	26	189	39	208	43	19	4
Pobergjë	1314	193	1429	295	1572	324	143	30
Pozhar	424	62	461	95	507	105	46	10
Prapaqan	740	109	805	166	885	183	81	17
Prokolluk	288	42	311	64	343	71	31	6
Prilep	2165	318	2354	485	2590	534	236	49
Rastavicë	1238	182	1346	278	1481	305	135	28
Ratish i Epërm	210	31	228	47	251	52	23	5
Ratish i Ulët	560	82	609	126	670	138	61	13
Sllup	338	50	368	76	404	83	37	8
Strellc i Epërm	3347	492	3640	750	4004	826	364	75
Strellc i Ulët	2114	311	2299	474	2529	521	230	47
Shaptej	591	87	643	133	707	146	64	13
Voksh	570	84	620	128	682	141	62	13
Vranoc i Vogël	101	15	121	25	133	27	12	2
Gjithsejtë	40019	5918	43516.3	8972	47874	9871	4357	898

Tabela 119. Numri ekonomive familjare, banorëve për vitin 2011, 2023 dhe 2031

Komuna e Deçanit si shumë Komunat tjera në Kosovë përballet me sfida të papunësisë. Përparësi e kësaj Komune është se 66.4% e popullsisë është aktive gjegjësisht e moshës 15 – 64 vjeç. Bazuar në të dhënat në nivel nacional dhe krahasimi i përqindjes me nivelin Komunal, rezulton se në Komunën e Deçanit, ka 4171 të papunë nga mosha 15 - 64, sipas vlerësimit te popullsisë të vitit 2021. Nëse bëhet krahasimi i numrit të papunëve me numrin e ekonomive familjare, atëherë rezulton se çdo e dyta ekonomik familjare e ka minimumi nga një të pa punësuar.

Numri ma i lartë i punëkërkuesve në Komunën e Deçanit ka qenë 1986 i regjistruar ne vitin 2018, ndërsa gjatë vitit 2020 deri 2023 numri i punë kërkuesve është 725 nga të cilët 365 aktiv dhe 360 jo aktiv.

Duke u bazuar në statistikat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2019, në Komunën e Deçanit, janë gjithsej 311 (ose 1213 persona), në vitin 2020 gjithsejtë 316 (ose 1264 persona), në vitin 2021 gjithsejtë 325 (ose 1300 persona) ndërsa në vitin 2022 gjithsejtë 316 (ose 1232 persona) ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale. Këto, shifra paraqesin rreth 3% deri 4% të gjithë popullsisë së vlerësuar në Deçan në vitet 2019 - 2021. Në të njëjtën kohë, bazuar në Statistikat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përfitues nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës janë 633 familje në vitin 2020, 628 familje në vitin 2021, 619 familje në vitin 2022.

Migrimi është një fenomen i cili ndikon mjaft në sektorin ekonomik ku kërkesa për fuqi punëtore ka filluar të ndjehet. Komuna e Deçanit është duke u përballur me lëvizjen e popullsisë nga zona rurale drejt asaj urbane, nga Komuna në Komunë ose migrim kombëtarë i cili është 0.08% në bazë vjetore, dhe nga Komuna drejt shteteve te ndryshme ose migrim ndërkombëtarë e që është 0.27% në bazë vjetore. Në përgjithësi migrimi në Komunën e Deçanit është në nivelin e 0.35% në bazë vjetore.

Komuna e Deçanit karakterizohet për një numër të madh të mërgimtarëve në vendet e BE-së të cilët jetojnë dhe veprojnë që nga vitet e ’70-ta të shekullit të kaluar, por edhe nga periudha e pas luftës. Remitancat e pranuara nga mërgimtarët janë në nivelin e kënaqshëm dhe kanë ndikim pozitiv në shumë ekonomi familjare. Në anën tjetër, Komuna e Deçanit ka numër të lindjeve mjaft të lartë në krahasim me numrin e vdekjeve.

3.3.2 Sektorët ekonomik – NVM

Ne Komunën e Deçanit janë gjithsejtë 2254 ndërmarrje prej te cilave me se shumti dominojnë ndërmarrjet individuale, pastaj shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, ortakëri dhe shoqëri aksionare. Shqetësuese është fakti se ne Komunën e Deçanit deri me tani është e regjistruar vetëm një kompani e huaj. Ky është një tregues së Komuna e Deçanit duhet të hartoj politika te qëndrueshëm për tërheqjen e investitorëve të huaj ku deri me tani, Komuna e Deçanit kontribuon me 211 milion € ne Bruto Prodhimin Vendor – BPV.

Deri në përfundimin e vitit 2022 në Komunën e Deçanit janë regjistruar 106 ndërmarrje te reja, ndërsa janë shuar 31 të tilla me një diferencë prej 75 ndërmarrjeve të reja. Në përgjithësi trendi i regjistrimit të ndërmarrjeve te reja na viti 2019 e deri në vitin 2023 ka pas vetëm rritje.

Hapja e ndërmarrjeve te reja sipas viteve është:

- Në vitin 2019 janë hap 98 dhe janë shuar 37 ndërmarrje dhe diferenca është +61 ndërmarrje te reja.
- Ne vitin 2020 janë hap 99 dhe janë shuar 19 ndërmarrje dhe diferenca është +80 ndërmarrje te reja.
- Në vitin 2021 janë hap 82 dhe janë shuar 19 ndërmarrje dhe diferenca është +63 ndërmarrje të reja.

- Në vitin 2022 janë hap 106 dhe janë shuar 31 ndërmarrje dhe diferenca është +75 ndërmarrje të reja.

Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara më se shumti ndërmarrje të regjistruara në 4 vitet e fundit janë:

Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave, 22.

- Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim, 12.
- Ndërtimtari, 17.
- Bujqësi, pylltari dhe peshkatari 10, etj.

Vendbanimi me se shumti ndërmarrje është Deçani me 458 të tilla, pastaj Carrabregu i Ulët, Carrabreg i Epërm, Prilep etj.

Më se shumti të punësuar në ndërmarrjet e regjistruara në vitin 2022 janë:

- Ndërtimtari, 700 të punësuar.
- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, 698 të punësuar.
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, 413 të punësuar.
- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit 284 të punësuar. etj.

Më se shumti ndërmarrje të shuara gjatë vitit 2022 është:

- Ndërtimtaria, 4 të shuara.
- Prodhim, 3 të shuara.
- Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim 3 të shuara.
- Aktivitete të shërbimeve tjera 3 të shuara.

Ne Komunën e Deçanit nuk ka zonë të caktuar dedikuar industrisë, të gjitha ndërmarrjet e mëhershme në shekullin e kaluar janë privatizuar dhe jo të gjitha janë funksionale pas privatizimit. Zona te biznesit nuk ekzistojnë dhe as zona te ekonomisë së lirë.

Korridori i vetëm ekonomik i cili është funksional dhe i qëndrueshëm është rruga R107 përgjatë të cili zhvillohen të gjitha veprimtaritë dhe në të ardhmen planifikohet që ai korridor të zgjerohet në drejtim jugor dhe verior duke mos e cenuar tokën bujqësore dhe në harmoni me Ligji Nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/11 për rrugë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-120.

Analiza SWOT – ekonomia dhe NVM	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Popullsia e arsimuar dhe në moshë pune (fuqia punëtore), - Vend i mirë gjeografik i kufizuar me katër komuna dhe dy shtete, - Infrastrukturë e mirë e brendshme rrugore, - Prodhimet bujqësore (kryesisht ndërmarrjeve familjare), - Bjeshkët e Nemuna si pasuri natyrore me potencial te zhvillimit ekonomik ne sektorin e turizmit, - Resurset natyrore dhe shumëllojshmëria e produkteve, - Prania e madhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, - Prezenca e disa ndërmarrjeve të mëdha,	- Shkalla e lartë e papunësisë, - Emigrimi i popullsisë e artë për punë, veçanërisht të kualifikuar, - Numri i pamjaftueshëm i stafit komunal për të zhvilluar politika të qarta afatmesme dhe afatgjata për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, - Prania e grave në menaxhimin e ndërmarrjeve minimale, - Niveli i ulët i punësimit për njerëzit me nevoja të veçanta, - Konkurrencë e paligjshme dhe mbizotërim i informalitetit. - Sektori i ndërtimit sjell të ardhura në buxhetin komunal vetëm në një periudhë të caktuar (nuk është i qëndrueshëm),

- Mbështetje e jashtme financiare, - Prania e tregjeve të hapura. -	- Mungesa e hartës së cilësisë së tokës për mundësitë e zhvillimit bujqësor, - Mungesa e fondit komunal të pronës për promovimin e ofertave PPP-së me synim te zhvillimit ekonomik, - Mungesa e dyqaneve artizanale, - Pengesat e krijuara nga Zona e Veçantë e Mbrojtur, - Mos harmonizimi i ligjeve që kanë lidhshmëri mes veti.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Aplikimi në fonde të ndryshme zhvillimore, - Mundësi të mira për zhvillimin e turizmit, - Mbështetja e nivelit qendror për ndërmarrjet e vogla dhe prodhimet vendore, - Krijimi i një shoqate lokale të ndërmarrjeve dhe bashkëpunimi me nivelin qendror, - Inkurajimi i kultivuesve lokalë me grante të nivelit qendror për prodhimet bujqësore (kryesisht në serra), - Stimulimi dhe mbështetja e zhvillimit të bletarisë. - Thjeshtimi procedurave dhe largimi i burokracisë për ndërmarrjet e vogla e të mesme për zhvillimin e ndërmarrjeve apo Start-up, - Mundësi e ndërtimit të partneritete me programe ndërkombëtare për të rritur kapacitetin njerëzor (nëpërmjet trajnimit brenda dhe jashtë vendit) për të zhvilluar ndërmarrjeve të vogla dhe në përputhje me standardet e BE-së për vendosjen e produkteve të ndryshme vendore, - Trajnimet e ndryshme për banorët duke u bazuar në potencialet që ajo i ofron.	- Rritja e numrit të papunëve, - Emigrimi i stafit të kualifikuar dhe profesional, - Furnizim i paqëndrueshëm me energji elektrike, - Pamundësia e zhvillimit të zonave ekonomike, industriale, agro-industriale, PPP për shkak të mungesës së fondit të pronës komunale, - Kreditë e bankave të papërshtatshme për ndërmarrjet, - Reduktimi i mbështetjes së jashtme financiare, - Mbyllja e programeve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare, - Konkurrencë nga komunat fqinje, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, - Mungesa e prodhimit vendor – ulja e prodhimeve ekzistuese, - Mbrojtjen dhe stimulimin e ndërmarrjeve dhe prodhuesve lokalë nga niveli qendror, - Administrimi i pronës së patundshme të disa ndërmarrjeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, - Klimë e pafavorshme për investime të sigurta, - Zhvillimi ekonomik në nivel vendi është i pakënaqshëm,

Tabela 120. SWOT analiza për ekonomi dhe NVM

3.3.3 Bujqësia

Sektori i bujqësisë është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të Komunës në të ardhmen. 65% e popullsisë ne Komunën e Deçanit gjenerojnë të ardhura nga sektori i bujqësisë. Në Komunën e Deçanit 74.19% e popullsisë jetojnë në zonën rurale ndërsa pjesa tjetër në urbane dhe viset malore. Në Komunën e Deçanit janë 10 ndërmarrje bujqësore të cilat janë të gjitha private dhe 361 ferma familjare. Pronësia e tokës bujqësore është private me sipërfaqe prej 13247 ha dhe vetëm 200 ha sipërfaqe janë pronë shoqërore. Toka bujqësore e kultivuar është 55%, toka bujqësore e pa kultivuar është 6% ndërsa livadhe dhe kullosa janë 39%. Pyjet ne Komunën e Deçanit e zënë një sipërfaqe te madhe të territorit Komunal ku 15281 ha sipërfaqe me pyje nga te cilat 37% janë private ndërsa 63% janë shoqërore.

Tokat pyjore për shfrytëzim komercial kanë pas rritje nga viti 2011 kur kanë qenë 582 ha, ndërsa ne vitin 2023 kjo sipërfaqe është rrit në 5711 ha, pra kemi një rritje prej 98%. Toka pyjore te mbrojtura kanë sipërfaqe prej 16765 ha dhe janë caktuar pas shpalljes së Parkut Kombëtar.

Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë dhe prodhimin e rendimenteve të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkatari.

	Prodhimi (t / ha)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2023	2011 - 2023
Gruri	3.76	3.35	3.85	3.75	-10.9	11.94	-2.597	-0.265
Misri	3.4	2.77	3.78	3.95	-18.53	42.6	4.497	16.176
Thekra	2.4	2.4	2.92	3.8	0	58.33	30.136	58.333
Tërshëra	2.46	2.14	2.89	0	-13.01	-100	-100	-100
Elbi	3.09	3.18	3.24	0	2.91	-100	-100	-100
Speci	32.18	16.09	19.79	41.08	-50	22.996	107.58	27.657
Domate	63.4	20.28	18.2	32.1	-68.012	-10.256	76.374	-49.369
Qepë	12.68	9.76	14.44	18.84	-23.028	47.951	30.471	48.58
Lakër	27.49	16.59	25.76	30.03	-39.65	55.274	16.576	9.24
Shalqini	22.56	20.16	21.33	28.36	-10.638	5.804	32.958	25.709
Jonxhe	9.86	3.51	3.93	4.29	-64.402	11.966	9.16	-56.491
Tërfili	3.1	2.94	3.92	3.59	-5.161	33.333	-8.418	15.806
Përzierje	3.39	2.44	2.95	3.35	-28.024	20.902	13.559	-1.18
Misër	15.01	11.15	19.11	18.3	-25.716	71.39	-4.239	21.919
Arre	2.78	2.31	2.65	3.53	-16.906	14.719	33.208	26.978
Mollë	7.55	4.71	8.29	15.01	-37.616	76.01	81.06	98.81
Dardhë	7.09	4.79	7.59	7.31	-32.44	58.46	-3.69	3.1
Kumbullë	6.54	12.47	13.26	5.84	90.673	6.34	-55.96	-10.7
Dredhëze	6	5.29	3.14	5.62	-11.833	-40.64	78.98	-6.33
Arre	4.94	4.1	5.3	5.6	-17.004	29.27	5.66	13.36

Tabela 121. Trendët e prodhimeve bimore nga 2011 deri 2023

Duke u bazuar në të dhënat nga viti 2011 deri në vitin 2023, janë hartuar projeksionet e prodhimtarisë bujqësore deri në vitin 2031. Parashikimi i prodhimeve në bujqësi përfshin vlerësimin e faktorëve të ndryshëm që mund të ndikojnë në prodhimet e të korrave, çmimet e tregut dhe përfitimin e përgjithshëm. Ndërsa parashikimi i prodhimeve me siguri të plotë është sfidues për shkak të pasigurive të natyrshme në bujqësi (siç janë kushtet e motit), disa elementë kryesorë janë marr parasysh në bërjen e parashikimeve siç janë:

- Analiza e motit dhe klimës
- Zgjedhja dhe rotacioni i të korrave
- Përparimet teknologjike
- Analiza e tregut
- Shpenzimet
- Politikat e Qeverisë
- Dinamika e zinxhirit të furnizimit
- Strategjitë e menaxhimit të rrezikut
- Rruajtja e kualiteti te tokës nga fatkeqësitë natyrore siç erozioni, përmbytjet, erërat e forta, djegiet etj.

Është e rëndësishme të theksohet se parashikimi i prodhimeve në bujqësi përfshin një kombinim të faktorëve shkencorë, ekonomikë dhe mjedisorë. Në rastin tonë është bërë një kombinim të dhënave në të kaluarën. Megjithatë për shkak të pasigurive të natyrshme në bujqësi prodhimtaria ne bujqësi i nënshtrohet fleksibilitetit.

	Prodhimi (t / ha)								
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Gruri	3.75	3.81	3.86	3.92	3.98	4.00	4.00	3.96	3.92
Misri	3.95	4.01	4.07	4.13	4.19	4.21	4.22	4.18	4.13
Thekra	3.8	3.86	3.91	3.97	4.03	4.05	4.06	4.02	3.97
Tërshëra	0.00	0.00	0.00	2.46	2.14	2.89	2.89	2.86	2.46
Elbi	0.00	0.00	0.00	3.09	3.18	3.24	3.24	3.21	3.09

Speci	41.08	41.70	42.32	42.96	43.60	43.82	43.86	43.42	42.96
Domate	32.1	32.58	33.07	33.57	34.07	34.24	34.27	33.93	33.57
Qepë	18.84	19.12	19.41	19.70	20.00	20.10	20.12	19.92	19.70
Lakër	30.03	30.48	30.94	31.40	31.87	32.03	32.06	31.74	31.40
Shalqini	28.36	28.79	29.22	29.66	30.10	30.25	30.28	29.98	29.66
Jonxhe	4.29	4.35	4.42	4.49	4.55	4.58	4.58	4.53	4.49
Terfili	3.59	3.64	3.70	3.75	3.81	3.83	3.83	3.79	3.75
Përzierje	3.35	3.40	3.45	3.50	3.56	3.57	3.58	3.54	3.50
Misër	18.3	18.57	18.85	19.14	19.42	19.52	19.54	19.34	19.14
Arre	3.53	3.58	3.64	3.69	3.75	3.77	3.77	3.73	3.69
Mollë	15.01	15.24	15.46	15.70	15.93	16.01	16.03	15.87	15.70
Dardhë	7.31	7.42	7.53	7.64	7.76	7.80	7.81	7.73	7.64
Kumbullë	5.84	5.93	6.02	6.11	6.20	6.23	6.24	6.17	6.11
Dredhëze	5.62	5.70	5.79	5.88	5.96	5.99	6.00	5.94	5.88
Arre	5.6	5.68	5.77	5.86	5.94	5.97	5.98	5.92	5.86

Tabela 122. Projeksionet e prodhimeve bimore deri 2031

Rritja e përqindjes së prodhimit ne krahasim me vitin paraprak

Prodhimi (t / ha) projeksionet deri në vitin 2031									
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Gruri	3.75	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Misri	3.95	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Thekra	3.8	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Tërshëra	0	0.00	0.00	0.00	1.15	0.74	1.00	1.01	1.16
Elbi	0	0.00	0.00	0.00	0.97	0.98	1.00	1.01	1.04
Speci	41.08	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Domate	32.1	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Qepë	18.84	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Lakër	30.03	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Shalqini	28.36	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Jonxhe	4.29	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Terfili	3.59	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Përzierje	3.35	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Misër	18.3	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Arre	3.53	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Mollë	15.01	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Dardhë	7.31	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Kumbullë	5.84	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Dredhëze	5.62	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01
Arre	5.6	0.99	0.99	0.99	0.99	1.00	1.00	1.01	1.01

Tabela 123. Projeksionet e prodhimeve bimore deri 2031 në përqindje


3.3.4 Vlerësimi i tokës bujqësore

Komuna e Deçanit, posedon një fond të kënaqshëm të tokës bujqësore ku sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është: 11,836.8 ha. Sipas Ministrisë se Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, njësitë e tokës bujqësore të parcelave në Komunën e Deçanit, ndahet në 11 nivele të vlerës si në tabelën e me poshtme.

Nivelet e vlerave (€ / m2)					
Deçan tokë bujqësore					
Numri i zonës së vlerësimit	Kategoria e vlerësimit				
	Fushë (€)	Kullosë (€)	Livadh (€)	Pemishte (€)	Vreshta (€)
101	5.00	3.40	4.00	5.00	5.00
102	4.00	2.80	3.20	4.00	4.00
103	3.60	2.50	2.80	3.60	3.60

104	3.80	2.60	3.00	3.80	3.80
105	3.40	2.30	2.70	3.40	3.40
106	3.00	2.10	2.40	3.00	3.00
107	2.50	1.70	2.00	2.50	2.50
108	2.50	1.70	2.00	2.50	2.50
109	2.00	1.40	1.60	2.00	2.00
110	1.50	1.00	1.20	1.50	1.50
111	4.00	2.80	3.20	4.00	4.00

Tabela 124. Nivelet e vlerave te tokës bujqësore ne € / m2 në Komunën e Deçanit



Harta 31. Zonat e vlerave të tokës në Komunën e Deçanit

3.3.5 Blegtoria

Vlerësimi i zhvillimit të blegtorisë në të ardhmen përfshinë marrjen në konsideratë të një sërë faktorësh që ndikojnë në industrinë e blegtorisë. Janë marr disa aspekte kryesore parasysh kur është bërë vlerësimi projeksioneve ne të ardhmen në blegtorisë:

- Tendencat e tregut.
- Përparimet teknologjike.
- Praktikat e mira të blegtorisë së qëndrueshme.
- Përmirësimi gjenetik dhe programet e mbarështimit.
- Donacionet dhe grantet ne sferën e blegtorisë.
- Menaxhimi i sëmundjeve.
- Biosiguria.
- Rregullatorët ne përdorimin e barërave të ndryshme për shëndetin e kafshëve.
- Tregtia dhe zingjiri i furnizimit.
- Preferencat e konsumatorit.
- Ndryshimet klimatike.
- Mbrojtja e mjedisit.
- Faktorët ekonomikë, zhvillimi i tregjeve vendore dhe teknologjia.

	Koncentrimi (nr.)				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2011	2012	2013	2023	2011 - 2012	2012 - 2013	2013 - 2023	2011 - 2023
Lopë	3400	3320	3300	2397	-2.35	64.02	-27.36	-29.5
Mëshqerre	600	890	870	882	48.33	-73.8	1.38	33.33
Dele mbarështimi	3099	3002	2897	2397	-3.13	-3.5	-17.26	-22.65
Qengj	4022	4017	3682	790	-0.12	-8.34	-78.54	-80.36
Cap	32	31	56	53	-3.125	80.65	-5.36	65.63
Dhi	184	218	216	172	18.48	-0.92	-20.37	-6.52
Derra	24	31	36	21	29.17	16.13	-41.67	-12.5
Dose	6	9	6	9	50	-33.3	50	50
Gjela	1032	917	913	1104	-11.14	-0.44	20.92	6.98
Pula	10124	9623	9574	10321	-4.95	-0.51	7.8	1.95

Tabela 125. Trendët e bagëtisë nga viti 2011 – 2023

Projeksionet e bagëtisë nga viti 2023 deri 2031									
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Lopë	2397	2469	2543	2619	2698	2779	2862	2948	3036
Mëshqerre	882	908	936	964	993	1022	1053	1085	1117
Dele mbarështimi	2397	2469	2543	2619	2698	2779	2862	2948	3036
Qengj	790	814	838	863	889	916	943	972	1001
Cap	53	55	56	58	60	63	65	67	69
Dhi	172	177	182	188	194	205	211	218	224
Derra	21	22	22	23	24	24	25	26	27
Dose	9	9	10	10	10	11	11	11	12
Gjela	1104	1137	1171	1206	1243	1280	1318	1358	1399
Pula	10321	10631	10950	11278	11616	11965	12324	12694	13074

Tabela 126. Projeksionet e bagëtisë në Komunën e Deçanit nga viti 2023 deri 2031

Projeksionet e bagëtisë nga viti 2023 deri 2031 në përqindje									
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Lopë	2397	3	3	3	3	3	3	4	4
Mëshqerre	882	3	3	3	3	3	3	4	4
Dele mbarështimi	2397	3	3	3	3	3	3	4	4
Qengj	790	3	3	3	3	3	3	4	4
Cap	53	3	3	3	3	3	3	4	4
Dhi	172	3	3	3	3	3	3	4	4
Derra	21	3	3	3	3	3	3	4	4
Dose	9	3	3	3	3	3	3	4	4
Gjela	1104	3	3	3	3	3	3	4	4
Pula	10321	3	3	3	3	3	3	4	4

Tabela 127. Projeksionet e bagëtisë nga viti 2023 deri 2031 në përqindje

Projeksionet e rritjes se gjedhit, deleve nga viti 2023 deri 2031 dhe e përqindje									
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Gjedhi	696	717	738	761	783	830	855	881	907
Dele	19	20	20	21	21	24	24	25	26
Gjedhi	696	3%	3%	3%	3%	6%	3%	3%	3%
Dele	19	3%	3%	3%	3%	10%	3%	3%	3%

Tabela 128. Projeksionet e rritjes se gjedhit dhe deleve

Analiza SWOT – bujqësia, blegtoria dhe pylltaria	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- ½ e territorit komunal është tokë bujqësore, - Kualiteti i mirë i tokës bujqësore, - Toka bujqësore nuk është e ndërtuar shumë, - Zhvillimi i bujqësisë kryesisht për nevoja familjare	- Mungesa e hartës së cilësisë së tokës për mundësitë e zhvillimit bujqësor, - Personeli i pamjaftueshëm i komunës për të zhvilluar politika të qarta afatmesme dhe afatgjata

mirëpo edhe për shitje, - Njerëz që janë të aftë të punojnë, - Infrastruktura e transportit me qasje të lehtë në zonat rurale. - Rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe prodhimit vjetor të tyre; - Kapacitetet e prodhimit bujqësore dhe blegtorale në rritje; - Sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore nën sistemin e ujitjes; - Organizimi i fermerëve në shoqata dhe grupe me interesa të përbashkëta në fushën e agro-biznesit - Sipërfaqe e mjaftueshme për grumbullimin e bimëve mjekuese në Bjeshkët e Deçanit. - Përkrahja e fermerëve më subvencione të ndryshme, mekanizëm pune dhe lopë të racës - Sipërfaqe e madhe me pyje dhe dru kualitativ.	për zhvillimin e bujqësisë, - Mungesa e interesit nga banorët për zhvillimin e sektorit bujqësor, - Mungesa e fondit të pronës komunale për zhvillimin bujqësor, - Sipërfaqe e madhe malore respektivisht ½ e territorit komunal janë vargmale, - Fragmentimi i tokave bujqësore; - Ndotja e kanaleve të ujitjes, - Mungesa e qasjes në tregje, - Mos funksionimi i pikave grumbulluese për prodhimet bujqësore - Kontaminimi i tokave bujqësore nga ujërat e zeza të pa kontrolluar. - Prerja e pyjeve në mënyrë të pakontrolluar.
MUNDSITË	RREZIQET
- Zhvillimi i fermave vertikale, - Zhvillimi i fermave të vogla urbane organike, - Aplikimi i teknologjive te reja ne bujqësi, - Inkurajimin e kultivuesve vendas nëpërmjet granteve të nivelit lokal dhe qendror për prodhimet bujqësore (kryesisht në serra), - Stimulimi dhe mbështetja e zhvillimit të bletarisë dhe blegtorisë, - Bashkëpunim ndër-komunal për vendosjen e produkteve në tregun e tyre, - Hapja e tregjeve te reja, - Konsolidimi i tokës bujqësore, - Prerje e kontrolluar (heqja e pemëve të dëmtuara dhe ripyllëzimi me pemë të tjera), - Zhvillimi i programeve për plasimin e produkteve te ndryshme bujqësore ne shtetet e ndryshme, - Grumbullimi i frutave të malit dhe përpunimi i tyre (gështenja, boronica dhe çaji e ndryshëm), - Mundësi e rritjes së sipërfaqeve të pyllëzuar.	- Humbja e fuqisë punëtore (duke shkuar në vende të tjera), kryesisht burrat për shkak të zhvillimit të ngadalshëm ekonomik në nivel kombëtar, - Paaftësia për të zhvilluar zona ekonomike, industriale, agro-industriale për shkak të mungesës së fondit të pronës komunale, - Ndotja e tokës bujqësore dhe burimeve ujore nga faktori natyror dhe faktori njeri, - Shndrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, - Kredi të papërshtatshme dhe të paqëndrueshme nga bankat, - Mbrojtjen dhe stimulimin e ndërmarrjeve dhe prodhuesve lokalë nga niveli qendror, - Konkurrencë nga vendet e zhvilluara me traditë në bujqësi (import), - Mundësi të vogla për të vendosur produktin në treg, - Dëmtimi i pyjeve nga faktorët njerëzorë dhe natyrorë (prerja e pakontrolluar mund të shpyllëzon sipërfaqe të mëdha të tokës në 10 vitet e ardhshme), - Dëmtimi i gështenjës dhe frutave të malit nga sëmundjet e ndryshme dhe faktori njeri. - Mungesa e mbështetjes në nivelin qendror për bizneset e reja “START-UP” në fushën e bujqësisë, - Katastrofat natyrore si erërat e forta, stuhitë, breshri dhe vërshimet i cenojnë rendimentet bujqësore.

Tabela 129. SWOT analiza për bujqësi, blegtori dhe pylltari

3.3.6 Turizmi

Në Komunën e Deçanit zhvillohen tre lloje të turizmit:

- Turizmin transit, pra si pikë kalimi për në vendet tjera në Kosovë apo nga Kosova në shtetet fqinje,
- Turizëm vikendi duke ofruar oferta për qëndrim gjatë vikendit.
- Turizëm qëndrimi i cili përfshinë pika qëndrimi turistik shumë ditorë si ne zonat urbane dhe rurale.

Sipas aktiviteteve të ndryshme turistike, deri me tani ne Komunën e Deçanit funksionon turizmi malor, turizmi rekreativ dhe sportiv, speleoturizmi, turizmi rural dhe kulturor, turizmi edukativ

dhe arsimor, turizmi kurativ (shëndetësor) dhe turizmi ndërkufitar - shtigjet. Për ofrimin e informacioneve dhe orientimin e turistëve, Komuna e ka hap Qendrën Turistike Informuese.

Ekzistojnë 3 zona turistike (2 private dhe 1 publike shoqërore) të shtrira në sipërfaqe prej 28840.18 ha dhe ne total me kapacitet prej 6503 akomodimeve. Turizmi edhe pse nuk është i zhvilluar ne nivelin e duhur, ai sadopak, ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës. Për projeksionet e zhvillimit te turizmit ne parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", çdo veprim do të jetë në *harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".* Andaj, numri i akomodimeve ne zonën urbane dhe rurale në 8 vitet e ardhshme është i mjaftueshëm për zhvillimin e turizmit ne Komunën e Deçanit.

Analiza SWOT - Turizmi	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Qendra për Informim Turistik, - Sheshi i Qytetit (i mbyllur për automjetet), - Ndërtesa me vlera trashëguese, kulturore, shpirtërore, natyrore dhe arkitektonike, - Shtigjet e ecjes dhe çiklizmit malor, - Gastronomi tradicionale lokale, - Ekzistenca e ndërtesave të hotelerisë për akomodim, jo të mjaftueshme. - Lumenjtë: Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumëbardhi i Lloqanit ,Burimeve natyrore, ujore dhe minerale, - Festivalet dhe manifestimet tjera tradicionale. - Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", - Zhvillimi i turizmit pranveror, veror, vjeshtor dhe atij dimëror. - Pozita e mire gjeografike ne relacion me dy qytetet e mëdha turistike Peje -Gjakove	- Personeli i pamjaftueshëm i komunës për të zhvilluar politika të qarta afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e turizmit, - Mungesa e strategjisë lokale të zhvillimit të turizmit, - Akomodimi është i pamjaftueshëm me kapacitetet që i ofron Komuna e Deçanit dhe është e nevojshme të rritet standardi i shërbimit, - Mungesa e një baze të dhënash për të gjitha apartamentet ose shtëpitë e ofruara për akomodim (qira ose hostel), - Mungesa e infrastrukturës: elektrikë ujësjellës, kanalizim, rrugë dhe telekomunikacioni - Mungesa e planeve në hapësirat zhvillimore në zonën e dytë dhe të tretë të P. K. " Bjeshkë e Nemuna" - Ndërtimet e pakontrolluara ne zonat ma atraktive dhe tërheqëse.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Zhvillimi i qendrës së qytetit të Deçanit, - Nxitja e lëvizjes aktive nëpërmjet krijimit të hapësirave publike, - Regjistrimi i shoqatave të hoteleve dhe gastronomisë dhe bashkëpunimi me institucionet lokale për koordinimin e veprimeve, - Bashkëpunim në nivel rajonal në ofrimin e ofertave turistike, - Zhvillimi i qendrave turistike: Hoteleve, qendrave të shijimit, guidat turistike, shtigje për ecje, fshatrat turistike dhe kampingje, në zonat zhvillimore në P. K. " Bjeshkë e Nemuna", (bazuar në Planin e Parkut Kombëtar " Bjeshkë e Nemuna"). - Udhëtim turistik të organizuara në zonat me vlera natyrore, kulturore dhe trashëgimore, - Bashkëpunim me OJQ-të lokale për zhvillimin, promovimin dhe ngritjen e kapaciteteve në fushën e turizmit. - Mbështetje nëpërmjet programeve bashkë financuese për zhvillimin e lagjeve me tema tradicionale (etno lagje) duke u bazuar ne potencialin e ndërtesave me vlera trashëgimore, - Mbështetja e festivaleve të reja me qëllim që të promovoni qytetin, kulturën, traditën dhe argëtimin. - Promovimi i imazhit të ri dhe ofertës turistike të Deçanit,	- Buxheti i vogël i Komunës. - Numri i pamjaftueshëm i kapaciteteve të akomodimit në hotel dhe kategorizimi i tyre, - Fatkeqësitë natyrore, - Mungesa e mbështetjes nga niveli qendror për zhvillimin e turizmit. - Pengesat ligjore.

- Promovimi i degës arsimore kushtuar turizmit dhe shërbimeve (shkolla e mesme), - Mbështetje për hapjen e qendrave për gjuhë të huaja (anglisht, gjermanishtt, frëngjisht etj). - Zhvillimi i partneritetit publiko privat.	

Tabela 130. SWOT analiza për turizmin

3.3.7 Mineralet

Llojllojshmëria e mineraleve është evidente ne Komunën e Deçanit. Shtrirja e tyre ne te gjithë territorin Komunal e bën këtë Komunë të pasur, dhe ofron mundësi për zhvillimin e sektorit të nxjerrës dhe të këtyre mineraleve.

Një pjesë e madhe e këtyre mineraleve ndodhen ne pjesën veri perëndimore, perëndimore te Komunës, aty ku shtrihet Parku Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe ne të cilën pjesë ndalohet çfarëdo lloj aktiviteti i nxjerrjes se mineraleve. Nuk është njohur sipërfaqja e saktë dhe sasia e mineraleve ne ketë zonë, me qenë se duhet paraprakisht të bëhen hulumtimet e nevojshme mirëpo, dihet se ne këtë zone ka mjaft shkëmbinj të fortë silikat, mermerëve, dolomitët etj.

Shkëmbinjtë e fortë silikat – ndodhen të shtrira në pjesën perëndimore, veriperëndimore, veriore, verilindore dhe lindore te Komunës Deçanit. Këta shkëmbinj të fort silikat kanë vlera të larta dhe mjaft të përshtatshëm për përdorimin e tyre ne fushën e ndërtimit si dhe për gurë dekorativ dhe dimensional. Për të identifikuar sasinë e tyre duhet te bëhen hulumtimet e detajuara dhe të merren parasysh ndikimet ne mjedis dhe përfitimet ekonomike. Në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" nuk do te lejohen te kryhet nxjerrja e mineraleve.

Shkëmbinjtë e fortë karbonatikë - janë hulumtuar dhe verifikuar rezerva të konsiderueshme të gëlqerorëve, të cilët përdoren si materiale gjeologjike në ndërtimtari dhe industri. Mermeri dhe gëlqerorët e mermerizuar gjenden kryesisht në sasie konsiderueshme në Komunën tonë. Ato përdoren si gurë dekorativë dhe janë në formë të mermerit brekçiozë në pjesën e Uzbilit në Grykën e Deçanit, i cili mund të përdoret si gurë dekorativë dhe dimensional.

Në Komunën e Deçanit janë të pranishme vetëm tri paraqitje të dolomitëve dhe analizat e pakta të hulumtuara kanë dhënë vlera të MgO (Oksidi i Magnezit) deri në 16%. Kështu, ata janë të klasifikuar si gëlqerorë dolomitikë. Dolomitët si të tilla gjenden në Grykën e Deçanit , Grykën e Lloqanit dhe Bjeshkët e Deçanit.

Vendburimet e travertinit janë të kufizuara në burimin e ujit mineral afër apo Gushavcit, i cili ka cilësi të mira kurative – shëndetësore.

Rëra dhe zhavorri në Komunën e Deçanit ka përbërje minerale dhe kokrrizore të përshtatshme, gjë që është e përshtatshme si lëndë e parë për prodhimin e betonit. Rezervat e rërës dhe zhavorrit në Komunën e Deçanit janë të koncentruar në shtretërit e lumenjve të Lumëbardhit të Deçanit dhe Lloqanit. Vlerësohet që resurse totale të rërës dhe zhavorrit janë rreth 3310 m3. Nxjerrja e këtij minerali rezulton i padobishëm dhe fitimprurës ndërsa ndikimet ne mjedis janë te larta. Nuk ka perspektivë ne këtë drejtim, mirëpo edhe në rastin e rërës dhe zhavorrit duhet te behën hulumtimet e sakta dhe te vlerësohet roli i tij.

Gjeo - data baza e Kosovës (GJDK) përmban të dhëna për mbi 116 lokacione të gurëve dimensional dhe dekorativë mirëpo mungojnë hulumtimet e sakta dhe të hollësishme teknike, petrografike dhe të dhënat tjera të rezervat e që duhet të bëhen bashkërendimet me nivelin qendror para se te zhvillohet ky sektor. Çdo veprim në pjesën perëndimore do të jetë në *harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*

3.3.8 Fushat e bashkëpunimit ndër komunal

Komuna e Deçanit ka lidhje te mira infrastrukturore me Komunat fqinje. Komuna e Pejës dhe Komuna e Gjakovës janë dy Komuna ku mjaft banorë të Komunës Deçanit gjejnë mundësi të berit biznes por edhe punësim. Raporti i te berit biznes me Komunat fqinjë nuk është shume ne favorin e Komunës se Deçanit me qene se mjaft ndërmarrje lokale kane pika biznesi ne këto Komuna. Raporti i te berit biznes me Komunën e Junikut nuk është i lart, përpos ne fushën e turizmit dhe te infrastrukturës rrugore. Raporti i turizmit me Komunën e Pejës është ma i madh ne krahasim me Komunën e Junikut mirëpo edhe konkurrenca është ma e fortë.

Aeroporti i Gjakovës shihet si një portë e fuqishme me ndikim ne Komunën e Deçanit ne te ardhmen, ndërsa zhvillimi i bujqësisë dhe bashkërendimi i prodhimeve bujqësore ne mes te Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut dhe Gjakovës, do e ndihmonin zhvillimin e sektorit të bujqësisë ne këtë rajon.

Bazuar ne dokumentet zhvillimore te Komunave fqinje, vërehen disa projeksione zhvillimore ne te ardhmen.

- Në Komunën e Pejës - prioritet i është dhënë rrugës së Dukagjinit e cila e lidhë Istogun me Prizrenin dhe dalje ne Shqipëri. Me zhvillimin e turizmit, Komuna e sheh daljen ne Malin e Zi nëpërmes Komunës Deçanit ku rol te madh luan zona EST dhe kompleksi “Borea”. Për ketë është e formuar Organizata për Menaxhim të Destinacionit. - Perëndim (OMD- Perëndim). Po ashtu, bashkëpunimi në sferën e shëndetësisë është i rëndësishëm dhe Komuna e Deçanit e shfrytëzon Kujdesin Dytësorë Shëndetësor. Gjithashtu ne sektorin ujor është i nevojshëm bashkërendimi i veprimeve ne mes të dy Komunave për mbrojtjen e lumenjve dhe zhvillimin e sektorit të peshkatarisë në të ardhmen
- Në Komunën e Gjakovës si prioritet shihet ndërtimit i rrugës rajonale që e lidh Rrafshin e Dukagjinit.
- Në Komunën e Junikut si prioritetet të bashkëpunimit me Komunën e Deçanit shihen ndërtimi i hekurudhës e cila e lidh Pejën me Deçanin, Junikun dhe Gjakovën ndërsa në sektorin e shëndetësisë shihet shfrytëzimi i QKMF-së se Deçanit për nevojat e banorëve të Junikut. Gjithashtu, bashkëpunimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rrugore shihet si prioritet i Komunës Junikut dhe me potenciale te zhvillimit ekonomik ne te ardhmen ne mes te Komunës Junikut, Deçanit dhe Gjakovës. Turizmi është një nga shtyllat kryesore të bashkëpunimit në mes të Komunës Junikut dhe Deçanit e me theks te veçantë pjesa e Belegut. Po ashtu, Komuna e Junikut e konsideron veten si portë hyrëse nga Shqipëria e cila do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e turizmit edhe në Deçan.

3.3.9 Zona ekonomike dhe industriale

Në Komunën e Deçanit nuk ekzistojnë parqet industriale, inkubator biznes, park teknologjik apo zonë e lirë. Në PZHK paraprake rendësi i është dhënë NVM si dhe zhvillimit të korridorit ekonomik gjegjësisht duke u bazuar ne gjendjen ekzistuese e që ka të bëjë me zhvillimin e bizneseve përgjatë rrugës kryesore (R-107). Duke i marr parasysh zhvillimet ne dekadën e fundit, interesimin e investimeve në biznese te reja si dhe në mbrojtjen e tokës bujqësore ky korridor është zgjeruar ne drejtimin verilindor ne drejtimin e Komunës Pejës dhe në drejtimin jugor drejt Komunës së Deçanit. Në kapitullin e konceptit të zhvillimit janë propozuar zonat potenciale të cilat do ti dedikohen prodhimit e cila është miqësore ndaj mjedisit.

3.4 Infrastruktura dhe shërbimet teknike

Në kapitullin e infrastrukturës dhe shërbimet teknike bëhet vlerësimi i gjendjes së ujësjellësit, kanalizimit fekal, kanalizimit atmosferik, energjisë elektrike, energjisë së ngrohjes, telekomunikacionit dhe menaxhimin e mbeturinave.

3.4.1 Ujësjellësi

Komuna e Deçanit furnizimin me ujë të pijshëm e kanë nga burimet nëntokësore me kapacitet të përgjithshëm 305.44 l/sek. Ekzistojnë gjithsejtë 7 pika të burimeve kryesore me (disa nën burime) të cilat e furnizojnë me ujë të pijshëm Komunën e Deçanit. Burimi Gryka e Deçanit e cila i ka 5 nën burime është me kapacitetin ma të madh të furnizimit me ujë të pijshëm gjegjësisht me 66.44 l/sek, ndërsa Burimi Gjipsi i Vokshit dhe Lugu i Zallit me 5 nën burime është me kapacitetit më të ulët të furnizimit me ujë të pijshëm gjegjësisht me 27 l/sek. Komuna e Deçanit, ciklin e furnizimit me ujë të pijshëm e ka arrit ne masën 90% vendbanimeve në përjashtim me vendbanimet Belle dhe Pleqe te cilat furnizohen nga burimet natyrore për shkak të konfiguracionit të vështirë malor për furnizim. Rrjeti shpërndarës është i ndarë në rrjetin primar dhe sekondar, të përberë nga gjithsejtë 13 tubacione, ku kemi 5 tubacione primare me gjatësi 68 km dhe 8 tubacione sekondare me gjatësi 111.6 km. Në përgjithësi ne Komunën e Deçanit janë gjithsejtë 179.6 km tubacione primare dhe sekondare ku vjetërsia e tubacioneve e rrjetit primarë është mesatarisht 27.5 vjet ndërsa vjetërsia e tubacioneve të rrjetit sekondarë është mesatarisht 29 vjet.

Burimet	Nëntokësorë (l / s)
Burimi, Bjeshka e Strellcit, 6 burime	40
Burimi, Gryka e Deçanit, 5 burime	66.44
Burimi, Gryka e Deçanit - Gypi i CDF - së 3 burime	42
Burimi, Bjeshka e Lloqanit, 3 burime	48
Burimi, Gjipsi i Vokshit dhe Lugu i zallit, 5 burime	27
Burimi,Hulaj,1 burime	37
Burimi, Isniqi, 2 burime	45

Tabela 131. Burimet

Kapacitete konverzuese sigurohen ne rezervuarët e vëllimeve të ndryshme nga e cila më e madhja është rezervuari i Dranocit me 760 m³ dhe me i vogli është rezervuari i Vokshit me 400 m³.

Rezervuarët	Kapacitetet konzervuese max. (m³)
Rezervuari i Cop - it	743
Rezervuari i NCA - së	508.68
Rezervuari i Isniqit	710
Rezervuari i Dranocit	760
Rezervuari i CDF - it	608
Rezervuari i Strellcit	628
Rezervuari i Hulaj	460
Rezervuari i Vokshit	400

Tabela 132. Rezervuarët

Numri i konsumatorëve në Komunën e Deçanit ishte 6472 i përberë nga amvisëria me 6011, klient komerciale 414 dhe klient institucional 47[74]. Ne vitin 2023 të dhënat tregojnë për shtimin e numrit të konsumatorëve gjegjësisht të lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit për 18 konsumatorë të ri ose 6946 konsumator nga të cilët 6490 janë amvisëri, 407 klient komercial dhe 49 klient publik[75].

Sipas K.R.U "Hidrodrini" Pejë – njësia shërbyese Deçan, gjatë një viti shpenzohen:

[74] K.R.U "Hidrodrini" Sh.A – Njësia operative Deçan.
[75] K.R.U."Hidrodrini" Sh.a – Njësia operative Deçan.

- 1110010 m³ për amvisëri ose me një mesatare prej 0.46 m³ në ditë;
- 85719 m³ për klient komercial ose me mesatare prej 4.79 m³ në ditë;
- 59827 m³ në vit për klient publik ose me mesatarisht prej 0.4 m³ në ditë.

Totali i konsumit të ujit të pijshëm ne Komunën e Deçanit është 1,255,556 m³.

Nr.	Mënyra e furnizimit							
	Vendbanimet	Sistemi	Menaxhimi	Burimi	Numri i banorëve	Numri i furnizimit	Furnizimi me %	Orët e furnizimit
1.	Deçan	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	3803	3803	100%	24 h
2.	Baballoq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1598	1598	100%	24 h
3.	Beleg	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	826	826	100%	24 h
4.	Belle	x	x	x	8	8	x	x
5.	Carrabreg i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	1446	1446	100%	24 h
6.	Carrabreg i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	2059	2059	100%	24 h
7.	Dashinoc	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	299	299	100%	24 h
8.	Drenoc	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4	1046	1046	100%	24 h
9.	Dubovik	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1060	1060	100%	24 h
10.	Dubravë	✓	Ujësjellësi	1.2.3	278	278	100%	24 h
11.	Gllogjan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	984	984	100%	24 h
12.	Gramaçel	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1097	1097	100%	24 h
13.	Hulaj	✓	Ujësjellësi	1.2.3	158	158	100%	24 h
14.	Irzniq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1739	1739	100%	24 h
15.	Isniq	✓	Ujësjellësi	1.2	3860	3860	100%	24 h
16.	Kodrali	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	808	808	100%	24 h
17.	Lëbushë	✓	Komunitet	1.2	1145	1145	100%	24 h
18.	Lumbardh	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	717	717	100%	24 h
19.	Lloqan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	499	499	100%	24 h
20.	Llukë e Epërme	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	1451	1451	100%	24 h
21.	Llukë e Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	506	506	100%	24 h
22.	Maznik	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	447	447	100%	24 h
23.	Papiq	✓	Ujësjellësi	1.2.3	174	174	100%	24 h
24.	Pobergjë	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4	1314	1314	100%	24 h
25.	Pozhar	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5.6.7	424	424	100%	24 h
26.	Prapaqan	✓	Ujësjellësi	1.2.3	740	740	100%	24 h
27.	Prokolluk	✓	Ujësjellësi	1.2.3	288	288	100%	24 h
28.	Prilep	✓	Ujësjellësi	1.2.3	2165	2165	100%	24 h
29.	Pleqe	x		x	11	11	x	x
30.	Rastavicë	✓	Ujësjellësi	1.2.3	1238	1238	100%	24 h
31.	Ratish i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3	210	210	100%	24 h
32.	Ratish i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3	560	560	100%	24 h
33.	Sllup	✓	Ujësjellësi	1.2.3	338	338	100%	24 h
34.	Strellc i Epërm	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	3347	3347	100%	24 h
35.	Strellc i Ulët	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	2114	2114	100%	24 h
36.	Shaptej	✓	Ujësjellësi	1.2.3	591	591	100%	24 h
37.	Voksh	✓	Ujësjellësi	1.2.3.4.5	570	570	100%	24 h
38.	Vranoc i Vogël	✓	Ujësjellësi	1.2.3	101	101	100%	24 h

Tabela 133. Mënyra e furnizimit të vendbanimeve me ujë

Sipas vlerësimit të rritjes te numrit të banorëve mirëpo edhe ekonomive familjare, projeksionet e furnizimit më ujë të pijshëm në Komunën e Deçanit për vitin 2031 do të jetë 1256970 m³ me një mesatare prej 176.6 m³ rritje në vit.

	Projeksioni i popullsisë	Projeksionet e rritjes së popullsisë	Amvisëri projeksionet m³	Klient komercial projeksionet m³	Klient publik projeksionet m³	Gjithsejtë m³	Ndryshimi m³
2023	43,516	0	1110010	85719	59827	1255556	0
2024	44,038	522	1110060	85849	59827	1255735	179

2025	44,567	529	1110110	85977	59827	1255914	178
2026	45,102	535	1110160	86104	59827	1256091	178
2027	45,643	541	110212	86230	59827	1256269	177
2028	46,191	548	1110264	86354	59827	1256445	176
2029	46,745	554	1110316	86477	59827	1256621	176
2030	47,306	561	1110369	86599	59827	1256796	175
2031	47,874	568	1110423	86719	59827	1256970	174

Tabela 134. Projeksionet e furnizimit me ujë deri ne vitin 2031

Sipas projeksioneve për 8 vitet e ardhshme të furnizimit me ujë të pijshëm për amvisëri, klient komercial dhe klient publik planifikohet se rritja e vëllimit me ujë të pijshëm është 1413 m^3 ma shumë se viti 2023. Sipas, kapaciteteve ekzistuese, kjo sasi e kërkesës për ujë të pijshëm është e përballueshme në përjashtim të periudhës së verës ku duhet të menaxhohet përdorimi i ujit të pijshëm, e cila është ne varësi me temperaturat e larta dhe reshjet atmosferike. Gjithashtu, rrjetet primare dhe sekondare e përballojnë ketë rritje të kërkesës ndërsa në raste e ndërtimeve të reja banuese, rrjeti sekondar do të shtohet në varësi të kushteve dhe kritereve të ndërtimit.

Vendbanimet	Projeksionet e furnizimit me ujë te pijshëm deri ne vitin 2031 m^3
Baballoq	45
Beleg	23
Belle	0
Carrabreg i Epërm	41
Carrabreg i Ulët	58
Dashinoc	9
Deçan	385
Drenoc	30
Dubovik	30
Dubravë	8
Gllogjan	28
Gramaqel	31
Hulaj	4
Isniq	49
Irzniq	110
Kodrali	23
Lëbushë	32
Lumbardh	20
Lloqan	14
Llukë e Epërme	41
Llukë e Ulët	14
Maznik	13
Papiq	5
Pobergjë	37
Pozhar	12
Prapaqan	21
Prokolluk	8
Prilep	61
Rastavicë	35
Ratish i Epërm	6
Ratish i Ulët	16
Sllup	10
Strellc i Epërm	95
Strellc i Ulët	60
Shaptej	17
Voksh	16
Vranoc i Vogël	3
Gjithsejtë	1413

Tabela 135. Projeksionet e furnizimit me ujë deri ne vitin 2031 sipas vendbanimeve

Vështirësitë në Komunën Deçanit në të ardhmen është reduktimi i papunësisë dhe parandalimi i migrimit kombëtarë dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, politika e nivelit qendror nuk ka qenë mjaft e orientuar ne uljen e papunësisë ne ketë rajon e me theks te veçantë në Komunën e Deçanit. Pozita gjeografike ne mes te Komunës Pejës dhe Gjakovës e sfidon mjaft shumë Komunën e Deçanit në tërheqjen e investitorëve të huaj. Gjithashtu, sfiduese është largimi i konkurrencës joformale dhe mbështetja sa ma shumë i NVM.

Rekomandohet që sa ma parë të fillohet me hartimin e projekteve konkrete për ofrimin e ndihmës te NVM dhe stimulimin e hapjes së ndërmarrjeve të reja dhe parandalimin e migrimit të fuqisë punëtore dhe intelektuale. Programet Start - UP do të janë mjaft efikase për Komunën për të tërhequr investitorë të rinj. Bashkërendimi i politikave dhe projekteve me nivelin qendror do te jetë më se i nevojshëm ndërsa përmirësimi i imazhit të Komunës se Deçanit në fushën e të berit biznes do të jetë promotor i rritjes së punësimit. Bashkëpunimi me sektorin privat është i nevojshëm ndërsa duhet të merren parasysh mbështetja maksimale e kultivuesve.

Përkundër faktit se Komuna e Deçanit i ka të mbuluara pothuajse të gjitha vendbanimet me ujë të pijshëm, është e nevojshme që në të ardhmen të mbulohen të gjitha shtëpitë me ujë matës, të bëhet rehabilitimi i rrjetit ekzistues, sistemet e rezervuarëve të mirëmbahen dhe rehabilitohen si dhe të rritet bashkëpunimi në mes të Komunës Deçanit dhe K.R.U "Hidrodrini" Sh.A Pejë – Njësia operative Deçan.

3.4.2 Kanalizimi fekal dhe kanalizimi i ujërave atmosferik

Rrejti i kanalizimit fekal ne Komunën e Deçanit e mbulon vetëm 45% të territorit komunal. Investimet ne ketë fushë janë të vazhdueshme mirëpo duhet edhe disa vite ne vazhdim që rrjeti i kanalizimit fekal të përfundon në tërësi. Gjatë procesit të hartimit të projekt Planit Zhvillimor Komunal, kompetencat e reja menaxheriale i kanë kaluar K.R.U "Hidrodrini" Sh.A Pejë - Njësia operative Deçan andaj azhurnimi i te dhënave të reja dhe digjitalizimi i tyre është ende në proces. Mirëpo, deri në përfundimin e këtij procesi, Komuna e Deçanit posedon të dhënat e saja të cilat tregojnë se ekzistojnë 8 gropa septike kolektive të cilat mbulojnë shtrirjen hapësinore të vendbanimeve me sistemin e rrjetit të kanalizimit dhe atë me sipërfaqe maksimale prej 78.9 ha në Deçan dhe sipërfaqe minimale prej 10 ha në Sllup ndërsa gjerësia e zonave mbrojtëse ndryshon nga 5 metra minimalja deri në 15 metra maksimalja.

Gropat septike kolektive	Sipërfaqja (ha)	Zona mbrojtëse - gjerësia (m)
Deçan	78.9	15
Carrabreg i Epërm	75.7	
Carrabreg i Ultë		
Lloqan - një pjesë	/	
Beleg	28.9	
Llukë e Epërme	35.3	
Llukë e Ultë	38.3	
Lumbardh		
Pobergjë	28.5	10
Hulaj	/	/
Gramaqel - një pjesë	/	3
Rastavicë	25.4	/
Sllup	10	5
Vranoc i Vogël	/	/
Drenoc	/	5

Tabela 136. Gropat septike kolektive

Vjetërsia e gropave septike kolektive është nga 6 vjeçare deri te ma e vjetra në 12 vjet, ose me mesatare prej 10.4 vjet, ndërsa rrjeti kanalizimit është prej 6 - 12 vjeçare. Në Komunën e Deçanit deri me tani ka 64 572,36 m të rrjetit primar dhe sekondarë të rrjetit të kanalizimit fekal. Këto te dhëna tregojnë se Komuna e Deçanit në përgjithësi ka rrjetin e ri të kanalizimit të ndërtuar pas lufte kurse në prioritetet Komunale është paraparë edhe shtrirje e rrjetit të kanalizimit edhe vendbanimet tjera.

Mbulimi i të gjitha vendbanimeve të Komunës së Deçanit me rrejt të kanalizimit fekal brenda 8 vjetëve është i pamundshëm dhe jo real sepse varet nga shumë faktor duke filluar nga buxheti Komunal dhe çështjet pronësore. Mirëpo brenda periudhës 8 vjeçare është e nevojshme që shpërndahet rrejti i kanalizimit lagjet e zonës urbane dhe si prioritet është rruga Elena Gjika, dhe të vazhdohet me 18 fshatrat ma prioritare. Gjithashtu është e nevojshme të ndërtohen tre impiante për trajtimin e ujërave të zeza gjegjësisht në fshatrat Strellc të Ulët (Bohriqe), Dubovik dhe Papiq.

Kanalizim i ujërave atmosferik është i shtrirë kryesisht në zonën urbane dhe shumë pak në zonat rurale ku deri më tani janë vetëm 6.5 km të rrjetit të ujërave atmosferik të shtrira kryesisht në zonën urbane por pjesërisht edhe në zonat rurale gjegjësisht me shtrimin dhe rregullimin e një pjese të rrugës R107 - pjesa hyrëse nga pjesa veriore. Në periudhën 8 vjeçare planifikohet te shtohen edhe 2,5 km të rrjetit atmosferik gjegjësisht deri të vendbanimi Strellc i Epërm si dhe 6 km tjera në drejtim te zgjerimit të rrugës deri në kufirin me Gjakovën. Rrjeti ekzistues është nga materiali PVC SN 8 me diametër Ø 500 mm dhe të njëjta planifikohen të shtrihen edhe në të ardhmen. Sistemi i kanalizimit të ujërave atmosferik e ka ndihmuar mjaft qytetin e Deçanit nga reshjet andaj mirëmbajtja dhe pastrimi i rregullt është i nevojshëm në të ardhmen. Periudha 8 vjeçare nuk mjafton që të mbulohet e gjithë sipërfaqja me kanalizimin te ujërave atmosferik e mbi të gjitha kur shtrimi i rrjetit të kanalizimit fekal është prioritet.

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike: ujësjellës, kanalizim, ujit atmosferik dhe ujitjes	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- E gjithë territori i Komunës është përfshirë në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm, - Kontrolli i vazhdueshëm i kualitetit të ujit, - 2/3 e zonës së qytetit është e mbuluar nga një rrjet kanalizimesh, - Kanalet e hapura, - Impianti mekanik për trajtimin e ujërave të zeza, - Rrjeti për ujitje te tokave bujqësorë, - Projekti për rrjetin e kanalizimit – ujërave të zeza, për ter territorin e Komunës. - Projekti për rrjetin e kanaleve për ujitje në tërë territorin e Komunës Deçanit. - Ekzistencën e OJQ-ve që merren me çështjet mjedisore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit. -	- Mungesa e kadastrës nëntokësore për furnizimin me ujë dhe rrjetin e ujërave të zeza, - Mungesa e rrjetit te kanalizimit te ujerave te zeza ne mbi 65 % te territorit te komunës - Dëmtimi i rrjetit nëntokësor të furnizimit me ujë ose kanalizimeve gjatë punimeve për shkak të mungesës së kadastrës nëntokësore, - Keqpërdorimi i ujit të pijshëm (përdorimi për vaditje, pastrim të lokaleve, larje makinash, etj.), - Lidhje të paligjshme me rrjetin e furnizimit me ujë, - Pagesat për shërbimet me ujë të pijshëm është i pa kënaqëm, - Mungesa e mbulueshmërise se tokës bujqësore me rrjet të ujitjes, - Pagesa për shërbim më ujë për ujitjen e tokave bujqësore shumë i ultë, - Furnizimi me ujë është i pasigurt. - Mbulimi jo i plotë i zonës urbane nga rrjeti i ujërave të zeza, - Menaxhimi i dobët i ndërmarrjeve publike regjionale të ujësjellësit dhe ujitës së tokave bujqësorë, - Vetëm pjesa qendrore e qytetit të Deçanit është e mbuluar nga një rrjet atmosferik i kullimit të ujit, - Ujërat e zeza dhe ato atmosferik derdhen ne Lumëbardhin e Deçanit dhe Lloqanit si pasojë e mungesës së impianteve të trajtimit të ujërave të zeza,

	- Kanalet e hapura nuk mirëmbahen rregullisht, - Mungesa e pikave – sistemit të akumulimit të ujërave, - Mungesa e inspektimit të rregullt të rrjetit të ujësjellësit, - Mungesa e rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit ne pjesën ne zhvillim ne zonën e parkut kombëtar.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Konfigurimi i terrenit i përshtatshëm për ndërtimin e një rrjeti për ujërat e zeza dhe atmosferike, - Terren i favorshëm për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në vende të destinuara për zhvillimin e bujqësisë, - Ndërtimi i një pende akumuluese për sigurimin e kapacitetit të ujit të pijshëm dhe atij për ujitje, - Mbështetje nga niveli qendror për të rritur cilësinë e ofrimin e shërbimeve, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm (zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve), - Ndërtimi i impianteve të vogla të trajtimit të ujërave të zeza, (sinë zonën urbane, rurale dhe atë malore), - Themelimi i Ndërmarrjes Komunale për menaxhimin e ujit të pijshëm, - Themelimi i Ndërmarrjes Komunale për menaxhimin e ujitjes së tokave bujqësore	- Mungesa e burimeve ujore dhe varësia nga komunat fqinje në të ardhmen, - Ndotja e burimeve të ujit nga faktorët natyror dhe faktori njeri, - Ndotja e ujit nga një rrjet i vjetruar, - Thatësira dhe mungesa e reshjeve, - Pa përgjegjësia e konsumatorëve në shfrytëzimin e ujit, - Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit nga fatkeqësitë natyrore, - Kontaminimi i ujërave atmosferik dhe ujërave për ujitjen e tokave bujqësore nga ujërat e zeza të pa kontrolluara -

Tabela 137. SWOT analiza për infrastrukturë teknike: ujësjellës, kanalizim, ujit atmosferik dhe ujitje

3.4.3 Energjia elektrike

Komuna e Deçanit, ka shtrirje me furnizim të energjisë elektrike nga dy termocentrale me ndezje thëngjilli "Kosova A" dhe "Kosova B" dhe importeve përgjatë rrjetit 400 kv dhe 220 kv në termocentralin "Kosova B", përgjatë rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv. Po ashtu Komuna e Deçanit furnizohet edhe nga hidrocentrali i Kozhnjerit, i cili e bënë furnizim me 8 Mgv ku zbrazja bëhet në NS Deçan 110/35/10 kv. Të dhënat nga KEDS dhe KESCO kanë qenë të kufizuara sa i përket rrjetit të energjisë elektrike. Ndërsa nga Hidrocentrali i Kozhnjerit janë ofruar të dhënat se prodhimi i energjisë elektrike e ndihmon një pjesë të zonës urbane të Deçanit, Lëbushë, Dubovik, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm, Pozhar, Kodrali dhe Drenoc, ndërsa pjesërisht fshatrat Strellci i Epërm, Strellc i Ulët dhe Isniq.

Duke iu referuar trendëve te rritjes së popullsisë dhe numrit të ekonomive familjare, sipas informatave nga grupet punuese për sektorin e energjisë elektrike, për çdo ekonomi familjare janë të nevojshme 0.70 kVA. Disa vendbanime në Komunën e Deçanit të cilat kanë pas trend të ulët të rritjes së popullsisë si dhe në projeksionet e rritjes së popullsisë deri në vitin 2031, nuk kanë nevojë që në të ardhmen të shtohen kapacitetet me furnizim të energjisë elektrike. Vendbanimet e tilla janë: Dashinoc, Dubravë, Hulaj, Maznik, Papiq, Pozhar, Prokolluk, Ratishë e Epërm, Sllup dhe Vranoc i Vogël.

Vendbanimet	Ekonomitë familjare 2023	Ekonomitë familjare 2031	Ekonomitë familjare (diferenca 2011 - 2023)	Projeksionet e planifikuara KVA
Baballoq	235	394	36	25
Beleg	121	204	19	13
Belle	1	2	0	2
Carrabreg i Epërm	213	357	32	22
Carrabreg i Ulët	303	508	46	32
Dashinoc	44	74	7	0
Deçan	594	936	85	60

Drenoc	154	258	23	16
Dubovik	156	261	24	17
Dubravë	41	69	6	0
Gllogjan	145	243	22	15
Gramaqel	161	271	25	18
Hulaj	23	39	4	0
Isniq	569	429	39	27
Irzniq	256	955	87	61
Kodrali	119	199	18	13
Lëbushë	168	282	26	18
Lumbardh	105	177	16	11
Lloqan	73	123	11	8
Llukë e Epërme	213	358	33	23
Llukë e Ulët	74	125	11	8
Maznik	66	110	10	0
Papiq	26	43	4	0
Pobergjë	193	324	30	21
Pozhar	62	105	10	0
Prapaqan	109	183	17	12
Prokolluk	42	71	6	0
Prilep	318	534	49	34
Rastavicë	182	305	28	20
Ratish i Epërm	31	52	5	0
Ratish i Ulët	82	138	13	9
Sllup	50	83	8	0
Strellc i Epërm	492	826	75	53
Strellc i Ulët	311	521	47	33
Shaptej	87	146	13	9
Voksh	84	141	13	9
Vranoc i Vogël	15	27	2	0
Gjithsejtë	5918	9871	898	589

Tabela 138. Projeksionet e furnizimit me energji elektrike deri ne vitin 2031

Për qëllimet të zhvillimit të turizmit në Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" *i cili do të zhvillohet në të ardhmen në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna" dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna",* është planifikuar shpërndarja e elektrifikimit ne Belle dhe Pleqe Bjeshkës së Madhe, Bjeshkët e Belegut janë planifikuar të forcohen me 13 kVA.

Në vendbanimin Baballoq është e nevojshme forcimi i rrjetit elektrik ndërsa në Irzniq, Ratish i Epërm dhe i Ultë është i nevojshëm ndërrimi i rrjetit të tensionit të lartë 10 kV. Në vendbanimin Isniq është e nevojshme të bëhet ndërrimi rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV.

Krahas vendbanimeve të lartpërmendura, në 8 vitet e ardhshme është e nevojshme që të bëhen mirëmbajtjet e përmirësimet e rrjetit të energjisë elektrike ne vendbanimet Lumbardh, Pozhar, Carrabreg, Pobergjë, Irzniq si dhe ndërrimi i trafove, ne fshatin Strellc i Epërm në tensionin 10kV dhe në fshatin Strellc i Ulët në tensionin 0.4 kV dhe 10kV.

Për rritjen e sigurisë është e nevojshme ndërrimi i shtyllave të vjetërsuara e sidomos nga druri, në shtylla të reja nga betoni ku prioritet për ndërrimin e shtyllave të rrjetit 10kV janë vendbanimet Hulaj dhe Pobergjë.

Të gjitha veprimet e sipër përmendura do të behën në harmoni të plotë me U.A. MMPH 08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, gjegjësisht pikën 16. Infrastruktura energjetike dhe pika 16.1 Kushtet e përzgjedhjes së cilat i caktojnë normat e linjave mbitokësore dhe nëntokësore:

- Në bazë të vlerësimit të ndikimit të fushës magnetike dhe elektrike të krijuar nga rrjeti i linjave mbitokësore;
- Në largësi nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies
    - 40 m nga autoudhet;
    - 20 m nga rrugët nacionale; dhe
    - 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale.
- Për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët kallkan të ndërtesës, nuk ka kufizim;
- Për linjat ajrore me tension deri 1.0 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2.0 m;
- Për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1.0 m nga vija ndërtimore.

3.4.4 Ndriçimi publik

Gjatësia e gjithë rrjetit të ndriçimit publik sipas PKVEE në qytetin e Deçanit dhe në fshatra deri më tani është raportuar të jetë 96 km, e që projekti është duke vazhduar edhe për të gjitha fshatrat e mbetura në Komunën e Deçanit. Ndriçimi publik në Komunën e Deçanit, është duke u kryer më ndriçues të teknologjisë LED dhe një pjesë e vogël e tyre llamba të tipit HID halide[76]. Është e nevojshme që të shtrihet sa ma shumë rrjeti i ndriçimit publik si në zonën urbane ashtu edhe në zonën rurale. Shpërndarja e rrjetit të ndriçimit publik është prioritet për Komunën e Deçanit mirëpo nuk është nga ato kryesoret me qenë se niveli i krimit ne hapësirat urbane ne Komunën e Deçanit nuk është i lartë por janë edhe prioritetet tjera siç është shtrimi i rrjetit të kanalizimit fekal, rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike etj. Zona urbane pothuajse është e mbuluar me ndriçim publik. Caktimi i rrugëve të cilat kanë nevojë për ndriçim janë caktuar duke e bërë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, si dhe duke i marr parasysh kërkesat e dala nga takimet me palët e interesuara e me theks te veçantë banorët. Të gjitha këto kërkesa janë vlerësuar duke i harmonizuar me kornizën ligjore dhe mundësitë buxhetore. Ne ketë drejtim rol të rëndësishëm luan edhe bashkëpunimi në vazhdimësi me KEDS dhe KESKO si dhe partneriteti me politikat e nivelit qendror rreth shpenzimit të energjisë elektrike. Në ketë drejtim, autoritetet lokale janë të orientuara në ndriçimin e cila është efikase në energji – LED mirëpo edhe që siguron shikueshmëri të mirë. Ky lloj ndriçimi pastaj, klasifikohet për llojin e rrugës, hapësirën që e rrethon, sigurinë për këmbësorët, çiklistët, personat me aftësi të kufizuara, sheshet, monumentet, këndet e lojërave, terrene sportive etj. Hapat drejt një qyteti të mençur do ta ndihmojnë Komunën e Deçanit që në të ardhmen të mendohet rreth menaxhimit të ndriçimit – kontrollimi nga distanca duke përdorur ndriçim inteligjent i cili i përgjigjet kushteve në kohë reale. Me ndriçim publik synohet që të ketë ndriçim të barabartë dhe të ofrohet siguri maksimale e cila mund të kombinohet edhe me CCTV.

Gjatë periudhës 8 vjeçare janë të nevojshme të shtrihet ndriçimi publik me trupa ndriçues te teknologjisë LED ndërsa përfituese do të janë edhe vendbanimet rurale siç janë Baballoq, Shaptej, Dubovik, Papiq dhe te vazhdohen me investimet ne Maznik dhe në të gjitha fshatrat e mbetura. Në të gjitha mundësitë, Komuna e Deçanit do të aplikon te organizatat dhe të sektori privat për grante apo donacione për shtimin e rrjetit të ndriçimit publik, ndërsa partneriteti publiko-privat në ketë drejtim është një nga mundësitë në qoftë se është ekonomikisht e qëndrueshme për Komunën e Deçanit.

[76] Plani Komunal i Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2022 - 2024 (PKVEE)

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike: Energjia elektrike	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- E gjithë popullata është e përfshirë në rrjetin energjetik, - Investimet e rregullta në rrjetin energjetik - Prezenca e hidrocentraleve, - Heqja e ndriçimit të vjetër publik dhe instalimi i ndriçimit të ri me sistem LED. - Gjendja pjesërisht e mirë e linjës largpërçuese, - Stabilizimi i furnizimit me energji elektrike, Prezenca e burimeve alternative të energjisë. - -	- Prezenca e rrjetit elektrik i vjetruar, i mbingarkuar dhe me humbje të panjohura, - Mungesa e kadastrës nëntokësore dhe mbi tokë të rrjetit të energjisë, - Dëmtimi i rrjetit të energjisë nëntokësore gjatë punimeve për shkak të mungesës së kadastrës nëntokësore. - Lidhjet e paligjshme në rrjet, - mbingarkesa e rrjetit, - Ndërprerje e energjisë elektrike, - Ngrohje me energji elektrike, - Ndërtesat ekzistuese të banimit dhe të rejat nuk marrin parasysh çështjen e energjisë efiçiencë, - Përdorimi i burimeve të ri përtëritshim të energjisë është minimal, - Mbulim i pamjaftueshëm ne fshatra me ndriçim publik, - Trafo stacionet në zonat rurale janë të vjetërsuara, - Mungesa e rrjetit elektrik dhe trafo stacioneve në zonat zhvillimore në P. K. "Bjeshkët e Nemuna"
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Aplikimi në programet ndërkombëtare për projekte efikase të energjisë, burimet e ri përtëritshim të energjisë si rezultat i rritjes së kërkesës për furnizim me energji elektrike, - Mbështetja e nivelit qendror nga KEDS në përmirësimin dhe zhvillimin e rrjetit të energjisë për të reduktuar humbjet e rrjetit, - Heqja e rrjetit ajror dhe ndërtimi i një rrjeti të ri nëntokësor, - Ndriçimi i të gjithë zonës urbane me ndriçim publik të llojit LED, - Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në të ardhmen, - Mundësi e mirë për prodhimi i energjisë elektrike me panele solare. - Parqe me ndriçim me panele solare. - Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme nga pendat akumuluese në kanjonin e lumit Lumëbardhi i Lloqanit,	- Lidhje të paligjshme në rrjet, - Rritja e kërkesës për energji elektrike ndërsa rrjeti ekzistues është i vjetruar dhe i mbingarkuar, - Vendosja e nënstacioneve në pronat private mund te ndikojnë në të ardhmen e furnizimit me energji elektrike, - Tensioni i paqëndrueshëm mund të dëmtojë familjet dhe bizneset, - Reduktimi i prodhimit të energjisë elektrike për shkak të humbjeve në rrjet, standardeve të reja mjedisore apo politikave të BE-së. - Kalimi i linjave te tensionit te larte ne vendbanime me dendësi te madhe.

Tabela 139. SWOT analiza e infrastrukturës teknike: energjia elektrike

3.4.5 Telekomunikacioni

Shtrirja e telekomunikacionit në Komunën e Deçanit është ne nivel të kënaqshëm. Operatoret e telefonisë mobile, e kanë të mbuluar pothuajse të gjithë territorin e Komunës Deçanit, duke përfshirë edhe zonat malore. Në pjesët e ndryshme, të pjesës perëndimore – zona malore, ka mungesë të rrjetit dhe ndodh që ka ndërhyrje nga operatorët e shteteve fqinje. Ne këtë drejtim është e nevojshme që të mbulohet i gjithë territori i Komunës me telefoni mobile e cila ne të ardhmen do të jetë në mbështetje të zhvillimit të turizmit në ketë pjesë. Në ketë drejtim, veprimet e shpërndarjes se antenave apo përçuesve tjerë në ketë zonë duhet *të zhvillohet në përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për "Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna" dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".* Sipas të dhënave të Telekomit të Kosovës operatori Vala i ka 20000 klient privat, 1200 klient publik dhe 700 klient komercial.

Operatorët publik por edhe privat, kanë arritur të shpërndajnë rrjetin optik në të gjithë pjesën rurale dhe urbane. Rrjeti kabllorë është i kombinuar në varësi të kompanive të cilat operojnë. Në ketë drejtim duhet të cekët se operatori publik Telekomi i Kosovës ka arrit me sukses që ta shpërndaj 43.78

km kabull optik nëntokësor në Komunën e Deçanit. Në anën tjetër 151.69 km rrjet të telefonisë fikse, kabllovike dhe internet janë të shpërndara nga Telekomi i Kosovës në të gjithë Komunën e Deçanit në një total prej 195.80 km. Problem është shpërndarja e rrjetit kabllor optik në vendbanimet e zonave malore ku terreni është i papërshtatshëm ku kompanitë publike i përdorin shtyllat e energjisë elektrike për të shpërndarë rrjetin kabllorë optik.

Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti sekondar, sipas vendbanimeve		
Kodi referues	Përçuesi 01 Gjatësia (km)	Përçuesi 02 Gjatësia (km)
Strellc		39,43
Isniq		39,45
Gllogjan, Dubravë, Hereq, Jasiq i Ri, Baballoq, Gramaqel dhe Shaptej, Projekt i vitit 2019		49,3
Prilep		6,48
Skivjan		5,91
Carrabreg i Ulët		0,40
Carrabreg - Ledina		0,35
Podi i Gështenjave		0,83
Lloqan		0,60
Beleg		1,86
Llukë e Epërme & Ulët		7,35

Tabela 140. Infrastruktura e telekomunikacionit, telefonia fikse, kabllovike dhe interneti - rrjeti sekondar, sipas vendbanimeve

Telefonia fikse nga viti në vit ka një rrënje, ndërsa sipas të dhënave të Telekomit të Kosovës, në Komunën e Deçanit në vitin 2023 janë gjithsejtë 1450 klient amvisërie, 30 klient publik dhe 100 klient komercial.

Si përfundim, zhvillimi i teknologjisë informative në Komunën e Deçanit është mjaft e nevojshme, mbi të gjitha kur synohet që disa veprime në zhvillimin e Komunës së Deçanit janë të bazuara në veprime konkrete të mençura. Kjo nënkupton se në vijim duhet ti ofrohet sa ma shumë mundësia të shpërndarjes së rrjetit optik dhe të ndjekin trendët bashkëkohore dhe në bashkëpunim me operatorët publik dhe privat të hartohet plani i shpërndarjes dhe investimeve të përbashkëta duhet i marr parasysh kushtet klimatike, qasja e lehtë në rrjetë, ndjekja e terreneve të përshtatshme, minimalizimi i dëmtimit të rrjetit nga faktorë të ndryshëm si dhe të fillohet me kalimin e rrjetit nga ai ajror në atë nëntokësore. Në këtë drejtim është e nevojshme që gjatë rregullimit të infrastrukturës së transportit, duhet të merren parasysh edhe shtrimi i rrjetit kabllor optik për të gjithë operatorët.

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike: Telekomunikacioni	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Mbulimi i mirë i operatorëve VALA ,IPKO, NJËART , ADEA, Kujtesa dhe Artmotion. - Rrjet i mirë i interneti në zonën urbane nga operatorë të ndryshëm privat, - Ofrimin e disa shërbimeve nga PTK (kryesisht shërbimet postare dhe pagesa), - Shtrirja e gypave për shpërndarjen e rrjetit të telekomunikacionit nëntokësor për gjatë rrugë kryesore në zonën Urbane	- Mungesa e kadastrit digjital nëntokësore dhe mbitokësor të rrjetit të telekomunikacionit, - Dëmtimi i rrjetit kabllor optik nëntokësor gjatë punimeve për shkak të mungesës së kadastrës nëntokësore, - Mos mbulueshmëria e të gjithë zonës malore me rrjetë të telefonisë mobile.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Fillimi i zhvillimit të koncepteve të "Qytet i mençur" me një theks të veçantë në lëvizshmërinë, - Përmirësimi i ofrimeve të ardhshme të shërbimeve.	- Varësia nga rrjeti i telekomunikimit mund të ketë ndikim në ekonomi në rastet kur ka defekte të tej zgjatura.

Tabela 141. SWOT analiza e infrastrukturës teknike: telekomunikacioni

3.4.6 Menaxhimi me mbeturina

Në Komunën e Deçanit ndodhet një njësi deponuese për mbeturina e cila ka sipërfaqe 4ha me zonë mbrojtëse 100m ndërsa stacioni transferues është në njësinë deponuese në Sverkë në Komunën e Klinës e cila ka sipërfaqe 130 ha dhe zonë mbrojtëse 800 m. Rrjeti i shërbimit është i shpërndarë në të gjitha vendbanimet në përjashtim të vendbanimit Belle dhe Pleqe të cilat ndodhën në viset malore dhe jetojnë numër shumë i vogël i ekonomive familjare gjegjësisht 2 në Belle dhe po aq në Pleqe.

Në të gjitha vendbanimet janë të shpërndara kontejnerët me volum 120 l dhe më së shumti janë të shpërndara në Deçan me 1467 copë dhe më se paku janë ne Jasiq i Ri me 3 copë. Ne përgjithësi janë 8363 kontejner të shpërndarë në të gjithë Komunën e Deçanit ku distanca ma e vogël mesatare ndërmjet kontejnerëve është ne Deçan me një mesatare prej 4 metra ndërsa mesatarja ma e madhe në mes të kontejnerëve është në Vranoc të Vogël me mesatare prej 1388 metra. Më se shumti janë klientë të amvisërisë me gjithsejtë 7681, pastaj klient komercial me 584, klient publik me 22 dhe klient me kontratë 11 ku gjithsejtë janë 8298 klient në Komunën e Deçanit. Nga të gjitha vendbanimet, Deçani prin me më se shumti klient të amvisërisë, komercial, publik dhe me kontratë ndërsa Isniqi është vendbanimi i dytë i cili ka më se shumti klient për të vazhduar pastaj me Strellc të Epërm, Strellc të Ulët etj.

Më se shumti grumbullohen mbeturina nga amvisëria me gjithsejtë 738.557 ton, klient komercial 56.153 ton, klient publik 2.115 ton dhe klient me kontratë 1.057 ton. Gjithsejtë në Komunën e Deçanit grumbullohen 797,882 ton mbeturina në vit.

Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit				
Vendbanimet	Rrjeti i shërbimit			
	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i kontejnerëve (nr.)	Vëllimi i kontejnerëve (m^3)	Distanca mesatare ndërmjet kontejnerëve (m)
Baballoq	15	352	120 l	43
Beleg	6	190	120 l	31.6
Carrabreg i Epërm	4	345	120 l	11.6
Carrabreg i Ultë	6	297	120 l	20
Dashinoc	20	51	120 l	392
Deçan	6	1467	120 l	4
Drenoc	9	230	120 l	39
Dubovik	8	185	120 l	43
Dubravë	20	52	120 l	384
Shaptej	14	92	120 l	152
Gllogjan	17	211	120 l	80
Gramaqel	19	252	120 l	75
Irzniq	13	314	120 l	41.4
Prokolluk	11	59	120 l	186
Isniq	5	794	120 l	6.3
Kodrali	9	150	120 l	60
Lëbushë	6	180	120 l	33
Lloqan	5	117	120 l	42
Hulaj	2	30	120 l	67
Llukë e Epërme	4	227	120 l	18
Llukë e Ulët	7	93	120 l	75
Lumbardh	9	151	120 l	60
Maznik	19	76	120 l	250
Vranoc i Vogël	25	18	120 l	1388
Papiq	23	20	120 l	1150
Pobergjë	9	255	120 l	35
Pozhar	8	106	120 l	75
Prapaqan	10	154	120 l	65
Prilep	5	340	120 l	15

Rastavicë	10	200	120 l	50
Ratish i Epërm	16	69	120 l	231
Ratish i Ulët	18	43	120 l	418
Sllup	8	56	120 l	14
Strellc i Epërm	8	589	120 l	14
Strellc i Ulët	11	455	120 l	24
Voksh	12	140	120 l	74
Jasiq i Ri	21	3	120 l	80
Pleqe	0	0	0	0
Belle	0	0	0	0
Gjithsej	418	8363	0	5746.9

Tabela 142. Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit

Vendbanimi	Numri i klientëve (nr.)			
	Klient te amvisërisë	Klient publik	Klient komercial	Më kontratë
Baballoq	340	1	10	1
Beleg	189	0	1	0
Carrabreg i Epërm	337	0	8	0
Carrabreg i Ultë	292	0	5	0
Dashinoc	51	0	0	0
Deçan	992	12	457	6
Drenoc	224	1	4	1
Dubovik	185	0	0	0
Dubravë	52	0	0	0
Shaptej	91	0	1	0
Gllogjan	208	0	3	0
Gramaqel	249	0	3	0
Irzniq	240	1	8	0
Prokolluk	59	0	0	0
Isniq	771	1	22	0
Kodrali	149	0	1	0
Lëbushë	172	0	7	1
Lloqan	117	0	0	0
Hulaj	28	0	2	0
Llukë e Epërme	224	0	2	1
Llukë e Ulët	93	0	0	0
Lumbardh	149	1	1	0
Maznik	76	0	0	0
Vranoc i Vogël	18	0	0	0
Papiq	20	0	0	0
Pobergjë	253	1	1	0
Pozhar	105	0	1	0
Prapaqan	153	0	1	0
Prilep	327	1	12	0
Rastavicë	190	1	8	1
Ratish i Epërm	69	0	0	0
Ratish i Ulët	43	0	0	0
Sllup	55	0	1	0
Strellc i Epërm	569	1	19	0
Strellc i Ulët	448	1	6	0
Voksh	140	0	0	0
Jasiq i Ri	3	0	0	0
Pleqe	/	/	/	/
Belle	/	/	/	/
Gjithsejtë	7681	22	584	11

Tabela 143. Numri i klientëve te amvisërisë, publik, komercial, me kontratë sipas vendbanimeve

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike: Menaxhimi i mbeturinave	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Një rrjet i mirë i pikave të zgjerimit për grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës, - Mbledhja e rregullt e mbeturinave, - Depo kryesore është vendosur në komunën fqinje dhe ndotja mjedisore për komunën e Deçanit është minimale. - Depo për mbeturinat e ngurta - Plani i Menaxhimit të Mbeturinave - Shpërndarja e kontejnerëve të mbeturinave për të gjitha familjet	- Personeli i pamjaftueshëm i komunës për të zhvilluar politika të qarta të menaxhimit të mbetjeve afatmesme dhe afatgjata, - Deponitë ilegale, - Ndërgjegjësimi i ulët i banorëve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe ndikimin e mbeturinave në të, - Fuqia punëtore e pamjaftueshme.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Projekte për ndarjen – kategorizimin e mbeturinave, - Mbështetje e nivelit qendror, programe ndërkombëtare për prokurimin e kamionëve të rinj për mbledhjen e mbeturinave, - Shpërndarja e kontejnerëve të klasifikimit të mbeturinave për të gjitha familjet, - Përmirësimi i shërbimeve në të ardhmen, - Ekzistenca e OJQ-ve mjedisore të profilizuar për mbrojtjen e mjedisit, - Rritja e ndërgjegjësimin të banorëve rreth mbeturinave.	- Depo kryesore ndodhet në komunën fqinje dhe në të ardhmen mund të ketë mosmarrëveshje të ndryshme, - Rritja e numrit te deponive ilegale, - Rritja e ndotjes mjedisore nga mbeturinat e deponive ilegale, - Epidemi të sëmundjeve të ndryshme, - Djegia e mbeturinave në deponitë ilegale, - Mungesa e fondeve për të mbështetur kompanitë e grumbullimit të mbeturinave për të mbajtur logjistikën për të ofruar shërbime të përshtatshme në rast se ato nuk mbledhin të ardhura – pagesat për shërbimet.

Tabela 144. SWOT analiza e infrastrukturës teknike: menaxhimi i mbeturinave

3.5 Infrastruktura e transportit dhe transporti publik

Në Komunën Deçanit në 10 vitet e fundit janë zhvilluar investime kapitale në sektorin e ujësjellësit dhe infrastrukturës së transportit. Rrjeti i rrugëve në masë të madhe është e asfaltuar dhe e shenjëzuar me synim të rritjes së sigurisë në trafik. Në territorin e komunës Deçanit kalojnë dy rrugë regjionale gjegjësisht R107 dhe R108 ku Rruga R107 e lidh Komunën e Pejës me Prizrenin dhe ka dalje ne pikën e Morinës ndërsa R108 është rruga e cila degëzohet nga R107 në qendër të Deçanit dhe lidhet me Plavën dhe Gucinë në Malin e Zi. Rruga R108 është rrugë malore e asfaltuar përpos një pjese përgjatë Manastirit të Deçanit (kjo është çështje politike nga ana e përfaqësuesve të Manastirit). Rruga R107 e cila e lidh Deçanin me Pejën dhe Deçanin me Gjakovën, kalon në qendër të qytetit. Ngarkesa dhe fluksi i madh e ngarkon jashtëzakonisht shumë Deçanin ku krahas ngarkesës në trafik, edhe ndotja nga gazrat dhe zhurma është e madhe. Te dy rrugët regjionale janë me gjerësi të brezit rrugor 7 metra ndërsa gjerësia e përgjithshme është 22 metra duke e përfshirë dy shirita për vozitje të vazhdueshme, shiritin për ndalje, shiritin përkufizues, bankinën dhe gjerësinë mbrojtëse. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve regjionale është 62.2 km dhe menaxhohen nga niveli qendror.

Përpos rrugëve regjionale, në Komunën e Deçanit janë edhe rrugët lokale të asfaltuara me gjatësi 362.6 km dhe rrugë lokale të paasfaltuara me gjatësi 42.4 km. Gjerësia e përgjithshme e brezit të rrugës lokale të asfaltuara dhe të paasfaltuara është 8 metra.

Rrugët regjionale dhe rrugët lokale të asfaltuara janë të shtruara me shtresën e asfaltit ndërsa rrugët lokale të pa asfaltuara janë të shtruara me zhavorr.

Si rrugë urbane primare janë gjithsejtë 21 km ndërsa sekondare janë 18 km dhe të gjitha janë të shtruara me asfalt ku gjerësia e brezit të rrugës ndryshon nga 8 deri 10 metra. Ekzistojnë 4 vend

parkingje për automjete në rrugët urbane dhe 2 stacione për autobus dhe 1 stacion për taksi ndërsa ne rrugët lokale janë gjithsejtë 37 stacione për autobus.

Gjatësia e rrugëve të pa kategorizuara është gjithsejtë 120 km nga të cilat 95 janë të asfaltuara dhe 25 km me zhavorr.

Ne territorin e Komunës së Deçanit është propozuar edhe traseja e Autostradës së Dukagjinit ku më 3 prill 2019 ne takimin e Komitetit drejtues ndërministror është prezantuar versioni final i "Autostradës Istog – Pejë – Deçan -Gjakovë – Prizren".

Me 6 mars 2020 është prezantuar propozimi alternativ për autostradën e Dukagjinit kurse me 25 maj 2023 vlerësohet se Autostrada e Dukagjinit nuk do të ndërtohet.

Sa i përket transportit publik, në Komunën e Deçanit ekzistojnë linjat periferike të cilat e lidhin Deçanin me Vokshin, Deçanin me Prapaqanin dhe Deçanin me Gllogjanin të cilat operojnë çdo 300 min. ndërsa linjat rajonale dhe nacionale janë Deçani me Prishtinën, Deçani me Pejën dhe Deçani me Gjakovën të cilat operojnë çdo 30 minuta, ndërsa linjat ndërkombëtare nuk janë të rregullta. Ato i përshtaten sezoneve dhe kërkesave dhe kryesisht operojnë ne vendet e BE-së si Austri, Zvicer, Itali, Francë, Gjermani, Belgjikë ndërsa gjatë sezonit të verës ato operojnë në linjat me Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Synimi i Komunës Deçanit është zhvillimi i turizmit në mënyrë të kontrolluar dhe në harmoni me kornizën ligjore, andaj është më se e nevojshme që në të ardhmen të rregullohet çështja e parkingjeve e me theks te veçantë parkingjet për autobus të cilët do të janë në dispozicion të turizmit.

Komuna e Deçanit nuk ka linjë hekurudhore e as ajrore andaj lidhja me hekurudhën bëhet vetëm nga stacioni i hekurudhës në Pejë ndërsa ajo ajrore vetëm nga aeroporti ndërkombëtarë "Adem Jashari" në Sllatinë. Ne projektet strategjike nacionale janë planifikuar që të zhvillohet hekurudha e cila e lidh Prishtinën me portin e Durrësit si dhe për linjat ajrore pritet aktivizimi i aeroportit të Gjakovës i cili do të ketë ndikim pozitiv ne zhvillimin ekonomik të Deçanit në fushën e turizmit dhe lehtësira për ardhjen e mërgimtarëve.

Analiza SWOT – Infrastruktura e trafikut	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- 80% e zonës së qytetit është e mbuluar nga infrastruktura shumë e mirë e transportit, - E gjithë zona urbane është e rregulluar – shtruar me asfalt, - Zonat rurale kanë qasje të mirë, - Distanca të shkurtra për lidhjet me komunat fqinje, - Qendra e Qytetit shesh multi funksional - Qytet i rrafshët dhe i përshtatshëm për ecje dhe çiklizëm, - Pika te caktuara për parking, - Numri i ulët i aksidenteve të trafikut, - Sinjalizimi i trafikut në nivel të kënaqshëm, - Ndriçimi publik në nivel të kënaqshëm, - Investimi në infrastrukturë si një përparësi, - Ekzistenca e bus ndaljeve, - Pikë lidhëse e pjesës veriore me atë jugore të Rrafshit të Dukagjinit, - Mirëmbajtje e mirë gjatë dimrit, - Bashkëpunimi i mirë me policinë. - Dy porta hyrëse në P. K. " Bjeshkët e Nemuna"	- Mungesa e trotuareve, në disa rrugica të qytetit dhe në zona rurale - 1/4 e rrjetit rrugor duhet të rindërtohet dhe të përmirësohet - ½ e territorit komunal është pjesë malore dhe është sfiduese për investime në infrastrukturën e transportit, - Mungesa e një data bazë e infrastrukturës rrugore, - Mungesa e stacionit të autobusëve - Mungesa e planit të investimeve në infrastrukturë (kryesisht investimet Ad-hock), - Investimi në infrastrukturë nuk është në përputhje me praktikat e mira të Bashkimit Evropian, - Stafi i pamjaftueshëm i komunës për të zhvilluar politika të qarta afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e lëvizshmërisë. - Buxheti i ulët komunal për zhvillimin e politikave të lëvizshmërisë, - Ndriçim publik nuk e mbulon të gjithë territorin komunalë, - Mungesa e shtigjeve të biçikletave, - Trotuaret e uzurpuara nga parkimet ilegale,

	- Një numër i vogël vendesh parkimi krahasuar me numrin e makinave, - Ndotja e mjedisit (ajrit dhe tokës) nga automjetet e vjetra, - Zhurma nga mjetet e motorizuara, - Mungesa e transitit nga drejtimi i Pejës dhe Gjakovës sidomos për mjetet e tonazhit të rendë, - Autobusët që hyjnë në portën veriore të qytetit kalojnë përmes zonave të banimit, - Mungesa e transportit publik sidomos dedikuar zhvillimit të turizmit, - Mungesa e kategorizimit të rrugës, - Qasja e lehtë dhe infrastruktura për personat me aftësi të kufizuara nuk janë në nivelin e duhur, - Ndërtesat e reja të ndërtuara nuk e përmbushin numrin e vendeve të parkimit, - Mungesa e buxhetit për shpronësim. - Mungesa e fondit të pronave komunale, - Nuk ka koordinim të investimeve paralelisht në infrastrukturën teknike gjatë investimeve në infrastrukturën e transportit. - Dëmtimi i infrastrukturës rrugore nga automjetet me mbipeshë.
MUNDSITË	RREZIQET
- Ofrimi i modaliteteve aktive të lëvizjes, - Deçani i njohur si "Zona 30", - Kategorizimi i të gjitha rrugëve në komunë, - Bashkëpunim me OJQ-të lokale për të rritur ndërgjegjësimin për trafikun dhe lëvizjet aktive, - Zhvillimi i një rrjeti të mirë për lëvizjen aktive, - Praktika të mira në përputhje me direktivat e BE- së. - Ndalimi i parkimit në qendër, - krijimi i parkimit të ri, zoonimi, parkimi për qiramarrësit, parkimi me pagesë dhe pa pagesë - PPP). - Mbyllja e qendrës për automjete, - Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, - Hapja e pikave të reja kufitare me Malin e Zi. - Asfaltimi i rrugës në Gryken e Deçanit me pjesën tjetër të rrugës R-107.	- ½ e territorit komunal është zonë malore dhe paraqet sfida të lidhjes në të ardhmen me shtetet fqinje, - Mos shpronësimi i pronave private për ndërtimin e transiteve brenda zonës urbane si rezultat i mungesës së mbështetjes nga niveli qendror, - Mungesa e mbështetjes nga Komisioni Ministror mbi Shpronësimet, - Mungesa e mbështetjes financiare nga niveli qendror për zbatimin e politikave të lëvizshmërisë, - Mungesa e kontrollit të cilësisë së karburantit, - Një numër i vogël policësh trafiku, - Mosndëshkimi për shkeljet e trafikut, - Hierarkia e policisë mund të çojë në uljen e bashkëpunim me nivelin lokal, - Rritja e numrit të automjeteve të vjetruara, - Varësia nga komunat fqinje në hyrjen në rrugët rajonale dhe nacionale,

Tabela 145. SWOT analiza e infrastrukturës trafikut

3.6 Infrastruktura dhe shërbimet publike dhe sociale

Pjesa e infrastrukturës publike sociale i përfshinë institucionet arsimore, institucionet publike, institucionet kulturore dhe rini, institucionet sportive dhe rekreative, institucionet e mirëqenës sociale dhe banorët, institucionet fetare, institucionet administrative dhe hapësirat publike.

3.6.1 Institucionet arsimore

Infrastruktura e institucioneve arsimore ne Komune e Deçanit i përfshinë të gjitha nivelet në përjashtim të nivelit universitar. Ne Komunën e Deçanit ndodhen gjithsejtë 18 shkolla fillore të mesme të ulët ndërsa 1 shkollë e mesme profesionale si dhe 1 gjimnaz. Përgatitja e profesionale dhe numri i stafit është i mjaftueshëm dhe i plotëson kërkesat e mbarëvajtjes së mësimit. Numri ma i madh i stafit është në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" me gjithsejtë 67, pastaj Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" me 54,

SHFMU “Isa Boletini” me 36 etj. Më së paku staf ka SHFMU “Kuvendi i Verrave të Llukës” me gjithsejtë 14 ku në këto të dhëna është j përfshirë edhe stafi menaxherial.

Nr.	Shkolla	Tipi i shkollës	Vendi	Hapësira m^2	Sipërfaqja (ha)	Stafi ne përgjithësi	Drejtorët	Zv. drejtorët	Sekretarët
1	"Vëllezërit Frashëri"	Gjimnaz	Deçan	3930	1.50	51	1	1	1
2	"Tafil Kasumaj"	SHMP	Deçan	2293	0.76	33	1		1
3	"Lidhja e Prizrenit"	SHFMU	Deçan	4885	3.20	64	1	1	1
4	"Isa Boletini"	SHFMU	Isniq	4050	1.03	36	1		1
5	"Bajram Curri"	SHFMU	Strellc i Epërm	2950	1.28	27	1		1
6	"Drita"	SHFMU	Gramaqel	1150	1.30	14	1		1
7	"Dëshmorët e Kombit"	SHFMU	Strellc i Ulët	1240	0.19	16	1		1
8	"Jusuf Gërvalla"	SHFMU	Prapaqan	4350	4.80	27	1		1
9	"Sylë Alaj"	SHFMU	Drenoc	770	4.20	19	1		
10	"Heronjtë e Dukagjinit"	SHFMU	Gllogjan	764	2.10	15	1		
11	"Lan Selimi"	SHFMU	Lumbardh	3914	2.04	26	1		
12	"Maxhun Çekaj"	SHFMU	Irzniq	2200	3.20	16	1		
13	"Sylejman Vokshi"	SHFMU	Prilep	820	0.42	13	1		1
14	"Dëshmorët e Vokshit"	SHFMU	Pobergjë	800	1.57	14	1		
15	"Ardhmëria"	SHFMU	Beleg	500	3.08	18	1		
16	"Faik Konica"	SHFMU	Ratish i Ulët	480	5.33	16	1		
17	"Esad Mekuli"	SHFMU	Maznik	700	0.35	16	1		
18	"Kuvendi i Verrave të Llukës"	SHFMU	Llukë e Epërm	450	1.85	13	1		
19	"Dëshmorët e Baballoqit"	SHFMU	Baballoq	800	0.42	14	1		
20	"Rexhep Kadrijaj"	SHFMU	Rastavicë	2700	2.30	15	1		
	Gjithsejtë			39746	40.83	463	20	2	9

Tabela 146. Institucionet arsimore, tipi, vendi, hapësirat, sipërfaqet dhe stafi

SHMU “Lidhja e Prizrenit” në Deçan është shkolla ndërtesa e të cilës ka sipërfaqen 4885 m^2 ,ndërsa SHMU “Kuvendi i Verrave të Llukës” në Llukë të Epërme, është shkolla me ndërtesën ma të vogël me gjithsejtë 480 m^2. Për nga sipërfaqja e hapësirë ne të cilën ndodhet ndërtesa e shkollës është në SHFMU “Faik Konica” në Ratish të Ulët e cila ka sipërfaqe prej 5.33 ha, ndërsa shkolla e cila ka hapësirën ma të vogël është SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Strellc i Ulët me gjithsejtë 0.19 ha.

Sa i përket institucioneve parashkollore ato janë prezentë në SHFMU “Drita”, Esad Mekuli”, “Ardhmëria”, “Bajram Curri”, “Dëshmoret e Kombit”, “Dëshmoret e Vokshit”, “Heronjtë e Dukagjinit”, “Isa Boletini”, “Jusuf Gërvalla”, “Kuvendi i Verrave të Llukës”, “Lan Selimi”, “Lidhja e Prizrenit”, “Maxhun Çekaj”, “Rexhep Kadrijaj”, “Sylë Alaj”, “Sylejman Vokshi”, “Faik Konica” dhe “Dëshmoret e Baballoqit”.

Për shkak të numrit të vogël për nxënësve, në shumë institucione parashkollore janë vetëm nga 1 edukatore përpos SHFMU “Lidhja e Prizrenit” ku janë 6 edukatore për shkak numrit të madh të nxënësve.

Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banorëve		Edukatore
Gramaqel	SHFMU " Drita "		1943 - 44		Gramaqel		1097		1
Vendbanimi	Fëmijëve me të drejte regjistrimi (nr.)		Nxënës të regjistruar (nr.)		Nxënës qe braktisen mësimet (nr.)		Nxënës qe përfunduan mësimet (nr.)		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Gramaqel	4	10	4	10	0	0	4	10	
	0	0	0	0	0	0	0	0	

Gjithsej	4	10	4	10	0	0	4	10	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Maznik	SHFMU " Esad Mekuli "		1968		Maznik		548		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	3	4	3	4	1	2	2	2	
	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	3	4	3	4	1	2	2	2	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banorëve		
Beleg Beleg	Ardhmëria		2000		Beleg - Kodrali - Pozhar		2058		
	M	F	M	F	M	F	M	F	1
	4	7	4	7	0	0	4	7	
Gjithsej	4	7	4	7	0	0	4	7	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banorëve		
Strellc i Epërm	SHFMU " Bajram Curri "		1975		Strellc i Epërm		4492		
Paralelja në Lëbushë					Lëbushë pjesërisht				
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Strellc i Epërm	14	24	14	24	0	0	14	24	
Paralelja në Lëbushë	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Gjithsej	14	24	14	24	0	0	14	24	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Strellc i Ulët	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"		05.12.2001		Strellc i Ulët		2114		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	12	7	12	7	0	0	12	7	
	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	12	7	12	7	0	0	12	7	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Pobergjë - Hulaj	SHFMU"Dëshmoret e Vokshit		2004		Pobergjë - Hulaj		1971		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	5	6	5	6	1	0	4	6	
	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	5	6	5	6	1	0	4	6	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banorëve		
Gllogjan	SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit "		1986 0 87		Gllogjan - Shaptej		1853		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	10	6	10	6	0	0	10	6	
	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	10	6	10	6	0	0	10	6	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Isniq	SHFMU "Isa Boletini "		1948		Isniq dhe Lëbushë		3879		
Lëbushë	Paralelja Lëbushë		2002				1145		
	M	F	M	F	M	F	M	F	2
Isniq	141	132	141	132	0	0	141	132	
Lëbushë	11	10	11	10	0	0	11	10	
Gjithsej	152	142	152	142	0	0	152	142	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Prapaqan	SHFMU "Jusuf Gërvalla "		1943		Prapaqan - Papiq		740		

Dubovik	Paralelja e ndarë		2002		Prapaqan - Dubovik		1060		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Prapaqan	7	8	7	8	0	0	7	8	1
Dubovik - Paralelja e ndarë	6	9	6	9	0	0	6	9	
Gjithsej	13	17	13	17	0	0	13	17	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Llukë e Epërme	SHFMU"Kuvendi i Verrave të Llukës"		2011		Llukë e Epërme		1451		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	8	4	8	4	0	0	8	4	1
	0	0	0	0	0	0	0	0	
Gjithsej	8	4	8	4	0	0	8	4	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Lumbardh	SHFMU "Lan Selimi"		1958		Lumbardh		1223		
Llukë e Ulët	Paralelja e ndarë		2006		Llukë e Ulët				
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Lumbardh	0	3	0	3	0	0	0	3	1
Llukë e Ulët	3	5	3	5	0	0	3	5	
Gjithsej	3	8	3	8	0	0	3	8	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Deçan	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"		1906		Deçan		7298		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Deçan - Carrabreg i Epërm & Poshtëm	423	512	423	512	7	3	416	509	6
	0	0	0	0	0	0	0	0	
Gjithsej	423	512	423	512	7	3	416	509	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Irzniq	SHFMU "Maxhun Çekaj"		1927		Irzniq - Prokolluk		2027		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	9	8	9	8	0	0	9	8	1
	0	0	0	0	0	0	0	0	
Gjithsej	9	8	9	8	0	0	9	8	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Rastavicë	SHFMU "Rexhep Kadrijaj "		1928		Rastavicë - Pemishtë - Baballoq		1238		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
	3	10	3	10	0	0	3	10	1
	0	0	0	0	0	0	0	0	
Gjithsej	3	10	3	10	0	0	3	10	
Vendbanimi	Emri i institucionit		Viti i themelimit		Lagja - zona gravituese		Numri i banoreve		
Drenoc	SHFMU "Sylë Alaj"		1999 -2000		Drenoc, Sllup		1046		
Voksh	Paralelja Voksh		2007 -2008		Voksh		570		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Drenoc	7	6	7	6	0	0	7	6	
Voksh	5	3	5	3	0	0	5	3	1
Gjithsej	12	9	12	9	0	0	12	9	
Isniq	Kulla e Mujë Mehmetit	/	3313	1925	0.1925
Isniq	Mulliri i Tahirsadrive	/	3180	1220	0.122
Isniq	Kulla e Sadik Ibishit	/	3405	1230	0.123
Isniq	Kulla e Sylë Tahirsylaj	/	4646	872	0.0872
Isniq	Kulla e Adem (Qerim) Osdautaj	/	1666	707	0.0707
Isniq	Kulla e Tafë (Hysen) Maksutaj	/	4782	525	0.0525
Pozharë	Xhamia e Pozharit	/	3170	2018	0.2018
Pozharë	Kulla e Demë Ali Pozharit	/	3151	90	0.09
Prokolluk	Mulliri i Beqir Halil Haxhosaj	/	964	15630	1.563
Drenoc	Xhamia e Drenocit	/	1371	7022	0.7022
Drenoc	Kompleksi i kullave në lagjen Mazrekaj	/	3314	225	0.0225
Drenoc	Kulla e Tahir Baqës	/	4140	881	0.0881
Llukë e Epërme	Mejtepi në fshatin Llukë e Epërme	/	1622	190	0.019
Llukë	Kulla e Ali Gecit	/	2055	32	0.0032
Llukë	Kulla e Florim Januz Gecaj	/	3585	1249	0.1249
Carrabreg	Xhamia e Carrabregut	/	1737	1258	0.1258
Irzniq	Kulla e Muhamet Dervish Çekaj	/	3167	1327	0.1327
Irzniq	Kulla e Zymer Fetës	/	3316	2406	0.2406
Irzniq	Mulliri i Sadik Berishës	/	1302	261	0.0261
Strellc i Ulët	Kulla e Shaban Murat Gjukaj	/	3149	2617	0.2617
Strellc i Epërm	Kulla e Bajram Qerim Istrefaj	/	4446	/	/
Strellc i Epërm	Kulla e Reshat Istrefaj	/	4447	199	0.0199
Strellc i Epërm	Shkolla e Parë Shqipe në Strellcin e Epërm	/	4786	12873	1.2873
Gllogjan	Kompleksi i Dëshmorëve	/	3150	8161	0.8161
Gllogjan	Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit	/	4440	/	/
Gllogjan	Kisha e Shën Ndout	/	375	/	/
Lëbushë	Qardaku i Azem Hamzë Ahmetaj	i rrënuar	1367	431	0.0431
Lëbushë	Xhamia e Lëbushës	/	1385	1003	0.1003
Dubovik	Kulla e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës	/	3211	/	/
Dubovik	Kulla e Donikë Jusuf Gërvallës	/	3584	3964	0.3964
Dubovik	Kulla e Hasan Mehmetit	/	4470	/	/
Voksh	Xhamia e Vokshit	/	2136	1890	0.189
Voksh	Kulla e Azem Ramë Lokaj	/	4614	/	/
Lumbardh	Kulla e Miftar Alisë	/	3315	1078	0.1078
Lumbardh	Kulla e Bajram Xhafer Lekaj	/	3527	/	/
Baballoq	Xhamia e Baballoqit	/	3169	1207	0.1207
Baballoq	Kulla e Hamzë Mataj	/	4132	875	0.0875
Rastavicë	Kulla e Gjyle Kadrijaj	/	3317	1161	0.1161
Rastavicë	Mulliri i Cufë Smajlit	/	/	553	0.0553
Pobergjë	Kulla e Himë Nimonit	/	4133	1063	0.1063

Pobergjë	Kulla e Haxhë Alisë	/	4174	/	/
Pobergjë	Kulla e Ali Jusuf Mataj	/	4134	997	0.0997
Gramaqel	Kulla e Ali Avdijaj	/	4148	998	0.0998
Gramaqel	Mulliri i Avdyl Zenel Jasiqi	/	1289	2205	0.2205
Lloqan	Kulla e Ramë Stojkaj	/	1408	368	0.0368
Hulaj	Mulliri Daut Osë Hulaj	/	1317	1896	0.1896
Carrabreg	Koshi i Drithit – Enver Likaj	/	4453	/	/
Broliq	Kulla e Ali Ozmonit	/	3212	/	/
Broliq	Mulliri i Avdyl Lulaj	/	4780	/	/
Isniq	Kulla e Rexhë Ibër Bala	/	3310	/	/
Kodrali	Tyrbja e Sadri Pepaj	/	1291	2432	0.2432
Gjithsejtë				9807.2	9.8702

Tabela 168. Trashëgimia arkitekturale - Monumentet arkitekturale, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Sa i përket nënkatoegorive kryesore të trashigimisë arkeologjike, në Komunën e Deçanit janë Murgorja e Zojës së Bekuar në Belle e cila është nga periudha e mesjetës dhe i mbrojtur me vendim, pastaj Fortifikimi i Antikitetit të Vonë në Strellc i Epërm e cila i takon periudhës së Antikës së vonë dhe ndodhet në fshatin Strellcë i Epërm, dhe lokaliteti arkeologjik në Rastavicë i cili i takon periudhes romake – antike të vonë. Monumnetet arkeologjike ne Komunen e Deçanit janë gjithësejtë 8 të tilla në Irzniq, Baballoq, Strellcë të Epërm, Rastavicë dhe Belle dhe kanë të bejnë me lokalitete, fortifikime dhe kala. Sa i përket pejsazheve kulutore, në Komunene e Deçanit janë Bliri në Rastavicë, Verrat e Llukës dhe Pishat e Decanit.

Trashëgimia arkeologjike, sipas nën - kategorive kryesore dhe shtrirjes hapësinore					
Njësia Kadastrale, Emri			Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
			I mbrojtur nr. Vendimit	I propozuar nr. Unik Data bazë	
Murgorja e Zonjës së Bekuar në Belle	Mesjetë	Belle - Deçan	Po	2837	
Fortifikim i Antikitetit të Vonë në Strellc	Antikë e vonë	Strellc i Epërm - Deçan		3504	
Lokaliteti arkeologjik në Rastavicë	Rastavicë	Romake - Antike e Vonë		3197	

Tabela 169. Trashëgimia arkeologjike, sipas nën - kategorive kryesore dhe shtrirjes hapësinore

Trashëgimia arkeologjike - Monumentet arkeologjike, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore					
Njësia Kadastrale, Emri			Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
			I mbrojtur nr. Vendimit	I propozuar nr. Unik Data bazë	
Lokaliteti i periudhës Romake ne Irzniq	Romake	Irzniq - Deçan		4196	
Lokalitet arkeologjik i periudhës Romake në Irzniq	Romake	Irzniq - Deçan		2995	
Tuma e vetmuar në Irzniq	Parahistori	Irzniq - Deçan		3234	
Fortifikim parahistorik	Parahistori	Baballoq - Deçan		3650	
Lokalitet arkeologjik parahistorik	Parahistori	Baballoq - Deçan		3235	
Fortifikim i antikitetit të vonë	Antikitet i vonë	Strellc i Epërm - Deçan		3233	
Lokalitet arkeologjik Romak	Romake Antikitet i vonë	Rastavicë - Deçan		3179	
Kalaja antike në Belle	Antikitet i vonë	Belle - Deçan		3164	

Tabela 170. Trashëgimia arkeologjike - Monumentet arkeologjike, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Peizazhet kulturore, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore					
Njësia kadastrale, Emri			Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
			I mbrojtur	I propozuar	
Bliri në Rastavicë	shek. XVIII	Rastavicë - Deçan		1516	
Verrat e Llukës	Parahistori	Llukë e Epërme - Deçan		3235	
Pishat e Deçanit		Deçan	1969		

Tabela 171. Peizazhet kulturore, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore

Deçani, ka asete të trashëgimisë kulturore të cilat janë pasuri e madhe për këtë Komunë të cilat në të ardhmen duhet të kalojën në dy faza e që kanë të bejën me mbrojtjen e tyre, konservimin dhe promovimin me synim të zhvillimit të sektorit të turizmit në të gjithë territorin e Komunës e që nënkupton se duhet të hartohen politikat e qarta lokale duke u bazuar në kornizen ligjore për mbrojtjen e trashigimisë kulturore, strategjitë e nivelit qendor, *Ligjin nr. Nr. 03/L-039 për Zonat e Vecanta të Mbrotjura, Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*

Analiza SWOT - Kultura, trashëgimia, fondi natyror dhe turistik	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Areali i bimëve endemike në Bjeshkët e Deçanit, - Fond i pasur dhe me diversitet me ndërtesa me vlera trashëguese, kulturore, shpirtërore dhe arkitektonike, - Strategjia lokale e zhvillimit te turizmit ne zonën Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", - Monumentet, - Shtigjet e ecjes dhe çiklizmit malor, - Shtigjet natyrore të skijimit, - Gastronomi tradicionale lokale, - Prezenca e hoteleve dhe bujtinave për përballimin e kapaciteteve të ndryshme turistike, - Hyrje e mirë në qytet dhe ndarje për zonën malore dhe rurale, - Festivalet vjetore, - Resurset natyrore, - Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumëbardhi i Lloqanit; - Zyra informuese turistike, - Bashkëpunimi ne nivel komunal me komuna fqinje dhe mike - Rruga Nacionale Deçan–Plavë R-108. - Dokumente të shkruara për trashëgimi kulturore, natyrore dhe monografi - Qendra informative turistike	- Buxheti i ulët komunal për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, - Ndërtimi pa kriter pranë zonave me vlera natyrore dhe kulturore, - Shtigjet e ecjes dhe çiklizmit malor nuk janë të rregulluara dhe të mirëmbajtura, - Mungesa e programeve – politikave promovuese të Deçanit në nivel nacional dhe ndërkombëtarë, - Mungesa e kapaciteteve hotelerisë dhe bujtinave - Mungesa e hulumtimeve arkeologjike Belle, Lumbardh, Prapaqan dhe vendbanime te tjera - Mungesa e investimeve në konservimin e ndërtesave të trashëgimisë kulturore; - Mungesa e investimeve për promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore; - Mungesa e digjitalizimit dhe rrjetëzimit të Zyrës Informuese turistike me qendrat tjera turistike.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Zhvillimi "Boshtit turistik, Deçan – Bjeshkët e Nemuna", - Mbështetje financiare për zhvillimin e "Etno lagjeve" ne pjesën perëndimore dhe lindore të komunës Deçanit, - Promovimi i Deçanit nëpërmes festivale të reja duke u bazuar në kulturën, traditën, argëtimin dhe rekreacionin, - Promovimi i imazhit të ri të Komunës Deçanit dhe ofertës turistike në takime, ngjarje ndërkombëtare kushtuar turizmit. - Ndërtesat e trashëgimisë kulturore të jenë në shërbim turistik në formë bujtina, gastronomi muze etnografike etj., Pikat për grumbullim,	- Katastrofat natyrore, - Dëmtimi i imazhit nga ndikimet politike dhe veprimet e dëmshme të izoluara, - Numri i pamjaftueshëm i kapaciteteve të akomodimit në hotel dhe kategorizimi i tyre, - Mungesa e mbështetjes nga niveli qendror. - Shpallja e mbi 50% të zonës së mbrojtur me planin e „Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna" do të ndikon ne kufizimin e zhvillimit ekonomik të Deçanit. - Mungesa e ligjeve për menaxhimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" - Ndërtimi i bujtinave me material të fortë ndërtimor; - Zhdukja e trashëgimisë materiale nga mungesa e investimeve për promovim,

paketim dhe tregtim të produkteve - bimëve mjekuese, - Përfshirja e me shumë festave tradicionale në agjendën zyrtare-institucionale, - Identifikimi i brendeve dhe promovimi i tyre (brendimi), - Zhvillimi i ofertës turistike dhe promovimi në nivel regjional dhe ndërkombëtar, - Ndërtimi i qendrave turistike në Bjeshkët e Deçanit, - Rrjetëzimin me qendrat turistike rajonale-hiking, ecja, alpinizëm, çiklizëm, kalërim etj.	- Dëmtimi i vazhdueshëm nga faktori natyror dhe njeri i trashëgimisë kulturore-kullave në Komunën e Deçanit, - Zhdukja e pasurive natyrore nga shfrytëzimi i pa kontrolluar , frutave të malit dhe bimëve mjekuese.

Tabela 172. SWOT analiza e aseteve për trashëgimi natyrore, kulturore dhe turizëm

3.7 Mbrojtja e mjedisit

3.7.1 Mjedisi

Mjedisi në Komunën e Deçanit ka përmirësime ne vitet e fundit si rezultat i administrimin të mbeturinave, pastrimin e deponive ilegale, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në pjesën rurale si dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese - shesheve dhe parqeve. Krahas veprimeve konkrete për rruajtjen e mjedisit, ekzistojnë shqetësime për humbjen e tokës bujqësore, mungesa e shtrirjes dhe trajtimi i ujerave të zeza në të gjithë vendbanimet, përdorimi automjeteve të vjetra, djegia e tokës pas korrjes, ngrohja me djegie, prerja e pa kontrolluar e pyjeve etj. Veprimtaritë të cilat kanë ndikim në ndotjen e mjedisit janë:

- Gurthyesit (gjithsejtë dy),
- Sharra të përpunimit të drurit (gjithsejtë 10),
- Seperacione (gjithsejtë 2) dhe
- Betoniera (gjithsejtë 3).

3.7.2 Ndotja e Ajrit

Ndotja e ajrit në Komunën e Deçanit vjen kryesisht nga rruga rajonale R107 e cila ka një fluks të madh ë qarkullimit të automjeteve, mirëpo në stinët ngrohta kur thatësira është evidente mirëpo edhe nga pakujdesia e banorëve, ndotja e ajrit rritet edhe nga djegiet. Përpos automjeteve dhe djegieve, ndotjen e ajrit e shkakton edhe sektori i ndërtimit në përgjithësi, si sektori privat ashtu edhe sektori publik. Mungesa e hapësirave publike si dhe degradimi i atyre ekzistues janë faktorë të cilët ndikojnë në rritjen e ndotjes së ajrit, andaj është shumë e rëndësishme që të merren masat e rritjes së hapësirave publike brenda vendbanimeve me synim te rritjes së cilësisë së ajrit. Për të monitoruar ndotjen e ajrit, në vendbanimin e Deçanit janë vendos 4 lokacione matëse, gjegjësisht:

- Te rruga R107 lokacioni te objekti afarist InterEX,
- Te rruga R107 lokacioni te lokali afarist Banana Split,
- Te sheshi Mentor Tolaj, dhe
- Në qendër të qytetit.

Sipas të dhënave të mbledhura, trendët e ndotjes së ajrit kanë luhatje nga muaji në muaj dhe nga pikat e caktuara ku është bërë matja.

Të njësia matëse afër objektit afarist InterEX, ne periudhën Korrik – Shtator 2023 në përgjithësi ka rritje të PM 2.5, PM 10, NO2 ndërsa O3 dhe SO2 kanë pas trendë të luhatjes në favor të uljes ndërsa CO ka pas trendë te luhatjes në favor të rritjes.

Situata te Sheshi Mentor Tolaj nuk është e mirë. PM 2.5 në këtë pjesë ka pas ne të njëjtën periudhë vetëm rritje ndërsa PM10 luhatje por me trendë negative. E njëjta situatë është edhe për NO2 dhe CO ndërsa O3 dhe SO2 kanë pas trendë pozitive drejt uljes së ndotjes.

Qendra e qytetit është ma kritike dhe pothuajse të gjitha substancat ndotëse përpos SO2 janë ne nivelet e larta. Qendra e qytetit është pika më se shumti frekuentohet nga banorët dhe vizitorët, andaj masat që duhet të merën në këtë pjesë të qytetit duhet të janë në favor të identifikimit të ndotësve dhe eliminimin e tyre.

Përpos qendrës së qytetit, pika me ndotjen ma të lartë është te pjesa e njohur e lokalit afarist Banana Split e cila të gjitha parametrat e substancave ndotëse i ka të lartë. Kjo është pjesa ku zhvillohet biznesi dhe rruga R107 dhe kjo konsiderohet si pika ma ndotëse e ajrit.

Sipas VSM-së të projekt PZHK-së, propozohen disa masa të cilat do të ndikojnë në rritjen e kualitetit të ajrit ne Komunën e Deçanit, ato janë:

- Që të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të shmanget dyndja e mjeteve transportuese në të njëjtën kohë, të evitohet kalimi I tyre në afërsi të zonave rezidenciale apo qendrës së qytetit sipas mundësive, të maksimizohet efiçienca e transportit.
- Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm I parametrave të kualitetit të ajrit, të shmangen aktivitetet që gjenerojnë ndotje jashtë vlerave të lejuara, aktivitetet ekzistuese t'i përmbahen rregulloreve për kualitetin e ajrit duke përdorur masa ose teknologji për parandalim të ndotjes ose trajtim eventual të ajrit dhe gazrave që emitohen. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të kualitetit të ajrit, të shmangen aktivitetet që gjenerojnë ndotje jashtë vlerave të lejuara, aktivitetet ekzistuese t'i përmbahen rregulloreve për kualitetin e ajrit duke përdorur masa ose teknologji për parandalim të ndotjes ose trajtim eventual të ajrit dhe gazrave që emitohen. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3.7.3 Ndotja e ujërave

Komuna e Deçanit ka arritur suksese ne kompletimin e rrjetit të ujësjellësit në nivel komunal. Përpos dy vendbanimeve ne të cilat nuk ka arrit të siguron furnizimin me ujë për shkak të terrenit të vështirë dhe numrit të vogël të banorëve. Krahas suksesit të furnizimit me ujë të pijshëm, rrejti i kanalizimit nuk është në gjendje të mirë. Rrejti në nivel të Komunës është i shpërndarë në masë deri 40% ndërsa shtrimi i tij konsiderohet si prioritet dhe në periudhën 8 vjeçare synohet te dyfishohet dhe të arrinë deri ne nivelin 80%. Njëjtë situata është edhe me rrjetin atmosferik i cili është i shpërndare vetëm në pjesët e vend banimit të Deçanit në masë 40% ndërsa planifikohet të mbulohet i gjithë territori deri ne 2035.

Hedhja e mbeturinave ne kanalet e hapura, procka dhe lumenj ka ndikim te madh ne ndotjen e ujërave. Gjithashtu përdorimi në mënyrë të pakontrolluar të pesticideve ka ndikuar në ndotjen e ujërave nëntokësorë e që si efekt negativ mjaft bunarë janë bërë të pashfrytëzueshme. Punimet dhe ndërtimet ne infrastrukturë të trafikut, teknike si dhe mungesa e reshjeve kanë ndikuar në lëvizjen e ujërave nëntokësor dhe si efekt negativ kanë ndikuar që ujërat e bunarëve te shteren. Mirëpo edhe përdorimi i ujë rrjedhave në mënyrë të pakontrolluar kanë ndikuar po ashtu pakësimin e ujit dhe ndotjen e tij. Këtu duhet të përmendet roli i hidrocentralit, fusha e bujqësisë, përdorimi nga NVM, eksplantimi i zhavorrit etj. Me eksplantimin e zhavorrit si efekt negativ janë rritur vërshimet dhe

përmbytjet e zonave të caktuara. Ky efekt zingjiror pastaj po ka dëme te mëdha ne ekonomitë familjare, bujqësinë dhe ne kualitetin e jetesës ne përgjithësi. Kostot e parandalimi të vërshimeve dhe përmbytjeve është shumë i madh. Kontrollimi i kualiteti të ujit është më se i domosdoshëm. Një rast i tillë me ujë të pijshëm ka ndodh ne vitin 2021, edhe pse ky rast nuk e ka përfundimin e saj, mirëpo është një tregues se kualiteti i ujit në përgjithësi duhet të monitorohet para se te përdoret për bujqësi, pastrim apo edhe pije për bagëtitë.

Zhvillimet e planifikuara në projekt PZHK mund të kanë ndikim negativ në kualitetin e ujit. Përkundër rritjes së mirëqenies banorë dhe kualitetit të jetese, zhvillimi i pakontrolluar i bujqësisë, turizmi, ndërtime, NVM, zonat ekonomie, prodhimtaria etj. mund të kanë ndikim negativ në ndotjen e ujit. Po ashtu, ndërtimi i pendave akumuluese të ujit do të ketë ndikim jo të mirë në biodiversitet, kualitetin e ajrit, ujit dhe tokës. Gjithashtu edhe ekosistemi do te ketë pasoja e sidomos gjate periudhës së ndërtimit. Shumë specie mund të zhduken nga pjesët e ndryshme dhe regjenerimit i tyre kërkon kohë. Sipas VNM-së janë propozuar masat të cilat janë të nevojshme për të ulur ndotjen e lumenjve, e ato janë:

- Kontrollimi i kualitetit të ujit dhe ndotësve të shkarkuar në ujë. Nëse ka materie tejet toksike, të krijohet një impiant I posaçëm për trajtimin e tyre.
- Masa gjatë ndërtimit të pendëve akumuluese me synim të minimizimit të dëmtimit të tokës, ujit ajrit si dhe në mbrojtjen e ekosistemit. Ne ketë pikë duhet të parandalohet ndotja e ujit gjatë ndërtimit dhe të behët menaxhimi i të gjitha mbeturinave ndërtimore.

3.7.4 Degradimi i tokës

Rritja e kualitetit të jetesës, nevoja për banim, mundësitë e hapjes së bizneseve të reja kanë ndikuar në rritjen e vendbanimeve në Komunën e Deçanit. Kjo rritje ka pas ndikim në humbjen e tokës kualitative bujqësore ndërsa nga ana tjetër më ndërtimet e reja ka erdh deri të zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara të cilat kanë ndikuar në degradimin e tokës. Përpos humbjes së sipërfaqeve të gjelbra, toka është degraduara edhe nga mbeturinat e shumta publike, të amvisërisë, bizneseve, mbeturinat industriale, varrezat e automjeteve, përdorimi në mënyrë të pakontrolluar të pesticideve, erozioni i tokës, eksploatimi i zhavorrit e cila pastaj është përcjellë me vërshime, përmbytje dhe rrëshqitje të dheut, gurthyesit dhe prerja jo legale e pyjeve.

Me këto veprime komuna e Deçanit, ka pësuar humbje të resurseve kualitative natyrore, ndërsa zhvillimi i turizmit, pendave për akumulimin e ujit, dhe pikat e mbeturinave vetëm do të ndikojnë ne degradimin e tokës. Andaj është më se e nevojshme se të gjitha veprimet e sipërpërmendura të behën ne mënyrë të kontrolluar dhe me sa ma pakë dëme anësore gjatë ndërtimit dhe operimit. Prandaj rekomandimet e VNM-së për projekt PZHK-në janë:

- Të analizohet terreni apo zona paraprakisht për të përcaktuar praninë e resurseve, të mbrohen tokat e pasura me resurse dhe të promovohet ri kultivimi apo rigjenerimi aty ku është e mundur. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor apo teknologjik, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Kontrollimi i pajisjeve dhe hapësirave ku shkarkohen materiet, të jenë hapësira të padepërtueshme, të sigurohet kualiteti I makinerive në përdorim.
- Përforcimi i zonave që paraqesin rrezik, shmangie e ndërtimit në ato zona.

Gjithashtu është e nevojshme që të punohet në rritjen e vetëdijesimit të banorëve për ti parandaluar dukuritë negative që kanë ndikim në degradimin e tokës e siç janë:

- Pesticidet dhe plehrat të përdoren në masën të caktuar;
- Ujërat e përdorura (ndotura) që përmbajnë lëndë të dëmshme duhet të trajtohen pastaj të shkarkohen në lumenjtë;

- Dhe më e rëndësishmja duhet rritur niveli i vetëdijes shoqërore mbi degradimin dhe ndotjen së tokës.

3.7.5 Zhurma

Kontribuuesi kryesor i ndotjes është Komunikacioni - Mungesë e mjeteve matëse dhe sistemit të monitorimit dhe e sistemit amortizues për zbutje të efektit të zhurmës në zonat e prekura - Mungesa e Planit të Veprimit dhe Hartës së Zhurmës.

Zhurma është njëra nga brengat e vazhdueshme në nivel të përgjithshëm ku Komuna e Deçanit, nuk ka Plan të Veprimit dhe Hartë për Zonat me Nivel të Zhurmës si dhe aparaturë përkatëse për matjen e nivelit të zhurmës, me të cilat obligohet sipas Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma Nr.02/L-102. Kontribuuesi kryesor ne ndotje akustike është trafiku gjegjësisht rruga R107 e cila e ndan vendbanimin e Deçanit në dy pjesë. Nivelet e zhurmës të matura me aplikacione te thjeshta tregojnë nivelin e lartë të zhurmës në pika e ndryshme të vendbanimit të Deçanit edhe pse ato në dukje të parë nuk konsiderohen të rrezikshme. Ndotja akustike është e lartë edhe gjatë ditës mirëpo edhe gjatë natës në periudha të caktuara e tejkalon nivelin e lejuar.

Gjatë matjeve të shpejta me aplikacione te thjeshta telefonike, rezulton se ne pikun e ditës e gjithë rruga R107 është me nivel deri 25% ma shumë se norma e lejuar gjatë ditës. Niveli i zhurmës ne pjesën qendër është 76.80 decibel ose 16.80 decibel ma e lartë se norma e lejuar prej 60 decibelëve. Ne zonat e banuara niveli i zhurmës është nen kufirin e 60 decibelëve (rreth 42 decibel) ndërsa në mbrëmje (ne ora 20:00) rruga R107 është mbi kufirin e 50 decibelëve (54.20 decibel). Mirëpo, për të pasur një gjendje reale të niveli të zhurmës, është e nevojshme që të vendosen matës në shumë pika të cilët e monitorojnë nivelin e zhurmës dhe të cilët në baza vjetore ofrojnë gjendjen reale gjatë periudhave te ndryshme ditore.

Andaj sipas VSM-së të projekt PZHK-së është e nevojshme që të merren masat për zbutjen e ndotjes akustike dhe sa ma parë të hartohet Planit të Veprimit dhe Hartës së Zhurmës. Me këtë dokument do të identifikohen zonat me ndotje të lartë akustike dhe caktimin e veprimeve konkrete për zbutjen dhe minimizimin e tyre për rritjen e kualitetit të jetesës për banorët. Sado që niveli i lartë i zhurmës nuk konsiderohet si pengues për banorët, duhet të cekët që sipas OSHB-së, ndotja akustike ka ndikim me pasoja negative në shëndetin mendor të banorëve.

3.7.6 Fatkeqësitë natyrore

Në këtë kapitull janë përfshirë të gjitha fatkeqësitë natyrore të cila kanë ndikim në Komunën e Deçanit. Disa nga ato janë befasuese dhe nuk mund të kontrollohen mirëpo disa fatkeqësi janë rezultat i veprimeve njerëzore dhe për të cilat mund të merren masat parandaluese. Komuna e Deçanit e ka hartuar Vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit[78].

Tërmetet – siç është cekur në pjesën e profilit pjesa verilindore, lindore dhe jugore janë pjesë ma të ndjeshme për nga tërmetet ne Komunën e Deçanit në krahasim me pjesën malore dhe kodrinore gjegjësisht pjesë veriperëndimore dhe perëndimore. Zona lindore në përgjithësi konsiderohet me deri në 7 shkallë të MCS ndërsa ajo perëndimore deri 6 shkallëve të MCS. Nuk ka të dhëna për zonat mikro- sizmike. Masat të cilat duhet të ndermirën në këtë drejtim janë kontrollimi i ndërtimeve të cilat duhet ti përshtaten të gjitha kritereve dhe ti përballojnë lëkundjet e tërmeteve si dhe është mjaft e rëndësishme të veprohet në drejtimin e:

[78] Plani i vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit, viti i miratimit 2010.

Fazës para tërmetit – vlerësimi i situatës dhe marrja e të gjitha masave përgatitore para se të ndodh një tërmet me pasoja.Fazës gjatë tërmetit - menaxhimi i situatës e me theks të veçantë edukimi i banorëve në rast të tërmeteve me pasoja.Fazës pas tërmetit - ofrimi i kujdesit shëndetësor, sigurimi i ujit të pijshëm dhe ushqimit, kujdesi ndaj popullatës së cenuar me theks te veçantë të sëmurët, të moshuarit, shtatzënat, personat me aftësi të kufizuara dhe mënjanimi aksidenteve, incidenteve apo konflikteve.

Vërshimet – janë dukuri të cilat kanë filluar të ndodhin ma shpesh në krahasim me dekadat e fundit. Andaj është më se e nevojshme të merren masat parandaluese të vërshimeve dhe përmbytjet e zonave. Janë dy periudha kryesore kur ndodhin vërshimet në periudha dimër – verë, kur ka reshje të mëdha të borës dhe shkrirja e shpejtë e borës për shkak te temperaturave të larta dhe periudha e vjeshtës për shkak të reshjeve të shiut.
Vërshimet shkaktohen kryesisht nga eksploatimi i zhavorrit në mënyrë të pakontrolluar ndërsa hedhja e mbeturinave ndikon mjaft në bllokimin e kanaleve, urave gjatë rritjes së nivelit të ujit dhe kjo rezulton me vërshime dhe përmbytje. Deri sa ne vitin 2011 ishin te vërshuar vetëm 1 ha, ne vitin 2012 rritja e përmbytjes nga vërshimet ka qene ne mase 33% gjegjeshit 1.5 ha. Gjendja e përmbytjeve nga vërshimet ishte stabile deri ne vitin 2023, kur 7 ha tokë ne Komunën e Deçanit janë përmbytur si rrjedhojë e vërshimeve. Pas analizimit të vërshimeve të vitit 2023 është erdh në përfundim se rrjedhja e ujit nga zonat malore drejt asaj fushore ne mënyrë të lirë ka shkaktuar përmbytje duke i cenuar zonat fushore siç janë: Strellc i Epërm-Behovci, që përshkon Isniq dhe Dubovik, Isniq - përroi i Sijakut dhe Selishtave, Përroi i Ukaj në Deçan, Lugu Davel në Carrabreg i Epërm, Lumëbardhi i Lloqanit që vërshon vendbanimet Baballoq dhe Jasiq i Ri, Përroi i Malit, që përshkon vendbanimet Prilep dhe Rastavicë.

Erozioni – është dukuri e cila ka filluar të përhapet ne në Komunën e Deçanit dhe është pasojë e eksploatimit të zhavorrit në lumenjve. Erozioni i shkaktuar ne lumenj i hap rrugë edhe vërshimeve dhe përmbytjeve duke ndikuar në një proces zingjiror ne dëme ekonomike, humbje në bagëti, teknikë dhe rendimente bujqësore. Vendet më të rrezikuara nga erozioni dhe vërshimet në komunën janë:
Fushat në lindje të Prilepit, Rastavicës, fusha Devoll e fshatit Baballoq, lagjet Regjaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel vërshohen nga lumi i Lloqanit;
Zonat nga Ura e Demës, duke përfshi fushat në veri të Deçanit, Llukë e Epërme dhe Ultë, Lumbardh, Kotradiq dhe Vranoci Vogël rrezikohen nga Lumëbardhi i Deçanit;
Sipërfaqet nga lagja Hajrizaj deri te Zalli Strellcit, Isniq (Lagja Bruqëve) dhe Dubovik vërshohen nga Përroi i Behovcit;
Pjesa veriore e fshatit Strellc i Epërm dhe aksi i magjistrales Strellc i Epërm - Lybeniq vërshohen nga Përroi i Durakuat.

Fatkeqësitë teknike teknologjike - Në Komunën e Deçanit, bizneset individuale në Deçan, janë të ndërtuara 16 pompa të karburanteve dhe 5 pompa me butan gaz. Kapacitet e deponive te këtyre karburanteve nuk kalojnë me tepër se 30m³. Bartja-transportimi i karburanteve bëhet përmes magjistrales Pejë-Gjakovë, rrugëve rajonale Llukë - Deçan, si dhe rrugëve tjera të fshatrave. Rreziku është edhe gjatë transportit ku mund të shkaktohet edhe shfaqja e zjarrit dhe shpërthimeve te ndryshme. Sipas shënimeve që posedon Komuna, nuk ka pasur ndonjë rast të shpërthimit të auto-cisternave apo ndezjes se tyre. Në Komunën e Deçanit, janë të identifikuara dy vende për grumbullim të hekurishteve dhe automjeteve të vjetra.
Gjatë luftës së fundit në Kosovë, rajoni i Dukagjinit, respektivisht zona e Koshares përfshirë edhe Komunat fqinje siç janë Deçani, Juniku dhe Gjakova kanë qenë cak i sulmeve ajrore nga forcat e Aleancës Veri atlantike – NATO kundrejt atyre pushtuese serbe. Pas përfundimit të luftës, nga UNEP[79]

[79] March.PDF (iaea.org)

është kryer vlerësim i mjedisit pas konfliktit në të gjithë territorin e Kosovës (5 -19 nëntor 2000) me theks te veçantë prezenca e uraniumit të varfëruar ne Kosovë. Në Komunën e Deçanit, janë identifikuar lokacione te cilat kanë rezultuar ma te ndotura nga mbetjet e luftës se fundit. Behet fjalë për fshatin Irzniq dhe Vranoc në të cilat janë kryer testet e tokës, ujit dhe teste tjera (prodhime te ndryshme nga kafshët) kanë rezultuar te pa ndotura ndërsa mbetjet e gjetura kanë qenë brenda normave të lejuara ose pothuajse të pandjeshme dhe pa ndikim ne në mjedis dhe jetën në përgjithësi. Mirëpo rekomandohet që në të ardhmen të vazhdohet me hulumtimet me synim të mbajtjes nën kontroll të gjendjes. Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet), në Komunën e Deçanit, nuk ka të evidentuar ndonjë sipërfaqe apo deponim të mbeturinave, që mund të kategorizohet si zonë me ndotje të lartë.

Rreziku nga zjarri – janë evidentë në pjesët e bjeshkëve, zonave të pyllëzuara si dhe në disa raste edhe disa ndërtesa individuale dhe zjarre fushore. Dëmet materiale nuk janë të vogla por nëse përfshihen edhe zjarret në pyje përfshinë një kosto shumë te madhe. Zjarret që janë paraqitur në male/bjeshkë dhe fusha dyshohet që janë shkaktuar nga pakujdesia e faktorit njeri. Sipas te dhënave, zjarret e vitit 2011 kane shkaktuar dëme ne 57 ha. Situata e atëhershme ishte vetëm një paralajmërim për rreziqet ne vijim e qe ne vitin 2012 u përfshinë 252.3 ha nga zjarri. Viti 2012 identifikohet edhe si viti i cili ka pas me se shumti dëme nga zjarri te cilat i kanë përfshi zonat malore. Ne vitin 2023, zjarret kanë përfshi rreth 50 ha të sipërfaqeve kryesisht te zonës malore.
Në përgjithësi në dekadën e fundit Komuna e Deçanit është goditur nga disa fatkeqësi natyrore të cila në të ardhmen mund të minimizohen me parandalimin e disa dukurive nga faktori njeri, rritjen e vetëdijesimit te banorët dhe realizimin e projekteve të cilat i parandalojnë këto dukuri.

Fatkeqësitë natyrore, sipas kategorive kryesore, 2011 - 2023									
Fatkeqësia	Sipërfaqja e afektuar (ha)					Trendët e rritjes / zvogëlimit			
	2011	2012	2017	2019	2023	2011 - 2012	2012 - 2017	2017 - 2019	2019 - 2023
Erozioni	0	0	0	0	3.5	0	0	0	0
Tërmetet	0	0	0	29394.00	0	0	0	0	0
Vërshimet	1	1.5	3	5	7	50	100	133.33	600
Rrëshqitjet	0	0	1	0	1.5	0	0	0	0
Zjarret pyjore	57	252.3	60	100	50	342.63	-320.5	66.66	-12.28

Tabela 173.Fatkeqësitë natyrore, sipas kategorive kryesore, 2011 – 2023

Përpos pikave të sipërpërmendura, mbrojtja e mjedisit sipas VNM-së së projekt PZHK-së, përfshijnë edhe disa fusha tjera siç është:

Biodiversiteti dhe peizazhet – ku humbja e sipërfaqeve të gjelbra është evidente dhe ka dëmtime të vegjetacionit gjatë ndërtimeve apo edhe operimeve. Gjithashtu është identifikuar edhe rrezikimi ose dëmtimi i mjedisit dhe peizazhit si pasojë e zhvillimit turistik, me zona rezidenciale rekreative dhe infrastrukturën përcjellëse. Andaj si masa propozohen krijimi i shiritave të gjelbra, parqeve, dendësimi i vegjetacionit dhe destinimi i sa ma shumë zonave të gjelbra, rikultivim dhe regjenerim të zonave të dëmtuara. Po ashtu, si masë propozohet zhvillimi i "eko turizmit" dhe turizmit të qëndrueshëm. Për ketë është e rëndësishme që për çdo zhvillim turistik të bëhet VNM sipas kërkesave të kornizës ligjore.

Trashëgimia kulturore dhe aspekti arkitekturore dhe vizual – ka të bëjë kryesisht me fazën e ndërtimit dhe restaurimit të trashëgimisë e cila mund të ketë ndikim negativ në mjedis. Ne këto raste ne varësi te llojit te restaurimit, rindërtimit, gërmimi apo konservimit lëshohem mjaft ndotës ndërtimore të cilët kanë ndikim negativ ne mjedis andaj ne ketë drejtim propozohen masat mbrojtëse të ujit, ajri dhe ndotjes nga zhurma.

Dendësia, shëndeti dhe nevoja për banim – kanë ndikim në ndotjen e mjedisit e sidomos në ajër, ujë dhe tonë mirëpo edhe nga zhurma dhe duhet të merren të gjitha masat gjatë procesit të planifikimit që këto burime të ndotjes së minimizohen dhe të zhduken në tërësi.

Faktorët socio ekonomik dhe turizmi – janë të rëndësishëm për rritjen e kualitetit të jetesës dhe mirëq3esnies së banorëve mirëpo krahas zhvillimit duhet të merren masat për parandalimin e ndotjes e sidomos me hapjen e NVM dhe lirimin e ujërave ndotës ne mjedis. Po ashtu edhe zhvillimi i turizmit duhet të jetë i kontrolluar në harmoni me kornizën ligjore dhe planet e miratuara për zonat e mbrojtura dhe me sa ma pak ndotja. Turizmi i sjell përfitimet ekonomike mirëpo mund të jetë edhe shkaktar kryesor për ndotjet toksike në mjedis, emetimit të gazrave, prishjen e pejsazheve dhe shqetësimin e faunës në përgjithësi.

Janë të nevojshme përdorimi i masave mbrojtëse siç janë kontrollimi dhe monitorimi i veprimtarive të reja/ekzistuese duke përforcuar rregulloret për grumbullim dhe depozitim/trajtim të mbeturinave me shtysa pozitive për ato biznese/sektorë që riciklojnë, kompostojnë, ripërdorin apo minimizojnë prodhimin në burim të mbeturinave. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kontrollimi i kualitetit të ujit dhe ndotësve të shkarkuar në ujë. Nëse ka materie tejet toksike, të krijohet një impiant i posaçëm për trajtimin e tyre. Marrja e masave siç parashihen në konceptin e "eko-turizmit" dhe turizmit të "qëndrueshëm". Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Të përdoren masa mbrojtëse aty ku ka mundësi, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të kualitetit të ajrit, të shmangen aktivitetet që gjenerojnë ndotje jashtë vlerave të lejuara, aktivitetet ekzistuese t'i përmbahen rregulloreve për kualitetin e ajrit duke përdorur masa ose teknologji për parandalim të ndotjes ose trajtim eventual të ajrit dhe gazrave që emitohen. Për secilin projekt të zhvillimit turistik dhe infrastrukturor, të bëhet VNM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Analiza SWOT - Mjedisi	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Lumenjtë Lumëbardhi i Deçanit dhe i Lloqanit, - Ajri i pastër - Menaxhimi koordinues për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësitë Teknologjike, - Vetëdijesimi për potencialet mjedisore – përfitimet sociale edhe ekonomike.	- Degradimi i shtretërve të lumenjve-alovialeve, - Mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe mostrajtimi i ujërave të zeza, - Mungesa e zyrtareve komunal që trajtojnë aspektet mjedisore, - Mungesë e vullnetit politik për mbrojtjen e mjedisit si rezultat i buxhetit te vogël dhe rritjes së çmimeve, - Efektet ne mbrojtjen e mjedisit janë të ngadalshme ose veprohet pas pasojave, - Shumë pak organizime – aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit në krahasim me potencialet që i ka Komuna e Deçanit. - Automjetet e vjetruara lëshojnë CO2 në mënyrë të pa kontrolluar, - Ndotja akustike në zonën urbane.
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Përfshirja e vlerësimit të rrezikut në plane zhvillimore; - Zhvillimi dhe koordinimi i sistemit të hershëm të paralajmërimit për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësitë Teknologjike, - Zbatimi i kritereve miqësore në ndërtim, - Zbatimi i programeve të efiqences së energjisë, - Zbatimi i energjisë së ripërtritshme, - Ulja e ndotjeve në tokë, ujë dhe ajër, nëpërmes kontrollit dhe inspektimeve, -	- Vërshimet, - Erozioni, - Zjarret, - Tërmetet, - Ndotja e ajrit nga mjetet e motorizuara, - Ndotja e ujit e derdhjes ne mënyrë të pa kontrolluara të mbetjeve të ndryshme dhe ujërave të zeza, - Ndotja nga plastika, - Ndotjet aksidentale, - Humbja – mungesa e ujit

	- Humbja e llojeve të vegjetacionit, - Rreziku i gështenjës nga sëmundjet e ndryshme, - Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet (urbanizimi i pakontrolluar), - Ndërtimi i pakontrolluar në zonat malore, - Inspektimi i punës së hidro - elektranave, - Konfliktet e krijuara nga politikat e nivelit lokal dhe atij qendror (mungesë e sinkronizimit të politikave).

Tabela 174. SWOT analiza për mjedis

3.8 Vendbanimet

Vendbanimet në Komunën e Deçanit është e ndarë në vendbanimet formale dhe jo formale. Vendbanimet formale janë vendbanimet formale urbane, vendbanimet formale rurale, Ne kuadër të vendbanimeve joformale janë gjithsejtë 8 vendbanime të tilla. Deçani është qendër administrative dhe politike për gjithë komunën. Ne këtë vendbanim funksionon administrata komunale, strukturat udhëheqëse dhe politike, shërbimet kryesore shëndetësore, agjencionet, institucionet rajonale etj. Përpos Deçanit, ekzistojnë edhe tre zyra tjera të vendit në Strellc i Epërm , Drenoc (Polana), ofrojnë shërbimet për qytetarë ndërsa Zyra e Gjendjes Civile në fshatin Irzniq, nuk është në funksion kurse shërbimet për këtë rajon ofrohen në objektin e Komunës së Deçanit.

Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë në 2011				
Vendbanimet	Tipi (Urban/ Rural)	Banor (nr.)	Sipërfaqe (km²)	Dendësia (nr./km²)
Baballoq	Rural	1598	5.07	315
Beleg	Rural	826	2.25	367
Carrabreg i Epërm + Carrabreg i Ulët	Rural	3505	6.04	580
Dashinoc	Rural	299	7.56	40
Deçan	Urban	3793	28.29	134
Drenoc	Rural	1046	5.57	188
Dubovik	Rural	1060	3.22	329
Dubravë + Shaptej	Rural	869	4.24	205
Gllogjan	Rural	984	6.45	153
Gramaqel	Rural	1097	4.54	242
Irzniq + Prokolluk	Rural	2027	6.14	330
Isniq + Belle + Pleqe	Rural	3879	69.49	56
Kodrali	Rural	808	2.66	304
Lëbushë	Rural	1145	3.32	345
Lloqan + Hulaj	Rural	657	21.38	31
Llukë e Epërme	Rural	1451	2.45	592
Llukë e Ulët + Lumbardhë	Rural	1223	5.34	229
Maznik+ Vranoc i Vogël	Rural	548	8.96	61
Papiq	Rural	174	1.04	167
Pobergjë	Rural	1314	15.51	85
Pozhar	Rural	424	1.79	237
Prapaqan	Rural	740	3.69	201
Prilep	Rural	2165	5.38	402
Rastavicë	Rural	1238	3.47	357
Ratish i Epërm	Rural	210	1.76	119
Ratish i Ulët	Rural	560	4.02	139
Sllup	Rural	338	1.05	322
Strellc i Epërm	Rural	3347	22.23	151
Strellc i Ulët	Rural	2114	4.55	465
Voksh	Rural	570	4.25	134
Irzniq II (zonë kadastrale nuk është vendbanim)	Rural	0	32.26	0
Gjithsejtë		40019	293.97	136 banorë / km²

Tabela 175. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë në 2011

Duke u bazuar në numrin e banorëve në vitin 2011, në Komunën e Deçanit llogaritet se ka 136 banorë për km². Dendësia ma e madhe është ne Carrabreg të Epërm dhe Carrabreg të Ulët me 580 banorë për km² ndërsa ma e ulëta është në Lloqan dhe Hulaj me 31 banorë për km². Në vendbanimin Deçan dendësia është 134 banorë për km² mirëpo duhet të merret parasysh se 21 % e territorit të vendbanimit Deçan është pjesë malore me pyje, Park Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur andaj llogaritjet e zonës së ndërtuar është afërsisht 331 banorë për km². Vendbanimet në Komunën e Deçanit, bazuar në U.A 08/2017 klasifikohen në disa grupe të madhësisë sipas numrit:

- Te banorëve:
  - Vendbanim shumë i vogël rural deri 200 banorë;
  - Vendbanimet e vogla rurale deri 500 banorë;
  - Vendbanimet e mesme rurale 500 -1000 banorë;
  - Vendbanimet e mesme te mëdha rurale 1000 – 2500 banorë;
  - Vendbanimet i mesëm rural 2000 - 5000 banorë;

- Funksioneve themelore:
  - Qendër Komunale

Numrin ma të madh e përbejnë vendbanimet e mesme të mëdha rurale nga 1000 – 2500 banorë gjithsejtë 12 të tilla ndërsa më se paku ka vendbanim shumë i vogël rural deri 200 banorë me gjithsejtë 1 të tillë.

Vendbanimet në Komunën e Deçanit	Numri i vendbanimeve
Vendbanim shumë i vogël rural deri 200 banorë;	1
Vendbanimet e vogla rurale deri 500 banorë;	4
Vendbanimet e mesme rurale 500 - 1000 banorë;	9
Vendbanimet e mesme te mëdha rurale 1000 – 2500 banorë;	12
Vendbanimet i mesëm rural 2500 - 5000 banorë;	4
Qendër Komunale	1
Vendbanime me karakter joformal	5

Tabela 176. Llojet e vendbanimeve në 2023

Vendbanimi i Deçanit sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 kishte 3792 banorë ndërsa sipas vlerësimeve të viti 2021 kishte 4027 banorë ndërsa në vitin 2022 kishte 4052 banorë. Duke e ndjekur ketë trend të rritjes së popullsisë supozohet se në vitin 2023 vendbanimi i Deçanit ka 4078 banorë. Duke i marr parasysh këto të dhëna rezulton se në vitin 2011 në vendbanimin e Deçanit kishte gjithsejtë 134 banorë për km², në vitin 2021 kishte 142 banorë për km² dhe në 2022 kishte 143 banorë për km². Sipas supozimit të vlerësimit të numri të banorëve në vitin 2023 vendbanimi i Deçanit kishte 144 banorë për km². Duke ju referuar Normave teknike për planifikim hapësinorë rezulton se në bazë të numrit të banorëve për km², vendbanimi i Deçanit mund te kategorizohet si Sipërfaqe urbane e përgjithshme (NTPH pika 1.5. Sipërfaqe urbane e përgjithshme) e cila i ka disa vlera optimale të planifikimit siç janë:

1. Numri maksimal i kateve 3 - 7
2.Vlera maksimale e (ISHPKZh): 50 - 70%
3.Vlera bazë e (ISN) 2.5
4.Vlera maksimale e (ISN) 4.0
5.Dendësia e banimit: 105 - 200 banorë/ha

Në Komunën e Deçanit janë të identifikuara gjithsejtë 5 vendbanime joformale të ndara në 8 lokacione. Të gjitha këto vendbanime janë në zonat rurale. Nga këto vendbanime vetëm 2 të tilla janë në prona private ndërsa dy të tjera janë në pronë komunale kurse 4 të tjera janë zona rurale në pronë shoqërore. Të gjitha këto vendbanime joformale kanë qasje në infrastrukturën e shërbimeve sociale, publike, transportit dhe teknike. Sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimeve joformale është 64.81 ha me gjithsejtë 247 ndërtesa individuale dhe 1137 banorë.

Vendbanimet joformale Baballoq 1, Baballoq 2 janë vendbanime të cilat janë të ndërtuara në prona komunale dhe statusi i tyre pronësor dhe juridik nuk është i qartë. Gramaqeli, Shaptej, Gllogjani dhe Irzniqi (disa pjesë nga këto vendbanime) janë në prona shoqërore dhe po ashtu kanë probleme më aspektin pronësor dhe juridik. Ndërsa vendbanimet në Kodrali dhe Bohriqe janë të zhvilluara në prona private të cilat kanë probleme me çështjen pronësore dhe juridike dhe janë ndërtuar nën standarde të ndërtimit.

Vendbanimet joformale										
Lokacioni	Urban Rural	Pronësia	Lloji i banimit	Qasje ne infrastrukturë dhe shërbime				Interesi	Sipërfaqe në ha	Ndërtesa
				Sociale	Publike	Transportit	Teknike			
Baballoq 1	Rural	Komunale	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	21.93	160
Baballoq 2	Rural	Komunale	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	11.85	40
Gramaqel	Rural	Shoqërore	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	2.02	15
Shaptej	Rural	Shoqërore	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	1.53	5
Gllogjan	Rural	Shoqërore	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	0.84	5
Irzniq	Rural	Shoqërore	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	0.88	5
Kodrali	Rural	Private	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	7.01	11
Bohriqe	Rural	Private	Banim individual	Po	Po	Po	Po	Afat gjatë	18.75	6

Tabela 177. Vendbanimet joformale në 2023

Bazuar në të dhënat e ASK-së, në Komunën e Deçanit sipas regjistrimit zyrtarë (të vitit 2011) janë 40019 banorë, ndërsa për vitin 2021, vlerësimi është 42490, parashikimi i rritjes së popullsisë deri në vitin 2031 është 45200 banorë.

	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Projeksioni i popullsisë	40,019	42,754	43,019	43,286	43,554	43,824	44,096	44,369	44,644	44,921	45,200
Projeksioni i shtimit vjetor	2,735	265	267	268	270	272	273	275	277	279	0

Tabela 178. Projeksionet e popullsisë me banorë rezident në Komunën e Deçanit

Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve të Komunës se Deçanit duke i marr parasysh vlerësimet e trendëve të rritjes së popullsisë rezidente dhe pa i marr parasysh banorët jo rezident dhe mërgimtarët janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme.

Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve												
Vendbanimi	**2011**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**	**2031**
Baballoq	1598	1697	1707	1718	1729	1739	1750	1761	1772	1783	1794	1805
Beleg	826	877	882	888	893	899	905	910	916	922	927	933
Belle	8	8	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9
Carrabreg i Epërm	1446	1535	1545	1554	1564	1574	1584	1593	1603	1613	1623	1633

Carrabreg i Ulët	2059	2186	2200	2213	2227	2241	2255	2269	2283	2297	2311	2326
Dashinoc	299	317	319	321	323	325	327	329	332	334	336	338
Deçan	3793	4027	4052	4078	4103	4128	4154	4180	4205	4232	4258	4284
Drenoc	1046	1111	1118	1124	1131	1138	1146	1153	1160	1167	1174	1181
Dubovik	1060	1126	1132	1140	1147	1154	1161	1168	1175	1183	1190	1197
Dubravë	278	295	297	299	301	303	304	306	308	310	312	314
Gllogjan	984	1045	1051	1058	1064	1071	1078	1084	1091	1098	1105	1111
Gramaçel	1097	1165	1172	1179	1187	1194	1201	1209	1216	1224	1231	1239
Hulaj	158	168	169	170	171	172	173	174	175	176	177	178
Irzniq	1739	1846	1858	1869	1881	1893	1904	1916	1928	1940	1952	1964
Isniq	3871	4110	4136	4161	4187	4213	4239	4266	4292	4319	4345	4372
Kodrali	808	858	863	869	874	879	885	890	896	901	907	913
Lëbushë	1145	1216	1223	1231	1239	1246	1254	1262	1270	1277	1285	1293
Lumbardh	717	761	766	771	776	780	785	790	795	800	805	810
Lloqan	499	530	533	536	540	543	546	550	553	557	560	564
Llukë e Epërme	1451	1541	1550	1560	1570	1579	1589	1599	1609	1619	1629	1639
Llukë e Ulët	506	537	541	544	547	551	554	558	561	565	568	572
Maznik	447	475	478	481	484	487	490	493	496	499	502	505
Papiq	174	185	186	187	188	189	191	192	193	194	195	197
Pobergjë	1314	1395	1404	1413	1421	1430	1439	1448	1457	1466	1475	1484
Pozhar	424	450	453	456	459	461	464	467	470	473	476	479
Prapaqan	740	786	791	796	800	805	810	815	820	826	831	836
Prokolluk	288	304	306	308	310	312	314	315	317	319	321	323
Prilep	2165	2299	2313	2327	2342	2356	2371	2386	2400	2415	2430	2445
Rastavicë	1238	1315	1323	1331	1339	1347	1356	1364	1373	1381	1390	1398
Ratish i Epërm	210	223	224	226	227	229	230	231	233	234	236	237
Ratish i Ulët	560	595	598	602	606	609	613	617	621	625	629	633
Sllup	338	359	361	363	366	368	370	372	375	377	379	382
Strellc i Epërm	3347	3554	3576	3598	3620	3643	3665	3688	3711	3734	3757	3780
Strellc i Ulët	2114	2245	2259	2273	2287	2301	2315	2329	2344	2358	2373	2388
Shaptej	591	628	631	635	639	643	647	651	655	659	663	668
Voksh	570	605	609	613	617	620	624	628	632	636	640	644
Vranoc i Vogël	111	118	119	119	120	121	122	122	123	124	125	125
Gjithsejtë	**40,019**	**42,490**	**42,754**	**43,019**	**43,286**	**43,554**	**43,824**	**44,096**	**44,369**	**44,644**	**44,921**	**45,200**

Tabela 179. Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve

Dendësia e banorëve sipas projeksioneve të rritjes së numrit të banorëve rezident do të jetë 267 banorë për km². Ne qoftë se i referohemi trendëve të banoreve rezident si dhe banoreve jo rezident duke marr parasysh edhe kthimin e mërgimtarëve në vendlindje, si dhe duke u bazuar në kërkesën e rritur për banim, projeksionet e popullsisë deri ne vitin 2031 do të jetë 47873 banorë.

	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Projeksioni i popullsisë	42490	43,000	43,516	44,038	44,567	45,102	45,643	46,191	46,745	47,306	47,874
Projeksioni i shtimit vjetor	510	516	522	529	535	541	548	554	561	568	0

Tabela 180. Projeksionet e popullsisë (me banorë rezident, jo rezident dhe mërgimtarët)

Projeksioni i numrit të banorëve rezident, jo rezident, kthimi i mërgimtarëve dhe kërkesa banim deri ne vitin 2031 është 47873 banorë e cila do të jetë edhe pikë orientuese e zhvillimit të Komunës së Deçanit në 8 vitet e ardhshme.

Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve me banorë rezident, jo rezident dhe mërgimtarë												
Vendbanimi	**2011**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**	**2031**
Baballoq	1598	1697	1717	1738	1759	1780	1801	1823	1845	1867	1889	1912
Beleg	826	877	888	898	909	920	931	942	953	965	976	988
Belle	8	8	9	9	9	9	9	9	9	9	9	10
Carrabreg i Epërm	1446	1535	1554	1572	1591	1610	1630	1649	1669	1689	1709	1730
Carrabreg i Ulët	2059	2186	2212	2239	2266	2293	2321	2348	2377	2405	2434	2463
Dashinoc	299	317	321	325	329	333	337	341	345	349	353	358
Deçan	3793	4027	4076	4125	4174	4224	4275	4326	4378	4431	4484	4538
Drenoc	1046	1111	1124	1137	1151	1165	1179	1193	1207	1222	1237	1251
Dubovik	1060	1126	1139	1153	1167	1181	1195	1209	1224	1238	1253	1268
Dubravë	278	295	299	302	306	310	313	317	321	325	329	333
Gllogjan	984	1045	1057	1070	1083	1096	1109	1122	1136	1149	1163	1177
Gramaqel	1097	1165	1179	1193	1207	1222	1236	1251	1266	1281	1297	1312
Hulaj	158	168	170	172	174	176	178	180	182	185	187	189
Irzniq	1739	1846	1869	1891	1914	1937	1960	1983	2007	2031	2056	2080
Isniq	3871	4110	4160	4209	4260	4311	4363	4415	4468	4522	4576	Në
Kodrali	808	858	868	879	889	900	911	922	933	944	955	967
Lëbushë	1145	1216	1230	1245	1260	1275	1290	1306	1322	1337	1354	1370
Lumbardh	717	761	770	780	789	799	808	818	828	838	848	858
Lloqan	499	530	536	543	549	556	562	569	576	583	590	597
Llukë e Epërme	1451	1541	1559	1578	1597	1616	1635	1655	1675	1695	1715	1736
Llukë e Ulët	506	537	544	550	557	564	570	577	584	591	598	605
Maznik	447	475	480	486	492	498	504	510	516	522	528	535
Papiq	174	185	187	189	191	194	196	198	201	203	206	208
Pobergjë	1314	1395	1412	1429	1446	1463	1481	1499	1517	1535	1553	1572
Pozhar	424	450	456	461	467	472	478	484	489	495	501	507
Prapaqan	740	786	795	805	814	824	834	844	854	864	875	885
Prokolluk	288	304	308	311	315	319	323	327	330	334	338	343
Prilep	2165	2299	2326	2354	2383	2411	2440	2469	2499	2529	2559	2590
Rastavicë	1238	1315	1330	1346	1362	1379	1395	1412	1429	1446	1463	1481
Ratish i Epërm	210	223	226	228	231	234	237	240	242	245	248	251
Ratish i Ulët	560	595	602	609	616	624	631	639	646	654	662	670
Sllup	338	359	363	368	372	376	381	386	390	395	400	404
Strellc i Epërm	3347	3554	3596	3640	3683	3728	3772	3818	3863	3910	3957	4004
Strellc i Ulët	2114	2245	2272	2299	2326	2354	2383	2411	2440	2469	2499	2529
Shaptej	591	628	635	643	650	658	666	674	682	690	699	707
Voksh	570	605	612	620	627	635	642	650	658	666	674	682
Vranoc i Vogël	111	118	119	121	122	124	125	127	128	130	131	133
Gjithsejtë	**40,019**	**42,490**	**43,000**	**43,516**	**44,038**	**44,567**	**45,102**	**45,643**	**46,191**	**46,745**	**47,306**	**47,874**

Tabela 181. Projeksioni i popullsisë sipas vendbanimeve me banorë rezident, jo rezident dhe mërgimtarë

Sipas projeksioneve të rritjes së numrit të banorëve ne Komunën e Deçanit duke e marrë parasysh banorët rezident, banorët jo rezident dhe kthimin e mërgimtarëve do të ketë 272 banorë për km².

Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë ne vitin 2011, i planifikuar me banore rezident, jo rezident dhe mërgimtar ne vitin 2031 dhe dendësia për m²								
Vendbanimet	Tipi	Banor (nr.)	Sipërfaqe (km²)	Dendësia (nr./km²)	Projeksioni i popullsisë rezidente 2031	Dendësia (nr./km²)	Projeksioni i popullsisë rezidente 2031	Dendësia (nr./km²)
Baballoq	Rural	1598	5.07	315	1805	356	1912	377
Beleg	Rural	826	2.25	367	933	415	988	439
Carrabreg i Epërm , Carrabreg i Ulët	Rural	3505	6.04	580	3959	655	2463	408
Dashinoc	Rural	299	7.56	40	338	45	358	47
Deçan	Urban	3793	28.29	134	4284	151	4538	160
Drenoc	Rural	1046	5.57	188	1181	212	1251	225
Dubovik	Rural	1060	3.22	329	1197	372	1268	394
Dubravë + Shaptej	Rural	869	4.24	205	982	232	1040	245
Gllogjan	Rural	984	6.45	153	1111	172	1177	182
Gramaqel	Rural	1097	4.54	242	1239	273	1312	289
Irzniq + Prokolluk	Rural	2027	6.14	330	2287	372	2423	395
Isniq + Belle + Pleqe	Rural	3879	69.49	56	4381	63	4641	67
Kodrali	Rural	808	2.66	304	913	343	967	364
Lëbushë	Rural	1145	3.32	345	1293	389	1370	413
Lloqan , Hulaj	Rural	657	21.38	31	1803	84	786	37
Llukë e Epërme	Rural	1451	2.45	592	1639	669	1736	709
Llukë e Ulët , Lumbardhë	Rural	1223	5.34	229	1382	259	1463	274
Maznik+ Vranoc i Vogël	Rural	548	8.96	61	630	70	668	75
Papiq	Rural	174	1.04	167	197	189	208	200
Pobergjë	Rural	1314	15.51	85	1484	96	1572	101
Pozhar	Rural	424	1.79	237	479	268	507	283
Prapaqan	Rural	740	3.69	201	836	227	885	240
Prilep	Rural	2165	5.38	402	2445	454	2590	481
Rastavicë	Rural	1238	3.47	357	1398	403	1481	427
Ratish i Epërm	Rural	210	1.76	119	237	135	251	143
Ratish i Ulët	Rural	560	4.02	139	633	157	670	167
Sllup	Rural	338	1.05	322	382	364	404	385
Strellc i Epërm	Rural	3347	22.23	151	3780	170	4004	180
Strellc i Ulët	Rural	2114	4.55	465	2388	525	2529	556
Voksh	Rural	570	4.25	134	644	152	682	160
Irzniq II (zonë kadastrale nuk është vendbanim)	Rural	0	32.26	0	0	0	0	0
Gjithsejtë		40019	294	136	45200	267	47874	272

Tabela 182. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë ne vitin 2011, i planifikuar me banore rezident, jo rezident dhe mërgimtar ne vitin 2031 dhe dendësia për m²

Sipas projeksioneve të rritjes së popullsisë deri në vitin 2031 me banorë rezident Deçani si sipërfaqe urbane e përgjithshme do të ketë rritje të numrit të banorëve dhe njëkohësisht do të ketë rritje të numrit të banorëve për km² gjegjësisht 151 banorë/km², ndërsa me banorë rezident, jo rezident dhe kthimin e mërgimtarëve, Deçani do të ketë 160 banorë/km². Me këto projeksione shihet se Deçani edhe në vitin 2031 do të jetë sipërfaqe urbane e përgjithshme.

3.9 Banimi

Banimi në Komunën e Deçanit karakterizohet me ndërtime të ulëta me një tendencë të rritjes së etazhitetit ne dhjetë vitet e fundit. Shtëpitë karakterizohen me një apo ma shumë familje ose siç njihet jetesa në bashkësi. Pas luftës në Kosovë, tendencat e banimit kanë ndryshuar duke krijuar njësi te reja banimi për një familje dhe gradualisht duke u ndarë nga të jetuarit në bashkësi. Kjo tendencë e ka rritur nevojën për banim, ndërsa vërehet shtimi i ndërtesave të banimit ne një pronë e që është dukuri e theksuar ne zonat rurale por edhe rritja e dendësisë së banorëve me ndërtesa shumë banesore e që është dukuri e theksuar në zonën urbane. Kjo tendencë është gjithnjë e në rritje dhe ka ndikim të drejt për drejtë në migrimin e brendshëm rural – urban.

Bazuar në të dhënat e sektorëve Komunal, kërkesa për banim ne zonën urbane është duke u rritur gjithnjë e ma shumë. Kërkesat janë rritur edhe nga diaspora të cilët për nga mënyra e re të banuarit ne vendet e ndryshme të BE-së, kërkojnë kushte te njëjta të banimit edhe në Deçan, gjegjësisht ndarje nga të banuarit në bashkësi. Siç u cek ma lartë banimi në Komunën e Deçanit dominohet nga ai individual - te veçuara me 6376 të tilla ose 167.68 ha. Ndërtesat ose blloqe apartamentesh janë 353 ose 2.99 ha dhe shumë pak objekte rezidenciale tjera të cilat janë gjithsejtë 52 të tilla ose 0.47 ha. Më se shumti janë ndërtesa individuale ndodhen ne zonën urbane gjegjësisht ne Deçan me 1094 dhe më se paku janë në Ratish të Epërm me 41 njësi banimi individual.

Sipas projeksioneve te zhvillimit të banimit ne 8 vitet e ardhshme planifikohet që të ketë rritje të kërkesave për banim ku kërkesat ma të mëdha do të janë ne zonën urbane të përgjithshme të Deçanit dhe pastaj vendbanimet tjera siç janë Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Strellci i Epërm, Isniq etj. Më se shumti do të ketë kërkesa për banime individuale pothuajse në të gjitha vendbanimet si urbane dhe ruralë ndërsa kërkesa për banime kolektive do të jetë kryesisht në Deçan dhe një pjesë të Isniqit.

Vendbanimet	Ndërtesat e banimit individuale dhe kolektive- numri i njësive					
	Banorë	Individuale 2011	Kolektive	Banorë	Individuale 2011	Kolektive
Baballoq	1598	226	0	1912	238	0
Beleg	826	114	0	988	122	0
Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm	3505	720	0	2463	727	0
Dashinoc	299	76	0	358	84	0
Deçan	3793	1094	25	4538	1118	67
Drenoc	1046	313	0	1251	321	0
Dubovik	1060	156	0	1268	164	0
Dubravë, Shaptej	869	148	0	1040	156	0
Gllogjan	984	150	0	1177	158	0
Gramaqel	1097	217	0	1312	225	0
Irzniq & Prokolluk	2027	410	0	2423	422	0
Isniq & Belle & Pleqe	3879	899	0	4641	911	0
Kodrali	808	146	0	967	154	0
Lëbushë	1145	210	0	1370	218	0
Lloqan & Hulaj	657	214	0	786	222	0
Llukë e Epërme	1451	217	0	1736	225	0
Llukë e Ulët & Lumbardh	1223	229	0	1463	237	0
Maznik & Vranoc	548	111	0	668	120	0
Papiq	174	50	0	208	58	0
Pobergjë	1314	339	0	1572	351	0
Pozhar	424	65	0	507	73	0
Prapaqan	740	131	0	885	139	0

Prilep	2165	365	1	2590	377	1
Rastavicë	1238	198	0	1481	206	0
Ratishë i Epërm	210	41	0	251	49	0
Ratishë i Ulët	560	42	0	670	50	0
Sllup	338	60	0	404	68	0
Strellc i Epërm	3347	740	0	4004	752	0
Strellc i Ulët	2114	474	0	2529	482	0
Voksh	570	166	0	682	174	0
Gjithsejtë	40019	8321	26	46144	8608	68

Tabela 183. Ndërtesat e banimit individuale dhe kolektive - numri i njësive

3.9.1 Programet e veçanta të banimit

Buxheti komunal ne vitet në dy dekadat e fundit ka treguar se Komuna e Deçanit nuk mundet ti zhvillon politikat e veçanta të banimit. Vështirësitë ne ketë drejtim e benë edhe fakti se komuna nuk posedon fond të madh të pronës komunale ne të cilën mund të planifikon programe të veçanta të banimit. Mbi gjitha zona urbane e përgjithshme e Deçanit nuk ka pothuajse fare prona komunale ndërsa pronat të cilat janë potencial për zhvillimin e programeve të tilla janë në zona të caktuara rurale dhe malore ku prioritet janë zhvillimet tjera të qëndrueshme në kontekstin bujqësore, turistik dhe ekonomik duke i respektuar ne harmoni te plotës ligjet në fuqi. Mirëpo, Komuna e Deçanit duhet të planifikon dhe të lobon në zhvillimin e politikave të banimit me sektorin privat dhe me nivelin qendror.

Analiza SWOT - Vendbanimet	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Zonë urbane e planifikuar ne të kaluarën (posedimi i planeve strategjike hapësinore), - Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën e Deçanit, - Qasja emirë e vendbanimeve në shërbimet komunale, - Prania e vargmaleve dhe lumenjve e benë Deçanin qytetin më tërheqës, - Infrastruktura teknike e pranishme në të gjitha bashkësitë territoriale ne zonën urbane, - Trendi në rritje i ndërtimit në dekadën e fundit, - Shërbime efikase të administratës publike në qendër të qytetit dhe lehtësisht të arritshme nga të gjitha vendbanimet, - Cilësia banimeve në përgjithësi është e mirë. - Shpallja e vendbanimit te ri fshati Shkëlzen Haradinaj dhe Pleqe	- Mungesa e buxhetit komunal për politikat e banimit (Programi për banim social),Mungesa e politikave lokale për banim social të integruar, - Mungesa e një programi të banimit komunal (politikat e banimit), - Mungesa e kapaciteteve njerëzore brenda dhe jashtë institucioneve lokale për planifikim të qëndrueshëm hapësinorë, - Zhvillimi i ndërtimeve të pakontrolluara (ndërtimet ilegale), - Kontroll i pamjaftueshëm ndërtimeve ilegale., - Fond i vogël i pronës komunale për realizimin e projekteve strategjike, - Uzurpimi i pronës komunale, - Banesat ose shtëpitë e papërdorur si rezultat i emigrimit, - Shpronësime janë të kushtueshme dhe mjaft sfiduese për pronarët, - Një numër i madh i ndërtesave pa leje ndërtimi, - Vendbanimet joformale
MUNDSITË	**RREZIQET**
- Zhvillimi i politikave të përballueshme të banimit (me theks të veçantë për grupet e cenuara, familjet shumë-anëtaresh dhe çiftet e reja), - Zbatimin e programeve të ndryshme të efektshmërisë të efiqences për ndërtesat e vjetra, - Prania e lumenjve një mundësi të mirë për lidhjen e vendbanimeve në qytet dhe ne zonat rurale nëpërmes lëvizjes aktive, - Rritja e numrit të zyrtarëve komunal me theks të veçantë në planifikimin urban dhe	- Buxheti i ulët si rezultat i numrit jo të madh të banorëve e pamundëson zhvillimin e politikave të banimit social, - Emigrimi i popullsisë në vendet më të zhvilluara, - Një përqindje e vogël e ndërtimeve të legalizuar, - Katastrofat natyrore – rreziqet natyrore si vërshimet, erërat e forta, tërmetet etj.

inspektimet, - Përmirësimi i infrastrukturës teknike në të gjitha vendbanimet (përfshirë edhe zonën rurale), - Zhvillimi i konceptit të "Qytet i mençur" - Përmirësimin e hapësirave publike, krijimin i të rejave dhe lidhshmëria e tyre në mes veti. - Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rritja e cilësisë së jetës, - Potenciali privat në sektorin e ndërtimit, Mundësi e zgjerimit të ndërtimit në zonat suburbane dhe tokat e kualitetit të dobët në zonat rurale.	

Tabela 184. SWOT analiza e vendbanimeve

3.10 Kapacitetet financiare te komunës

Për vlerësimin e kapaciteteve financiare janë marr parasysh tre vitet e fundit ndërsa për vitet në vijim është marr parasysh Buxheti i Kosovës për vitin 2023 – komunat.

Pasqyra dhe trendët e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2020 - 2023								
Kategoria ekonomike	Buxheti i planifikuar - viti:				Trendët e rritjes / zvogëlimit - viti:			
	2020	2021	2022	2023	2020 2021	2021 2022	2022 2023	2020 2023
Rroga dhe paga	5416005	5556738	5689340	5800000	2.60	2.39	1.95	7.09
Mallra dhe shërbime	1365474	1582859	1694536	2100000	15.92	7.06	23.93	53.79
Shpenzime komunale	155000	156000	156000	200000	0.65	0.00	28.21	29.03
Subvencione dhe transfere	140000	140000	160000	200000	0.00	14.29	25.00	42.86
Shpenzime kapitale	2655117	2706803	2940479	3819805	1.95	8.63	29.90	43.87
Gjithsej	9731596	10142400	10640355	12119805	4.22	4.91	13.90	24.54

Tabela 185. Pasqyra dhe trendët e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2020 – 2023

Planifikimi i buxhetit komunal nga viti 2023 deri 2031. Viti 2023, 2024 dhe 2025 janë paraparë sipas Buxhetit të Kosovës për komunat ndërsa nga viti 2026 – 2031 është planifikuar buxheti duke u bazuar ne rritjen buxhetore nga viti 2023 deri 2025.

Buxheti për vitin	Garantët Qeveritare	Te hyrat vetanake	Financimi i jashtëm	Financimi nga huamarrja	Financimi nga huamarrja	Total Shpenzimet
2023	11,021,320	1,098,485	0	0	0	12,119,805
2024	11,734,566	1,145,054	0	0	0	12,879,620
2025	12,218,615	1,195,204	0	0	0	13,413,819
2026	12,719,578	1,244,207	0	0	0	13,963,786
2027	13,241,081	1,295,220	0	0	0	14,536,301
2028	13,783,965	1,348,324	0	0	0	15,132,289
2029	14,349,108	1,403,605	0	0	0	15,752,713
2030	14,937,421	1,461,153	0	0	0	16,398,574
2031	15,549,856	1,521,060	0	0	0	17,070,916

Tabela 186. Projeksionet e buxheti deri ne vitin 2031

Analiza SWOT e infrastrukturës institucioneve administrative publike	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
- Mbulueshmëria e mire me shërbime administrative, - Personeli i përgatitur për ofrimin e shërbimeve, - Përbërja shumë e mirë gjinore, - Disa shërbime kryhen sipas parimit "one-stop-shop" dhe "online", - Mbështetje nga programet ndërkombëtare për sektorë të veçantë.	- Personeli i pamjaftueshëm i komunës për funksionimin e duhur të administratës publike sidomos në inspektim, - Stafi i pamjaftueshëm profesional i komunës për të zhvilluar politika të zhvillimit të qëndrueshëm afat-mesëm dhe afatgjatë për sektorë të ndryshëm. - Mospërshtatja e pozitës dhe përgatitjen profesionale – kualifikimi i stafit, - Objekti i Komunës i pa përshtatshëm për funksionim efikas për të ofruar shërbime për qytetar, - Mungesa e qasjes së lehtë dhe pa pengesa për personat me nevoja të veçanta, - Mungesa e buxhetit, - Mungesa e të dhënave sektoriale dhe hapësinorë në sistem digjital dhe të përditësuara, - Mungesa e parkimit për personelin administrativ dhe qytetarët,
MUNDESITE	**RREZIQET**
- Trajnimi profesional i stafit lokal për të zhvilluar politikat e zhvillimit, - Mbështetja e programeve ndërkombëtare për të rritur cilësinë e punës, transparencën dhe rritjen e kapacitetit profesional, - Digjitalizimi i të gjitha drejtorive dhe rritja e shërbimeve "one-stop-shop" dhe shërbimeve të tjera "online", - Krijimi i instrumenteve të përfshirjes së Këshillave Lokale si dhe fuqizimi i tyre, - Përfshirja dhe krijimi i kushteve i të gjitha grupeve të interesit në vendimmarrje rreth buxhetit dhe projekteve investuese (aktivizimi i qytetarisë aktive).	- Mungesa e mbështetjes nga administrata publike lokale nga niveli qendror me të gjitha drejtoritë e nevojshme. - Buxhet i ulët komunal nga niveli qendror, - Mungesë e profesionalizmit për fushat e caktuara menaxheriale, - Mungesa e teknologjisë do shkakton burokraci, - Qytetari jo aktive.

Tabela 187. SWOT analiza e infrastrukturës se institucioneve administrative dhe publike.

4 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e Zhvillimit Hapësinorë prezanton procesin e përgjithshëm strategjik dhe qasjen, duke e përshkruar të ardhmen e dëshiruar dhe duke e nënvizuar se çfarë duhet të arrihet në mënyrë që të sjellë zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve[80].

Korniza e Zhvillimit Hapësinorë është një përgjigje hapësinore ndaj kontekstit zhvillimor, nevojave ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe vizionit të zhvillimit të qëndrueshëm. Korniza është mjet kyç i menaxhimit të përdorimit të tokës në mënyrë të duhur dhe strategjike e cila e orienton, menaxhon dhe ja lehtëson marrjen e vendimeve Komunale ne lidhje me përdorimin racional, zhvillimin dhe planifikimin e tokës. Korniza e Zhvillimit Hapësinorë është kërkesë ligjore respektivisht e paraparë në U.A. MMPH – Nr. 11/2015 Mbi elementët dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimorë Komunal, e cila përpos orientimit të zhvillimeve në nivel Komunal, ajo në të njëjtën kohë harmonizon dhe bashkërendon politikat zhvillimore ne nivel rajonal, nacional dhe ndërkufitarë. Nëpërmes kësaj kornize, balancohet zhvillimi, ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme resurset natyrore, kulturore dhe ekonomike, i mënjanon pabarazitë e të së kaluarës duke i kthyer në sinergji duke ofruar veprime konkrete afatshkurta, afat mesme dhe afat gjatë. Ne Komunën e Deçanit nëpërmes Kornizës së Zhvillimit Hapësinorë lehtësohet:

- Marrjen e vendimeve konkrete.
- Përshpejtimi i rritjes ekonomike dhe transformimi i ekonomisë për të krijuar punë të denjë dhe jetesë të qëndrueshme;
    - Prezantimi i programit për ndërtimin e infrastrukturës ekonomike.
    - Drejton investimet ne sektorin publik nëpërmes hartimit të projekteve.
    - Drejton investimet në sektorin publike nëpërmes partneritetit.
    - Zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të zhvillimit rural të lidhur me politikat reformuese për prodhimin, promovimin dhe plasimin e produkteve ushqimore.
- E lehtëson përdorimin efektiv dhe të qëndrueshëm të burimeve të tokës.
- I forcon parimet e dala nga Ligji Nr. 04/L-174 siç janë parimi demokratik, subsolidiaritetit, pjesëmarrjes, përfshirja, proporcionalitetit dhe parandalimit.
- Koordinimin me i mirë ndër Komunal, me nivelin qendror dhe ndërkufitarë.
- Promovimi i zhvillimeve dhe investimeve ne të ardhme.
- Paraqitja vizuale, nëpërmes hartave të zhvillimit të sektorëve të ndryshme Komunale duke i ndarë ne periudhat afat shkurtë, afat mesëm dhe afatgjatë.
- Ofron shërbime profesionale dhe të lehta për banorët e saj, vizitorët dhe investitorët.
    - Forcimi i aftësive profesionale të kapaciteteve njerëzore.
    - Forcimi i institucioneve lokale nëpërmes ofrimit të shërbimeve ma të mira, gjithëpërfshirëse, llogaridhënie dhe demokratike.
    - Prezantimi i një programit për ndërtimin e infrastrukturës sociale.
    - Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore.
    - Rritja e sigurisë nëpërmes politikave bashkëkohore dhe të kujdesshme, rritje të kohezionit shoqëror dhe të qëndrueshëm.
- E lehtësojnë zhvillimin në mënyrë progresive drejt arritjes së një forme hapësinore të dëshiruar brenda zonës së juridiksionit – kufijve administrativ të Komunës.

[80] U.A. MMPH – Nr. 11/2015 Mbi elementët dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimorë Komunal

Për caktimin e kornizës të zhvillimit hapësinorë është e nevojshme që të caktohet vizioni i Komunës. Vizioni është një imazh i përgjithshëm i së ardhmes së dëshiruar bashkërisht që do të arrihet përmes përpjekjeve të përbashkëta. Është një synim realist për të ardhmen i mbështetur mbi potenciale dhe kapacitete të disponueshme dhe të arritshme. Gjendje e ardhshme ku çështjet dhe sfidat e identifikuara zhvillimore marrin përgjigjen e duhur. Vizioni paraqet hapin e parë në planin e zhvillimit strategjik që tregon drejtimin afatgjatë të zhvillimit të ardhshëm. Adresimi gjithëpërfshirës i synimeve sociale, ekonomike, hapësinore dhe mjedisore bazuar në cilësitë, asetet dhe mundësitë e identifikuara. Gjithashtu, prezanton ndjenjën e identitet lokal të integruar në zhvillimet e ardhshme të një shkallë më të gjerë. Frymëzon, tërheq dhe mobilizon pjesëmarrësit në arritjen e të ardhmes së dëshiruar.[81]

4.1 Vizioni

Para se të fillohet me përpilimin e Deklaratës së Vizionit, si pikë nisje është marr deklarata e vizionit nga Planit Hapësinorë i Kosovës 2010 -2020 + i cili ketë pjesë e identifikon si Urat e Kosovës (Hapësira e Verdhë). Kjo hapësirë ndodhet në pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga Komuna e Deçanit, Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës. Gjakova është qendra ma e madhe administrative të Urat e Kosovës. Zhvillimi i Urave të Kosovës ose Hapësirës së verdhë është e bazuar në zhvillimet shërbyese tregtare e turistike, agro-industriale dhe industri e lehtë.

Deklarata e Vizionit për Urat e Kosovë (Hapësira e Verdhë) sipas Planit Hapësinore të Kosovës 2010 - 2020 + është:

Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.

Qëllimet e përgjithshme për Urat e Kosovës (hapësira e Verdhë) sipas Planit Hapësinorë të Kosovës 2010 – 2020+ janë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, ndër urbanë me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Gjatë zhvillimit të skenarit për Urat e Kosovës (Hapësira e Verdhë) janë identifikuar disa, konflikte dhe sinergji.

Konfliktet sipas Planit hapësinore të Kosovës 2010 -2020 + janë:

- Shtrirja e vendbanimeve me tokën bujqësore.

[81] Udhëzues për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale. Programi I mbështetjes se planifikimit hapësinorë Komunal ne Kosove "Bëjmë qytete me të mira bashkë" – UN-Habitat, Kosovë.

- Zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve.
- Zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore.

Ndërsa, sinergjitë sipas Planit Hapësinorë të Kosovës 2010 – 2020+ janë:

- Zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore.

Në Planit Hapësinorë të Kosovës 2010 -2020 + janë të identifikuara disa zona të mbrojtura të ndara në:

- Zonat dhe monumentet e mbrojtura.
- Monumentet kulturore me status të mbrojtjes.
- Zonat e veçanta të mbrojtura.

Në kuadër të këtyre grupeve janë identifikuar:

- Maja e Ropsit, Deçan – rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut;
- Kozhnjeri, Deçan – rezervat shtazor i llojit të dhisë së egër;
- Malet e Prilepit, Deçan – rezervat bimor me përbërje të panjës malore;
- Rrjedha e lumit Mirusha, Malishevë – me rëndësi hidrologjike dhe peisazhore;
- Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e fshejtë, Gjakovë – monument natyre or me rëndësi hidro-gjeomorfologjike;
- Bliri në Isniq, Deçan – monument natyror me karakter botanik;
- Bliri në Strellc të Epërm, Deçan - monument natyror me karaktër botanik;
- Trungjet e Blirit në Isniq, Deçan – Monument natyrore me vlera të rralla botanike;
- Trungjet e bungut në Lozicë, Malishevë – monument natyror me karaktër botanik;
- Çabrati, Gjakovë – monument memorial i natyrës;
- Pishat e Deçanit, Deçan – Përbërja e pastër e pishës së zezë;
- Parku rajonal i Mirushës, Klinë, Malishevë, Rahovec – Kanioni, ujëvarat dhe peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme.

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

- Manastiri i Deçanit, Deçan.
- Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, Rahovec.
- Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe, Rahovec.

Gjatë punëtorisë me Ekipin Komunal për Planifikim, Ekipin Komunal për Mbrojtje Mjedisi, shoqërisë civile, grupet e interesit dhe përfaqësuesve të drejtorive të Komunë Deçanit, është hartuar deklarata e përbashkët e vizionit për Komunën e Deçanit i cila është produkt i Planit Hapësinorë të Kosovë 2010 -2020 +, punës së përbashkët të të gjithë hisedarëve dhe resurseve dhe kapaciteteve financiare për zhvillimin 8 vjeçar.

Deklarata e Vizionit: Urë lidhëse me Malin e Zi, me infrastrukturë dhe shërbime të zhvilluar. Aty ku vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore gërshetohen të rrethuara me sipërfaqet e gjera pyjore, të begatuara me rrjedhat ujorë, kanionet atraktive dhe mjedis i pastër. Hapësirë me vendbanime dhe turizëm të qëndrueshme, ku prodhimet e bujqësisë, blegtorisë, agro – industrisë dhe ndërmarrjeve e brendojnë këtë komunë.

Slogani: Deçani mjedis me kualitet të lartë jetese

Deklarata e vizionit të Komunës Deçanit është ne harmoni me deklaratën e vizionit sipas Planit Hapësinorë të Kosovës 2010 – 2020 + duke e respektuar hierarkinë zhvillimore nga niveli lokal me nivelin qendror.

Deklarata e vizionit të Komunës Deçanit me deklaratën e vizionit për Urat e Kosovës - përputhshmëria	
Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin	*Urë lidhëse me Malin e Zi*
Rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.	*Hapësirë me vendbanime dhe turizëm të qëndrueshme*
Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës.	*Me infrastrukturë dhe shërbime të zhvilluar.*
Pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane.	*Aty ku vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore gërshetohen të rrethuara me sipërfaqet e gjera pyjore, të begatuara me rrjedhat ujorë, kanionet atraktive dhe mjedis i pastër.*
Të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.	*Hapësirë me vendbanime dhe turizëm të qëndrueshme, ku prodhimet e bujqësisë, blegtorisë, agro – industrisë dhe ndërmarrjeve e brendojnë ketë komunë.*
Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin	*Portë lidhëse me shtetet fqinje Shqipërinë dhe Malin e Zi*
Rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.	*Hapësirë me vendbanime dhe turizëm të qëndrueshme*

Tabela 188. Deklarata e vizionit të Komunës Deçanit me deklaratën e vizionit për Urat e Kosovës – përputhshmëria

Deklarata e vizionit të Komunës Deçanit është në harmoni të plotë me potencialet dhe resurset që kjo komunë i posedon si dhe në harmoni me deklaratën e vizionit të Planit Hapësinorë të Kosovës 2010 – 2022+. Komuna e Deçanit, ka potencial të bollshëm për zhvillimin të qëndrueshëm ne të ardhmen siç janë:


- Pozita e saj gjeografike me dy Komuna relativisht të zhvilluara ekonomikisht siç janë Peja dhe Gjakova dhe me dy shtete siç janë Mali i Zi dhe Shqipëria (nëpërmes Komunës së Junikut).
- Rrjeti rrugor lidhës që kalon ne ketë komunë dhe e lidhë pjesën veriore të Dukagjinit me atë jugore dh me dy shtetet fqinje.
- Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me potenciale të zhvillimit të turizmit lokal, ndër Komunal dhe ndër kufitar - *Të gjitha veprimet për zhvillimin e zonës turistike në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" do të janë në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*
- Zhvillimi i turizmit rural të kombinuar me promovimin e vlerave kulturore dhe natyrore.
- Popullatë relativisht e re dhe e aftë për punë dhe të shkolluar mirë.
- Fond i pasur me trashëgimi natyrore siç janë pyjet, toka bujqësore, lumenjtë, flora dhe fauna, mineralet-mermeri;
- Fond i pasur me trashëgimi kulturore dhe ndërtesat me vlera arkitektonike, numër i madh i kullave dhe ndërtesat fetare.
- Toka kualitative bujqësore me mundësi të mira në kultivimin dhe zhvillim të agro-industrisë.
- Toka kualitative edhe për zhvillimin e sektorit të blegtorisë dhe produkteve tjera të saja.
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e mirëqenies sociale dhe rritjen e kualitetit të jetesës.

4.2 Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Për arritjen e vizionit për Komunën e Deçanit, është e nevojshme që të bëhet zbërthimi i saj i cili arrihet nëpërmes caktimit të qëllimeve. Qëllimi është një deklaratë e përgjithshme që rrjedh nga Vizioni dhe e cila përshkruan një arritje të dëshiruar në kuadër të në një fushë tematike. Secili "Qëllim" artikulohet pastaj përmes një numri "Objektivash". Objektivi është një deklaratë më konkrete

dhe specifike e të arriturave të dëshiruara dhe të mundshme. Objektivi duhet të jetë SMART: Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Real / Relevant dhe i kufizuar në kohë "Time-bound". Shpjeguar ndryshe:

- Specifike – Objektivi tregon qartë, kështu që kushdo që e lexon mund të kuptojë se çfarë do të bëhet dhe kush do ta bëjë.
- I matshëm – Objektivi përfshin mënyrën se si do të matët veprimi. Matja e objektivave ndihmon të vlerësohet nëse po bëhet përparim, na mban në rrugën e duhur dhe në kohë.
- I Arritshëm – Objektivi është realist duke pasur parasysh realitetet me të cilat përballet komuniteti. Vendosja e objektivave të arsyeshme ndihmon në vendosjen e projektit drejt suksesit.
- Real / Relevant – Një objektiv përkatës ka kuptim, domethënë i përshtatet qëllimit, i përshtatet kulturës dhe strukturës së komunitetit dhe adreson vizionin e projektit.
- I kufizuar në kohë (Time Bound) - Çdo objektiv ka një afat kohor specifik për përfundimin.



Grafiku 19. Skema e deklaratës vizionit, qëllimeve dhe objektivave

Pasi që të caktohen objektivat vazhdohet me identifikimin e aktiviteteve respektivisht me veprimet konkrete për realizimin e objektivave.

4.2.1 Mbrojtja e mjedisit, trashëgimia natyrore dhe kulturore

Qëllimi 1 - Inventarizimi dhe masat mbrojtëse të hapësirave me vlerat e trashëgimisë
Objektivat:

O.1.1 Studimi, shenjëzimi dhe caktimi i masave mbrojtëse për lokacionet arkeologjike të identifikuara.
O.1.2 Eksplorimi dhe masat mbrojtëse arkeologjike në themelet e Kalasë (Qelisë) dhe në tërë hapësirën Belle, Pleqe dhe lokalitetet tjera.
O.1.3 Shënimi i vendeve arkeologjike, tabelat informuese për zonat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, qasja të integruar për trashëgimi brenda planifikimit hapësinor.

Qëllimi 2 - Ruajtja e trashëgimisë materiale të paluajtshme kulturore
Objektivat:

O.2.1: Kujdesi permanent në kullat ekzistuese dhe konservimi i tyre, ofrimi në shërbim të turistëve.
O.2.2: Konservimi në ndërtesat e trashëgimisë kulturore (kullat, mullinjtë, hambarët dhe kultura jo-materiale) dhe digjitalizimi i vend lokacioneve.
O.2.3: Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore.

O.2.4: Ruajtja dhe mbrojtja e ndërtesave të trashëgimisë kulturore.
O.2.5: Mirëmbajtja dhe kujdesi i monumenteve të trashëgimisë natyrore.
O.2.6: Hartimi i monografisë për ndërtesat e trashëgimisë materiale dhe jo materiale (shpirtërore).

Qëllimi 3 - Krijimi i një mjedisi të pastër pa ndotje dhe siguri ndaj rreziqeve natyrore
Objektivat:

O.3.1: Shfrytëzimi racional i resurseve mjedisore: ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetit.
O.3.2: Ngritja e vetëdijes për një ambient të pastër.
O.3.3: Masat mbrojtëse tek zonat erozive në Bjeshkët e Deçanit.
O.3.4: Ndërgjegjësimi dhe masat e parandalimit për ndezjen e zjarreve në fusha dhe pyje.

4.2.2 Zhvillimi ekonomik

Qëllimi 4 - Zhvillimi i zonave me potenciale turistike
Objektivat *(Vërejtje: të gjitha objektivat e cekura i referohen zonës rurale. Për pjesën potenciale turistike malore dhe kodrinore që është pjesë e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" do të trajtohen me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe duke iu referuar Planit Hapësinorë të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna". Njëjtë do të veprohet edhe me Zonën e Veçantë të Mbrojtur për Manastirin e Deçanit i cili do të trajtohet me Ligjin nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura):*

O.4.1: Zhvillimi i turizmit nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe promovimit të burimeve natyrore dhe kulturore.
O.4.2: Bashkëpunimi dhe lidhja e miqësisë me shtetet fqinje Shqipëri dhe Mali i Zi, me qëllim të shkëmbimit dhe përvojave turistike.
O.4.3: Hartimi i Planeve të hollësishme rregulluese për zonat me kapacitete turistike të Deçanit.
O.4.4: Sigurimi i infrastrukturës turistike për gjithë zonën e identifikuar si zonë me interes zhvillimit.
O.4.5: Planifikimi dhe ndërtimi i kontrolluar në të gjitha hapësirat e identifikuara si potenciale turistike.
O.4.6: Përgatitja e guidave turistike.
O.4.7: Hartimi i Planit Lokal për Zhvillimin Ekonomik.
O.4.8: Zhvillimi i turizmit - ndërtimi i bujtinave në vendet e lejuara për akomodim.
O.4.9: Planifikimi për ndërtimin e shtigjeve për kalërim dhe çiklizëm.

Qëllimi 5 - Nxitja e zhvillimit të bujqësisë
Objektivat:

O.5.1: Ruajtja e tokës bujqësore.
O.5.2: Nxitja dhe zhvillimi i blegtorisë, pemëtarisë dhe perime kulturave dhe fushave tjera bujqësore.
O.5.3: Ruajtja dhe rigjenerimi i Rripit të Gështenjave.
O.5.4: Grumbullimi i fryteve malore, deponimi, paketimi, brendimi.
O.5.5: Krijimi infrastrukturës për ujitje i tokës bujqësore.
O.5.6: ndërtimi i pendave akumuluese në gryken e Lloqanit për ujitjen e tokave Bujqësore.
O.5.7: Rritja e sipërfaqeve me bimë mjaltëdhënëse.
O.5.8: Subvencionimi i prodhueseve për produkte bujqësore.
O.5.9: Nxitja dhe zhvillimi i agroturizmit.

O.5.10: Nxitja dhe maturimi i agroturizmit i ndërlidhur përmes trashëgimisë kulturore dhe funksionalizimit të kullave.
O.5.11: Grumbullimi dhe paketimi, brendimi i bimëve mjekuese.
O.5.12: Përpunimi dhe prodhimi i ujit të pijshëm si brend i Deçanit.

Qëllimi 6 - Nxitja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)
Objektivat:

O.6.1: Planifikimi i një zone parku i biznesit në zonën kadastrale Dranoc me sipërfaqe 20 ha.
O.6.2: Favorizimi i bizneseve prodhuese (bujqësore, artizanale).
O.6.3: Nxitja dhe përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
O.6.4: Mbështetja e ekonomive NVM me synim nxitjen e prodhimit të produkteve vendore (ushqim dhe artizanat).

Qëllimi 7 - Zhvillimi i resurseve njerëzore
Objektivat:

O.7.1: Bashkëpunimi në formën e punës praktike: shkolla dhe bizneseve;
O.7.1: Angazhimi dhe favorizimi i të rinjve dhe grave në biznes;
O.7.1: Aftësimi i personave me aftësi të kufizuara për fillimin e start-UP biznes;
O.7.1: Mbështetja dhe përkrahja e kuadrove për të rritur mundësitë e punësimit në veprimtari aktive që gjenerojnë të ardhura.

Qëllimi 8 - Nxitja dhe favorizimi i veprimtarive shërbyese
Objektivat:

O.8.1: Përgatitja dhe aftësimi i grupeve punuese në profilet e gastronomisë, hotelerisë dhe zanateve shërbyese tregtare.
O.8.2: Ndarja e hapësirave-Krijimi i mundësive për ushtrimin e disa artizanaleve që mungojnë në Komunën e Deçanit.

4.2.3 Infrastruktura e transportit

Qëllimi 9 - Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm
Objektivat *(Vërejtje: Asfaltimi i rrugës në relacionin Deçan – Kozhnjer – kufiri me Malin e Zi i planifikuar me Planin Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020 +, ka përfunduar pothuajse i gjithi përpos pjesës të Manastiri i Deçanit për shkaqe politike, andaj ky projekt nuk është identifikuar si objektiv).*

O.9.1: Ndërtimi i aksit rrugor (aortës) kryesor të Qytetit të Deçanit.
O.9.2: Ndërtimi i rrugës unazore nga dy hyrjet në drejtimin e Pejës dhe Gjakovës (Lindje – Perëndim).
O.9.3: Shenjëzimi me masat standarde dhe rritja e sigurisë në komunikacion në të gjitha kategoritë e rrugëve.
O.9.4: Standardizimi dhe rritja e sigurisë në të gjitha rrugët (për të gjitha kategoritë).

4.2.4 Infrastruktura Teknike

Qëllimi 10 - Rritja e kapacitetit dhe shtrirja e rrjetit të infrastrukturës

Objektivat e infrastrukturës hidroteknike:

O.10.1: Rritja e kapaciteteve për ujin e pijshëm (ndërtimi i tri pendave akumuluese në lumin e Lumëbardhit të Lloqanit).

O.10.2: Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në të gjitha vendbanimet.
O.10.3: Kontrollimi i lidhjeve ilegale në ujësjellës.
O.10.4: Ndërtimi-shtrirja e kanalizimit në zonat rurale.
O.10.5: Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Deçanit.

Objektivat e infrastrukturës se ujitjes :
O.10.6: Menaxhimi i ujërave nga kompania K.R.U. "Drini i Bardhë" SH.A.
O.10.7: Ndërtimi i kanaleve për ujitjen e tokës bujqësore në zonat rurale.
O.10.8: Shtrirja e Sistemit të ujitjes në zonat rurale.
O.10.9: Ndërtimi i pendës akumuluese në fshatin Hulaj.

Objektivat e infrastrukturës së energjisë elektrike:
O.10.10: Ndërrimi i largpërçueseve në zonën urbane dhe në hapësirën e trasesë së re (rrugës kryesore-qendër) të planifikuara nga korporata energjetike KEDS.
O.10.11: Furnizimi me linjën e re energjetike në zonën e Bjeshkëve të Deçanit.
O.10.12: Zëvendësimi i rrjetit ajror me tela 10/20 kv më atë kabllovike nëntokësorë në zonën e qytetit dhe pastaj aty ku shtohen linjat e reja.
O.10.13: Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme (uji, era dhe solare).

Objektivat e infrastrukturës së telekomunikimit:
O.10.14 Furnizimi me linjën shpërndarëse përmes Sistemi të kabllove optike në zonën e qytetit.
O.10.15 Zëvendësimi i rrjetit ajror me tela më atë të kabllove nëntokësorë.
O.10.16 Mbulueshmëria me rrjetë në tërë vendbanimet dhe në Bjeshkët e Deçanit.
O.10.17 Shtrirja dhe mbulueshmëria me rrjetin e telefonisë mobile në Bjeshkët e Deçanit.

4.2.5 Trajtimi i mbeturinave

Qëllimi 11 - Modeli i një Qyteti të pastër
Objektivat:
O.11.1: Caktimi i tri lokacioneve për deponimin e mbeturinave inertë.
O.11.2: Administrimi i mbeturinave të amvisërisë në tërë territorin e Komunës së Deçanit.
O.11.3: Sigurimi i pajisjeve (makineritë) për pastrimin e rrugëve kryesore të qytetit.
O.11.4: Trajtimi i mbeturinave në bazë të prodhimit duke përfshirë riciklimin, kompostimin dhe selektimin.

4.2.6 Infrastruktura publike dhe sociale

Qëllimi 12 – Arsimi cilësor në të gjitha nivelet
Objektivat e arsimit:
O.12.1: Përfundimi i shkollave, të cilat janë në ndërtim dhe hapësirave përcjellëse.
O.12.2: Ndërtimi i së paku dy çerdheve për fëmijë.
O.12.3: Hapja e shkollës se muzikës në bashkëpunim me MASHT (shkollë e re në Deçan).
O.12.4: Ngritja e standardit më pajisje dhe teknologji në të gjitha shkollat.
O.12.5: Mirëmbajtja dhe furnizimi permanent i inventarit shkollor.
O.12.6: Ndërtimi i infrastrukturës adekuate për rreth shkollave.

Qëllimi 13 - Ofrimin i shërbimeve shëndetësore në çdo kohë

Objektivat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale:

O.13.1: Rritja e standardit të shërbimeve me kuadro profesionale pajisje të kërkuara, laboratorike.
O.13.1: Rritja e kapaciteteve për persona të pa strehë-ndërtimi i ndërtesave për strehim.
O.13.1: Rritja e kapaciteteve për personat me aftësi të kufizuara mendore.
O.13.1: Funksionalizimi i Qendrës së trajtimit mendor në Pejë-Dega në Deçan.
O.13.1: Të gjitha ndërtesat publike të kenë qasjes për personat me aftësi të kufizuara.
O.13.1: Ndërtimi i një qendre për përkujdesje të moshën e tretë.

Qëllimi 14 - Shërbime administrative efikase

Objektivat e administratës publike:

O.14.1: Shërbime administrative dhe qasje e lehtë për të gjithë qytetarët në një vend (One Stop Shop-aplikimi online për shërbime të administratës publike e cila formë rritë efikasitetin e shërbimit në administratë dhe lehtëson marrjen e shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset);
O.14.2: Funksionalizimi i shërbimeve elektronike e-shërbimet (qytetarët dhe bizneset realizojnë detyrimet përmes internetit, i cili shërbim lehtëson komunikimin me qytetarët);
O.14.3: Fuqizimi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së TI-së;
O.14.4: Vendosja e sistemeve elektronike dhe integrimi i tyre në proceset administrative;
O.14.5: Funksionalizimi dhe rritja e kapaciteteve për shërbime publike-Irzniq;
O.14.6: Planifikimi i parkingjeve për qytetarët në afërsinë e ndërtesave administrative.

Qëllimi 15 - Kujdesi i shtuar për memorialët dhe varrezat në Komunën e Deçanit

Objektivat:

O.15.1: Mirëmbajtja për varrezat e Qytetit të Deçanit, në vendin e ashtu quajtur Qestë (varreza Komunale);
O.15.2: Përkujdesja dhe mirëmbajtja e varrezave në zonat rurale.
O.15.3: Mirëmbajtja në kompleksin memorialin në Gllogjan.
O.15.4: Mirëmbajtja e memorialëve të Dëshmorëve dhe shesheve në tërë territorin e Komunës.
O.15.5: Hartimi i projektit dhe realizimi i punimeve në kompleksin për të gjithë dëshmoret në Qytetin e Deçanit-shpati tek udhëkryqi i rrugës Sali Çeku dhe rrugës së Manastirit.
O.15.6: Përkujdesja për memorialët e ndërtuara, dhe ndërtimi i memorialëve të reja të listuar nga administrata Komunale e Deçanit.

4.2.7 Kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat

Qëllimi 16 - Rritja e kapaciteteve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes

Objektivat:

O.16.1: Rregullimi i infrastrukturës në Pallatin e Kulturës sipas fushave përfaqësuese;
O.16.2: Rregullimi i hapësirave të mjaftueshme për aktivitete kulturo-artistike (biblioteka, salla e teatrit, kinema, koncerte);
O.16.3: Ndërtimi dhe funksionalizimi i qendrave kulturore në zonat rurale;
0.16.4: Menaxhimi dhe plotësimi më artefakte muzeut të "Qytetit" dhe muzeut "Jusuf Gërvalla".
O.16.5: Përfundimi i Qendrës Rinore, Kolonine e Artistëve, Qendra e trashëgimisë kulturore dhe fshati turistik në vendin e quajtur Podi i Gështenjave - Deçan.
O.16.6: Planifikimi i terreneve sportive në zonën urbane dhe zonat rurale.
O.16.7: Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për

këmbësorë dhe çiklistë në pjesën urbane dhe rurale.
O.16.8: Mbështetja dhe organizmi i aktiviteteve kulturore - Ansambli i Këngëve dhe Valleve në Deçan, grupeve folklorike, letrare, dramave, artit pamor etj.

4.2.8 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Qëllimi 17 - Zhvillimi kompakt i vendbanimeve, shfrytëzimi racional i tokës
Objektivat e vendbanimeve:


O.17.1: Zhvillim i kontrolluar i vendbanimeve, zoonimi dhe kufiri i saktë për çdo vendbanim;
O.17.2: Zoonimi i ri në zonën urbane.
O.17.3: Trajtimi i vendbanimeve joformale.

Qëllimi 18 - Plotësimi i kapaciteteve për institucione publike
Objektivat e banimit:

O.18.1: Sigurimi adekuat i banimit për familjet me nevojë-ndërtimi i ndërtesave të banimit sipas programit për banim social 2022-2030.
O.18.2: Rritja e kapaciteteve të kontrollit nga ana e ekspertëve me qëllim të sigurisë për materialin ndërtimor;
O.18.3: Aplikimi i standardeve sipas masave për efiçiencë në institucionet publike;
O.18.4: Favorizimi i ndërtimeve kolektive mundëson ruajtjen e fondit të tokës bujqësore.

4.3 Koncepti i zhvillimit hapësinorë

Koncepti i zhvillimit hapësinorë të Komunës së Deçanit bazohet në pozitën gjeografike; resurseve natyrore dhe mundësitë për zhvillim si hapësira me burime natyrore; potenciale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore; zhvillimin e NVM; lidhja kyçe ne mes të pjesës veriore dhe jugore të Rrafshit të Dukagjinit; lidhja me Malin e Zi dhe Shqipërinë (nëpërmes Komunës Junikut); dhe shtrirjes së balancuar dhe të qëndrueshëm ne të gjithë territorin Komunal. Nisur nga vizioni për të ardhmen dhe përcaktimi i qëllimeve, orientimit zhvillimorë dhe fokusimi i objektivave (në fushën turistike, bujqësore, ekonomike, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, infrastrukturës dhe akumuluesit), bazohet me procesin e shpërndarjes së baraspeshuar, e cila arrihet me konceptin koherent i zhvillimit hapësinor të Komunës së Deçanit. Bazuar U.A. Nr. 11/2015 mbi elementët, kërkesat themelore për hartimin dhe zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, koncepti i zhvillimit hapësinorë i Komunës së Deçanit është produkti i bazuar në konceptet e nyjës, korridoreve, plotësim dhe dendësim, mbajtja nën kontroll, mbrojtja dhe zonat e rritjes.



Grafiku 20. Konceptet sipas U.A. Nr. 11/2015 mbi elementët, kërkesat themelore për hartimin dhe zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal

4.3.1 Zhvillimi i planifikuar

Zhvillimi i planifikuar i referohet procesit të krijimit të një plani strategjik ose udhërrëfyes për një zonë ose projekt të caktuar për të arritur qëllime dhe objektiva specifike. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e infrastrukturës, planifikimin urban, menaxhimin e mjedisit, zhvillimin ekonomik dhe planifikimin e shërbimeve sociale. Zhvillimi i planifikuar përfshin një qasje sistematike dhe të strukturuar për të identifikuar nevojat dhe kërkesat e një komuniteti ose organizatë dhe për të zhvilluar një plan veprimi për të përmbushur këto nevoja. Procesi zakonisht përfshin konsultime me palët e interesuara - hisedarët, duke përfshirë komunitetin, agjencitë, OJQ-të, nivelet e qeverisë, bizneset dhe palët e tjera të interesuara. Disa nga hapat kryesorë të përfshirë në zhvillimin e planifikuar përfshijnë kryerjen e kërkimeve dhe analizave, zhvillimin e një vizioni dhe qëllimesh, identifikimin e strategjive dhe veprimeve për arritjen e atyre qëllimeve, vendosjen e afateve kohore dhe buxhetet, dhe zbatimin dhe monitorimin e planit me kalimin e kohës. Zhvillimi i suksesshëm i planifikuar kërkon udhëheqje të fortë, komunikim efektiv dhe bashkëpunim midis të gjithë artereve të përfshirë në proces. Ka shumë burime që mund të përdoren për të informuar dhe lehtësuar përpjekjet e planifikuara të zhvillimit, duke përfshirë:

- Të dhënat demografike - ku përfshihen informacione për popullsinë e Komunës, si mosha, gjinia, etnia dhe madhësia e familjes.
- Të dhënat ekonomike - ku përfshihen informacione për ekonominë lokale, si sektorët e industrisë, normat e punësimit dhe të ardhurat mesatare.
- Rregulloret e përdorimit të tokës apo zoonimi - kjo përfshin informacion në lidhje me modelet aktuale të përdorimit të tokës dhe rregulloret tjera.
- Të dhënat mjedisore: këtu përfshihen informacione rreth mjedisit natyror në zonë, si burimet ujorë, cilësia e ajrit dhe habitatet e kafshëve të egra.
- Të dhënat e komunitetit - kjo përfshin komentet nga banorët, pronarët e bizneseve dhe palët e tjera të interesuara në lidhje me nevojat, shqetësimet dhe prioritetet e tyre për zonën.
- Praktikat më të mira dhe studimet e rasteve - kjo përfshin informacion në lidhje me përpjekjet e suksesshme të planifikuara zhvillimore në komunitete të tjera, të cilat mund të përdoren për të informuar vendimmarrjen dhe për të identifikuar strategjitë që mund të jenë efektive në kontekstin lokal.

Duke i siguruar të gjitha këto të dhënat lehtësohen të gjitha mundësitë për të filluar të ofrohen drejtimet e zhvillimit për të ardhme e Komunës sepse:

- Janë kuptuar nevojat dhe preferencat e grupeve të ndryshme brenda komunitetit.
- Janë identifikuar mundësitë dhe sfidat ekonomike në zonë.
- Mund të merren vendime në lidhje me përdorimin dhe zhvillimin e tokës në të ardhmen.
- Janë identifikuar kufizimet mjedisore dhe mundësitë për zhvillim.
- Kemi përgjigjet nga komuniteti dhe hisedarët të cilët nëpërmes përmes anketave, takimeve publike dhe përpjekjeve të tjera të informimit i kane ngrit çështjet të cilat e ndihmojnë procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit.
- Komuna është e aftë që të fillon me përdorimin e praktikave të mira rajonale dhe ndërkombëtare për marrjen e drejtimit të duhur drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke u bazuar ne të gjitha potencialet që i posedon Komuna e Deçanit, zhvillimi i ardhshëm do të jetë I drejtuar në:

Zhvillim të turizmit - *ku të gjitha veprimet për zhvillimin e zonës turistike në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" do të janë në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e*

Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna". Potenciali turistik në Komunën e Deçanit është mjaft e madhe. Ajo e ka një kombinim të mirë të turizmit malorë i cili është shumë drejtimesh dhe atij rural e cila është e shoqëruar me shumë trashëgimi kulturore dhe natyrore. Pozita gjeografike e ndihmon shumë zhvillimin e sektorit të turizmit malor dhe hartimin e politikave zhvillimorë turistike me Komunat fqinje si Peja dhe Juniku por edhe me shtetet fqinje siç janë Mali i Zi dhe Shqipëria. Deri me tani nuk ka pas zhvillim të turizmit për shkak të shumë sfidave siç janë qasja, zhvillimet politike, "izolimi" me Malin e Zi, situata politike, vetëdijesimi i banorëve për potencialët turistike, caktimi I zonave të mbrojtura siç është ajo e Zonës së Veçantë të Mbrojtur e që e përfshinë Manastirin e Deçanit si dhe të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna". Ne vitet e fundit interesimi për turizëm ka pas rritje. Kjo është evidentë edhe të numri ne rritje të vizitoreve, kërkesat janë ne rritje edhe për vizitat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Në zonën malore çdo veprim të turizmit dot ë jetë ne harmoni me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" ndërsa në zonat rurale do të zhvillohen bujtinat. Krahas zhvillimit të turizmit është e nevojshme që të rritët numri i profesionistëve dhe përgatitjen e kapaciteteve njerëzore për promovimin e turizmit, mikpritjen, shërbimet etj. Është në interes të veçantë të bëhet krijimi i identitet si komunë turistike dhe të ketë promovime ma të mëdha ne nivel nacional por edhe ndërkombëtarë. Turizmi i cili mund të zhvillohet në të ardhmen është:

- Turizmin transit, pra si pikë kalimi për në vendet tjera në Kosovë apo nga Kosova në shtetet fqinje,
- Turizëm vikendi duke ofruar oferta për qëndrim gjatë vikendit
- Turizëm qëndrimi i cili përfshinë pika qëndrimi turistik shumë ditorë si ne zonat urbane dhe rurale.

Në kuadër të këtyre llojeve është turizmi malor, i cili do të zhvillohet në harmoni me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", turizmi rekreativ dhe sportiv, speleoturizmi (shpellave), turizmi rural dhe kulturor, turizmi edukativ arsimor, turizmi kurativ (shëndetësor) dhe turizmit ndërkufitar - shtigjet.

Zhvillimi i bujqësisë të kombinuar edhe me blegtorinë - është drejtimi tjetër i favorshëm për zhvillimin e Komunës Deçanit. Toka kualitative bujqësore ofron mundësi të mira të zhvillimit të këtyre dy sektorëve. Rendimentet bujqësore dhe përgjithësi kanë pas trendë negative pas shpalljes së pavarësisë, mirëpo në vitet e fundit trendët kanë qenë pozitive. Me te rëndësishme janë kultivimi i kulturave të ndryshme bimore, frutore dhe perimeve. Trendët pozitive ne vitet e fundit i kane rrit rendimentet e drithërave ne ketë komunë andaj krahas drithërat ekzistojnë edhe kulturat tjera bimore të cila ne te ardhëm kanë potenciale për zhvillim. Një lloj i tillë është kultivimin i bimëve mjekësore si në zonën rurale dhe atë malore. Mirëpo në pjesën malore kultivimi dhe grumbullimi do të bëhet vetëm sipas Planit Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe ligjit në fuqi. Kultivimi i erëzave ka pas trend pozitiv në vitet e fundit dhe kërkesa është në rritje gjë qe tregon edhe mundësinë e eksportimit ne të ardhmen. Posedimi i bagëtive ka pësuar një trend negativ pas periudhës së luftës. Ndër vite, ky sektor i ka mbijetuar sfidave me rritje të lehtë e cila ka ndikuar në rritjen e prodhimeve në përgjithësi. Rritjen ma të madhe e ka sektori i qumështit dhe produktet e saj. Një zhvillim ne vitet e fundit ka qene edhe sektori i bletarisë i cili me shume sfida e ka gjet veten ne treg e sidomos nga rajonet malore. Mundësitë e ringjalljes se traditës se bletarisë si ne te kaluarën, do te jete mjaft efikas për ekonomitë familjare. Agro-industria është një potencial qe mundet me u rikthye ne Komunën e Deçanit dhe krahas saj të zhvillohet edhe NVM dedikuar sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë. Krahas këtyre veprime është me interes që të investohet sa ma shumë ne zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe të mbështetën fermerët ose shoqatat të cilat i dedikohen kësaj fushe. Kjo sot ë thotë se duhet mjaft

trajnime dhe punëtori të organizohen që të ngritën kapacitetet e aplikimit në grante, projekte apo donacione të ndryshme si dhe të krijojnë sa ma shumë marketing me brendim të prodhimeve të kësaj komune. Për ketë sektor është mjaft e rëndësishme mbrojtja e tokës bujqësore dhe zhvillimi i saj i qëndrueshëm. Përpos bujqësisë, është me rendësi ruajtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme - është drejtimi I radhës i cili ka perspektivë të mirë ne të ardhmen. Pozita gjeografike e Komunës Deçanit është premtuese për një të ardhme te sigurt. Forcimi i bashkëpunimit me viset e Malit të Zi mirëpo edhe me komunat fqinje kanë ndikuar dhe do të ndikojë në të ardhmen në zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Popullsia kryesisht e re dhe e shkolluar janë premtuese për zhvillimin e NVM ne të ardhmen. Investimet e fundit ne Komunën e Deçanit tregojnë se ka një treg dhe mundësi të hapura, gjithashtu investime nga diaspora ne NVM janë evidente dhe premtuese ne te ardhmen. Promovimi për investime ne Komunën e Deçanit është e domosdoshme por njëkohësisht edhe me zhvillimin e sektorit të turizmit dhe të bujqësisë dhe blegtorisë, ndikimet ne zhvillimin e NVM-ve do të jetë evidente. Komuna e Deçanit ofron mundësi të mira të zhvillimit te ndërmarrjeve të prodhimit parësor si është bujqësia, pylltari; prodhim dytësor si industri e lendes së parë, me theks te veçantë përpunimi i drurit, prodhime te lehta, prodhim i energjisë; prodhim tretësor me shërbime tregtare, shërbim profesional financiar dhe i informacionit dhe transport.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore - janë potencialet të cilat do të lidhen me sektorin e turizmit në përgjithësi. Ky fond i pasur, ne të ardhmen do ti nënshtrohet ruajtës por edhe regjenerimit në përgjithësi për ti konservuar dhe promovuar në mënyrën ma të mirë të mundshme. Rritja e numrit të vizitorëve do të jetë ekonomikisht pozitive për Komunën e Deçanit nga e cila do të përfitojnë NVM dhe banorët e komunës. Konfiguracioni i territorit malor, kodrinor (rreze mali me gështenja) dhe i rrafshet krijon mundësi te mira të zhvillimit të "shtigjeve të trashëgimisë kulturore" dhe "shtigjeve të trashëgimisë natyrore" të cilat e lidhin Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me kullat, mullinjtë, kishat xhamitë, manastirin, zonat arkeologjike si dhe trashëgimit tjera natyrore.

Zhvillimi i infrastrukturës - ne komunën e Deçanit, do të jetë sektori tjetër i rëndësishëm. Ofrimi i qasjes për të gjithë është një nga parimet e qeverisjes së mirë mirëpo, përpos qasjes është e nevojshme edhe ofrimi i sigurisë dhe promovimi i lëvizjes aktive. Nëpërmes rregullimit të infrastrukturës, Komuna e Deçanit do të ketë lidhshmëri ma të mirë me komunat fqinje, rajonin dhe shtete fqinje dhe do i ndihmon zhvillimit të sektorit të turizmit por edhe për plasimin e produkteve të ndryshme bujqësore dhe blegtorale. Në vitet në vijim pritet rregullimi i rrugës R107 dhe do te zgjidhet çështja e Autostradës se Dukagjinit, ndërsa në nivel lokal do të zhvillohen shtigjet e biçikletave me synim t promovimit të turizmit por edhe të promovimit të lëvizjes aktive. Në anën tjetër, do ndihmohet rritja e transportit publik për të gjitha vendbanimet e Komunës Deçanit. Përpos infrastrukturës së transportit, zhvillim do të ketë edhe infrastruktura teknike, ku si prioritet është shtrirja e rrjetit të kanalizimit fekal ne të gjithë territorin e komunës e cila do ketë ndikim pozitiv ne mbrojtjen e tokës kualitative, mbrojtjen e ujërave nëntokësor dhe lumenjve. Furnizimi me energji elektrike është bazë e zhvillimit të qëndrueshëm me theks në sektorin ekonomik. Energjia e ripërtritshme është trend në rritje andaj, përdorimi i resurseve natyrore pa ndikim negativ ne mjedis, do e ndihmon furnizimin e qëndrueshëm të Komunës Deçanit. Shpërndarja e rrjetit nëntokësore të internetit ne të gjitha vendbanimet është e nevojshme për rritjen e komunikimit të shpejtë. Sidomos është e nevojshme që krahas elektrifikimi të gjithë zonën e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" të bëhet edhe shpërndarja e internetit me fibër optik. Menaxhimi i mbeturinave është në nivel të duhur dhe grumbullimi është i rregullt. Mbete sfiduese ne te ardhmen vetëdijesimi i popullatës për mos ndotje të mjedisit.

Akumuluesit - janë potencialët kryesore të cilët do e ndihmojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë mirëpo ne të njëjtën kohë do e ndihmojnë edhe kontrollimin e vendbanimeve nga vërshimet dhe përmbytjet, Shtrimi i rrjetit të ujitjes në Komunën e Deçanit është ne nivel të mirë, mirëpo mirëmbajtja dhe funksionalizimi i tyre ka mjaft sfida. Andaj me zhvillimin e akumuluesve, do të ketë nxitje të zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe turizmit të cila pastaj do të kanë ndikim ne NVM.

Administratë - efikase dhe e digjitalizua – është tjetër drejtim i cili i ndihmon banorët e Komunës së Deçanit në kryerjen e shërbimeve por edhe të vizitoreve dhe investitorëve potencial. Administrata ekzistuese i kryen te gjitha shërbimet e veta në harmoni me kornizën ligjore ndërsa digjitalizim dhe krijimi i hapësirave të reja dhe moderne për punë administrative do e rrit efikasitetin e shërbimeve. Përpos zhvillimit të shërbimeve administrative, interes i është dhënë edhe zhvillimi infrastrukturës sociale me synim të rritjes së shërbimeve të duhura ne harmoni me kërkesat në terren dhe NTPH.

Të gjitha drejtimet e sipërpërmendura do të zhvillohen duke e marr parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e mjedisit te pastër për te gjithë.

4.3.2 Skenarët e propozuar

Përdorimi i skenarëve në procesin e hartimit të projekt PZHK-së për Komunën e Deçanit, është detyrim ligjor. Mirëpo krahas detyrimit ligjor, skenarët përdoren për të nxitur mënyra të reja të menduarit midis planifikuesve dhe palëve të interesuara. Si histori për të ardhmen, skenarët përshkruajnë vizione ose alternativa të mundshme dhe përdoren për të vlerësuar implikimet e vendimeve dhe politikave.[82]

Për të arritur një skenar të qëndrueshëm duhet të merren parasysh të gjitha fushat tematike që kane ndikim në zhvillim dhe të trajtoheni në mënyrë të njëtrajtshme dhe të balancuar. Nëpërmes skenarit nxjerrën pikat e forta respektivisht supozimet dhe vlerat, si dhe pikat e dobëta respektivisht sfidat dhe problemet të cilat munden ta cenojnë të ardhmen. Përveç zbulimit të supozimeve dhe vlerave, skenarët synojnë të ofrojnë një kuptim të sfidave aktuale dhe të ardhshme, të identifikojnë ndërprerjet dhe varësitë fillestare dhe të përgatitën dhe përshtatën për të ardhmen.[83] Me metodat e skenarëve, që varrojnë nga shumë intuita në shumë Teknike, planifikuesit adoptuan metoda dhe mjetë të reja analitike nga disiplina të ndryshme, si bashkëpunim i planifikimit me shkenca të aplikuar dhe inxhinierinë.[84]

Bazuar në pozitën gjeografike dhe konfiguracionin e Komunës Deçanit, potencialet e para kyçe zhvillimore janë zhvillimi i turizmit ne mënyrë të kontrolluar dhe zhvillimi i sektorit bujqësor të përcjella me zhvillimin e NVM - të. Të gjitha këto janë të orientuara ne bashkëpunim me Komunat fqinje (bashkëpunim ndër Komunal) dhe shtetet fqinje (bashkëpunim ndërkufitar). Për ta zhvilluar skenarin përfundimtar, Komuna e Deçanit ka organizuar punëtori më hisedarë të ndryshëm ku janë marr parasysh tre skenarët e mundshëm:

Skenari 1 (Skenari zero) - skenari i cili është i bazuar ne trendin ekzistues zhvillimorë, i cili si bazë e ka planin paraprak. Këtu është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe janë identifikuar pikat e

[82] Chakraborty Arnab, McMillan Andre. 2015. "Scenario Planning for Urban Planners: Toëard a Practitioner's Guide." *Journal of the American Planning Association* 81 (1): 18–29. https://doi.org/10.1080/01944363.2015.1038576.
[83] Khakee Abdul. 1991. "Scenario Construction for Urban Planning." *Omega* 19 (5): 459–69 https://doi.org/10.1016/0305-0483(91)90062-X.
[84] Ëachs Martin. 2001. "Forecasting Versus Envisioning: A Neë Ëindoë on the Future." *Journal of the American Planning Association* 67 (4): 367–72 https://doi.org/10.1080/01944360108976245.

forta dhe pikat e dobëta të skenarit dhe në përfundim është bërë vlerësimi përfundimtar i tij se sa është i përshtatshëm që të zhvillohet ne tetë vitet e ardhshme.

Skenari 2 (Skenari policentrik) - është skenari i cili është bazuar ne konceptin e zhvillimit në të gjithë territorin e Komunës së Deçanit më synim të krijimit të balancimit zhvillimorë hapësinore. Ne ketë skenarë janë identifikuar pikat kyçe – respektivisht pikat ku janë potencialet e mundshme zhvillimore ne tetë vitet e ardhshme. Edhe në ketë skenarë janë identifikuar pikat e forta dhe pikat e dobëta të tij para përzgjedhjes përfundimtare.

Skenari 3 (Skenari i baraspeshuar) - është skenari i cili i plotëson nevojat e së tashmes, pa i kompromentuar potencialet e brezave të ardhshme për të përmbushur nevojat e veta. Pra, çdo veprim i cili është trajtuar e ka marr parasysh aspektin mjedisor, ekonomik dhe shoqëror. Ne këtë skenarë janë identifikuar të gjitha pikat e forta dhe pikat e dobët para marrjes së formës përfundimtare.

Duhet të cekët se gjatë procesit të përgatitjes së skenarëve, kanë ekzistuar mjaft pika sinergjike në mes të skenarëve të cilat janë vlerësuar për nga qëndrueshmëria e tyre dhe mirëpo edhe pika të cilat kanë qenë kontradiktore dhe ne të cilat është punuar që të mënjanohen dhe të krijohen lidhshmëri ose të minimizohet ndikimi i tyre.

4.3.2 Skenari 1: Trendi aktual i cili i referohet gjendjes ekzistuese e që si bazë e ka PZHK në fuqi

Skenari 1 – respektivisht skenari i cili është i bazuar ne trendin ekzistues zhvillimorë, i cili si bazë e ka planin paraprak. Këtu është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe janë identifikuar pikat e forta dhe pikat e dobëta të skenarit dhe në përfundim është bërë vlerësimi përfundimtar i tij se sa është i përshtatshëm që të zhvillohet ne tetë vitet e ardhshme.

4.3.2.1 Pikat e favorshme (pikat e forta)

Investimet në infrastrukturën e trafikut – i përfshinë investimet në rrjetin rrugor në zonën e Grykës së Deçanit, pastaj në rrugët kryesore dhe degëzuese të fshatrave. Deri me tani, infrastruktura e trafikut konsiderohet e suksesshme sa i përket investimeve në rrugët brenda zonës urbane mirëpo me ketë skenarë planifikohet që të investohet në të gjithë infrastrukturën e trafikut brenda zonës urbane dhe lidhja me vendbanimet tjera rurale. Përpos përmirësimit të infrastrukturës së trafikut, brenda zonës urbane, në ketë skenarë propozohet që të behën investimet ne rritjen e sigurisë në të gjithë zonën urbane dhe në zonat rurale. Deçani ne ketë skenarë mbetët si udhëkryq ne nivel Komunal dhe në nivel ndërshtetëror andaj propozohet që të vazhdohet me zhvillimin e akseve të rrugëve rajonale të cilat e lidhin Komunën e Pejës me Komunën e Gjakovës në të cilën është investuar me ndërtimin e rrugës me katër korsi. Mirëpo, krahas saj propozohet që të organizohen edhe vend parkingjet dhe të rritën shtigjet për çiklistë. Andaj zhvillimi i politikave të lëvizshmërisë si plan zhvillimor sektorial do e ndihmon Komunën e Deçanit qe të arrij qëllimet e veta pro mjedisore. Përkundër faktit që rruga kryesore me katër korsi është aktive dhe e ka lehtësuar qarkullimin e automjeteve, në ketë skenarë propozohet që të bëhet edhe analizimi i rrugës transite e cila në të ardhmen do e shkarkon Qytetin e Deçanit dhe ja mundëson zhvillimin e politikave pro mjedisore të cilat i përshtatën qëllimit të zhvillimit të turizmit dhe komune ekologjike.

Aksi tjetër i rëndësishëm është rruga në drejtim të Plavës e cila e konsiderohet si rrugë turistike dhe e ndihmon zhvillimin e rajonit perëndimorë të Komunës në fushën e turizmit. Ky propozim është trajtuar në harmoni me Ligjin nr. 04/L-086 Për parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe e ndihmon komunë e Deçanit që të jetë portë hyrëse ne Kosovë dhe të forcon lidhjet tradicionale me vendbanimet në Malin e Zi.

Infrastruktura Teknike – planifikohet të zgjerohet dhe të plotësohet ne drejtimin lindor respektivisht ne zonat rurale të Komunës Deçanit ndërsa e njëjta gjë planifikohet edhe në pjesën

perëndimore por duke e marr parasysh ligjin[85] e cila e trajton ketë zonë.

Ujësjellësi dhe rrjeti i ujitjes planifikohet të zgjerohet në të gjitha fshatrat ne zonën rurale kurse në zonën urbane është planifikuar rregullimi i të gjithë kanalizimit dhe rrjetit të reshjeve atmosferike. Rrjeti i kanalizimit është i ndarë në tre faza respektivisht faza e parë e cila e mbulon të gjithë zonën urbane; faza e dytë e përfshinë të gjithë zonën e rurale ndërsa faza e tretë është faza e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujerave të zeza. Ne zonë perëndimore, rrjeti i kanalizimit do të trajtohen ne harmoni me ligjin[86]. Shtigjet përgjatë lumenjve janë të rregulluara pjesërisht mirë në ketë skenarë planifikohet që të bëhet rregullimi i tyre përgjatë të gjithë territorit të Komunës Deçanit e cila përpos ofrimit të shtigjeve për ecje dhe çiklizëm ato po ashtu mund të shërbejnë edhe për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit deri të impianti i trajtimit të ujërave atmosferik, ujësjellësit etj. duke i anashkaluar të gjitha shpenzimet e shpronësimit.

Rrejti energjetik do të shtrihet ne të gjithë territorin e Komunës dhe do i plotëson të gjitha kushtet e tensionit të furnizimit të qëndrueshëm. Andaj është më se e domosdoshme që në disa fshatra të mëdha të ndërtohen stacionet e trafo të cilat edhe furnizojnë ne mënyrë të rregullt. Ne ketë skenar, shpërndarja e rrjetit energjetik të qëndrueshëm në zonën perëndimorë do të jetë në harmoni me ligjin për ketë zonë mirëpo edhe me politikat zhvillimore shtetërore dhe ndërshtetërore për furnizim energjetik.

Grumbullimi i mbeturinave ne Komunën e Deçanit është në nivelin e duhur mirëpo kërkohet investim i vazhdueshëm në ketë drejtim dhe të rritët niveli i shërbimit i cili është i varur nga përqindja e pagesës dhe të vazhdohet më largimin e të gjitha deponive ilegale.

Rregullimi i ndriçimit publik është i planifikuar jo vetëm në zonën urbane e cila është ne nivelin e kënaqshëm mirëpo edhe ne në zonat rurale. Shtrimi i rrjetit është i planifikuar të jetë në faza, ku së pari ndriçohen qendrat e fshatrave me ndriçim LED pastaj për të vazhduar me lagjet e fshatrave dhe ne fund lidhja e fshatrave ne mes veti dhe me zonën urbane. Ne zonën perëndimore është planifikuar që të bëhet ndriçimi i rrugës kryesore e cila të dërgon në pikën kufitarë me Malin e Zi dhe pastaj të vazhdohet me zonat e reja turistike të cila janë në harmoni me ligjin për ketë zonë.

Hapësira e hapura publike dhe varrezat – janë trajtuar ma specifikisht në zonën urbane mirëpo duke kaluar edhe ne rregullimin e pjesëve – hapësirave publike në qendrat e fshatrave. Të njëjtin trajtim e kanë edhe varrezat dhe memorialët.

Shërbimet administrative - vazhdojnë të kryhen pothuajse të gjitha nga qendra administrative në Deçan. Komuna e Deçanit në zonën urbane është ajo kryesorja me të gjitha shërbimet mirëpo sipas këtij skenari planifikohet të behët edhe zhvillimi i qendrave administrative në fshatra të cilat kanë ndikim ma të madh dhe frekuentojnë ma shumë banorë.

Në kulturë dhe sport - është planifikuar fuqizimit i Qendrës Rinore, Koloninë e Artistëve, qendrën e trashëgimisë kulturore dhe fshatin turistik në Podin e Gështenjave. Është propozuar rregullimin i shesheve, dy palestrave sportive ndërsa sfiduese paraqitet mungesa e hapësirave për akomodim të vizitorëve.

Në edukim - janë planifikuar rregullimi i hapësirave shkollore dhe përmirësimi i tyre nëpërmes digjitalizimit. Gjithashtu janë planifikuar të ndërtohen edhe tre shkolla tjera.

Në bujqësi – planifikohet të përfundojnë të gjitha ndërtimet e kanaleve të ujitjes, shtirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në zonën urbane dhe të vazhdohet me zonat rurale. Është e rëndësishme që sektori i bujqësisë të fillon krijimin e politikave me të dhënat e sakta për kualitetin e tokës respektivisht të llojit të pemëve dhe perimeve të cilat mund të mbjellën në tokat bujqësore. Nga kjo mund të hapën mundësitë e reja dhe të qëndrueshme për grane dhe përfitime të ndryshëm të

[85] Ligjin nr. 04/L-086 Për parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"
[86] Ligjin nr. 04/L-086 Për parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"

cilat mund ta ndihmojnë sektorin e bujqësisë ne ketë komunë e cila e përbën njërën nga shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm.

NVM - është vërejtur operimi i kompanive ndërtimore dhe investimet janë orientuar në ndërtesat afariste - banesore, ndërsa veprimtaritë tjera në dyqanet tregtare dhe artizanale. Ne ketë skenarë planifikohet qe rruga rajonale Pejë – Prizren të paraqes aksin e zhvillimit ekonomik.

4.3.2.1 Pikat kritike (pikat e dobëta)

Duke u bazuar në zhvillimet, që janë bërë deri me tani në Komunën e Deçanit, skenari në fjalë nuk ka arritur ti plotëson pritshmërinë e zhvillimit të qëndrueshëm. Kapacitetet – resurset ekzistuese natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore nuk janë shfrytëzuar ne mënyrën ma të përshtatshëm dhe të denjë. Përkundrazi, shumë pak është bërë ne mbrojtjen e resurseve natyrore ndërsa trashëgimia kulturore nuk është promovuar aq shumë sa ka kapacitete Komuna. Kjo është një pasqyre e çartë se nëse vazhdohet me ketë drejtim atëherë Komuna e Deçanit nuk do të ketë perspektivë të qartë prandaj propozohet që të nderohet ky drejtim.


Zhvillimi i Komunës i bazuar në resurset natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të prezantuara në ketë skenarë nuk duhet anashkaluar në tërësi mirëpo propozohet që ato të plotësohen me politika sektoriale ma të përshtatshme duke u bazuar ne buxhetin, kapacitetet njerëzore dhe përgjegjësitë e nivelit lokal. Në ketë mënyrë Komuna e Deçanit do të ofron mjedis ma të përshtatshëm dhe të lehtë për të bërë biznes, që të mbroj mjedisin dhe resurset e saj, të promovon trashëgiminë kulturore dhe të balancon zhvillimin në të gjithë hapësirën Komunale. Edhe në ketë skenarë rol të rëndësishëm luan zhvillimi i turizmit dhe bujqësisë. Mirëpo, për të zhvilluar turizmin, duhet të bëhen planifikime të bazuara me plane konkrete ku këto masa do të dëshmojnë dhe bëjnë vlerësimin strategjik dhe ndikim në mjedis, në mënyrë që të minimizohet ndikimi në komponentët e mjedisit. Prandaj është më se e nevojshme që të behët:

- Mirëmbajtja dhe administrimi i mbeturinave.
- Mbrojtja e habitatit për bimët dhe kafshët e egra në shkallë lokale dhe rajonale.
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe menaxhimi i aseteve të trashëgimisë kulturore.
- Promovimi dhe ofrimi i të mirave natyrore dhe kulturore në ofertën turistike me rrjetëzimin ndër Komunal dhe ndërkufitar.

Në qoftë se nuk arrihen të plotësohen këto kushte atëherë Komuna e Deçanit ballafaqohet me rreziqet siç janë:

- Ndotja e ujit, ajrit, tokës dhe degradimin e biodiversitetit.
- Asetet e trashëgimisë kulturore drejt humbjes së vlerave të tyre historike dhe arkeologjike.
- Humbja e fondit të tokës bujqësore nga ndërtimet e pa planifikuara si në zonën urbane dhe zonat rurale.
- Pengimi i zhvillimit në mënyrë balancuar, të integruar dhe të duhur si rezultat i ndërtimeve të shpërndara në zonat rurale dhe koncentrimit të ndërtimit vetëm në rrugën kryesore Pejë - Gjakovë.

Duke marrë parasysh analizën e skenarit të trendit aktual është evident që Komuna e Deçanit, ka nevojë për orientim të ri në drejtimin e saj zhvillimor, prandaj ky skenar konsiderohet i përshtatshëm për Komunën që të krijoj parakushte për një perspektivë premtuese me koncepte të reja duke nxjerr prioritete ne harmoni me nevojat për një zhvillim të qëndrueshëm.



Harta 32. Skenari 1

4.3.2 Skenari 2: policentrik - formë e zhvillimit të shpërndarë

Skenari i dytë është bazuar ne konceptin policentrik – të shpërndarë, në mënyrë të shtrirjes së shërbimeve në tërë hapësirën e Komunës, ruajtja dhe mbrojtje e burimeve dhe resurseve natyrore dhe kulturore, të cilat janë aset i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, që hyjnë në funksion të zhvillimit lokal. Parashtrimi i ideve dhe integrimi i tyre ndër sektorial promovon zhvillimin dhe funksionimin për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë. I gjithë planifikimi zhvillimor duhet të ketë në konsideratë projekte zhvillimore, që krijojnë sinergji planifikuese. Në ketë skenarë është krijuar balancimi brenda Komunës së Deçanit, ku disa vendbanime të cilat kanë koncentrim ma të madh të banorëve do të kanë shërbimet. Vendbanimet tjera të cilat nuk kanë numër të madh të banorëve do të varen nga vendbanimet ma të mëdha ku distanca e lëvizjen nuk do të jetë e madhe. Këto pika të shërbimeve do të ofrojnë propozime të ndryshme zhvillimore duke u bazuar në nevojat e banorëve dhe do të forcojnë komunikimin vertikal në mes të banorëve dhe institucioneve lokale. Të gjitha këto veprime e kanë për synim që të rrisin kualitetin jetesës së banorëve ne Komunën e Deçanit.

4.3.2.1 Pikat e favorshme zhvillimore konkrete

Turizmi - shërbimet përmirësohen në harmoni me kërkesat, që vijnë nga nevojat e zhvillimit, parimet nga sektori i zhvillimit si dhe nga sektorët e tjerë duke përfshirë bujqësinë dhe edukimin në ofrimin e shërbimeve turistike. Ndërtimi i qendrës turistike në Bjeshkën e Belegut dhe ndërtimi i rrugës në Gryken e Deçanit, janë pika të favorshme zhvillimore për ndërtimin e rrjetit hotelerik duke e shpërndarë ketë rrjet të shërbimeve turistike në të gjitha bjeshkët e Komunës së Deçanit. Një rolë kyç në zhvillimin e turizmit ka marketingu, politikat planifikuese të marketingut përfshinë: promovim, brendim, guidat turistike me bukuritë e pamjeve të bjeshkëve, trashëgimia, traditat dhe përshkrim të aktiviteteve të atraksionit dhe rehabilitimit. Në këtë skenarë parashihet fuqizimi i Zyrës Informuese Turistike me karakter të bashkëpunimit ndër Komunal dhe krijimit të rrjetëzimit ndërkufitar dhe

rajonal. Sipas këtij skenari, aksi më i fuqishëm turistik është ai në drejtimin veri perëndimor i cili lidhet me Malin e Zi (ne një pjesë degëzohet edhe më Shqipërinë nëpërmes Komunës Junikut) dhe përbëhet nga Zona e Veçantë e Mbrojtur[87]. Ndryshe ky aks njihet edhe si Zona e Promovimit të Vlerave Turistike. Në anën lindore ky aks degëzohet nëpërmes rrugëve por edhe lumenjve në drejtim të fshatrave të cilat janë të pasura me ndërtesa me vlera arkitektonike, shpirtërore dhe monumentale siç janë kullat, xhamitë, kishat, varrezat, monumentet dhe komplekse memorialë. Kjo shpërndarje e aksit dhe shtigjeve turistike e balancon zhvillimin e turizmit ne Komunën e Deçanit dhe krijon një fond të madh të ofertave të ndryshme turistike.

Bujqësia - Iniciativat deri me tani të ndërmarra në bujqësi kanë qenë me synim të arrijnë në prodhime bujqësor me logjikën e zinxhirit të furnizimit të shkurtër duke kërkuar cilësi të lartë në prodhimin intensiv dhe transformimin e industrisë së ushqimit (varietetet autoktone), zakonisht duke nxjerr produkte vendore në prodhim në formë tradicionale. Projektet e bujqësisë të orientohen në formën e investimeve në teknologjinë e përpunimit të produkteve në agrikulturë dhe gastronomi. Pjesa lindore do të jetë e dedikuar për bujqësi ndërsa ne pjesën perëndimorë do të zhvillohet brenda kornizave të parapara ligjin për këtë zonë. Duhet të ceket se pjesa lindore sipas këtij skenari do të jetë e zhvilluar me rrjetin e ujitjes dhe për mbrojtjen e tokës bujqësore është planifikuar të mbulohet e gjithë zona me rrjet të kanalizimit dhe atij atmosferik. Gjithashtu si modalitet i këtij skenari është edhe krijimi i politikave të komasacionit e cila mund të sjellë mjaft përfitime për banorët e këtyre zonave.

Përmirësimi dhe zgjerimi i hapësirave publike - Hapësirat publike ekzistuese duhet të zgjerohen, në gjithë zonën urbane, po ashtu duhet të zgjerohen edhe tek hapësirat jashtë qytetit në zonat rurale, aty ku pritën vendkalimet, parqet dhe sheshet. Bashkë më zgjerimet e këtyre hapësirave duhet paraprakisht të planifikohet edhe trajtimi urban me dizajnin atraktiv dhe aplikimin e konceptit identifikues për vendin dhe rrethinën (sheshet).

Promovimi i vlerave kulturore - Deçani identifikohet me vlerat e trashëgimisë jo materiale (shpirtërore), traditën e mikpritjes, të zakoneve, festave tradicionale të cilat i kanë mbijetuar kohës edhe sot këto manifestime tradicionale festohen. Vend lokalitet me vlera të kulturës natyrore dhe kulturore përfaqëson secila pjese e Komunës së Deçanit, secili lokalitet ka edhe specifiken e vetë prezantuese ku duhet të veçohet hapësira e Grykës së Deçanit, me gjurmët arkeologjike, arkitektonike dhe historike si: Manastiri i Deçanit, Ujë i Thartë (Gushavci), Kërshi i Çelisë, Zona arkeologjike e Belles, Pleqes, lumenjtë ruajtja dhe rigjenerimi i zonës së gështenjës. Gjithashtu ndërtesat e trashëgimisë kulturore duke përfshi: kullat ku një pjese e tyre është në mbrojtje të përkohshme kurse duhet të jenë në konsideratë edhe fondi i mbetur i kullave, mullinjve, ndërtesave të trashëgimisë kulturore të tjera-hambar, kultit fetar, monumentet e natyrës, zonat me interes zhvillimor qoftë turistik, rekreativ dhe edukativ. Deçani, në përgjithësi duhet të konsiderohet si një qendër, që ofron vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, që janë unike të cilat duhet të mbahen në përkujdesje dhe investime të vazhdueshme institucionale. Në këtë skenarë parashihet fuqizimi i një rrjeti ndërlidhës në mes të gjitha hapësirave dhe ndërtesave të trashëgimisë kulturore dhe sigurimi i mjeteve qarkulluese për t'ju mundësuar vizitorëve qasje të lehtë dhe atraktive.

Qasje dhe lëvizshmëri e qëndrueshme - qarkullimi i brendshëm i pjesës së qytetit nën përkushtimin urban, që të arrihet kjo qasje e lehtë pranë ndërtesave të shërbimeve publike, mundësi e lëvizjes së lirë për këmbësoret, nxënësve për arritjen në shkolla, qarkullim i lehtë për automjetet dhe mjetet transportuese për furnizim, janë probleme të cilave u është qasur administrata Komunale me intervenimet maksimale të lejuara sipas kompetencave të gjendjes ekzistuese. Është bërë përmirësimi në zgjerimin e trotuareve ekzistuese dhe ndërtimi i atyre të reja në pikat kyçe, janë asfaltuar rrugët qarkore të cilat mundësojnë anashkalimin e qendrës së qytetit. Në drejtim të hyrjes nga Gjakova është mundësuar degëzimi i rrugës në dy drejtime nga vendi i quajtur "Bunari i Fushës '' kah Belegu djathtas dhe në anën e kundërt drejtimi i Carrabregut.

[87] Ligji nr.03/L-039 Për zonat e veçanta të mbrojtura


4.3.2.1 Pikat kritike (pikat e dobëta)

Ky skenar ndjek pjesërisht një qasje të integruar hapësinore territoriale, i cili mundëson sinergji projektesh për t'u lidhur me zhvillimin e zonave me interes të Komunës, siç është Parkut Kombëtarë, të cilat janë për zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe zonat me interes të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuptim, ky skenar vë në funksion vetëm ato fusha të planifikimit ku ekziston një lidhje/ndikim i menjëhershëm i aktiviteteve të lidhura me zhvillimin ekonomik lokal-turizmin, por nuk merr parasysh një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse duke përfshi integrimin e sektorëve të tjerë në zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies sociale. Përkundër potencialeve të mëdha të zhvillimit të turizmit në të gjithë territorin e Komunës së Deçanit, duhet të cekët se varësia e Komunës vetëm në turizëm nuk rezulton me zhvillim të qëndrueshëm ne tetë vitet e ardhshme. Sektori i turizmit nuk duhet të anashkalohet mirëpo jo të fokusohet vetëm në të, për shkak se:

- Komuna e Deçanit nuk ka përvojë të madhe në menaxhimin e të gjitha resurseve turistike.
- Zhvillimi i turizmit nuk është fushë e cila zhvillohet shpejtë. Përkundrazi, ekzistojnë mjaft sektorë të cilat duhet të zhvillohen paraprakisht para se të zhvillohet turizmi siç janë p.sh. rritja e vetëdijesimit për përfitimet nga turizmi, edukimi i banorëve për hapjen dhe menaxhimin e bujtinave, hosteleve, moteleve dhe hoteleve, promovimi i Komunës së Deçanit për potencialet natyrore, kulturore dhe të trashëgimisë dhe hartimi i projekteve të ndryshme të cilat sjellin grante sepse buxheti i Komunës së Deçanit nuk është i mjaftueshëm për të zhvilluar turizmin.
- Konkurrenca – e cila ndodhet brenda Kosovës dhe jashtë kufijve shtetëror. Duhet të cekët se përkundër bashkëpunimit të mirë ndër Komunal dhe ndërshtetëror ekzistojnë edhe një konkurrencë në mes të Komunave (në ketë rast ne mes të Deçanit, Pejës dhe Junikut) për ofrimin e ofertave sa ma të mira për turizëm. Ndërsa në nivelin ndërshtetëror konkurrenca është e ndjeshme nga pjesa veriore e Shqipërisë dhe pjesa lindore e Malit të Zi të cilat kanë projekte dhe ndihma konkrete nga niveli qendror për zhvillimin e turizmit ne këto zona.

Për ti anashkaluar të gjitha këto, duhet të merret parasysh një qasje e strukturuar integruese, ndër Komunale dhe rajonale duke pasur parasysh edhe këto politika planifikuese:

- Vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë në propozimin për financimin e politikave lokale zhvillimor, çështje të lidhura me planifikimin e qëndrueshëm të shfrytëzimit racionale të resurseve natyrore, njerëzore, bujqësore, trashëgimisë, kulturës dhe promovimin e shërbimeve turistike.
- Politikë planifikuese me projekte adekuatë për banimin, akomodim për krijimin e kushteve dhe rritjen e numrit të vizitorëve.



Harta 33. Skenari policentrik

4.3.2 Skenari 3: I zhvillimit të baraspeshuar duke u bazuar në zhvillimin e planifikuara me PZHK 2009 – 2017 dhe policentrik (kombinuar)

Skenari i tretë është i bazuar në balancimin e zhvillimit në mes të pjesës lindore dhe perëndimore të Komunës së Deçanit. Kjo mbështetët ne shumë sektor respektivisht në gjithë përfshirjen e të gjitha sektorëve të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies dhe kualitetit të jetesës së banorëve. Ky skenar e krijon lidhjen ne mes të sektorit publike dhe sektorit privat, pra sektori privat i cili është potencial në zhvillimin e Komunës së Deçanit do të jetë pjesë përbërëse e partneritetit.

4.3.2.1 Pikat e favorshme (pikat e forta)

Në këtë skenar vijnë në shprehje një shkallëzim në rritje dhe gjithëpërfshirës në planifikim. Baza zhvillimore ndërtohet mbi përmbajtjen e skenarit të parë duke i përdorur edhe disa sinergji nga skenari i dytë (siç është rasti i policentrizmit) por të detajuara në plotësimet e nevojave, kërkesave dhe sfidave zhvillimore. Për deri sa në skenarin e parë mbesin në planë të parë zhvillimet kryesore në infrastrukturë dhe pjesërisht zhvillimet indikativë në turizëm, bujqësi dhe ruajtjen e mjedisit, në këtë variant mirën parasysh të gjitha fushat, që kanë ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve me prioritet pa lënë anash të gjithë sektorët tjerë dhe tentohet me veprime strategjike integruese më platformën gjithëpërfshirëse të sistemohet zhvillimi paralel, të hyjnë në proces të gjithë arteret në zhvillim dhe të prekën të gjitha fushat tematike.

Infrastruktura e trafikut – ne këtë skenarë bazohet në rrjetin ekzistues rrugor duke i përmirësuar akset rrugore ne drejtimin verior respektivisht në drejtim të Pejës, në drejtimin jugor – drejt Gjakovës dhe përmirësimin e aksit rrugor në drejtimin të Malit të Zi e i cili kalon në Zonën e

Veçantë e Mbrojtur. Në ketë skenar merret parasysh auto udha e propozuar për zonën e Dukagjinit e që lidh Komunën e Istogut me Komunën e Prizrenit. Për zonën perëndimore propozohet qasja deri me Malin e Zi e cila përpos rrugës janë planifikuar edhe lëvizjet me biçikleta, shtigje për biçikleta malore, shtigje për ecje etj. Për ti zhvilluar të gjitha këto, sipas këtij skenari Komuna e Deçanit duhet ta harton dokumentin zhvillimor sektorial për lëvizshmëri e cila i cakton të gjitha modalitetet e lëvizjes. Ne anën lindore janë planifikuar të plotësohen aktet e lëvizjes për biçikleta dhe trotuare të cilat përpos lidhjes me zonën urbane, ato do të kanë lidhje edhe me zonën perëndimore drejt Bjeshkëve të Nemuna për arsye të zhvillimit të turizmit. Alternativë është që në hyrje të Komunës së Deçanit nga veriu drejt jugut të bëhet devijimi i rrugës e cila do të ketë karakter transitor dhe do i ndihmon zonës urbane që të shkarkohet nga trafiku i motorizuar apo nëpërmes zhvillimit të politikave të lëvizshmërisë të largohet trafiku i tonazhit të rëndë. Gjithashtu, brenda zonës urbane propozohet të shtohet gjatësia e shtigjeve për biçikleta dhe a ma shume zona për ecje duke krijuar hapësira publike, sheshe dhe sa ma shumë gjelbërim. Gjithashtu, sipas propozimit të këtij skenari, parkingjet do të rregullohet për pjesët e qendrave të qytetit të Deçanit, por edhe nën qendrave Drenocit, Isniqit, Irzniqit dhe Strellcit të Epërm. Po ashtu, nën qendrat ne Drenoc, Isniq, Irzniq dhe Strellc të Epërm do të plotësohen si identitete të reja të këtyre vendbanimeve. Infrastruktura e trafikut e propozuar realizohet brenda kornizës buxhetore Komunale e cila duhet të jetë e koordinuar edhe me politikat e investimeve kapitale në infrastrukturën e trafikut

Infrastruktura Teknike – është e njëjtë sikurse infrastruktura Teknike e skenarit zero por me një propozim të ri për ndërtimin e parqeve solar të cilat do e ndihmojnë Komunën e Deçanit në përgjithësi (si sektori publik ashtu edhe ai privat) për furnizim me energji elektrike. Ky propozim bazohet ne modalitetet e investimit nga vetë Komuna ne pronat e veta Komunale apo edhe nëpërmes partneritetit publiko privat. Gjithashtu, ne sektorin e energjisë elektrike rendësi e vençat i është jep edhe promovimi, kreditimi apo bashkëfinancimi i energjisë së ripërtritshme për njësitë familjare. Përgjatë lumenjve ne Komunën e Deçanit, do të ndërtohen shtigjet për ecje të cilat do të shërbejnë edhe për infrastrukturën Teknike ndërsa në bashkëpunim me nivelin qendror do të hartohen politikat zhvillimore për impiantin e ujërave të zeza por edhe të energjisë elektrike. Gjithashtu ne ketë skenarë, është planifikuar që të bëhet edhe "lidhja e kaltër" e cila e lidh Deçanin me liqenin e Radoniqi.

Hapësirat publike dhe varrezat – janë propozuar që të kanë lidhshmëri ne të gjithë zonën urbane, dhe lidhshmëri me nën qendrat. Ne anën perëndimore propozohet që të fillo depërtimi nga parku kombëtar drejt zonës urbane në formën e biofilizmit me synim të rritjes së sipërfaqes ne m2 për një banorë. Në Komunën e Deçanit nuk ka politikë të qartë për hapësirat publike andaj është më se e nevojshme që të hartohet një dokument i tillë i cili do e ndihmon mjaft Komunën për kategorizimin, organizimin, investimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Shërbimet administrative – propozohen që të janë të shpërndara me synim të gravitimit sa ma të madh të banoreve ndërsa lëvizja të jetë sa ma e shkurtër. Andaj one-stop-shop është e propozuar të jetë jo vetëm ne qendrën administrative gjegjësisht në Qytetin e Deçanit, por edhe në nën qendrat siç janë Drenoci, Isniqi, Irzniqi dhe Strellci i Epërm.

Kultura dhe sporti – sipas këtij skenar bazohet ne një plantë aktiviteteve të ndryshme kulturore ndërsa për zhvillimin e aktiviteteve sportive, propozohet shtimi i terreneve sportive në zonën urbane dhe ato rurale me synim të zhvillimit të infrastrukturës sportive. Sportet e reja të cila planifikohen të zhvillohen janë skijimi të cilat do të zhvillohen ne pjesën perëndimore të Komunës duke u bazuar ne ligjin dedikuar kësaj zone. Atraksionet e planifikuara për aktivitete sportive dhe kulturore janë zonat e atraksionit në Lloqan, atraksioni i Lumëbardhit, atraksioni i Gështenjave dhe Pishave.

Edukimi – i nënshtrohet digjitalizimit ndërsa sipas këtij skenarit rekomandohet qe të zhvillohen drejtimet të cilat do e risin nivelin e kapaciteteve profesionale njerëzore për zhvillimit e

turizmit qofshin turizëm transitor, vizitë disa ditore apo turizmi disa ditorë. Rëndësi ne ketë drejtim i është dhënë edhe zhvillimit të turizmit shëndetësor dhe sportiv andaj edukimi programi i edukimit në ketë drejtim duhet të përqendrohet ne këto drejtime.

Bujqësia – është njëra nga shtyllat kryesore të këtij skenari krahas zhvillimit të turizmit. Bujqësia planifikohet të zhvillohet në anën lindore ndërsa në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit do të zhvillohet sipas udhëzimeve të kornizës ligjore. Në ketë skenarë janë planifikuar në ndërtohen disa akumulues të cilat do ta ndihmojnë sektorin e bujqësisë në stinët e nevojshme për ujitje mirëpo edhe për atraktivitete të ndryshme ujore.

NVM – do të zhvillohen brenda zonës urbane mirëpo edhe në zonat e caktuara rurale të cilat do të janë të dedikuara bujqësisë por edhe industrisë së lehtë e cila nuk do të ketë ndikim në mjedisin. Akset kryesore të cilat do të zhvillohen me NVM do të janë kryesisht në aksin kryesor të rrugës nacionale e cila kalon në mes të zonës urbane të Deçanit ndërsa në anën jug perëndimore është planifikuar të zhvillohet edhe parku solar. Zhvillimi ekonomik do të jetë në tre drejtime respektivisht ekzistojnë tre drejtime të mbrojtjes dhe zhvillimit nga ku:

- Është në drejtimin e Pejës (verilindje)
- Është në drejtimin e Malit të Zi (veriperëndim)
- Është në drejtimin e Gjakovës (juglindje).


Turizmi – është njëra nga shtyllat kryesore të zhvillimit të Komunës së Deçanit. Ajo është e përqendruar – balancuar në të gjithë Komunën e Deçanit respektivisht në ato malor dhe rural. Të planifikimet zhvillimore të bëhet paraprakisht vlerësim strategjik i fizibilitetit mjedisor për investime kurse gjatë realizimit të projekteve të aplikohet raporti të VNM-së.

Vendbanimet – Zhvillimi i vendbanimeve do të jetë ma i përqendruar në zonën urbane ndërsa ne nivelin e dytë janë planifikuar zhvillimet në nivelin nën qendrave. Në zonën urbane planifikohet zhvillimi në ne katër drejtimet ne mënyrë të kontrolluar. Këtu kuptohet që duhet pasur kontroll të zhvillimit të ndërtimeve e me theks të veçantë mbrojtjen e tokës ndërtimore.

4.3.2.1 Pikat e kritike (pikat e dobëta)

Sikurse skenarët e më përparshme edhe ky skenarë i ka pikat e saja të dobëta të cilat në një mënyrë apo tjetër kanë kontradikta përkundër sinergjive të sajë. Disa nga problemet e identifikuara nga ky skenar është buxheti i vogël Komunal, mungesa e resurseve profesionale njerëzore, mos identifikimi i problemeve ne mënyrë thelbësore të Komunës se Deçanit të cila nuk janë identifikuar ne ketë skenarë ose të cilat nuk janë të bashkërenditura si dhe pjesëmarrja e të gjitha grupeve të interesit, hisedarëve dhe banorëve jo vetëm gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së por edhe gjatë zbatimit të tij.

Gjithashtu, një nga pikat e dobëta të këtij skenari është zhvillimi turizmit e cila kërkon mjaft kohë që të promovohet dhe të zhvillohet kjo sferë ndërsa turizmi ne këtë skenarë është njëra nga tre shtyllat kryesore.



Harta 34. Skenari i zhvillimit të baraspeshuar

4.3.3 Vlerësimi i skenarëve

Gjatë zhvillimit të skenarëve grupet punuese i kanë hartuar disa skema zhvillimore të bazuara në turizëm, mbrojtjen e lumenjve, zhvillimin e qasjes së lehtë dhe të sigurt dhe zhvillimin ekonomik. Shërbimet ndaj banorëve dhe vizitorëve është tjetër fushë e cila është e rëndësishme për zhvillimin e komunës. Këto fusha janë konsideruar si ma te rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm ne të ardhmen me qenë se bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Koncepti i vlerësimit të skenarëve është bazuar në metodologjinë e skemave grafike të cilat përmbajnë elementet e analizës SWOT, qëllimet dhe objektivave. Metodologjia e skemave grafike e lehtëson procesin e vlerësimit të skenarëve duke i nxjerr pikat potenciale por edhe kritike te çdo skenari, duke i vlerësuar ato me pikë dhe duke i marr parasysh mundësitë financiare dhe njerëzore. Të gjitha këto skema janë trajtuar ne tabelën e mëposhtme.


Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – turizmi		
	Skenari 1 PZHK	Projektet e planifikuara për ngritjen e infrastrukturës së turizmit në Komunën e Deçanit, pengohen nga korniza ligjore me arsyetim se këto projekte ndikojnë në mënyrë negative në zonat e caktuar të Grykës së Deçanit. Korniza ligjore ketë skenarë e pengon dukshëm në zhvillimin e saj e si rrjedhojë ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik lokal. Më theks negativ duhet të veçohet - gjendja e tanishme rrugës e pa asfaltuar në Grykën e Deçanit e cila për çështje politike e dëmton mjaft zhvillimin e turizmit ne ketë anë me qenë së është e vetmja qasje kryesore për në ketë zonë. Realizim i projektit të Kelkos ka ndikuar në shfaqjen e erozionit ne disa pika të rrugës dhe ka krijuar paqëndrueshmëri të tokës.
	Skenari 2 policentrik	Zhvillimi i turizmit në ketë skenarë është i bazuar në të gjithë territorin Komunal respektivisht në atë malor dhe atë rural. Zhvillimi i turizmit sipas këtij skenari ka krijuar balancim ne të gjithë territorin, mirëpo fokusi i saj është i bazuar vetëm në turizëm gjë e cila nuk ofron siguri dhe qëndrueshmëri ekonomike. Andaj, është e nevojshme që të plotësohet me ma shumë veprime avancues për zhvillimin e turizmit me integrimin ndër sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë duke krijuar sinergji të projekteve me rrethinën urbane dhe planifikimet për projekte zhvillimore në zonën malore dhe rurale.
	Skenari 3 i baraspeshuar	Ne ketë skenarë turizmi shihet si një promotorë – njëra nga shtyllat kryesore zhvillimore e cila ka balancë të plotë hapësinorë të zhvillimit turistik. Sipas këtij skenari, plotësohen të gjitha kushtet e lidhje së pjesës malore me atë rural ne fushën e turizmit ku si lidhje kryesore është zona urbane. Ky skenar propozon që të hartohet një platformë zhvillimore për kategorizimin e Komunës së Deçanit, me prioritet me interes të përgjithshëm destinacion turistik duke përfshirë zhvillimin dhe investimet në të gjithë sektorët e zhvillimit ekonomik lokal. Ofrojnë mundësi të investimeve zhvillimore në Zonën urbane, Grykën e Deçanit dhe zonën rurale të cilat janë në interes lokal dhe nacional.

Tabela 189. Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – turizmi


Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – lumenjtë		
	Skenari 1 PZHK	Investimet që kanë ndodhin në lumin e Lumëbardhit paraqesin nismën në aksin e ri për zhvillimin në aspektin e turizmit, lëvizjes dhe qasjes së lirë e pa pengesa. Kjo qasje e re e ndihmon Komunën e Deçanit që të krijon lëvizje aktive përgjatë lumenjve të saj. Me rregullimin e brezave të lumenjve dhe ndërtimit të shtigjeve për ecje krijohet një arterie e re në depërtimin drejt zonës së gjelbër si rrip ndërlidhës nga Qyteti në drejtimin e bjeshkëve. Ligji për Zonën e Veçantë të Mbrojtur ka ndikuar që kjo strategji të ndërpritet dhe për momentin ekziston vetëm një pjesë e cila është e rregulluar dhe i ofron qytetit të Deçanit qasje ne lum, kështu që rrjedha e ujit të Gushavcit nuk mund të jetë hapësirë e atakuar për zhvillim.
	Skenari 2 policentrik	Aksi përgjatë brigjeve të Lumëbardhit detyrimisht lind nevojën për shpronësimin e disa parcelave, ridestinimin e rripit përgjatë shtratit të lumit, depërtimin prej njërës anë në anën tjetër të Lumëbardhit. Rreziku vjen nga interesimi për ndërtime përgjatë bregut të Lumëbardhit dhe si pasojë do të krijohet ndërtim përgjatë këtij aksi .
	Skenari 3 i baraspeshuar	Përgjatë lumenjve zhvillohet hapësirat për lëvizje të cilat e lidhin pjesën perëndimore me atë lindore respektivisht të gjitha shtigjet e ecjes e çiklizmit që planifikohen në pjesën perëndimore do të kanë lidhje jo të drejtë për drejt (aty ku bijën ndesh me ZVM) me lumenjtë. Një numër i pronave që ndodhen ne kufi me lumenjtë do të shpronësohen ndërsa do të krijohen lidhjet tjera të karakterit tradicional dhe kulturore nga zonat rural drejt këtyre lumenjve. Këto rregullime përpos integrimit dhe baraspeshimit të gjitha vendbanimeve ato ne të njëjtën kohë ofrojnë qasje dhe lëvizje të lirë deri të liqeni i Radoniqi, duke ofruar mundësi të mira të zhvillimit të projekteve nder Komunale. Gjithashtu, për nevojat e zhvillimit të bujqësisë, janë planifikuar disa akumulues të cilët do të kanë ndikim pozitiv në shumë sfera.

Tabela 190. Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – lumenjtë


Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – infrastruktura		
	Skenari 1 PZHK	Linjat komunikuese ndër urbane me qasje nga periferia e qytetit dhe lidhja me zonat rurale përkojnë me nevojat për t'u lidhur me dy shtetet fqinje: Shqipërinë (nëpërmes Komunës Junikut) dhe Malin e Zi. Po ashtu kjo qasje kalon përmes rrugëve të Bjeshkëve të Deçanit, ku duhet të bëhen investime në mirëmbajtën dhe ndërtimin e rrugëve që lidhen me shtetet fqinje.
	Skenari 2 policentrik	Problemet në qarkullim janë të koncentruar në rrugën kryesore të qytetit. Kjo rrugë kryqëzohet me të gjitha hyrje-daljet nga tre drejtimet (nga Peja, Gjakova dhe Gryka e Deçanit) dhe mund të lehtësohet nëse ndërtohet auto udha e Dukagjinit, e cila do t'ia lehtësoj rrugën kryesore. Kjo auto udhë do të ulë zhurmën në zonën urbane dhe do të ndikon në zvogëlimin e ndotjes dhe ofrojnë kushte për zhvillimin e lëvizjes aktive.
	Skenari 3 i baraspeshuar	Sistemimi i gjithë transportit publik: auto udha e Dukagjinit, rrugët përmbledhëse dhe shpërndarëse brenda zonës urbane, rregullimi i parkingut, shtigjet për ecje, shtigjet për çiklizëm, do të rregullohen me hartimin e dokumentit sektorial për lëvizshmëri. Rrugët kryesore nacionale mbetën me prioritet me theks të veçanta rruga e cila nëpërmes Grykës së Deçanit e lidh Kosovën me Malin e Zi. Ky është një prioritet i cili do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik. Rrugët nacionale do të plotësojnë të gjitha kushtet e lëvizjes aktive ndërsa në zonën rurale do të krijohet një rrjet i qëndrueshëm rrugor i cili nëpërmes fshatrave të ndryshme do të lidhet me Komunat fqinje respektivisht Komunën e Pejës dhe të Junikut ndërsa për arsye të zhvillimit turistik rrjeti rrugëve do të lidhet edhe me liqenin e Radoniqi. Për çështje kulturore dhe të trashëgimisë, rrjeti i rrugëve do të ketë lidhje edhe me monumentet e me theks të veçanta atë të Gllogjanit si dhe me Manastirin e Deçanit. Të gjitha këto rrugë do të kanë prioritet lëvizjen aktive respektivisht trotuaret për ecje dhe shtigjet për biçikleta.

Tabela 191. Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – infrastruktura


Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit –bizneset		
	Skenari 1 PZHK	Biznesi është funksional por i kufizuar. Dyqanet më se shumti janë të zhvilluara në rrugën e cila e lidhë Pejën me Gjakovën nëpërmes qendrës së Deçanit. Kjo rrugë është e ngarkuar dhe ka mungesë të parkingjeve për furnizim të rregullt. Maketet e mëdha janë përgjatë rrugës kryesore dhe krijojnë pengesa në komunikacion. Ato kanë hapësira përcjellëse shumë të vogla komfor normave të planifikimit për veprimtarinë që ushtrojnë. Tregu i qytetit zhvillohet në masë të madhe në pronën privatë dhe për çështje pronësie nuk janë arritur kapacitetet e duhura për standardet e kërkuara. Treg të kafshëve nuk ka fare. Tregjet mobile organizohen përgjatë rrugës pa kushte higjienike. Zona industriale nuk ekziston ndërsa ne rrugët drejt Grykës së Deçanit janë disa biznese të gastronomisë.
	Skenari 2 policentrik	Bizneset nuk janë të koncentruar por të shpërndara në tërë zonën e qytetit ku duhet disa të jenë të zona industriale, si tip i koncentruar i bizneseve. Nisur nga fakti se e gjithë hapësira është pronë privatë atëherë do të shtohet kujdesi që të grumbullohen përmbajtjet e reja në ri funksionalizim dhe të bëhen ndërtime sipas planifikimit të lejuar. Kërkohet një Sistemim i ri në tërë hapësirat afaristë varësisht prej natyrës së fushë veprimtarisë.
	Skenari 3 i baraspeshuar	Plani ofron një model të veçantë në shtrirjen e zhvillimit hapësinor, precizohet në hartën për shfrytëzimin e tokës. Rruga nacionale Pejë – Gjakovë do të mbetët aksi fuqishëm i zhvillimit të bizneseve të ndryshme. Parku i biznesit i planifikuar në fshatin Drenoc është masa që lindë procesin inovativ në strategjinë e deritashme të bizneseve. Veprim që konsolidon bizneset duke krijuar kushtet për pjesëmarrjen në treg, u jepet rast bizneseve dhe stimulon politikat e tregut konkurrues. Pikat grumbulluese për produktet e agrikulturës së pakut në tri zona rurale janë hapat pasues në politikën urbane për shtimin e programeve në fushën e bujqësisë .

Tabela 192. Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – biznesi


Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – bujqësia		
	Skenari 1 PZHK	Bujqësia konsiderohet si një nga shtyllat kryesore për zhvillimin ekonomik të Komunës Deçanit. Zbatimi i politikave bujqësore nuk kanë qenë ne nivelin e duhur. Kjo për shkak se buxheti Komunal nuk i plotësonte të gjitha kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e tij në mënyrën adekuatë. Kushtet e paqëndrueshme klimatike (erërat, reshjet, vërshimet, mungesa e ujit) kanë ndikuar shpesh herë ne uljen e prodhimeve të ndryshme bujqësore. Po ashtu, interesimi për zhvillimin e bujqësisë ne kohët e fundit ka filluar të bie çka ka ndikuar ne mos punimin e tokës e këtu kanë ndikuar edhe politikat nga niveli qendror për subvencionimin e sektorit bujqësor. Përkundër vështirësive, Komuna e Deçanit ka arri që ta ris gjatësinë e kanaleve për ujitje si dhe mbrojtjen e disa zonave nga vërshimet e lumenjve.
	Skenari 2 policentrik	Zhvillimi i bujqësisë në këtë skenarë është ma inferior se sa zhvillimi i turizmit. Bujqësia zhvillohet vetëm ne pjesën lindore të saj. Për rritjen e prodhimeve bujqësore planifikohet të rritët sipërfaqja e tokës së ujitur, rritja e subvencioneve si dhe ofrimi i kushteve për plasim e prodhimeve vendore. Propozohet që të hartohen politikat zhvillimore të këtij sektori i cili do të jetë plan strategjik për 20 vitet e ardhshme.
	Skenari 3 i baraspeshuar	Zhvillimi i bujqësisë është i baraspeshuar. Në akt, zhvillimi i bujqësisë është i njëjtë sikurse zhvillimi i turizmit dhe NVM. Ne këtë rast të tre këto fusha bashkëveprojnë në mes vetë dhe krijojnë sinergji të baraspeshuar ku në pjesën lindore të Komunës Deçanit është planifikuar të shtrihet rrjeti i ujitjes, të krijohen akumuluesit, të ndërtohen disa pika grumbulluese të prodhimeve bujqësore si dhe në zonën e planifikuar për biznes të caktohen disa sektor dedikuar vetëm bujqësisë me synim që Komuna e Deçanit të jetë pikë reference për prodhimet bujqësore ne nivelin kombëtar. Gjithashtu, këto produkte bujqësore planifikohen të eksportohen edhe në shtetet fqinje siç janë Shqipëria dhe Mali i Zi. Ndërsa sa i përket pjesës perëndimore, bujqësia do të zhvillohet ne nivel ma të ulët, ashtu siç e ka caktuar ligji për këtë zonë. Kjo do të ndikon mjaft në rruajtjen e florës mirëpo edhe habitatet e ndryshme të faunës. Vëmendje e veçantë i është jep sektorit të shëndetësisë respektivisht caktimin e zonave në të cilat do të kultivohen prodhime të ndryshme bujqësore mjekësore. Kjo lidhet drejt për se drejti edhe me nivelin e edukimit, ku rëndësi e veçantë ne shkollat e Komunës Deçanit do të jetë drejtimi i kultivimit të produkteve të ndryshme bujqësore mjekësore.

Tabela 193. Vlerësimi i implikimit hapësinor të skenarëve në procesin e planifikimit – bujqësia

		
Koncepti i nyjës	Koncepti i korridori	Koncepti i plotësimit dhe dendësimit
Skenari 1: Banimi është i përqendruar në zonën urbane dhe ma pak në vendbanimet tjera. Gjithashtu punës më shumë i është jep rëndësi në zonën urbane se sa në atë rurale ndërsa rekreacionet janë të propozuara ne zonë urbane dhe ma pak në atë rurale. ***Skenari 2:*** Banimi nuk është i përqendruar vetëm ne zonë urbane mirëpo ka një shpërndarje në të gjitha vendbanimet e cila sipas këtij skenari do të ndikon edhe në hapjen e vendeve të punës në sektorin e turizmit. Rekreacioni është i shpërndarë në të gjithë territorin e Komunës sepse ky skenar mbështetët në zhvillimin e turizmit. ***Skenari 3:*** e ka përdorur konceptin e nyejve në mënyrë ma të përgjithshme. Sipas këtij skenari, është bërë kategorizimi i banimit në ato të zonës urbane, nën qendrat dhe vendbanimet ma të vogla -fshatrat. Vlejnë të cekët se me ketë skenar duke e zbatuar konceptin e nyjave tentohet që të rikthehen banorët në viset malore ndërsa jeta në zonat rurale të jetë me e qëndrueshme. Kjo nënkupton se me zhvillimin e sektorit të turizmit, bujqësisë dhe NVM do të rritët edhe numri i të punësuarve në të gjithë territorin e Komunës. Rekreacioni është i përhapur në të gjithë territorin e Komunës dhe ka lidhshmëri të ne mes të zonës urbane, malore dhe rurale.	***Skenari 1:*** konceptin e korridoreve e ka pas të zhvilluar ne rrugët nacionale të cilat e kane lidh Pejën dhe Gjakovën. Gjithashtu një nga korridoret e rëndësishme ishte edhe lidhja me Malin e Zi. Korridoret e lidhjes se nyjave respektivisht me nën qendrat nuk ishin të cekura ne detale respektivisht pa treguar se me cilat nyje behej lidhja. ***Skenari 2:*** zhvillimi është i përqendruar ne zhvillimin turistik duke i marr parasysh korridoret e lidhjes se nyjave respektivisht rrugët rajonale, lidhjet me Komunat fqinje, lidhjet me shtetet fqinje si dhe lidhjen me vendbanimet ne të gjithë Komunën e Deçanit. Të cilat njihen si “korridore të gjelbra”. ***Skenari 3:*** e ka të zhvilluar konceptin e korridorit të ngjashëm me skenarin policentrik mirëpo ne këtë rast merret parasysh edhe zhvillimi i auto udhës se Dukagjinit e cila do i ndihmon zhvillimit të Komunës ne ta ardhmen. Pjesa e rrugës nacionale e cila kalon nëpër zonën urbane të Deçanit konsiderohet si pjesa e cila do të ketë më se shumti zhvillime, me theks të veçantë zhvillimin e NVM. Andaj sipas këtij skenari, zbatimi i konceptit të korridoreve do ti mundëson Komunës Deçanit se nëpërmes korridorit që e lidh Deçanin me Gjakovën të zhvillohen aktivitetet e ndryshme (me theks të veçantë të biznesit) të cilat do të krijoj një bosht të fort dhe qëndrueshëm ekonomik. Gjithashtu me zhvillimin e bizneseve në ketë korridor, do të ndihmon mbrojtjen e tokës kualitative me qenë së se ajo zonë tashmë është e kontaminuar nga gazrat e automjeteve, gomat, pluhuri etj.	***Skenari 1:*** konceptin e plotësimit dhe dendësimit e ka pas të përqendruar vetëm në zonën urbane ndërsa ne nën qendrat apo vendbanimet nuk ka pas politika të qarta të plotësimit dhe dendësimit. ***Skenari 2:*** plotësimin dhe dendësimin e ka të përqendruar në zonë urbane dhe ma pak në vendbanimet tjera. Synohet që në ketë skenarë koncepti plotësimit dhe dendësimit të jetë gradual duke u bazuar ne zhvillimin ekonomik respektivisht të turizmit. ***Skenari 3:*** e planifikon plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane respektivisht ne të gjitha drejtimet e me theks të veçantë në pjesën jugore ku do t zhvillohet edhe korridori i cili ka karakter ekonomik dhe biznesi. Gjithashtu theks të veçantë i jepet edhe nen qendrave ku synohet që në të ardhmen të bëhet përqendrimi i popullatës ne këto nën qendra si rezultat i zhvillimit ekonomik. Gjithashtu i jep hapësirë edhe zhvillimit të vendbanimeve tjera respektivisht të fshatrave në mënyrë të kontrolluar.

		
Koncepti i kontrollit	Koncepti i mbrojtjes	Koncepti i zonës ne rritje
Skenari 1: konceptin e kontrollit e ka të bazuar ne rritjen e zonës urbane ne mënyrë të kontrolluar në drejtimin verior, lindor dhe jugor. ***Skenari 2:*** konceptin e kontrollit e ka të përqendruar në zonën urbane dhe në vendbanimet tjera respektivisht në fshatrat në mënyrë të kontrolluar. Zhvillimi në mënyrë të kontrolluar është i planifikuar edhe në zonën malore respektivisht në pjesën perëndimore duke u bazuar në normat e zhvillimit të planifikuara sipas ligjit për ketë zonë. ***Skenari 3:*** *e ka* konceptin e kontrollit të përqendruar ne zonën urbane dhe katër nën qendra. Ne zonën urbane kontrolli bëhet në drejtimin verior, lindor, perëndimore dhe në atë jugor. Në pjesën jugore planifikohet zgjerimi edhe ne korridorin jugor respektivisht ne rrugën nacionale Deçan – Gjakovë duke i dhënë karaktër ekonomik.	Skenari 1: E konsideron pjesën e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" si zonë potenciale për zhvillim të turizmit me qenë së ketë pjesë të komunës nuk e konsideron si zonë të mbrojtur. ***Skenari 2 dhe Skenari 3:*** Në të dy skenarët është zbatuar koncepti i mbrojtjes respektivisht mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike, dhe të trashëgimisë.	***Skenari 1:*** i ka parashtruar disa kufij të cilat kanë nevojë për rritje respektivisht të zhvillimit të dendur. Ky koncept ka marr drejtimin e duhur dhe disa zhvillime të zonave në rritje janë zbatuar. Ku skenarë ju ka ndihmuar skenarëve tjera që të kanë drejtimet e duhura për zhvillimin e rritjes. ***Skenari 2:*** e ka të zbatuar konceptin në zonën urbane dhe në vendbanimet tjera. Ne të dy rastet ky zhvillim është ne mënyrë të kontrolluar ku ne zonën urbane është ma intensive ndërsa ne vendbanimet tjera është me intensitet ma të ulët. ***Skenari 3:*** e ka të zbatuar konceptin e zonës në rritje të përqendruar në zonën urbane dhe në disa nën qendra. Në vendbanimet tjera ajo është me intensitet ma të ulët. Gjithashtu në ketë skenarë planifikohet të zbatohet ky koncept edhe në pjesën perëndimore respektivisht në zonën malore e cila do të jetë në harmoni të plotë me ligjin e caktuar për ketë zonë.

Tabela 194. Vlerësimi i skenarëve sipas koncepteve të U.A. Nr. 11/2015 mbi elementët, kërkesat themelore për hartimin dhe zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal

Skenarët	Skenari 1	Skenari 2	Skenari 3
Turizmi	*	***	*****
Lumenjtë	***	*****	*****
Infrastruktura	*****	*****	*****
Bizneset	*	*****	*****
Bujqësia	***	***	*****
Konceptet	**Skenari zero**	**Skenari policentrik**	**Skenari i baraspeshuar**
Koncepti i nyjës	*	***	*****
Koncepti i korridori	***	***	*****
Koncepti i plotësimit dhe dendësimit	***	*	*****
Koncepti i kontrollit	*****	***	*****
Koncepti i mbrojtjes	*****	*****	*****
Koncepti i zonës ne rritje	***	*	*****

Vlerësimi përfundimtarë – i skenarëve dhe zbatimit të koncepteve		
Skenari 1	**Skenari 2**	**Skenari 3**
Trendi ekzistuesi zhvillimit ka shfaqur shenja të sfidave të cilat kanë erdh nga shumë shkaqe. Disa nga ato nuk i takonin me kompetencave të nivelit lokal. Duke e marr parasysh që zhvillimi duhet i përshtatet kohës dhe nevojave të banorëve të saj, ky skenarë nuk është vlerësuar si skenari me i përshtatshëm që të vazhdon me hartimin e tij në të ardhmen.	Ky skenar e ka shpërndarë zhvillimin ne të gjithë territorin e komunë. Politikat e saj zhvillimore janë të orientuar vetëm në një drejtim respektivisht ne turizmin e qëndrueshëm si shtyllë kryesore e zhvillimit. Gjithashtu ku skenarë i jep mundësi të ofrimit të shërbimeve në të gjitha vendbanimeve si dhe lidhshmërinë ne mes të zonës urbane, rurale dhe malore në fushën e turizmit. Duke e marr parasysh se zhvillimi është përqendruar vetëm ne një drejtim dhe ma pak në fushat tjera atëherë ky skenar konsiderohet si ma pak i përshtatshëm.	Skenari i baraspeshuar si bazë e merr gjendjen ekzistuese ne Komunën e Deçanit. Duke i identifikuar të gjitha sfidat dhe nevojat e banorëve, ajo e ka krijuar një baraspeshë e cila do të plotëson të gjitha nevojat e banorëve. E rëndësishme është se ky skenar mbështetët ne tre shtylla kryesore siç janë turizmi, bujqësia, NVM, infrastruktura dhe trashëgimia. Të gjitha këto janë fushat të cilat i japin qëndrueshmëri Komunës së Deçanit andaj ky skenar konsiderohet si ma i përshtatshmi po me disa plotësime të detajuara në fushat e ndryshëm tematike.

Tabela 195 Vlerësimi përfundimtar i skenarëve

4.4 Elementët e konceptit hapësinor

Siç u vërejt ma lartë, koncepti përfundimtar i zhvillimit hapësinor është i bazuar në një sistem të elementëve të ndërlidhura dhe të integruara hapësinore i cili koncept arrihet përmes përfshirjes së hisedarëve të ndryshëm për planifikim të qëndrueshëm, i cili shërben si platformë bazike për kushtet zhvillimore për revidimin e PZHK-së dhe hartimin e Hartës Zonale Komunale të Komunës së Deçanit.

Në të gjithë skenarët e me theks të veçantë në skenarin e baraspeshuar, janë krijuar nyjat ku do të zhvillohen aktivitetet siç janë banimi, puna, edukimi dhe rekreacioni. Nyjat lidhen me korridoret respektivisht infrastruktura rrugore të cilat mund të kenë intensitet të lartë të zhvillimit tek nyjat.

Rendësi iu është jep dendësimi mirëpo edhe plotësimit të cilat i dendësojnë dhe i mbushin hapësirat si mënyrë për të arritur integrimin hapësinorë. Dendësia është bërë me synim të ofrimit të mundësive për ndërtim, kontrollimin e zgjerimit të qytetit kundrejt tokave bujqësore, kontrollimin e migrimit lokal, zhvillimin ekonomik, zbatimin e konceptit të qytetit kompakt dhe uljen e shpenzimeve në investimet kapitale ne infrastrukturë teknike, trafikut dhe sociale dhe orientimi i buxhetit në prioritete tjera strategjike.

Nevojat e banimit me intensitet të lartë për zhvillimin e një qyteti kompakt i kemi paraparë përreth Zonës qendrore të qytetit duke zbatuar normativat e ndërtimit pasi që kjo zonë edhe bart krejt zhvillimin e qytetit.

Ana veriore është ndër pjesët ma vitale të qytetit e cila bart edhe zhvillimin e pjesëve tjera të qytetit ku intensiteti i lartë i ndërtimit nga ana veriore parashihet të kufizohet nga ana e djathtë rrugës Luan Haradinaj, Lumit të Lumëbardhit të Deçanit duke respektuar normat teknike të ndërtimit deri tek kufiri i parcelave të para nga ana e djathtë e rrugës sekunadare të rrugës Ramë Thaqi.

Pastaj në anën lindore vazhdon përgjatë anës së djathtë të rrugës Elez Geci dhe Maxhun Berisha dhe kalon në fundin e kufirit të parcelave të ish fabrikave të drurit duke vazhduar përgjatë anës së djathtë të rrugës së Demonstratave, Isa dhe Valdet Kuçi, Mehmet Uka dhe deri tek kufiri parcelës së QKMF-së. Nga ana lindore në Carrabreg vazhdon me anën e djathtë të rrugës Lavdim Likaj deri tek udhëkryqi me rrugën Rexhë dhe Artan Qorraj, Adem Ukëhaxhaj, drejtimi kah rrethi në rrugën Fatmir Nimanaj, dhe përfundon me anën e djathë të rrugës Sylë Ukëhaxhaj.

Nga ana jugore intensitet i lartë parashihet të vazhdohet në anën e djathtë të rrugës Xhamia e Carrabregut, Bekim Berisha, Haxhi Gogaj, Çamëria dhe deri tek kanali i ujitjes duke vazhduar lart me lagjen Cacaj drejtimi i rrugës Nagip Cacaj, UÇK-së ana e djathtë e tyre dhe deri tek udhëkryqi kryesor me rrugën Manastiri.

Në anën perëndimore intensitet i lartë i ndërtimit parashihet ana e djathtë e rrugës së Manastirit deri tek kufiri i parcelave të Lagjes Kuçi drejtimi deri tek fundi i rrugës Haki Povataj ana e djathtë e saj duke vazhduar nga kufiri i parcelave tjera të familjeve Kuçi përballë gjimnazit deri tek rruga Dëshmoret e Deçanit, dhe nga këtu përgjatë anës së djathtë të kësaj rruge e deri tek fundi i rrugës Elena Xhika, Maxhun Cacaj dhe drejtimi në fundin e rrugës Xajë Kuçi.

Mbrojtja është planifikuar ne drejtimin perëndimore gjegjësisht ne Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” si dhe në mbrojtjen e tokës bujqësore me synim të rritjes së kontrolluar të vendbanimeve rurale drejt tokave kualitative bujqësore. Mbrojtja tjetër është aplikuar edhe në hapësirat përgjatë lumenjve duke i respektuat distancat e caktuara për ndërtim (në zonën urbane dhe disa rurale) ndërsa në pjesën rurale mbrojtja nga erozioni dhe eksploatimet. Koncepti i mbrojtjes është aplikuar edhe te ndërtesat me vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me synim të promovimit dhe zhvillimit ne të ardhmen në kontekstin e turizmit. Ne zonën urbane është zbatuar mbajtja dhe

vënia nën kontroll te ndërtimit me synim të aplikimit të kufijve urbanë fizik ndërsa janë caktuar edhe masat mbrojtëse të resurseve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

Krahas mbrojtjes, janë caktuar drejtimet e zhvillimit të zonave respektivisht të rritjes së zonës me synim të rritjes së intensitetit të zonave ekzistuese dhe plotësimin e zonave ku është e përshtatshme zhvillimit. Duke synuar që të zhvillohet koncepti i qytetit kompakt dhe jo i zgjeruar, janë propozuar drejtimet e zhvillimit të sektorit të:

- Ndërtimit – duke i caktuar zonat ne të cilat mund të ndërtohet me etazhitete të ndryshme duke filluar nga etazhiteti individual deri të ai shumë banesor – kolektiv. Në sektorin e ndërtimit është ofruar mundësia e cila për shumë vite e ndihmon Komunën e Deçanit mirëpo edhe investitorët që ti orientojnë investimet e veta duke i plotësuar nevojat e banimit, kërkesat e banimit në të ardhmen dhe kontrolluar migrimin.

- Ekonomik – duke i caktuar zonat me mundësi të zhvillimit të bizneseve të llojeve të ndryshme duke mos i cenuar zonat me resurse natyrore. Zhvillimi i ekonomik i përfshinë NVM, bujqësinë, blegtorinë dhe turizmin me shërbimet tjera.

- Turizmi – duke e kombinuar pjesën malore, kodrinore dhe atë rurale. Zona urbane do të shërben si por hyrëse në fushën e turizmit duke ofruar shërbimet e nevojshme të informimit, akomodimit dhe shërbimeve tjera rekreative. Në pjesën malore gjegjësisht në parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" çdo zhvillim turistik do të behët në harmoni me Planin Hapësinorë Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"

- Bujqësia – duke e përfshirë sa ma shumë zonën rurale cila ka potencial të tokës kualitative dhe të përshtatshëm për bujqësi. Zhvillimi i bujqësisë është një nga shtyllat kryesore të Komunës Deçanit për zhvillimin e ardhshëm. Në pjesën perëndimore zhvillimi bujqësisë do të jetë në harmoni të plotë me Planin Hapësinore Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".

- Blegtoria – duke ofruar mundësitë e zhvillimit të sektorit blegtoral i cili në vitet e fundit ka trend pozitiv dhe kthimi në traditat e zhvillimit të sektorit blegtoral.


- Shërbimet – janë cak i Komunës Deçanit e cila do ti ndihmon në të ardhmen banorët e vet, vizitorët dhe investitorët potencial. Për këtë është më se e nevojshme ndërtimi i infrastrukturës gjegjësisht me ndërtimin e ndërtesës së re moderne të Komunës Deçanit, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, ofrimin e shërbimeve të mira në menaxhimin e mbeturinave, furnizimi i qëndrueshëm me ujësjellës, ujitje dhe energji si dhe shpërndarja e rrjetit të internetit.

Skenari përfundimtarë është rezultat i lidhjes së strukturës se gjelbër (mjedisit), strukturës së kaltër (lumenjve), me zonën e ndërtuar (zonën urbane dhe fshatrat) dhe strukturat tjera fizike (infrastruktura e trafikut dhe ajo teknike) të cilat së bashku përbëjnë kornizën e dëshiruar të zhvillimit hapësinor të komunës. Lidhja funksionale e elementëve të këtij sistemi, bazohet në intensitetin e lëvizjes dhe bashkëveprimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, duke krijuar kështu një hierarki nyjash (qendra të aktiviteteve) dhe rrjetesh (korridoret / lidhjet ndërmjet nyjave) të niveleve të ndryshme. Elementët hapësinore trajtohen në bazë të një qasje të shtresëzimit, ku elementë të ndryshëm ndërtohen mbi njëri-tjetrin bazuar në marrëdhëniet reciproke ndërmjet tyre si:


- Korridoret që përshkruajnë Deçanin (R107 dhe R108) si dhe mundësi e ndërtimit të auto udhës së Dukagjinit. Këto korridore pastaj degëzohen në rrugë lokale duke ofruar qasje të lehtë në të gjitha vendbanimet. Lidhja këtyre korridoreve me shtete fqinje duke i fuqizuar

sektorët zhvillimore por edhe duke ruajtur traditat dhe zakonet me shtetet fqinje.


- Bjeshkët e Nemuna, pasuri e kësaj komune e cila është e trajtuar me ligj dhe ofron zhvillim në mënyrë të kontrolluar.
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore si veçanti dhe pasuri e kësaj komune do ketë ndikim në zhvillimin ne të ardhmen ne veçanti ne sektorin e turizmit.
- Zona e pasur për bujqësi dhe blegtori.
- Qendra urbane - Qyteti i Deçanit si porta kryesore e menaxhimit të zhvillimit të qëndrueshëm në shumë sektor
- Atraksionet dhe rekreacionet.
- Rregullimi i lumenjve dhe akumulimi.
- Mbrojtja dhe zhvillimi.



Harta 35. Koncepti i kornizës dhe strategjisë së zhvillimit hapësinore në Komunën e Deçanit



Harta 36. Tërësitë hapësinore karakteristike te Komunës së Deçan



Harta 37. Korniza e zhvillimit hapësinorë në Komunën e Deçanit

4.4.1 Tërësitë hapësinore funksionale

Tërësia hapësinore e Komunës së Deçanit është e ndarë ne tre zona të cilat kanë karakteristika të ndryshme zhvillimore, e ato janë:

- Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët": zona e Bjeshkëve të Nemuna brenda territorit të Deçanit, hapësirë në anën perëndimore të Komunës, pjesë e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".
- Tërësia "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore": është zonë kodrinore malore dhe me pjesën urbane - Qyteti i Deçanit, i vendosur në mes të tërësisë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" dhe tërësisë "bujqësia", me pozitë qendrore në komunë. Në këtë tërësi ndodhet edhe Zona e Veçantë e Mbrojtur[88] rreth Manastirit të Deçanit.
- Tërësia "Bujqësia": zona bujqësore, rrafshi aluvial i Lumëbardhit të Deçanit dhe atij të Lloqanit, pellgjet në të dy anët përreth tyre dhe rrafshet pjellore të gërshetuara në tërë zonën rurale

Komuna e Deçanit është ndër të paktat Komuna të cilat brenda territorit të sajë e kanë të mbrojtura dy zona respektivisht zonën e Parkut Kombëtarë për "Bjeshkët e Nemuna" e cila kontrollon 54.41%të territorit Komunal dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur rreth Manastirit të Deçanit e cila e kontrollon 2.69 % të territorit Komunal të Komunës Deçanit.

[88] Ligji nr.03/L-039 Për zonat e veçanta të mbrojtura

Tërësitë dhe nën tërësitë Komunës së Deçanit	ha	%
Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët": Zona e Parkut Kombëtar për Bjeshkët e Nemuna, Komuna e Deçanit	15,995.40 ha	54.41 %
Nën tërësia e "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore": Zona kodrinore – malore	41.40 ha	0.15 %
Tërësia "Zona rurale e Komunës Deçanit" : Zona Urbane Zona Rurale e Komunës së Deçanit	11,836.80 ha	40.26 %
Nën tërësia e "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore": Zona e Veçantë e Mbrojtur rreth Manastirit të Deçanit	790.70 ha	2.69 %
Tërësia "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore": Zona Urbane	729.75 ha	2.49 %
Gjithsejtë:	29,394.05 ha	

Tabela 196. Siperfaqet e terësive në Komunen e Deçanit

4.4.2 Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët"

Kjo tërësi trajtohet në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" [89]*, gjegjësisht i përfshinë të gjitha projeksionet mbrojtëse, zhvillimore, qëllimet, objektivat dhe aktivitete dedikuar Komunës së Deçanit.*

4.4.3 Tërësia "Zona Urbane dhe trashëgimia kulturore"

Hapësirat kodrinore malore-pellgjet e dy lumenjve, është kryesisht zonë e zhvillimit që karakterizohet me kusht të volitshme për ndërtim dhe zhvillim. Menaxhohet nga autoritetet e nivelit qendror dhe atij lokal. Tërësia e dytë ndahet në këto nën zona:

- Zona e vendbanimeve - dy zona vendbanimesh: Pleqe dhe Belle, fshati Shkëlzen Haradinaj, zhvillim i kontrolluar në bashkëpunim me të gjithë akteret relevant.
- Zona e zhvillimit - hapësira jashtë zonës urbane, turizmi sporti, rekreacioni.
- Zona e pyjeve privatë (zhvillim i kontrolluar) - Në këtë zonë janë caktuar hapësira me interes zhvillimi por gjithnjë duke respektuar ruajtjen e mjedisit. Të gjitha ndërtimet janë listuar në zona ku do të rregullohen sipas planeve rregulluese të hollësishme, duke respektuar kriteret dhe normat për investimet në hapësirat e Parkut Kombëtar.
- Zona e Veçantë e Mbrojtur[90] - Kjo zonë përfshinë hapësirën rreth Manastirit të Deçanit, e cila mbulon një sipërfaqe prej: 790.7 ha. Në këtë zonë sipërfaqe e konsiderueshme është në pronësi shtetërore, pastaj pjesa tjetër ju takon pronarëve privat. Kjo zonë ka një peizazh mahnitës dhe është pjesa hyrëse për Bjeshkët e Deçanit. Sipas Ligjit Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, dispozitat e këtij ligji e pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Për ligjin në fjalë nuk është bërë një hulumtim dhe studim paraprak për vlerat dhe potencialin qe posedon kjo zonë.
- Zona urbane - Tërësinë urbane në të cilat ekzistojnë zona rurale toka bujqësore të cilat i përfshijnë hapësirat e fshatrave dhe është e shpërndarë në të gjithë hapësirën fushore dhe kodrinore me sipërfaqe 11,836.8 ha. Tërësinë urbane respektivisht zona e qytetit të Deçanit dhe shtrihet në sipërfaqe prej 729.75 ha.


Në kuadër të zonës së qytetit, ekzistojnë tre zona të cilat janë të ndara në 5 njësi te reja.

[89] gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78122


[90] Ligji nr.03/L-039 Për zonat e veçanta të mbrojtura

4.4.4 Tërësia e tretë: Zona rurale e Komunës Deçanit


Kjo zonë e përfshinë të gjithë territorin lindor të rrafshët të Komunës së Deçanit. E njohur si zonë kualitative bujqësore, këto planifikohet të zhvillohet bujqësia dhe blegtoria. Në ketë zonë kalojnë edhe dy lumenjtë respektivisht lumi i Lumëbardhit të Deçanit dhe ai i Lloqanit. Rrafshinat përreth këtyre lumenjve (aluvial) janë pellgje mjaft kualitative dhe pjellore andaj kjo zonë i ka të gjitha predispozitat që të zhvillohet bujqësia në mënyrë intensive. Përndryshe, pas tërësisë së parë respektivisht Grykës së Deçanit, zona rurale e Komunës Deçanit e zënë 40.26% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Komunës.



Harta 38. Shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës për gjendjen ekzistuese në Komunën e Deçanit



Harta 39. Shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës në Komunën e Deçanit (gjendja e planifikuar)



Harta 40. Shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës në Komunën e Deçanit (gjendja e planifikuar)

4.4.5 Mbrojtja e mjedisit – planifikimi

Mbrojta e mjedisit është një prioritet për Komunën e Deçanit. Disa nga veprimet konkrete ne vitet në vijim janë: parandalimi dhe ulja e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe mbrojtja e biodiversitetit. Duke i përdorur të gjitha politikat lokale për mbrojtjen e mjedisit, Komuna e Deçanit synon që nëpërmes projekt PZHK-së të arrij:

- Ekuilibri ekologjik – është thelbësor për mbijetesën e të gjithë organizmave të gjallë andaj është e fokusuar ne mbrojtjen e florës dhe faunës.
- Përmirësimin e shëndetit të njeriut - me ajër të pastër, uji dhe ushqim, të cilat janë të nevojshme për njeriut dhe ti anashkalojnë problemet shëndetësore.
- Biodiversiteti të pasur dhe të qëndrueshëm – me një mori speciesh bimore dhe shtazore dhe ruajtja e ekosistemeve dhe mbijetesën e shumë specieve.
- Ndryshimet klimatike – respektivisht veprimet konkrete për parandalimin e ndryshimeve klimatike.
- Zhvillimi i qëndrueshëm: Mbrojtja e mjedisit është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm, i cili synon të plotësojë nevojat e brezit aktual pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre. Për ketë, Komuna e Deçanit është e fokusuar në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm – OZHQ deri në vitin 2030.

Gjithashtu parashihet të bëhet mirëmbajtja, rregullimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, prrojeve, pastrimi i deponive ilegale dhe gjelbërimi i hapësirave të degraduara, ndalimin e shfrytëzimit të inertëve nëpër lumenj. Për të ardhmen me qëllim të identifikimit dhe çështjeve të tjera mjedisore mbetët të trajtohen me PLVM, i cili parashihet të bëhet revidimi (ndryshimi). Dokumenti i VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor) parasheh një përfshirje të zgjeruar të masave dhe veprimeve për zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis si dhe zhvillimeve tjera të parapara në PZHK, të cilat janë të integruara në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

4.4.5 Mbrojtja e ajrit

Ndotja e ajrit në gjithë territorin e Komunës, nuk është e lartë përveç pjesës urbane ku komunikacioni është burim i ndotjes së ajrit (mjedisit). Komuna në bashkëpunim me MMPHI, duhet të koordinoj kontrollet e vazhdueshëm të imitimeve të pluhurit dhe tymit nga komunikacioni/trafiku, gurëthyesit, beton-asfaltet, djegiet e mbeturinave duke vendosur matës të ndotjes së ajrit në rrugët me frekuentim të komunikacionit apo bizneset me ndikim në mjedis. Të hartohen projekte dhe të krijohen breza të gjelbërimit me qëllim të zvogëlimit/evitimit të ndotjes nga pluhuri, gazra dhe zhurma.

Masat kundër ndotjes së ajrit:

- Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Ajrit.
- Vendosja e matësve të ndotjes së ajrit.
- Ulja e emetimeve të gazrave të ndryshme.
- Krijimi i hapësirave të gjelbra.
- Zhvillimin e transportit të qëndrueshëm me synim të zhvillimit të transportit aktiv dhe ekologjik
- Marrjen e masave ndëshkuese ndaj personave fizik apo juridik që i tejkalojnë nivelet e lejueshme të ndotjes dhe zhurmës, sidomos në zonat me banim.
- Rritja e ndërgjegjes tek banorët dhe vizitorët ne Komunën e Deçanit.

4.4.5 Mbrojtja e ujit

Një nga pikat më të rëndësishme të Komunës së Deçanit për zhvillimin bujqësor dhe turizmin si dhe zhvillimin e NVM janë lumenjtë, proçkat, prrojet të cila disa nga ato derdhen në liqenin e Radoniqit. Andaj, mbrojtja e ujit është mjaft e rëndësishme për Komunën e Deçanit dhe masat të cilat do të merren për mbrojtjen e ujërave janë ato të ujërave sipërfaqësor dhe ujërave nëntokësorë. Për mbrojtën e ujërave sipërfaqësor janë caktuar disa masa parandaluese të:

- Burimeve ujor apo
- Ndotja nga ujërat e zeza,
- Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme me përdorimin në mënyrë të kontrolluar të plehrave organik dhe pesticideve,
- Mbrojtja e ligatinave të cilat luajnë rolin e filtrave për ujërat nëntokësor,
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe
- Hartimi i rregulloreve ndëshkuese për ndotësit.

Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore janë caktuar masat:

- Së pari duhet të mbrohen ujërat sipërfaqësor.
- Monitorimi i ujërave nëntokësorë duke e monitoruar burimin potencial të ndotjes.
- Menaxhimi i përdorimit të kimikateve (përdorimi i pesticideve dhe plehrave në mënyrë të kontrolluar).
- Kontrollimi i përdorimit të tokës nëpërmes planifikimit të duhur hapësinorë.
- Përdorimi i metodologjive bashkëkohore në bujqësi me synim të mbrojtës së tokës por edhe të ujërave nëntokësor.
- Promovimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e ujërave nëntokësor.

Duke iu referuar të gjitha masave të lartpërmendura, Komuna e Deçanit mbrojtje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja, Komuna parasheh ndërtimin e kanalizimit për ujërat e zeza në zonën rurale dhe impianteve me standarde pro mjedisore.

4.4.5 Mbrojtja e tokave bujqësore

Komuna e Deçanit, në kuadër të angazhimeve për mbrojtjen e tokës bujqësore duhet të veprojë sipas objektivave të Strategjisë për Konsolidimin e Tokës 2010 - 2022, e cila strategji si objektiva të përgjithshme ka realizimin e projekteve të konsolidimit të tokës dhe të sigurojë shfrytëzim racional të tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mbështetje për zhvillimin e bujqësisë. Mbrojtja e tokave bujqësore si aset ekonomik dhe mjedisor duhet të mbrohet parimisht nga degradimi dhe ndërtimet e shpërqendruara gjithashtu duhet të mbrohet nga erozioni, fragmentimi dhe ndërtimet ku si masë për mbrojtje nga ndërtimet duhet të jetë respektimi rigoroz i normave ligjore. Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri të degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike, ku në Komunën e Deçanit, në tri vitet e fundit shndërrimi i fondit të tokës bujqësore në atë ndërtimore është 13,31 ha[91].

Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave e kjo mund të arrihet më ndërmarrjen e këtyre masave si:

- Ruajta e zonave natyrore.
- Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokës.


[91] Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (2018-2020)

- Planifikimi cilësor hapësinore për tokën dhe zbatimi rigoroz i përdorimit të tokës.
- Përgatitja e projekteve për parandalimin e vërshimeve për zonat Strellc, Isniq, Dubovik, Prilep dhe Gramaqel.
- Hartimi i projekteve për mbrojtjen e veçantë të ngastrave të tokës nga përdorimi i pakontrolluar i plehut artificial në bujqësi (nitrate, nitritet, fosfatet dhe ushqyesit e tjerë).
- Parandalimi i kontaminimit të tokës nga gazrat e ndryshme.
- Hartimi i projekteve ideore dhe kryesorë për mbrojtjen e tokës nga mbeturinat e paligjshme (të gjitha llojet e mbeturinave).
- Përgatitja e projekteve për mbjellje të fidanëve në zonat ku janë pastruar nga mbeturinat.
- Hartimi i projekteve dhe marrja e masave për mbrojtjen nga erozioni.
- Menaxhimi i mirë i mbetjeve (Riciklimi, Ripërdorimi dhe Regjenerimi mbetjeje).
- Inspektime për zbatimin e masave për mbrojtje të tokës bujqësore kundër degradimit si pasojë e ndikimit njerëzor.
- Hartimi i projekteve për tokat e papunuara dhe për tokat me cilësi të ulët bujqësore.
- Organizimi i një fushatë informative për qytetarët apo me anë të broshurave për mbrojtjen e mjedisit tokësor dhe burimeve tokësore nga tjetërsimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore.
- Hartimi i rregulloreve ndëshkuese për ndotësit e tokës.

4.4.5 Menaxhimi i mbeturinave

Në Komunën e Deçanit, është krijuar një sistem i shëndoshë mjedisorë për menaxhimin e mbeturinave, i cili sistem është mbështetur nga GIZ-i Gjerman. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale " Higjiena" Sh.A, e cila bënë grumbullimin e mbeturinave sipas parimit "Derë më derë" ka për qëllim zvogëlimin e sasisë së mbeturinave përmes procesit të selektimit, riciklimit, ose në formë të dobishme (kompostim), ku sasia e mbeturinave zvogëlohet në vlerën minimale nga vendi, që është prodhuar e deri në deponi, i gjithë procesi bëhet sipas Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2031. Me menaxhimin e mbeturinave, Komuna e Deçanit po kontribuon ne mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik dhe rruajtja e burimeve. Masat të cilat duhet të ndermirën janë të cekura në planin e menaxhimit të mbeturinave mirëpo është mjaft e rëndësishme që në të ardhmen të veprohet më:

- Tre R-të - Redukto, Ripërdor dhe Riciklojnë.
- Ndarja e mbeturinave në burim.
- Teknologjitë e përdorimit të mbeturinave në energji.
- Edukimi dhe vetëdijesimi i banorëve.



Harta 41. Plani për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklim

4.4.5 Mbrojtja e pyjeve

Në Komunën e Deçanit, pyjet përfshinë rreth 36 % të territorit administrative, me një sipërfaqe prej rreth 16,786.10 ha tokë pyjore/sipërfaqe, ku shumica e sipërfaqes pyjore gjendet në kuadër të Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, kurse 1,873 ha janë livadhe dhe kullosa. Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi.

Mbrojtja e pyjeve ekzistuese është jetike për Komunën e Deçanit, me qenë re kanë ndikim të drejt për drejtë në mbrojtjen e specieve të vlefshme dhe unike të biodiversitetit respektivisht pyjet janë shtëpia e shumë specieve, ku shumë prej të tyre janë të rrezikuara ose të kërcënuara. Duke marr parasysh masivin e tyre, pyjet luaj rrol të rëndësishëm ne rregullimin e klimës duke thith në vetë dyoksidin e karbonit, një gaz serrë që kontribuon në ndryshimet klimatike. Ato gjithashtu e rruajnë ciklin e ujit gjegjësisht luajnë një rol të rëndësishëm në ciklin e ujit duke thithur dhe ruajtur ujin, duke e lëshuar atë ngadalë në përrenj, lumenj dhe trupa të tjerë ujore. Duke mbrojtur pyjet, ne mund të ndihmojmë për të siguruar që ka një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm me ujë për njerëzit dhe kafshët e egra. Gjithashtu ato e mbrojnë tokën nga erozioni i tokës dhe e mbrojnë cilësinë e tokës duke e mbajtur atë në vend, duke reduktuar rrezikun e rrëshqitjeve të dheut dhe fatkeqësive të tjera natyrore. Pyjet ofrojnë një sërë përfitimesh ekonomike, duke përfshirë lëndën drusore, produktet pyjore jo-drusore, turizmin dhe mundësitë e punësimit për komunitetet lokale. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Pyjet duhet të jenë të mbrojtura nga degradimi, prerjet ilegale dhe zjarret. Duhet të hartohen projekte në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për inventarizimin e pyjeve, sipërfaqeve të degraduara dhe të shpyllëzuara duhet të rigjenerohen përmes pyllëzimit dhe ri-

pyllëzimit, të mbrohen bashkësitë e pastra të hormoqit, si dhe ato të përziera të bredhit dhe hormoqit që janë kategoria më e dëmtuar e halorëve në këtë pjesë po ashtu të ndërmerren masa mbrojtëse nga dëmtuesit (insektet) për bashkësitë e dushkut (quercus) dhe gështenjës, të ndërmerren masa dhe projekte konkrete për mbrojtjen e tokës pyjore. Masat të cilat do të ndërmerret për mbrojtjen e pyjeve janë:

- Përgatitja e projekteve për mbrojtje, ruajtje dhe konservim të disa llojeve të fito - cenozes (gështenjës).
- Krijimi i zonave të mbrojtura pyjore në të cilën është e ndaluar rreptësishtë prerja pa një mbikëqyrje. Këto zona "mbrojtje" kane vetëm për prerjen e tyre ndërsa nuk ndalojnë vizitën e këtyre zonave. Prerja mund të bëhet në mënyrë të kontrolluar nga organet përgjegjëse me program të qëndrueshëm të ripyllëzimit.
- Përgatitja e projekteve për mbrojtjen e zonave ku jetojnë kafshët e egra mes të cilave ka edhe lloje që konsiderohen të rrezikuara si dhe projekteve për mbrojtjen e tyre të veçantë.
- Pylltaria e qëndrueshme nëpërmes korrjen e pemëve me synim të regjenerimit pa e dëmtuar eko sistemin pyjor.
- Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal për biodiversitet.
- Përgatitja e projekteve për vitalizmin e habitateve malore dhe për parandalimin të shkatërrimit të vendbanimit të shumë llojeve të florës dhe faunës.
- Adresimi i nxitësve të shpyllëzimit siç janë bujqësia dhe zhvillimi i infrastrukturës, mund të ndihmojë në uljen e presionit mbi pyjet. Kjo mund të bëhet përmes ndërhyrjeve politike, të tilla si rregullimi i praktikave të përdorimit të tokës dhe ofrimi i stimujve për zhvillim të qëndrueshëm.
- Ruajtja e brezit të gështenjës dhe trajtimi nga dëmtuesit. Inkurajimi i ripyllëzimit duke i mbjell pemët e reja, pastrimi i rregull nga mbetjet dëmtuese me synim të rivendosjes së ekosistemeve pyjore dhe gjithashtu mund të ndihmojë në zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike duke thithur dioksidin e karbonit nga atmosfera.
- Sigurimi i mjeteve alternative të jetesës për komunitetet lokale mund të ndihmojë në uljen e presionit mbi pyjet. Kjo mund të përfshijë promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore, zhvillimin e mundësive të eko-turizmit ose mbështetjen e prodhimit të produkteve pyjore jo-drunore.

4.4.5 Mbrojtja nga erozioni

Në Komunën e Deçanit, janë evidentuar zona erozive, të cilat janë prezantuar në Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit të vitit 2018, ku sipas këtij plani erozioni shtrihet në hapësirat e tokave bujqësore, të kultivuara apo braktisura, në tokat pyjore e livadhore, shtretërit e lumenjve, përrenjtë dhe tokat përreth tyre. Dëmet e shkaktuara prej tij ndjehen në masë 3% në bujqësi dhe pylltari. Erozioni i tokës është një proces natyror që ndodh kur toka lëviz ose transportohet nga një vend në tjetrin nga era, uji ose forca të tjera. Megjithatë, aktivitetet njerëzore mund të përshpejtojnë erozionin e tokës dhe të çojnë në degradimin e cilësisë së tokës. Disa nga arsyet kryesore të erozionit të tokës përfshijnë:

- Mbi kullotja respektivisht kur shumë kafshë kullosin në një sipërfaqe toke, kjo mund të çojë në heqjen e bimësisë, e cila e ekspozon tokën ndaj erozionit. Mbi kullotja është një shkak i zakonshëm i erozionit të tokës në zonat me popullsi të madhe bagëtish.
- Pemët dhe bimësia tjetër ndihmojnë në mbajtjen e tokës në vend, kështu që shpyllëzimi mund të çojë në erozionin e tokës. Kjo është veçanërisht e vërtetë në zonat me shpatë të pjerrëta, ku humbja e pemëve dhe vegjetacionit tjetër mund të rrisë rrezikun e rrëshqitjeve të dheut dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

- Disa praktika bujqësore, të tilla si lërimi mund të rrisin rrezikun e erozionit të tokës duke prishur strukturën e tokës dhe duke e ekspozuar atë ndaj erozionit të erës dhe ujit.
- Ndërtimi i ndërtesave, rrugëve dhe infrastrukturës tjetër mund të çojë në erozionin e tokës duke hequr bimësinë dhe duke ndryshuar modelet natyrore të kullimit të tokës.
- Ndryshimet klimatike mund të kontribuojnë gjithashtu në erozionin e tokës duke ndryshuar modelet e reshjeve dhe duke rritur intensitetin e stuhive dhe ngjarjeve të tjera të motit.
- Pjerrtësia e terrenit dhe përbërja pedologjike si dhe nga faktori njeri (nxjerrja e zhavorrit).

Erozioni i tokës mund të ketë ndikime të rëndësishme në shëndetin e ekosistemeve dhe produktivitetin e tokave bujqësore. Është e rëndësishme të zbatohen masa për të parandaluar erozionin e tokës dhe për të mbrojtur cilësinë e tokës për brezat e ardhshëm. Masat kundër erozionit janë:

- Revidimi, i Planit për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera në Territorin e Komunës së Deçanit 2018.
- Lërimi konservues respektivisht reduktimin ose eliminimin e punimit dhe lëvrimit të tokës, gjë që mund të ndihmojë në reduktimin e erozionit të tokës duke ruajtur strukturën e tokës dhe lëndën organike.
- Bujqësia konturore përfshin mbjelljen e kulturave përgjatë vijave konturore të tokës, e cila ndihmon në ngadalësimin e lëvizjes së ujit dhe reduktimin e erozionit të tokës në shpatet.
- Të mbjellat mbuluese mbillen midis periudhave të prodhimit të bimëve për të ndihmuar në mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe për të ruajtur cilësinë e tokës.
- Rivendosja e bimësisë natyrore, si mbjellja e pemëve dhe bimëve të tjera, mund të ndihmojë në reduktimin e erozionit të tokës dhe rivendosjen e shëndetit të Ekosistemit.
- Hartimi i projekteve për ndërtimin e pendave mbrojtëse në lumenj, përroskave dhe përrenjve.
- Hartimi i projekteve për ndërtimin e mbrojtësve në brigjet e lumit.
- Hartimi i projekteve për pyllëzimin e vendeve të zhveshura dhe atyre të degraduara.
- Hartimi i projekteve për mbjelljen e brezit gjelbërues që do të mbulonin rripin prej 10 m, largësi prej brigjeve të lumenjve kryesorë.
- Erë bllokuesit janë rreshta pemësh ose bimësi tjetër që mbillen për të mbrojtur tokën nga erozioni i erës. Ato gjithashtu mund të ofrojnë habitat për kafshët e egra dhe të ndihmojnë në reduktimin e rrjedhjes së ujit.
- Tarracimi përfshinë ndërtimin e një sërë hapash ose platformash të nivelit në shpatet e pjerrëta, të cilat ndihmojnë në ngadalësimin e lëvizjes së ujit dhe reduktimin e erozionit të tokës.
- Praktika të tjera të ruajtjes së tokës, të tilla si përdorimi i kompostos dhe materialeve të tjera organike, mund të ndihmojnë në përmirësimin e strukturës së tokës dhe reduktimin e erozionit.

Në përgjithësi, parandalimi i erozionit të tokës kërkon një kombinim të praktikave të ruajtjes së tokës, menaxhimit të përdorimit të tokës dhe mbrojtjes dhe restaurimit të ekosistemeve natyrore. Duke marrë këto masa, Komuna e Deçanit mund të ndihmojmë në ruajtjen e tokave të shëndetshme dhe kualitative dhe të sigurojmë përdorim të qëndrueshëm të tokës për brezat e ardhshëm.

4.4.5 Mbrojtje nga breshëri

Breshëri, viteve të fundit ka shkaktuar dëme në bujqësi, përkatësisht në periudhën e vegjetacionit të bimëve. Aktualisht, Kosova, nuk ka sistem mbrojtës raketor për shpërndarjen e reve, si dhe paralajmërimit të hershëm të kësaj dukurie. Për të zvogëluar dëmet e konsiderueshme që po

shkaktohen nga breshëri, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është mirë që të ngritët një sistem i mbrojtjes. Ndryshe, para vitit 1999, në Kosovë kanë funksionuar 110 pika lesuese të raketave për mbrojtje kundër breshrit.

- Përgatitja e projekteve për ndërtimin stacioneve kundër breshrit në vendet ku kanë ekzistuar më herët.
- Sistemet e paralajmërimit të hershëm mund të japin njoftim paraprak për stuhitë e afërta breshëri, duke lejuar fermerët dhe palët e tjera të interesuara të marrin masa për të mbrojtur të korrat, bagëtinë dhe infrastrukturën.
- Përdorimi i rrjetave kundër breshrit të cilat vendosen mbi të mbjellat për ti mbrojtur ato nga dëmtimi i breshrit.
- Sigurimi i strehimit për bagëtinë gjatë stuhive me breshër mund të ndihmojë në uljen e rrezikut të lëndimit dhe vdekjes.

Në përgjithësi, mbrojtja nga dëmtimet nga breshri kërkon një kombinim masash, duke përfshirë strukturat mbrojtëse dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm. Duke marrë këto masa, Komuna e Deçanit e redukton ndikimin e stuhive të breshrit duke i mbrojtur të korrat, bagëtinë dhe infrastrukturën Teknike.

4.4.5 Mbrojtjen nga zjarri

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-012 Për Mbrojtje nga Zjarri, Komunat janë përgjegjëse për nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri në nivel Komunal në bazë të vlerësimit të rrezikut nga zjarri në pajtim me Planin Shtetëror për Mbrojtje nga Zjarri. Komuna e Deçanit, ka Qendrën e Zjarrfikësve dhe në territorin e Komunës së Deçanit, më të atakuar më zjarre janë pjesa malore - bjeshkët si pasojë:

- Rrufesë e cila mund të ndezë zjarre në bimësinë e thatë dhe materiale të tjera të djegshme.
- Kushtet e motit të nxehtë dhe të thatë mund të shkaktojnë që vegjetacioni të bëhet i thatë dhe më i prirur ndaj ndezjes.
- Aktivitetet njerëzore si zjarrit në kamp, fishekzjarrët, pirja e duhanit dhe djegia e mbeturinave mund të shkaktojnë gjithashtu zjarre natyrore.
- Raste të rralla si djegia spontane kur materialet organike si sana ose kompostoja gjenerojnë nxehtësi dhe ndizen.
- Ndryshimet në klimë mund të kontribuojnë gjithashtu në zjarret natyrore duke krijuar kushte më të nxehta dhe më të thata që rrisin rrezikun e ndezjes.

Është e rëndësishme të theksohet se shumë zjarre natyrore shkaktohen nga një kombinim i këtyre faktorëve dhe se rreziku i zjarreve natyrore mund të ndryshojë në varësi të një sërë faktorësh si gjeografia, klima dhe praktikat lokale të përdorimit të tokës. Masat mbrojtëse parashihen komfor Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), ku masat që duhet ndërmarrë janë:

- Inspektim për parandalimin të zjarrvënësve të qëllimshme në zonat pyjore dhe tokat bujqësore.
- Respektim i kushteve të ndërtimit të përcaktuara me kornizën ligjore për mbrojtje nga zjarri;
- Sigurimi i elaborateve për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për të gjitha projektet e ndërtimit për të gjitha kategoritë komfor ligjeve përkatëse.
- Planifikimi i tampon zonave në mes të zonave pyjore dhe tjera të cilat janë të ndjeshme nga zjarret si dhe një tampon zonë në brezin kufitar për të penguar përhapjen eventuale të zjarrit;
- Vendosja e hidrantëve në vendet e caktuara në qytet dhe zona rurale.

Ndër masat tjera që duhet të ndermirën janë:

- Pastrimi i bimësisë që krijojnë shpërthime zjarri duke hequr pemët, degët dhe gjethet e thata, sasinë e karburantit apo gazrave të disponueshëm në hapësira potenciale për një zjarr.
- Krijimi i hapësirave të hapura rreth shtëpive ose ndërtesave të tjera (si fermat) mund të ndihmojë gjithashtu në parandalimin e përhapjes së zjarreve.
- Djegiet e kontrolluara, të njohura gjithashtu si djegie të përshkruara, janë zjarre të ndezura qëllimisht që menaxhohen me kujdes për të reduktuar grumbullimin e karburantit dhe rrezikun e një zjarri më të madh e të pakontrolluar.
- Zbulimi i hershëm i zjarreve është thelbësor për të parandaluar që ato të bëhen më të mëdha dhe më të rrezikshme. Kjo mund të bëhet përmes një kombinimi të patrullimeve njerëzore, mbikëqyrjes ajrore dhe teknologjive të sensorit në distancë.
- Zhvillimi i planeve të evakuimit në rast zjarri natyror për të garantuar sigurinë e banorëve dhe për të minimizuar humbjet e jetës.
- Fushatat e edukimit publik mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet e zjarreve natyrore dhe si t'i parandaloni ato. Kjo mund të përfshijë informacion mbi praktikat e sigurisë nga zjarri, si dhe këshilla për krijimin e një hapësire të mbrojtur rreth shtëpive dhe strukturave të tjera.

4.4.5 Mbrojtja nga vërshimet

Mjedisi çdo ditë e më tepër po rrezikohet nga fatkeqësitë natyrore, si rezultat i ndryshimeve klimatike. Në kuadër të veprimeve për mbrojtje të mjedisit dhe parandalimit të fatkeqësive natyrore Komuna e Deçanit, do të jetë e përgatitur që të ballafaqohet me këto sfida dhe t'i minimizojë dëmin për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve, andaj duhet të hartoj Planin Operativ për Mbrojtje nga Vërshimet për pjesët e rrezikuara. Vërshimet ne Komunën e Deçanit kanë qenë rezultat i:

- Reshjeve të dendura, të cilat e kanë mbingarkuar Sistemin e kullimit dhe bëjnë që lumenjtë dhe trupat e tjerë ujorë të derdhen nga brigjet e tyre.
- Shkrirja e borës në pranverë ose në temperatura më të ngrohta, ka ndikuar që lumenjtë dhe përrenjtë të dalin nga brigjet e tyre dhe të shkaktojnë përmbytje.
- Valët e stuhisë ne rastet e caktuara kanë shkaktuar përmbytje në pjesët ku kalojnë lumenjtë.
- Shpyllëzimi.
- Ndërtimi i pakontrolluar e me theks të veçantë përdorimi i betonit dhe asfaltit, të cilat rrisin shpejtësinë dhe vëllimin e rrjedhjes së ujit.
- Ndryshimet klimatike.

Po ashtu duhet të ndërmarr masa hidroteknikën kundër erozionit. Masat për mbrojtje nga vërshimet janë:

- Ndërmarrja e masave për ndalimin e ndërtimeve të ndërtesave banuese dhe ndërtesave të karakterit ekonomik afër brigjeve të lumenjve, në largësi prej më së paku 10 m, nga shtrati lumor (pikës së ujit).
- Vendosja e Sistemit të paralajmërimit të hershëm e cila do e ndihmojnë në alarmimin e njerëzve për potencialin e përmbytjeve dhe të ofrojnë udhëzime për rrugët e evakuimit dhe masa të tjera sigurie.
- Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese ndaj përmbytjeve, pendat dhe muret kundër përmbytjeve, e ndihmojnë parandalimin ose reduktimin e ndikimit të përmbytjeve në zonat e cenueshme.
- Ndërtimi i pendave për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjtë në fshatin Strellc i Epërm, përroi i Behovcit, Duraku dhe Suhaja në fshatin Dubovik.

- Pastrimi i shtratit të Lumëbardhit në pjesën nën Urën e Demës në fshatin Isniq, Llukë e Epërm, Llukë e Ulët dhe Lumbardh dhe shtratit të Lumëbardhit të Lloqanit, Prilep, Rastavicë, Baballoq dhe Gramaqel.
- Planifikimi i përdorimit të tokës mund të ndihmojë në parandalimin e zhvillimit në zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe të sigurojë që ndërtimet e reja janë projektuar për t'i bërë ballë përmbytjeve.
- Menaxhimi i përmbytjeve natyrore duke përdorur teknikat natyrore të menaxhimit të përmbytjeve, të tilla si rivendosja e ligatinave, mbjellja e pemëve dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës, mund të ndihmojnë në ngadalësimin e rrjedhës së ujit dhe zvogëlimin e rrezikut të përmbytjeve.
- Sistemet e përmirësuara të kullimit, të tilla si pellgjet e mbajtjes së ujërave të stuhisë, mund të ndihmojnë në ruajtjen e ujit të tepërt dhe të zvogëlojnë rrezikun e përmbytjeve në zonat urbane.
- Edukimi dhe vetëdijesimi i banorëve mbi rreziqet e përmbytjeve dhe si të përgatitët dhe t'u përgjigjet përmbytjeve mund të ndihmojë në minimizimin e ndikimit të përmbytjeve në komunitet.
- Marrja e veprimeve për të reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike mund të ndihmojë në uljen e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së përmbytjeve.

4.4.5 Mbrojtja nga stuhitë e erës

Pozita gjeografike e Komunës së Deçanit, është krijuar rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, është atakuar nga erërat me intensitet të lartë. Komuna, duhet përmes planeve të identifikoj vendbanimet që i nënshtrohen erërave të forta për të ndërmarrë masa mbrojtëse kundër stuhive duhet pasur në konsideratë në procedurat e dhënies së kushteve për ndërtim e ndërtesave me etazhitet të lartë si dhe ndërtesave të infrastrukturës Teknike, dhe ndërtesave energjetike në pjesën e Bjeshkëve të Deçanit. Dallimet e presionit të ajrit si rezultat i lëvizjes së ajrit të presionit të lartë në ajër të presionit të ulët e që e karakterizon ketë zonë krijojnë erërat e forta. Topografia e Komunës Deçanit është mjaft e favorshme për lëvizjen e ajrit dhe krijimin e modeleve të ndryshme të lëvizjes së ajrit. Ndryshimet sezonale shpesh ndikojnë që ndryshimi i temperaturave të ndikojnë ne krijimin e erërave të forta dhe reshjeve të dendura me stuhi. Aktivitetet njerëzore si shpyllëzimi, ndërtimi dhe proceset industriale mund të ndryshojnë modelet e erës në Komunën e Deçanit. Masat të cilat do të merren për mbrojtje nga erërat e forta janë:

- Informimi i saktë dhe në kohë për ardhjen apo praninë e erërave të forta.
- Paralajmërimi për banorët për tu strehuar për ardhjen apo praninë e erërave të forta.
- Planet e evakuimit për banorët të cilët janë të rrezikuar nga erërat e forta.
- Përgatitja e ekipeve të emergjencës për rastet e erërave të forta duke i trajnuar për rastet e tilla. Këtu përfshihet policia, zjarrfikësit, mjekët ndihmës, përfaqësuesit e lagjeve dhe OJQ-të.
- Pastrimi i rregullt nga mbeturinat urbane të cilat mund të janë të rrezikshme gjatë erërave të forta.
- Bashkëpunimi me të gjitha agjencitë përgjegjëse për rastet e erërave të forta. Autoritetet lokale mund të bashkëpunojnë me agjenci të ndryshme si shërbimet meteorologjike, për të marrë informacionin më të fundit në lidhje me ndikimin e mundshëm të erërave të forta dhe për të zhvilluar një reagim efektiv.

4.4.5 Mbrojtja nga tërmetet

Komuna e Deçanit, shtrihet në zonën me magnituden maksimale 7 dhe 8, sipas Institutit Sizmologjik të Kosovës, ku forcat sizmike mund të kalkulohen sipas € kodit 8, në ndërtimet e infrastrukturës dhe ndërtesave të banimit për të përballuar intensitetin e lëkundjeve dhe për minimizimin e pasojave në rast rreziku, kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta dhe infrastrukturës rrugore sidomos urave dhe rrjetit të energjetikës në Bjeshkët e Deçanit. Masat të cilat do të merren për rastet e tërmeteve ndahen në masat para ndodhjes së tërmeteve dhe masat pas tërmetit ose siç njohën ndryshe "pas efekti". Masat që duhet të merret para ndodhjes së tërmetit janë:

- Monitorimi i zbatimit të ndërtimeve të reja dhe rezistenca e tyre ndaj tërmeteve.
- Vlerësimeve të rrezikut që mund të shkaktohen nga tërmetet.
- Edukimi dhe vetëdijesimi i banoreve në rastet e tërmeteve e me theks të veçantë menaxhimi i panikut.
- Stërvitja e ekipeve të emergjencës të cilat mund të përbehen nga autoritetet ndryshme, banorët dhe OJQ-të.
- Zhvillimi i planeve të reagimit ndaj emergjencave
- Zhvillimi i planeve të evakuimit
- Bashkëpunimi me agjenci përgjegjëse rajonale, qendrore por edhe ndërkufitare për rastet e tërmeteve.

Masat që duhet të merën pas tërmetit apo ndryshe që njihet si "pas efektit" janë:


- Konsolidimi i menjëhershëm i ekipeve për kërkim dhe shpëtim.
- Sigurimi i strehimit urgjentë duke i përdorur ndërtesat e padëmtuara, ndërtesat publike apo strehimi në familje.
- Ofrimi i ndihmës mjekësore duhet siguruar edhe ambulanca lëvizëse për ndihmë të parë.
- Riaktivizimi i infrastrukturës kritike respektivisht rindërtimi i infrastrukturës kritike si shërbimet e ujit dhe energjisë elektrike, si dhe rrugëve dhe sistemeve të tjera të transportit.
- Largimi i mbeturinave duke i koordinuar përpjekjet për të pastruar mbeturinat nga rrugët dhe zonat publike për të lejuar shërbimet e urgjencës të arrijnë tek ata në nevojë dhe për të lehtësuar rifillimin e aktiviteteve normale.
- Mbështetje psikologjike dhe shërbime këshillimi për të prekurit nga tërmeti, duke përfshirë të mbijetuarit dhe familjet e tyre.
- Vlerësimi i dëmit.

4.4.5 Thatësia

Në Komunën e Deçanit thatësia më e madhe paraqitet gjatë muajve qershor korrik dhe gusht. Komuna duhet të ndërmarr këto masa:

- Programet e ruajtjes së ujit për të reduktuar kërkesën për ujë gjatë kohërave të thatësirës. Kjo mund të përfshijë fushata edukative, kufizime të ujit dhe zbatimin e praktikave të kursimit të ujit.
- Monitorimi i thatësirës dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe të ofrojnë paralajmërim të hershëm për thatësira e mundshme, duke u mundësuar komuniteteve të përgatitën dhe të përgjigjen.
- Planifikimi i emergjencës së thatësirës që përshkruajnë veprimet që duhen ndërmarrë gjatë thatësirës, të tilla si reduktimi i përdorimit të ujit, zbatimi i racionimit dhe identifikimi i burimeve alternative të ujit.

- Ndërtimi i pendëve në lumenj për akumulimin e ujit.
- Efikasiteti i përdorimit të ujit dhe riciklimi e cila do të promovojnë përdorimin e teknologjive dhe praktikave efikase ndaj ujit, të tilla si pajisje dhe pajisje me rrjedhje të ulët, si dhe riciklimin e ujërave të zeza për përdorime jo të pijshme.
- Furnizimi urgjent me ujë të tilla si rezervuarët e ruajtjes së ujit ose njësitë e lëvizshme të trajtimit të ujit, për të siguruar ujë gjatë thatësirave ose mungesave të tjera të ujit.
- Fushata të ndërgjegjësimit publik për të edukuar publikun mbi rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe si të reduktohet përdorimi i ujit.
- Koordinimi me agjencitë e tjera



Harta 42. Plani për mbrojtjen e rreziqeve natyrore

4.4.6 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

4.4.6 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Komuna e Deçanit, është e pasur me monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Asetet e trashëgimisë kulturore sipas kategorive janë: arkeologjike, arkitektonike, monumente natyrore, rezervate stërkite të natyrës, Park Kombëtar, peizazh i mbrojtur i pishës dhe një Zonë e Veçantë e Mbrojtur të cilat janë pjesë e listës së MKRS dhe MMPHI.

Kjo trashëgimi do të mbrohet dhe zhvillimet përreth tyre do të jenë në harmoni me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, sipas të cilave zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshinë perimetrin e vend-shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojte dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike.

Në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ndalohen aktivitetet në vijim:

- Ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje.
- Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale.
- Zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë.
- Instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjitalë.

Komuna e Deçanit ka të planifikuara në periudhën afatmesme dhe afatgjatë këto projekte në fushën e trashëgimisë kulturore janë:

- Hartimi i projektit për mbrojtjen dhe zhvillimin e rripit të gështenjës.
- Hartimi dhe Miratimi i Planit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore.
- Kulla e Mazrekaj - renovim.
- Kulla e Haklaj - renovim.
- Digjitalizimi i ndërtesave të trashëgimisë kulturore.
- Kompleksi i kullave në fshatin Dranoc - renovim për ofrimin e shërbimeve gastronomike.
- Kompleksi i kullave në Isniq - renovim, organizimi i evenimenteve tradicionale.
- Kulla në Belle - restaurim nga MKRS.
- Kulla Ramosaj - restaurim nga CHwB.
- Kulla e Dëshmorëve - renovim MKRS.
- Kompleksi memorial historik i ZO të Dukagjinit MKRS.
- Mulliri i Gjukaj - restaurim MKRS.
- Kulla e Ibish Osmanaj - renovim MKRS.
- Kulla e Ibish Sadikut Osdautaj - restaurim MKRS.
- Kulla e Himë Mushkolaj – inventarizimin nga UNDP.
- Kulla e Mustaf Dukaj - restaurim UNDP.
- Mulliri i Daut Osë Hulaj- restaurim MKRS.
- Kulla e Ramë Povataj - renovim MKRS.
- Kulla e Shaban Murat Gjukaj - restaurim MKRS.
- Kulla e Ali Isuf Mataj - restaurim MKRS.

4.4.6 Mbrojtja e trashëgimisë natyrore

Trashëgimia natyrore në Komunën e Deçanit, është e pasur dhe e shumëllojshme ku duhet të veçohen rezervatet natyrore si: “Kozhnjeri”, “Maja Ropsit”, “Bjeshka e Prilepit”, “Zona e rëndësisë së Posaçme” (viti i shpalljes 2005). Prej bimëve drunore me të rëndësishmet në këtë pjesë janë: Gështenja (Castane Sativa), Hormoçi (Picea), Bredhi (Abis), Arneni (Pinus Peuce), Arneni i bardhë (Pinus Cheldreichi), Ahu (Fagus moesiaca) dhe llojet e ndryshme të fletorëve.

Në Grykën e Deçanit dhe Lloqanit, është mjaft mirë e zhvilluar edhe verri (Alnus) dhe lloje të ndryshme të shelgut (salix). Vlen të theksohet edhe aspekti gjeologjik, që është mjaft heterogjen dhe dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna), ku janë prezent disa lloje të shkëmbinjve, me të përhapurit janë shkëmbinjtë silikat, serpentin dhe karbonit (dolomitët). Shkëmbinjtë silikat janë të përhapur edhe në “Majën e Ropsit” dhe aty është prezent një florë, gjithashtu karakteristike që dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare. Prej llojeve bimore, që janë të rrezikuara nga nxjerrja e rrënjëve për t’u shitur duhet cekë lloji Gentiana Luta (gentiana e verdhëlincuri), e cila më parë kishte një shtrirje të gjerë, kurse tani ka mbet në disa lokalitete gati në zhdukje. Kjo bime është shëruese (përdorej për plagë dhe sëmundje të lëkurës) dhe rrënjët e saja edhe sot përdoren dhe shitën me çmim të lartë. Përveç shfrytëzimit të egër të bimëve të larta


(vaskulare) duhet bërë edhe edukimi i atyre njerëzve që bëjnë grumbullimin e kërpudhave. Duhet të mësohen si duhet bërë vjelja (jo të mirën më rrënje, por të pritën me thike në mënyre që të mos të ndikojnë në zhdukjen e këtyre bimëve që kane rendësi ekonomike. Në aspektin vegjetacionit rëndësi kanë disa fitocenoza që janë mjaft të rralla si eulfenis dhe arnenit (molikës).

4.4.6 Zona e Veçantë e Mbrojtur

Shtrihet në Grykën e Deçanit, përgjatë rrjedhës së "Lumëbardhit të Deçanit", me një hapësirë prej 790.7 ha , është shpallur me vendim të UNMIK-ut në vitin 2005. Sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, "Zonë e Veçantë e Mbrojtur" e përkufizon se do të jetë një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit, që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historikë, kulturorë, arkitektural apo arkeologjikë, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik. Shpallja e kësaj zonë më shumë ka qenë vendim politik që është ndërmarr ku paraprakisht nuk është bërë një hulumtim të vlerave shkencore biologjike që ka zona, Manastiri i Deçanit, i cili është i mbrojtur nga UNESCO.

Kjo pjesë karakterizohet më bukuri të rrallë të natyrës me shkëmbinjtë gëlqerorë, që "Lugina e Lumëbardhit", është e ndërtuar në kanjonin e glacialit të dikurshëm në luginën, që është 30 km. Vlen të theksohet se në aspektin gjeologjik, është mjaft heterogjen dhe dallon nga pjesët e tjera të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna). Në ketë pjesë gjendet edhe kompleksi i trungjeve të pishës së zezë (pinus nigra) pyjore, i vene në mbrojtje ligjore, si zone e mbrojtur e pishës pyjore. Ky pyll është mbjellë në pjesën e parë të shek. XIX-të, me sipërfaqe prej 15 ha, kurse pjesët jugore dhe lindore të këtij pylli janë të pasur me gështenja.


Përgjatë rrjedhës së "Luginës së Lumëbardhit", janë të pasura me trungje të verrit (alnus glutinosa, alnus viridis) dhe shelgu (Salix) po ashtu edhe bimët barishtore janë shumë të pranishme të kësaj pjesë që i japin një diversifikim florës të kësaj pjesë. Kjo pjesë duhet të veçohet së është e pasur më faunë lumore ku veçohen llojet e peshqve. Këto rrjedha të ujit asnjëherë nuk shterin, as në kohë thatësie sepse kanë rrjedha anësore. Edhe pse është në kundërshtim ligjor, janë lejuar punimet për ndërtimin e hidrocentralit Kelkos Company SH.P.K me ç 'rast me prerjen e gjelbërimit të lartë në pjesën anësore të rrugës, ku në shumë vende ka ardhur deri të procesi i rrëshqitjeve dhe masave të dheut.



Harta 43. Hapësirat e evidentuara nën mbrojtje në Komunën e Deçanit

4.4.7 Zhvillimi ekonomik

Komuna e Deçanit, ka një bazë mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Në këtë Komunë ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomik, filluar nga veprimtaritë primare ekonomike, ato sekondare dhe shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Gjithashtu, kjo Komunë ka bazë të mirë edhe për veprimtari të lehta industriale, kurse bukuritë natyrore dhe trashëgimia materiale dhe jo-materiale ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit. Komuna e Deçanit, do të ofroj shërbime edhe më efikase duke ngritur kapacitetet human në fushën e turizmit. Tërë planifikimi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Komunës, do të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore dhe kulturore dhe në avancimin e resurseve humane. Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave që vijnë për t'i shfrytëzuar ato resurse. Hapësira e Komunës së Deçanit, ka dallime të theksuara sa i përket strukturave ekonomike, sociale dhe natyrore. Bazuar në këto dallime, edhe propozimi i zhvillimit ekonomik do të këtë një diversitet të pasur, që ofron kjo Komunë janë: zonat rurale për zhvillimin e turizmit, zonat historike, zonat arkeologjike, zona e Bjeshkëve të Deçanit, dhe trashëgimia jo-materiale, evenimentet tradicionale.




Harta 44. Plani i zhvillimit ekonomik

4.4.7 Zhvillimi i turizmit

Zonat me potencial turistik përveç pjesës se rrafshët në zonën urbane dhe rurale, potenciali me vlera zhvillimore është përqendruar në pjesën e Bjeshkëve të Deçanit. Komuna e Deçanit, kryesisht është e pasur me pyje dhe kullosa dhe fondin e tokës bujqësore, sipas Ministrisë së Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, toka bujqësore kategorizohet në 11 njësi bujqësore të parcelave. Peizazhet natyrore në gjithë territorin janë mjaft atraktive për rekreacion dhe turizëm. Mund të thuhet se pyjet, kullosat, uji, liqenet, mineralet, peizazhet janë resurset natyrore më të rëndësishme të zonës së Bjeshkëve të Deçanit. Për të zhvilluar turizmin në mënyrë të qëndrueshme, duhet pasur parasysh parimet kryesore të zhvillimit siç janë: shfrytëzimi i resurseve për nevoja momentale dhe ruajtja e tyre për nevojat e gjeneratave të ardhshme. *Turizmi do të trajtohet në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"* [92]*, gjegjësisht i përfshinë të gjitha projeksionet mbrojtëse, zhvillimore, qëllimet, objektivat dhe aktivitete dedikuar Komunës së Deçanit.*

[92] gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78122

Deçani me rrethinë, posedon parakushte dhe potencial mjaft të favorshëm për zhvillimin e turizmit edhe në të ardhmen. Si aset i rëndësishëm në Komunën e Deçanit janë bjeshkët si trashëgimi natyrore dhe trashëgimia kulturore të cilat i japin rëndësi të veçantë kësaj zone. Burimet natyrore dhe kulturore që ka kjo zonë mundësojnë zhvillim e turizmit, kërkohet që të investohet edhe në rregullimin e infrastrukturës turistike. Për faktin së bjeshkët e Deçanit, kanë vlerë dhe potencial të rëndësishme natyror, kulturor dhe strategjike për të cilën kërkohet një kujdes i veçantë për planifikim dhe zhvillim turistik. Të koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor janë identifikuar dhe prezantuar me projekt propozime strategjike për zhvillimin e turizmit në Bjeshkët e Deçanit, të cilat janë identifikuara në 14 lokalitete apo zona turistike.



Harta 45. Pozita e lokaliteteve në Zonën kadastrale Komunale

Në tërësinë "Urbanë dhe trashëgimia kulturore" do të ofrohen ofertat e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore të cilat janë të karakterizuara me kulla, mullinj, xhami, kisha dhe Manastiri i Deçanit. Në ketë tërësi ekzistojnë mjaft hotele, hostele te cilat mund të akomodojnë mjaft turist mirëpo numri i shfrytëzimit të turizmit është ende i ulët në krahasim me kapacitetet që i posedon kjo zonë.

Në tërësinë " Trashëgimi natyrore - Bjeshkët" do të zhvillohet turizmi vetëm *në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna.*

Në tërësinë "Zona rurale e Komunës Deçanit" ofron mundësi të mira të zhvillimit të turizmit me karakter trashëgimisë siç janë kullat dhe mullinjtë si dhe të argo turizmit.

Komuna e Deçanit, krahasuar me potencialet që i ka ende nuk ka arrit të krijon ofertën e saj të kompletuar për turizëm. Nevojitet mjaft kohë dhe angazhim që kjo oferte të zhvillohet andaj, duhet me doemos të rritet numri i akomodimeve dhe të zhvillohet infrastruktura turistike në përgjithësi. Për këtë është me se e nevojshme të hartohen politikat afat mesme për zhvillim siç janë:

- Ngritja e kapaciteteve humane në fushën e turizmit.
- Ndërtimi i shtëpisë së Shoqatës së Bjeshkatarëve "Shkëlzen Haradinaj" (vazhdim i projektit).

- Ndërtimi i Mullirit Tradicional në parkun Kombëtarë duke u bazuar ne Planin Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".
- Krijimi dhe ndërtimi i fshatit turistik "Laku i kryqes".
- Ndërtimi i rezidencës turistike Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.
- Ndërtimi i Qendrës së grumbullimit, përpunimit të frutave dhe bimëve mjekuese me kompleks gastronomik.
- Ndërtimi i tri pendave akumuluese të ujti ne Grykën e Lloqanit.
- Ndërtimi i qendrës për rruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e produkteve të gështenjës afër fshatin Strellc i Epërm (ne brezin e gështenjës që shtrihet ne kuadër të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".

4.4.7 Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë

Për zhvillimin e bujqësisë duhet të rishikohet - plotësohet strategjia dhe plani për zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Deçanit, duhet të planifikoj politika lehtësuese, për subvencionimin e këtij sektori. Në këtë aspekt Komuna e Deçanit, duhet të ndërmarrë këto objektiva për zhvillimin e bujqësisë duke ndihmuar bujqit në: grupimi i parcelave bujqësore, aplikimi i masave agroteknike, ngritja e kapaciteteve të magazinimit dhe përpunimit të produkteve, ngritja e fermave dhe serave (përpunim qumështi, mishi dhe perimeve të freskëta) të favorizoj me investime rritjen e sipërfaqeve me pemëtari, bletari, kultivimin e bimëve mjekuese dhe rritjen e fondit të gjedheve dhe shpezëve, gjithashtu të mbështetet edhe ngritja e qendrës se grumbullimit dhe përpunimit të frutave malore, frigoriferëve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, organizmin e fermerëve në organizata bujqësore të prodhimeve bujqësore. Objektivi për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, nënkupton menaxhim të resurseve natyrore dhe siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore, sipërfaqet e pyjeve, rritjen e kapaciteteve të rendimenteve, duke siguruar që rrjeti ekzistues i kanaleve të ujitjes të betonohet dhe zgjerohet me aplikim e sistemit të avancuar të ujitjes. Kullosat dhe livadhet janë potencial ku duhet të mbështetet zhvillimi i blegtorisë, lavërtarisë, pemëtarisë, perimtarisë dhe agro industrisë. Gjithashtu për të siguruar ujitjen në mënyrë të qëndrueshme është e nevojshme që të ndërtohen tre akumulues.

Zhvillimi i bujqësisë intensive do të jetë në pjesën lindore gjegjësisht në tërësinë e tretë "Zona rurale e Komunës Deçanit". Në këtë pjesë do të zhvillohet lavërtaria, perimtaria, pemëtaria dhe gjedhtaria. Duke e marr parasysh sipërfaqen e madhe të tokës kualitative në këtë tërësi, është e nevojshme që të shtrihet rrjeti i ujitjes, të trajnohen sa ma shumë pronarët e tokave për aplikim në projektet apo grante te ndryshme bujqësore, mbështetja në ngritjen e fermave të reja, shpërndarja e fidanëve të ndryshme të pemëtarisë dhe brendimi i produkteve të Komunës Deçanit. Në përgjithësi ne këtë tërësi do të këtë prodhime parësore gjegjësisht bujqësi duke përfshirë prodhime bujqësore komerciale, infrastrukturë bujqësore dhe prodhim bujqësor për konsum vetjak.

Bujqësia mund të zhvillohet edhe në hapësirat fushore dhe kodrinore të tërësisë "Zona Urbane dhe Trashëgimia kulturore". Në këtë pjesë mund të zhvillohet sektori pemëtarisë, gjedhtaria, bletaria dhe kultivimi i llojeve te ndryshme te florës, bimëve shëruese etj. Duke i marr parasysh se në këtë tërësi ka ende familje të cilët i kultivojnë rendimentet e ndryshe bujqësore, andaj rekomandohet që të ngiten fermat e reja të vogla, përpunimi i qumështi dhe nënprodukteve tjera të qumështit, mishit, fruta farore, fruta të imta dhe bimë mjekuese.. Në këtë tërësi, mbështetet edhe mbrojta dhe zhvillimi i gështenjës andaj, është e rëndësishme që kjo kulturë të mbrohet dhe të zhvillohet me tutje deri në brendimin e tij. Për shkak të pozitës së favorshme në mes të dy tërësive, propozohet që në këtë pjesë të ndërtohen edhe qendra me frigorifer të ndryshëm të cilët do e ndihmojnë ruajtjen e rendimenteve të ndryshme e me theks të veçantë të frutave të imta. Sa i përket florës, rekomandohet që të kultivohen lulet të cilat e ndihmojnë bletarinë, siç janë: lavandula, luledielli, lulet e egra, marigoldët etj. Në këtë pjesë do të zhvillohet prodhimi parësor e cila përfshinë prodhim bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore dhe për prodhim bujqësor për konsum vetjak.

Në pjesën perëndimore gjegjësisht në tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" do të zhvillohet sektori i bujqësisë në harmoni me Planin Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".

Bletaria - Komuna e Deçanit, ka mjaft sipërfaqe tokësore në të cilën rritën dhe zhvillohen një numër i konsiderueshëm i bimëve nektaruese (nektarmbajtëse), që janë burim kryesor i ushqimit të bletëve. Bimët nektaruese që shfrytëzohen për kullotjen e bletës sipas shtrirjes së tyre ndahen si: bimë natyrore dhe bimët e ndryshme bujqësore të kultivuara.
Gjithashtu vlen të përmendet ndikimi i faktorit njeri, i cili më punën e tij në ngritjen dhe rregullimin e kopshteve dhe kultivimin kulturave të tjera bujqësore ndikojnë shumë në përmirësimin e kullosave për bletët. Natyra e Komunës së Deçanit, ofron kushte mjaft të mira për të nxjerrë sa më herët bletët në kullosë para fillimit të pranverës gjejnë kullosa të bollshme në natyrë si: Bagren (Akacia-Robinia pseudacacia L.), Blirit (Tilia sp.L), Gështenjës (castane sativa) etj.
Përpos bimëve drunore të cilat gjenden të përhapura në vendin tonë, kemi edhe shumë lloje të bimëve barishtore. Këto bimë barishtore janë të përhapura nëpër livadhet e ultësirave, livadhet kodrinore, livadhet malore dhe kullosat. Në të gjitha këto livadhe rritën shumë bimë që janë të njohura për prodhimin e nektarit dhe të pjalmit (polenit) me cilësi shumë të mirë e këtu vlen të përmenden:
Zymbyli i livadheve (C. Caerylea), që lulëzon nga fundi i qershorit dhe gjatë tërë korrikut, Manaferra (Ribes rubrum), Tërfili i livadheve (Trifolium Pratënse L.), Sherbela e livadheve (Silvia verticilata L.), Trumza (Satureia subspicata Vis.) Luleverdha (C. Palustris) që është pranishëm në livadhet kodrinore dhe në Bjeshkët e Deçanit. Këto kushtet të favorshme që ofron natyra bëjnë të mundur zhvillimin e bletarisë. Për të zhvilluar ketë sektor është e nevojshme që ti ofrohen kushtet sa ma të favorshme për bletët. Në përgjithësi, bletët tërhiqen nga lulet që janë të pasura me nektar dhe polen, kanë ngjyra të ndezura dhe janë të lehta për t'u qasur. Mbjellja e një shumëllojshmërie të këtyre luleve mund të ndihmojë në tërheqjen dhe mbështetjen e popullatave të bletëve. Bletët tërhiqen nga një shumëllojshmëri lulesh, por disa lule janë më të favorshme për bletët se të tjerat siç janë:

- Lavandula - bletët e duan nektarin nga lulet e livandës dhe shpesh mund të shihen duke gumëzhitur rreth shkurreve të livandës gjatë verës.
- Luledielli - lulet e mëdha dhe të ndritshme të luledielli janë të preferuarat e bletëve, duke u siguruar atyre sasi të bollshme nektari dhe poleni.
- Lulet e egra - një përzierje e larmishme e luleve të egra, të tilla si tërfili, luleradhiqe dhe familja e Asteracea, mund t'u ofrojnë bletëve një furnizim të qëndrueshëm të ushqimit gjatë gjithë sezonit të rritjes.
- Marigoldët (familje e Asteracea) - këto lule të ndritshme dhe të gëzuara ofrojnë një burim të mirë nektari dhe poleni për bletët.
- Lulet koni - të njohura edhe si echinacea, janë lule të njohura të kopshtit që tërheq bletët me lulëzimin e tyre të shndritshëm dhe të dukshëm.
- Borage (familjes Borago officinalis) – ndryshe janë të njohura edhe si lule ylli, është një barishte e preferuar e bletëve. Lulet janë gjithashtu të ngrënshme dhe mund të përdoren në sallata ose si garniturë.
- Crocus (e familjes iridaceae/iris) janë një nga lulet e para që lulëzojnë në pranverë, duke u siguruar bletëve një burim të hershëm nektari dhe poleni pas një dimri të gjatë.

Duke i marr parasysh këto mundësi, propozohet që sektori intensiv të zhvillohet në tërësinë "Zona urbane dhe trashëgimia kulturore" mirëpo duke mos e përjashtuar as edhe tërësinë "Zona rurale e Komunës Deçanit".

Për të mbështetur ketë sektor është e nevojshme që të krijohet bashkëpunim në mes të Komunës Deçanit me OJQ-të siç janë:

- Trajnime për bletarët e ri.
- Ngritja e parkut të bletarisë dhe shtimi i numrit të shoqërive të bletëve.
- Subvencionimi i bletareve me pajisje dhe koshere.
- Mbështetja e sektorit të zhvillimit të lulishteve ku me theks të veçantë do të mbështetët gjinia femërore në zhvillimin e këtyre bizneseve.

Blegtoria – Komuna e Deçanit njihet tradicionalisht për zhvillimin e blegtorisë. Ajo karakterizohet me fond të pasur e të konsiderueshëm të livadheve e kullosave. Janë të llogaritura 1,873 ha sipërfaqe për kullosa çka e mundëson zhvillimi e kësaj veprimtarie. Gjithashtu me politikat e qëndrueshme afat shkurtër dhe afat mesëm të zhvillimit të blegtorisë ne të ardhmen do të mundësohet edhe zhvillimi i blegtorisë në pjesën rurale. Ekziston tradita dhe përkushtimi i banorëve për ta zhvilluar këtë veprimtari, sepse ofron shumë përfitime, duke përfshirë:

- Ushqimi - blegtoria është një burim ushqimi për konsum njerëzor.
- Të ardhurat - blegtoria mund të jetë një burim të ardhurash për fermerët dhe prodhuesit.
- Plehrat - plehrat e bagëtive mund të përdoren si pleh për të përmirësuar pjellorinë e tokës dhe rendimentet e të korrave.
- Veshje - blegtoria siguron lesh dhe lëkurë që mund të përdoret për të bërë veshje dhe produkte të tjera.
- Rëndësia kulturore - në shumë kultura, blegtoria është një pjesë e rëndësishme e zakoneve dhe ceremonive tradicionale.
- Punësimi - blegtoria dhe industritë e ngjashme ofrojnë mundësi punësimi për miliona njerëz në mbarë botën.
- Burimet gjenetike - racat e bagëtive dhe burimet e tyre gjenetike janë të rëndësishme për sigurinë ushqimore në të ardhmen dhe për mbarështimin e racave të reja, të përmirësuara të kafshëve.

Të gjitha përfitimet e lartë përmendura lidhen direkt me mundësinë e rritjes së numrit të punësuarve ne Komunën e Deçanit e cila ka ndikim të drejt për drejt në zhvillimin ekonomik. Andaj është më se e nevojshme që të behet lidhshmëria e politikave blegtorale, me strategjinë lokale për zhvillim ekonomik dhe të identifikohen hapat konkrete të mbështetjes së këtij sektori. Duke i bashkërenditur të gjitha këto veprime, fillojnë të hapen mundësitë e reja zhvillimore siç janë:

- Tregu për mish, qumësht, djathë, vezë dhe produkte të tjera të qumështit që janë burime të rëndësishme të proteinave dhe lëndëve ushqyese në dietat njerëzore.
- Grumbullimi dhe deponimi leshit dhe lëkurës të cilat kanë treg për shitje si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj.

Zhvillimi i blegtorisë lejohet të zhvillohet në mënyrë intensive në tërësinë “Zona rurale e Komunës Deçanit”, ndërsa te tërësia “Zona urbane dhe trashëgimia kulturore” do të jetë ma pak e zhvilluar dhe në mënyrë të kontrolluar. Në pjesën urbane të kësaj tërësie ku ka ndërtime të mëdha, nuk lejohet zhvillimi i blegtorisë intensive përpos pjesës kodrinore. Në tërësinë “Trashëgimia natyrore – Bjeshkët” lejohet zhvillimi i blegtorisë vetëm sipas Planit Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna”.

4.4.7 Pylltaria si aktivitet ekonomik

Në Komunën e Deçanit, ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme me pyje. Zhvillimi i pyjeve në Komunën e Deçanit do të ketë një mori përfitime mjedisore dhe ekonomike. Pjesa ma e madhe e pyjeve në Komunën e Deçanit ndodhen në anën perëndimore të saj. Ky masivitet i pyjeve i ndihmon Komunës se Deçanit që të ketë ajër ma cilësor me qenë se absorbojnë dioksidin e karbonit nga atmosfera dhe e ndihmojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike. Andaj, kërkohet që në kuadër të

zhvillimit të politikave sektoriale, Komuna e Deçanit se bashku me nivelin qendror të hartojnë një plan për shfrytëzim dhe mbrojtje të pyjeve.

Mbrojtja dhe menaxhimi efikas i pyjeve ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e mjedisit të shëndosh dhe ta ndihmon biodiversitetin respektivisht speciet e ndryshme bimore dhe shtazore. Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e rrjedhës së ujit në pellgje ujëmbledhëse, duke ndihmuar në parandalimin e erozionit, rregullimin e temperaturave të përrenjve dhe ruajtjen e cilësisë së ujit. Gjithashtu me shfrytëzimin e tyre racional mund të zhvillohet industria e drurit, biomasës dhe artizanalëve tjera të cilat mund të përdorën ne sektorin e ndërtimit, prodhimin e letrës etj.

Komuna e Deçanit, duke pasur parasysh fondin e pyjeve mund të shfrytëzohet masën drunore të dëmtuar për biomase (ngrohje). Me menaxhimin e mirë të pyjeve ofrohen mundësitë e mira për punësim e që kanë të bëjnë me prerjet dhe përpunimin e drurit ndërsa në aspektin kulturorë dhe shpirtëror, pyjet luaj rol të rëndësishëm për shumë njerëz duke shërbyer si vend i rëndësishëm për ceremoni të ndryshme, kampingje, meditime dhe lidhjen me natyrën.

Pyjet janë të shtrira kryesisht në tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" dhe për mbrojtjen e tyre janë të nevojshme të ndermirën disa masa që kanë të bëjnë me:

- Zhvillimin dhe forcimin e kornizës ligjore dhe politikat lokale. Në ketë drejtime është e nevojshme që të ketë bashkërendim dhe mbështetje edhe nga niveli qendror dhe të hartohen mekanizmat për parandalimin e dëmtimit të pyjeve. Me shpalljen e Parkut Kombëtarë" Bjeshkët e Nemuna" është më se e nevojshme që të mbrohet biodiversiteti dhe ekosistemet.
- Kontrollimi i gjuetisë dhe parandalimi i gjuetisë së egër e cila ka ndikim në zhvillimin e pyjeve.
- Parandalimi i qasjes së paautorizuar dhe nxjerrjen e burimeve në mënyrë të pakontrolluar.
- Gjithë përfshirja e banorëve dhe pronarëve të tokave në zonat pyjore për të marr njohuritë rreth traditave dhe praktikat e mbrojtjes së pyjeve. Gjithashtu është e nevojshme edhe ngritja e vetëdijesimit të banoreve dhe vizitorëve për mbrojtjen e pyjeve.
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e pyjeve nga personat përgjegjës mirëpo edhe nga grupet vullnetare, banorët etj. Për ketë është e nevojshme që të zhvillohet sektori i monitorimit të pyjeve duke siguruar foto satelitore, pajimin me dron, shpërndarja e sensoreve të ndryshëm monitorues dhe fotografik të cilat sjellin imazhe në kohë reale rreth dukurive negative.
- Ripyllëzimi dhe pyllëzimi të zonave të nevojshme nëpërmes aktiviteteve të ndryshme me synim të mbrojtës së pyjeve. Rekomandohet që të behët ripyllëzimi dhe pyllëzimi me llojet e njëjta të druve me synim të mos prishjes së balancës së ekosistemit.
- Menaxhim i zjarreve me synim të parandalimit të zjarreve në pjesët pyjore.
- Prerjet e kontrolluara duke i minimizuar ndikimet negative mjedisore dhe sigurojnë regjenerimin e zonave të prera.
- Rritja e bashkëpunimit nder komunal dhe ndërkufitar, me organizatat lokale, nacionalë dhe ndërkombëtarë, OJQ-të me synim të parandalimit të shpyllëzimit.
- Zhvillimi i hulumtimeve të ndryshme pyjore me synim të promovimit të Komunës së Deçanit në sektorin e biologjisë dhe mjedisit ën përgjithësi.
- Stimulimi nëpërmes shpërndarjes së donacioneve të ndryshme komunale për OJQ-të për parandalimin e shpyllëzimit.

Në mënyrë të kontrolluar, prodhimi do të jetë parësore dedikuar pyjeve gjegjësisht pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, rotacion të mesëm, të gjatë dhe pylltari e bazuar ne mbulesë të vazhdueshme. Këto do të kanë ndikim në prodhimin dytësor me industri të lendes së parë, për prodhime drurit dhe produkteve me bazë të drurit.

4.4.7 Zhvillimi i industrisë së lehtë dhe i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme NVM-ve

Strategjia e krijimit të një ambienti tërheqës në Komunën e Deçanit bazohet në favorizimin e artizanaleve, ndërmarrjeve të vogla , në veçanti atyre me zhvillimin e argo-industrisë dhe agro-turizmit. NVM-të tashmë do të kanë një orientim investues, pasi fillimisht do të parashihen lehtësime në infrastrukturën përcjellëse, pastaj sigurimi i një lokacioni si parku i biznesit i cili është planifikuar në hapësirat e fshatit Drenoc, me sipërfaqe 20 ha. Vend ky si nyje qarkulluese dhe i përshtatshëm për të gjitha kategoritë që kërkojnë trajtim të veçantë dhe kritere në ruajtjen e mjedisit.

Koncepti i zhvillimit ekonomik të NVM-së për ushtrimin e veprimtarisë së tyre Komuna e Deçanit, ka planifikuar zonën për ushtrimin e veprimtarisë se industrisë se lehtë, agro-turizëm dhe shtrirjen e veprimtarive të NVM-së në sektor të ndryshëm.

NVM për prodhim parësor gjegjësisht për bujqësi janë të planifikuara ne tërësinë "Zonat rurale të Komunës Deçanit". Në këtë sektor janë planifikuar prodhime bujqësore komerciale, dhe me infrastrukturë bujqësore.


Veprimtaritë ekonomike duke përfshirë prodhim parësor: me zhvillimin e prodhimtareve bujqësore komerciale, infrastrukturë bujqësore dhe pylltari.

Veprimtaritë ekonomik duke përfshirë prodhime dytësore: industri e lëndës së parë që kanë të bëjnë me prodhim të drurit, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i energjisë ripërtritshme.

Veprimtaritë ekonomike duke përfshirë prodhim tretësor me shërbim tregtar: Shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, Shërbim i patundshmërisë, Shërbim i akomodimit dhe ushqimit, Shërbim financiar dhe i sigurimit, shërbim administrativ dhe mbështetës.

Në Komunën e Deçanit jeton popullatë e re dhe fuqia punëtore nuk mungon. Mirëpo, duhet qe sa ma parë të hartohen politikat sektoriale të cilat do e ndihmojnë zhvillimin e NVM dhe rritjen e punësimit ndërsa në anën tjetër do e ndihmon demografinë në aspektin e uljes së migrimit.

Në varësi të rritjes së kërkesave dhe nevojës për zgjerim, propozohet që korridori i cili i lidh nyjat respektivisht rruga e cila e lidhë Deçanin me Gjakovën dhe Deçanin me Pejën të zgjerohet në drejtimin jugor me aktivitete të ndryshme ekonomike. Në këtë mënyrë, zhvillimi ekonomik bëhet përgjatë këtij korridori, në tokat kryesisht të kontaminuar nga gazrat, pluhuri dhe mbetjet e gomave duke i mbrojtur tokat pjellore dhe kualitative nga zhvillimi i pakontrolluar.



Harta 46. Parku i biznesit në fshatin Drenoc

4.4.8 Infrastruktura Teknike – planifikimi

4.4.8 Ujësjellësi

Sistemi i ujësjellësit në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga njësia operative K.R.U "Hidrodrini" Sh.A Pejë. Bazuar në rëndësinë e ujësjellësit dhe ndikimin e tij në kualitetin e jetës dhe mirëqenien e popullatës si dhe në zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës, gjatë hartimit të PZHK-së, duhet gjithsesi të harmonizohen planet dhe projektet planifikuese për investimet kapitale në infrastrukturën e furnizimit me ujë ku nevojat imediatë janë për përmirësimin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit në pjesën urbane dhe rurale aty ku ka nevojë duke përfshirë edhe zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe gjetjen e humbjeve Teknike dhe administrative si dhe identifikimin dhe eliminimin e lidhjeve ilegale. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës, për:

- Ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime,
- Zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbime të furnizimit me ujësjellës të cilat janë fshati Belle dhe Pleqe dhe Shkelzen Haradinaj.

Vlen të cekët se në 35 vendbanime dhe pjesa urbane ekziston rrjeti e funksional i ujësjellësit. Pastrimi - dezinfektimi i ujit të pijes bëhet me klor të lëngët për arsye të mungesës së klorit të gazet. Cilësia e ujit për pije kontrollohet nga IKSHPK - Pejë bazuar në Ligjin Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës. Sipas parametrave të analizave nga IKSHPK cilësia e ujit të pijes në Komunën e Deçanit, në pikëpamje fizike, kimike dhe biologjike është i mirë.


Projektet e planifikuara për fazën afatmesme në periudhën 2024-2025 dhe afatgjatë 2026-2032 për infrastrukturën Teknike të planifikimit janë këto projekte:

- Funksionalizimi i klorinatorëve në Komunën e Deçanit.
- Rehabilitimi në disa pjesë të ujësjellësit në qendër të qytetit me vlerë 50,000.00 €.
- Pajimi i rajonit të Vokshit me ujëmatës.
- Sistemi i rezervarit në Hulaj të rehabilitohet me ujëmatës.
- Marrja në menaxhim të rrjetit të kanalizimit të ujerave të zeza në tërë territorin e Komunës së Deçanit.
- Ndërtimi dhe shtrirja e ujësjellësit në Bjeshkët e Deçanit.
- Hulumtimi dhe analizimi i mundësisë së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.

Ofrimi i shërbimi me ujë të pijshëm bëhet në harmoni me politikat dhe strategjitë e K.R.U "Hidrodrini" Sh.A Pejë, mirëpo duke i marr parasysh edhe normat e dala nga U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 14. Infrastruktura e ujësjellësit.

4.4.8 Sistemi i kanalizimit

Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit, ka shënuar një zhvillim të theksuar viteve të fundit. Në bazë të shënimeve të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe aktualisht sistemi i kanalizimit i ujërave të zeza është i shtrirë në një gjatësi të përgjithshme prej: 64,572.36 m. Në rrjetin e kanalizimit përshihen: Qyteti i Deçanit, fshatrat: Beleg, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Llukë e Epërm, Llukë e Ulët, Lumbardhë, Rastavicë, Pobergjë, Drenoci dhe Sllup, ku të gjitha ujërat e zeza trajtohen pjesërisht dhe duhet të ndërtohen impiante sipas standardeve për trajtimin e ujërave të zeza, për të evituar ndotjen e cila paraqet kërcenim serioz për shëndetin e popullatës dhe mjedisin në tërësi është e domosdoshme edhe realizmi sa me i shpejt i planifikimit për ndërtimin e kanalizimit në 18 fshatra tjera të cilat janë pa sistem të kanalizimit duke përfshirë edhe ndërtimin e impianteve. Ndërtimi i kanalizimit dhe impianteve në këto vendbanime: Strellc i Ulët - Bohriqe, Dubovik - Lagjja Gërvallaj - kufi me fshatin Kryshec dhe Papiq kjo me vlerë afërsisht 13 milion (trembëdhjetë milion €) ku trajtimi i ujërave të zeza do të bëhet sipas normave dhe standardeve mjedisore. Rregullimi i rrjetit të kanalizimit do të jetë në harmoni të plotë me U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 15. Infrastruktura e kanalizimit.



Harta 47. Shtrirja e ujësjellësit dhe kanalizimit

4.4.8 Kanalizimi atmosferik

Deri me tani rrjet të kanalizimit për ujërat atmosferike është i shtrirë vetëm në zonën urbane dhe atë në pjesën qendrore të qytetit me gjatësi prej 6.5 km, me kapacitet Ø 200mm - Ø 500mm, me puset të vendosura në largësi nga 25-30 m, përgjatë rrugës kryesore të qytetit, shkarkimi i tyre bëhet në lokacione të ndryshme në kanalet e hapura.

Shtrirja e rrjetit të ujërave atmosferike në të ardhmen parashihet edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferike në pjesën e vjetër të qytetit e ashtu quajtura (rruga e vjetër) me gjatësi prej 3 km. Kanalizimi i ujërave atmosferik është trajtuar më rastin e ndërtimit të rrugës së qendrës më gjatësi prej 6 km. Ky rrjet parashihet të ndërtohet edhe në këto qendra të vendbanimeve në zonat rurale si: Strellc i Epërm, Isniq, Carrabreg i Epërm, Irzniq dhe Drenoc ku do të jetë me gjatësi prej 12 km, por është e domosdoshme të bëhet edhe trajtimi i tyre dhe pastaj shkarkimi në kanalet e hapura apo në rrjedhat e lumenjve. U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 15. Infrastruktura e kanalizimit respektivisht nën pikës 2.3. (ujërat e përziera/urbane (të cilat mund të jenë ujëra të ndotura shtëpiake, ose përzierje e ujërave shtëpiake dhe industriale dhe/ose ujëra atmosferikë)).

4.4.8 Ujitja

Sistemi i rrjetit të ujitjes parashihet të mbuloj tërë tokat bujqësore në Komunën e Deçanit. Deri më tani është investuar në rrjetin e ujitjes dhe planifikohet të vazhdohet në këtë drejtim edhe në të ardhmen. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e tyre ka kosto të lartë mirëpo Komuna e Deçanit planifikon që në kuadër të politikave zhvillimore për bujqësinë të planifikon edhe aplikimin në grante dhe projekte të ndryshme të nivelit qendror dhe organizatave të ndryshme. Në të gjithë Sistemin ekzistues pritën

të realizohen projekte për ndërtimin e kanaleve të ujitës, me ç 'rast parashihet ndërtimi i 32 kanaleve me gjatësi rreth 51.49 km. Me të gjithë ketë gjatësi, Komuna e Deçanit e mbulon të gjithë zonën rurale me Sistemin e ujitjes.

Nr.	Lokaliteti i kanaleve të ujitjes që do të ndërtohen	Gjatësia në m
1.	Kanali i Llukës së Epërme	2600
2.	Kanali i Brenovicave (Hulaj - Lloqan)	2000
3.	Kanali i Durakut në Irzniq	3000
4.	Kanali i Mlekut në Irzniq	1780
5.	Kanali i Mushkolaj	1700
6.	Kanali i prronit në Gllogjan	600
7.	Kanali i mullirit në Gllogjan	680
8.	Kanali i malit në Baballoq	1860
9.	Kanali i Kuçishtave në Baballoq	1500
10.	Kanali i Ramosaj-Hysen Kuçi	1000
11.	Kanali i Drenocit (Deçan - Drenoc)	2600
12.	Vija e Gumureve-Carrabreg	1200
13.	Kanali i Bunarit të Fushës - Ledina	2000
14.	Kanali i Gërdajave1+2	1000
15.	Vija e Sadik Ramve për gjatë asfaltit	800
16.	Kanali i Prapaqanit	1400
17.	Kanali i Prilepit, vazhdim nga ''Lokaj Plast''	1850
18.	Kanali i Prilepit, Rastavicë në drejtim të Shkollës deri të AMF	1300
19.	Kanali të Kameraj-Company- Lëbushë	320
20.	Lëbushë lagja-Varrezat e Nuraj	400
21.	Kanali Deçan –Drenoc/pjesa nën Lumë (shtrat të lumit) të Lloqanit	//
22.	Kanali kodra e Vokshit-Lugje	2500
23.	Kanali i Bajraqeve në Jasiq të Ri (Penda e Ujitjes)	//
24.	Kanali Deçan – Carrabreg – Prilep – Rastavicë	4500
25.	Penda e Ujitjes në Vranoc të Vogël	//
26.	Kanali i Arave të Dushkut	2800
27.	Vija e Blakës	3000
28.	Vija e Rreknimit	2000
29.	Kanali i Hortaqeve	1200
30.	Kanali i Orrnicave	400
31.	Vija e Plluxhishtave	1500
32.	Kanali i Gështenjës	4000


Tabela 197 Lokaliteti i kanaleve të ujitjes që do të ndërtohen

Në kuadër të zhvillimit të Sistemi të ujitjes njëkohësisht janë planifikuar të ndërtohen tre penda akumuluese në Gryken e Lloqanit. Ndërtimi i këtyre pendave do ta lehtësoj mjaft sektorin e bujqësisë e sidomos në periudhat thatësire. Një veprim i tillë është mjaft i rëndësishëm sepse:

- E ndihmon Komunën e Deçanit në furnizimin me ujë. Uji i grumbulluar në lumenjtë do i ndihmon njerëzit por edhe kafshët dhe mund të përdorët për ujitje, prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe proceset e ndryshme agro industriale.
- E ndihmon ekosistemin dhe mund të janë pika ndalesa për shumë habitate të faunës e me theks të veçantë të llojeve të rrezikuara.
- Luan rol të rëndësishëm ne menaxhimin e përmbytjeve sepse Komuna e Deçanit në vitet e fundit ka qenë zonë e rrezikuar nga përmbytjet të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin Komunal mirëpo edhe të buxheti i ekonomive familjare. Akumuluesit ne këto raste shërbejnë si rezervuar natyror dhe mund të mbajnë sasi të ujit gjatë reshjeve të shiut dhe i parandalojnë përmbytjet. Në rastet e reshjeve të dendura, akumuluesit e ndalojnë për një periudhë kohore ku faktori njeri i merr të gjitha masat për shpëtimin e jetës, pronës bagëtisë, teknikës, pajisjeve etj.

- Përpos sektorit të bujqësisë pikat akumuluese luajnë rrol të rëndësishëm edhe në aspektin e rekreacionit dhe mund të janë pika atraktive për turizëm si shëtitje me kanoe, kamping, not, peshkim etj. Vlejnë të cekët se këto akumulues mund të nxisin edhe zhvillimin e sporteve të ndryshme ujore.

I vetmi ndikim negativ i akumuluesve është prishja e jetës nënujore respektivisht gjallesave nën ujë të cilave habitati i lëvizjes ju ndryshon mirëpo në përgjithësi, akumulimi i ujit luan një rol kritik në ruajtjen e jetës dhe ruajtjen e shëndetit të ekosistemeve të planetit tonë.



Harta 48. Sistemi i ujitjes për tokat bujqësore në Komunën e Deçanit

4.4.8 Furnizimi me energji elektrike

Rrjeti elektrik në Komunën e Deçanit, furnizohet nga dy nën stacione: rrjetit 400 kv në NS Deçan 110/35/10 kv dhe NS Isniq 35/10/kv, në një pjesë të rrjetit është investuar në përmirësimin dhe furnizimin me energji elektrike, kurse pjesa tjetër e Qytetit të Deçanit, duhet të behën investime në përmirësim e rrjetit ekzistues në pjesën urbane të pa përfshirë dhe pjesën rurale me qëllim për të rritur cilësinë dhe sigurinë e furnizimit si dhe për të reduktuar humbjet Teknike në zonat e caktuara të territorit të Komunës.

Komuna e Deçanit, së bashku me KEDS-in, duhet të përmirësoj gjendjen ekzistuese të rrjetit elektrik në pjesën rurale në ato vendbanime, ku rrjeti është i dobët, duhet të bëhen projekte për ndërrimin e rrjetit ekzistues (vjetruar), po ashtu duhet të përfshihen edhe kalimi nga rrjeti shpërndarës ajror në rrjetin shpërndarës kabllor si dhe zëvendësimin e linjave ajrore me kabllo

nëntokësor, duhet të merret parasysh edhe ndërrimi i stabilimenteve ekzistuese (vjetruara). Deri me tani është shpërndarë rrjeti i energjisë elektrike në Bjeshkën e Deçanit (Bjeshka e Madhe) me gjatësi 5 km, në vlerë: 195,000.00 €. Shpërndarja e rrjetit elektrik parashihet, që të bëhet në të gjitha e Bjeshkët e Deçanit, me qëllim të përmirësimit të kushteve për mirëqenie të qytetarëve dhe zhvillimin e turizmit. Projektet të cilat parashihet të realizohen janë:


- Ndriçimi i rrugëve dhe shesheve publike në zonat rurale me gjatësi prej 50 km, në periudhën kohore 2021-2023, ku afërsisht do të jenë të ndriçuara rreth 90 % e rrugëve dhe shesheve, ndërsa 10 % e rrugëve do të ndriçohen në zone urbane të cilat janë të pa përfunduara në vlerë: 342,000.00 €;
- Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut, Pleqe dhe Belle me vlerë: 800,000.00 €;
- Rregullimi i rrjetit elektrik të vjetruar në fshatin Baballoq, ku shuma e investimit për ndërrimin e rrjetit elektrik do të jetë me vlerë: 997.731.7 €;
- Ndërrimi i rrjetit të vjetruar me rrjet të ri në fshatrat: Irzniq, Ratish (tension i lartë) 10 kv ku vlera e investimit nga KEDS-i është: 70,730.32 €;
- Ndërrimi i shtyllave dhe rrjeti i ri 10 kv në fshatrat: Hulaj, Pobergjë vlera: 9,747.50 €;
- Në lagjen Tahirsylaj në Isniq ndërrimi i rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kv vlera: 43,321.61 €;
- Ndërrimi rrjetit në fshatin Irzniq - Aliçkaj kodër-zhvendosja e trafos në vlerë: 10,403.06 €;
- Ndërrim i rrjetit në fshatin Lumbardh, lagjja Molukt në vlerë: 10,915.80 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Pozhar, lagjja e ashtu quajtur Qaush Asllanit në vlerë: 18,560.10 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Carrabreg i Ulët në lagjen Ramosaj II në vlerë: 5,501.28 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Pobergjë, vendi i ashtuquajtur trafo e varrezave në vlerë: 33,976.08 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Irzniq, në lagjet Aliçkaj dhe Zejnaj në vlerë: 16,484.90 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në dy fshatrat Strellc i Epërm dhe Strellc i Ulët tensioni 10 kv në vlerë: 30,010.57 €;
- Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Strellc i Ulët, 0.4 kv në lagjen e ashtuquajtur Pajazitaj - Hoxhaj në vlerë: 28,922.01 €;
- Ku vlera totale e investimeve për ndërrimin e rrjetit dhe trafove 10 kv dhe 0.4 kv nga pika 3 deri në pikën 14 është: 471,885.79 € ku të gjitha projektet parashihen të përfundohen në periudhën kohore 2021-2025, këto investime do të jenë në bashkëpunim Komune - KEDS[93]

Gjatë procesit të hartimit të projekt PZHK-së, Drejtoria për Zhvillim të Rrjeteve dhe Projekteve nga KOSST[94] bazuar në Planin Zhvillimor 2023-2032 ka zhvilluar edhe projektin e ri me interes kombëtarë respektivisht Linja Interkonektive NS Deçan – NS Bajram Curri e cila ka gjatësi 33km (14 km në Shqipëri dhe 19 km në Kosovë) ku një pjesë e saj kalon në territorin e Komunës së Deçanit.
Gjithashtu, në kuadër të zhvillimit të furnizimit të qëndrueshëm me rrejt energjetik, Komuna e Deçanit i ka ndarë parcelat të prezantuara në hartën më poshtë në të cilat është planifikuar të ndërtohet parku solar. Ky park do të zhvillohet në harmoni të plotë me kornizën ligjore dhe modalitetet e investimit në ketë park janë nga më të ndryshmet duke filluar nga partneriteti në mes të Komunës dhe nivelit qendrorë, Komunës dhe sektorit privat (PPP), dhënia me koncesion sektorit privat etj.


Përkundër faktit që rrjeti energjetik menaxhohet nga KEDS të cilët kanë strategjitë e tyre afatgjatë për furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm, Komuna e Deçanit në bashkëpunim me KEDS bazohet

[93] Operimi rrjet- KEDS.
[94] Home Page (kostt.com)

edhe në normat e dala nga U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 16. Infrastruktura energjetike.



Harta 49. Lokacionet për ndërtimin e parkut solar



Harta 50. Rrjeti energjetik në Komunën e Deçanit – planifikimi

4.4.8 Menaxhimi i mbeturinave

Deçani qytet ekologjik është prioritet i Komunës, ku menaxhimi i mbeturinave në nivel të Komunës është përmirësuar dukshëm krahasuar me gjendjen e mëhershme, në këtë drejtim Komuna ka parashtruar qëllimin dhe objektivat specifike që janë pjesë integrale e menaxhimit të qëndrueshëm si: grumbullimi i mbeturinave derë më derë, duke përfshire aktivitete si: selektimin, riciklimin, kompostimin, ambalazhimin etj.
Administrimi i mbeturinave në territorin e Komunës behët sipas Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2022 - 2030. Qëllimi i këtij plani është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për territorin a administruar nga Komuna, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore mjedisore dhe kornizën planifikuese strategjike.

Mirëmbajtja aktualisht zbatohet në mënyrë të kënaqshme dhe synohet që të arrihen objektivat e planifikimit siç janë:

- Sigurimin e kamionëve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave.
- Sigurimin e kontejnerëve publik dhe individual për grumbullimin e mbeturinave.
- Sigurimin e kontejnerëve dhe infrastrukturës përcjellëse për ndarje dhe riciklim.
- Sigurimin e enëve kompostuese dhe
- Investimet në deponinë e materialeve inertë.

Tipi i investimit	
	Investimet për vitin 2024
1	Kontejnerë 1.1 m^3
2	Rregullimi i hapësirës - bazamentit dhe rrethojave për vendosjen e ishujve ekologjik
3	Kontejnerë të plastikës 1.1 m^3 – Kontejnerë me ngjyrë të cilët do të vendosen në ishujt ekologjik
4	Kontejnerë të plastikës 240 L- Kontejnerë me ngjyrë të cilët vendosen në ishujt ekologjikë
5	Kontejnerë të plastikës 120 L
6	Enë për kompostim
7	Investimet në infrastrukturë për qendrën grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi dhe demolomi
8	Ndërtimi i deponisë inerte
9	Ndërtimi i objektit për mbeturina të vëllimshme

Tabela 198. Lista e projekteve dhe investimeve kapitale për administrimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit,[95]

Komuna se bashku me OJQ-të, ka dizajnuar kampanjën për vetëdijesim. Kampanja nënkupton logo dhe moto e Komunës, që do të përdorë për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për reformën në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Kampanja do të fokusohet në fushat në vijim:

Zgjerimi i shërbimeve - çdo zgjerim i shërbimit për çdo vendbanim do t'i paraprijë me takime publike me banorë. Në të njëjtën kohë Komuna, do të organizojë ligjërata për shkollat fillore dhe të mesme për të ngritur vetëdijen e nxënësve rreth procesi të menaxhimit të mbeturinave dhe efektet pozitive dhe negative të mbeturinave.

Ndarja në burim në shkolla dhe institucione - Komuna do të organizojë takime dhe ligjërata me nxënësit e shkollave, mësimdhënësit, dhe punonjësit e institucioneve publike për të shpjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave dhe përfitimet nga ky proces, do të publikojë broshura ku do të shpjegohet në mënyrë të qartë procesi i ndarjes së mbeturinave.

Ndarja në burim në amvisëri - Komuna do të organizojë takime lagje për lagje duke ju shpjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave në burim dhe përfitimet nga ky proces, do të publikojë broshura të cilat do të shpjegojnë qartë këtë proces si dhe kohën e operimit për mbledhjen e mbeturinave.

Ishujt ekologjik - lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme koha për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme, Komuna do të informojë qytetarët për ishujt ekologjik, lokacionin për mbeturinat e vëllimshme dhe kohën për mbledhjen e këtyre mbeturinave përmes broshurave dhe takimeve me qytetarë. Komuna, ka caktuar lokacion për mbeturinat ndërtimore dhe të demolimit në fshatin Lëbushë.

Të gjitha veprimet gjatë procesit të menaxhimit të mbeturinave do të bazohen në strategjinë sektoriale lokale dhe në normat e dala nga U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 17. Deponitë e mbeturinave dhe ndërtesat përcjellëse.

4.4.8 Telekomunikacioni

Kapitulli i telekomunikacionit e përfshinë telefoninë fikse, telefoninë mobile dhe shërbimet e internetit. Duke e marr a parasysh zhvillimin teknologjik dhe të komunikimit, Komuna e Deçanit është e gatshme që ti përshtatet ndryshimeve teknologjike ne 8 vitet e ardhshme edhe të ofrojë kushte sa ma të mira të komunikimit të cilat nuk janë të parapara në projekt PZHK-në.

[95] Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2018-2022

4.4.8 Telefonia Fikse

Rrjeti i telefonisë fikse në Komunën e Deçanit, është i lidhur nëpërmjet fibrat optik. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së në Deçan, e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik, po ashtu PTK-ë bënë edhe shërbimin postar. Nga gjithsej 38 vendbanime, që ka Komuna e Deçanit, prej të cilave 36 mbulohen nga operatori ekonomik Vala, kurse shërbimet tjera postare i mbulon Telekomi i Kosovës.

4.4.8 Telefonia Mobile


Komuna e Deçanit, është e mbuluar mjaftë mirë me telefoni mobile. Të gjitha vendbanimet kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ish Ministria e Infrastrukturës tani Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Të dy operatorët mobil Vala dhe Ipko, i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të Komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatori mobil Vala është 11 antena, ndërsa nga operatori mobil Ipko është 8 antena.

4.4.8 Shërbimet e Internetit

Shërbime të internetit ofrohen nga disa operator të cilët e mbulojnë pjesën ma të madhe të territorit të komunë së Deçanit siç janë: Vala, Ipko, Artmotion, Kujtesa, Adea Computer, Tel Kos dhe Një arti. Pjesa ma e madhe e territorit të Komunës është e mbuluar me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore - bjeshkët dhe dy vendbanimet fshati Belle dhe Pleqe. Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me operatorin ekonomik Vala, në të ardhmen parashihet që ky operator të bëjë vendosjen e antenave dhe shtrirjen e rrjetit në Bjeshkët e Deçanit. Projektet e planifikuara ndërmjet Komunës dhe operatorit ekonomik Vala, që do të bëhen gjatë viteve në vijim janë:

- Mbulimi me rrjet të telekomunikacionit me fibër optik përgjatë rrugës nacionale Deçan-Plavë, dhe mbulimin me rrjet mobil të zonave turistike në Komunën e Deçanit.

Me realizimin e projekteve të sipër përmendura, Komuna e Deçanit e forcon komunikimin, krijon qasje ma të mire ne informacion, e promovon turizmin, ofron mundësi të edukimit online dhe e forcon lidhjen sociale ne ketë zonë.



Harta 51. Plani i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashëm

4.4.9 Infrastruktura e transportit dhe transportit

Infrastruktura e transportit dhe transporti ka ndikim esencial për zhvillimin e çdo sektori në territorin e Komunës Deçanit. Planifikimi i infrastrukturës rrugore duhet të jetë në harmoni me normat e caktuara sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 11. Infrastruktura e transportit rrugor. Politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore ne Komunën e Deçanit do të jenë të karakterit lidhës ne mes të dy apo ma shumë vendbanime mirëpo duke e marr parasysh edhe aspektin social dhe ekonomik e që nënkupton ofrimin e kushteve të sigurisë për ecje dhe çiklizëm, gjelbërimi i tyre dhe harmonizimi i tyre me politikat sektoriale e sidomos me sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turistik. Duke i marr parasysh të gjitha këto propozime, ne të ardhmen Komuna e Deçanit do të udhëheqë politikat e lëvizjen me prioritet të:

- Këmbësorit - duke ofruar sa ma shumë lëvizje aktive kundrejt lëvizjes pasive. Për ketë synohet që të krijohen sa ma shumë hapësira për ecje respektivisht trotuare, hapësira publike, korridore të gjelbra si dhe rritja e sigurisë ne trafik. Rrjeti i hapësirave publike do ti nënshtrohet një analize të hulumtimi në nivel të zhvillimit të politikave sektoriale e cilat do të ketë rritje të dukshme të lëvizjes aktive. Zhvillimi i shtigjeve për ecje do të zhvillohen në harmoni me U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 11. Infrastruktura, nën pika 11.10. Shtigjet dhe rampat.

- Çiklistit – duke iu mundësuar sa ma shumë shtigje për çiklizëm brenda zonës urbane, lidhjes me vendbanimet tjera respektivisht me fshatrat, si dhe krijimin e shtigjeve të cilat do të jetë

atraktive, turistike dhe ekstreme (në zonat malore). Të gjitha këto do të janë të lidhura me normat dhe politikat e lëvizjes shtëpi – punë - shtëpi, shtëpi – shkollë - shtëpi, shtëpi – blerje – shtëpi. Investimet ne zhvillimin e rrjeteve të çiklizmit do të bëhen në raport më U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 11. Infrastruktura, nën pika 11.11. Korsitë dhe shtigjet për biçikleta.

- Transportit publik – do të ofrohet brenda zonës urbane dhe lidha e saj me vendbanimet tjera respektivisht me fshatrat. Është e rëndësishme që të ofrohen politikat e qarta të cilat e promovojnë përdorimin e transportit publik dhe mënjanimin e përdorimit të automjetit. Andaj, organizimi i transportit publik do të ndikon pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit, në buxhetin e familjes si dhe ne zhvillimin ekonomik të Komunës. Për zonën perëndimore respektivisht zonën malore propozohet të organizohet transporti i llojit "shuttle -bus" i cili do të bëjë transportin në mënyrë të kontrolluar në vende të ndryshme brenda kësaj zone. Kjo do të ketë kontribut pozitiv në zhvillimin e turizmit dhe transportimin e vizitorëve të ndryshëm si dhe do të mbroj mjedisin nga gazrat e automjeteve dhe do të ruaj biodiversitetin. Rekomandohet që "shuttle-bus" të jetë ekonomik dhe të subvencionohet nga Komuna e Deçanit. Komuna e Deçanit i posedon të gjitha mundësitë e zhvillimit të transportit të integruar multimodal. Andaj, është e rëndësishme që pas projekt PZHK-së të Komunës së Deçanit, të fillohet me procesin e hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban.

- Parkimit – ofrim i parkingjeve për të gjitha hapësirat e banuara, ekonomike dhe administrative. Parkingjet për vizitorë propozohen të organizohen sa ma larg qendrës së qytetit me synim ofrim të transportit publik për lëvizje ne pjesët tjera urbane. Të gjitha parkingjet do të përmbajnë në vetë parkingjet për personat me nevoja të veçanta dhe pikat e furnizimit me rrymë. Gjithashtu, zonat e banuara do ti nënshtrohen një regjenerimi urban që të mund të organizohen parkingjet për banorë mirëpo edhe hapësirat publike e këndet e lojërave. Të gjitha parkingjet do të projektohen sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 11. Infrastruktura, nën pika 11.8.

- Automjetit - prioriteti i fundit i cili do ti nënshtrohet restrikcioneve të ndryshme siç është anashkalimi i qendrës së qytetit, ulja e shpejtësisë, kufizime në rrugë njëanësore etj. Profilet e rrugëve do të projektohen dhe zbatohen duke u bazuar ne U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë pika 11. Infrastruktura, nën pika 11.4.

Bashkëpunimi me akteret relevant për rritjen e sigurisë në trafik është më se i domosdoshëm. Roli i Policisë së Kosovës është i rëndësishëm ne hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë në trafik. Identifikimi i saktë i pikave të zeza ku ndodhin më se shumti aksidentet duhet të analizohen dhe të ofrohen zgjidhjet më të mira për rritjen e sigurisë. Në ketë drejtim pritët kontributi edhe banorëve të Komunës së Deçanit, OJQ-ve si dhe organizatave të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare. Kjo nënkupton përmirësimin e udhëkryqeve, vendkalimeve të këmbësorëve etj., mirëpo edhe zbatimin e masave të mbrojtjes si anësoret, shtyllat lëvizëse, ndriçues të ndryshëm etj.

4.4.9 Infrastruktura e transportit

Pozita gjeografike e Komunës së Deçanit, në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme rajonale dhe nacionale, si dhe rrjeti rrugor lokal mundëson komunikim të mirë dhe mjaft efikas në transportin e njerëzve dhe mallrave gjithashtu duke ndërlidhe Qytetin e Deçanit, me të gjitha vendbanimet po ashtu edhe më shtetet fqinje. Komuna e Deçanit, ka shtrirje të rrugëve në të gjitha kategoritë me gjatësi prej:

- 405 km rrugë lokale ku 345 km janë të asfaltuara, 60 km të pa asfaltuara,
- 28 km rrugë nacionale
- 41.5 km rrugë regjionale.

Komuna e Deçanit, karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Në Komunën e Deçanit, ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale, regjionale, lokale të pa kategorizuara. Rrjeti i rrugëve në Komunën e Deçanit, përbëhet nga:

- Rrugët nacionale - R-107 (Deçan-Mali i Zi), kjo rrugë lidhë Deçanin, me shtetin fqinje Malin e Zi me gjatësi prej: 28 km. Sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë kjo rrugë përfshihen në pikën 11.1. Rrjeti kombëtar i infrastrukturës rrugore, nën pika 2.

- Rrugë regjionale - R-108 në territorin e Komunës së Deçanit, është rruga Deçan-Pejë-Gjakovë dhe Rruga Deçan-Junik-Shqipëri, të cilat rruge lidhin me qendrat me rendësi ekonomike të dy apo me tepër rajoneve apo qendrave administrative brenda apo jashtë vendit gjithsej me gjatësi prej: 41.5 km. Sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë kjo rrugë përfshihen në pikën 11.1. Rrjeti kombëtar i infrastrukturës rrugore, nën pika 3.

- Rrugë lokale - rrugët të cilat i lidhin 38 vendbanime, duke përfshire rrugët lokale të asfaltuara dhe rrugë të pa kategorizuara, gjithsej përfshinë gjatësinë prej: 405 km, të cilat rrugë lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve, këto rrugë lidhin qendrën e qytetit me të gjitha pjesët e zonave rurale po ashtu krijojnë qasje të mirë edhe për rrugët nacionale/regjionale. Sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë kjo rrugë përfshihen në pikën 11.2. Rrjeti lokal i infrastrukturës rrugore, nën pika 1.

- Auto udha e Dukagjinit (Istog – Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren) - ka mbetur si projekt propozim, që duhet të bëhen hapat e mëtejme konkret për realizmin e këtij projekt propozimit nga niveli qendror ku në projekt PZHK-në e Komunës së Deçanit është inkorporuar në rrjetin rrugo. Sipas U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë kjo rrugë përfshihen në pikën 11.1. Rrjeti kombëtar i infrastrukturës rrugore, nën pika 1.


Për çështjen e sigurisë në trafik, jo të gjitha kategoritë e sipër përmendura i plotësojnë kushtet. Është më se e nevojshme që të fillohet me hartimin e strategjisë për rritjen e sigurisë ne trafik dhe të merren hapa konkrete me qenë se Komuna e Deçanit është e orientuar drejt zhvillimit të turizmit si në zonat urbane e rurale ashtu edhe në ato malore. Po ashtu promovimi i zhvillimit të lëvizjes aktive nuk mund ti arrin qëllimet e saj të plota nëse nuk ofrohen kushtet e lëvizjes së sigurt, andaj pas projekt PZHK-së është e nevojshme që të ndërmerren këto hapa:

- Identifikimi dhe kategorizimi i të gjitha hapësirave publike në zonën urbane dhe rurale. Për kategorizim do të merren për bazë praktikat dhe udhëzimet e mira ndërkombëtare[96] dhe ato lokale[97]
- Krijimi i rrjetëzimit të hapësirave publike në mes veti duke i identifikuar projektet – investimet kapitale të cilat do e mundësojnë jetësimin e këtij rrjeti.
- Identifikimi i të gjitha pikave më të frekuentuara për ecje dhe çiklizëm dhe hartimi i politikave për rritjen e sigurisë (me theks të veçant ne afërsi të shkollave).

[96] https://unhabitat.org/sitës/default/files/2019/02/Indicator-11.7.1-Training-Module_Public-spaces_Jan_2019.pdf
[97] Public Space Profile Pristina | UN-Habitat (unhabitat.org)

- Lidhja e zonës urbane me zonën rurale nëpërmes lëvizjes aktive duke i identifikuar “korridoret e gjelbra” sipas prioriteteve (p.sh. korridoret e prioritetit të parë, dytë, tretë et.).
- Lidhja e politikave të lëvizjes aktive me politikat sektoriale të zhvillimit të turizmit (si ai urban, rural dhe malor) duke i forcuar sinergjitë dhe larguar kontradiktat.
- Zbatimi i projekteve për fazë – fazë me synim të rritje së sigurisë në trafik për promovimin e lëvizjes aktive dhe zhvillimin e turizmit.

Si ombrellë ë të gjitha veprimeve të lartpërmendura është e nevojshme që Komuna e Deçanit të harton sa ma parë dokumentin strategjik sektorial për lëvizshmërinë respektivisht planin e qëndrueshëm të mobilitetit urban i cili duhet të jetë në harmoni me të gjitha politikat tjera zhvillimore sektoriale.



Harta 52. Plani i infrastrukturës së transportit


Me synim të krijimi të qasjes për të gjitha vendbanime ne Komunën e Deçanit është e nevojshme që të vazhdohet me asfaltimin e rrugës ne Pleqe, Belle, Belle te epërme dhe të mesëm, vazhdimi i asfaltimit të rrugës Sadri dhe Adem Osa, vazhdimi i asfaltimit të rrugëve në bjeshkë sipas Planit Hapësinorë Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”, asfaltimi i rrugëve në qytet, zgjerimi i rrugës në qendër të qytetit si bashkëfinancim me nivelin qendror, si dhe asfaltimi i rrugëve ne Strellc të epërm, Strellc të Ulët, Llukë dhe fshatra tjera si vazhdim i projektit.

4.4.9 Transporti publik

Transporti ndër urban planifikohet të bëhet me autobusë dhe minibusë, nga operatorët privatë kurse me vendbanimet e Komunës, transporti vazhdohet me minibus. Në tërë territorin e Komunës së Deçanit, pika ndaluese për automjetet e transportit publik janë gjithsej 72, kurse pika ndaluese të pajisura me shenjëzim për automjetet e transportit publik lokal janë 70, ndërsa numri i automjeteve motorike të regjistruar si taksi - kombibus janë 13. Stacioni i autobusëve mbetët për diskutim me që objekti ekzistues është në kontest pronësor me rregullimin e çështjes së stacionit të autobusëve, Komuna e Deçanit i ka të gjitha mundësitë që të fillon me hartimin e politikave për transport multimodal. Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim nga operatorët privat me linjat ne zonat e ndryshme urbane, rurale dhe ndërkufitare. Gjithashtu është planifikohet që në pjesën perëndimore të aktivizohet "shuttle-bus" i cili është mjet transportues ekologjik dhe do të jetë në dispozicion të vizitorëve të për ketë zonë. Ky projekt do të hartohet dhe menaxhohet nga Komuna e Deçanit.

4.4.9 Transporti i pa motorizuar - këmbësor dhe biçikleta

Rrjeti i shtigjeve për këmbësor, biçikleta dhe hapësira publike do t'i kushtohet një planifikim i detajuar sipas modelit multimodal (avancim i transportit) dhe ndërlidhjes përmes hapësirave publike, parqeve dhe shtigjeve po ashtu i kushtohet rendësi edhe lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara.



Harta 53. Transporti publik urban dhe rural – planifikimi

Komuna e Deçanit në planifikimin 8 vjeçar parasheh këto investime:

- Përfundimi i Shëtitores përgjatë Lumit të Lumëbardhit nga Ura e Demës deri tek burimi i ujit të thartë Gushavci. Tani vetëm e trasuar pjesërisht dhe gjendët në punim e sipër. Shteg ky që mundëson qarkullimin edhe të këmbësorëve edhe të mjeteve të pa motorizuara.
- Shtegu për ecje dhe çiklizëm nga qendra e qytetit, drejtë dy shkollave të mesme deri afër ish bletarisë dhe kryqëzimi i saj në dy drejtime: djathtas drejt Lumit Lumëbardhi i Deçanit dhe majtas në drejtim të manastirit dhe vazhdimi pastaj për në Podin e Gështenjave.
- Shtegu për ecje dhe çiklizëm nga Podi i Gështenjave drejtë grykës së Lloqanit, e degëzuar me Vendbanimin Hulaj në anën jugore për të vazhduar drejt Lakut të Kryqes si zonë malore dhe zbritja rrëze bjeshke deri të Gushavci.
- Parashihen shtigje të reja dhe shtigje të zgjeruara nga tri drejtimet e qytetit për në parkun e qytetit i planifikuar tek ish shtëpizat e ish. "Napredakut" (tani pronë Komunale) , me një sipërfaqe prej 12 ha dhe me ambient për të gjitha disiplinat rekreative. Në afërsi të parkut janë edhe qendra rinore dhe objekti i trashëgimisë kulturore.

4.4.9 Parkimi

Në përgjithësi në Komunën e Deçanit, parkimi është problem që paraqitet në pjesën urbane, konkretisht në qendër të qytetit ku dihet se nuk ka një hapësirë të definuar, që i plotëson kushtet dhe kriteret për parkim publik ku kjo gjendje është si pasojë e mungesës se pronave Komunale. Hapësirat ekzistuese, që shërbejnë si parkime janë në prona privatë dhe ndërtesave të shumë banesore dhe qendrave tregtare - bizneseve. Komuna e Deçanit, parasheh që në të ardhmen të ofron pikat e parkimit nëpër disa zona të caktuara. Pjesa ma e fokusuar është rruga regjionale Pejë - Deçan-Gjakovë ku planifikohet të behën disa investime për parking. Opsionet janë të ndryshme duke filluar nga:

- Parkimi paralel ne rrugë në mënyrë lineare dhe të organizuar duke u bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare e cila bazohet në raportit një pemë – dy parkingje – një pemë.
- Krijimi i vend parkingjeve të reja të shpërndara ne të gjithë zonën urbane afër pikave të rëndësishme siç janë ndërtesa Komunale, QMF-të, Stacioni Policorë etj.
- Hartimi i politikave të parkingjeve nëpërmes Partneritetit Publiko Privat.
- Ndërtimin e një garazhe publike me dy etazhe në qendër të Qytetit ku parashihet zgjidhja e problemit të parkimit publik. Ky propozim lidhet edhe me politiken e transportit publik e cila mund të jetë falas për transport në pikat e ndryshme të zonës urbane dhe rurale.
- Paketat inovative dhe tërheqëse për lëvizje në mënyrë të lehtë dhe të rregullt mund të zhvillohen nëpërmes zbatimin të politikave të lëvizshmërisë siç janë konceptet "parko dhe ec", "parko dhe çiklo" apo "parko dhe përdor transport publik". Të gjitha këto mund të rregullohen me hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban për Komunën e Deçanit.

Duke i zbatuar veprimet e sipër përmendura atëherë Komuna e Deçanit:

- E rritë nivelin e sigurisë sepse duke i siguruar vend parkingjet në zonat e caktuara dhe duke i larguar ato nga rrugët, do të ketë ndikim pozitiv në uljen e aksidenteve në rrugë si dhe t'ju lehtëson lëvizjen e automjeteve të ndryshme të urgjencës siç janë ndihma e parë, zjarrfikëset, policia etj. Gjithashtu, ndotja nga lëvizja e automjeteve në zonat e ndryshme urbane do të ulët dukshëm.
- Do të baraspeshon nevojën – kërkesën për parking në raport me numrin e vend parkingjeve. Me këto veprime caktohet edhe intensiteti i numrit të vend parkingjeve. Ky veprim e mbështet dhe e forcon metodat e ndryshme alternative të lëvizjes.

- Ofrimi i lehtë i qasjes për të gjitha kategoritë e shoqërisë – me theks të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik - duke ju ofruar parkingjet e mjaftueshme bizneseve të ndryshëm e me theks të veçant tregjeve të hapura ku do të bëhet plasim i produkteve të ndryshme lokale.
- Fuqizimin e transportit multimodal – duke krijuar transport të qëndrueshëm duke krijuar modalitetet të lëvizjes me transport publik, çiklizëm, ecje, etj. dhe duke e dekurajuar lëvizjen vetëm në automjet duke e ndihmuar zhvillimin e politikave të lëvizjes aktive.

Organizimi i parkingjeve do të jetë sipas normave Teknike të cilat i parasheh U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë respektivisht pika 11.8. Vend - parkimet.

4.4.10 Infrastruktura publike - planifikimi

Zhvillimi i Sistemit të infrastrukturës publike i referohet mirëqenies së qytetarëve përmes ngritjes së nivelit të shërbimeve dhe qasjes më të lehtë në ndërtesave publike. Në këtë aspekt, parimet themelore të zhvillimit të ardhshëm të këtij sektori janë:

- Përmirësimi i shërbimeve në të gjitha vendbanimet dhe shtrirja e balancuar e shërbimeve në tërë territorin e Komunës;
- Përmirësimi i shërbimeve në fushën e përkujdesjes së: fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara .

Në periudhën e zbatimit të planit, duhet të monitorohet zhvillimi hapësinor dhe demografik i secilit vendbanim dhe struktura e moshës së popullatës, dhe në përputhje me këtë dhe funksionet e tyre themelore, të sigurohen shërbimet e nevojshme publike. Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuatë. Në PZHK-ë, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- Vendbanime;
- Rekreacion;
- Toka bujqësore;
- Korridore të gjelbërimit;
- Kullosa dhe livadhe;
- Pyje;
- Pyllëzim;
- Gurëthyes;
- Rrjedha të ujit.

4.4.10 Institucionet arsimore


Në përgjithësi, qasja në arsim fillor dhe të mesëm në Komunën e Deçanit, është e mirë. Në zhvillimin e ardhshëm të infrastrukturës arsimore synohet sigurimi i ndërtesave të nevojshme të edukimit parashkollor me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel të arsimimit, parashihet ndërtimi i tri çerdheve. Projektet e planifikuara për infrastrukturën arsimore janë [98]:

- SHMU " Lidhja e Prizrenit" Deçan: Ndërtimi i fushave të futbollit të vogël, basketbollit dhe trotuareve me ndërtesa përcjellëse, asfaltimi dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 120 m dhe gjerësi 5 m dhe hapësira për 50 parkingje.

[98] Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2019-2022.

- SHFMU - " Dëshmorët e Baballoqit" – Baballoq: Ndërtimi i aneksit.
- SHFMU - "Dëshmorët e Vokshit"- Pobergjë: Ndërtimi i aneksit.
- SHFMU -"Kuvendi i Verrave të Llukës"- Llukë e Epërme: Para masa dhe parallogaritja për sanitare fushore dhe rregullimi i shtegut me kubëza deri tek sanitaret.
- Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri " në Deçan: Punimi i kanalizimit për kyçje në kanalizimin e ujërave të zeza të objektit të shkollës vlera.
- SHFMU "Sylejman Vokshi" Prilep: Ndërtesa e re e shkollës.
- SHFMU "Jusuf Gërvalla"- Prapaqan: Ndërtimi i Sallës së Sportit, Rregullimi i hyrjes kryesore dhe oborrit të shkollës me kubëza.
- SHFMU – "Ardhmëria" Beleg [99]. Ndërtimi i objektit të ri të shkollës.
- SHFMU "Maxhun Çekaj" Irzniq: Renovimi i tërësishëm i objektit të shkollës (molerim, demontim dhe montim të dyerve, sanitaret e brendshme, rrethojat e shkallëve etj.)
- SHFMU "Lan Selimi" Llukë e ulët (paralele e ndarë): Rrethojë e objektit të shkollës.
- SHMT "Tafil Kasumaj" – Deçan: Salla e Sportit – ndërtesa e re, renovimi i kulmit të shkollës, zgjerimi i objektit të shkollës.
- SHFMU- "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë: Rrethimi i shkollës, Trotuari për nxënës.
- SHFMU - "Faik Konica"- Ratishë: Trotuari, Kubëzimi i oborrit.

Për të gjitha investimet në institucionet arsimore do të përdoren normat U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë respektivisht pika 3. Infrastruktura e institucioneve arsimore.



Harta 54. Planit të hapësirave publike dhe sociale - ndërtesat edukative


[99] Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2019-2022.

4.4.10 Institucionet shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Zhvillimi i kujdesit shëndetësor do të bazohet në përmirësimin e cilësisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat Shëndetësore në zonat rurale. Ofrimi i shërbimeve cilësore do të sigurohet përmes rritjes së numrit të personelit shëndetësor, në veçanti të mjekëve familjarë. Gjithashtu përmirësimi i kujdesit shëndetësor do të mundësohet duke pajisur të gjitha institucionet shëndetësore me pajisje të reja dhe moderne mjekësore dhe furnizim të rregullt me inventar, shërbime laboratorike dhe specialistike. Rinovimi dhe funksionalizimi i disa AMF, zhvillimi i kujdesit shëndetësor parashihet të jetë edhe në Bjeshkët e Deçanit, vendbanimin Belle, Pleqe dhe Bjeshkën e Belegut i cili shërbim do të bëhet në përputhje edhe me zhvillimin e sektorit të turizmit në këto zona. Në një periudhë afatgjate, është planifikuar edhe ndërtimi i inseneratorit në fshatin Irzniq.

Në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për rastet sociale, është planifikuar sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ndërtimi i ndërtesave për strehim të familjeve me nevoja sociale.

Planifikimi i Komunës së Deçanit, për ndërtimin e ndërtesave për banim social është paraparë ndërtimi i dy ndërtesave. Në bazë të linjave buxhetore Komunale është planifikuar të ndërtohen këto ndërtesa për banim social në Rr. "Manastirit"[100], në afërsi të ndërtesës së objektit social ekzistues.



Harta 55. Plani i hapësirave publike dhe sociale – ndërtesat shëndetësore

[100] Programi Komunal për Banim Social

Në sigurimin e përkujdesjes për të moshuarit, pa përkujdesje planifikohet ndërtimi i objektit për akomodim dhe kujdes për këtë kategori. Planifikimi i projekteve për institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale janë:

- Ndërtimi i inseneratorit në fshatin Irzniq.
- Ndërtimi i dy ndërtesave për banim social.
- Ndërtimi i objektit për të moshuarit Deçan.
- Aplikimi i energjisë efiçiente, QKMF në Deçan.
- Renovimi i AMF-së në Lumbardh.
- Blerja e një automjeti të ri për implementimin e programit për nënën dhe fëmijën, shërbim i patronazhit.
- Ndërtimi i garazheve për automjetet e QKMF-së.
- Blerja dhe digjitalizimi i RTG në QMF Strellc.
- Blerja e softuerit për distribuimin e imazheve të RTG-ve (grafive).
- Blerje e aparaturës bashkëkohore për laboratorë.
- Blerja e automjeteve të reja.
- Ashensori në QKMF-së.

Për të gjitha investimet në institucionet shëndetësore dhe të mirëqenies sociale do të përdorën normat U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë respektivisht pika 4. Infrastruktura e institucioneve shëndetësore.

4.4.10 Administrata publike

Komuna e Deçanit, ka planifikuar ndërtimin e objektit të ri të komunës ku do të vendosen këto institucione: Administrata Komunale, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Deçan, Qendra për Pune Social - QPS dhe Qendra për Regjistrim të Dokumenteve - QRD dhe Regjistrimin e Automjeteve - QRA, të cilat aktualisht funksionojnë në disa ndërtesa të veçanta.

Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet avancimi i Sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, për funksionim me efikas në administratën e institucioneve të cekura me lartë, është planifikuar ndërtimi i objekti që do të ndërtohet brenda periudhës kohore 2024-2032, në lokacionin e quajtur ish objekti i Drinit të Bardhë në Deçan, me etazhitet të lartë, me vlerë investive afërsisht rreth 3 milion €. Planifikimi për administratën publike për vitet 2024-2032 është:

- Ndërtimi i objektit të ri;
- Avancimi i Sistemit elektronik, për informimin e qytetarëve.
- Decentralizimi i administratës - funksionalizimi i shërbimeve administrative me qendrat sekondare.
- *Shërbime administrative dhe qasje e lehtë për të gjithë qytetarët në një vend (One Stop Shop-aplikimi online për shërbime të administratës publike e cila formë rritë efikasitetin e shërbimit në administratë dhe lehtëson marrjen e shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset);*
- Funksionalizimi i nën qendrës për shërbime publike në fshatin Irzniq;
- Planifikimi i parkingjeve nëntokësore në qendrën e qytetit - hapësirë kjo tani e bartur në pronësinë e Komunës dhe në shërbim për objektin administrativë dhe qytetarët.


Për të gjitha investimet në institucionet shëndetësore dhe të mirëqenies sociale do të përdorën normat U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë respektivisht pika 5. Infrastruktura e institucioneve administrative.

4.4.10 Hapësirat publike

Hapësira e përgjithshme publike në territorin e Komunës së Deçanit, është 6.41 ha, nga territori prej 293 km². Me përfundimin e punëve të planifikuara për ndërtimin e qendrës së qytetit, hapësirave gjelbëruese me shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta përgjatë Lumëbardhit, shëtitorja përgjatë rrugës së Manastirit, Podi i Gështenjave, rruga nga Ura e Demës deri të "Uji i Thartë (Gushavcit), rruga e vjetër në Deçan, sipërfaqja e gjelbëruar për kokë banori do të rritët dukshëm. Mirëpo, pas miratimit të projekt PZHK-së, Komuna e Deçanit duhet të harton sa ma parë dokumentin strategjik sektorial për hapësirat publike dhe të tenton sa ma parë që të benë lidhjen e hapësirave publike të cilat to të krijojnë një rrjetë urbane, të lidhura në mes veti. Vlejnë të cekën se me ketë veprim fuqizohet lëvizja aktive, zbatohen politikat e qëndrueshme të lëvizshmërisë si dhe promovohet turizmi urbane si pikë lidhje në mes të atij malor dhe rural. Mirëpo, rregullimi i hapësirave publike nuk do të jetë e fokusuar vetëm në zonën urbane, të njëjta veprime pritën të ndërmerren edhe ne zonën rurale si dhe në zonën malore respektivisht të qendrat e vendbanimeve në këtë rajon duke u bazuar në ligjin në fuqi për ketë rajon. Andaj me këto veprime Komuna e Deçanit do synon në:

- Ndërveprimi social – ku njerëzit që të ndër veprojnë me njëri-tjetrin, gjë që mund të ndihmojë në ndërtimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve shoqërore dhe të rrisë kohezionin e komunitetit.
- Të rrisë aktivitetin fizik – me ndërtimin e parqeve dhe kënde të lojëra me synim të përmirësimit të shëndetit fizik dhe mirëqenies.
- Qasja me të lehtë në natyrë - e cila ofron përfitime shëndetësore, mendore dhe emocionale si reduktimi i stresit dhe promovimi i relaksimit.
- Shprehja kulturore, tradicionale dhe historike – me ofrimin e historive dhe traditave të ndryshëm. Zhvillimin e kulturës dhe artit nëpërmes instilacioneve të ndryshme të artit publik.
- Rritjen ekonomike – duke u transferuar në tregje ndërsa sheshi i qytetit mund të shërbejnë si qendra të aktivitetit ekonomik dhe të stimulojnë zhvillimin ekonomik lokal.
- Angazhimi qytetar – duke shpreh mendimet dhe bindjet e tyre në tubime (pjesëmarrje demokratike).


Me të gjitha synimet e lartcekura, Komuna e Deçanit do të kontribuon në një cilësi më të lartë të jetës së banorëve, do të promovon traditat, kulturën dhe historinë, do të rris kohezionin social dhe do të krijoj komunitete më të qëndrueshme dhe rezident.



Harta 56. Plani i hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra

Komuna planifikon që në marrëveshje me MMPHI të realizojë një sistem të integruar të hapësirave përmes zhvillimit të shtigjeve dhe korridoreve të gjelbra të cilat kalojnë përmes Bjeshkëve të Deçanit, si shtegu Via Dinarika, i cili fillon nga Sllovenia dhe përfundon në Shqipëri, ku një pjesë e tij kalon edhe në territorin e Komunës së Deçanit, nga Milishevci në Qafë të Bogiqes (Bjeshka e Belegut), pastaj shtegu Majat e Larta Ballkanike (Peaks of the Ballkans), shteg që i lidhe tri shtete (Kosove, Shqipëri dhe Mali i Zi) i cili shteg kalon edhe në territorin e Komunës së Deçanit, në Bjeshkën e Belegut (shtegu për ecje në gjatësi prej 5 km, dhe sinjalizimi për ecje, 3 pika ushqyese, 5 pushimore për turistë, 1 pikë për shpërndarjes të ushqimit për kafshë) Roshkodol, Zllonopojë deri në Qafën që ndanë Milishevcin me Bjeshkën e Lumëbardhit, përgjatë këtyre vijave planifikohet qe të ndërtohen afërsisht 50 stane, që do të ofrojnë shërbim për turistët. Andaj është e nevojshme që krahas zbatimit të këtyre projekteve strategjike, në të njëjtën kohë të investohet edhe në kushtet për rregullimin e rrugëve të caktuara, ujësjellësin, kanalizimin dhe shërbimet e telekomunikacionit. Gjithashtu, informimi për lëvizje siç është sinjalizimi i shtigjeve për ecje në zonën malorë është i rëndësishëm. Me ketë synohet që të bëhet balancimi i lëvizjes nga zona malore drejt asaj urbane dhe rurale. Hartimi dhe zbatimi i projekteve të ndryshme për hapësirat publike mund të kanë përmbajtje të ndryshme të cilat kanë ndikim pozitiv ën mbrojtjen e mjedisit dhe në aspektin social duke mos e përjashtuar as atë ekonomik. Andaj, gjatë zbatimit të projekteve kapitale për hapësirat publike do të përdorën normat të dala nga U.A. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë respektivisht pika 9. Hapësirat e gjelbra.


Në këtë drejtim disa nga investimet e planifikuara deri në vitin 2032 janë në fshatin Belle respektivisht ndërtimit një hapësire publike me së bashku tre kulla, rregullimi i rrugës ne këtë fshat i cili do të ketë ne vetë brez të gjelbër përgjatë rrugës, elektrifikimi dhe ndriçimi për rritjen e sigurisë në hapësirën publike si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme dhe pika informuese dhe promovuese të historisë së lokalitetit.




Harta 57. Plani i hapësirave sportive

Menaxhimi i varrezave

Komuna e Deçanit, ka ndërmarre hapa konkret në rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, kurse në zonën rurale varrezat janë të shpërndara sipas lagjeve, të cilat mirëmbahen nga familjet. Në të ardhmen Komuna e Deçanit, planifikon që menaxhimin e varrezave të bëjë nga një ndërmarrje publike lokale. Aktualisht është e rezervuar hapësira për varrezat e qytetit dhe ka filluar jetësimi i kësaj hapësira, për të cilën ekziston plani detal. Mbetët të investohet në finalizimin e projektit. Është projektuar në sipërfaqen prej 10 ha dhe është sistemuar si kompleks me të gjitha veprimtaritë përcjellëse: Ceremonitë fetare për tri konfesionet, përpunimi i varreve, mirëmbajtja dhe shërbimet e transportit.



Harta 58. Menaxhimi i varrezave në Komunën e Deçanit – planifikimi



Harta 59. Plani i hapësirave publike dhe sociale - ndërtesat fetare

Nr.	Vendi	Rruga	Nr. i parcelës	m^2	Vërejtje
1.	Deçan	“Haxhi Mushkolaj”	P-70505021-01542-0	4025	Qungjet
2.	Deçan	“Haxhi Mushkolaj”	P-70505021-01447-0	3222	Qungjet
3.	Deçan	Mes rr. “Metë Sylve dhe “Luan Nimonaj”	P-70505021-00410-0	1460	
4.	Llukë e Epërme	“Të verrat e Llukës “	P-70505085-00004-3	20900	Llukë të Epërme
5.	Carrabreg i Epërm	“Muharrem Lataj”	P-70505080-00970-0	842	Të blini në qendër
6.	Carrabreg i Epërm	“Muharrem Lataj”	P-70505080-00981-0	2504	Varrezat e fshatit
7.	Carrabreg i Epërm	“Muharrem Lataj”	P-70505080-01086-0	13990	Varrezat e fshatit
8.	Carrabreg i Poshtëm	“Lavdim Likaj”	P-70505080-00179-0	7162	Transitit Carrabreg
9.	Lumbardh	“Avni Pergjegjaj”	P-70505046-00293-0	42357	Të përmendorja
10.	Lumbardh	“Avni Pergjegjaj”	P-70505046-00293-0	1500	Rruga tek varrezat
11.	Isniq	“Ali Musa”	P-70511038-01748-0	480	
12.	Isniq	“Ali Musa”	P-70511038-01680-0	1195	
13.	Isniq	“Ali Musa”	P-70511038-01678-0	4190	
14.	Isniq	“Ali Musa”	P-70511038-01750-0	4923	
15.	Isniq	“Osë Dautit”	P-70511038-02209-0	9303	Afër kullës
16.	Voksh	“Dëshmorët e Vokshit”	P-70505011-00333-0	13002	Afër shkollës
17.	Hulaj	Hulaj	P-70505078-00564-0	8962	
18.	Pobergjë	“Arif Vokshi”	P-70505058-00810-0	136668	
19.	Beleg	“Sadri Vishaj”	P-70505004-00307-0	13948	
20.	Beleg	“Sadri Vishaj”	P-70505004-00296-0	7464	Të xhamia
21.	Pozhar	“Valiant Ferizi”	P-70505059-00061-0	7194	
22.	Pozhar	Pozhar	P-70505059-00057-0	2018	Të xhamia
23.	Kodrali	Kodrali	P-70505040-00321-1	4003	
24.	Ratish e Epërm	“Arifaj”	P-70505015-00269-0	12276	
25.	Dashinoc	“Mujë Mehmeti”	P-70505019-00446-0	5400	Varret e Xhurkaj
26.	Drenoc	“Enver Alaj”	P-70505026-00530-0	7022	Të xhamia
27.	Sllup	“Bilall Mazrekaj”	P-70505072-00243-0		Të përmendorja
28.	Prilep	“Gazmend Lokaj”	P-70505062-00273-0	2115	Të xhamia
29.	Prilep	“Blerim Lokaj”	P-70505062-00268-0	14682	Të shkolla
30.	Rastavicë	“Arben Qerimaj”	P-70505065-00723-0	9318	
31.	Rastavicë	“Tahir Kadrijaj”	P-70505065-00160-0	4970	
32.	Irzniq	“Cenë Bajram Daci”	P-70505068-00619-0	5566	
33.	Irzniq	Tek lapidari	P-70505068-00818-0	10173	Të lapidari i dëshmorëve
34.	Irzniq	Të ”Maxhun Çekaj”	P-70505068-00739-0	2074	Tek lapidari
35.	Irzniq	“Rexhep Dervishaj”	P-70505068-00103-1	3163	Varrezat e Mushkolajve
36.	Gllogjan	“Shkelzen Haradinaj”	P-70505013-00037-0	8160	Kulla dhe varrezat e dëshmorëve
37.	Gllogjan	“Shkelzen Haradinaj”	P-70505013-00045-0	1557	
38.	Baballoq	“Shalaj”	P-70505002-00641-1	43787	Suka në Baballoq
39.	Shaptej	“Rifat Beqiraj”	P-70505082-00357-0	14748	
40.	Gramaqel	“Jagozi”	P-70505016-00512-0	15386	Varreza
41.	Gramaqel	“Jagozi”	P-70505016-00510-0	58856	Varreza
45.	Gramaqel	“Gojanëve”	P-70505016-00143-0	11196	
46.	Lëbushë	“Enver Haradinaj”	P-70511057-00304-0	1121	
47.	Lëbushë	“Enver Haradinaj”	P-70511057-00303-0	1410	
48.	Lëbushë	“Enver Haradinaj”	P-70511057-00372-0	2198	
49.	Strellc i Ulët	“Rexhë Zeqaj”	P-70511028-00818-0	5302	
50.	Strellc i Epërm	“Tahir Zemaj”	P-70511022-00955-0	2868	
51.	Strellc i Epërm	“Tahir Zemaj”	P-70511022-00880-0	448	
52.	Strellc i Epërm	“Tahir Zemaj”	P-70511022-00890-0	1875	
53.	Dubovik	“Vëllezërit Gërvalla”	P-70511031-00148-0	2888	

Tabela 199 Vend lokacionet e varrezave sipas vendbanimeve[101]

[101] Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

4.4.11 Vendbanimet – planifikimi

4.4.11 Destinimet dhe përmasat

Komuna e Deçanit, shtrirjen e vendbanimeve në gjithë territorin e saj mund të përshkruhet si model i dy tipave si: vendbanime të koncentruar përgjatë rrugës kryesore në qendër të qytetit dhe rreth tij, kurse në zonën rurale zhvillimi i vendbanimit është kryesisht i shpërqendruar, një tip të tillë të vendbanimit e kemi edhe në periferi të qendrës urbane.

Plani synon të adresojë këtë çështje duke rekomanduar zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke filluar nga zona urbane e deri tek vendbanimet në zonën rurale. Investimet publike në përpjesëtim me rritjen e popullsisë synojnë të ofrojnë shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi, që janë element shumë me rendësi. Çdo vendbanim duhet të zhvillohet duke u bazuar në potencialin për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofroj shërbime duke marrë parasysh rritjen e popullsisë sipas të dhënave të vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2011 deri 2018, del se në Komunën e Deçanit, për çdo vit kemi shtim natyrore të popullsisë prej 225 banorë. Në fund të vitit 2021, Komuna e Deçanit, kishte 42753 banorë. Si rezultat përllogaritja e rritjes se popullsisë për vitin 2031, popullata e Komunës së Deçanit, do të jetë rreth 45199 banorë vendbanimet në vijim do të zhvillohen sipas funksioneve, Qyteti qendër Komunale dhe vendbanimet si nën qendra: Strellc i Epërm, Irzniq, Isniq, Drenoc, Gramaqel dhe shtrirja e vendbanimeve në Bjeshkët e Deçanit-Pleqe dhe Belle.


Emri	Funksioni	Klasifikimi sipas madhësisë
Deçani	Qendër Komunale	vendbanim urban
Strellc i Epërm	Nën qendër	Vendbanim i madh rural
Irzniq	Nën qendër	Vendbanim i mesëm rural
Isniq	Nën qendër	Vendbanim i madh rural
Drenoc	Nën qendër	Vendbanim i mesëm rural
Gramaqel	Nën qendër	Vendbanim i mesëm rural
Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, Llukë e Epërm, Pobergjë, Prilep dhe Strellc i Ulët	Vendbanim	Vendbanim i madh rural
Beleg, Dubovik, Gllogjan, Lloqan, Llukë e Ulët, Pozhar, Prapaqan, Prokolluk, Rastavicë dhe Voksh	Vendbanim	Vendbanim i mesëm rural
Dashinoc, Dubravë, Hulaj, Kodrali, Lëbushë, Lumbardh, Maznik, Papiq, Ratish i Epërm, Ratish i Ulët, Sllup, Shaptej dhe Vranoc i Vogël	Vendbanim	Vendbanim i vogël rural
Pleqe dhe Belle	Vendbanim	Vendbanim i vogël

Tabela 200 Funksioni dhe madhësia e vendbanimeve


4.4.11 Orientimi i zhvillimeve në të ardhmen

Planifikimi i akomodimit, zhvillimit në të ardhmen bazohet sipas kërkesave për zhvillim duke pasur në konsideratë rritjen e popullsisë dhe ekonomisë, ku ky zhvillim përkthehet në sipërfaqe të tokës, që duhet të planifikohet për të akomoduar kërkesat për zhvillim.


Planifikimi parasheh respektim të normave strikte, kufizimit të vendbanimeve me kufirin urban të caktuar, në gjithë territorin e Komunës së Deçanit, sa i përket në aspektin e pozicionit shpërndarës të vendbanimeve, pjesa dërmuese e sipërfaqeve ndërtimore të fshatrave: Isniq, Llukë e Epërme, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ulët, një pjesë e Lloqanit, i takojnë zonës urbane me caktimin e kufirit urban prej 729.75 ha, këto trajtohen dhe plotësohen sipas kritereve urbanistike të caktuara si zonë urbane. Sipas tipit të vendbanimeve të përqendruara në qytet dhe vendbanimet e shpërndara rurale duke u bazuar edhe në rritjen e popullsisë aktuale të banimit (njësi/banim/ha) në zonën urbane dhe rurale, ku kërkesat për tokë për të akomoduar zhvillimin në 8 vitet e ardhshme për zonë urbane janë afërsisht 50 ha tokë në vendin e quajtur Podi i Gështenjave, kurse në zonën rurale janë afërsisht 120 ha, ku i bie të jetë gjashtë njësi banimi në ha. Përllogaritja e tokës së nevojshme për akomodim të zhvillimit të ardhshëm për banim dhe ekonomi.



Harta 60. Kufiri ndërtimor i vendbanimeve



Harta 61. Kufiri ndërtimor zona urbane



Harta 62. Harta e zonave të destinuara me interes kombëtar dhe lokal

Synimi i planit është që zhvillimi të kontrollohet në mënyrë të balancuar dhe kompakt, duke përfshirë të gjitha zonat kadastrale me kufi ndërtimor. Për këtë arsye, dendësia mesatare e banimit në zonën urbane do të rritët nga 23 njësi banimi në hektarë në 55 njësi banimi në hektarë.

Në zonën rurale, zhvillimet do të përqendrohen në qendra të vendbanimeve nëpërmes kufijve për zhvillim. Dendësia mesatare e banimit do të rritët nga 4 njësi banimi për hektarë deri në 12 njësi banimi për hektarë, varësisht nga funksioni i vendbanimit. Kjo do të mundësojë zhvillim më të përqendruar dhe kompakt në të gjitha vendbanimet e Komunës.

Tabela më poshtë paraqet dendësitë e parashikuara për zonën e parë, dytë dhe tretë të qytetit po ashtu edhe në zonat rurale. Alokimi i saktë i dendësive të banimit për çdo pjesë të zonës urbane dhe rurale do të përcaktohet saktësisht në Hartën Zonale të Komunës (HZK). Rrjedhimisht, pas përcaktimit të dendësive për zonë urbane dhe rurale do të përllogaritët saktë sasia e tokës e nevojshme për të mbështetë zhvillimin e ardhshëm, duke u bazuar në tipologjinë e ndërtimit.

Nr.	Emërtimi	Vendbanimi	Dendësia e aktuale-njësi banimi/ha	Dendësia e parashikuar-njësi banimi/ha	Dendësia e aktuale banorë/ha	Kategoritë e sipërfaqeve sipas dendësisë	Dendësia e parashikuar banorë/ha	Kategoritë e sipërfaqeve sipas dendësisë
1	Urbane	Njësia qendër dhe perëndim	55	55	259	SUK	259	SUK
2	Urbane	Njësia veri dhe lindje	45	45 - 50	212	SUQ	212 - 235	SUQ
3	Urbane	Njësia jug	23	23 - 35	108	SUP	108 -165	SUP
4	Rurale	Baballoq	4	4 - 5	19	SRIU	19 - 24	SRIU
5	Rurale	Beleg	5	5 - 7	24	SRIL	24- 33	SRIL
6	Rurale	Carrabreg i Epërm + Carrabreg i Ulët	7	7 - 12		SRIL	33 - 57	SRIL

7	Rurale	Dashinoc + Belle + Pleqe	3	3 - 4	14	SRIU	14 - 19	SRIU
8	Rurale	Drenoc	4	4 - 5	19	SRIU	19 -24	SRIU
9	Rurale	Dubovik	4	4 - 5	19	SRIU	19 - 24	SRIU
10	Rurale	Dubravë+Shaptëj	2	2 -3	10	SRIU	10 -14	SRIU
11	Rurale	Gllogjan	4	4 - 5	19	SRIU	19 -24	SRIU
12	Rurale	Gramaqel	4	4 - 5	19	SRIU	19 -24	SRIU
13	Rurale	Irzniq+ Prokolluk	4	4 - 5	19	SRIU	19 -24	SRIU
14	Rurale	Isniq	7	7 - 8	33	SRIL	33 -38	SRIL
15	Rurale	Kodrali	5	5 - 6	24	SRIL	24 - 28	SRIL
16	Rurale	Lëbushë	6	6 - 7	28	SRIL	28 - 33	SRIL
17	Rurale	Lloqan + Hulaj	4	4 - 5	19	SRIU	19 - 24	SRIU
18	Rurale	Llukë e Epërme	5	5 - 6	24	SRIU	24 -28	SRIL
19	Rurale	Llukë e Ulët + Lumbardh	3	3 - 4	14	SRIU	14 - 19	SRIU
20	Rurale	Maznik + Vranoc i Vogël	3	3	14	SRIU	14	SRIU
21	Rurale	Papiq	3	3	14	SRIU	14	SRIU
22	Rurale	Pobergjë	5	5	24	SRIU	24	SRIU
23	Rurale	Pozhar	4	4	19	SRIU	19	SRIU
24	Rurale	Prapaqan	4	4	19	SRIU	19	SRIU
25	Rurale	Prilep	5	5 - 6	24	SRIU	24 - 28	SRIL
26	Rurale	Rastavicë	4	4 - 5	19	SRIU	19 - 24	SRIU
27	Rurale	Ratish i Epërm	6	6 -7	28	SRIL	28 - 33	SRIL
28	Rurale	Ratish i Ulët	4	4	19	SRIU	19	SRIU
29	Rurale	Sllup	3	3 - 4	14	SRIU	14 - 19	SRIU
30	Rurale	Strellc i Epërm	5	5 - 6	24	SRIU	24 -28	SRIL
31	Rurale	Strellc i Ulët	4	4 - 5	19	SRIU	19 - 24	SRIU
32	Rurale	Voksh	4	4	19	SRIU	19	SRIU
SUK – sipërfaqe urbane kryesore SUQ - sipërfaqe urbane qendrore SUP – sipërfaqe urbane e përgjithshme SRIL – sipërfaqe rurale me intensitet te lartë SRIU – sipërfaqe rurale me intensitet te ulët								

Tabela 201. Zhvillimi i ndërtimit të vendbanimeve

Emri i vendbanimit	Zona e ndërtuar ha	Zona e pa ndërtuar në ha	Varrezat në ha	Total sipërfaqe në ha	Total sipërfaqe në ha	Total sipërfaqe në ha
Baballoq	72.7	429.3	5.1	507.1	2.00	74.70
Beleg	28.6	194.6	1.4	224.6	0.79	29.39
Carrabreg i Epërm + Carrabreg i Ulët	75.6	525.8	2.7	604	2.08	77.68
Dashinoc	13.7	742.3	0.2	756.1	0.38	14.08
Deçan	92.9	2734.8	1.5	2829.1	313.54	406.44
Drenoc	51.4	498.8	6.5	556.6	1.41	52.81
Dubovik	41.5	279.3	0.8	321.6	1.14	42.64
Dubravë + Shaptej	29	393.7	1.1	423.8	0.80	29.80
Gllogjan	39.1	605.1	0.9	645.1	1.08	40.18
Gramaqel	44.6	401.3	8.0	453.9	1.23	45.83
Irzniq + Prokolluk	65.1	546.5	2.3	613.9	1.79	66.89
Isniq + Belle	125.1	6821.1	2.3	6948.5	3.44	128.54
Kodrali	31.2	233.0	1.4	265.6	0.86	32.06
Lëbushë	29.2	302.6	0.5	332.3	0.80	30.00
Lloqan + Hulaj	29.6	2107.3	0.9	2137.8	0.81	30.41
Llukë e Epërme	40	201.1	3.6	244.7	1.10	41.10
Llukë e Ulët + Lumbardh	59.4	468.0	6.4	533.8	1.63	61.03
Maznik+ Vranoc i Vogël	25.4	870.5	0.5	896.3	0.70	26.10
Papiq	8.9	95.3	0.0	104.2	0.24	9.14
Pobergjë	41.8	1508.5	1.0	1551.3	1.15	42.95
Pozhar	17.6	160.6	0.7	178.9	0.48	18.08
Prapaqan	31.9	336.0	1.2	369	0.88	32.78

Prilep	57.9	478.8	1.5	538.2	1.59	59.49
Rastavicë	41.1	304.5	1.8	347.4	1.13	42.23
Ratish i Epërm	9	165.9	1.4	176.3	0.25	9.25
Ratish i Ulët	17	385.3	0.3	402.5	0.47	17.47
Sllup	13.7	90.4	0.7	104.7	0.38	14.08
Strellc i Epërm	111.8	2110.8	0.9	2223.5	3.07	114.87
Strellc i Ulët	77.1	377.1	0.5	454.7	2.12	79.22
Voksh	20.9	403.0	1.4	425.3	0.57	21.47
Irzniq II	0	3225.0	0.0	3225	0.00	0.00
			Gjithsejtë	29395.8	347.91	1690.71

Tabela 202. Zona e ndërtuar dhe zonat e planifikuara për ndërtim

4.4.12 Vendbanimet joformale – planifikimi

Në Komunën e Deçanit janë gjithsejtë të identifikuara 8 vendbanime joformale të cila planifikohen ti nënshtrohen procesit të formalizmit. Ky proces do te jetë proces afat gjatë mirëpo në varësi të zhvillimit të kornizës ligjore për trajtimin e vendbanimeve joformale edhe proceseve gjyqësore. Të gjitha vendbanimet joformale i kanë shërbimet sociale, publike, transportit dhe teknike. Problem të këto vendbanime janë çështja pronësore – toka mirëpo edhe shfrytëzimi i ndërtesave siç është rasti i Baballoqit 1 dhe Baballoqit 2 të cilat janë ndërtuar ne pronën komunale me synim të procesit të kolonizimit të këtyre zonave me refugjatet serb nga Kroacia dhe Bosnja në kuadër të programeve "Ju Program" dhe "Solidariteti". Në përgjithësi janë identifikuar 247 ndërtesa të llojit të banimit individual, dhe 64.81 ha. Në të jetojnë 247 familje dhe përafërsisht 1137 banorë.

4.4.13 Ndërtimet pa leje

Angazhimi ne vitet në vijim është qenë bashkëpunim edhe me banorët të parandalohen ndërtimet pa leje ndërtimore ndërsa të gjitha ndërtimet pa leje të identifikuara ti nënshtrohen trajtimit në bazë të Ligjit nr.08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit N6.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Procesi i trajtimit të ndërtimeve sipas projekt PZHK-së do të ndryshon vetëm në rast se ndryshon korniza ligjore për trajtimin e tyre.

4.4.14 Banimi - planifikimi

Komuna e Deçanit, duke marr për bazë zhvillimin si prioritet ka kërkesat me të mëdha për ndërtesat e banimit kolektiv. Aktualisht janë rreth 21 ndërtesa të karakterit kolektiv në zonën e qytetit duke i përfshirë edhe ato që janë në ndërtim e sipër, me kapacitetin prej 750 njësi banimi. Duhet të theksohet se këto janë të përqendruara përreth qendrës së qytetit, që patjetër është paraparë të përfshihet zgjerimi i qytetit në pjesën perëndimore-pjesa e re e qytetit.

Komuna e Deçanit, do të bëjë përpjekje që ta ruaj çmimin aktual i cili është i përballueshëm për një numër të banorëve por jo për të gjithë, prandaj do të vazhdohet me një strategji lokale fillimisht përmes partneritetit publiko-privat që të ofroj kushte në zbutjen e kostos së banesave dhe po ashtu të siguroj mundësinë për ndërtimin e dy ndërtesa të banimin social në afërsi të ndërtesat ekzistues. Planifikimet tjera për ndërtim do të jenë edhe në zonën e dytë dhe nën zonat tjera urbane.

Rritja e Tokës ndërtimore më e theksuar është në qytetin e Deçanit. Në fakt, rritja e kërkesës për banim është ma e lartë në zonën urbane se në zonat rurale. Kërkesat dhe aplikimet për leje të ndërtimit janë në rritje nga viti në vit. Sipas të dhënave nga DUMM , kërkesat për shtëpi individuale

janë më të shpeshta në krahasim me kërkesat për banim shumë banesorë, mirëpo në vitet e fundit, kërkesat për banim shumë banesorë janë në rritje nga viti në vit.

Kërkesat për shtëpi individuale janë kryesisht rezultat i:

- Rritjes së kualitetit të banimit (për shtëpi të re).
- Zhvillimi i ekonomive individuale duke ndërtuar shtëpi individuale dhe afarizëm në përdhese.
- Sigurimit të banimit për çiftet e reja.
- Sigurimit të banimit për mërgimtarët.

Kërkesat për banim në ndërtesat shumë banesorë janë kryesisht rezultat i:

- Kërkesave për banim me çmim të përballueshëm.
- Sigurimit të banimit për çiftet e reja.
- Sigurimit të banimit për mërgimtarët.

Duhet të cekët se në qytetin e Deçani, ekzistojnë vështirësitë e sigurimit – blerjes së tokës ndërtimore për shkak të mungesës së ofertës mirëpo edhe për shkak të çmimit të lartë për ato që ofertohen. Në anën tjetër, ndërtesat shumë banesore ofrojnë mundësi të sigurimit ma të lehtë të banimit dhe kjo i shkon më se shumti për përshtati çifteve të reja, mërgimit nga zonat rurale drejt zonës urbane, dhe ndarja e familjeve te mëdha. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, në Komunën e Deçanit, ekzistojnë 445 familje ose 7% me 8 anëtarë, 310 familje ose 6% me 9 anëtarë dhe 1017 familje ose 17% me 10 e më shumë anëtarë në familje. Po ashtu, trendi i blerjes dhe kërkesës për banim është shtuar në vitet e fundit edhe nga mërgimtarët.

Mërgimtarët përpos që janë blerës të njësive të banimit në ndërtesat shumë banesore, ata po ashtu janë edhe investitorë në zhvillimin e sektorit të ndërtimit. Shfrytëzimi i banesave në ndërtesat shumë banesore nga ana e mërgimtarëve është shpeshtuar gjatë viteve të fundit. Trendët e shfrytëzimit të njësive të banimit nga mërgimtarët, ka qenë kryesisht gjatë periudhave të pushimeve verore dhe dimërore, mirëpo ne vitet e fundit shfrytëzimi i njësive banesore nga mërgimtarët është shpeshtuar. Kjo është e lidhur ngushtë me nevojat e vizitave të familjareve por edhe në sektorët e ndryshme ekonomikë.

Kategorizimi i kategorive për zgjerimin e Tokës ndërtimore ndahet në:

Rritja e popullsisë - vendbanimi i Deçanit (zona urbane) është vendbanimi më i kërkuar për banim dhe punësim, por njëkohësisht rritje të banimit dhe ekonomisë hasim edhe te vendbanimet e Isniqit, Llukës së Epërme dhe Carrabregut. Vendbanimi i Isniqit dhe Llukës së Epërme ndodhet ne kufi me vendbanimin e Deçanit, gjegjësisht ne pjesën verilindore dhe lindore, ndërsa Carrabregu ndodhet në pjesën juglindore dhe jugore të Deçanit. Shtrirja hapësinore ne dy dekadat e fundit, kane krijuar lidhshmëri te Isniqit, Llukës së Epërme dhe Carrabregut me Deçanin. Lidhshmëria ma e theksuar është me korridore ekonomike dhe ma pak me banim. Kjo ka ndikuar që lidhshmëria e këtyre tre vendbanimeve te krijojnë xhepa – boshllëqe të pa banuara. Lëvizja e popullsisë nga zona rurale drejt zonës urbane kane ndikuar ne rritjen e kërkesës për banim. Po ashtu, parashikohet qe rritja e popullsisë deri ne vitin 2031 të jetë 47874 banorë. Kërkesa për banim e rritë kërkesën për infrastrukturë dhe shërbime shtesë, duke çuar në zgjerimin e vendbanimeve ekzistuese ose krijimin e të rejave. Po ashtu, principi i krijimit të lagjeve të qëndrueshme dhe lidhshmëria e tyre ne mes veti me hapësira publike, korridore ekonomike, krijon qytet kompakt me synim të mbrojtjes së tokës bujqësore dhe mjedisit në përgjithësi.

Zhvillimi Ekonomik - faktorët ekonomikë luajnë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e vendbanimeve. Zonat që përjetojnë rritje ekonomike mund të tërheqin bizneset dhe banorët, duke çuar në zgjerimin e zonave urbane dhe zhvillimin e zonave të reja tregtare dhe banuese. Ne këtë rast, Deçani në vitet e fundit është bërë pikë me interes për zhvillimin e bizneseve të vogla por edhe

prodhuese duke u bazuar ne resurset dhe kapacitetet që i posedon. Ndikim ne rritjen ekonomike ne Deçan janë edhe investimet nga mërgimtarët të cilët vit pas viti i rrisin investimet ne Deçan ne bizneset e vogla, ndërtim, bujqësi dhe pjesërisht në turizëm.

Disponueshmëria e tokës - Disponueshmëria e tokës së përshtatshme për zhvillim është një faktor kritik në zgjerimin e vendbanimeve. Lidhshmëria e Deçanit me Isniqin, Llukën e Epërme dhe Carrabregun kanë krijuar xhepa – boshllëqe të pa ndërtuara të cilat planifikohen të përdoren si tokë ndërtimore. Këto xhepa -boshllëqe konsiderohen si tokë e disponueshme për ndërtim me synim të mbajtjes nën kontroll të zgjerimit të qytetit dhe lidhjen në mënyrë të kontrolluar të Deçanit me Isniqin, Llukën e Epërme dhe Carrabregun.

Infrastruktura - Infrastruktura e përshtatshme, si rrugët, shërbimet komunale dhe shërbimet publike, është thelbësore për zgjerimin e vendbanimeve. Zonat me infrastrukturë ekzistuese që mund të mbështesin rritjen kanë më shumë gjasa të shohin zgjerim në krahasim me zonat ku mungojnë këto lehtësira. Janë pikërisht vendbanimet Deçani, Isniqi, Lluka e Epërme dhe Carrabregu të cilat lidhen me rrugën R 107 dhe e shfrytëzojnë për lidhje në mes veti përpos shumë rrugëve tjera urbane dhe rurale. Qasja e mirë ne infrastrukturë të trafikut dhe në infrastrukturën teknike kanë nxitur zgjerimin e tokës ndërtimore në drejtimin verilindor, lindor dhe jugperëndimor.

Politikat e qeverisjes lokale – janë të orientuar drejt qytetit kompakt që do të ofrojnë hapësira për ndërtim duke ndaluar zgjerimin e vendbanimeve në zonat rurale.

Faktori mjedisorë - i të tillë si topografia, toka e ndërtuar ndikojnë ne zhvillimin e zgjerimit të vendbanimeve duke mos lejuar që të bëhet ndotja e tokës kualitative dhe të cenohen burimet natyrore (siç është rasti i lumenjve).

Faktorët socialë dhe kulturorë - duke përfshirë preferencat e komunitetit, zgjedhjet e stilit të jetesës dhe trashëgiminë kulturore, ndikojnë në zgjerimin e vendbanimeve. Disa lagje mund të kenë prioritet ruajtjen e karakterit të tyre historik ose ruajtjen e një cilësie të veçantë të jetës, duke ndikuar në rritjen e ritmit dhe natyrën e zgjerimit si rezultat i kërkesës për banim.

Kërkesa e Tregut - Kërkesa e tregut për banim, hapësira komerciale dhe kualitet jetese e nxisin zgjerimin e vendbanimeve. Prandaj zgjerimi dhe lidhja me vendbanimet Isniq, Llukë e Epërme dhe Carrabreg i plotëson këto kërkesa për një periudhë 8 vjeçare me mundësi të vazhdimit edhe për ma shumë vite.

Zhvillimi i teknologjisë – është kriter tjetër i rëndësishme i cili ofron mundësi inovative ndaj zhvillimit, të tilla si iniciativat e qytetit të zgjuar, praktikat e qëndrueshme të ndërtimit dhe infrastruktura digjitale.

Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat sipas Planit Lokal për Efiçencë të Energjisë dhe Ligji për Programet e Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164 dhe kërkesat e kodit të ndërtimit.

Tërësia "Zona rurale e Komunës Deçanit" - është zonë e cila do të zhvillohet duke akomoduar veprimtari bujqësore dhe banim. Shfrytëzimet e tokës bujqësore janë të lejuara në këtë zonë: bujqësi, industri e prodhimeve

4.4.15 Shfrytëzimi i tokës – Planifikimi

Mjedisi karakterizohet me diversitet të formave të shumta natyrore si dhe me ndikime të ndryshme të faktorit njeri. Në bazë të veçorive fiziko-natyrore dhe atyre humane Komuna e Deçanit, është e ndarë në tri tërësi natyrore ku përfshihen edhe aktivitetet tjera shoqëroro-ekonomike. Ndarje

hapësinore e planifikuar sipas ndarjes fiziko-natyrore dhe atyre humane ndahet në:

- Tërësinë "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët"
- Tërësinë "Urbane dhe trashëgimia kulturore"
- Tërësinë "Zona rurale e Komunës Deçanit"

Tërësia "Trashëgimia natyrore – Bjeshkët" : *Kjo pjesë trajtohet ne harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*

Tërësia "Urbane dhe trashëgimia kulturore": *një pjesë e kësaj tërësie trajtohet ne harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".*

Tërësinë "Urbane dhe trashëgimia kulturore": pjesa urbane përfshin një sipërfaqe prej 729.75 ha, është bartëse kryesore e zhvillimit administrativ social dhe ekonomik bazuar në interesimin dhe kërkesat e vazhdueshme për zhvillim, në ketë zonë duhet, që hapësirat të jenë të balancuara në gjithë kufirin urbanë. Zona urbane si tërësi ndahet në dy zona: banim, shërbimet administrative dhe shërbime të tjera ekonomike, sociale, parqe dhe hapësira publike.
Zona urbane ndahet në 5 njësi urbane: Njësia qendrore, njësia lindore, njësia jugore, njësia perëndimore dhe njësia veriore.

Njësia qendrore: Është pjesa ma vitale e qytetit të Deçanit e cila ka ndikim ne drejtimin dhe zhvillimin e tërë pjesës perëndimore dhe lindore. Ne kuadër të shfrytëzimit , në pjesën qendrore ekzistojnë numër i madh i NVM, banimi, infrastruktura administrative, arsimore dhe shëndetësore. Kjo zonë në pjesën veriore kufizohet me Lumëbardhin e Deçanit, në pjesën lindore me një pjese të fshatit Llukë e Epërme dhe me një pjesë të Carrabregut të Epërm duke ndjekur rrugët ekzistuese. Ne pjesën jugore me vendbanimin Carrabreg duke e kaluar Carrabregun e Epërm ne drejtimin perëndimor, paralelë me rrugën regjionale R107 në drejtimin verior drejt qendrës se qytetit dhe duke kaluar ne rrugën e Manastirit lidhet më pikën e fillimit. Kërkesat dhe tendencat e zhvillimit të njësisë qendër janë mjaft të larta, si në zhvillimin e NVM, ndërtimet e larta me destinime afariste dhe banesore, qendra biznesi, markete, parkingjet, hapësira publike të gjelbëruara etj. Deri me tani, rruga R107 shërben si arteria kryesore ekonomike me tendencë të zgjatjes ne drejtimin jugor deri të vendbanimi Baballoq në të dy anët e rrugës. E njëjta ka tendencë, duke u bazuar në kërkesat e investitorëve potencial, që të zhvillohet edhe në drejtimin verior – drejt vendbanimit Lybeniq. Kjo vijë afariste brenda njësisë qendër njihet si Korridori ekonomik i Deçanit. Nevojat për banim ne ketë njësi janë të larta dhe propozohet zbatimi i konceptit "qytet kompakt" me zgjerim të kontrolluar ku në rast të zhvillimit të turizmit apo nevojave tjera ekonomike, biznesoredhe kërkesave të investitorëve të respektohet ligji dhe të gjitha normativat teknike për planifikimin hapësinorë për këtë pjesë të qytetit.

Njësia lindore: Është pjesë e cila e paraqet edhe kufirin lindor të qytetit të Deçanit, ajo në perëndim kufizohet me zonën qendër ndërsa në pjesën veriore me zonën veriore. Njësia lindore ka shfrytëzim të kombinuar në mes të banimit individual dhe afarizmit. Tendencat për ndërtim në ketë zonë nuk janë të mëdha mirëpo kjo zonë konsiderohet si potencial ne të ardhmen për zhvillim me synim të zbatimit të konceptit qytet kompakt.

Deri në atë periudhë, në ketë zonë lejohet ndërtimi me destinim banimin si dhe zhvillimin e bizneseve – turizmit dhe nevojave tjera ekonomike duke respektuar ligjin dhe normat teknike të planifikimit hapësinorë. Me synim të largimit të automjeteve nga pjesa e njësisë qendër, propozohet që në ketë pjesë të hartohen politikat e qarta të lëvizjes dhe qarkullimit të automjeteve, duke i marr parasysh edhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të nivelit qendror.


Të pjesa e lumit Lumëbardhi i Deçanit, distanca e Vijës ndërtimore nga trupat ujorë të jetë në largësi prej 15 m nga pika e skajshme e anës së jashtme të shtratit të ujërave të mëdha në zonat urbane dhe

ku shtrati i ujërrjedhjës është i rregulluar dhe krejt në harmoni me Ligjin për ujërat dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. II neni 3. Inkurajohet që për synim të zhvillimit të turizmit urban dhe rural por edhe atij malor, kjo pjesë të zhvillohet me afarizëm të llojit gastronomi dhe hoteleri me etazhitet sipas normave dhe në harmoni me ligjin.

Njësia jugore: Është pjesë që përfaqëson pjesën jugore të vendbanimit të Deçanit e cila kufizohet ne verilindje me njësinë lindore, ne anën veriore me njësisë qendrore dhe në pjesën veriperëndimore më njësinë perëndimore. Kjo njësi është e dedikuar për banim të ulët me etazhitet sipas normave dhe në harmoni me ligjin. Në ketë njësi lejohet edhe zhvillimi i biznese të cilat mund të janë të kombinuara më banimin individual apo të veprojnë si njësi në vetë. Me synim të largimit të automjeteve nga pjesa e njësisë qendër, propozohet që në ketë pjesë të hartohen politikat e qarta të lëvizjes dhe qarkullimit të automjeteve, duke i marr parasysh edhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të nivelit qendror. Rëndësi e veçantë duhet ti jepet vazhdimësisë së Korridorit Ekonomik të Deçanit e cila e lidhë njësinë qendër nëpërmes njësisë jugore me vendbanimin Baballoq dhe me tutje deri ne kufi me Komunën e Gjakovës. Kjo nënkupton që ky Korridor Ekonomik i Deçanit, mund të ketë kombinime ne zhvillim në mes të afarizmit, gastronomisë, hotelerisë banimit, industrisë, me synim të mbrojtjes së tokës bujqësore dhe kualitative.

Njësia veriore – Është pjesë që e prezanton pjesën ma atraktive në aspektin mjedisor – lumi Lumëbardhi i Deçanit dhe ujë mineral, sportive – stadiumi dhe palestra, kulturore – një pjesë e Zonës së Veçantë të Mbrojtur dhe Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Në ketë njësi, planifikohet të zhvillohet banimi individual me etazhitet të lejuar sipas ligjit dhe normave teknike, të kombinuara me afarizëm të integruar në ndërtesa ose si njësi të veçanta. Kjo njësi karakterizohet edhe me Korridorin Ekonomik të Deçanit i cili zhvillohet ne drejtimin e Pejës. Të pjesa e lumit Lumëbardhi i Deçanit, ndërtimi i ndërtesave individuale nuk lejohet të jetë nën kriteret e parapara me Ligjin për Ujërat dhe Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë njëjtë sipas kritereve sikurse tek njësia lindore. Inkurajohet që për synim të zhvillimit të turizmit urban dhe rural por edhe atij malor, kjo pjesë të zhvillohet me afarizëm të llojit gastronomi dhe hoteleri dhe krejt në harmoni me Ligjin dhe normat teknike kurse *pjesa e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur, trajtohen me Ligjet ne fuqi.*

Njësia perëndimore (Qesta): Kufizohet me njësinë qendër, njësinë veriore dhe njësinë jugore dhe njëkohësisht e definon kufirin lindor të qytetit të Deçanit. Një pjesë e kësaj njësie është trajtuar me Plan Rregullues Urban "Qesta" dhe në ketë zonë kalon porta e grykës së Lloqanit dhe porta e Grykës së Deçanit. Gjithashtu është në zhvillim Qendra Rinore, Kolonia e Artistëve, Qendra e Trashëgimisë Kulturore, pishina e mbyllur me ndërtesa përcjellëse, Fshati Turistik (Podi i Gështenjave) Deçan, shtigje të biçikletave, shëtitore, shtigje për ecje – hiking etj. si dhe Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan. Andaj, edhe zhvillimi i ardhshëm i dedikohet planit të përmendur mirëpo duke e marr parasysh edhe propozimin e ri të rrugës R107 nga niveli qendror. Edhe në ketë njësi planifikohet ndërtimit individual duke respektuar ligjin në fuqi dhe normat teknike si dhe duke i marr parasysh edhe potencialet e zhvillimit me afarizëm të llojit të integruar në ndërtesa apo të veçuara për gastronomi, afarizëm, hoteleri në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit të qëndrueshëm.



Harta 63. Ndarja e zonës urbane - tërësitë urbane

Sipërfaqet e njësive ne zonën urbane			
Emri i njësisë	Sipërfaqe e banuar ekzistuese në ha	Sipërfaqe e banuar e propozuar në ha	Gjithsejtë
Njësia Veriore	39.7	49.8	89.5
Njësia Qendrore	69.4	50.6	120
Njësia Lindore	28.7	18.1	46.8
Njësia Jugore	42.2	17.5	59.7
Njësia Perëndimore	19.8	67.3	87.1
	199.8	203.3	403.1

Tabela 203. Sipërfaqet e njësive në zonën urbane

4.4.16 Ndryshimet nga PZHK-ja e mëparshme

Në këtë dokument të planifikimit , si rrjedhojë e fazës studimore kanë lindë disa kërkesa të reja të cilat na determinojnë ndryshime nga PZHK-ja e mëparshme. Fillimisht Zona Urbane e qytetit të Deçanit e ndarë në katër nën zona apo njësi me karakteristika të njëjta urbane nga e kaluara , tani kanë pësuar ndryshime. Ndryshimet kanë rrjedhur nga vetë zhvillimet ndërtimore dhe nga shfaqja e interesit të pronarëve te tokave në zonën urbane. Zona Urbane ka sipërfaqe prej 12.44 Km ². Të katër zonat janë risistemuar sipas toponimeve të vjetra dhe është bërë ndarja në 5 njësi urbane të reja me karakteristika më të sakta urbane dhe të ndërlidhura me nevojat zhvillimore dhe kërkesave të banorëve. Zgjerimet ndërtuese kanë ndodhur brenda zonës urbane – zona e tretë dhe zona e katërt si zonë e pa banuar, në drejtimin e Grykës së Deçanit ,mbi shkollat e mesme, ndërsa në zonën rurale janë bërë zgjerimet në pronat publike me interesin e zhvillimit si park biznesi dhe vende grumbullimi për produktet dhe prodhimet e rrethinës.

Projekt PZHK e vitit 2024 – 2032 është produkt i zhvillimeve të kontrolluara dhe të pakontrolluara të dekadës së fundit. Pas hartimit te profilit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese, projeksionet e

zhvillimit të ardhshëm janë të orientuara drejt zhvillimit të turizmit, bujqësisë, ndërmarrjeve te vogla dhe të mesme, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, infrastrukturës dhe akumuluesve. Pas vlerësimit të PZHK-së 2009 - 2017 dhe hartimit të projekt PZHK-së , 2024 – 2032 janë identifikuara disa ndryshime te zhvillimit:

- Në PZHK-në e vitit 2009 -2017 nuk janë përfshirë qëllimet e dala nga Plani Hapësinorë i Kosovës 2010 -2020 +, ndërsa projekt PZHK 2023 -2031 i ka të përfshira.
- Në projekt PZHK-në 2024 – 2032 pjesa perëndimore e komunës Deçanit është shpallë Park Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" për të cilin është hartuar Plani Hapësinorë "Parku Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna". Kjo zonë në PZHK-në 2009 – 2017 i është janë dedikuar zhvillimit të turizmit.
- Në projekt PZHK-ne 2024 – 2032 është caktuar edhe kufiri i Zonës së Veçantë të Mbrojtur për Manastirin e Deçanit i cili ne PZHK-ne 2009 – 2017 nuk ka qenë i identifikuar dhe i precizuar. Ne projekt PZHK 2024 – 2032 kjo zonë trajtohet në harmoni të plotë me Ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.
- Zhvillimi ekonomik vazhdon të jetë i përqendruar në rrugën kryesore gjegjësisht në R107, me synim të parandalimit të zhvillimit të ekonomive ne tokat kualitative bujqësore. Në PZHK 2009 -2017, ky aks rrugor i është dhënë prioritet të zhvillimit ekonomik mirëpo duke mos i sqaruara saktë zhvillimet ekonomike në hapësirat tjera të lagjeve dhe vendbanimeve.

  Ekonomik - Zhvillimi ekonomik në rrugën R107 do të vazhdon edhe me tutje sepse është një trend i cili ekziston që nga viti 1955 dhe i baraspeshon zhvillimet ekonomike dhe tregtare ne mes te zonës Lindore dhe perëndimore te Komunës Deçanit.

  Social – Ne këtë rrugë qasja është ma e lehtë dhe ndodhen mjaft institucione, administrative, shëndetësore, arsimore, shërbyese dhe tregtare. Zhvillimi i ekonomik në formë lineare i përgjigjet konceptit të Qytetit Linear të hartuar nga Arturo Soria y Mata Spanja i cili këtë koncept e ka zhvilluar se pari ne Vjenë e pastaj është kopjuar si praktikë në shumë qytete tjera. Ky koncept e segregon transportin, i përmban të gjitha institucionet administrative, edukative, dhe sociale. Përfshinë zonën e banimit, hapësirat publike dhe i jep mundësi zhvillimit bujqësor prapa këtij koncepti.

  Mjedisor – Rruga R107 është rrugë e kontaminuar nga lëshimi i vazhdueshëm i gazrave të automjeteve, pluhuri dhe ndërtimet. Sipas hulumtimeve ndotësit nga emetimet e automjeteve, nga konsumimi i automjeteve dhe rrugëve transferohen në tokë në grimca të cilat shpërndahen në ajër, tokë dhe ujë. Ndotja është më e madhe është pranë skajit të rrugës, por mund të shtrihet deri në me shumë se 50 m (deri maksimumi 70 metra). në disa toka ngjitur me rrugët mund të tejkalojnë pragjet mbi të cilat ekziston rreziku i mundshëm i dëmtimit të prodhimit të ushqimit. Më se shumti raportohen nivele të ngritura të kancerogjeneve si p.sh. hidrokarburet aromatike poli ciklikë.
- Në Projekt PZHK 2024 – 2032 me synim të mbrojtjes së mjedisit dhe të prodhimit të energjisë së ripërtritshme është planifikuar ndërtimit i parkut solar i cili do të zhvillohet me sektorin privat (PPP) dhe në partneritet me nivelin qendror.

  Ekonomik – promovimi i prodhimit të energjisë së ripërtritshme do të gjeneron të hyra në nivel komunal, sektori publik si dhe do ta lehtëson furnizimin me energji elektrike kompanisë përgjegjëse. Ndërtimi i mundshëm i parkut solar nëpërmes partneriteti PPP do të nxis imazhin e Komunës Deçanit si vend miqësor ndaj investitorëve.

Social – do të rrit interesimin dhe vetëdijesimin e banorëve të Komunës Deçanit që të mendojnë rreth energjisë së ripërtritshme dhe ti ulin shpenzimet dhe të krijojnë mjedis të pastër.

Mjedisor – do të rritë vetëdijesimin e qytetarëve për energjinë e ripërtritshme si dhe do të krijon një mjedis ma të pastër.

- Ne projekt PZHK-në 2024 – 2032 janë zbatuar Normat Teknike për Planifikim Hapësinorë ndërsa ne PZHK 2009 -2017 nuk ka pas normat teknike për planifikim hapësinorë por janë zbatuar vetëm rregulloret komunale.
- Ne PZHK-2024 – 2032 është hartuar Vlerësimi Strategjik Mjedisor ndërsa miratimi i PZHK-së 2009 – 2017 ka pas vetëm qëllime të caktuara në aspektin mjedisor.
- Në Projekt PZHK-ne 2024 – 2032 zhvillimi i politikave të banimit është ma i qartë në krahasim më PZHK-në 2009 – 2017 ne të cilin numri i kateve për lagjet dhe vendbanimet nuk ka qenë i caktuar. Zgjerimi i tokës ndërtimore ne zonat e banuar janë bërë me kujdes ndaj tokës kualitative bujqësore. Ne pjesën urbane kufijtë e zgjerimit janë caktuar me rrugët ekzistuese gjegjësisht duke krijuar kufi fizik në krahasim me planin e me hershem kur kufijtë janë caktuar me ngastra kadastrale. Zgjerimi e respekton gjendjen ekzistuese te ndërtuar, me rritje minimale ne krahasim me Planin Zhvillimor Komunal dhe duke i respektuar kufijtë e Planeve Rregulluese Urbane te miratuara. Një ndryshim është se ne pjesët e caktuara të është rrit dendësia me synim të krijimit të qyteti kompakt. Kufijtë e ri fizik do te lehtësojnë monitorimin e ndërtimit ndërsa mundësia e ndërtimit (shtëpi individuale, ndërmarrje, administrata etj.) do të jetë e barabartë për të gjithë duke respektuar parimin e reciprocitetit të ndërtimeve të reja në krahasim me ndërtimet te cilat nuk kanë leje të ndërtimit.
- Ndryshimet në infrastrukturën sportive janë evidente me qenë se ne PZHK 2009 -2017 nuk kanë qenë të planifikuara stadiumi dhe palestra sportive, ndërsa në projekt PZHK 2021 – 2032 zona e dedikuar për stadium dhe palestër sportive është e caktuar duke u bazuar në gjendjen ekzistuese për të cilën janë bëre edhe vlerësimet ë përgjithshme për zhvillimin në të ardhmen të infrastrukturën e sportit në të gjithë komunën.

  Ekonomike – Infrastruktura e sportit do të ketë shpenzime në buxhetin komunal për ndërtimit e terreneve sportive mirëpo me kalimin e kohës shumë familje do kursejnë sa i përket organizmit të lojërave sportive ne terrenet e hapura dhe nuk kanë nevojë për rezervime të terreneve sportive private.

  Sociale – me zhvillimin e infrastrukturës sportive do te rritet dukshëm socializimi dhe rritet jeta aktive.

  Mjedisore – do te këtë hapësira shume funksionale të cilat do të kanë ndikim pozitiv në mjedis.
- Ne projekt PZHK 2024 – 2032 në dallim me PZHK 2009 – 2017 janë planifikuar rrjetet e kanalizimit fekale dhe impiantet e trajtimit të ujërave duke u bazuar në gjendjen faktike dhe projeksionet ne te ardhmen.
- Ne projekt PZHK 2024-2032 është planifikuar ndërtimi i autostradës i njohur si “Autostrada e Dukagjinit” ndërsa ne PZHK 2009 -2017 rendësi i është dhen vetëm rrugës R107.
- Ne projekt PZHK 2024 – 2032 rruga rajonale R107 është trajtuar në harmoni me propozimin e nivelit qendror ndërsa në PZHK 2009 – 2017 rruga rajonale R107 nuk ka qenë e trajtuar në mënyrë specifike.
- Infrastruktura arsimore në projekt PZHK 2021 – 2032 janë të identifikuara dhe projeksionet ne të ardhmen janë ma të qarta si në pjesën tekstuale ashtu edhe në atë hartografike. Në PZHK 2009 – 2017, infrastruktura e arsimit është përmend në mënyrë të përgjithshme.

- Ne krahasim me PZHK 2009 – 2017, rruga R108 gjegjësisht e cila e lidh Kosovën e Malin e Zi nëpërmes komunës Deçanit, në projekt PZHK 2024 – 2032 është trajtuar në harmoni me politikat zhvillimore te infrastrukturës së niveli qendror.
- Në projekt PZHK 2024 – 2032, rrjeti rrugor është i kategorizuar dhe janë planifikuar projeksionet e shtrirjeve dhe lidhjeve të reja në harmoni me normat teknike për planifikim dhe planet sektoriale për qarkullimin e lirë, pa pengesa dhe rritjen e sigurisë. Gjithashtu është trajtuar edhe lëvizja aktive (ecja dhe çiklizmi) në krahasim me PZHK 2009 – 2017, ku prioritet ka qenë lëvizja pasive (mjetet motorike).
- Projekt PZHK 2024 – 2032 i trajton të gjitha zhvillimet e infrastrukturës ndërkufitare, turistike dhe ekonomike në harmoni me nivelin qendror në krahasim me PZHK 2009 - 2017 ku bashkëpunimi ndër komunal dhe ndërshtetëror nuk ka qenë i trajtuar sipas ligjeve ne fuqi.
- Sa i përket trashëgimisë kulturore dhe natyrore në projekt PZHK 2024 -2032 kjo çështje është e trajtuar në hollësi me lista te ndërtesave nën mbrojtje, norma teknike, dhe ligje për mbrojtje në krahasim me PZHK 2009 -2017 e cila trashëgiminë kulturore dhe natyrore e ka pas të trajtuar në mënyre të përgjithshme.
- Ne sferën e bujqësisë përpos identifikimit të zonave potenciale për zhvillimit të sektorit të bujqësisë, projekt PZHK 2021 -2023 i trajton hollësisht projeksionet zhvillimore të bujqësisë nga ujitja, rendimentet si dhe sektorin e blegtorisë.
- Menaxhimi i mbeturinave në PZHK 2024 – 2032 është shumë ma i hollësishëm duke u bazuar në politikat dhe programet sektoriale të hartuara nga komuna e Deçanit – “Deçani qytet ekologjik” ndërsa ne PZHK 2009 – 2017, menaxhimi i mbeturinave është trajtuar pjesërisht.
- Në projekt PZHK 2024 – 2032 janë bërë ndarjet e njësive brenda qytetit të Deçanit duke u bazuar ne gjendjen ekzistuese dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese në krahasim me PZHK 2009 -2017 ku zona urbane është trajtuar me Planin Zhvillimor Urban.

5 PRIORITETET STRATEGJIKE

PRIORITETËT STRATEGJIKË PËR ZHVILLIMIN E KOMUNËS SË DEÇANIT		
Sektorët	Nr.	Veprimet strategjike
Turizmi	1	Formalizmi i vendbanimeve në Bjeshkët e Deçanit si vende me vlera turistike duke u bazuar ne kornizën ligjore.
	2	Hartimi i Planeve të Hollësishme Rregulluese për shtatë zonat e rrëze bjeshke – brenda zonës urbane si potenciale për ndërtim të kontrolluar dhe zhvillim
	3	Planifikimi dhe ndërtimi i kontrolluar në të gjitha pikat e identifikuara si potenciale turistike të bjeshkëve
	4	Promovimi i turizmit – Ndërtimi i një qendre informative dhe jetësimi i projekteve për zhvillim
Infrastruktura	5	Ndërtimi i Autostradës së Dukagjinit e cila kalon nëpër Deçan
	6	Përfundimi i infrastrukturës rrugore në të gjitha punimet e filluara në Grykën e Deçanit
	7	Ndërtimi i rrugës transit (unazore-lindje perëndim) në Zonën e Qytetit
	8	Ndërtimet dhe masat mbrojtëse anti erozive në Shtratin e Lumëbardhit të Deçanit dhe të Lloqanit
	9	Sigurimi i transportit publik në të gjitha pikat frekuentuese e po ashtu edhe për Zonën Belle e Pleqe
	10	Ndërtimi i pendave akumuluese në Lumëbardhin e Lloqanit dhe të Deçanit
	11	Shpërndarja e rrjetit të ujësjellësit dhe mirëmbajtja e tij në të gjitha vendbanimet e Komunës së Deçanit
	12	Ndërtimi i fabrike për trajtimin e ujërave të zeza në afërsi të Lumëbardhit të Deçanit
	13	Vazhdimi i kanalizimit për pjesën e mbetur të zonës urbane dhe fshatrave
	14	Përfundimi i Elektrifikimit i të gjitha hapësirave ku ka filluar punimi posaçërisht furnizimi me energji në Zonën e Grykës.
Bujqësia	15	Përcaktimi i tokave bujqësore për kultivimin e bio-produkteve në Komunën e Deçanit
	16	Ndërtimi i tregut të kafshëve në hapësirën Komunale në Strellcin e Epërm
	17	Planifikimi i pikave grumbulluese për artikujt nga agrikultura dhe bimët mjekuese në: Fshatin Irzniq , Drenoc , Strellc, Deçan - Qestë.
	18	Rivitalizimi dhe mbrojtja e brezit të gështenjave dhe brezit të pishave në hapësirat e rrëze bjeshkëve
	19	Pastrimi dhe Rivitalizimi i pyjeve në Zonën Urbane
	20	Planifikimi i tregjeve mobile në Zonën e Qytetit
	21	Përcaktimi i tokave bujqësore për kultivimin e bio-produkteve në Komunën e Deçanit
	22	Ndërtimi i tregut të kafshëve në hapësirën Komunale në Strellcin e Epërm
Arsimi	23	Ndërtimi i shkollave në Komunën e Deçanit
Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore	24	Investimet në trashëgimi – Ndërtimi i Memorialit të Qytetit dhe Restaurimi i Kullave si vlera të trashëgimisë kulturore
	25	Eksplorimi i plotë dhe formalizmi i hapësirave në Qeli dhe Belle
Ruajtja e Mjedisit	26	Ndërtimi i gjashtë impianteve për pastrimin ujërave të zeza - me prioritet ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Fshatin Lumbardh
Parku i qytetit	27	Planifikimi dhe ndërtimi i parkut të Qytetit buzë Rrugës së Manastirit mbi shkollat e mesme deri në zonën e Podit të Gështenjave – Hapësirat e ish Kampit
	28	Ndërtimi i qendrave për grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe demolomi i tyre
Zhvillimi socio - ekonomik	29	Planifikimi dhe ndërtimi i Parkut të Biznesit në hapësirat në Fshatin Dranoc
	30	Ndërtimi i Qendrës Rinore në afërsinë e Shtëpisë së Komunitetit
	31	Ndërtimi i dy çerdheve në zonën urbane

Tabela 204 Prioritetet strategjike për zhvillimin e Komunës së Deçanit

6 Dispozitat për zbatim

Plani Zhvillimor Komunal i Deçani, është dokument bazë, që parasheh zhvillimin e dëshiruar hapësinor për të ardhmen. Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të komunës dhe sfidat kryesor që janë identifikuar, është përcaktuar vizioni për të ardhmen si dhe qëllimet që duhet të arrihen. Gjithashtu është propozuar korniza e zhvillimit Komunal sipas të cilit planifikim është me projekte konkret ku parashihet të realizohet një zhvillim i qëndrueshëm. Projekt Plani Zhvillimor Komunal i Komunës Deçanit parasheh fushat konkrete dhe mënyrën se si do të arrihet planifikimi, zhvillimi dhe mbrojtja e resurseve në tërë territorin e Komunës.

Plani është real dhe i zbatueshëm duke u bazuar në kapacitetet financiarë dhe njerëzore. Zbatimi konkret i këtij plani është prezantuar në këtë pjesë, ku përshkruhen dispozitat për zbatim, përmes të cilave përshkruhet mënyra më konkrete e zbatimit praktik të këtij plani. Pra, jepen udhëzimet dhe sugjerimet për realizimin e planit me hapa strategjik të propozuar, me tërë përmbajtjen e tyre, duke përfshirë afatet kohore, implikimet financiare dhe hapësirën përkatëse.

Projekt Plani Zhvillimor Komunal është në harmoni me dokumentet tjera strategjike siç janë:

- Plani Hapësinore i Kosovës dhe
- Plani Hapësinor i Parkut kombëtare “Bjeshkët e Nemuna”

Projekt Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit është dokument i cili i orienton zhvillimet ne të ardhmen në periudhë kohore 8 vjeçare gjegjësisht 2024 – 2032. Përgjegjës për zbatimin e këtij projekt plani është Komuna e Deçanit, me të gjitha sektorët menaxhuese të saj.

6.1 Dispozitat e Përgjithshme

Në këtë pjesë jepen informata për normat e përgjithshme të zbatimit të planit, ku përfshihen afatet kohore, përgjegjësit dhe kompetencat e secilës fushë të analizuar në nivelin Komunal. Plani Zhvillimor Komunal është hartuar për periudhën kohore 2024-2032. Përpilimi i planit bëhet së paku çdo 8 vite, në përputhshmëri me nenin 11, pikën 1.4 të ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174. Përgjegjës për përpilimin e Planit është Qeverisja lokale e Komunës së Deçanit. Plani gjithashtu është në përputhje të plotë me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-106, mbi elementët themelore të Planit Zhvillimor të Komunës dhe Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174. Plani merr parasysh të gjitha projektet e përcaktuara për t’u realizuar si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli Komunal. Dispozitat për zbatim përcaktojnë mënyrën e rregullimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së hapësirave sipas destinimit të përcaktuar. Plani përfshinë projekt-elaboratin me titull “Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032” që ka filluar procesin e hartimit që nga viti 2019. Përmes përfshirjes së stafit Komunal të Komunës së Deçanit. Ky plan është dokumenti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe të gjitha planet tjera i nënshtrohen këtij plani. Veprimet/projektet e propozuara në PZHK janë grupuar në dy faza të zhvillimit:

- Faza I: periudhën 2024 – 2028 ku kryesisht janë të përfshira projektet /veprimet afatshkurta të cilat edhe janë të ndërlidhura me kornizën afatmesme të planifikimit buxhetor Komunal;
- Faza II: periudhën 2028 - 2032 dhe i përfshin veprimet/projektet afatmesme dhe afatgjatë.

Në përputhshmëri me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, neni 26, Komuna duhet të përpiloj Hartën Zonale të Komunës në afat kohor prej 9 muaj pas miratimit përfundimtar të PZHK-së. Gjithashtu edhe të gjitha investimet në komunë që kanë karakter hapësinor duhet të jenë në

harmoni me propozimet dhe prioritetet e përcaktuara me Planin zhvillimor Komunal. Pas miratimit të planit dhe hyrjes së tij në fuqi, Komuna duhet të analizojë planin aktual buxhetor (kornizën buxhetore) dhe gjatë rishikimit të saj, Komuna inkorporon projektet e parapara në kornizën buxhetore. Meqenëse në kohën e përgatitjes së Planit të veprimit për zbatimin e projekteve të planifikuara në PZHK-ë duhet të parashihet me burimet financiare janë të vlerësuara, referencat e dhëna janë vetëm indikativë dhe shërbejnë si orientim për administratën Komunale në përgatitjen e projekteve. Detyra e bartësit/institucioneve përgjegjëse për zbatim të veprimeve është që në kohë të përgatisë dokumentacionin teknik, dhe në mënyrë aktive të angazhohet në sigurimin e financimit përmes aplikimit me projekte në ministritë përkatëse, të donatorët, ose përmes formave të ndryshme të partneritetit publiko-privat dhe bashkëpunimit me institucione tjera. Prandaj, Plani i veprimit është i rëndësishëm pasi që i shërben Komunës si mjet për të menaxhuar në mënyrë sistematike zhvillimet në territorin e Komunës.

Kushtet për rregullimin e hapësirës – janë të caktuara në projekt Planin Zhvillimor Komunal për Komunën e Deçanit nëpërmes të cilit janë të caktuara vendbanimet ne të cilat lejohet ndërtimit, shtrirja e infrastrukturës së transporti dhe teknike si dhe mbrojtja e zonave me trashëgimi kulturore dhe natyrore nga ndërtimet. Për zbatimin e kushteve të rregullimit, Komuna e Deçanit do të vazhdon edhe me proceset tjera të bazuara në kornizën ligjore (procesi i legalizimit) si dhe zbatimin e kritereve te zhvillimit dhe mbrojtjes së tokës kualitative bujqësore duke zbatuar udhëzimet e dala nga ligjet për kualiteti e tokës bujqësore, për lumenjtë, zonat e mbrojtura , mbrojtjen e mjedisit etj.

Kushtet e shfrytëzimit të tokës – janë të përcaktuara nga niveli lokal në përjashtim të Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”. Në ketë projekt Plan Zhvillimor Komunal, Komuna e Deçanit i cakton të gjitha projeksionet e zhvillimit të ardhshëm të vendbanimeve që kanë të bëjnë me banimit, ndërtimit, shërbimet administrative, shëndetësore, arsimore, kulturore, rekreative etj.; tokat bujqësore dhe politikat zhvillimore duke përfshirë blegtorinë, kullosat, pyjet; zhvillimin e zonave ekonomike, trajtimin e hapësirave më vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore; trajtimin e zhvillimit të turizmit duke respektuar kornizën ligjore për Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”; parandalimin rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore, zhvillimin e infrastrukturës së transportit me synim të promovimit të lëvizjes aktive dhe zhvillimin e infrastrukturës teknike.

Kushtet e zhvillimit jashtë vendbanimeve – do të lejojnë ndërtimin i cili është në interes shoqëror dhe komunal dhe i cili do të ju lehtëson nevojat për shërbime të banorëve. Në ketë drejtim inkurajojnë ndërtimet e hapësirave për aktivitete fizike dhe rekreacion ndërsa për qëllim të minimizimit dhe kontrollimit të ndërtimit propozohen që ndërtimet e për banimit janë në skaj të rrugëve më synim të mbrojtjes së tokës bujqësore.

Kushte për zhvillimin e ekonomive – janë të përcaktuara zonat ku do të zhvillohen aktivitetet ekonomike të cilat janë thelbësorë për Komunën Deçanit. Komuna e Deçanit do të ofron disa pika ku do të zhvillohet ekonomia si dhe bizneset me synim te rritjes se numrit të punësuarve. Në anën tjetër është e nevojshëm që me krijimin e zonave ekonomike apo të bizneseve, të mbrohet toka bujqësore dhe të shfrytëzohen mundësitë e rrugëve kryesore siç është rasti i korridorit Deçan – Gjakovë apo Deçan – Pejë.

Kushtet për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë – janë të përcaktuara në projekt Plan Zhvillimor Komunal, duke ofruar projeksionet e zhvillimit të ardhshëm bujqësor dhe blegtori. Pjesa ma e madhe e Komunës Deçanit do të zhvillohet për bujqësi duke përfshirë edhe një pjesë të zonës urbane, në përjashtim të pjesës Parku kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna” ne të cilin do të zbatohet Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”.

Kushte për zhvillimin e turizmit dhe hotelerisë – janë të përcaktuara zonat ne të cilat do të bëhet zhvillimi i turizmit. Në pjesën e parkut kombëtarë do të zbatohet Plani Hapësinorë i Parkut kombëtarë

“Bjeshkët e Nemuna” ndërsa për pjesën urbane dhe rurale janë të përcaktuara drejtimet e zhvillimit të disa llojeve të turizmit i cili do të ketë ndikim ne zhvillimin ekonomik të komunës.

Kushte e zhvillimit të korridoreve – janë të planifikuara dhe propozuara duke u bazuar në strategjitë e niveli qendror mirëpo edhe në interesat e nivelit lokal me synim të ofrimit të qasjes për të gjitha vendbanimet mirëpo edhe krijimin e rrjetit të korridoreve funksionale ne të gjithë komunën me synim të krijimit të balancit hapësinore për qasje të lehtë.

6.1.1 Detyrat dhe masat për zbatimin e planit

Komuna e Deçanit është përgjegjëse për ta udhëhequr tërë procesin për realizimin e këtij plani brenda periudhës kohore 2024-2032. Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit është koordinator i realizimit të këtij plani, por gjithashtu edhe Drejtoritë tjera Komunale do të jenë të involvuara drejtpërdrejtë, duke marrë për sipër zhvillimin e fushave përkatëse në harmoni të plotë me këtë dokument.

Të gjitha zhvillimet e parapara në këtë plan parashihet të financohen nga: buxheti Komunal, qendror, donacione dhe nga biznesi privat e cila mbështetje financiare kërkon një bashkëpunim ndër-institucional dhe konkretisht nga sektorët gjegjës që të kenë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha këto institucione dhe akteret kyç për realizimin e planifikimeve të planit. Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit vazhdimisht përcjell zbatimin e planit dhe rrjedhën e zbatimit të tij, gjithashtu realizon edhe hulumtime që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin urban.

6.1.2 Dispozitat përfundimtare

- Me miratimin nga Kuvendi Komunal i Deçanit ky plan bëhet i plotfuqishëm.
- Vlefshmëria e planit do të jetë 8 vjeçare (2024-2032)
- Monitorimi do të bëhet nga DUMM në baza vjetore.

6.1.3 Sistemi i monitorimit

Koordinimi dhe monitorimi i veprimeve për zbatimin e PZHK-së duhet të realizohet përmes vendosjes së një Sistemi të integruar ku përveç regjistrimit të dhënave analitike, mundësohet edhe përcjellja e ndryshimeve apo fenomeneve specifike në hapësirë dhe fushë të përfshirë në PZHK. Bazën për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit e përbëjnë një grup i treguesve të cilët në mënyrë adekuatë e përshkruajnë zhvillimin hapësinor në Komunën e Deçanit. Përzgjedhja e tyre duhet të bëhet bazuar në:

- ndërlidhjen e tyre me qëllimet dhe objektivat e Planit;
- mundësinë e monitorimit afatmesme dhe afatgjatë të tyre;
- rëndësinë e tyre për vendimmarrje gjatë hartimit të politikave të planifikimin hapësinor; dhe
- Pajtueshmërinë e tyre me treguesit për monitorimin e fushave zhvillimore të PZHK-së.

Me vendosjen e një Sistemi informativ të integruar për monitorim dhe raportim të rregullt (në baza vjetore) të zbatimit të Planit, themelohet një bazë elektronike e projekteve zhvillimore e cila azhurnohet rregullisht në përputhje me shkallën e realizimit dhe rezultatet e arritura. Përditësimi i të dhënave bëhet në mënyrë periodike në mënyrë që monitorimi të siguron në vazhdimësi informata kthyese lidhur me shkallën e zbatimit të programeve dhe projekteve të PZHK-së dhe rezultateve të zbatimit të tyre. Në bazë të këtyre informatave, drejtoritë relevantë të Komunës janë të obliguara të përgatisin Raportet vjetore monitoruese të aktiviteteve të tyre, të cilat DUPMM i konsolidon në një raport përfundimtar të monitorimit të zbatimit të PZHK-së. Raporti përfundimtar dorëzohet në zyrën e Kryetarit dhe në Asamblenë Komunale për shqyrtim dhe për të nxjerrë vendimin për hapat e mëtutjeshëm para se të dorëzohet në MMPHI.

6.1.4 Përgjegjësit e monitorimit

Për monitorimin e zbatimit të PZHK-së në nivel strategjik janë përgjegjës: Ekzekutivi, Kuvendi Komunal dhe akteret e tjerë relevant (shoqëria civile). Ndërsa në nivelin operacional monitorimi është detyrë e Ekipit koordinues/grupit i cili në baza vjetore raporton për arritjen e rezultateve të pritura nga zbatimi i projekteve dhe përgatit propozimet për ndryshim nëse është e arsyeshme edhe me plane konkrete.

	Qëllimi	Rezultatet direkte	Efektet
Indikatori			
Përshkrimi i indikatorit			
Vlera fillestare			
Vlera e synuar			
Burimi i informatave			
Periudhat e matjes			
Institucioni përgjegjës			
Raportimi			

Tabela 205 Tabela e monitorimit të zbatimit të PZHK-së

Ndikim i lartë	Ndikim i mesëm	Ndikim i ulët	Nuk ka ndikim

Tabela 206 Niveli i ndikimeve

Vërejtje*: Plani i veprimit do të detalizohet dhe plotësohet me afatet e zbatimit pas shqyrtimit publik.*

7 PLANI I VEPRIMIT

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË ADMINISTRATË	Administrata funksionale dhe efikase	Ndërtimi i objektit të ri të komunës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	6500000
		Avancimi i sistemit elektronik, ku çdo qytetar të ketë mundësi të informohet me gjithçka që i intereson dhe të mund të plotësoj formular dhe parashtroj kërkesa sipas nevojës së tij përmes sistemit elektronik si digjitalizimit të administratës.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	12850
		Decentralizimi i administratës – Funksionalizimi i shërbimeve administrative edhe në qendrat sekondare.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	15420
		Kuadër i profesionalizuar i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve-avancimi i sistemit elektronik.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	12850
		Hartimi i Planeve rregulluese të hollësishme për Zonën urbane të qytetit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	250000.00
		Hartimi i projekte të ndryshme në interes zhvillimi të Komunës së Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	560000.00
		Hartimi i Planeve rregulluese të hollësishme në Zonat e III-ta zhvillimore në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	1500000.00
		Hartimi i Planeve rregulluese të hollësishme për VJF	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	75000.00
		Ndërtimi i Aneks Objektit për Zjarrëfikësa (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	80000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS TRANSPORTIT							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS TRANSPORTIT	INFRASTRUKTURE SMODERNE DHE E SIGURT	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqe (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	4000000.00
		Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Belle (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	150000.00
		Vazhdimi i asfaltimi i rrugës në fshatin Belle e Sipërme dhe e Mesme	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	133500.00
		Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osa (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	350000.00
		Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Muharrem Lataj	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	280000.00
		Rregullimi dhe sinjalizimi i shtigjeve për ecje në Bjeshkët e Deçanit.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	30000.00
		Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugës për në Bjeshkën e Madhe (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	350000.00
		Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugës për në Bjeshkën e Madhe Faza II-të 9 (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	500000.00
		Rregullimi dhe sinjalizimi i shtigjeve për ecje në Bjeshkët e Deçanit.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	30000.00
		Renovimi i rrugëve dhe rrugicave në Deçan në bashkëfinancim më Qytetarët	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe qytetaret	430000.00
		Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës së Qendrës së qytetit të Deçanit Faza e III-të në bashkëfinancim më qeverinë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	7500000.00
		Lloti III-të, Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Strellc i Epërm, Strellc i Ultë dhe Llukë e fshatrat tjetra (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	450000.00
		Ndërtimi i parkingjeve ne hyrje te qytetit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna	120000.00
		Ndërtimi garazhës publike	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatorë	1000000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - TURIZMI							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	Ekonomi funksionale dhe efikase	Ngritjen e kapaciteteve humane në fushën e turizmit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000
		Ndërtimi i Shtëpisë së Shoqatës së Bjeshkatarëve " Shkelzen Haradinaj" (vazhdim i projektit)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	452000
		Ndërtimi i Mulliri Tradicional në Parkun Kombëtar, Zonë Kadastrale Deçan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	85600
		Krijimi dhe ndërtimi i fshatit turistik " Laku i Kryqes"	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	545200
		Ndërtimi i Rezidencën Turistike të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	458500
		Ndërtimi i Qendër e grumbullimit, përpunimit te frutave dhe bimëve mjekuese më Kompleks Gastronomikë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	685000
		Ndërtimi i tri pendave akumuluese të ujit në Gryken e Lloqanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	1850000
		Ndërtimi i qendrës për rruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e produkteve të gështenjës afër fshatit Strellc i Epërm (ne brezin e gështenjës që shtrihet ne kuadër të Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	185000
		Ndërtimi i Qendrës turistike bashkëfinancim më IPA, GIZ dhe EU Faza e II-të (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Ndërtimi i Shtëpisë Alpine bjeshkatare Faza e II-të (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Ndërtimi i Pishinës së mbyllur gjysmë olimpike (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	700000.00
		Ndërtimi i katër villave në hapësirën afër gjashtë villave ekzistuese të ndërtuara te Fshati Alpin (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	160000.00
		Ndërtimi i Qendrës turistike bashkëfinancim më IPA, GIZ dhe EU Faza e II-të (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Ndërtimi i Shtëpisë Alpine bjeshkatare Faza e II-të (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Ndërtimi i pushimoreve për turistë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	120000.00
		Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjave (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	30000.00
		Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjave Faza e II-të	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	120000.00
		Ndërtimi i pushimoreve për turistë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	120000.00
		Shtimi i shtigjeve për ecje me destionacion turistik	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatorë	150000.00

		Zhvillimi i sporteve ekstreme dhe aventureskë ne kombinim me zhvillimin e turizmit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatorët	200000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT – UJËSJELLËSI							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË UJËSJELLESIT	Ujësjellësi funksionale dhe efikase	Funksionalizimi i klorinatorëve në Komunën e Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh.A - Pejë	4580
		Rehabilitimi në disa pjesë të ujësjellësit në qendër të qytetit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh.A - Pejë	50000
		Sistemi i ujësjellësit në rajonin e Vokshit do të pajiset me ujëmatës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh.A - Pejë	18500
		Rritja dhe zgjerimi i kapaciteteve me ujë të pijshëm ne Hulaj	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh.A - Pejë	160000
		Marrja në menaxhim e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në tërë territorin e Komunës së Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KRU "Hidrodrini" Sh.A - Pejë	45850
		Ndërtimi i Ujësjellësit në Bjeshkët e Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	285000
		Hulumtimi dhe analizimi i mundësisë së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	15000
		Ndërtimi i ujësjellësit në Bjeshkën e Madhe	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	170000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT – KANALIZIMI							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KANALIZIMI	Kanalizimi funksionale dhe efikase	Ndërtimi i kanalizimit në 18 fshatra	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	8500000
		Ndërtimeve i rrjeti të kanalizimit dhe tri impianteve në: Strellc i Ulët (Bohriqe), Dubovik (lagjeje Gërvallaj), Papiq, Isniq dhe Prapaqan.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	15000000
		Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferik në pjesën e vjetër të qytetit e ashtu quajtura (rruga e vjetër) me gjatësi prej 3 km	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000
		Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferik në vendbanimet: Strellc i Epërm, Isniq, Carrabreg i Epërm, Irzniq dhe Drenoc ku do të jetë me gjatësi prej 12 km.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	800000
		Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Elena Gjika	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	230000

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT - KANALET E UJITJES							
TRATEGJIA E ZHVILLIMIT BUJQËSI	Bujqësi funksionale dhe efikase	Kanali i Llukës së Epërme - 2600 m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	138650
		Kanali i Gështenjës	Komuna	Komuna	2024-2022	Komuna dhe donatorë	150000
		Kanali i Brenovicave (Hulaj - Lloqan) 2000 m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	115000
		Kanali i Durakut ne Irzniq - 3000m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	178000
		Kanali i Mlekut ne Irzniq - 1780m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	136500
		Kanali i Mushkolaj - 1700m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	114500
		Kanali i prronit në Gllogjan - 600m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	78450
		Kanali i Mullirit në Gllogjan - 680m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	44200
		Kanali i malit në Baballoq - 1860m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	115400
		Kanali i Kuçishtave në Baballoq - 1500m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	74500
		Kanali i Ramosaj – Hysen Kuçi - 1000m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	65000
		Kanali i Drenocit (Deçan - Drenoc) - 2600m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	149500
		Vija e Gumureve - Carrabreg - 1200m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	88650
		Kanali i Bunarit te Fushës - Ledina - 2000m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	125000
		Kanali i Gërdajave 1+2 - 1000m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	65000
		Vija e Sadik Ramve për gjatë asfaltit - 800m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	55000
		Kanali i Prapaqanit - 1400m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	91000
		Kanali i Prilepit, vazhdim nga ‘’Lokaj Plast’’ - 1850m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	118400
		Kanali i Prilepit, Rastavicë kah Shkolla deri tek Ambulanca - 1300m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	84500
		Kanali te Kameraj – Company - Lëbushë - 320m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	22400
		Lëbushë lagja – Varrezat e Nuraj - 400m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	28500
		Kanali Deçan – Drenoc, pjesa nën Lumë (shtrat të lumit) të Lloqanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	86500
		Kanali kodra e Vokshit – Lugje - 2500m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	162000
		Kanali i Bajraqeve në Jasiq të Ri (Penda e Ujitjes ska metra)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	85200
		Kanali Deçan – Carrabreg – Prilep – Rastavicë - 4500m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	282500
		Kanali i Arave të Dushkut - 2800m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	196000
		Vija e Rreknimit - 2000m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	18650
		Kanali i Orrnicave - 400m	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	32500
		Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan, Isniq, Carrabreg, Beleg, Kodrali dhe Irzniq (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatorët	450000
		Ndërtimi i pendave të ujitjes në Lumëbardhin e Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	400000

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
	Energjia elektrike funksionale dhe efikase	Ndriçimi i rrugëve dhe shesheve publike në zonat rurale parashihet, që të jetë me gjatësi prej 80 km, në periudhën kohore 2023-2031, ku afërsisht do të jenë të ndriçuara rreth 90 % e rrugëve dhe shesheve, ndërsa 10 % e rrugëve do të ndriçohen në zone urbane të cilat janë të pa përfunduara	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KEDS	342000
		Zgjerimi i Ndriçimit Efiqient publik nëpër fshatrat Baballoq, Shaptej, Dubovik, Papiq dhe Maznik (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe KEDS	350000
		Elektrifikimi i Bjeshkës se Belegut, Pleqe dhe Belle (vazhdim)	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	800000
		Elektrifikimi i Bjeshkës së Madhe Faza e II-të (vazhdim)	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	326723
		Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut (vazhdim)	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	150000
		Rregullimi i rrjetit elektrik të vjetruar në fshatin Baballoq	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	997731
		Ndërrimi i shtyllave dhe rrjeti i ri 10 kv në fshatra: Hulaj, Pobergjë	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	9747
		Në lagjen Tahirsylaj në Isniq ndërrimi i rrjetit të tensionit të ulët 0.4 Kv	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	43321
		Ndërrimi i rrjetit në fshatin Irzniq – Aliçkaj, kodër-zhvendosja e trafos	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	10403
		Ndërrimi i rrjetit në fshatin Lumbardh lagja Molukëve	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2022-2032	Komuna dhe KEDS	10915
		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Pozhar lagja e ashtu quajtur Qaush Asllanit	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	18560
		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në Carrabreg i Ulët në lagjen Ramosaj II	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	5501
		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Pobergjë vendi i ashtuquajtur trafo e varrezave	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	33976
		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Irzniq në lagjet Aliçkaj dhe Zejnaj	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	16484
		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në fshatin Strellc të Ulët 0.4 Kv në lagjen Pajazitaj - Hoxhaj	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	28922

		Ndërrimi i rrjetit nga i vjetri në të ri në dy fshatrat Strellc i Epërm dhe Strellc i Ulet tensioni 10 Kv	Komuna dhe KEDS	Komuna dhe KEDS	2024-2032	Komuna dhe KEDS	30010
		Ndërtimi dhe vendosja e stabilimenteve për Shërbimin telefonik në Bjeshkët e Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25450.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohorë	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT - MENAXHIMI I MBETURINAVE							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MENAXHIMI I MBETURINAVE	Menaxhimi i mbeturinave funksionale dhe efikase	Furnizimi dhe shpërndarja e Kontejnerëve 1.1 m^3	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	12600
		Rregullimi i hapësirës - bazamentit dhe rrethojave për vendosjen e ishujve ekologjik	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	30000
		Kontejnerë të plastikës 1.1 m^3 – kontejnerë me ngjyrë të cilët do të vendosen në ishujt ekologjik	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	20000
		Kontejnerë të plastikës 240 L - Kontejnerë me ngjyrë të cilët vendosen në ishujt ekologjikë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	10000
		Furnizimi dhe shpërndarja e Kontejnerëve të plastikës 120 L	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	16000
		Furnizimi më Enë për kompostim	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000
		Investimet në infrastrukturë për qendrën grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi dhe demolomi	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	150000
		Ndërtimi i deponisë inerte	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	60000
		Ndërtimi i objektit për mbeturina të vëllimshme	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	100000

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT - ARSIMI							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT ARSIMI STRATEGJIA E ZHVILLIMIT - ARSIMI	Arsim funksional dhe efikas	Asfaltimi dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 120 m dhe gjerësi 5 m dhe hapësira për 50 parkingje në Deçan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	75000.00
		Renovimi i Shkollës në fshatin Voksh (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	34776.00
		SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit"– Baballoq Ndërtimi i aneksit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	54000.00
		SHFMU "Dëshmorët e Vokshit"- Pobergjë Ndërtimi i aneksit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	23188.00
		SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës" - Llukë e Epërme Sanitare fushore dhe rregullimi i shiritit të ecjes me kubëza	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	16750.00
		Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"-Deçan Punimi i kanalizimit për kyçjen e ujërave të zeza të objektit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	6800.00
		SHFMU "Sylejman Vokshi" - Prilep Ndërtimi i objektit të ri të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	800000.00
		SHFMU "Jusuf Gërvalla"- Prapaqan Ndërtimi i Sallës se sportit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	560000.00
		Rregullimi i hyrjes kryesore dhe oborrit të shkollës me kubëza	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	8000.00
		SHFMU "Ardhmëria"- Beleg Ndërtimi i objektit të ri të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	820000.00
		Ndërtimi i rrethojave në oborrin e SHFMU "Ardhmëria" në Beleg (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	34776.00
		SHFMU "Maxhun Çekaj" - Irzniq Renovimi i tërësishëm i shkollës (molerimi, demontimi dhe montimi i dyerve, sanitaret, rrethojat e shkallëve etj.)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	24560.00
		SHFMU "Lan Selimi" - Llukë e Ulët (paralele e ndarë) Rrethoja e objektit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	6580.00
		Renovimi i kulmit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	30600.00
		Zgjerimi i objektit të shkollës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	28000.00
		Trotuari për nxënës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	48600.00
		Ndërtimi i trotuareve në Rastavicë dhe Ratishë i Ulët (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	200000.00

		Sigurimi dhe pajisja me kabinetet për praktika profesionale sipas profileve te caktuara siç janë: Infermieria e përgjithshme, Informatika, Makineria, Turizmi dhe Hoteleria	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatorët	25000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SHENDETËSIA DHE MIRËQENIA SIOCIALE							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SHENDETËSIA DHE MIRËQENIA SIOCIALE	Shëndetësia dhe mirëqenia Sociale funksionale dhe efikase	Ndërtimi i inseneratorit në Irzniq	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	19500.00
		Ndërtimi i dy objekteve për banim social	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	758000.00
		Ndërtimi i objektit për të moshuarit Deçan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	185500.00
		Aplikimi i energjisë efiçiente në QKMF në Deçan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	100000.00
		Renovimi i AMF-së në fshatin Lumbardh	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	18500.00
		Blerja e një automjeti të ri për implementimin e programit për nënën dhe fëmijën, shërbimi i patronazhit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	32000.00
		Investime në shëndetësinë primare	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	165000.00
		Blerja dhe digjitalizimi i RTG në QMF e fshatit Strellc i Epërm	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	8500.00
		Blerja e softuerit për distribuimin e imazheve te RTG-ve	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	8500.00
		Blerja e aparaturës bashkëkohore për laboratorë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	44000.00
		Blerja e automjeteve te reja	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	75000.00
		Ashensori në QKMF në Deçan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT - HAPËSIRAT PUBLIKE							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSIRAT PUBLIKE	Hapësirat Publike funksionale dhe efikase	Ndërtimi i Sheshit të qytetit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	2200000.00
		Ndërtimi i Rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës rinore, Higjienës, Kolonisë së artistëve dhe Shtëpisë Alpine (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Ndërtimi i Varrezave të qytetit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	450000.00
		Memoriali i dëshmorëve në Bjeshkën e Belegut (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	250000.00
		Ndërtimi i Objekteve memorial të Dëshmorëve të kombit në fshatrat Llukë e Epërme, Drenoc dhe Kodrali.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	300000.00
		Investime kapitale në shtëpinë rezidenciale (infrastruktura sociale)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	75000.00
		Kompleksi memorial për të gjithë Dëshmorëve të kombit dhe veteranëve të Rrafshit të Dukagjinit në Gllogjan	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	775000.00
		Kolonia e Artistëve (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	35000.00
		Kolonia e Artistëve Faza e II-të (vazhdim)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	200000.00
		Hartimi i planit për hapësirat publike	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	50000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT-TRASHEGIMIA KULTURORE							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TRASHEGEMIA NATYRORE	Trashëgimia natyrore funksionale dhe efikase	Kulla e Mazrekaj - renovim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	22000.00
		Kulla e Haklaj - renovim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	22000.00
		Digjitalizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	5000.00
		Kompleksi i kullave në fshatin Drenoc - renovim për ofrimin e shërbimeve gastronomike	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	18500.00
		Kompleksi i kullave në Isniq – renovim për mbajtje të evenimenteve tradicionale	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	15500.00
		Organizmi tradicional i evenimentet të trashëgimisë	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	80000.00
		Fshati Belle ofrimi i ekoturizmit	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	6500.00
		Kulla në Belle - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	15500.00
		Kulla Ramosaj - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	CHËB	22500.00
		Kulla e Dëshmoreve - renovim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	30000.00
		Shtabi i UÇK-së në Gllogjan	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	100000.00
		Mulliri i Gjukaj - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	12500.00
		Kulla e Ibish Osmanaj - renovim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	22500.00
		Kulla e Ibish Sadikut Osdautaj - inventarizim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	18500.00
		Kulla e Himë Mushkolaj - inventarizim	Komuna	Komuna	2024-2032	UNDP	12500.00
		Kulla e Mustaf Dukaj - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	UNDP	32000.00
		Mulliri i Daut Osë Hulaj - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	14500.00
		Kulla e Ramë Povataj - renovim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	38500.00
		Kulla e Shaban Murat Gjukaj – restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	45000.00
		Kulla e Ali Isuf Mataj - restaurim	Komuna	Komuna	2024-2032	MKRS	45000.00
		Ndërtimi i Kullës muze të Verrat e Llukës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna - MKRS	60000.00
		Vazhdimi i ndërtimit të kompleksit të trashëgimisë në fshatin Belle	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	145800.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Akterët vendim marrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi €
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT MBROJTJA E MJEDISIT							
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË MBROJTJES SE MJEDISIT	Mbrojtja e mjedisit funksionale dhe efikase	Përgatitja e projekteve për mbrojtje, ruajtje dhe konservim të disa llojeve të fito - cenozes (gështenjës).	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	200000.00
		Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal për Biodiversitet	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	11500.00
		Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të menaxhimit të qëndrueshëm të shfrytëzimit dhe mbrojtjes të bimëve mjekuese.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	40000.00
		Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të menaxhimit të qëndrueshëm të shfrytëzimit dhe mbrojtjes frutave te malit.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	40000.00
		Përgatitja e projekteve për parandalimin e vërshimeve për fshatrat Strellc, Isniq, Dubovik, Prilep dhe Gramaqel.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	320000.00
		Hartimi i projekteve për mbrojtjen e veçantë të ngastrave të tokës nga përdorimi i pakontrolluar i plehut artificial në bujqësi (nitrate, nitritet, fosfatet dhe ushqyesit e tjerë).	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	15600.00
		Përgatitja e projekteve për mbjellje të fidanëve në zonat ku janë të pastruar me mbeturina.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000.00
		Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e ajrit.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	85000.00
		Hartimi i projekteve për mbrojtjen dhe pastrimin nga dëmtuesit (insektet) gështenjën dhe pishat. Revidim - Plani për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në Komunën e Deçanit	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000.00
		Hartimi i projekteve për ndërtimin e pendave mbrojtëse në lumenj, përroskave dhe përrenjve	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	150000.00
		Hartimi i projekteve për mbjelljen e fidanëve pyjore në brezin mbrojtës të lumenjve.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	18500.00
		Hartimi i projekteve për mbjelljen e drunjve që do të mbulonin rripin prej 10 m, largësi prej brigjeve të lumenjve kryesorë	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	17500.00
		Promovimi i praktikave të qëndrueshme të peshkimit për të ruajtur biodiversitetin e liqejve akumulues dhe lumenjve.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	15000.00
		Hartimi i Planit Operative Emergjent Lokal (POEL)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	23000.00

		Ndërtimi i pendave për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjtë në fshatin Strellc i Epërm: Prroni i Behovcit, Durakut dhe Suhaja në fshatin Dubovik.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	45000.00
		Pastrimi i shtratit të Lumëbardhit në pjesën nën Urën e Demës në fshatin Isniq, Llukë e Epërme, Llukë e Ulët dhe Lumbardh dhe shtratit të Lumëbardhit të Lloqanit në fshatin Prilep dhe Gramaqel.	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	85500.00
		Hartimi i projekteve dhe fushatave sensibilizuese për mbrojtjen e ujit nga përdorimi i pakontrolluar i plehrave artificiale në bujqësi (nitrate, nitrite, fosfate dhe ushqyesit tjerë).	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	33000.00
		Hartimi i projektit për deponitë e organizuara, për varrimin e kafshëve në rastet emergjente, si dhe mbrojtjen kundër mbeturinave të paligjshme (të gjitha llojet e mbeturinave)	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	28000.00
		Revidimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	25000.00
		Hartimi i Planit Lokal kundër Zhurmës	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	54750,00
		Ndërtimi i një qendre për strehimin e qeneve endacak	Komuna	Komuna	2024-2032	Komuna dhe donatoret	285000.00